

# MASKA E TRADHËTISË

Tiranë 2023

Boton:  
**IKlikLarg**

Biblioteka:  
**Thumbi**

Redaktor:  
**Andi Rakipi**

Recenzent:  
**Besim Jashari**  
**Mahir Rexhepi**

Lektor:  
**Sonja Erebara**

Redaktor teknik & dizajn:  
**Illir Podrimja**

**Tiranë 2023**

# Maska e tradhëtisë

## Gënjeshtrat e Shaqir Fetait dëm kolosal për BFI-në

*“Mos polemizo për ata që tradhtojnë vetveten. Allahu nuk e do atë që është gënjeshhtar e mëkatar.”* (En Nisa, 107)

Ditë më parë, në një kontribut televiziv të Tv Klan M, do të bëhet fjalë për xhaminë Mehmed Aga, në fshatit Llozovë, nga rrënojat e së cilës ka mbetur vetëm minarja. Lidhur me fatin e kësaj xhamie televizioni në fjalë i është drejtuar edhe BFI-së prej ku i paskan thënë se, në kuadër të këtij Institucioni ekziston një sektor që merret me çështjen e xhamive dhe rinovimit të tyre. Pa dyshim që ky “sektor” është rrena e radhës e Shaqir Fetait, sepse nuk ekziston, kurse, nëse mendon për sektorin kulturor, le të thotë Shaqir Fetai se që kur ekziston ky “sektor” (1994) cilën xhami e ka rinovuar!

Edhe pse na ekzistua ky sektor, sërish kësaj pyetje i është përgjigjur Shaqir Fetai, i cili, që në fillim të muhabetit dëshmon se nuk ia ka haberin se për cilën xhami bëhet fjalë, për cilin fshat dhe ku gjendet ky fshat! Fshati Llozovë, më herët është quajtur fshati Xhumajli dhe shtrihet në mes të Velesit dhe Shtipit, pra, nuk ka lidhje me Prilepin! Ndërsa Shaqir Fetai thotë se e ka parasysh këtë xhami në zonën e Prilepit porse prioritet ngelë Xhamia e Çarshisë në Prilep! Madje, Shaqir Fetai, kqyreni dudukun, përgjigjet kësisoj: “Edhe ne vazhdojmë trendin që ajo xhami të rindërtohet nga institucionet shtetërore, tani me projektin e kemi gati por duhet të flasim për kushte të tjera që bëhen për ta rinovuar apo rindërtuar atë xhami sepse i përket një monumenti historik të Perandorisë Osmane që është në dobi të të gjithëve, pavarësisht besimit të kujt i përkasin.”

Shaqir Fetai e vazhdon trendin!!! Shaqir Fetait i është thënë miliona herë që mos të mundohet të aktrojë intelektualizëm duke përdorur neologjizma apo fjalë të cilat ai nuk ua di kuptimin, sepse po del analfabet absolut! E para, fjala trend i përket fjalorit të modës; fjala “trend” përcakton një model që karakterizon një tendencë të caktuar për të ndryshuar parametrat e serive kohore për afat të gjatë. E dyta, Shaqir Fetai thotë se ajo xhami duhet të rinovohet (o abdall, ajo është e shkatërruar deri në themel, pra, jo të rinovohet por të rindërtohet!), sepse qenka në dobi “të të gjithëve, pavarësisht besimit të kujt i përkasin”! A është në vete ky farë abdalli apo jo, a është i qartë me vetëveten kur flet apo ia futë si kau pelës! Përfundimisht, Shaqir Fetai dëshmon se psikikisht është në nivele të larta të retardimit, ndaj dhe, familjarët, miqtë e dashmirët e tij, bëjnë mirë që ta ndihmojnë duke e dërguar në psikiatër. Nuk ka asgjë të keqe! Nga sikleti i madh si pasojë e gabimeve trashanike gjithësecili, pra, edhe Shaqir Fetai, kanë nevojë për trajtim psikiatrik!

E treta, më skandalozja: Shaqir Fetai në kuadër të një periudhe gramatikore, është në gjendje të rrejë shumëfish. Shaqir Fetai thotë se “tani projektin e kemi gati”!

Po çka deklaroi një muaj më parë, pikërisht në këtë televizion nacional, pikërisht rreth kësaj pyetje të cilës i ikte mu si djalli temjanit! Në pyetjen e gazetares se ku kanë arritur punët dhe kur do të nisë rindërtimi i xhamisë së Prilepit, Shaqir Fetai do të deklarojë:

“Ja çfarë kemi bërë! Ne që në fillim e kemi vizituar! Kemi kërkuar që menjëherë projekti të kryhet dhe t’i dorëzohet Ministrisë së Kulturës, sepse, Xhamia do të rindërtohet si objekt i kulturës, ndaj i bie nën kompetenca të kësaj Ministrie!” Pastaj, Shaqua shton se, projekti në fjalë nuk qenka gati kurse qenka autorizuar që sa më parë ta përgatisë Drejtoria për trashëgimi kulturore, e cila, pastaj, sipas Shaqir Fetait, do të nënshkruaj memorandum bashkëpunimi me TIKAn e cila do ta rindërtojë Xhaminë! Në këtë intervistë Shaqir Fetai i mëshon edhe hallit të vet për sa i përket rindërtimit të Xhamisë së Prilepit. Tani halli qenka se na është ndërruar kryetari i Komunës së Prilepit dhe, tërë biseda duhet të fillojë nga e para! Shaqir Fetai na e paska projektin të gatshëm?! Shaqir Fetai rrenë, nuk ka kurrfarë projekti por, ka vetëm një gatishmëri fantomike për ta prolonguar sa më gjatë dhe mundësisht, për ta penguar që kurrë të mos rindërtohet kjo Xhami!

Shaqir Fetait nuk i duhet kurrfarë projekti, sepse projekti ekziston që nga viti 2010, i dorëzuar në Drejtori për trashëgimi kulturore dhe e cila ka qenë e obliguar nga Qeveria që në afat prej 3 muajve të nisë me rindërtimin e Xhamisë, ndërsa financiarisht do të mbështetet nga buxheti i shtetit. Për këtë gjë, BFI në këtë drejtori ka derdhur edhe mjete financiare për t’ia ndihmuar fillimin e punëve! Shaqir Fetait tani i duhet vetëm të ngrisë padi gjyqësore kundër kësaj Dejtorie për shkeljen e të gjitha afateve si dhe të kërkojë përgjegjësi politike por edhe dëmshpërblim material!

Shaqir Fetai ndoshta nuk di si të thirret në dokumentat e arkivuara, ndoshta edhe nuk i di këto aktivitete, sepse ai kurrë nuk i ka pasur prioritet aktivitetet në interes të fesë e të myslimanëve të vendit! Përqëndrimi i tij ka qenë gjetkë dhe në interes të segmenteve të caktuara antisllame e antishqiptare në vend dhe më gjërë!

Në Memorandumin për mirëkuptim të nënshkruar në mes të Reisul Ulemasë H. Sulejman ef. Rexheut dhe Drejtorit të Drejtorisë për trashëgimi kulturore, Pasko Kuzmanit, më 5 maj të vitit 2010, e protokoluar me nr. 03-323, veç tjerash thuhet se, palët u dakortësuan që:

“Me qëllim të ruajtjes së përhershme të vlerave historike, artistike, ambientale, sociologjike si dhe të vlerave të tjera shkencore e kulturore të Objektivit Çarshi Xhamia-Prilep, i ndërtuar më vitin 1475, e mbrojtur si Trashëgimi kulturore me vendim nr. 01-482/1 të datës 1. 04. 1968, të kryhet rekonstruimi.

Rekonstruimin do ta kryej Qendra Nacionale Konzervatore, Shkup, kurse mjetet materiale do të sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga donacionet e Bashkësisë Fetare Islame si dhe nga burimet e tjera.

Fillimi i punëve për rekonstruim të Objektivit të Çarshi Xhamisë-Prilep, do të nisë në afat prej tre muajve nga dita e nënshkrimit të këtij Memorandumi”, thuhet, veç tjerash, në këtë dokument, në të cilin duhet të mbështetet Shaqir Fetai, pavarësisht që mban nënshkrimin e H. Sulejman ef. Rexheut.

Natyrisht, të gjithë e dimë se punët do të prolongoheshin, ndërsa për pasojë, BFI-ja do ta bojkotojë Konferencën ndërkombëtare ndër-religjioze që organizohet nga Ministria e Kulturës e RMV-së, konferencë kjo që, pa pjesëmarrjen e BFI-së nuk kishte kurrfarë kuptimi!

Edhe diçka! Shaqir Fetai në intervistën e fundit dhënë në këtë televizion do të nënvizojë se për ndërtimin e kësaj Xhamie nuk ka vullnet politik! Pra, projekti ekziston por jo dhe vullneti politik! Vullneti politik nuk ekzistonte edhe më parë por presioni i BFI-së ishte shumë i fuqishëm mbi politikën! Cili është presioni i Shaqir Fetait mbi politikën shtetërore për ta rindërtuar këtë Xhami? Nuk ka kurrfarë presioni, madje, Shaqir Fetai vetë do të deklarojë se, personalisht ai nuk është person që reagon ashpër, që ngrit zërin, që bën preisione, por, është person që i analizon shkaqet që pengojnë rindërtimin e Xhamisë! Me Shaqir Fetain shkaqet do të jenë në një listë kilometrike!

Pra, ekziston lista e shkaqeve penguese dhe jo projekti! I vetmi projekt jetik aktual për BFI-në është ai i shporrjes së Shaqir Fetait nga ky Institucion një orë e më parë, sepse u bëmë për faqe të zezë!/**1KlikLarg/30.05.2022**

## **“E mira” e premtuesit gënjeshtar dhe E mira e Zotit**

**Veç gjëra të këqia po përjeton Bashkësia Fetare Islame që kur, segmente të caktuara që nuk kanë të bëjnë asgjë me BFI-në, e instaluan Shaqir Fetain në krye të saj. Dhe, ja ku jemi sot: një BFI pa personalitet, pa integritet, të dezorganizuar, të copëtuar, të shkatërruar, me pjesëtarët e saj të dezorientuar**  
*Nga Mr. Abaz Islami*

Për një të mirë më të madhe, njeriu edhe mund të heqë dorë nga e mira me të cilën jeton. Është në natyrën e njeriut që ta provojë gjithnjë e më të mirën, pavarësisht se i vie në formë premtimi. Njeriu joshet, ai kurrë nuk është i kënaqur me situatat nëpër të cilat kalon, qofshin ato edhe ideale. E do më të mirën që i është premtuar, për të cilën është në gjendje të shkelë norma, rregulla e “burrni”, vetëm që të bëhet “sa më mirë”!

Dy vite më parë, Shaqir Fetai, i ra shqelëm shtambës me qumësht! I kishin premtuar se “qumështi pluhur” është më i mirë se ai natyrali. I tuboi personat që u joshën me një të mirë të madhe dhe, bashkarisht iu futën aventurës që, në emër të së mirës më të madhe, ta shkatërrojnë të mirën të cilën kurrë më parë nuk e ka pasur Bashkësia Fetare Islame në RMV. Për hirë të “së mirës së premtuar” u shkel tërë rregullativa e Institucionit, e tërë Kushtetuta, rregulloret e shkarkimit dhe të zgjedhjeve, u shkelën dispozitat ligjore të shtetit për sa i përket ushtruesit të detyrës të një posti! Ushtruesi i detyrës ka tagër t’i organizojë zgjedhjet, pa të drejtën e përfshirjes së tij si kandidat i mundshëm për t’u zgjedhur, sepse kjo apriori përbën konflikt interesi.

Organet e BFI-së, anëtarët e Rijasetit me të drejtë vote në zgjedhjen e organeve drejtuese, u joshën pas “së mirës” së idealizuar nga Shaqir Fetai dhe, bashkarisht, i ranë shqelëm shtambës me qumësht!

Pastaj, në pritje të “së mirës së premtuar” u detyruan që të ta nënshkruajnë edhe “një kontratë të përgatitur nga vetë djalli! Meqë ushtruesi i detyrës u imponua si pronar i “së mirës” kërkoi nga të manipuluarit që të manipulohen edhe më shumë, deri në palcë, duke e zgjedhur për “reis”. Ua mori votat duke i lutur që ta votojnë vetëm për dy vite, sa të siguronte pensionin nga posti i “reisit”. Në kundërshtëpërbllim ua garantoj reformat ideale që sjellin “të mira absolute”!

Përditë e më keq, veç gjëra të këqia përjetoi ky Institucion që kur, segmente të caktuara që nuk kanë të bëjnë asgjë me BFI-në, e instaluan Shaqir Fetain në krye të saj. Dhe, ja ku jemi sot: një BFI pa personalitet, pa integritet, të dezorganizuar, të copëtuar, të shkatërruar, me pjesëtarët e saj të dezorientuar.

Ata që u mësuan gjatë kohë me një të mirë të përgjithshme, të cilët hoqën dorë nga ajo për një “të mirë absolute” që ua premtoi Shaqir Fetai, ndjehen të gënjyer, të turpëruar, të pagjumë! Nuk mund të flenë qetë sepse u manipuluan, hoqën dorë nga e mira e myslimanëve të vendit për “të mirën” e Shaqir Fetait që na doli të jetë interes personal i tij!

Pendesën e pranon i Madhi Zot, por vetëm nëse bëhet në emër të Tij dhe për hirë të së Mirës që vjen prej Tij dhe Rrugës së Tij. Me shumë suksese e mbarësi është e shtruar kjo Rrugë. Pa dyshim!/**TetovaSot/01.06.2022**

## **Me Shaqir Fetain gjithçka mbrapsht**

### **Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI**

Paramendoni, myslimanë të dashur, Shaqir Fetai askund nuk shkon pa e ftuar, madje as në organet e veta ku (një reis legjitim) e ka obligim kushtetutar që t'i vizitojë e t'ua inspektojë punët pa kurrfarë "ftese zyrtare"! Por, si t'i japë vetes rëndësi Shaqir Fetai pa u ftuar zyrtarisht madje edhe nga organet "e veta"! Lajmi nuk do të ishte i plotë nëse brenda vetes nuk e kishte informacionin se në këtë mbledhje ishte i shoqëruar nga "shefi i kabinetit" të vet! Edhe me këtë informacion Shaqir Fetai përpiqet t'i japë vetës peshë! Paska "shef të kabinetit" ndërkohë që nuk ka kabinet! Shaqir Fetai te e shumta që mund të ketë është një sekretar teknik që i kryen punët e një sekretarëshe të rëndomtë! Ata që e njohin këtë abdall e dinë se si ai vdes që t'i japë vetes pak peshë, të duket "alim" ndonëse është kokrra e injorantit; të duket pak si paqtues ndërsa edhe shejtani do t'ia kishte zili në prapështira që di t'i kurdisë!

E paska ftuar i ashtuquajtur i mufti i Shkupit për t'i dhënë pak fllad b... me sukseset që i paska arritur! Paramendoni, të dashur myslimanë, hala pa kurrfare mbledhje të rijasetit prej nga do të duhej të miratoheshin "konkluzione bazë" (siç u thotë abdalli) për sa i përket haxhit dhe kurbanëve të sivjemë. Shaqir Fetai qenka kënaqur nga plani i Qenan Ismailit, i cili, në fakt njihet si luftëtarë 17 vjeçar i pakompromis kundër BFI-së e në mbrojtje të interesave të FRI-së. Shaqir Fetai nga ai fllad që e paska marrur b... nga Qenan Ismaili, paska konkluduar se sivjet kjo Myftini me fitra e zeqate i paska tejkaluar të gjitha pritshmëritë! Myslimanët insistojnë që të dijnë në mënyrë transparente: cilët ishin krahasimisht kontributet financiare në vitin 1992, cilët ishin pritshmëritë e Shaqir Fetait për vitin 2022 dhe cilat ishin këto suksese të sivjemë të Qenan Ismailit.

Pse Shaqir Fetai me qykë të zorit bëhet abdall në katrorë! Si paska qenë i suksesshëm ky Ramazan kur vetë ai ka kaluar nëpër situata katastrofale! Si guxon ta llogarisë të suksesshëm kur myslimanët e Shkupit janë dëshmitarë se si asnjëherë më parë sivjen xhamitë i kanë pasur përgjysëm me xhematë, jo vetëm në shenjë revolte kundër "politikave zyrtare" të BFI-së por edhe në shenjë revolte kundër instalimit nëpër xhamitë tona të personave të dyshimtë për ekstremizëm dhe radikalizëm fetar, të cilët po e zbehin islamin tonë që traicionalisht është kultivuar në këto hapësira.

Shaqir Fetait sukses i kësaj Myftinie i duket edhe promovimi i "xhamive" të sekteve e të religjioneve që po manipulojnë në emër të islamit.

Se Shaqir Fetai tashmë u ka hypur skijave të kalbura, dëshmon edhe prononcimi i tij kur thotë: "shpreha gatishmërinë e BFI-së për ta përkrahur këtë Myftini"! Këtë gatishmëri mund ta shprehë vetëm, për shembull, organet policore apo të bujqësisë, por jo edhe "qeveria", sepse ky është edhe obligim kushtetutar por edhe nënkuptohet si detyrë mbi çdo detyrat e tjera.

Tani, u ngelë myftinive të tjera që, nëse dëshirojnë ta ndjejnë kënaqësinë e përkrahjes së Shaqir Fetait, duhet që ta ftojnë zyrtarisht që të marrë pjesë nëpër mbledhjet e tyre ku do të debatohet për haxh e kurbona, sepse “rijaseti” nuk e ka ndërmend të dalë me “konkluzione bazë”! Ky vërtetë që ka rrjedhur fare nga trutë e kokës!/1KlikLarg/Mileniumi3/02.06.2022

## **Shaqir Fetai ka arritur një sukses: dezorganizimin total të BFI-së**

**Këto ditë u publikua Raporti i DASH mbi liritë fetare në botë, pra, edhe në Maqedoninë e Veriut gjatë vitit 2021, ndërsa ky raport kaloi pa zhurmë! Sepse nuk u pëlqeu, si për shembull, Shaqir Fetait**

### **Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI**

Dokumenti i DASH nuk është materie analitike, nuk është as “reportazh”, nuk është as mbresa amerikane nga një vend, porse, thjesht, raport që thekson ato probleme të veçanta që i kanë ngritur vetë Institucionet.

Paramendoni se cili ka qenë problemi i veçantë të cilin është dashur ta theksojë i gjori Shaqir Fetai! Në raportin amerikan thuhet shprehimisht: “Udhëheqësit e BFI-së thanë se marrëdhëniet me qeverinë në Shkup ishin përmirësuar më pas që nga takimi i janarit ndërmjet kryetarit të BFI-së, Reis Shaqir ef. Fetahu dhe presidentit Stevo Pendarovski”! Pra, për Shaqir Fetain ky takim ka qenë jetik, ka qenë i magjishëm sepse, që nga ai moment, BFI-ja ka nisur të lulëzojë! Një konstatim të tillë mund ta japë vetëm një person (si Shaqir Fetai) i cili nuk ka lidhje me jetë, që gjërat reale i përcepton me trurin e një adoleshenti, pa sens diplomatik, pa karizëm prej lideri, pa aftësi për nuhatje të prapaskenave ku mund të luhen njëmijë lojëra të rrezikshme.

Takime të reist me faktorët më të lartë të shtetit si dhe të faktorëve me relevancë në vend, ka pasur gjithnjë dhe, këto takime asnjëherë nuk janë përceptuar si momente që kanë bërë kthesë në raportet që kanë ekzistuar në mes BFI-shtet! Kjo i bën vaki vetëm Shaqir Fetait!

Por, mu në pikun e relaksimit të marrëdhënieve Shaqir Fetai-shtet, na paska dalur një problem për të cilin paska reaguara Shaqir Fetai! Raporti thotë: “Më 18 shkurt, Bashkësia Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut, dënoi publikisht regjistrimin zyrtar nga Qeveria të “Bashkësisë Islame Selefiste” në dhjetor të vitit 2020, duke deklaruar se do të ishte e dëmshme për unitetin e muslimanëve në vend.”!

Po çka ndodhi me këtë “bashkësi fetare selefiste” pastaj? Çka ka vërejtur Shaqir Fetai diçka të dëmshme për unitetin e muslimanëve të vendit? Cili ishte aktiviteti i kësaj “bashkësie selefiste” dhe me cilin aktivitet e dëmtoi unitetin e muslimanëve të vendit! A e përcolli, a e vëzhgoi Shaqir Fetai veprimtarinë e kësaj bashkësie”!

Në paragrafin e grupeve religjioze u regjistrua edhe një “bashkësi fetare” tjetër, për të cilën deri më sot Shaqir Fetai nuk e tha asnjë fjalë, asnjë reagim, asnjë shqetësim! U regjistrua një “БАШКЦИА Е ЕХЛИ СУНЕТИТ Е ЦЕМАТИТ – КУМАНОВО”, për të cilën Shaqir Fetai nuk raportoi askund, ndonëse është një “bashkësi” me të gjitha predispozitat për ta përçarë



unitetin e myslimnëve në vend si dhe për ta dëmtuar në palcë çështjen kombëtare shqiptare!  
Shaqir Fetai jo që nuk e tha asnjë fjalë deri më sot por, fatkeqësisht, edhe e legjitimoi, e legalizoi, nisi t'i falë terren veprimi. "Filozofia" e kësaj "bashkësie" religjioze katërcipërisht bie ndesh fesë islame e cila tradicionalisht është kultivuar në vendin tonë!

Kjo "bashkësi" ka nisur të ndërtojë xhami të veta, ka nisur të ngjallë elementin radikal në mesin tonë, ka filluar të mbushë me xhemat prej do fytyrave të papara më herët në mesin e xhemateve të rregullta. Në promovimin e këtyre xhamive religjioze kanë prezantuar edhe "organe" të Shaqir Fetait sa për ta legjitimuar veprimtarnë e tyre.

Të supozojmë se Shaqir Fetai nuk e ka atë kapacitet që të ngrisë zërin revoltues kundër organeve shtetërore që merren me përçarjen e trungut të unitetit të myslimanëve të vendit, të supozojmë se Shaqir Fetai nuk e turbullon atë gjellë ku ha edhe vete, të supozojmë se nuk dëshiron t'ia prishë elementeve që e instalojnë në krye të BFI-së, të supozojmë se duhet të jetë parimor me marrëveshjen që e paska arritur me Zaevin dhe Vicen (prej të cilëve gjithnjë kërkon ndihmë(!)), por ama, ka mundur të marrë masa kundër "myftiut" të vet, Qenan Ismailit, i cili me kënaqësinë më të madhe merr pjesë në përrurimin e "objekteve fetare" të grupit religjioz "БАШКЕСИЯ Е ЕХЛИ СУНЕТИТ Е ЦЕМАТИТ - КУМАНОВО", i cili jep dekrete të nënshkruara nga Shaqir Fetai për persona për të cilët jo shumë larg ka folur si për persona shumë të rrezikshëm të shtyra nga "elementet radikaliste dhe ekstremiste"!

Pra, kjo "bashkësi" në raport me "bashkësinë" për të cilën na paska reaguuar Shaqir Fetai, është miliarda herë më problematike dhe më e rëndë! Dhe, Shaqir Fetai, as më vitin 2020, as më 2021, dhe as tani nuk e thotë asnjë fjalë! Sepse, misioni i Shaqir Fetait është përçarja, dobësimi dhe dezorganizimi total i BFI-së!

Ashtu siç është vetë, me mision special, ashtu ka caktuar edhe personin "special" për kontakt me faktorin ndërkombëtar dhe të sigurisë në vend, Mustafa Dautin! Shumë shpejtë do të turpërohen që të gjithë ata që kanë pasur punë me këtë person të kriminalizuar deri në palcë. Drejtësia do ta lakuriqësojë për turp! Shumë shpejtë do të turpërohen të gjithë ata të cilët kanë këmbyer qoftë dhe një muhabet të rëndomtë me këtë person! Dihet se cili ka qenë aktiviteti i tij derisa ka "shërbyer" në Strugë! Nga ajo kohë e deri më sot, tashmë nga burgu janë liruar shumë persona nga bota e kriminimit dhe drogës dhe, shumica prej tyre, tek e shohin në foto apo në television Mustafa Dautin, habiten se si ka mundur që "bashkëveprimtari" i tyre të punojë në BFI e të shesë hoxhallëk!  
Dhe, cili është vokabulari i këtij farë "hoxhe" në kontakte me të huajt? Çka u thotë? Shaqir Fetai po e kryen me sukses misionin, ë? Se, cilin mision, këtë mund ta dinë vetëm Mustafa Dauti dhe Qenan Ismaili, ky tresh fatal për BFI-në dhe për myslimanët e vendit!  
**1KlikLarg/Kombetare/04.06.2022**

## **Dezorganizim, diletantizëm apo sabotim**

**Lidhur me një dokument të lëshuar nga bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait, me numër protokolar 03-278, të datës 3.06.2022, me titull NJOFTIM PËR HAXHIN 2022 / 1443 H**

***Nga Mr. Eset Shaqiri***

Nga BFI-ja na lëshohet një dokument i cili përmbanë qëndrimet e “komisionit të haxhit” dhe jo të Rijasetit. Pra, “komisioni në fjalë paska analizuar shumë faktorë dhe, në fund, e paska sjellë para aktit të kryer Rijasetin duke ia kumtuar çmimin që duhet ta ketë parasyshë gjatë regjistrimit të haxhilerëve të sivjemë. Praktikë e paparë dhe krejt e mbrapshtë, e pandodhur ndonjëherë në BFI! Komisioni raporton, mund të propozojë, por, vendimet i sjell Rijaseti! Kur u mbledh ky Rijaset? Kur debatoi mbi çmimin e haxhit! Kur solli qëndrim për këtë çmim?

Megjithatë, dokumenti në fjalë, mbi të gjitha, flet për një situatë kaotike në këtë Institucion. Kurrë, asnjëherë, asnjë institucioni nuk i ka bërë vaki të publikojë një shkresë, si ky dokument, i cili, mbi të gjitha, në mënyrë shumë të qartë shpalosë dezorganizimin total të Institucionit, shpalosë injorancën e administratës së këtij Institucioni! Një Zot e di, mund të jetë në pyetje edhe tallja dhe sabotimi i haptë që ia bëjnë “eprorit” të vet, Shaqir Fetait!

Dokumentin e lëshojnë, siç thonë që në fillim, “duke u nisur në nenin 3, pika 17, të Kushtetutës së BFI!!!

Shkojmë me radhë:

Neni 3 i Kushtetutës së BFI-së ka vetëm një pikë dhe ajo thotë: “Selia e BFI-së është në Shkup”! Jemi në një kohë kur gabimet teknike duhet t’i llogarisim si shumë njerëzore dhe, nisur nga kjo logikë, i shikuam edhe nenen e tjera që përpara 3 kanë numër tjetër e që gjatë të shkruarit ka mundur të rrëshqasë, të bie, të mos shkruhet! Prandaj –

Neni 13 i Kushtetutës së BFI-së ka vetëm një pikë dhe thotë: “Pasuria e BFI-së shërben ekskluzivisht për realizimin e qëllimeve të saja.”

Neni 23 i Kushtetutës së BFI-së ka vetëm një pikë dhe thotë: “BFI ka organet dhe institucionet e veta.”

Neni 33 i Kushtetutës së BFI-së ka 2 pika dhe thuhet: “Muftinia mban mbledhje të rregullta më së paku një herë në muaj. Mbledhjen e Muftinisë e konvokon Muftiu, në raste të veçanta, atë e konvokon, me kërkesë të Rijasetit të BFI-së dhe të një të tretës së anëtarëve të Muftinisë.”

Neni 43 i Kushtetutës së BFI ka një pikë që thotë: “Rijaseti i BFI-së zgjedh Këshill të posaçëm për dorëzimin e Menshurës.”

Neni 53 i Kushtetutës së BFI-së ka dy pika dhe thuhet: “Në BFI kryhen veprimtari edukativo-fetare, arsimoro-shkencore, kulturore, socio-humanitare dhe ekonomiko-financiare.

Ruhet thesari kulturor përmes medreseve, fakulteteve islame, institutive islame, qendrave kërkimoro-shkencore, botuese, bibliotekatave, arkivave, muzeumeve, etj.”

Neni 63 ka një pikë ku thuhet: “Funksionarët e BFI-së, të zgjedhurit, të emëruarit përgjigjen para Reis ul Ulemasë.”

Pra, asnjë nen që përfundon me numrin 3 nuk parasheh organizim të haxhit! Kjo edhe një herë dëshmon se Shaqir Fetai kurrë nuk është orientuar sipas Kushtetutës së BFI-së, kurrë nuk e ka njohur dhe asnjëherë nuk e ka respektuar. Kushtetuta e BFI-së dhe Shaqir Fetai janë dy nocione që nuk puçen në asnjë pikë!

Problemi edhe më skandaloz që e thekson ky dokument është paragrafi i fundit, i cili flet: ose për hajni dhe vjedhje të haxhit, ose flet për sabotim të qëllimshëm!

Paragrafi i fundit i këtij dokumenti thotë: “Ju informjmë se regjistrimi për në Haxh 2022, ka përfunduar ngase është plotësuar kuota e caktuar për Maqedoninë e Veriut nga Ministria e Haxhit e Arabisë Saudite.

Njohtimi është i karakterit apelues, fton haxhilerë për t’u regjistruar, madje i njohton edhe me çmimin prej 5700 euro dhe, në fund, thotë, kot e keni, mos vraponi, sepse numri është plotësuar! Kjo të nxjerr në përfundimin logjik: vizat për haxh të sivjemë që të gjitha i janë shitur diasporës e cila mbase ka mundësi për ta paguar haxhin me çmimin fantomik të caktuar nga Shaqir Fetai! Nëse ka ndodhur kjo, ndërsa paragrafi i fundit i këtij dokumenti i bie kësaj logjike, atëherë, kemi të bëjmë me një skandal shumë të turpshëm të Shaqir Fetait.

*(Autori është zëvendës-kordinator i Këshillit për mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV)/TetovaSot/04.06.2022*

## **I pabesi gjithnjë të pret në besë**

**Sapo paska deklaruar Shaqir Fetai se, sivjet, haxhilerët nga Maqedonia e Veriut do të bëjnë një “super haxh”! Prandaj edhe qenka çmimi i lartë, sepse Shaqir Fetai qenka angazhuar që sivjet haxhilerët të kalojnë një haxh të mrekullueshëm! E kush ia kërkoi Shaqir Fetait një nder të tillë? Deklarata e tij u vërshua nga qindra komente – të gjitha sharje e përbuzje! Që të gjitha**

### ***Nga Murtezan Veseli***

Si e mendon Shaqir Fetai “super haxhin”? I bie që një “super namaz” të jetë ai që falet në postaqinë super të butë të arushave të bardha! Një “super shahadet” të deklarohet pasi të bëhet remiski i tij, apo, me ndonjë mikrofon kompjutorik i cili këndimin e “super shahadetit” ta nxjerrë me zëra të mrekullueshëm! Ose, një “super zeqat” i bie që, për shembull, Shaqir Fetait t’i falet një porshe përplotë me dollarë!

Shaqir Fetai duhet të pranojë se ka kalkuluar shumë fort me periudhën dyvjeçare të pandemisë me ç’rast nuk pati kryerje të haxhit. U akumulua një numër kandidatësh të cilët e kanë ëndërr jetike kryerjen e haxhit. Dhe, Shaqir Fetai u tha myslimanëve të vendit, të regjistroheshin, sepse, sivjet do të shkohet! Mrekullueshëm, të gjithë ata që ishin të gatshëm që të nisen sivjet, qenkan regjistruar dhe, ditën kur Shaqir Fetai ua bëri publik çmimin e haxhit të sivjemë, prej 5700 euro, po atë ditë kumtoi se tashmë është plotësuar numri i haxhilerëve i paraparë në kuotën e caktuar për myslimanët e Maqedonisë së Veriut nga Ministria e Haxhit e Arabisë Saudite!

Asnjë prej kandidatëve nuk kishte njohuri paraprake mbi çmimin, ndërsa tashmë kanë përhapur llafe se janë kandidatë për haxh të sivjemë dhe për këtë tashmë janë regjistruar! Si të ç’regjistroheshin tani e të përballen me epitelin ironzues “haxhi pishmani”! U paraqitën për të zënë vend, duke besuar se për dallim prej herës së fundit, çmimi i haxhit të sivjemë do të rritej nja 2-300 euro, hajde më së shumti 500 euro! Tani, që të gjithë haxhilerët e paraqitur më herët po ndjehen të prerë në besë. Epo, i pabesi gjithnjë ka prerë në besë. Prej Shaqir Fetait, të pabesit, nuk mund të pritët që të ta kthejë me nder besimin që ke për të, sepse, kjo e neverikos atë, kjo e mërzit, kjo e nxjerr përtej lëkurës së vet! Ai thellë në vete e di që është i pabesë, ndaj dhe nuk ka dëshirë që askush t’i zëjë besë, dhe, nëse dikush i zë besë, do të zhgënjehet shumë keq!

Paramendoni, hoteli në Medine qenka shumë afër, 100-150 metra larg Xhamisë së Pejgamberit a.s. Shaqir Fetai rrenë sa është i rrumbullakët, aq më tepër pastaj rrenë kur thotë se edhe në Qabe

hoteli qenka shumë afër, nja 1000-1500 metra larg! Shaqir Fetai vetë ka qenë në haxh, atëherë kur i humbnin haxhilerët e Gostivarit dhe, ndonëse ka qenë shumë më afër, hotelet nuk kanë qenë problem për ta ngritur çmimin e haxhit në 5700 euro! Shaqir Fetai thotë se do të rrotullohen shumë shpesh autobusët (mos o Zot! Mos dëshiron të thotë se do të qarkulljnë shpesh autobusët), të cilët do t'i bartin haxhilerët gratis nga hoteli për në xhami dhe anasjelltas! Ndërsa në shpjegimin e thatë mbi çmimin e haxhit të sivjemë, Shaqir Fetai thotë se brenda çmimit përfshihet edhe transporti brenda Arabisë Saudite! Ku është këtu “rrotullimi falas”? Shaqir Fetai nuk e gjenë të arsyeshme që të dalë publikisht para opinionit dhe të tregojë në hollësi se pse ky çmim kaq i lartë, çka paguhet prej këtij çmimi në haxh, dhe ku do të shpenzohen praktikisht këto të holla prej 5700 eurove!

Por, si një skuth e një gënjeshtar tashmë i dëshmuar, Shaqir Fetai deklaroi në një televizion nacional: “Këtë vit do të kemi një çmim më të lartë se viteve që është organizuar, viteve të fundit, për arsye se tashmë Arabia Saudite ka vendosur kushte të veçanta për shkak të coronavirusit. Tashmë paguhet gjithçka në Arabinë Saudite ka shumë çështje që kanë qenë pa pagesë e tashmë kanë vendosur pagesë, biles kanë vendosur edhe TVSH, çdo pagesë do të ketë TVSH”!

Çmimi qenka kaq i lartë për shkak se Arabia Saudite paska vendosur kushte të veçanta për shkak të coronavirusit? A ka shpjegim më idiotik se ky?! Po për haxhilerët e rajonit që kanë çmime shumë më të ulët se të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait – për këta nuk ka kushte të veçanta për koronën a? Le t'i numërojë vetëm tri çështje që dikur paskan qenë pa pagesë ndërsa sot Arabia Saudite i paska bërë me pagesë ndaj dhe qenka rritur çmimi! Si shpjegohet, pra, kjo rritje e çmimit? Ka vetëm një shpjegim!

Le ta bëjë publike kontratën e sekretarit gjeneral të Shaqir Fetait, Irsal Jakupit, me hotelin në Meke më vitin 2019, dhe le ta shohin mbarë opinionin se si u vodhën vetëm nga kjo kontratë fiks mbi 1 milion rialë! Po qarkullon diku deklarata e arabit, pronarit të hotelit në Medine, i cili dëshmon se myslimanëve nga Maqedonia e Veriut i ka lënë një çmim të leverdisshëm, aq sa është paguar në të vërtetë, por që është dashur të nënskruajë një kontratë kinse çmimin ua ka caktuar më të lartë e që ishte gati dyfishi i çmimit! Natyrisht, thotë arabi, më është paguar tërë shuma që ua kam caktuar kurse pjesa tjetër ka hyrë në xhepin e Irsal Jakupit! Po në Meke? Po në transport? Po në shitjen e vizave!

Sa më i lartë çmimi, më të favorshme mundësi për vjedhje më të madhe! Kjo i intereson Shaqir Fetait dhe jo “super haxhi” i myslimanëve të vendit! Nëse ka pasur mundësi për çmim më të vogël dhe që garanton kryerjen në mënyrë sa më modeste të haxhit – këtë do ta kishin zgjedhur myslimanët e vendit, dhe jo dëshirën e sëmurë të Shaqir Fetait për një “super haxh”! Por edhe besatimet e Shaqir Fetait për një “super haxh”, në vendin e ngjarjes do të zvetënohen nga prerja në besë. Sepse, Shaqir Fetai një jetë të tërë e ka kaluar duke prerë njerëz në besë. I pabesi këtë punë ka! Kush i zë besë ORAO-s, e gëzoftë!/**Kombetare/07.06.2012**

## *Intervistë*

### **Mbi anarki nuk mund të ndërtohet asgjë e shëndoshë**

*(Bisedë me shkas me H. Afrim ef. Tahirin, ish-sekretar gjeneral i BFI-së, sot drejtues i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së, me të cilin biseduam për situatën aktuale në këtë Institucion si dhe për shumë çështjesh të tjera rreth BFI-së.)*

***Këto ditë myslimanëve të Maqedonisë së Veriut u erdhi si shok-bombë çmimi për kryerjen e haxhit nën organizimin e BFI-së. 5700 euro për standardin tonë është një shifër “imagjinare”! Ju në BFI përfliteni si një prej organizatorëve më të denjë e më të mirë që kanë organizuar haxhin nën ombrellën e këtij Institucioni! Si caktohet çmimi i haxhit?***

Më herët ka qenë shumë më vështirë! Organizimi i haxhit ka qenë një përgjegjësi po aq sa bartja e emrit mysliman! BFI-ja si Institucion është për ta ndihmuar myslimanin, për t’ia lehtësuar sa më shumë organizimin e jetës në frymën islame. Myslimani jeton një jetë të tërë për të arritur që ta përjetojë një njëzetë ditësh në vendet e shenjta ku kryhet një prej obligimeve islame, haxhi! Kjo është dëshirë jetike e çdo myslimani dhe, kushdo që ia mundëson sa më lehtë ta realizojë këtë dëshirë ai do të ketë sevape të panumërta. Është prej mëkateve të mëdha përpjekja që haxhi të shfrytëzohet si mundësi për pasurim personal, duke ia vështirësuar haxhiut realizimin e kësaj dëshire jetike.

Sot, Ministria e Haxhit e Arabisë Saudite, me qëllim që të vë rend e rregull, me qëllim që t’ua mbyllë edhe vrimat përfituese matrapazëve të ndryshëm, ka mundësuar që Haxhi të jetë shumë transparent dhe të dihen paraprakisht të gjitha shpenzimet. Në haxh numri i madh i haxhilerëve shkon në mënyrë të organizuar. Organizatori paraprakisht është i obliguar që, përveç marrëveshjeve administrative me institucionet gjegjse të shtetit arab, ta bëjë kontratë me hotelet, të cilat mund të ofrojnë edhe tre vakte ushqim brenda çmimit! Kjo kontratë të hapë mundësinë e marrjes së vizave, sepse do të dihet saktësisht numri i haxhilerëve që do të udhëtojnë nën organizimin e institucionit. Paraprakisht dihen edhe çmimet e vaksinave, të ilaçeve, të taksave, të qëndrimit në Mina, Arafat, udhëtimit brenda Arabisë Saudite. Dihen edhe biletat e udhëtimit! Pse të gjitha këto nuk bëhen transparente! Pse nuk tregohet se ku do të zënë vend çdo cent prej atij 5700 euro të caktuar si çmim haxhi! Do të bëhet një “haxh cilësor”? Po pse, si qenka bërë më herët haxhi? Haxh jo cilësor, ë? Sapo u bë zyrtar ky çmim, vërshuan qindra e mijëra reagime e komente të myslimanëve të vendit! Një reagim i tillë nuk është parë në historikun e rrjeteve sociale ndër ne dhe, unë, thjesht, jam pa fjalë para këtyre komenteve! Nuk do të kishte çmim përfitues për institucionin që do të më detyronte të rri kokëulur para atij lumi ofendimesh e sharjes, që të gjitha të arsyeshme!

***Mbase situata financiare në BFI është shumë e rëndë dhe, është paralajmëruar edhe më herët se, përpara e kemi edhe organizimin e haxhit që është një burim financiar i mirë për arkën e BFI-së?***

Jo, haxhi asnjëherë nuk mund të llogaritet si burim i rëndësishëm financiar i BFI-së! Sepse, ky nuk është qëllimi! Qëllimi parësor është që BFI-ja, anëtarëve të vet t'ua mundësoj kryerjen sa më rehat të këtij obligimi! Në shumën e përgjithshme të çmimit përfshihen edhe shpenzimet e ndryshme të cilat BFI-ja nuk ia del t'i mbulojë, siç janë shpenzimet e komisionit para udhëtimit, të mjekëve që duhet të jenë së bashku me haxhinjtë, pastaj, udhëheqësit e haxhinjëve e ndonjë shpenzim i papritur! Fatkeqësisht, kësaj radhe mund të jenë shumë individë që do të shkojnë “gratis” në haxh, në kurriz të haxhilerëve që do t'ua mbulojnë të gjitha shpenzimet. Po flitet se Shaqir Fetai planifikon të dërgojë sa më shumë “bashkëpunëtorë” me qëllim që t'i korruptojë e t'ua fitojë përkrahjen edhe për ndonjë ditë!

***Përkrahjen Shaqir Fetai ua fitoi qysh para dy viteve! Pse a për brenda dy viteve do të shterrej kjo përkrahje?***

Dy vite më parë, Shaqir Fetai në krye të BFI-së erdhi i shtyrë nga mekanizmat jashtë oborrit të çdo organi të BFI-së, që nga xhamitë e deri në Rijaset. Myslimanëve të devotshëm mund t'ua marrësh besimin, mund t'ua manipuloshë besimin, sepse ata nuk kanë kohë të kalkulojnë mbi dallaveret, planet e poshtra, sepse kohën e tyre e kanë për lutje dhe ibadete drejtuar Allahut xh.sh. Mund t'ua marrësh edhe përkrahjen duke u shitur si pjesëtarë i këtij komuniteti të devotshëm. Por ama, nëse një ditë ndërjegjësohen, nëse një ditë shohin se i ke manipuluar, nëse një ditë të hetojnë se po i gënjenë, muslimanët e devotshëm nuk ta falin, të kthehen me një uragan të urrejtjes së përjetshme.

Dy vite më parë, Shaqir Fetai pranoi që të shkelet Kushtetuta e BFI-së! Mbarë opinionin e di se si erdhi përmes shkeljes së tërë rregullativës së BFI-së, traditës dhe historikut të formimit të klerarkisë fetare në vend! Shaqir Fetai më së paku duhej të ishte kandidati i mundëshm për Reisul Ulema, sepse, ai ishte aktori kryesor i dështimit të investimit të miliona dollarëve në Myftininë e Gostivarit dhe, edhe sot e kësaj dite nuk ka dhënë as përgjigje penale dhe as morale për atë se si u larguan investitorët arabë që ishin në gjendje të investojnë në një vakëf më të madhin në vend!

***Megjithatë, ai u votua?***

U votua prej personave jokompetentë dhe të paparaparë me Kushtetutë për të votuar! Ai, krye më vete themeloi “organe” vetëm që të sigurojë vota!

***Dhe tani, mendoni se nuk e gëzon votën e tyre?***

Nuk është kaq e thjeshtë! Pyetja duhet të shtrohet: çka ndikoi në shkaktimin e kësaj pakënaqësie jo vetëm të organeve por edhe të tërë myslimanëve të vendit? Shaqir Fetai, një prej eprorëve më të dobët të organeve të BFI-së, si në profesion ashtu edhe në karakter, përkundër faktit që gjithmon e ka pasur përkrahjen dhe lavdin prej ish-reisul ulemasë, u instalua me premtime të mëdha, llafë goje! Asnjëherë nuk prezantoi program, asnjëherë nuk shpalosi projekte, asnjëherë

nuk i analizoi as “të arriturat” dhe as dështimet për këto dy vite, as nevojat e myslimanëve dhe as të mirën e islamit në këtë vend, as çështjet kombëtare dhe as të komuniteteve të bashkësisë sonë! Ai erdhi përmes mashtrimeve, përmes truqeve të poshtra, përmes dallaveve dhe rrenave! Dhe, edhe më tej ka ngelur po në atë stad! Natyrisht që, kjo do t’i nervozojë dhe do t’i shqetësojë të gjithë, si brenda ashtu edhe jashtë BFI-së!

### ***Të gjithë në BFI po thonë që, më mirë ta mbajmë Shaqir Fetain se sa të na vie Afrim Tahiri?***

Po, është kjo një strategji e Shaqir Fetait që e ka përdorur deri më tani: nëse nuk rrini urtë do të vie Afrim Tahiri e do t’ju dëbojë të gjithëve!

Po pse t’i dëbojë Afrim Tahiri? Afrim Tahiri për tetë vite rresht kam qenë sekretar i përgjithshëm i tyre, ka mundur t’i largojë e t’ua gjejë zëvendësimin të gjithëve! Me cilin prej tyre, apo edhe më gjërë, me cilin prej të punësuarve në BFI ka pasur probleme personale Afrim Tahiri! Madje edhe kur ish-reisul ulema ka sjellë konstatime dhe vendime për të dëbuar dikë nga puna, unë e kam qetësuar, e kam bindur se nuk duhet të largohet nga puna. Ka nëpunës të tillë që edhe më kujtojnë si sebeb që kanë vazhduar në punë edhe sot e kësaj dite. Po, i vetmi njeri për të cilin kam kërkuar të largohet nga puna ka qenë vetëm një person, Mustafa Dauti! Madje unë kam deponuar edhe dorëheqje me shkrim me të cilën kam kushtëzuar, ose unë në BFI ose Mustafa Dauti! Ai ka qenë i larguar pikërisht për shkak të vjedhjeve, manipulimeve, veprimeve antiislame që i ka ndërmarrur në emër të islamit dhe të BFI-së! Pas një viti, pasi u largova unë nga BFI, ai u rikthye në mënyrë triumfaliste!

### ***Vetëm ky person na qenka problematiku i BFI-së?!***

Jo, sot ai nuk është i vetmi, fara e keqe shtohet dhe ta shkrumbon tërë grunajën! Sot kemi plotë “bashkëpunëtorë” të Shaqir Fetait të cilët BFI-në, organet dhe objektet e BFI-së i përdorin si zyre, apo si logjistikë për ta zhvilluar biznesin e vet personal e familjar, përmes organizatave, shoqatave e aktiviteteve të ndryshme. Ndërsa kemi plotë teologë të diplomuar e me tituj që rrinë në shtëpi, të papunë. Nuk mundet që një njeri, i cili ka punuar dy dekada kundër BFI-së, ta ka vjedhur fitrin, zeqatin, të ka ndërhyrë në organizim të haxhit, të ka dëmtuar në çdo pore të jetës fetare, sot të rehatohet në kolltukun e organeve të BFI-së dhe të punojë për BFI-në! Nuk mundet! Ai kolltukun e organeve të BFI-së e përdorë vetëm për ta dëmtuar edhe më tej këtë Institucion si dhe për ta dërguar jazin në mullirin e vet! Ai nuk është pjekur për të mirën e BFI-së por për të mirën e “dyqanit” të vet!

Natyrisht, Platforma e Lëvizjes që e drejtoj unë, Programi i Lëvizjes, projektet, vizionet, të gjitha janë në të mirë të reformimit të BFI-së, për kthim të dinjitetit të dikurshëm, për përforsim të personalitetit historik që e ka pasur dikur ky Institucion, për ngritjen e kapaciteteve të denja për një Institucion siç është BFI! Unë kurrë nuk formova as institucion paralel, as nuk formova shoqatë, nuk apelova që fitri e zeqati të derdhen në Lëvizjen tonë, nuk e dëmtova për asnjë sekond as Medresenë, as Fakultetin, i mbrojta të gjithë ata personalitete e teologë duke i mbajtur sa më larg Lëvizjes, sepse, do të rrezikonin me sanksione nga ata të cilët nuk mund të pajtohen asesi me Platformën tonë për ta vënë në binare të shëndosha BFI-në! Pra, synimi im nuk është që t’i hakmerrem dikujt, sepse askush nuk më ka më të voglin hak, aq më pak që të kryejmë reforma gjithëpërfshirëse në BFI duke larguar njerëz, por bashkarisht të kontribuojmë për një BFI me integritet e dinjitet origjinal. Këtë mision timin e lufton Shaqir Fetai. Duke u thënë të tjerëve, më përkrani mua sepse do t’ju vijë Afrimi!



Afrim Tahiri, ja, publikisht po prononcohem: nëse Afrim Tahiri do të jetë pengesë për reforma të thella dhe të shëndosha në BFI, atëherë, ja, këmba e Afrim Tahirit kurrë nuk do të shkelë në BFI! Në një megaintervistë, të botuar më vitin 2016, me titull “BASHKËSINË FETARE ISLAME E PRET NJË EPOKË E RE”, veç tjerash kam deklaruar publikisht: “Kurrë në jetë, me asnjë çmim nuk do të pranoj të jem reisul ulema i BFI-së... Unë do të jem krah i atij që do ta kërkojë ndihmën time si njohës i organizimit dhe i politikave organizative të BFI-së. Ndryshe do të jem kritikues i rreptë dhe i përhershëm i të gjithë atyreve që veprojnë jasht linjave të përcaktuara me Kushtetutën e BFI-së...” Kësaj që kam thënë këtu e gjashtë vite më parë i qëndroj edhe më tej me besnikëri! Pra, nuk dua që Afrim Tahiri të bëhet problem i BFI-së! Unë jam thellësisht i interesuar që të shpëtojmë këtë Institucion dhe jo që të bëhem ndonjë “shef”! Për këto shtatë vite opozitarizëm kam mundur, kam pasur oferta të mrekllueshme të punësohem e të bëhem me dhjetra her shef e drejtor dhe ta harroj tërësisht BFI-në! Megjithatë, edukata ime, ndërtimi im intelektual, përgatitja ime akademike, përvoja ime profesionale, besimi im islam, nuk më lejuan që të jem tërësisht indiferent ndaj një të mire kolektive siç është BFI-ja dhe të mendoj fillikat për vetëveten!

Megjithatë, nëse vazhdojnë shkeljet kushtetutare, nëse vazhdon praktika e sotshme që BFI-ja të jetë institucion ku do të rehatohen e do të dirigjojnë fallcifikatorët, blerësit e diplomave, pseudo-teologët e diplomuar nëpër fakultete të dyshimta, ata që kryejnë fakultete për pesë-gjashtë muaj, apo për një e dy vite, duke u shitur pastaj si “gjeni”, do të jem i pakompromis ndaj këtij “komuniteti” ndotës të ambientit dhe emrit të BFI-së; do ta shtoj dhe do ta intensifikoj luftën time në rikthimin dhe në ruajtjen e pastërtisë shekullore të të vetmit institucion islam që e kemi në RMV! Spiunët dhe tradhëtarët, devaluësit dhe kompromituesit e çështjeve kombëtare e fetare, le të angazhohen nëpër shërbimet e denja për profile të tilla, ata nuk e kanë vendin në BFI dhe nuk guxojnë të ankohen te asnjë faktor se po i sulmuakemi shumë! Një BFI me profile të tilla brenda, nuk e meriton të ekzistojë!

### ***Si do ta shpëtojë Afrim Tahiri BFI-në?***

Jo Afrim Tahiri, por askush, asnjë mysliman në vend nuk e ka forcën e mjaftueshmë për ta shpëtuar BFI-në dhe për ta nxjerrë nga kjo gropë e trishtueshme ku është katandisur! BFI-në mund ta shpëtojmë bashkarisht, të gjithë nëpunësit, duke zbritur në bazë, duke u përkulur e lutur para tyre që ta ritkhejnë besimin e humbur në BFI. Për këtë akt duhet shumë punë, shumë mund, shumë përkushtim! Nuk është rikthim i besimit dhe përkrahje, radhitja e njerëzve para kabinetit duke pritur rend të vijnë e të të urojnë “suksese e shëndet”! Çdo urim i sukseseve përkthehet në pritshmëri të sukseseve. Ndërsa sukseset arrihen vetëm kur për një sukses përfshirja e aktorëve është sa më e gjërë, që nga baza e deri lart! Nuk guxon të kalojë javë pa nisur realizimin e projekteve të reja, të cilat janë hartuar bashkarisht, nga nevojat, kërkesat dhe dëshirat e bazës në terren. Plani zhvillimor duhet të ofrojë kushte e mundësi që të gjithë myslimanët e vendit të ndjehen si kontribues të vërtetë e të sinqertë në ringritjen e BFI-së dhe të organeve të saj! Teologët dhe hoxhallarët duhet të jenë edhe advokues të xhemateve tona dhe t’i adresojnë të gjitha kërkesat dhe nevojat e tyre në organet më të larta të BFI-së! BFI-ja nuk do të mund të shfrytëzohet si logjistikë për ngritje të kapaciteteve vetanake e familjare të nëpunësve të vet! BFI-ja do të kontribuojë që të zhvillohen shoqatat e ndryshme me sufiksin humanitar e islam, do t’i ftojë ata në partneritet, në angazhim të përbashkët për ngritjen e kualitetit jetësor si dhe për zhvillim të gjithmbarshëm të jetës islame në vend. Ky qëndrim është një prej postulateve kryesore të Programit tonë të Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së.

### ***Cili është çelësi i juaj për akreditimin e Medresesë?***

Akreditimi i Shkollës së Mesme Profesionale Medreseja “Isa Beu” është një përpjekje e kahershme e cila assesi të realizohet. Pse? Sepse asnjëherë nuk është kqyrur si projekt! Projektet ngriten në bazë të rezultateve të nxjerra nga një analizë dhe hulumtim i thellë! A është debatuar ndonjëherë për nevojën e akreditimit, apo kjo gjithnjë na është imponuar si “strategji” e të parit me qëllim që të dalë në pah “fuqia politike” e tij! Shpesh është përdorur edhe për ta diskredituar forcën politike në pushtet karshi myslimanëve të vendit! Është jo korrekte dhe e pandershme që këtë barrë t’ua lëmë partive tona politike! Nuk jam për një akreditim me vendime qeveritare apo ministore! Jam për një akreditim që do të vinte natyrshëm nga sistemi shoqëror. Për të ndodhur kjo gjë gjithësesi që duhet të ndryshojë ky sistem aktual politik, madje përmes ndryshimeve të mëdha kushtetutare! Tërë kjo katrahurë politike që të na mundësohet të prodhojmë hiperinflacion hoxhallarësh?! Nuk jam as për një akreditim i cili do t’ia hapte portat duarve të pushtetit për të vepruar pastaj si të dëshirojë me Shkollën tonë Profesionale. Pra, nuk jam për rikthim të një “Velika Medresa “Kral Aleksandar”! Po, jam për një ndihmë financiare tradicionale nga buxheti shtetëror, qoftë ajo edhe në përqindje simbolike, për të cilën do ta kishte tagrin e plotë për ta përcjellë institucionalisht shpenzimin e asaj ndihme!

***Informacionet që vijnë nga brenda BFI-së flasin për një situatë kaotike, për anarki totale, për zhdukje të tërësishëm të besimit e të respektin të ndërsjellë, për një prishje të raporteve ndërnjerëzor e ndërkolegial! Kjo në masë të madhe po ia lëkundë pozicionin edhe Shaqir Fetait! Çka e shpëton Shaqir Fetain!***

Dorëheqja! Sa më parë që të ndodhë kjo, aq më lehtë do të kalojë vetë Shaqir Fetai dhe, mbi të gjitha, do të ngelë një fije kashte e BFI-së ku mund të kapet dhe të shpëtojë nga një katandisje fatale! Mbi anarki nuk mund të ndërtohet asgjë e shëndoshë. Ai erdhi në mënyrë anarkike, me puç e me komplot, dhe, nëse nuk ofron dorëheqje të menjëhershme, në mënyrë anarkike do të ikë. Sepse, këtë rrugëtim ka trasuar ai: ardhje-vajtje anarkike! Instalimi në mënyrë antikushtetutare fundin gjithknjë e ka helaq!/**TetovaSot/09.06.2022**

## **BDI-ja nuk mund të jetë çerdhe e “ORAO”-ve**

**Në një intervistë të H. Afrim ef. Tahirit, drejtuesit të Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI, botuar në disa portale kombëtare, me titull “MBI ANARKI NUK MUND TË NDËRTOHET ASGJË E SHËNDOSHË” në pyetjen se çka e shpëton nga turpi Shaqir Fetain, efendi Tahiri përgjigjet shkurt e qartë: DORËHEQJA**

***Nga Jasir Jashari***

Fjala e mirë, e sinqertë, fjala shpëtimtare, ndonëse mund të nxirret nga goja me ton të lartë, apo duke mërmëritur, mund të duket si urdhërore, si e prerë e definitive, megjithatë, është fjalë zemre që thuhet për të shpëtuar dikë nga situata e rëndë ku ka rënë, apo për t'i dalë situatës përpara e cila rrezikon të degjenerojë deri në turp e mëkat!

E tillë ishte edhe fjala e H. Afrim ef. Tahirit me të cilën i drejtohet Shaqir Fetait në mënyrë urdhërore: “Dorëheqja! Sa më parë që të ndodhë kjo, aq më lehtë do të kalojë vetë Shaqir Fetai dhe, mbi të gjitha, do të ngelë një fije kashte e BFI-së ku mund të kapet dhe të shpëtojë nga një katandisje fatale!”

Janë qindra arsye, janë qindra fakte, janë qindra situata që të shtyjnë deri te shqiptimi i fuqishëm i kësaj fjale dejtuar këtij farë instalacioni të qarqeve nëntokësore që ditë për ditë po e merr më qafë BFI-në si dhe tërë komunitetin mysliman të vendit.

Është më se e vërtetë se Shaqir Fetai u instalua në mënyrë anarkike në krye të BFI-së, e shkeli, e mohoi dhe veproi kundër çdo rregullative të BFI-së, kundër Kushtetutës së saj, shkeli mbi çdo nen e mbi çdo gërmë të saj! Imponimin e vet e nisi dhe po e vazhdon në mënyrë perfide, si ai rezili kur mundohet të shpërfaqet si tërësisht i pafajshëm, për gjynah e i drejtë!

Shaqir Fetai për momentin është i dehur nga “nektari i karrierës”, ndërsa, shumë shpejt, sapo t'i kalojë kjo dehje, do të bndet se i vetmi njeri që ia paska dashur të mirën paska qenë pikërisht H. Afrim ef. Tahiri! Sepse, efendi Tahiri, në fakt me fjalën “dorëheqje” drejtuar Shaqir Fetait, nga ai po kërkon që mos të mëkatojë më me shkatërrimin e BFI-së, mos të mëkatojë më duke u dhënë infuzion çakajve të BFI-së, mos të mëkatojë më duke e degraduar këtë Institucion deri në “çekallnicë” ku pritet për ndonjë çaj gratis, të mos mëkatojë më duke e përdorur këtë Institucion si miniere të okupuar ku kanë të drejtë të nxjerrin minerale për vete vetëm ata që ia puthin këmbët Shaqir Fetait! Sa më parë që të japë dorëheqje Shaqir Fetai aq më shpejt do të stopohet dezorganizimi i xhimateve tona, aq më pak do të ketë matrapasllëqe në emër të fesë! Tashmë krejt bota myslimane e di që Shaqir Fetai është shndërruar në “kumarxhi” dhe BFI-në e ka

shpërfytyruar në tavolinë kumari ku u jepet e drejta për të fituar të gjithë që ulen rreth tavolinës por që, që të gjithë janë të vetedishëm se mund të fitojë vetë Shaqir Fetai!

Me largimin urgjent të Shaqir Fetait, vetë ai do të arrijë të ndërgjegjësohet shumë shpejt e të kuptojë se ka qenë mashë në duart e huaj, se ka qenë alet që ka dëmtuar Institucionin, se ka qenë “matrapik” që ka goditur pa dhimbje në themelet e BFI-së! Do të trishtohet deri në vetëvrasje por, megjithatë, do t’i falënderohet Zotit si dhe të gjithë atyreve që janë bërë sebeb që ai të largohet sa më parë, sepse, sa më gjatë të qëndrojë në BFI pasojat do të jenë katastrofale për këtë Institucion dhe për myslimanët! Për këtë të vërtetë tashmë është i vetëdishëm edhe vetë Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai është bërë temë debati për mbi 1700 analizave, komenteve, shkrimeve gaztareske, të cilat e kanë zbërthyer edhe ADN-në e tij, e cila i del e degraduar nga injektimi i viruseve anikombëtare e anifetare! Shaqir Fetai nuk guxon më, asnjë minut, ta gënjejë vetëveten si dhe “bashkëveprimtarët” e vet! U dëshmuua kohëve të fundit se Shaqir Fetai është bërë njeriu më i urryer në Maqedoninë e Veriut: mijë e mijëra komente e prononcime të myslimanëve të vendit kundër tij! Ai duhet të ndalojë më me praktikën idiotike të tij, duke i sjellë nëpër kabinet të njëjtët njerëz e fytyra që i përdor si “përkrahës të flaktë” të tij! Shaqir Fetai nuk duhet nga askush, nuk respektohet nga askush, madje as nga familjarët e tij të cilët tashmë kanë hequr dorë nga ky karrierist i verbuar dhe e kanë lënë që të zhytet në mëkat ditë e më shumë.

Shaqir Fetai e ka të kotë përpjekjen që po ua shpreh disa “bashkëveprimtarëve” të tij duke u thënë se mos të mërzhiten fare sepse na e paska përkrahjen e Ali Ahmetit si dhe të BDI-së!

Nëse kjo rrenë e Shaqir Fetait na del e vërtetë, atëherë, unë, autori i këtij shkrimi, me familje shumë të gjërë e me ndikim, me shokë e miqasi të sinqertë, të gjithë votues dhe “militantë” të BDI-së e të Ali Ahmetit, publikisht prononcohem se do ta bojkotojmë këtë parti dhe liderin tonë! Unë po e bëj publike, kurse kështu si unë ka shumë në RMV, ndaj, të mos lejohet që për një plesh të kallet tërë jorgani, për një skrajë pas shiu të hiqet dorë prej demave të majmë! Nuk mundet që gomari t’i prijë karavanit të deveve! Unë dhe familja ime, miqësia dhe shokët, i garantojmë fitore spektakolare Ali Ahmetit dhe BDI-së në fshatin tim! A mund ta garantojë këtë Shaqir Fetai, i cili mashtron se është BDI ndërsa kjo parti në katundin e tij humbë vazhdimisht. Pastaj, rrenë Shaqir Fetai, sepse BDI-ja kurrë nuk ka qenë, nuk është dhe nuk mund të jetë çerdhe e shaqirave!

Prandaj – dorëheqje që ta ruajmë eko-habitatin tonë kombëtar e fetar!/**TetovaSot/01.06.2022**

## **Shaqir Fetai mundohet t'i poshtrojë institucionet kombëtare**

**Ambasadori i ri i Kosovës në RMV, Florian Qehaja, i sapo emërtuar në këtë detyrë, këto ditë ka realizuar një mori takimesh me shumë institucione shtetërore e jo shtetërore të vendit, paskësh realizuar një vizitë edhe në BFI. Është kjo përtej detyrës protokolare, në funksion të analizimit të filozofive gjegjëse të veprimit! Ambasadat nuk janë vetëm përfaqësim reprezentativ i vendit, por edhe mbrojtëse të interesave kombëtare që mund të dëmtohen nga vendi ku përfaqësojnë**

### ***Nga Adelina Shabani***

Në Maqedoninë e Veriut qenka emëruar ambasador biri i një prej personaliteteve të shquar shqiptar, gjeneral Ramadan Qehaja, i cili, si udhëheqës i Akademisë së TMK-së, ka dhënë kontibut të pamohueshëm në mbrojtjen dhe sigurinë e Kosovës. Florian Qehaja, me t'u emëruar në postin e ambasadorit të Kosovës në RMV ka realizuar një mori takimesh me qëllim që të njohtohet drejtë për drejtë me personalitetet drejtuese të vendit, me synimet e tyre, me politikat e tyre të ndryshme për vendin dhe, përgjithësisht për rajonin! Në axhendën e tij ka qenë edhe takimi me Shaqir Fetain, pasi që me të ndërliidhen shumë informacione që kanë të bëjnë me radikalizmin dhe ekstremizmin fetar ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, me pretendime për t'u shtrirë edhe në viset e tjera etnike shqiptare. Dhe, çka do të fliste tërthorazi Shaqir Fetai kur ambasadorin në fjalë e pret bashkë me Mustafa Dautin, njeriun më kontravers në këtë shtet, njeriun më të përfolur për imoralitet dhe për veprime antikombëtare në këtë hapësirë. Shaqir Fetai i paska uruar shëndet e suksese si dhe i paska ofruar zotëri ambasadorit gatishmërinë për bashkëpunim në sfera të ndryshme!

Ky abdalli mendon se Ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut është për t'ia përmbushur "axhendën" Shaqir Fetait, duke e thelluar "bashkëpunimin" në mes të BFI dhe Ambasadës së Kosovës! Të vetmën bashkëpunim që e synon Shaqir Fetai është këmbimi i "informacioneve" (mundësisht, sa më sekrete), sepse ato i duhen "zyres autonome" të Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai i paska shprehur "gatishmërinë për një afërsi vëllazërore dhe bashkëpunim të mirëfillt"! Deshti apo jo Shaqir Fetai, shqiptarët janë vëllazër dhe hiç nuk kanë nevojë për "afërsinë" e Orao-s! Paska kërkuar bashkëpunim të mirëfillt?! Po deri më tani, çfarë paska qenë ai bashkëpunim në mes të BFI dhe Ambasadës së Kosovës! Për çfarë bashkëpunimi të mirëfilltë po pretenduaka Shaqir Fetai! Ky është tërësisht në aut!

A mund të pritët bashkëpunim i mirëfilltë në momentin që figura reprezentative e Kosovës pritët me Mustafa Dautin? Kush është Mustafa Dauti? Si ia prezantoi këtë "slikë" ambasadorit të Kosovës? Çka i tha, përveçse rrena dhe vetëm rrena! Dhe, mbi rrenat Shaqir Fetai pretendon

bashkëpunim me ambasadorin? Shaqir Fetai e ka fyer ambasadorin, e ka ofenduar Kosovës, e ka njolesur personalitetin e Familjes Qehaja! A i tregoi zotëri ambasadorit se çfarë personi i ligë është Mustafa Dauti, a i tregoi se është i kapur prej tij dhe se nuk mund t'i lëvizë asnjë hap; a i tregoi se është duke bërë përpjekje maksimale për t'u liruar prej tij! A mos i tha se ka deponuar një deklaratë në prokurori e cila do t'ia hajë kokën Mustafa Dautit! Pse e dha këtë deklaratë! A mos paska ngritur prokuroria e shtetit ndonjë proces kundër Mustafa Dautit me të cilin e pret pinjollin e Familjes Qehaja?!

Si Shaqir Fetai ashtu edhe Mustafa Dauti hanë në të njëjtin grazhd, janë të lidhur me të njëjtin “kërpush”, ndaj dhe janë të pandashëm në pritjen dhe njolesjen e personaliteteve kombëtare! Fatkeqësisht, e kanë kapur edhe Institucionin mjaft të rëndësishm, ndërsa vizitat bëhen për nder të Institucionit dhe jo për nder të bashkëpunëtorëve të shërbimeve serbo-ruse! Shaqir Fetai asnjë delegacion tjetër nuk e pret me Mustafa Dautin, porse vetëm ato delegacione nga institucionet kombëtare. Është detyre e shërbimeve që ngrisin kapacitete zbuluese dhe kundërzuluese! Ambasadori e paska falënderuar për këtë “pritje vëllazërore”! Po kujt nuk i organizoi “pritje vëllazërore” Shaqir Fetai? Pritje vëllazërore i organizoi edhe delegacionit rus, bashkëpunëtorë të Putinit, me të cilët devalvoi shumë personalitete kombëtare të vendit duke u organizuar “takime vëllazërore”! Është e rrejshme ajo “pritje vëllazërore” që organizohet me Mustafa Dautin! Shaqir Fetai dhe Mustafa Dauti janë në po të njëjtat valë të lumit të turbullt, i cili kurrë nuk mund të jetë i bereqetshëm. Së shpejti do t'ju dalin mutsihanet në sipërfaqe, por atëherë, vallë, çfarë do të na thotë Shaqir Fetai! Ka qenë i manipular nga Mustafa Dauti, apo, ka qenë i detyruar nga “motivuesit misterioze” për të bashkëvepruar me Mustafa Dautin! Nëse ka qenë i detyruar dhe, ndërkohë është i pastër, kurrë nuk do të pranonte që të realizohet një takim në mes të pinjollit të Familjes Qehaja dhe Mustafa Dautit. Kjo dëshmon se edhe më i zi se Dauti, është vetë Shaqir Fetai! **1KlikLarg/11.06.2022**

## Skuthëria e Shaqir Fetait

**Shaqir Fetai në këtë vend është, për momentin, njeriu më i dëmshëm i shoqërisë shqiptare dhe myslimane; njeriu që shtyhet dhe përkrahet nga elementët antikombëtare e antifetare. Askush nuk e do, ndërsa manipulon me “respektin” e secilit që ia mësynë për ta njohur nga afër këtë skuth**

*Nga Vahid Ibrahim*

Nuk ka njeri që tashmë nuk e di se kush është Shaqir Fetai! Ky farë abdlili veten e imponon si “reis” ndërsa të gjithë e dinë se është e keqja katastrofale e fesë dhe e çështjeve kombëtare në vendin tonë! Edhe vetë ai e ka parasysh këtë fakt, prandaj, sa herë që del në foto para njerëzve të rëndësishëm, krekoset si injrant duke përçuar mesazhin: “sa keni qejf të fotografoheni me mua”! Shaqir Fetai tashmë është dëshmuar (nga halli) edhe si tip imponues (spiunët edhe të hanë shkop b... janë të detyruar të durojnë e të mbledhin informacion), si tipa që mbledhin njerëz në rrugë për t’u fotografuar e për t’u dëshmuar si “lider” i grupit, ndonëse ai grup mund të jetë tërësisht huligan!

Shaqir Fetai nuk mbanë llogari për asnjë personalitet, nuk mbanë llogari për peshën historike të asnjë figure, nuk i intereson karriera e askujt! Shaqir Fetai e ka obligim që të futet gjithkund ku i thonë, të fotografohet me të gjithë ata me të cilët i thonë të bëjë foto, sepse do t’ju duhen për sabotazh (të fotografohesh me një spiun është katastrofë)!

Shaqir Fetait nuk i intereson personaliteti dhe dinjiteti i askujt, ai e di që është njollë e madhe, ndaj duhet t’iu ngjitet të gjithëve që t’i njollosë sa më shumë!

Një karakter i këtillë, a mund të jetë besimtar së pari dhe, pastaj, a mund të jetë “prijës” i besimarëve! Një karakteri i tillë i cili që nga shtrati kur të ngritet planifikon se kë ta marrë më qafë, ç’vrepim të bëjë që do ta plotësojë katërcipërisht vetëm interesin e vet, çfarë dëmi të shkaktojë që të mbahet në mend, kë ta njollosë, kujt t’ia nxijë karrierën!

Shaqir Fetai e di fare mirë se kush është në të vërtetë, e di fare mirë se sa i ndytë që është, e di fare mirë se si e keqpërdorë islamit për të realizuar interesa të huaja, e di fare mirë se sa është i poshtër dhe, megjithatë, të tjerëve ua do respektin, ua kërkon bashkëpunimin, ua nënvizon “pritjen vëllazërore në ambient të ngrohtë”, ua kërkon pozimin për fotografim, ua do njollosjen e CV-së, sepse e di se të fotografohesh me këtë farë abdalli nuk është kurrfarë “kujtimi” përveçse njollosje e biografisë.

Pra, ky nuk mban llogari për asnjë personalitet kombëtar, atëherë, pse të mbahet llogari për këtë skuth! Ky duhet të injorohet, të bllokohet dhe të anashkalohet gjithnjë e më shumë! Sepse, është i rrezikshëm, ka dëshmuar se ka afinitete dhe skuthëri për të shkaktuar skandale, e ka obligim për

t'i njollosur të gjithë personalitetet kombëtare (jo rastësisht ia çoi njerëzit e Putinit kryeparlamentarit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferit)!  
Për momentin, në ofensivë janë të gjithë ish-udbashët, oficerët dhe bashkëpunëtorët e UDB-së serbe. Megjithatë, “gjallëria” e tyre nuk do të jetë më e gjatë se e bishtit të këputur të zhapinit!/**Kombetare/12.06.2022**

**U “solemnizua” marrëveshja për hurma të dhuruara!!!**

**U mbush kupa! Institucionet gjegjëse shtetërore duhet të reagojnë menjëherë; duhet që ta kapin, ta lidhin dhe ta dërgojnë për shërim Shaqir Fetain, sepse, djali nuk është mirë me mend. Këtë më së miri e dëshmon “aktiviteti” i tij i fundit që nuk është gjë tjetër përveçse idiotizëm**

***Nga Venera Arnori***

Shaqir Fetai e ka humbur udhën në oborr! Është hutuar deri në përmasa të një deliranti që nuk di më se çfarë bënë! Kur ka aq shumë skandale, kur nuk ia arrinë t'i mbulojë e t'i fshehë skandalet e njëpasnjëshme, njeriu bën rrëmujë, shkakton disa dukuri e skadale më të vogla, me qllim që njerëzit të merren me gjëra sporadike dhe jo me esencën e problemit. Në BFI esenca e vetme problematike ngelë Shaqir Fetai, i cili, tërësisht e ka humbur kontrollin mbi veten, mbi BFI-në, mbi organet e BFI-së! Jo që i ka pasur ndonjëherë në kontrollë, por ama, për momentin nuk ka organ në këtë Institucion të kapur prej hajnave e pisave, që nuk e ka të qartë se Shaqir Fetai është kanceri i BFI-së të cilën po e tret dhe po e venitë ditë e më shumë.

Tërë muajin e Ramazanit e kaloi duke mrizuar, duke thurrur intriga dhe, eventualisht, duke shkumuar nëpër iftare ku e thirrnin. I babzituri nuk e mendon të varfërin, mendjen e ka te b... e vet. Së këndejmi, nuk ia doli të organizojë kurrfarë aktiviteti institucional e t'i bëjë myslimanët e vendit që gjatë kohë ta mbajnë në mend organizimin e aktiviteteve humanitare të BFI-së  
Një muaj pas Ramazanit, iu kujtua Shaqir Fetait që të organizojë aktivitet humanitar me 25 ton hurma të ardhur si dhuratë nga Arabia Saudite!

Dhe, dy muaj pas Ramazanit, Shaqir Fetai na del me një informacion me titull: “Fondacioni i Mbretit Selman bin Abdulaziz Al Saud sot solemnizoi kontratën e dhurimit të 25 tonelatave të hurmave BFI-së”! A po mundet me i ra në fije ndonjë shqiptar këtij titulli idiotik, apo, nuk është me rëndësi titulli i pështjellaftë, me rëndësi është që të shkaktohet hutia! Këtë qëllim e ka Shaqir Fetai! Si mund të solemnizohet kontrata?! A mund të solemnizohet diçka? A është dhurim a çka janë këto 25 ton hurma?! Mos po do Shaqir Fetai me thënë se në mënyrë solemne u nënshkrua një kontratë?

Nëse është dhurim, pse të nënshkruhet kontratë? Kontrata nënkupton përfitim, apo, marrëveshje dypalëshe! Çka përfituan arabët nga kjo dhuratë, apo, për çka u mor vesh Shaqir Fetai me arabët! Cili ishte koncensionin i Shaqir Fetait për këto 25 ton hurma të dhuruara? Ndryshe, nuk ka marrëveshje por ka vetëm nënshkrim të dokumentit për pranim-dorëzim të 25 ton hurmave. Dhe, “solemnizimi” i këtij dokumenti është pordhë e ftohtë!



Asgjë nuk do të ishte kjo kontratë nëse nuk do të nënshkruhej në prezencë të Shaqir Fetait, i cili thotë: “Solemnizimi i kontratës u realizua në prezencë të Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame në RMV, Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai!” Pastaj abdalli thotë se, hurmat u shpërndanë më herët ndërsa sot bëhet “solemnizimi i kontratës”! Ec e merre vesh analfabetin! Po nëse hurmat janë shpërndarë, pse ajo pamje para BFI-së duke shpërndarë hurma! Erdhën hurma të tjera! A veç për hurma do të përkujdeset Shaqir Fetai? Veç me hurma do t’i tallë të varfërit, apo, me rëndësi është që në të tilla raste Shaqir Fetai po na del si “humanitar”! Hurma për të varfërin nuk paraqet, absolutisht, kurrfarë satisfakcioni, ndërsa për Shaqir Fetain paraqet mundësi për t’u tallur me loçkë të zemrës, bre Zoti qafën ia theftë, hë!

Krejt në fund, shtrohet edhe një dilemë: pse këta zotërinjë të Ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë nuk po dhurojnë hurma e nuk po “solemnizojnë marrëveshje” të tilla në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë? Pse këta zotërinjë më shpesh nga Tirana po e vizitojnë BFI-në se KMSH-në në Tiranë, pse bashkëpunim “të ngrohtë e vëllazëror” me Shaqir Fetain e jo, bie fjala, me Bujar Spahiun e KMSH-së, apo Naim Tërnavën e BIK-ut!

Fare në fund: a nuk është ofendim, poshtrim, tallje me integritetin e të varfërit duke bërë “humanitet” me të në vlerë të hurmës! Këtë idiotizëm mund ta lejojë, ta stimulojë dhe ta përkrahë vetëm Shaqir Fetai, i cili, vetëm një Zot e di se në ç’ujëra të turbullta është futur!/**IKlikLarg/14.06.2022**

## **Akademikët që nuk janë në anën e popullit i ha ujku!**

Shaqir Fetai na paska marrë pjesë në një mbledhje të Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, të cilën e paska udhëhequr dekani Dr. Shaban Sulejmani!

Shaqir Fetai nuk e tregon arsyen e pjesëmarrjes në këtë mbledhje, as motivin dhe as kontributin e vet! Si çka mori pjesë aty: si përçarës, si shkatërrues apo si spiun! Çka i ofroi kësaj vatre akademike, çka i premtoi stafit akademik, krejt në fund, a mendon Shaqir Fetai se është aq i rëndësishëm dhe aq domethënës për këtë Fakultet sa të prezantojë nëpër mbledhjet e saj.

Nga ana tjetër, a nuk është ofendim për këtë staf akademik që të përfshihen në një “hapësirë” ku prezanton edhe Shaqir Fetai? Në fakt, dalin shumë të diskutueshëm të gjithë ata akademikë që pranojnë t’ia dëgjojnë “pordhët” Shaqir Fetait, sepse, secili prej tyre është akademik e shkuar akademikut në raport me Shaqir Fetain! Së këndejmi, ia vlenë që ta pranojnë në “debat” Shaqir Fetain?

Për të qenë ofendimi edhe më i madh për këtë staf që pretendojnë të quhen akademikë, që të gjithë pranojnë porosi nga Shaqir Fetai! Ky farë abdalli i paska porositur që të punojnë! A pranohet porosia prej një shkatërrimtari, prej një shkelësi e shkatërruesi të tërë Bashkësisë Fetare Islame! A pranohen porosi prej atij që dërgon në vend porosi të huaja, të dala nga guzhinat e UDB-së!

Shaqir Fetai paska porositur “që të zhvillohen konform vlerave shkencore”! Po ku i di Shaqir Fetai vlerat shkencore! Cilat janë ato vlera shkencore që duhet t’i kapin akademikët e këtij Fakulteti? Cilat janë ato vlera të kënaqshme për këtë Institucion? I pavleri nuk mund të flasë për vlera shkencore, sepse nuk i kupton, nuk i di, nuk i njeh! Shaqir Fetai është model i antivlerës, kështu që, akademikët që ia dëgjojnë kopallat, duhet të kenë kujdes se, mund të kollofiten nga ujku, “pronar” i të cilit është Shaqir Fetai! Apo, sa mund të quhen akademikë ata që pranojnë të porositen prej Shaqir Fetait, apo të humbin kohë duke ia dëgjuar pallavrat e zbrazëta Shaqir Fetait! Në kushte normale, të gjithë ata që fascinohen nga pallavrat e Shaqir Fetait duhet menjëherë të zhveshin petkun e akademikut, sepse, akademiku nuk dënjon asnjë sekond ta humbë me injorantin!

Kudo që prezanton Shaqir Fetai, kudo që flet ky farë injoranti, kudo që lë porosi kyfarë servili i interesave të huaja, aty gjithçka shkatërrohet nga skandalet e pariparueshme. Kjo tashmë është vërtetuar në shumë raste. Sepse, jo njëherë Shaqir Fetai ka thënë që, do t’i njollos që të gjithë, do t’i detyroj që të më shërbejnë që të gjithë... Ja, kështu, siç po e detyron njërin për të cilin thotë se i ka nja njëzet banesa, një në Durrës, një në Siti Moll, dhe disa banesa që ia paskësh falur fëmijës së vet të jashtëligjshëm! Këto janë muhabetete të Shaqir Fetait, ndryshe nuk do t’i dinte opinionin!

Për të tillë tipash ka nevojë Shaqir Fetai, ndaj dhe i “përvetëson” gjithandej ku prezanton përmes formave të shantazhit. Ky farë duduku duhet të dëbohet, duhet të injorohet, duhet tërësisht të anashkalohet dhe jo të lejohet të marrë pjesë nëpër logje dhe ta keqpërdorë vendin duke lënë “porosira”! Ai përcjell vetëm atë porosi që ia thonë shërbimet e huaja. Porosi të veta nuk ka!/**Kombetare/17.06.2022**

## **Të vdesësh për armikun**

**Kush mund të vdes për armikun? Vetëm ai që i shërben dhe që është fatalisht i dashuruar në armikun. Vetëm një “i dashuruar” i tillë do të pranonte që të japë jetën kot e kot – të vdes për armikun**

### ***Nga Drilon Sejdi***

Këto ditë lexova dramën më të fundit të dramaturgut tonë të mirënjohur, Avni Halimit, me titull “Magbethi nga Jahja Pasha”! Teksti në fjalë ironizon një “pushtet” të tërë të instaluar nga “i plotëfuqishmi” që e kontrollon gjithmonë të isnaluarin ! Ia jep mundësinë që të ndjehet “mbret në fron”, që ta ndjejë pushtetin e falur për eksperiment si “mbretëri absolute” të mbretit i cili, në mungesë të mundësisë dhe guximit për ta vrarë instaluesin, “të plotëfuqishmin”, e vretë “mbretërinë” e vet deri në zhdukje të çdo ëndërrë të bukur! Duke e ditur se Avni Halimi ka punuar mëse dy dekada në Bashkësinë Fetare Islame, në lexim të parë krijohet përshtypja se këtë “mbretëri”, personazhet e kësaj “mbretërie” i ka gjetur pikërisht në këtë Institucion, situatat tragjiko-komike, dalin nga ky ambient ku të gjitha prapështirat mbulohen me vellon e tejdukshme fetare me të cilën manipulon kjo “mbretëri”

Pa dyshim, situata sot ka percipituar deri në tragjedi kombëtare! Nëse një dramaturg apo një skenarist do ta përdorte situatën që po zhvillohet aktualisht brenda Institucionit të BFI-së, pa dyshim që do ta ndërtonte tekstin mbi këtë sinopsis me titull: ‘TË VDESËSH PËR ARMIKUN’! Një “mbret” që instalohet Nga pushteti politik me qëllim që të vë kontrollë në institucionin që e lakmon vite me radhë! Në krye të këtij Institucioni do të instalohet, pa dyshim, personi që një jetë të tërë i ka shërbyer pushtetit përmes kontributit të vet nga nëntoka! Pa dyshim, ky do të ishte “reisi” aktual, Shaqir Fetai!

Ngjtja do të ndërtohej mbi themelet e një spiunazhi unikat, të papërsëritshëm, prej spiunimit në adoleshencë e deri në marrjen e misionëve edhe më të rëndësishme – shkatërrimin, njollosjen, degradimin e institucioneve kombëtare (qoftë ky ambasador, deputet, apo kryeparlamentar)! Nyje filmike, apo dramatike, do të shërbente edhe tema e vrapimit maraton pas legjitimitetit, jo duke u marrur me zhvillim të projekteve të rëndësishme, por, duke pritur e përcjellë, që nga miza e kalit deri te bualli, me synim të përfitimit të legjitimitetit prej tyre si “mbret” i instaluar prej të tjerëve!

Përse instalohet “mbreti” Shaqir Fetai? Natyrisht, për ta përmbushur e realizuar çdo kërkesë të armikut! Por, asnjëherë me vullnet e me lezet vetanak, gjithnjë duke u shantazhuar nga “i plotëpushtetshmi” i cili ka mijëra argumente për ta detyruar në punë të fëlliqura! Buxhetin “e mbretërisë” do ta kërkojë nga diaspora! Janë para të shumta që do ta joshin edhe ndërmjetësuesin

e këtij buxheti, do ta tundojnë për të vjedhur një shumë të konsiderueshme! Ndonëse e dënueshme me vdekje, “mbreti” do ta avancojë, sepse, i duhet një i korruptuar i tillë, i duhet një i kompromituar, sepse do ta ketë një përkrahje më shumë, një mik të shkëputur nga armiku i “mbretërisë” së tij! Natyrisht, këtë strategji do ta përdorë edhe “mbreti” për t’i shantazhuar bashkëpunëtorët e vet që ia përbëjnë “mbretërinë”! Ky shantazh do të duket si shkathtësi e “mbretit” për ta realizuar sa më shpejt dhe pa problem skenarin devalvues e degjenerues të “të plotëfuqishmit”!

Po pse e bën tërë këtë kryepersonazhi, në rastin konkret, Shaqir Fetai! Thjesht, për ta dëshmuar lojalitetin e përrjeshëm ndaj instaluesve të vet, pavarësisht se ata mund të jenë edhe armiq të popullit! Dhe, nëse Shaqir Fetai nuk do të mund të vdesë për popullin, të paktën të vdesë për armiqtë e popullit të vet, që në esencë, janë edhe armiq të tij. Sepse, kërkuesi i degjenerimit të institucionit jetik të një populli, nuk mund të jetë mik i zbatuesit të skenarit, por, pa dyshim, armik kokë e këmbë!

Sado që një vegël do të pranonte me vullnet që të vdes për armikun e vet, do me thënë, të vdesë në zbatim të projektit të armikut të vet, në fund do të dukej si një figurë tragjike, megjithatë, asnjë regjisor në botë nuk do ta nxirrte të tillë, por, kryekëput do ta nxirrte një figurë komike që natë e ditë punon për një fund të vetin tragjik, duke krijuar, megjithatë, një situatë komike me një personazh tragjik!

Çështja është se ky sinopsis nuk është për një monodramë, porse për një veper me më shumë personazhe! E kush nga bashkëveprimtarët e Shaqir Fetait do të pranonin që një ditë të bëhen të “pavdekshëm” duke u ngritur në personazhe të “TË VDESESH PËR ARMIKUN”!/TetovaSot/17.06.2022

## **Shaqir Fetai provokon medresantët**

**Pse Shaqir Fetai mundohet ta justifikojë fundin e arsimimit të medresanteve (motrave tona) me “akoma nuk e kemi të akredituar Medresenë”! Edhe më herët nuk ishte e akredituar por, kishte një “rroçko” që e detyronte tërë qeverinë që të japin urdhër për pranim të medresantëve në çdo fakultet shtetëror**

### ***Nga Sanie Memishi***

Këto ditë, me të përfunduar të procesit mësimor në Medresenë “Isa Beu”, sipas Shaqir Fetait drejtori i Medresesë Ibrahim Idrizi ia paska organizuar një takim me nxënësit më të dalluar të kësaj gjenerate! Do me thënë, ky nuk i beson vetëvetes se mund t’i takojë këta nxënës, prandaj i duhet organizimi i Ibrahim Idrizit, ose, e përqeshë Ibrahim Idrizin duke u munduar ta paraqesë si lolo, si një kavië që natë e ditë i rri “pronto” Shaqir Fetait, madje edhe i organizon “evente” të tilla promovuese të një fytyre pa kurrfarë personaliteti e respekti! Krejt këtë atmosferë e “paska begatu” edhe prezenca e sekretarit të Medresesë Lutfi Nexhipi!

Pra, këta “faca” paskan takuar dhe kanë faktuar të vërtetën se si Shaqir Fetai “i paskan dekoruar” nxënësit më të mirë të vitit, me qëllim të respektit ndaj nxënësve të gjeneratave të SHMI “Medreseja Isa Beu”! Shaqir Fetai, “të gjithëve u ndau mirënjohje dhe botimet e reja të BFI të RMV. Ai e falënderoi Drejtorin për organizimin e këtij takimi”, thuhet në informatën e botuar në “gazetën e murit” të BFI-së!

Shaqir Fetai mendon se me këtë “gjest” të poshtër të tij, përmbillet tërë obligimi ndaj këtyre nxënësve në emër të të cilës po i rjep myslimanët e Maqedonisë së Veriut! Një “dekoracion” dhe, aq! A nuk është kjo sjellje cinike e tij, tallje me nxënësit (medresantet) të cilat, me vetë faktin që janë të angazhuar të dalin si nxënës më të suksesshme të gjeneratës, ato kanë synime, kanë ëndërra të veta, kanë ambicie për të arritur shkollim edhe më të lartë?

Këta nxënës e nxënës nuk plasën që ta takojnë Shaqir Fetain e të marrin “dekoracione” prej tij, por, thjesht, i shkuan në zyre me shpresë se prej tij do të marrin ndonjë informatë që shkon në të mirë të shkollimit të tyre sipëror. Apo, thjesht, i shkuan me inat për t’i dëshmuar se është i paafte dhe i pafuqishëm për t’ua hapur perspektivat medresanteve, ndërsa është shumë i zoti për vetëlavdërim dhe për rrena!

Ai, i manipulon, u flet edhe për këtë “mundësi”, por, gjithçka ngelë manipulim alla-shaqirçe!

Shaqir Fetait as që i intereson perspektiva e medresanteve, as që i intereson shkollimi i mëtejme i tyre, Shaqir Fetait, thjesht, i intereson vetëm kolltuki i uzurpuar me puç e me tradhëti si dhe t'i shkojë gjithçka vaj me pushtetin maqedonas që e instaluan në krye të BFI-së! Këtij pushteti i duhej një i këtillë si Shaqir Fetai, pa kurrfarë personaliteti, sepse, dikur, reisi i Shaqir Fetait e lodhte çdo pushtet duke i detyruar që të sillnin vendime për t'u regjistruar të gjithë medresantët, atje ku duan vetë ata! Medresja është shkollë e mesme që funksionon në Maqedoninë e Veriut, konform ligjeve dhe rregullave për arsimim dhe, deri më sot, asnjë inspektorat i arsimit nuk ka konstatuar se kjo vatër arsimore duhet të injorohet dhe të anashkalohet tërësisht! Prandaj, nuk ka nevojë që medresantët, sidomos motrat tona, të pësojnë për faktin se Shaqir Fetai nuk po ia arrinë që ta akreditojë Medresenë. Askujt nuk i intereson akreditimi, thjesht, i intereson që të ushtrohet presion, madje edhe me padëgjueshmëri qytetare, që të hiqen të gjitha këto "kufizime raciste" të strukturuave ortodokse antiislame dhe, nxënësve të shkollës profesionale të këtij shteti, t'i lejohet shkollimi në të gjitha universitetet shtetërore. Këtë Shaqir Fetai jo që nuk di si ta bëjë por, edhe sikur ta dinte, ai nuk e ka guximin, nuk e ka integritetin, personalitetin, vendosshmërinë për t'ua hapur dyert e shkollimit medresanteve.

Në fund të këtij informacioni, ishin edhe disa komente, ndërsa njëri ishte shumë prekës! Një mysliman i vendit i drejtohet Shaqir Fetait duke e pyetur nëse e ka frikë Allahun, sepse në shtëpi i ka dy vajza që ia kanë kryer medresenë ndërsa ënërrat për shkollim të mëtejme, nëpër fakultetet e vendit, thjesht, i janë shuar, sepse kanë kryer një shkollë diplomat e së cilës nuk i pranon askush! I kërkon që t'i përgjigjet këtij halli të myslimanëve të vendit, dhe jo që t'i fshijë komentet kritike mbi paaftësinë e Shaqir Fetait për ta akredituar Medresesë!

Kujt i duhet një shkollë e tillë që ua vret ëndërrat të rinjëve duke i përjashtuar prej shoqërisë me arsim sipëror? I duhet vetëm Shaqir Fetait, sepse, falë kësaj Shkolle ai po ia del t'ia vjelë taksat myslimanëve të vendit, duke u thënë se ato para i duhen për mirëmbajtjen e Medresesë, kurse i shpenzon në rroga e në qejfe të bashkëvepruesve të vet! Cilës Medrese? Të asaj çerdhe të lakejve të Shaqir Fetait që i shërbejnë si "tançerkat" në video-spot? Të asaj "rrënueseje" të ëndërrave rinore për arsimim sipëror?

A ka shpirt ky farë bastardi? Deri ku mund të shkojë cinizmi i tij i pashterrshëm ndaj myslimanëve të vendit? Apo, Shaqir Fetai nuk pjerdh për këtë hall të myslimanëve të vendit, sepse as që i ndjenë ata, as që i llogaritë shoqëri "sagllam"! Ata duhet të vijnë një pas një në zyren e Shaqir Fetait, të fotografohen me të dhe, kësisoj, t'ia krijojnë lajmet limonadë, me të cilët, kënaqet i gjori, si foshnjat me gomë aromë frutash me të cilën i kruajnë dudat kur nisin t'i shpërthejnë dhëmbët e qumështit!/**IKlikLarg/18.06.2022**

## **Haxhi i sivjemë i organizuar privatisht e në emër të BFI-së**

Në faqet zyrtare të BFI-së, që nga 23 marsi e deri më sot, nuk ka asnjë informacion që mund të flasë se në cilën datë është mbledhur Rijaseti i BFI-së dhe ka debatuar mbi organizimin e Haxhit të sivjemë. Ekziston vetëm një komunikatë në të cilën interpretohet neni 37 i Kushtetutës së BFI-së si dhe janë caktuar disa kushte për haxhin e sivjetëm. Kaq!

Pra, kemi të bëjmë me një organizim ilegal të haxhit, ndonëse në emër të BFI-së) Me gjasë, për herë të parë në historikun e Bashkësisë Fetare Islame të RMV-së, në emër të këtij Intitucioni, do të organizohet një haxh jashtëinstitucional, përtej çdo rregullative juridike të Institucionit në fjalë. Kjo, sepse, pa dyshim, mundësitë për vjedhje nga haxhi dhe për mosraportim para organit më të lartë kolektiv do të jenë më se reale, shkruan Top24.

Çmimi i haxhit të sivjemë është jashtëzakonisht i lartë për kushtet reale të myslimanëve të vendit. Vërtet kush e caktoi sivjet çmimin e Haxhit?

Neni 37 i Kushtetutës së BFI-së thotë: “Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame është organizator kryesor dhe i vetëm në realizimin e kryerjes së Haxhit dhe Umrës”. Nëse hidhni një kërkim në faqen zyrtare të BFI-së, në FB-un e BFI-së, por edhe në FB-un e kryetarit të BFI-së, Shaqir ef. Fetait, nuk gjendet asnjë informacion, asnjë shënim, asnjë raportim për mbledhje të Rijasetit, (i cili, sipas alinesë së dytë të po të njëjtit Nen, e obligon të paktën një herë në muaj të mbajë mbledhje të rregullt), ku është do të vendosej për themelimin të komisionit për haxh, po njëkohësisht as ky komision nuk ka asnjë mbledhje ku do duhej të raportonin para anëtarëve të Rijasetit, me çka, të njëjtit, do të sillnin vendim për çmimin e haxhit 2022!

Bazuar në këtë rregullativë juridike, kjo formë e organizimit të haxhit është institucionale dhe konform Kushtetutës së BFI-së! Ne kërkuam edhe nga zyrtarë të BFI-së që të na përgjigjen se mbi çfarë kritere dhe mbi ç’norma u arrit çmimi i haxhit të sivjemë, prej nga na thanë se “kjo është kompetencë e reisit dhe se komisioni i formuar prej tij i referon për çmimin më të ulët që kanë arritur ta sigurojnë për haxhilerët tanë dhe pastaj këtë çmim e komunikon për opinion vetë reisi dhe ky qëndrim i reisit duhet të zbatohet edhe prej organeve të BFI-së”!, tha për Top24 burimi i cili nuk pranoi të pronocohet publikisht.

Nëse kjo është metoda, atëherë, fatkeqësisht, kemi të bëjmë me vendime autokrate dhe të papërgjegjshme.

Ndyshe kushtetuta e BFI-së qartë përcakton rolin e gjithësecilit brenda këtij institucioni, duke u nisur nga neni 39 e deri te neni 44 ku përshkruhen detajisht detyrat e Reisul Ulemasë dhe kjo kushtetutë e BFI-së e cila ende është në fuqi në asnjë Nen apo aline nuk nënvizohet se ai cakton komisionin e Haxhit, se ai është organizator i haxhit, se ai është caktues i çmimit të haxhit!

Pika 5 e Nenit 37 si dhe alinea 2 nenit 38 qartë flasin për atë se si Rijaseti është ai organ i cili formon komisione të përhershme apo të përkohëshme! Ndërkaq, për herë të fundit Rijaseti i BFI-së ka dalur me kumtesë më 23 mars të këtij viti ku ka informuar se ka mbajtur mbledhje dhe se ka sjellë disa konkluzë, prej të cilave, ajo e pesta thotë: “Rijaseti i BFI-së, lidhur me Haxhin informon besimtarët e vendit se sipas informatave nga autoritetet e Mbretërisë së Arabisë Saudite, sivjet do të organizohet udhëtim për kryerjen e Haxhit.

Për informata tjera rreth Haxhit në mënyrë plotësuese do të jepen pasi të nënshkruhet Mahdari me Ministrinë e Haxhit të MAS. Me këtë rast, edhe njëherë ia bëjmë me dije opinionit se i vetmi organizator legjitim dhe kompetent i Haxhit në vendin tonë është Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame në RMV.” Rijaseti deri më sot nuk është tubuar dhe nuk ka debatuar lidhur me organizimin e haxhit dhe as lidhur me caktimin e çmimit. Këtë e bën një komision formal që e ka caktuar vetë Shaqir Fetai në cilësi të reisit dhe fatkeqësisht, për herë të parë në historikun e BFI-së ndodhë që ky Institucion të mos e organizojë haxhin por, atë ta organizojë një komision jashtëkushtetues i caktuar privatisht nga Shaqir Fetai, i autorizuar nga ai që komisioni të bredhë nëpër viset e Arabisë Saudite, të bëjë kontrata dhe, nga atje, të sjellë një çmim që do të jetë çështje e kryer! TOP24.

Edhe pasi jemi në prag të realizimit të Hxhit 2022, ende BFI nuk ka dhënë detaje rreth mënyrës së organizimit vendosejes transportit dhe detajeve tjera që ndërlihen me organizimin e haxhit./**Top24/23.06.2022**



## **Shaqir Fetai e humbi kontrollin! E humbi...**

**Me Shaqir Fetain gjithçka rrjedh egër, çdo proces është ilegal dhe në interes të huaj, sepse, vetë Shaqir Fetai është interesi i huaj, ilegalisht i instaluar në krye të BFI-së me qëllim që gjithçka të rrjedhë egër, trishtueshëm, me synime shkatërrimtare! Këtë e dinë, fatkeqësisht, edhe myftinjtë e sotit, të cilët me lezet po ia mbajnë iso-n Shaqir Fetait në punët e tij të fëlliqta.**

### ***Nga Valbon Osmani***

Për herë të parë në historikun e BFI-së kemi të organizuar haxh të egër, ilegal, fatkeqësisht në emër të Institucionit! Nuk është respektuar asnjë rregullativë e BFI-së, nuk është përfillur asnjë organ dhe nuk janë sjellë kurrfarë vendimesh nga organi më i lartë kolektiv, nga Rijaseti! Haxhin e “organizon” Shaqir Fetai me “myhybët” e vet të inspiruar nga rrëfimet legjendare të “Bagdatski llopovit”!

Shaqir Fetai dëshmoi se, jo që nuk di të funksionojë sipas rregullave të organeve kolektive, jo se nuk e di Kushtetutën e BFI-së, jo që nuk e njeh praktikën e organizimit institucional të këtij obligimi fetar, por, thjesht, e ka shumë të qartë se po i vie fundi, prandaj, të shfrytëzohet rasti dhe të përmbush orekset e veta aqesavi jepet mundësia, natyrisht pa u përfshirë këtu organet kolektive apo trupat ndihmëse. Ky manipulim kurrë nuk do t’i falet Shaqir Fetait, një ditë ai do të përgjigjet edhe penalisht për këtë anashkalim që ia bën organit kolektiv në punën me të cilën e obligon madje vetë Kushtetuta e BFI-së! Thjesht, Shaqir Fetai vetë pret dhe vetë qep!

Për ta zbutur paksa këtë kritikë që e lakuriqëson tërësisht organizimin e egër të haxhit të sivjemë, Shaqir Fetai, i tmerruar nga ajo se u zbulua për hajninë e madhe, nisë me manipulimet e veta.

Paska thirrur myftinjtë për konsultime para nisjes së haxhit! Pra, nuk thotë se e tuboi RIJASETIN, por, i tuboi myftinjtë si dhe drejtorët e institucioneve dhe sektoreve, me qëllim që të konsultohet! Të gjithë këta organe përbëjnë Rijasetin i cili tubohet për të sjellë vendime, për të propozuar më të mirën para miratimit të çfarëdo vendimi!

Çka ka këtu për t’u konsultuar? Ka formuar vetë komisionin, i ka caktuar vetë udhëheqësit e haxhit si dhe të haxhilerëve, ka caktuar vetë çmimin dhe, në fund, hajde mos të më ngelë kopili në dorë! I fton myftinjtë për manipulim! Nuk mund të ketë konsultime në prag të nisjes së haxhilerëve, sepse, nuk ka çka i këshillon dhe as çka i konsulton myftinjtë Shaqir Fetai, i cili as që ia ka haberin e organizimit të këtij obligimi islam, as që ka organizuar ndonjëherë dhe as që di se si shkojnë punët rreth haxhit. Ai di vetëm të përfitoj nga haxhi.

Shaqir Fetai veten e llogaritë “pushtet” (edhe atë, maqedonas), nuk ia ka ngenë askujt, nuk e bën hesap as Kushtetutën e BFI-së, as Organet kolektive të BFI-së, sjell vendime autokrate dhe, në fund t’i njollosë që të gjithë. Prandaj, i fton myftinjtë, tallet me myftinjtë dhe, në fund, llogari do të kërkojë edhe prej tyre! Llogari për ç’gjë as që dinë se çfarë ka ndodhur, sepse kanë qenë tërësisht të përjashtar nga procesi!

Ndoshta edhe e meritojnë këtë përbuzje dhe këtë tallje të gjithë myftinjtë! Përjashtohen nga procesi ndërsa pak para nisjes për në haxh, tubohen dhe “konsultohen”! Sa vlenë konsultimi i tyre, këshillat apo këshillimet pasi gjithçka që ka dashur ka vendosur vetë Shaqir Fetai!

Për herë të parë përjashtohet Rijaseti nga ky organizim, për herë të parë përjashtohen myftinjtë dhe organet e tjera nga ky proces por që, në llogaridhënie përfshihen edhe ata! Kështu mendon Shaqir Fetai dhe kësaj ia arrinë! Myftinjtë nuk bëhen hesap në këtë organizim, ndërsa nëse plasim aferat e vjedhjes dhe të korrupsionit, atëherë, të gjithë mund ta hanë por jo dhe Shaqir Fetai! Shaqir Fetai qenka takuar edhe me udhëheqës dhe me mjekë të haxhit? Edhe ky është aktivitet i egër, sepse, dikush ata emra, ata propozime, numrin e tyre, është dashur ta miratojë në ndonjë mbledhje të Rijasetit! As ky hap nuk është hedhur! Gjithçka në ilegalitet dhe, sipas dëshirës dhe propozimeve të Shaqir Fetait! Një ekip prej nja 80 personave të përzgjedhur nga instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së!

Të gjithë këtyreve haxhi u paguhet nga BFI-ja! Kush e solli këtë vendim?

Të gjithë këtyreve u paguhet dhe mëditje? Kush e solli dhe kush e miratoi vendimin për lartësinë e mëditjeve?

Të gjithë këta mund të kenë edhe shpërblime dhe benificione ekstra? Kush e solli këtë vendim dhe cila do të jetë ajo shumë e përfitimeve ekstra?

Kujt i duhen këto shërbime, nëse jo ekskluzivisht Shaqir Fetait! Sepse ai dëshiron që vjedhjen t’ia kryejnë sa më shumë persona dhe, që të gjithë ata të kontribuojnë për t’ia realizuar dëshirat meskine dhe të poshtra Shaqir Fetait! Rreth 500 mij euro do të jenë shpenzimet të cilat do t’ua mbulojë BFI-ja, respektivisht, shumë kjo që do të nxirret nga çmimi i haxhit të sivjemë. Pra, të gjithë haxhilerët e sivjemë kanë paguar çmim kaq të larë, sepse, ekipi i Shaqir Fetait është i madh dhe i pangopshëm shpenzimet e të cilëve përfshihen në këtë çmim të sivjemë të haxhit! Pra, “ekipin ndihmës dhe mjekësor” nuk e paguan bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait, por, e paguajnë të gjithë haxhilerët e sivjemë!

Me Shaqir Fetain gjithçka rrjedh egër, çdo proces është ilegal dhe në interes të huaj, sepse, vetë Shaqir Fetai është interesi i huaj, ilegalisht i instaluar në krye të BFI-së me qëllim që gjithçka të rrjedhë egër, trishtueshëm, me synime shkatërrimtare! Këtë e dinë, fatkeqësisht, edhe myftinjtë e sotit, të cilët me lezet po ia mbajnë iso-n Shaqir Fetait në punët e tij të

fëlliqta./1KlikLarg/Fakte/24.06.2023

## **Kush do të përgjigjet penalisht për vakëfin e grabitur**

**Këto ditë, portali kombëtar Top24 publikoi një dokument-tabelar që dëshmon për kohën dhe shumën e dhënë në letra me vlerë në vend të denacionalizimit të pronave të BFI-së. Qeveria ka kryer obigimin e vet, kurse BFI-ja i ka shkelur të gjitha detyrimet, obligimet, parimet islame për sa i përket shndërrimit të kësaj shume parashë në prona të përhershme (vakëf) të BFI-së**

### ***Nga Mr. Eset Shaqiri***

A e keni parë dhe dëgjuar se si Shaqir Fetai duke shkumuar nënvizon mirësinë e pushtetit maqedonas në denacionalizimin e pronave, duke ia “dhënë” Shaqir Fetait Kapanhanin, Besistenin, “ish-kino Napredokun”, disa hektar tokë, pazarin në Kërçovë etj.!

Por, a e keni dëgjuar ndonjëherë të flasë për letrat në vlerë, të cilat, janë dhënë në kundërvlerë të pronave që kanë qenë të nacionalizuar. Natyrisht, vlerësimet kanë qenë vetëm sipas dëshirës dhe vlerësimeve subjektive të pushtetit kurse BFI-ja nuk ka bërë asnjëherë zhurmë, me qëllim që të merren ato shuma parashë, pa u bërë fort transparent tërë procesi. Nuk i ka interesuar vlerësimi objektiv, Shaqir Fetait i ka interesuar vetëm paraja, sepse, e kishte ëndërr që të dëshmohej se sa “i sukseshëm” që na doli si instalacion politik nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së!

Kurrë nuk e tha një fjalë, kurrë nuk e bëri publike vlerën prej 257.418.762.00 den (mbi 4 milion euro), kurrë nuk e bëri asnjë informim lidhur me këtë lloj denacionalizimi të pronës për disa myftini. A ka ndonjë raport financiar brenda BFI-së, ndonjë dokument që flet për këto të hyra dhe për ridestinimin e tyre; a u shënuar dikund se letra në vlerë kanë hyrë në arkën e BFI-së për këto lloje e tipa të pronave të denacionalizuara nga ana e qeverisë maqedonase! Nuk ka dhe, as që do të zihen ngojë donjëherë nga ana e Shaqir Fetait. Sepse, pa dyshim që sakaq do të shpalosej tërë ai kriminalitet, ajo hajni dhe ajo zhvatje që i është bërë vakëfit të BFI-së. Vakëfi mund të “shitet” me qëllim që me ato para të blihet një vakëf tjetër edhe më kapital! Pra, nuk ka ndodhur ndonjëherë, nuk ka bërë vaki që të shitet vakëfi që të sigurohen rroga, apo, të rriten rrogat siç e bëri këtë Shaqir Fetai! Ku janë këto para? Çka u bë me ato para? Ku përfunduan ato para?

Njerëz nga brenda BFI-së e shpjegojnë në mënyrë shumë të qartë se si u shpërndanë këto para! Sipas këtyre zërave konstatohet se: për çdo shumë nga vlerësimet paushalle dhe subjektive të pronave të nacionalizuara 20 për qind janë dhënë për funksionarë të caktuar të pushtetit që kanë nënshkruar në vendimet për ato bono në vlerë, 5-10 për qind janë dhënë për sekserin që ka ndërmejtësuar për ta nxjerrë sa më parë vlerësimin nga komisionet gjegjëse qeveritare. Ose, ky

tridhjetë për qindësh ka qenë strategji e myftive për mos t'i deklaruar paratë që i kanë futur nëpër xhepat e veta! Nëse nuk është kështu, le të prononcohen!

Rruga deri në arkën qendrore është edhe më e gjatë! Nga shuma e mbetur, prej 70 për qindëve, 30 për qind (sipas rregullores së fundit 50 për qind) shkojnë në arkën qendrore për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore të BFI-së dhe, pjesa e ngelur shkon në Myftini. Myftiu, për ta shprehur lojalitetin e plotë ndaj Shaqir Fetait, respekton kërkesën e “reisit” të cilit i duhen ato para për t'ua siguruar dhe rritur rrogat nëpunësve të vet! Natyrisht, nuk jepen të gjitha, sepse një përqindje duhet të shkojë nëpër xhepat e nëpunësve të myftinive me qëllim që të korruptohen dhe ta heshin vjedhjen e madhe të vakëfit. Madje ka pasur myfti që ka trashëguar nga myftiu paraprak rreth një milion euro, të cilën, toptan e dorëzon në arkën qendrore me qëllim që ta nxjerrë nga “situata mjerrane” reisin e vet!

Ka myfti që ka hequr dorë nga hoteli që është dashur të ngritet si pronë e Myftinisë së Shkupit, apo që, akoma nuk e ka thënë asnjë fjalë për tejkalimin e të gjitha afateve për dorëzimin e kësaj prone në pronësi të Myftinisë së Shkupit! Publikisht është hedhur gurëthemeli i hotelit të BFI-së në hapësirën e ish-Komunalecit dhe ishte caktuar afati se kur do të duhej të përfundonte ky ndërtim kapital! Asnjë fjalë nga ky Vakëf, asnjë reagim për vonesën dhe asnjë procedurë për dëmshpërblim për Myftininë! Flitet si dikush prej nëpunësve të BFI-së që i mbronë interesat e investitorit dhe ndërtuesit të “lagjes se re” tashmë ka siguruar disa banesa nga objektet e ngritura në vakëfin e denacionalizuar të Shkupit! Vërtet, a e di kush se ku dhe si përfunduan paratë e malit në Gazi Babë që u denacionalizua në letra në vlerë! BFI-ja i mori paratë, e humbi hapësirën e mrekullueshme dhe, KOM-i që refuzoi denacionalizimin e paraparë sipas “qeverisë”, tashmë është bërë me kishë në majë të Gazi Babës!

Kjo është rruga nëpër të cilën kanë kaluar këto bona me vlerë dhe kjo është arsyeja se pse kurrë nuk e keni dëgjuar Shaqir Fetain të flasë për këtë lloj të denacionalizimit të vakëfit, siç nuk ka folur kurrë as për arsyen e dëbimit të Bankës Islame për Zhvillim e cila i kishte finalizuar të gjitha procedurat për të investuar miliona euro dhe për ta bërë një vakëf gjigant për Myftininë e Gostivarit! U raportua për çdo proces dhe për çdo fazë gjatë ecurisë së punëve për të investuar në këtë vakëf por kurrë nuk u raportua mbi arsyen e dëbimit të tyre. Apo, ikën vetë sepse u trishtuan nga kërkesat korruptive dhe hajdute të ish myftiut të Gostivarit. Do të zbardhen edhe këto afere të trishtueshme, pa dyshim, ndërsa myftinjtë që kanë futur duart grabitqare në vakëf, do të turpërohen pa kurrfarë mëshire! Në gjithçka mund të ketë kompromis por, kurrën e kurrës në falje të grabitçarëve të vakëfit!/**TetovaSot/29.06.2022**

## **Reklamë e shpifur e Shaqir Fetait në rolin e stjuardesit të haxhilerëve**

**Haxhi i sivjemë, në organizimin privat të Shaqir Fetait, do të jetë i pari haxh në historinë e BFI-së që është organizuar në mënyrë të egër! Përfshirja e myhybëve lehtësisht të shantazhueshëm të Shaqir Fetait në këtë organizim, nuk i jep kurrfarë peshe institucionale organizimit të sivjemë të haxhit**

***Nga Halid Sadiku***

Për herë të parë në historikun e Bashkësisë Fetare Islame kemi të organizuar një haxh privat e që naivisht i taksohet Institucionit në fjalë. Pa vulën e BFI-së vështirë se do të arrinte Shaqir Fetai të organizonte haxhin, kësajsoj, si manipulanti i tmerrshëm që është, ai e shfrytëzon siglën e BFI-së dhe, përtej normave juridike të BFI-së, përtej traditës dhe organizimit institucional të haxhit, pa respektuar Kushtetutën e BFI-së, organet e saj si dhe rijasetin, si organ kolektiv, ai organizon një lloj haxhi të denjë për autokratët dhe manipulantët!

Shaqir Fetai thotë se “poogrami” i haxhit të sivjemë paska paraparë që ai të gjendet në aeroport, madje edhe të hyp në aeroplan, për t’i përcjellë vetë ai haxhilerët e grupit të parë dhe të fundit! Ç’farë programi na paske qenë ky i Shaqir Fetait! A është normal se çfarë flet ky!

Në fakt, ditën kur doli zbuluar se si po organizon haxh të egër, duke keqpërdorur siglën e BFI-së, ai u tmerrua dhe nisi të bëjë një fushatë, të zhvillojë një propagandë të mjerë, duke dalur në syret me turlifarë mahluki-bashkëpunëtori të vet, me qëllim që të krijojë përshtypje se, ja, ai është me tërë “stafin e vet”! Po ku ishte ky staf, ku ishin këta përfaqësues të organit kolektiv kur u desht të miratohet komisioni i haxhit, kur u desht të zgjidhet kryetari i haxhit, kur u desht të formohet e të miratohet “programi” i haxhit, kur u desht të përcaktohet çmimi i haxhit, kur u desht të vendoset për mënyrën e organizimit të haxhit?! Gjithçka vendosi vetë Shaqir Fetai, me qëllim që vjedhja të bëhet sa më e sofistikuar, mos të dihet realisht sa ishin hotelet, sa ishte udhëtimi, sa ishin pagesat e tjera, të cilat, në përgjithësi do ta diktonin edhe çmimin e haxhit!

Nuk mund të institucionalizohet ky organizim i haxhit i Shaqir Fetait përmes fotografive (me qindra sosh) si dhe përmes video-klipeve idiotike të dërguara nga nisja apo nga pritja e haxhilerëve, duke na përçarur fotografi me pamje të poshtra, burra që dalin nga autobusi me gjoks e bark të zbuluar, me ihramin e hedhur në mënyrë nosnhalante, ndonëse nga po ai autobus dalin edhe gratë, motrat, nënat tona. Këto pamje nuk i bëjnë përshtypje Shaqir Fetait, atij i duhen pamje nga nisja-arritja, me qëllim që të shihet se sa mirë i përcjellin, sa mirë i presin haxhilerët

tanë dhe, tërë kjo të dëshmojë për “institucionalizimin” e haxhit si dhe ta “justifikoj” çmimin e lartë të haxhit të sivjemë! I përcjellim, i presim, i marrim ngryk, prandaje dhe duhet të na paguajnë haxh të shtrenjtë, sado i papërballueshëm të jetë. Ne, “Ilopovat e Bagdadit” jemi në shërbim të haxhilerëve dhe jo BFI-ja!

E kotë, Shaqir Fetait nuk mund ta mbulojë injorimin e vet që ia bëri organizimit isnitucional të haxhit.

Haxhi i sivjemë, në organizimin privat të Shaqir Fetait, do të jetë i pari haxh në historinë e BFI-së që është organizuar në mënyrë të egër. Përfshirja e myhybëve lehtësisht të shantazhueshëm të Shaqir Fetait në këtë organizim, nuk i jep kurrfarë peshe institucionale, por, kjo përfshirje edhe një herë do të dëshmojë se sa të inkriminuar janë bashkëveprimtarët e Shaqir Fetait, sa të korruptuar që janë, madje deri në përmasën e lakeut, të sahanëlëpirësit me fytyrë të pistë.

Të bëhesh vegël propagandistike e Shaqir Fetait do të thotë që të bëhesh mjet i përkryer i rrënimit të themeleve të BFI-së, i lartësimit të kësaj pune që është mision i vetëm i Shaqir Fetait. Një njeri, imoral, i pandershëm, hajn, tradhëtar, komplotist, spiun – pra, një njeri i këtillë të merret me çështje fetare është, në fakt, përfundim i misionit që synon shkatërrimin e jetës fetare institucionale. Të mjerë janë të gjithë ata që akoma nuk e kanë kuptuar këtë mision të Shaqir Fetait, kurse edhe po kaq të mjerë janë të gjithë ata që e kanë kuptuar por që për një interes të poshtër të tyre vendosin që t’i servilosen Shaqir Fetait./**1KlikLarg/30.06.2022**

## **Regjistrimi i medresantëve po pengohet nga “rijaseti” i Shaqir Fetait**

**Deputeti i Aleancës për Shqitarët, Halil Snopçe, ka ngritur në Parlament një shqetësim i cili, në fakt shpalos diskriminimin politik që u bëhet medresantëve të “Isa Beut”!  
Maturantët e kësaj Medrese nuk mund të regjistrohen, në asnjë fakultet publik, madje as në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup**

*Nga Shaban Aziri*

“Janë rreth 180 maturantë që nuk kanë të drejtë të regjistrohen, rreth 550 nxënës të Medresesë Isa Beu të cilët vetëm e kryejnë shkollimin e mesëm dhe për shkak të mos pasjes së akreditimit nuk kanë të drejtë të regjistrohen në universitetet shtetërore. Paradoksi më i madh, shteti i Turqisë i pranon, mund të regjistrohen në Turqi, nuk mund të regjistrohen në universitetet e këtij shteti. Unë këtu garantoj në emër të ASH-së se do nisim iniciativë për ligj për pranimin e diplomave nga ana e shtetit”, tha mes tjerash Snopçe.

Dhe, shtrohet pyetja: pse për këtë problem të BFI-së reagon politika? Nga ana tjetër, disa raporte ndërkombëtare thonë se, që kur instalacioni politik Shaqir Fetai i caktuar në krye të BFI-së nga pushteti aktual maqedonas, na qenka takuar me presidentin Stevo Pendarovski, raportet ndërfaqetare në vend qenkan në harmoni të plotë! Po a nuk e prishë këtë harmoni kjo qasje diskriminuese ndaj Medresesë “Isa Beu”? Pse “rijaseti” nuk e lakuriqëson këtë të pavërtetë për sa i përket “harmonisë ndërfaqetare”, dhe ta vë theksin mbi diskriminimin fetar si pasojë e të cilit është edhe ky qëndrim për ta penguar regjistrimin e medresantëve atje ku dëshirojnë! Në Turqi mund të regjistrohen, pa dyshim, por, a e dinë politikanët tanë se, nostrifikimi i diplomave nga fakultetet turke pamundësohet pikërisht për shkak të bazës së atyre diplomave, e që i bie të jetë Medresja “Isa Beu”? Pra, është për t’u përshendetur ndërgjegjësimi i politikës për sa i përket këtij problemi! Por, megjithatë, shtrohet një pyetje: pse reagon politika për Medresenë ndërsa hoxhallarët, teologët e vendit, profesorët e Medresesë, nxënësit e Medresesë dhe, për më tepër, vetë “rijaseti” heshtë dhe bëhet palë me politikën diskriminuese të pushtetit aktual!

Kush po i pengon këta që të protestojnë deri në padëgjueshmëri qytetare? Kush po i pengon këta që të ngrisin zërin kundër diskriminimit që po u bëhet fëmijëve të tyre, të cilët nuk mund të regjistrohen atje ku dëshirojnë vetë për të vetmin “faj” se kanë krye një shkollë profesionale teologjike! Ky problem duhet t’i tangojë teologët dhe tërë Rijasetin, duhet ta trishtojë Shaqir Fetain i cili, për një fotografi me Pendarovskin apo me Zaevin, është në gjendje që edhe ta mbyllë Medresenë!

Shkolla e Mesme Medresja “Isa Beu” nuk akreditohet përderisa Shaqir Fetai të jetë palë e politikave diskriminuese kundër medresantëve të “Isa Beut”! A ka më krim se t’ua pamundësoshë qindra nxënësve që të vazhdojnë shkollimin e mëtejme ku të kenë dëshirë vetë ata! Pse këta të jenë të padëshirueshëm nëpër fakultete shtetërore? Pse Shaqir Fetai të angazhohet për një Medrese me vetëm 35 për qind lëndë teologjike vetëm e vetëm që të plotësohet “një kriter” që na u dashka për t’u regjistruar nëpër fakultetet shtetërore! Rijseti i BFI-së, politikbërësit e vendit duhet të insistojnë në një Medrese me qind për qind lëndë fetare, me qëllim që të na dalin teologë të mirëfilltë! Pushteti i Maqedonisë së Veriut është përplot me paradokse dhe, një prej tyre është edhe fakti që, brenda një viti ka punësuar tetë medresantë në shërbimin intelektual maqedonas, ndërsa nuk ua pranon diplomat!

Është koha e fundit që Bashkësia Fetare Islame, Rijaseti, uzurpatori i këtij Institucioni, Shaqir Fetai, të dalë nga gëzofi ku strehohet nën sjetulla të pushtetit maqedonas dhe, ta detyrojë këtë pushtet, partitë tona, institucionet relevante që, ta ngrisin zërin kundër kësaj padrejtësie të pushtetit, kundër diskriminimit politik e fetar që u bëhet nxënësve të Medresesë dhe, të mos pritët akreditimi, madje edhe të refuzohet akreditimi i cili aktualisht po merret si alibi për ta pamundësuar regjistrimin e medresantëve nëpër fakultete shtetërore ku dëshirojnë ata. Medresja është një shkollë legale, legjitime, e regjistruar, me program mësimor konform kërkesave të institucioneve gjegjëse shtetërore ndaj dhe, nxënësit e kësaj shkolle të mesme duhet të jenë të barabartë në politikën regjistruese të të gjitha fakulteteve shtetërore të vendit. Këtë mund ta bëjë vetëm Rijaseti, vetëm Medresja, vetëm profesorët, nxënësit, me presionin e tyre, me reagimet e njëpasnjëshme, me protestat masovike që e detyrojnë politikën që të jetë më fleksibile në raport me këtë problem!

Vitin e kaluar u organizua një protestë njëorëshe e medresantëve dhe, sakaq, u mobilizua tërë politika e vendit, deri te Kryeministri Zaev, për të qetësuar situatën duke ofruar premtime të rrejshme. Një reagim më i unifikuar, i inicuar prej vetë atyreve që duhet të inicohet (Rijaseti, profesorët, nxënësit, prindërit) do ta detyronte politikën që brenda minutit të ofrojë rrugëdalje, siç ofronte edhe më herët kur për këtë gjë “kërleshej” ish-reisul ulema të cilit nuk i interesonte gjithëaq “harmonia ndërfitare” sa i interesonte jeta islame instituconale në vend. Atëbotë, anashkalohej qeveria, anashkalohej partia, anashkalohej Kuvendi dhe, vetëm me një vendim të Ministrisë së Arsimit, hapeshin dyert për të gjithë medresantët e vendit. Sot kjo praktikë ka vdekur, sepse është ringjallur interesi meskin i Shaqir Fetait, i cili, absolutisht nuk ka kurrfarë pikëtakimi me interesat e medresantëve tanë./**Top24/30.06.2022**



## **Kur të pangopshmit manipulojnë dhe vjedhin**

**Vjedhje e radhës e Shaqir Fetait do të jetë kjo e Kurbanëve! A e keni parë se si fton Shaqir Fetai, si manipulon, si përpiqet ashiqare për të vjedhur?! Apeli i Shaqir Fetait është: “DHURO KURBANIN TËND PËR MEDRESENË “ISA BEU””!**

*Nga Valbon Osmani*

Që kur Shaqir Fetai u instalua politikisht nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së, Myftinia e Gostivarit po i thyen të gjitha “rekordet” për sa i përket të hyrave në arkën qendrore nga aksionet fetare! Nëse kjo është e vërtetë, atëherë, ky fakt a nuk flet për Shaqir Fetain si myfti llopov? Gostivari nuk u ndërgjegjësua sakaq, në moment, por të hyrat në arkën e BFI-së nga kjo trevë myslimane kanë qenë në kontinuitet të njëjta, kanë krijuar një traditë nga një devotshmëri permanente. Pra, kanë dhënë edhe më herët ngjashëm si sot, por, problemi është se vetë Shaqir Fetai, si myfti i atëhershëm i Gostivarit, ka manipuluar me ato kontribute financiare gostivarase, nuk i ka dorëzuar të gjitha në arkën qendrore, ka vjedhur sa ka dashur, prandaj, kurrë nuk pati guxim që të raportojë se si qenka vjedhur në kohën e ish-reisul ulemasë, për të cilin sot Shaqir Fetai hedh gurë e dru nëpër ndeja “sekrete”!

## **Shaqir Fetai po rrenë apo naivisht po i zbulon gjurmët e vjedhjeve të veta**

Është e pashpjegueshme që brenda dy-tre muajve pas instalimit të Shaqir Fetait, aq shumë qenkan gëzuar gostivarasit sa, paskan vendosur që të bëhen dorëshlirë dhe krejt pasurinë ta derdhnin në BFI! Sepse, kështu lavdërohet Shaqir Fetai, ndërkohë që po këta myslimanë i paskan dhënë më pak kur paska qenë myfti i Gostivarit! Diçka nuk shkon: ose po rrenë Shaqir Fetai, ose naivisht po i zbulon gjurmët e vjedhjeve të tmerrshme që i paska bërë si myfti! Ose, le ta pranojmë si fakt edhe këtë përshtypje: mund të ketë ndodhur që gostivarasit të mos jenë të kënaqur me punën e Shaqir Fetait si myfti, i cili më tepër është shquar si një autokrat demagog se sa si ndonjë “lider” lokal! E kanë bojkotuar, e kanë refuzuar, sepse e kanë njohur, ia kanë ditur të bëmat që nga periudha si student në Sarajevë! Apo, ja që Shaqir Fetai, duke e ditur se e njohin të gjithë gostivarasit si person të prishur, nuk ka pasur guxim që të imponohet dhe të organizojë tubim më të madh të kontributeve financiare, sepse, e ka ditur fort mirë edhe kundërefektin e “organizimit” të tij! Shaqir Fetai nuk do t’ia dalë që të na shpërfaqet në “engjell”, sepse, për këtë person, pa dyshim që do të ketë ndonjë kapitull të posaçëm në dorëshkrimin e paralajmëruar të ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit!

## **Matematika racionale që e demonton vjedhjen e Shaqir Fetait**

Shaqir Fetai, me haxhin e 2022-shit dëshmoi se është i po atij klani të hajnave që kanë ikur nga “bota ireale” dhe me kënaqësi janë shndërruar në pasues të vërtetë të “Bagdatski llopovave”! Organizoi një haxh të egër, u mundua që ta institucionalizojë, pra, i bëri të gjitha përpjekjet për të dëshmuar se prapa kësaj Vjedhje të Madhe të Haxhit 2022 nuk qëndron Shaqir Fetai por tërë BFI-ja, madje edhe komisioni për përcjellje të haxhinjëve i përbërë nga Qufli Osmani, Shaban Ramani dhe Milazim Dibrani si vrima të fundit të kavallit dhe si “fjala e fundit” e procesit organizativ të Haxhit!

Një pushim veror prej 10 ditëve në hotel me tetë yje, full all inkluziv, me transport, kushton rreth 800 euro! Njëzetë ditë do të kushtonte 1600 euro, shto këtu edhe nja 1000 euro taksa e viza për kokë të haxhiut, pra, nuk do të shkonte më tepër se 2600 euro, shto edhe nga një mijë euro për kokë të haxhiut si shpenzime të paparashikueshme, plus nga katërqind euro fitim për BFI-në si organizatore, ja, gjithësej 4000 euro! Vjedhje e madhe e Shaqir Fetait, e cila e joshi që t’i futet kësaj avanture duke anashkaluar Kushtetutën e BFI-së si dhe të gjitha organet përgjegjëse dhe ekskluzivisht të thirrura për të sjellë vendime që i përkasin organizimit të Haxhit.

## **Vjedhja e radhës e Shaqir Fetait**

Vjedhje tjetër e radhës është kjo e Kurbanëve! A e keni parë se si fton Shaqir Fetai, si manipulon, si përpiket ashiqare për të vjedhur. Apeli i Shaqir Fetait është: “DHURO KURBANIN TËND PËR MEDRESENË “ISA BEU””!

Pa dyshim që ky apel është kryekëput manipulativ! Është apel i pulikuar nga një grusht hajnash që janë mësuar që myslimanin ta rjepin mundësisht deri në palcë! Deri kur Medresja “Isa Beu” do të shërbejë si mbulesë e hajnisë së Shaqir Fetait? Deri kur kjo Medrese do të shërbejë si mjet për t’u katapultuar në haram disa prej haramëve të BFI-së që çuditërisht akoma po u shkon kungulli mbi ujë! Sivjet Shaqir Fetai çmimin e kurbanit e ka caktuar të jetë 150 euro! Kurse ka plotë agjenci e shoqata humanitare që ofrojnë kurbanë të therrur, të rjepur e të paketuar nëpër pjesë sipas normave fetare, me një çmim prej 80, 100, 110 euro!

Veç kësaj, pse të gjithë kurbanët për Medrese? Pse nuk thuhet se sa mish shpenzon në vit Medreseja, sa kurbanë i duhen, pse nuk e tregojnë numrin e saktë të kurbanëve që duhet të dhurohen për Medresenë! Pse thonë se, u plotësua numri i kurbanëve për Medrese, ndërsa pjesën tjetër do t’ua falim të varfërve! Kurbanit i therrur brenda ditës shpërndahet tek të varfërit, fqinjët, farefisi dhe, kurbanit nuk futet nëpër frigorifera që, kur t’i vie veza te b... Shaqir Fetait, të vrapojë të shpërndajë “mish kurbanit” për të varfërit! Kjo shtë edhe vjedhe por edhe keqpërdorim i kurbanëve të myslimanëve që kurbanin e vet e kanë dhuruar për “Medrese”! Mbajtja e kurbanëve nëpër frigorifere vetëm sa e dëmton buxhetin e BFI-së dhe i sjell përfitime pronarëve të frigoriferëve që mund të jenë në ujdin me Shaqir Fetain e “bagdatski llopovat” e tij!

## **Kundërshtarët e BFI-së kanë pushtuar “kalanë”**

Pse kohëve të fundit nuk paguhen dhe nuk donohen kurbanë si gjat viteve 1990-2000? Në fakt, në emër të BFI-së sot donohen edhe më shumë kurbanë se gjatë viteve të theksuara më sipër por, ja që, diku po treten ato kurbanë? Po vidhen? Pa dyshim që po! Një prej formave të vjedhjes është edhe ajo që po ushtrohet prej ish-togjev që pakompromis e luftonin BFI-në! Mbi njëzet vite me radhë kanë dëmtuar BFI-në duke i ndërhyrë në sistemin e saj financiar: duke vjedhur fitra,

zeqat, kurbanë, duke organizuar “haxh të egër”! Sot, këta “luftëtarë të BFI-së”, kanë kaluar në “organe” të BFI-së, pra, i kanë hyrë nga brenda “armikut”, e kanë pushtuar “kalanë”! Dhe, a mos po presin këta “organe” që t’u besojmë se po angazhohen për të mirën e BFI-së? Në fakt, këta janë duke e shfrytëzuar BFI-në si logjistikë për t’i realizuar planet dhe projektet e “shoqatave” dhe “forumeve” të tyre prej nga, përmes shërbimve sekrete, janë katapultuar në BFI! I rritur dhe i pjekur me frymën e këtyre “shoqatave” e “forumeve” pa dyshim që është edhe vetë Shaqir Fetai, prandaj, ky farë “reisi” do të ngelë në historinë e BFI-së si i vetmi “reis” që ka bashkëpunuar ngusht me armiqtë e dëshmuar të BFI-së!

Megjithatë, ju “jepeni kurbanin për Medresenë”! Është identike sikur të thuash: falni troje, falni ara, objekte, pasuri për Vakëf, ndërsa ne e dimë se si do ta shpenzojmë atë pasuri. Ju vetëm falni! Dhe, pastaj, këtyre t’u interesojë Medreseja “Isa Beu”! Pa dyshim që gënjejnë! Mbase do të jenë “transparent” në numrin e kurbanëve, sa për ta përdorur si “sukses” të tyre si rrjedhojë e “kënaqësisë dhe lumturisë” së myslimanëve me punën e tyre “të ndershme”, por, kurrë nuk do të tregojnë se ku shkuan ata kurbanë, ku shkoi ai mish, sa u therrën për nevojat e Medresesë, dhe ku shkoi pjesa tjetër! Nuk do ta tregojnë sepse do të dalë zbuluar apeli i tyre manipulativ “Dhuroni kurbanin tuaj për Medresenë”!

Pleqnarët do të thoshin: TRASHNE ZULLUMIN E SHAQIR FETAIT ME DUART E JUAJ!

### **Shaqir Fetai si “politikan vizionar”**

Këto ditë Shaqir Fetai, në një restorant prestigjioz, në rrethinën e Gostivarit, kishte tubuar nja tri-katër myhybë të tij dhe po ngulfateshin në mish e pije! Po u mbante ligjeratë “patriotike”! U fliste mbi obligimin patriotik të BFI-së që duhet ta kryej në këto çaste vendimtare për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut! Për këto çaste, po u thoshte, e kemi hallall edhe nëse vjedhim nga arka e BFI-së, nëse krijojmë fond të zi për t’i dalur në ndihmë partisë!

Nëse kjo është parti pa dyshim më e fuqishme në vend, atëherë, ç’i duhen paratë e vjedhura të Shaqir Fetait! Do me thënë, Shaqir Fetai na qenka i detyruar në vjedhje të fitrit, të kurbanit, të haxhit, të vakëfit, të zeqatit, sepse, i duhet fond për ta ndihmuar partinë në zgjedhjet e jashtëzakonshme që do të mbahen gjithësesi!

Asnjë simpatizant i kësaj Partie, kurrën e kurrës nuk do të besonte se ky subjekt politik ka ardhur në atë derexhe sa i duhen paratë e BFI-së? Vjedhjen Shaqir Fetai do të mundohet ta kamuflojë me “këtë nevojë” të BDI-së, të dëshmojë se sa është i afërt me këtë parti, të dëshmojë se e ka brengë fatin e kësaj partie, të dëshmojë se kjo parti nuk mund t’ia dalë pa kontributin konkret financiar të Saqir Fetait!

Mbase e ka edhe mision për t’ia nxirë fytyrën kësaj partie para ndërkombëtarëve? Sepse do të shpërthente një dyshim i paimagjinueshëm nëse paratë e një institucioni fetar derdhen në fondin e një partie! Shaqir Fetai jo njëherë është dëshmuar se është alet i përkryer për tradhëti dhe për dëmtim të imazheve të mira të krijuara me vite e decenie. Janë të shumta faktet që flasin për këtë prishuni të Shaqir Fetait, të cilën ai e shet si “vizion politik”!/TetovaSot/04.07.2022

## **Urimet e cinikut**

Shaqir Fetai na e paska “uruar” Amerikën për ditëlindjen e saj! “Pikërisht në këtë ditë (4 korrik), në vitin 1776 Presidenti Tomas Xheferson përpiloi Deklaratën e Pavarësisë, dokumentin me të cilin lindi pavarësia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i garantoi lirinë dhe demokracinë popullit amerikan”, thotë Shaqir Fetai!

Dhe, kush flet për Deklaratën e Pavarësisë? Shaqir Fetai që e shkeli me dy këmbë, që e refuzon natë e ditë, që e bastardon në çdo sekond Kushtetutën, “Deklaratën e Pavarësisë” së BFI-së nga kreatura aq e poshtër por e dashur nga Shaqir Fetai “ish-BFI-ja e Jugosllavisë”!

Kush flet për lirinë dhe demokracinë e popullit amerikan? Shaqir Fetai që nuk ka lidhje me demokraci, Shaqir Fetai që duke i hapur rrugë autokracisë ka mundësuar shkeljet mbi çdo vlerë të demokracisë amerikane, duk krijuar terren për vjedhje, për korrupsion, për ekstremizëm fetar, për defaktorizim të Institucionit, për dezorganizim të shoqërisë myslimane të vendit, për shantazh, për zhvatje, për bashkëpunim me elemente terroriste pro-ruse që shiten për myslimanë! Shaqir Fetai është promovues i pikërisht atyre vlerave të cilat Amerika i urrenë deri në luftim të pakompromisë. Shaqir Fetai bën mirë që një herë në jetë të dalë nga ajo gërzhoja cinike e tij!/**Lajme7/04.07.2022**

## **Demagogji dhe mediokritet para medresantëve**

**Akreditimi i Medresesë “Isa Beu” nënkupton jo vetëm pranim të diplomave të kësaj Shkollë të Mesme Profesionale, por edhe implikime financiare që duhet të mbulohen nga buxheti shtetëror! Që nga ky moment, do të duhej të heshtin të gjitha apelet që të jepen fitra e zeqate, kurvana e kontribute të tjera për Medresenë, në emër të së cilës bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait po vjedh pa hesap**

***Nga Blerim Hoxha***

Me rastin e përfundimit të vitit akademik dhe marrjes së diplomave nga maturantët e Medresesë “Isa Beu”, qenka organizuar edhe një “event” sa për t’ia mundësuar Shaqir Fetait edhe një herë demonstrimin e pafuqisë së vet, dështimin katërcipërisht të tij, talljen e pushtetit me të që nga momenti kur pranoi të instalohet në krye të një Institucioni jashtëzakonisht të rëndësishëm sa për ta shprehur vullnetin e mirë në planin e shkatërrimit të BFI-së si dhe të të gjitha organeve dhe institucioneve të saj. Shaqir Fetai akoma nuk është i bindur se çfarë roli ka pranuar! Nuk është i bindur sepse ai ka vuajtu për rol, qoftë ky edhe negativ, apo edhe tragjik!

Shaqir Fetai këtë “event” e kishte përdorur edhe sa për ta vënë në dyshim konstatimin se, në raport me pushtetin ai është një pulen e puthadorë i pashembullt në historinë e BFI-së! Sakaq, në këtë “event” do ta ngris zërin e ngjizur e do ta kundërshtojë qëndrimin e pushtetit, por ama jo në publik, por para nxënësve dhe prindërve, duke thënë se “do të vie koha kur revoltën time do ta paraqes edhe aty ku duhet”! Shaqir Fetai, tamam si një skuth e mediokër i pashoq mundohet që të shpreh “një brengë” para nxënësve dhe prindërve madje edhe t’u kërkoj falje se pse akoma nuk ia doli që ta akreditojë Medresenë!

Sa vlenë ky truk i abdallit? Çka do të thotë “kërkim falje” kur ti, me paaftësinë tënde, me misionin tënd nënshtrues, po ia mbyllë arsimimin superior një aradhe të tërë maturantësh! I vjel myslimanët, ua vjedh kafshatën e gojës dhe, në fund, si dhelpira dinake që i hedh këlyshët e vet, ashtu i lë në udhëkryq maturantët e Medresesë “Isa Beu”! Snobizëm i paparë nga ana e Shaqir Fetait, u kërkon falje nxënësve për misionin e tij anti-medrese dhe anti-BFI, madje pa u skuqur për faktin se, për faj të tij, 150 maturantë të Medresesë ngelin pa u regjistruar në fakultete! Po pse nuk i ftoi që të gjithë, në shenjë rrebelimi kundër pushtetit aktual maqedonas, të regjistroheshin në FSHI! Personi që e ka dert Meresenë, nuk do ta kishte dert simpatinë e pushtetit dhe të ndërkombëtarëve por, do të dorëhiqej në shenjë revolte, duke ua prishur të gjithë hesapet, të gjithëve!

Shaqir Fetai nuk na paska faj për këtë dështim! Fajin na e paskan ndërkombëtarët të cilët i paskan garantuar Shaqir Fetait se do t’i ndihmojnë në akreditimin e Medresesë, për të cilën gjë

Shaqir Fetai na paska ndejtë aq urtë sa prej ndërkombëtarëve edhe paska marrur mirënjohje për “harmoni ndërfitare”!

Fajin edhe më të madh për mosakreditimin e Medresesë, na e paska, sipas Shaqir Fetait, Kisha Ortodokse Maqedonase! A është në vete abdalli, Shaqir Fetai, apo, kur e humb ky kontrollin ia futë kot e kot! Do me thënë se, KOM-i nuk dëshiron që ta akreditojë Shkollën e “Bogosllovisë”, ndaj dhe, për pasoj, nuk do të akreditohet as Medreseja!

Atëherë, pse rrenë Shaqir Fetai se shumë shpejt do ta akreditojë Medresenë! Pushteti do të pajtohet që për hirë të Shaqir Fetait, t’i ndryshojë të gjitha ligjet, ndoshta edhe të prekë në Kushtetutë që, t’ia mundësojë akreditimin e Medresesë! Dhe, më vonë vite më vonë, t’i teket edhe KOM-it për ta akredituar “Bogosllovinë” dhe, hajde, edhe një herë, t’i hymë ligjeve të Kushtetutës së Shtetit! Apo krejt kjo mund të tejkalohet me urdhër ministror, me vendim qeveritar, siç bëhej kjo, deshtën apo jo, në kohën e ish-reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit! Ndërhyrjet në norma juridike nuk bëhen vetëm për interes të një komuniteti por për interes të mbarë shoqërisë! Shaqir Fetai e ka të kotë presionin ndaj pushtetit politik pa u akorduar me Kishën Ortodokse Maqedonase! A e ka këtë pehllivanllëk Shaqir Fetai? Assesi, veçse në përpjekjet e tij eventuale mund të dalë i ... – lagur!

Nuk sensbilizohet opinioni i vendit, as ndërkombëtarët dhe as institucionet shtetërore me fjalime e me retorikë boshe prej abdalli, para nxënësve dhe prindëve, nuk ka zgjidhje duke iu kërkuar falje atyreve se nuk po ia del ta kryej këtë obligim parësor, por, kjo bëhet me konferenca për shtyp prej vetë “reisit”, me afatizim të prioriteteve, me ftesë për protesta, me ndërprerje të çdo bashkëpunimi me institucionet shtetërore, me padëgjueshmëri qytetare, me rrezikim të kolltukut të grabitur, tërë kjo për të mirën e gjeneratave që po i merr më qafë Shaqir Fetai me “kërkim faljesh” prej lakeu! Nëse nuk di dhe nuk mundet, nëse ndjehet i paaftë dhe vetëm pak njerëzor, atëherë, le të tërhiqet se ka kush e bën këtë detyrë në afat rekord!

Nëse Medresja për Shaqir Fetain na qenka i vetmi objektiv islam, atëherë le të veprojë dhe, mos ta mbajë këtë vatër arsimore si mundësi për ta vjelur popullatën myslimane dhe për të vjedhur sa të duan Shaqir Fetai me myhybët e vet!

Akreditimi i Medresesë “Isa Beu” nënkupton jo vetëm praninë të diplomave të kësaj Shkollë të Mesme Profesionale, por edhe implikime financiare që duhet të mbulohen nga buxheti shtetëror! Që nga ky moment, do të duhej të heshtin të gjitha apelet që të jepen fitra e zeqate, kurbanda e kontribute të tjera për Medresenë, në emër të së cilës bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait po vjedh pa hesap./**TetovaSot/06.07.2022**

## **Për Shaqir Fetain intoleranca është vlerë euro-integruese!**

**BFI-së me rastin e festave fetare! Sipas “mesazhit” të përcjellë nga ky “manifestim qendror” (kush është ai që këtë gjest të mirë e quan “manifestim qendror”?!) del puna që Shaqir Fetai ka pasur nevojë të madhe për t’i justifikuar dhe legjitimuar protestat e dhunshme të VMRO-së dhe Levicës, edhe atë mu në ditën e Bajramit të Kurbanit**

***Nga Mr. Eset Shaqiri***

Sipas një tradite të hershme, Reisul Ulema ishte i “detyruar” të qëndrojë në seli dhe të presë personalitete të shquar nga jeta politike, akademike, nga shoqëria civile, nga kori diplomatik dhe nga sektori i biznesit! Me këtë rast, ishte bërë traditë që mysafirët e lartë të qeraseshin me bakllava ose të donuar ose të bërë nga vetë familja e ish-reisul ulemasë!

“Ceremonia e manifestimit të Bakllavasë së Bajramit”

Mos ma merrni për të madhe, por kështu e thonë nga BFI. Në fb zyrtar të BFI-së ka një postim me titull: “Fjalimi i Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai në Ceremoninë e manifestimit të “Bakllavasë së Bajramit”!

Nga ku nevoja për të zgjedhur një mënyrë tjetër të prezencës së reisul ulemasë në mesin e personaliteteve të ndryshme. A nuk flet kjo se u bë e nevojshme pikërisht kur shumë personalitete në një periudhë të caktuar hezitonin që të vijnë e ta vizitojnë selinë e BFI-së. Shaqir Fetai, përfundimisht vuan për “lagështi (vllagë) personaliteti të cilën e merr duke e ndërë në mes të personaliteteve të larta të vendit. Veç kësaj, Shaqir Fetai edhe manipulon me këtë prezencë të personaliteteve, të cilën, të tjerëve ua shet si “përkrahje masovike” që po i vjen nga të gjithë! Cili është mesazhi i kësaj ideje “për qerasje të elitës” me “bakllavë të Bajramit”? Çka përcjell ky gjest! Çka flet ky gjest! A i ka hije një organizate fetare që, me paratë e kurbanit, me fitër e zeqat, pasi t’ua vjelë besimtarëve, të paguaj restorante elitare, të paguaj bakllava e pije me çmime të kripura të restoranteve! Le ta nxjerrë faturën Shaqir Fetai dhe le të dëshmojë se këtë “mastraf” të kotë e mbuloi nga xhepi i vet! Me paratë e besimtarëve ia do që të blejë pak personalitet dhe autoritet të cilën, qysh në ditën e nesërme nuk e ka më, sepse nuk e ka as të lindur dhe as dhuratë nga i Madhi Zot, i Cili, asnjëherë nuk i ka dhuruar autoritet!

Po cili ishte mesazhi personal i Shaqir Fetait para të pranishmëve (simbolikë) si nga jeta politike ashtu edhe nga kori diplomatik (!)? Çka tha Shaqir Fetai? Asgjë të rëndësishme!

Në sy të të gjithëve Shaqir Fetai, tërthorazi, i arsyetoi dhe u dha përkrahje morale protestave të organizuara nga VMRO-DMNE dhe Levica! Duke u munduar që të pallamudë, ndonëse nuk i kishte fare hije, Shaqir Fetai “përfshihet” në kontributet e përgjithshëm për inkuadrimit në Maqedonisë në NATO si dhe për nevojën e inkuadrimit të vendit në BE!

Madje për këtë gjë ai sikur porositi që askush të mos mërzhitet nga protestat e dhunshme të bllokut opozitar maqedonas, sepse, sipas Shaqir Fetait: “Intoleranca dhe diversiteti fetar apo

nacional asnjëherë nuk duhet të jenë pengesë në rrugëtimin e shoqërive drejt paqes dhe përparimit"! Sa për ta njohtuar Shaqir Fetain, po ia bëjmë me dije se fjala "intolerancë" do të thotë mungesë tolerance! Pra, aty ku mungon toleranca, qoftë nacionale apo fetare, aty ka konflikt, aty nuk mund të ketë as përparim dhe as inkuadrim në BE! Aktualisht, intolerancën e porosisin dhe e propagojnë vetëm misionarët rusë që futen në një shoqëri për ta realizuar qëllimin rus për rajonin! Shaqir Fetai nuk është abdall për të nënvizuar gjëra si forma të "gafës"! Ai e di shumë mirë se ku dhe kur duhet të lëshojë një "apel" i cili mund të jetë fatal. Talat Xhaferrit ia futi në Parlament misionarët rusë, kurse para Ali Ahmetit, thërret në një "intolerancë" që është mision rus! Dhe, na thotë që, që mos të brengosemi, madje ta përkrahim protestën opozitare, sepse intoleranca (ruse) nuk mund të jetë pengesë për inkuadrimin e vendit tonë në BE.

Dhe, si gjithnjë me poshtërsitë e veta, fjalimin e vet "akademik" e përfundon me: "Ju falemnderit shumë për prezencën e juaj, sot i dhatë një rëndësi të madhe sakrificës për njeriun, paqen dhe bashkëjetësën në mes njerëzve dhe kombeve në përgjithësi"!

Duke e menduar veten si "lider" i NATO-s, apo i ndonjë super-organizmi botëror, i falënderon pjsëmarrësit që i dhanë kuptim sakrificës për njeriun! Ndërsa të pranishmit aty ishin vetëm për të hëngër bakllava, për ta ushtruar një "sakrificë" mbi bakllavanë! Zatën, ftesat që ia bënin njëri-tjetrit, në shumicën e rasteve ishin: "A po vini të shkojmë të hamë bakllava", sepse, asjëri nuk di se si t'i vë emër këtij veprimi idiotik e shpenzues të Shaqir Fetait!**1KlikLarg/10.07.2022**



## **Antipropaganda e antipopullorit Shaqir Fetahu**

### ***Editorial i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI***

Figura më antipopullore për momentin në vend pa dyshim që është Shaqir Fetai! Prej një personaliteti të diskutueshëm, prej një “profesori të respektueshëm”, prej një “myftiu” që ka vepruar si urith, ka arritur në një stad ku secili që përshëndetet me të ndjehet i turpëruar. Sot, ndër turpet e mëdha llogaritet edhe ajo nëse të sheh dikush me këtë person, i cili, për interesa të veta të ulta është në gjendje që t’i turpërojë të gjithë, çdo një mysliman të vendit dhe më gjërë. I mbetur pa kurrfarë personaliteti, i mbetur pa kurrfarë autoriteti, Shaqir Fetai mundohet që çdo person që i pihet çaji apo kafja me të, çdo mevlud, çdo varrim e çdo ngushëllim ta keqpërdorë duke e kthyer në aktivitet të tij personal. I përdor rastet, i përdorë njerëzit, i përdorë situatat për pak reklamë, duke menduar se, sado pak do t’i rritet marzhi i “popullaritetit”. Në fakt, këto nuk po përceptohen asgjë tjetër përveçse manipulim të Shaqir Fetait për marketin!

Qindra fotografi se si hypin haxhilerët në autobus, qindra fotografi se si falen haxhilerët, qindra fotografi se si ecin, si bëjnë tavaf, si e gjuajnë shejtanin, qindra fotografi se si pushojnë nën tendat e Arafatit dhe, tërë kjo paraqitet sikur BFI-ja dhe Shaqir Fetai t’i kishte dërguar këta haxhinj në haxhillëk me pagesë nga vetë BFI-ja; sikur vetë Shaqir Fetai t’ua kishte paguar haxhin! Po, një donator që paguan dhe dërgon myslimanë në haxh, këtij po që i ka hije të dëshmojë për çdo situat, sepse, fundja, është aktiviteti i tij për një të mirë, për një qëllim të shenjtë.

Bashkësia Fetare Islame nuk ka detyrë që të jetë në shërbim të myslimanëve, por e ka obligim të patjetërsueshëm! Siç e ka faljen e namazit në xhemat, ibadet ky që absolutisht nuk guxon të keqpërdoret dhe të përvetësohet nga imami! Haxhilerët kanë paguar nga 5700 euro kurse Shaqir Fetai mundohet të paraqitet si të jetë “donatori” i këtij haxhi!

Edhe kurbanët e sivjemë Shaqir Fetai mundohet t’i paraqesë si kurbanë të sponsoruar prej tij! A nuk është turp që të zhvillojë propagandë se sa mish shpërndau BFI-ja? Prej nga ky mish i BFI-së kur këtij Institucioni iu paskan dhuruar edhe sivjet mbi 6000 kurbanë? Kurbanin që e kanë paguar muslimanët, Shaqir Fetai e shpërndanë si kurban të vetin! Kur një person ngelë pa fytyrë, pa reklamë dhe pa personalitet, natyrisht që do të bëjë edhe veprime të tilla të shëmtuara! Shaqir Fetai thotë se sivjet qenka kryer “plotësisht therrja e kurbanëve”, për dallim nga viti i kaluar kur na paskan mbetur rreth 100 kurbanë të patherrur. Therrjen e plotë Shaqir Fetait ia paskan kumtuar anëtarët e Komisionit Qendror, të cilin e ka zgjedhur vetë dhe pa kurrfarë vendimi e propozimi nga Rijaseti.

Mishin e tëpërt e paska shpërndarë për ç’gjë publikon edhe qindra fotografi! Fotografi që dëshmojnë punën shkel e shko të Shaqir Fetait, sa për reklamë e përfitim të ndonjë pike, fotografi

që ia tradhëtojnë nijetin, përkushtimin, sepse kemi stogje të mishit, të grumbulluar si pleh nëpër kamionë të papërshtatshëm, fotografi që “të varfërit” e marrin mishin dhe e ngarkojnë në Benz, në super makina luksoze. Një institucioni normal, që nuk i ka ngelur te marketingu i poshtër, që nuk do të përfitojë nga munda, nga djersa, nga gjaku e para e huaj, do të kërkonte që i tërë mishin të paketohej dhe, vetë myftinitë të shkonin nëpër magazina-frigoriferë, t’i tërhiqnin pakot e caktuara dhe direkt ta bënin shpërndarjen e mishit nëpër xhami ku do të ftoheshin të varfërit e secilës lagje, mëhallë, e rrugicë, të vinin e ta tërheqnin pjesën që u takon. Fundja, apeli për therrje të kurbanëve për Medrese dhe për të varfër është bërë nëpër xhami, lista e atyreve që duhet të marrin mish kurban është bërë nëpër xhami! Për më tepër, mishin nuk është një produkt që pret kalim propagandistik nëpër hierarkinë qesharake të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait. Edhe diçka? Pse Shaqir Fetai nuk e tregon se cila ishte sasia e mishit që u ndal për Medresen dhe cila ishte sasia e mishit me të cilën u ngarkuan secila myftini për ta shpërndarë te nevojtarët! Duhet të dihet saktësisht numri i nevojtarëve që u ndihmuan nga myftinitë dhe sasia e mishit që iu dha! Nuk e dimë nëse i kujtohet opinionit kur Shaqir Fetai thoshte se, sivjet, për herë të parë do të botojmë emrin dhe mbiemrin e secilit pages të kurbanit në Medrese, nëpër myftini dhe në selinë e BFI-së?/1KlikLarg/TetovaSot/12.07.2022

## **Pse Shaqir Fetait i dhimbset populli serb**

Këto ditë, bota e përkujtoi 27 vjetorin e masakrës serbe të kryer në Srebrenicë, mbi mëse 8 mij gra, burra e fëmijë myslimanë. Të gjithë e përkujtuan si një gjenocid të popullit serb më të rëndin që nga Lufta e Dytë Botërore.

Vetëm Shaqir Fetait flet për një “masakër të Srebrenicës” dhe jo për një masakër serbe në Srebrenicë! Masakrën sipas Shaqir Fetait e paskan bërë hordhitë serbosllave!

Kush është ky popull? Kush e njeh me këtë emër këtë popull! Pse Shaqir Fetait ka nevojë që ta amnistojë popullin serb nga një masakër e tmerrshme dhe tërë këtë shtazëri t’ia përshkruajë hordhive inekzistent! Masakra është kryer nga ushtria, policia dhe paramilitarët serbë, nga komandantët serbë që kanë urdhëruar masakër në emër të populli serb! Në mesin e serbëve ka shumë peshonalitete që me turp e pranojnë këtë gjenocid të popullit serb, ndërsa Shaqir Fetait ua përshkruan “hordhive serbosllave”, një kalk ky që dikur prej shqiptarëve përdorej për t’i personifikuar të gjithë “jugosllavët” përfshirë këtu edhe myslimanët e Bosnjës Socialiste që ishin bërë palë me shovenistët serbë kundër shqiptarëve të Kosovës! Pra, në rastin konkret, në Srebrenicë gjenocid nuk bënë “serbollsavët” por vetë populli serb. Se, mbase Shaqir Fetait mendon se ka edhe “serboamerikanë”, “serbokinezë”, “serbogjermanë”, “serboantikë”, “serbosllavë” dhe, prej të gjithë këtyre “serbove” të këqinj paskan qenë vetëm “serbosllavët”! Askund, në asnjë fjali nuk i përmendë serbët si popull gjenocidal, të paktën në rastin e Srebrenicës! Masakra serbe janë kryer edhe me dhjetra në tërë Kosovën, të cilat Shaqir Fetait asnjëherë nuk i përkujton dhe nuk shprehu dhembje me popullin shqiptar!

Shaqir Fetait si shumë po i dhimbset populli serb!/**Lajme7/12.07.2022**

## Si kundrohet sot Shaqir Fetai

**Mënyra se si bëri karrierë Shaqir Fetai, atë e nxjerr në prototip të hipokritit klasik!**

**Ndërsa, ajeti 107 i Sures Et Teube, për sojin e Shaqir Fetait, thotë:**

*“(Hipokritë) janë edhe ata që ndërtuan një xhami për t’u shkaktuar dëm (besimtarëve), për ta forcuar mohimin dhe për të krijuar përçarje në mesin e besimtarëve, duke iu shërbyer ajo si pusi atyre që qysh më parë luftonin kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Dhe, vërtet ata betohen: “Ne kishim për qëllim që të bënim vetëm një vepër të mirë”! Por Allahu dëshmon se në të vërtetë ata janë gënjeshtarë.” (Et Teube, 107)*

## Nga Ilir Topi

Të gjithë ata që tashmë e njohin Shaqir Fetain, kudo që të paraqitet, kudo që të prezantohet, kudo që të përfshihet, e kanë një definicion shumë të qartë që e zbërthen tërësisht karakterin e tij negativ!

Të gjithë e dinë ecurinë e tij në karrierë, që nga vitet studentore në Sarajevë e deri më 27 maj të vitit 2020! Biografinë e tij tashmë e kanë pasqyrë të qartë çdo mysliman i vendit e më gjërë, çdo faktor i brendshëm apo i jashtëm! Pastaj, mënyra se si ai pranoi të instalohet në krye të BFI nga pushteti maqedonas, atë e zbërtheu deri në detaje më të imta dhe, sot, nuk ka njeri para të cilit shfaqet Shaqir Fetai që mos t’i përkujtohet intriga epike të paregjistruar ndonjëherë në historinë e BFI-së! E Allahu i Gjithëdëshëm për intrigat dhe intrigantët thotë: “Intrigat e fshehta vijnë vetëm nga djalli, për t’i dëshpëruar besimtarët. E megjithatë, ai nuk mund t’u shkaktojë kurrfarë të keqeje, përveç nëse Allahu e lejon atë. Pra, besimtarët le të mbështeten tek Allahu!” (El Muxhadile, 10)

Intriganti i sojit të Shaqir Fetait e ka frikë të vërtetën, e ka frikë Allahun, e ka frikë të saktën, e ka frikë përparimin, prandaj, intriganti i fëlliqtë shpërftyrohet në pamje të Shaqir Fetait dhe flet me gojën e tij “Nëse nuk më përkrahni mua, nëse nuk jeni me mua, do ju vie Afrim Tahiri dhe do ju nxjerrë të gjithëve jashtë”! Po pse? Çfarë qenkan këta përkrahja e të cilëve i duhet Shaqir Fetait? Pse qenkan kandidatë potencialë për t’u dëbuar nga BFI-ja e që të mirat e këtij Institucioni mund t’i shfrytëzojnë vetëm nëse do të jenë përkrahës besnikë të Shaqir Fetait? Nëse janë për t’u dëbuar, pse i mban rreth vetes Shaqir Fetai? Pse nuk mundet të funksionojë pa përkrahjen e tyre?

Të gjithë e dinë se Shaqir Fetai e pati një “kryekomandant” që i zuri besë më shumë se çdo kujt tjetër mbi këtë dhe! Të gjithë e dinë se, ishte pikërisht ky Shaqir Fetah që i priu intrigës për ta tradhëtuar “kryekomandantin” e vet dhe për t’ia ngulur thikën pas shpine! Këtë fakt Shaqir Fetai nuk mund ta fshehtë kurrë, nga kjo hipotekë ai kurrë nuk mund të shkarkohet dhe, këtë njollë turpi ai kurrë nuk mund ta fshijë nga balli i vet, si nuk mund t’u ik as shumë fakteve e dokumentave që flasin për prishurinë e tij!

Të gjithë e dinë mënyrën se si pranoi Shaqir Fetai që të shndërrohet në një shund instalacion të pushtetit maqedonas! Të gjithë e dinë se pse pranoi, çka do ta gjente nëse nuk do të pranonte ta zhvillojë tradhëtinë dhe puçin, të gjithë e dinë se kush e dirigjoi në këtë intrigë dhe, si rezultat i çkafit erdhi deri te zhvillimi i kësaj intrige! Thjesht, tashmë të gjithë e dinë se si u katapultua nga shërbimet sekrete në krye të BFI-së!

Nuk ka faktor në vend dhe më gjërë që nuk e dinë se Shaqir Fetai është njeri pa kurrfarë integriteti, është i kapur nga spiunazha, nga tradhëtia, nga hajnia, nga mëkatet e ndryshme; të gjithë ata që e rrethojnë ia dinë këto sifate por, nga ana tjetër, edhe vetë ai nuk mund të rrethohet nga më të mirët, nga më të ndershmit, nga më të devotshmit, por, do të rrethohet vetëm nga soji i vet, nga ata të cilët i mbanë në grusht si persona të korruptuar, të devaluuar e pa integritet!

Të gjithë e dinë se Shaqir Fetai e zhvilloi tradhëtinë duke u ndihmuar pikërisht nga këta që sot i ka bashkëpunëtorë të ngushtë dhe, pa dyshim, të gjithë presin, faktorët e brenshëm e të jashtëm që, pikërisht këta që e sollën me tradhëti në krye të BFI-së, pikërisht këta edhe ta tradhëtojnë! Sepse, ata veçmë e tradhëtuan më të dashurin e tyre (ish-reisul ulemanë), prandaj, as që pjerdhin për Shaqir Fetain!

Kudo ku paraqitet Shaqir Fetai, sakaq prej të pranishmëve ai kundrohet si hipokrit, si tradhëtar, si intrigant, si njeri që ia nguli thikën pas shpine njeriut që më së shumti në jetë bëri për Shaqir Fetain! Ai që e hëngër thikën pas shpine, jo që nuk e dinte se kush është Shaqir Fetai, jo që nuk e dinte se nga cilat kanalizime nëntokësore vinte, jo që nuk e dinte se çfarë mëkatari ishte, por, thjesht, e fali që t'i japë shansin e jetës, prandaj, ky fakt i pamohueshëm e depersonalizon tërësisht Shaqir Fetain në çdo vend e kuvend, para secilit njeri të arsyeshëm!

Nuk ka faktor i vendit dhe i jashtëm, brenda e jasht vendit, që tashmë nuk e dinë, që nuk posedojnë informacion, që nuk e kanë të qartë se kush është Shaqir Fetai. Ka prej disa “subjekteve” që i premtojnë “përkrahjen”, që e pranojnë për “reis” vetëm duke e keqpërdorur, vetëm duke e kundruar si mashë për të realizuar ndonjë projekt e synim të tyre që nuk është as hajri dhe as e mira e myslimanëve të vendit. Prandaj, sot, në Maqedoninë e Veriut, që kur u instalua Shaqir Fetai, kemi një lum dukurishë, një lum veprimesh ideologjike e sektariane, kemi një lum “projektesh” që nuk i bëjnë nder as shqiptarit por as përkatësit të fesë islame; thjesht, Shaqir Fetai na del projekt që do ta përfundojë synimin e deorganizimit dhe defaktorizimit të BFI-së, të myslimanëve, të shqiptarëve!

Shaqir Fetai jo vetëm që kundrohet, porse, tashmë është tërësisht i zbërthyer si “projekt” i huaj prej të cilit duhet hequr duar një orë e më parë! /**Kombetare/17.07.2022**

## "Feja" e të djallëzuarit

**Cili abdall në RMV beson se dikush i paska besuar punë Shaqir Fetait të cilin ky po e kryeka me nder e me sinqeritet! Shqiptarët dhe myslimanët asgjë nuk i kanë besuar Shaqir Fetait! Punën këtij farë narcisi ia besuan vetëm struktura të caktuara të pushtetit maqedonas, të cilën, nuk do të mund ta fitonte sikur paraprakisht mos ta kryente “tradhëtinë e madhe”! Ai duhej të dëshmonte se është alet i mirë i strukturave antishqiptare e me rrënjë që zgjatojnë nga UDB-ja**

### *Nga Halid Sadiku*

A i ka hije Shaqir Fetait që të manipulojë me ajete e hadithe! Hadithet që interpretohen nga goja e Shaqir Fetait e humbin besueshmërinë dhe saktësinë! Nga njeriu i dyshimtë, i pasinqertë dhe hipokrit, edhe citimi i ajeteve kuranore duhet t’i merret me rezervë! Sepse, ky soj, ka ndërtuar edhe “xhami për t’u shkaktuar dëm besimtarëve” (Et Teube, 107)!

E vërteta e pamohueshme gjithmonë, përjetë, ngelë si dëshmi! Është dëshirë e Allahut Fuqiplotë që ta mbajë të gjallë përjetë kujtimin, evidencën, mbi tradhëtinë, mbi spiunimin, mbi hipokrizinë, mbi gjithçka që ka ndaluar Ai! Si mund të harrohet data 27 maj e vitit 2020, ditë kjo kur Shaqir Fetai i priu tradhëtisë më të tmerrshme që ka përjetuar historikisht BFI-ja! Ta përdorë liderin fetar për të bërë karrierë, ta përdorë për ta mburrur kudo e kurdo, ta përdorë për ta njollosur e për ta zhytur sa më keq llugave, kurrë pa ia tërhqur vërejtjen, kurrë pa e këshilluar, kurrë pa e udhëzuar në të mirë, kurrë pa e kritikuar qoftë edhe islamikisht dhe, fare në fund, “ta shpëtojë islamin” duke ia ngulur thikën prapa shpine, duke e njollosur e katranosur po atë, për të cilin, një javë më parë kishte folur si për një figurë markante të fesë e të kombit, me të cilin një javë më parë kishin falur bashkarisht bajram...

Vërtet, cila fe e Shaqir Fetait e proklamonte këtë sjellje prej kriminelit?! Cila fe e Shaqir Fetait thotë që, atë që e plagosi duke e plandur rëndë mbi dhe, tashmë nuk duhet të takohet dhe as të përshëndetet, qoftë edhe me një selam siç i jepet një plaku të shtyer në moshë! Pse e predikon këtë “fe” Shaqir Fetai! Vetëm kriminelët ia kanë frikën viktimës, vetëm tradhëtarët e spiunët ruhen nga viktimat e tyre, vetëm vrasësi i cili ka ngritur dorë mbi udhëheqësin e vet, ka frikë që të përballlet me të, nuk i lë as bashkëpunëtorët e vet që ta përshendesin ish-udhëheqësin e tyre, sepse edhe ata i ka përdorur dhe i ka përlyer në një punë të pistë!

Cila “fe” e Shaqir Fetait thotë që personin të cilin e ke plaguar, ndonëse e ke shënjestruar për ta vlarë fare, nuk duhet të ftohet në ndonjë event fetar si lider i dikurshëm, cila “fe” e Shaqir Fetait thotë që ndaj tij duhet “ngritur” tërë respektin dhe nderin!

Cila “fe” e Shaqir Fetait lejon që të shpifet, që të eliminohet konkurrenca me lloj-lloj intrigash, që të dëbohen njerëz nga puna duke i spiunuar se si pijnë kafe me personin që nuk ia njeh “fenë” Shaqir Fetait!

Cila është ajo “fe” që ia lejon Shaqir Fetait ta shkatërrojë vakëfin, ta shesë, ta shpenzojë për veprime antiislame të Shaqir Fetait! Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait e cila ia lejon vjedhjen e haxhit, duke bërë marrëveshje për hotelet me “matrapazët” të cilët i kanë marrur qysh më herët dhe ia ofrojnë “nën rogoz” Shaqir Fetait?

Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait që ia lejon që të grabiten myslimanët e vendit në emër të kurbanëve, të cilët, jo që nuk i therrë, por edhe ato që i ka therrur ua keqpërdor mishin duke zhvilluar “humanitet personal”!

Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait që e urdhëron në deinstitutionalizim të jetës fetare dhe në deorganizim të xhematit, duke lejuar “lulëzimin” e lloj-lloj sekteve dhe duke i institucionalizuar këto dukuri të tmerrshme për myslimanët e vendit!

Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait e cila ia bën hallall vjedhjen nxënësve të Medresesë, i detyron të paguajnë shkollim të cilin nuk ia njeh as Fakulteti “i vet”!

Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait e cila ia ndriçon skenën tek nusëron e bën temena para oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviçit, para oficerit më të tmerrshëm për shqiptarët e Maqedonisë Perëndimore, Temellko Boshkovskit, e deri te komandanti i “branitellave”, Stojançe Angellov, me të cilin, së bashku i gjykuan brohoritjet e protestuesve shqiptarë “Shqipëria etnike” dhe “UÇK-UÇK”, kurse, asnjë fjalë nuk i doli nga goja kundër protestuesve maqedonasë që orkestruashin nga strukturat ruse në brohoritjet “smrt za shiptari”, “gasna komora za shiptari”... Nuk ka mysliman dhe shqiptar në RMV që e do “fenë” e Shaqir Fetait, sepse, të gjithë e dinë se ku e ka burimin “feja” e tij! Të gjithë faktet flasin se, Shaqir Fetait me nder e me sinqeritet i ka kryer vetëm ato punë që ia ka besuar Stanko Dragoviçi dhe loza e tij!/**BotaSot/20.07.2022**

**A mund të relativizohet e vërteta**

**A mund të shpifet për të shpifurin! I shpifur është ai të cilin Krijusi i Gjithësisë e ka pajisur me plotë shenja që ta ngjallë krupën, të neveritë e të ngacmon vjelljen! Çdo gjë që thuhet për këtë soj është e vërtetë dhe vetëm e vërtetë.**

***Nga Jasir Jashari***

Tash e një kohë Shaqir Fetai po mundohet t'i shfrytëzojë ndejat, si me vendorët ashtu edhe me nërkombëtarët, për t'u ankuar se disa individë po shpifin për të, po thonë gjëra të pavërteta! Dhe tërë këtë shqetësim po e ngrit me plotë dhembje, me trishtim prej një “melaqeje të Stańczyt”! Shaqir Fetai është realitet, të bëmat e tij janë realitet, djallëzitë e tij janë realitet! Së këndejmi, nënvizimi i këtij realiteti si na qenka shpifje! Ne nuk mund të themi se nuk ka ndodhur Shaqir Fetai! Ai ka ndodhur dhe e kanë shkaktuar shërbimet antishqiptare e antifetare dhe, tërë kjo është realitet, nuk është shpifje, nuk është fiksjon!

Shaqir Fetai mendon se ajo që ka kaluar harrohet shpejt dhe, nëse nuk harrohet, me çdo kusht duhet të harrohet! Ajo që iku iku, të shikojmë përpara dhe, për hirë të kësaj “perspektive”, duhet të harrojmë gjithçka që ka ndodhur dhe, nëse e përkujtojmë, duhet ta luftojmë si “shpifje”! Këtë dëshirë e ka Shaqir Fetai!

A mund të llogaritet shpifje, 27 maji i vitit 2020, momenti kur i manipuloi kolegët e vet dhe i orientoi nga një tradhëti e paharrueshme në analet historike të BFI-së!

A mund të llogaritet shpifje dokumentimi se si dy-tre ditë më përpara Shaqir Fetai bashkë me “myhybët” e vet do ta falin bajramin me atë që do ta tradhëtojnë dhe, a mund të llogaritet shpifje deklarata e incizuar e Shaqir Fetait përmes së cilës i thurrë elozhe liderit të vet fetar, të cilit, dy-tre ditë më vonë do t'ia ngulë thikën pas shpine!

A është shpifje fakti që ish-reisul ulema e pat bërë personalitet, duke ia fshehur të gjitha gjurmët e një të ligu dhe të njeriut të dyshimt!

A është shpifje se Shaqir Fetai erdhi dhe u instalua jashtë çdo normative të BFI-së, duke shkelur pa kurrfarë “insafit” mbi Kushtetutën e BFI-së?

A është shpifje fakti se, për ta relativizuar instalimin e vet prej shërbimeve të huaja, Shaqir Fetai lejoi dhe stimuloi regjistrimin e turlifare “bashkësie islame”, madje ka prej të tillave që i ka legalizuar dhe institucionalizuar!

A është shpifje fakti që Shaqir Fetai i relativizoi të gjitha bashkësitë sektariane, madje prej atyreve që u bënë konkurrentë të drejtëpërdrejtë të BFI-së, kurse i reagoi vetëm një “bashkësie fetare”-individ!

A është shpifje fakti që, Shaqir Fetai për të krijuar mashtrime optike nisi dhe selinë e rijasetit e shndërroi në çajtoje duke i qerasur e duke u fotografuar me të hurit e të litarit!

A është shpifje fakti i dokumentuar se Shaqir Fetai flirtoi me shërbimet sekrete ruse, të cilët u mundua t'i depërtojë edhe nëpër institucionet më të larta shtetërore!



A është shpifje konstatimi se, sa herë që flet Shaqir Fetai rrenë!

A është shpifje fakti që Shaqir Fetai i tmerrohet për vdekje takimit me ish-reisul ulemanë të cilit ia nguli thikën pas shpine!

A është shpifje fakti që, Shaqir Fetai i ka nën vëzhgim të gjithë ata që shprehin një respekt e një pendesë për atë që ia bënë ish-reisul ulemasë!

A është shpifje fakti që Shaqir Fetai në asnjë mënyrë nuk lejon që ish-reisul ulema të ftohet në ndonjë event fetar në vend!

A është shpifje e vërteta që Shaqir Fetai disa herë është prononcuar se është ithtar i debateve ndërsa kurrë nuk ka pranuar të dalë në debate por vetëm në “monologje televizive”!

A është shpifje fakti që Shaqir Fetai e ngulfat transparencën, sepse tmerrohet nga transparenca, ndaj edhe sot e kësaj dite nuk dihet se pse i dëboi arabët të cilët ishin të gatshëm të investojnë miliona dollarë për vakëfin e Gostivarit?

A është shpifje fakti që Shaqir Fetai tmerrohet nga transparenca, prandaj asgjë nuk dihet se çka u bë me Hotelin e BFI-së në Shkup, nuk dihet asgjë se çka po ndodhë me ish-selinë e Myftinisë së Shkupit, nuk dihet asgjë se si u tretën lerat në vlerë që u dhanë në vend të denacionalizimit e që ishin me dedikim për blerje të vakëfit! A mund të përfundojë në korrupsion e në terrorizëm kapitali i shpenzuar në mënyrë “tinzare”!

A është shpifje fakti që Shaqir Fetai deri më sot ka shpenzuar shumëfish më tepër duke dhuruar “dekoracione” e mirënjohje se sa që ka shpenzuar në aktivitete të mirëfillta fetare islame!

A mos e llogaritë shpifje Shaqir Fetai se, ai bashkë me “sekretaricat” e veta po harxhon buxhet tre fish më shumë se sa disa zyrtarë shtetëror plme kabinetet e veta!

A mos e llogaritë Shaqir Fetai shpifje shpirtin e vet provincial dhe sjelljet e tij prej hipokriti, mediokri, snobi, analfabeti...

A mos duhet që t’ia fshehim përpjekjet Shaqir Fetait për t’ua blerë përkrahjen myftive me mijëra euro!

A mos është shpifje fakti që Shaqir Fetai “i shpërbleu” të gjithë ata që pranuan të manipulohen prej tij dhe të bëhen bashkëpunëtorë në nguljen e thikës pas shpine reisit të tyre si dhe në nguljen e kazmave në themel të BFI-së!

A mos është shpifje edhe fakti që Shaqir Fetai gjatë vizitave nëpër rezidenca ambasadash e institucionesh bën “selfie” ndërsa pastaj ato fotografi me prapavijë objektet e ambasadave apo të institucioneve përfundojnë në shërbime antiperëndimore!

Krejt në fund, çka mund të shpifet për Shaqir Fetain kur vet ai është i shpifur! Çka mund të gënjejhet për Shaqir Fetain kur vetë ai është gënjeshtër më e tmerrshme që u ka ndodhur myslimanëve të vendit!

I djallëzuar po mundohet të shesë “islam” – as kjo nuk është gënjeshtër, nuk është shpifje, prandaj është sevap prej sevapeve të mëdha që Shaqir Fetai të lakuriqësohet nga djallëzia çdo ditë e më shumë! Shejtani nuk e ka vendin në mesin e myslimanëve të devotshëm! Kurrë dhe në asnjë mënyrë!/**TetovaSot/22.07.2022**

## **BFI-ja bojkoton Familjen Jashari**

**Këto ditë, Komuna e Tetovës shpalli qytetar nderi Bacin Rifat Jashari! Gjatë kësaj ceremonie, ajo që ra në sy ishte mungesa e parisë fetare nga BFI-ja, ndonëse, sipas autoriteteve komunale, kanë qenë të ftuar si nga niveli qendror po ashtu edhe nga ai lokal. Thjesht, Familja Jashari u bojkotua nga BFI-ja, respektivisht nga Shaqir Fetai**

### ***Nga Ilir Topi***

Shaqir Fetai, shund instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, paska prezantuar në eventin politik të organizuar në “Klubin e Deputetëve” me rastin e tejkalimit të problemeve bullgaro-maqedonase që rezultoi me miratim të ofertës franceze për nismën e bisedimeve për inkuadrim të shtetit në BFI!

### **Shaqir Fetai e pranon edhe konvertimin, vetëm të pranohet si “lider”**

Opozita maqedonase por edhe përfaqësues fetarë ortodoksë nuk prezantuan në këtë “festë nacionale”! Z. Z. Stefani, kryetari i KOM-it, nuk prezantoi, sepse nuk kishte dashur ta legjitimojë, sipas tij, padrejtësinë që po i bëhet popullit maqedonas me këtë “ofertë franceze”! I pyetur Shaqir Fetai se si e ka ndjerë veten i vetmuar si lider fetar në këtë event, kishtë thënë se “e kupton opozitën, ndërsa ne të pushtetit patjetër duhet të jemi në evente të tilla”! Shaqir Fetai veten e konsideron “pushtet”! Pra, me vetëdëshirë përfshihet në atë “klub” politikanësh që nuk ia akreditojnë Medresenë, nuk ia ndërtojnë Xhaminë në Prilep e në Llazhec, nuk ia ruajnë “higjienën fetare” duk lejuar dhe stimuluar paraqitjet dhe regjistrimin e turlifarë religjioni që veprojnë në emër të islamit, nuk e njohin gjuhën shqipe si gjuhë por vetëm si të folur e 20 përqindëshit etj. Nuk e ka dert Shaqir Fetai, e legjitimon krejt këtë padrejtësi dhe këtë diskriminim vetëm e vetëm që të paktën, të tjerët nëse jo myslimanët, ta pranojnë si “lider fetar”!

### **I sëmuri për pak “liderizëm”**

Shyqyr që myslimanët e Maqedonisë së Veriut nuk e patën kuotën prej 100 mij kandidatëve për të shkuar në haxhillëk! Sepse, çfarë do të bënte Shaqir Fetai me 100 mij duar! Do t’i përshëndeste të gjithë?

A e keni parë se si Shaqir Fetai, ky farë folkloristi provincial, nuk mundet të dalë përtej budallakisë së vet! Shaqir Fetai mendon se do t’ia dalë të përfitojë pak simpati me gjestet e tij abnormale! Dhe, e dyta, do të mendojë se do t’ua dalë që t’i kamuflojë disi vjedhjet që ua bëri haxhilerëve të sivjemë duke ua ngritur çmimet në stratosferë!

Doli në aeroport dhe i priti të gjithë, duke u folur një për një për dore! A mos i pati të thirrur në dasëm, apo, mos i erdhën në ndonjë vaki ngushëllimi, apo, cili ishte halli i Shaqir Fetait që t’i presë haxhilerët ndërkohë që familjarë të shumtë kishin dalur në aeroportin e Shkupit për t’i

pritur haxhilerët që ktheheshin nga kryerja e një obligimi fetar, të cilët, thuase ishin për interes të Shaqir Fetait dhe ky tashmë e ndjente obligim që t'i presë e t'i përshëndesë që të gjithë, për dore! Pse nuk i përshëndet për dore të gjithë ata që ia japin fitrin, zeqatin, të gjithë ata që paguan kurbanë. Sepse, të gjithë ata janë një, persona më vete, nuk janë, për shembull 900 pages të fitrit që njëherëzi do të paguajnë në BFI që të përshëndeten për dore nga Shaqir Fetai!

Pra, Shaqir Fetai pati nevojë për diçka tjetër, për disa pamje që ia tradhëtuan “sinqeritetin” prej hipokriti! Shaqir Fetai e dinte se qindra vetë, familjarë e të afërm, do të dilnin në aeroport për t'i pritur grupin e parë, të dytë, të tretë! Para tyre do të defilonte Shaqir Fetai duke i përshëndetur me dorë, si ajo “përshëndetja hitleriane” e liderçifëve autoritarë. Për këtë pamje kishte nevojë Shaqir Fetai, sepse, diku do t'i shitet gënjeshtër se si dalin myslimanët dhe e presin Shaqir Fetain!

Tashmë është konstatim i pamohueshëm se Shaqir Fetai është shumë rëndë i sëmurë për pak “liderizëm”, të cilën e inskenon edhe në këtë mënyrë, në emër të islamit! Pisave as turp nuk u vie!

### **Hajnat gjithnjë përpiqen t'i mbulojnë gjurmët**

Shaqir Fetain e ke gjithkund ku është pushteti politik! Aty ku nuk është, nuk mund ta gjeshë as Shaqir Fetain. Me këtë rast, iu mundësua edhe realizimi i amanetit (!) për ta bojkotuar Familjen Jashari! Cila është arsyeja e mungesës së Shaqir Fetait në eventin ku nderohet pjesëtari i Familjes që u shndërrua në simbol mbarëkombëtar? Mund të ndodhë dhe, në të tilla raste dërgohet njeriu i dytë, apo, një prej organeve kryesore të rijasetit, dhe jo përfaqësues sektoresh të parëndësishëm e të papërfillshëm!

Shaqir Fetai nuk ka qenë në eventin e organizuar nga Komuna e Tetovës por ama mundohet t'ia vjedh eventin! Nuk ka aktivitete, nuk ka informacion! Prandaj, mezi presin që të vjedhin aktivitete të huaja dhe t'i plasojnë në paçavurën e vet si aktivitete të BFI-së! Fiks 24 orë pas përfundimit të programit të përgatitur nga kjo Komunë me rastin e shpalljes Qytetar Nderi të Tetovës Bacin Rifat Jashari, “akademikët” e Shaqir Fetait publikojnë lajmin në fb të BFI-së ku tregojnë se paska pasur përfaqësues nga BFI në këtë ceremoni dhe se, me këtë rast “sonde do të mbahet koncert në sheshin...”! Kur sonde? Koncerti u mbaj 24 orë para “informacionit” plagjiaturë të BFI-së!

BFI-ja, ndonëse 24 orë me vonesë, i informon të gjithë qytetarët e vendit se do të ketë koncert ku do të marrin pjesë muzikantë nga Shqipëria, Kosova dhe nga Maqedonia e Veriut!

Epo kur të mbulon turpi dhe harami, bëhesh edhe “pronar” i budallakinave më iditike që mund të manifestohen, edhe atë, në emër të islamit! Kjo mund t'i ndodhë vetëm Shaqir Fetait, i cili, me vite e vite dëshmon parreshtur se nuk i intereson asgjë që i përket islamit dhe shqiptarisë!/**TetovaSot/24.07.2022**

## **Kur minjtë bëjnë dasmë**

Një prej punëtorëve shkencor të dalluar, përkthyes i Kuranit, kontribuues i dalluar në fushën e shkencave islame si dhe në orientalistikë, Prof. Dr. Feti Mehdiu, së fundmi u dëshmuua edhe si njohës dhe studiues i hollësishëm i jetës dhe veprimtarisë së Hasan Kaleshit, njërit prej intelektualëve kombëtarë dhe orientalistëve me përmasa botërore. Kohë më parë, prof. Mehdiu botoi kolonën prej tetë vëllimeve, “Hasan Kaleshi”, në të cilën është përfshirë tërë aktiviteti dhe kontributi shkencor i Hasan Kaleshit në sferën e islamistikës, orientalistikës, gjuhës arabe etj. Këto ditë Hasan Kaleshit do t’i shënohet 100 vjetori i lindjes së tij! Një moment i mirë për ta promovuar edhe kolonën tetë vëllimeshe “Hasan Kaleshi”, të përgatitur nga Prof. Feti Mehdiu. Natyrisht, meqë Hasan Kaleshi me origjinë është nga rrethina e Kërçovës, i takon që këtë datë jubilar ta shënojnë institucionet vendore, shoqatat kulturore, universitetet shqiptare. I takon Komunës së Kërçovës për të organizuar ndonjë ngjarje për nderë të kësaj figure jashtëzakonisht të rëndësishme, i takon ta përkujtojnë Shoqata e intelektualëve shqiptarë, Shoqata e historianëve shqiptarë, i takon Institutit për trashëgimi kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve të RMV-së! Pa dyshim, u takon edhe universiteteve shqiptare në vend, e me theks të veçantë fakulteteve të orientalistikës si pranë UT-së ashtu edhe pranë UP-së!

Fatkeqësisht, një ngjarje të tillë nuk e kanë paralajmëruar asnjë nga asociacionet dhe institucionet e përmendur më sipër. Dhe, aty ku nuk ka maçok, minjtë bëjnë dasmë!

Event kushtuar 100 vjetorit të Hasan Kaleshit do të organizojë Bashkësia Fetare Islame në RMV, në të cilën, veç të tjerash, do ta promovojë edhe kolonën “Hasan Kaleshi”, përgatitur nga Prof. Feti Mehdiu! Po pse BFI-ja? Çka e lidhë BFI-në me këtë orientalist, apo cili është kontributi minor i Hasan Kaleshit për myslimanët e Maqedonisë së Veriut, apo thjesht për BFI-në? Maqedonia e Veriut ka pasur një numër të konsiderueshëm teologësh që kanë kontribuar në Lëvizjen Kombëtare, që mund të llogariten rilindës të mirëfilltë, të cilëve, deri më sot, nuk ua ka kushtuar qoftë një orë përkujtimore!

Bashkësia Fetare Islame në RMV, me këtë iniciativë për ta promovuar punën shkencore të Prof. Feti Mehdiut, sikur ka hapur “siparin” e promovimeve të të gjithë librave të botuara gjithandej botës shqiptare! Ose, të paktën, do të duhet t’i promovojë të gjithë librat-monografite që do të përgatiten për orientalistët shqiptarë! Apo, është arritur një ujdi në mes të organizatorit dhe autorit që, kontributin autorial, në rastin konkret të prof. Feti Mehdiut, ta prezantojë BFI-ja si aktivitet të vetin! Veçse akoma nuk është e qartë: do të përkujtohet 100 vjetori i lindjes së Hasan Kaleshit, apo do të përurohet kolona prej tetë vëllimeve, në të cilat përfshihet jeta dhe veprimtaria e Hasan Kaleshit! BFI-ja nuk është as autore dhe as botuese e veprimtarisë së akademikut të respektuar! BFI-ja kurrë nuk ka iniciuar qoftë më të voglin hulument shkencor mbi personalitetin apo veprimtarinë e këtij orientalisti shqiptar! BFI-ja ka vepra të botuara për personalitete kombëtare që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm si për vetë BFI-në ashtu dhe për avancimin e jetës fetare islame në vend dhe që, deri më sot, as që ka denjuar të publikojë qoftë ndonjë informacion sado të shkurtë mbi këto botime, ndërsa i rreket promovimit të punëve që nuk kanë të bëjnë asgjë me BFI-në!

Janë akademitë kombëtare, janë fakultetet gjegjëse të universiteteve tona nacionale, janë institucionet e asociacionet kulturore, shkencore e arsimore, kompetente për të vlerësuar nëse

duhet apo jo të përkujtohet ndonjë personalitet nga e kaluara jonë kombëtare. Në këtë sferë, derisa institucionet përkatëse shkencore nuk e thonë fjalën e vet, komunitetet fetare mund të jenë subjektet e fundit që mund të mendojnë organizim të ndonjë eventit! Po, mund ta ndriçojnë personalitetin dhe kontributin vetëm të atyre figurave të veta që kanë dhënë kontribut, sado modest, kombëtar, fetar e shkencor! /**HEJZA/28.07.2022**

## **Kur udbashi dekoron udbashë**

**Instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, jo njëherë ka dëshmuar se është një popullist që luhetet mes popullizmit radikal dhe atij instrumental. Sepse, kjo është strategjia më e qëlluar e “liderëve” që dalin nga gjirizët e shërbimeve sekrete – të mobilizojnë popullin për një “ideologji” të pathemeltë**

### ***Nga Venera Turkeshi***

Në çka bazohet popullizmi radikal e në çka ai instrumental i Shaqir Fetait! Pa dyshim, ky farë abdalli as që ka kapacitet intelektual për t'i kuptuar këto teori, porse, i zbaton me përpikshmëri teoritë-urdhërat që i vijnë nga lart! Një popullist radikal si Shaqir Fetai, e ndanë shoqërinë në “ne” dhe në “ata” duke u mbështetur në “ideologji popullore” antielitiste e të pathemelta! Ndarjen në “ne” dhe në “ata” e arrijnë duke mbjellë frikë dhe duke e “radikalizuar” masën kundër përpjekjeve të “atyre” që mund të vijnë me program e me ideologji të themeluar mbi baza të interesave të përgjithshme.

“Ne” mund të mbijetojmë nëse mbahemi bashkë e të bashkuar, nëse vetëlavdërohemi e nëse dekorohemi në mes vete!

### **Nënvlerësimi i dekoratës si qëllim i devalvimit të figurës elitiste**

Ish-reisul ulema i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili do të ngelë përjetësisht viktimë e elementeve të UDB-së, kishte inicuar një ide shumë humane që tashmë ishte bërë praktikë: në manifestimin kushtuar Hixhretit të dekorohen edhe figura të rëndësishme kombëtare e fetare që kanë dhënë kontribut të dukshëm në lëmenj të ndryshëm! Përzgjidheshin 3-4 figura, të papërlyera, me një biografi të pastër, me kontribute konkrete, të shënuara e të lavdëruara dhe, publikisht shpërbleheshin me çmimin “Haxhi Vehbi Dibra”, personalitet ky i lavdëruar në historinë tonë kombëtare!

Këtë praktikë po e vazhdon edhe Shaqir Fetai (sepse nuk ka ide të tjera, nuk ka kapacitete estetike por vetëm kopjuese dhe aftësi përvetësuese të vlerave të huaja)!

Shaqir Fetai, si instrument i huaj, do të luhetet edhe nepër valët e popullizmit instrumental, duke e keqpërdorur masën për vetëreklamim! Nuk ka ndryshe si ta mbulojë biografinë e vet të errët, nuk ka si t'i kamuflojë aktivitetet e veta prej spiuni i UDB-së, nuk ka si ta mbështjellë injorancën dhe hipokrizinë e vet me gjëra që nuk mund të jenë afinitete të “personalitetit” të tij! Organizon aktivitete populliste jo se i ha b... për popull, për vlera shoqërore, për dekorata e shpërblime, por, thjesht, për t'u vetëreklamuar! Këtë e dëshmon edhe me “foto-reportazhe” idiotike, duke publikuar 40-50 fotografi prej të cilave 90 për qind prej tyre e mbulojnë “reisin” më kontravers, që na del si “organizator i manifestimit islam” ndonëse deri dje ishte instrument i UDB-së që ka marrur më qafë bij e bija më të vlefshme të popullit që mendon se fare lehtë mund ta instrumntalizojë.

Kësaj radhe Shaqir Fetai i dekoroi pesë persona, prej të cilëve dy me dosje të trashë si bashkëpunëtorë të UDB-së! Udbashi dekoron udbashët! Madje e dekoroi edhe një person për të

cilin gjatë viteve nëntëdhjeta Shaqir Fetai do të përfshihet në një konflikt e fushatë të tmerrshme duke u sulmuar edhe si udbashë dhe që kurrë nuk u distancua nga ato akuza!

Mbahuni me mua, se nëse vijnë “ata” – që të gjithë e kemi hëngër! Kjo është ideologjia e pathemeltë e Shaqir Fetait që dirigjohet nga guzhinat nëntokësore të shërimeve të huaja, të cilët, në asnjë vend nuk këmbëngulin për themele të shëndosha të një procesi, sepse, në procese me themele do të vetëpërgjashtoheshin dhe vetëeliminoheshin përgjithmonë.

## **Në 100 vjetorin e Hasan Kaleshit “përurohet” Shaqir Fetai**

Një event tjetër të cilin Shaqir Fetai e shfrytëzoi për vetëreklamim është edhe ai kushtuar 100 vjetorit të orientalistit, Hasan Kaleshit, me çrast u promovua edhe kompleti “Hasan Kaleshi” përgatitur nga Prof. dr. Feti Mehdiu! Çka e lidhë Hasan Kaleshin me BFI-në? Cili është kontributi i tij në avancimin dhe zhvillimin e jetës fetare islame ndër myslimanët e Maqedonisë? Cili është kontributi i BFI-së, madje cili është kontributi konkret i Shaqir Fetait, në përgatitjen e kompletit tetëvëllimësh “Hasan Kaleshi”? Zero kontribut, por, ja që, duke u nisur nga mentaliteti populist i instrumentalizuar, Shaqir Fetai i keqpërdorë këto situata për vetëreklamim! Natyrisht, nuk është i aftë për t’i kapur këto detaje, pa sugjerimin dhe pa sinjalizimin nga ana e shërbimeve sekrete!

Nga tërë ai manifestim nuk ke asnjë informatë, nuk ke asnjë tekst, ndërsa ke me dhjetra fotografi, ku mungon portreti i atij të cilit i dedikohet eventi, ndërsa me shumicë i ke fotografitë ku nusëron dhe petllavet Shaqir Fetai!

## **Shaqir Fetai e fëlliqë çdo mexhlis ku prezanton**

Shaqir Fetai, duke e vuajtur së tepërmi dekonspirimin e tij si fuks, nën pseudonimin “Orao”, bashkëpunëtorë i oficerit udbash Stako Dragoviqit, ka nevojë radikale që të organizojë një event edhe më populist ku instrumentalizimi i masës do të jepte efekt! Shaqir Fetai ka nevojë që të “legjitimohet” në hapësira lokaliste, në vendin e vet dhe, aty ta përjetojë duartrokitjen e tyre, derisa ta shohin si një “lider” që ka dalur nga mesi i tyre! Në cilësinë e “kryetarit” të myslimanëve të vendit, organizon mbrëmje fetare kushtuar mërgimtarëve tanë që janë kthyer nëpër vendlindje të tyre për pushime verore. Po pse a vetëm nga Gostivari qenkan ata mërgimtarë që po na vikan në atdhe? Vetëm gostivarasit duhet ta përjetojnë një event të tillë! “Lideri” që organizon evente lokaliste! Kjo është ajo që i duhet Shaqir Fetait, sepse ai po dëbohet në Gostivar, ai po shahet nga Gostivari, sepse ai nuk ka fytyrë që të dalë e të takojë vendali, sepse të gjithë e dinë se kush është dhe kush paska qenë Shaqir Fetai! Mund të mos e dinë vetëm gurbetçarët të cilët, me halle të veta, me përmallime të veta, me entuziazëm të vet, as që u intereson dhe as që e dinë se kush është e çka është Shaqir Fetai. Me këtë shtresë popullore e ka më të lehtë të manipulojë Shaqir Fetai, prandaj, nuk i shtrinë këmbët më thellë, prandaj, si “kryetar” ai nuk organizon një event qendror për hirë të të gjithë mërgimtarëve, pavarësisht se nga janë e ku kanë ardhur!

Shaqir Fetait nuk i intereson fakti se prezenca e tij në një “mexhlis” në fakt vetëm sa e flliqë atë “mexhlis”! Shaqir Fetait i intereson që ta presin mirë, ta dëgjojnë dhe t’i duartrokasin, sepse, vetëm kjo i llogaritet sukses para oficerëve të tij të UDB-së dhe mundësi për të bërë e për t’u shtyer në karrierë! Popullizmi i tij është shtrat i rehatshëm i UDB-së!/**Politesa/31.07.2022**

## **Koha kur Bashkësia Fetare Islame drejtohej nga një jo mysliman**

*"Ka disa njerëz që thonë: "Besojmë në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit!", por në të vërtetë ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por në të vërtetë mashtrojnë vetëm vetveten, megjithëse nuk e ndiejnë. Në zemrat e tyre ka një sëmundje, të cilën Allahu ua shton. Ata i pret një dënim i dhembshëm, për shkak të hipokrizisë së tyre. Kur u thuhet: "Mos bëni çrregullime në tokë!" – ata thonë: "Ne bëjmë vetëm përmirësime në tokë!" Por jo! Në të vërtetë, pikërisht ata janë shkaktarët e çrregullimeve, ndonëse nuk e ndiejnë." (El Bekare, 8-12)*

### **Nga Blerim Hoxha**

Institucioni fetar islam gjatë periudhës së sistemit monist, madje edhe më herët, fill pas përfundimit të Perandorisë Osmane, kaloi nëpër sisteme nga më të errëtat në historinë e njerëzimit. Megjithatë, ndonëse nën pushtete mbretërore antiislame, fashizoide, diktatoriale, asnjëherë nuk pati fatin që të drejtohet nga hipokritë, njerëz të pushteteve politike, jo besimtarë. Fatkeqësisht, për herë të parë, pas gjashtë shekujve funksionim të BFI-së, si institucion i vetëm fetar islam në RMV, tashmë në krye të saj kemi një jo mysliman! Ndonëse dikush me të drejtë mund të habiten për këtë konstatim, megjithatë, faktet janë të pamohueshme.

Cili mysliman i devotshëm do të pranonte që të rritet shpirtërisht, në karrierë e me plotë afinitete prej hipokriti dhe, të ulej me dëshirë të madhe në fronin e drejtimit të BFI-së? Kjo i ka shkuar për dore vetëm Shaqir Fetait!

Çfarë myslimani të devotshëm mund të shohë njeriu tek Shaqir Fetai i cili thithjen e gjakut shqiptar e ka stërvitur tek oficerët e UDB-së, siç na ishin dikur Stanko Dragoviçi e Temellko Boshkovski! A e keni vërejtur se si Shaqir Fetai lavdërohet me ata që i pret në "kabinetin" e tij! Për të gjithë thotë: "ka dhënë kontribut të madh kombëtar", "është aktivist i shquar kombëtar"! Prej nga ua di ky aktivitetet komëtare shqiptarëve në diasporë? Apo, po i fut në hipoteka njerëzit që një ditë të gjithë të thonë se "Shaqir Fetai ka dhënë kontribut të moth kombëtar"! Shaqir Fetai është prej atyre "që përpiqen ta mashtrojnë Allahun dhe besimtarët"!

I mallkuar është, qoftë ky edhe mysliman, ai i cili eprorit të vet fetar ia ngul thikën pas shpine! Ish-reisul ulema i pat lodhur myslimanët e vendit, dy dekada rresht duke ua lavdëruar dhe duke ua imponuar Shaqir Fetain si "myfti e intelektual i madh", ndërsa po ky, në fund, ia nguli thikën pas shpine ish-reisit! Tani, t'i besohet Shaqir Fetait? Tani, të lidhet "xhemati" pas tij? Tani, të mendohet se një mysliman i devotshëm mund ta bëjë këtë tradhëti dhe këtë krim siç e bëri Shaqir Fetai?

A mund t'i thuhet mysliman Shaqir Fetait, i cili, një jetë të tërë ka vepruar me intriga, vetëm e vetëm që ta pastrojë terrenin dhe në fund të instalohet në fronin e BFI-së? A mund t'i thuhet mysliman Shaqir Fetait i cili e kërkon dhe e pranon ndihmën e pushtetit politik antiislam që ta ndihmojnë që të instalohet në krye të BFI-së dhe nga aty të nisë rrënimin e madh e të padhimbshëm të Institucionit?

Shaqir Fetai ka këmbëngulur në largim nga puna të të gjithë atyreve që dikur ia kritikonin ish-reisin duke kërkuar prej tij reforma në BFI, ndërsa, në fund, pikërisht Shaqir Fetai ia ngulë



thikën pas shpine reisit që e mbronte me qëllim që ta mbrojë BFI-në nga reformat të cilat nuk durojnë brenda institucionit asnjë udbash, asnjë hajn, asnjë kriminel, asnjë drogaxhi, asnjë të ylbër, asnjë të paudhë, asnjë vjedhës të haxhit, të kurbanëve, të cilët, sot, Shaqir Fetai i ka patarica të veta që i ndërron varësisht nga relievi i terrenit! Shaqir Fetai mendon se mund ta mohojë këtë të vërtetë e cila tashmë është e deponuar në fromë deklarate e dëshmie në gjyqësorin e vendit dhe është arkivuar si praktikë gjyqësore që do të shërbejë për hulumtime e studime të rasteve nga më antiislame!

A mundet të jetë mysliman i devotshëm një si Shaqir Fetai i cili instalimin e vet e projekton duke shkelur mbi Kushtetutë dhe mbi të gjitha aktet normative të BFI-së?

Cili mysliman i devotshëm do të pranonte si Shaqir Fetai që të harxhojë fitra e zeqat duke ndarë “dekoracione” e mirënjohje të hurit e të litarit vetëm e vetëm që të bëjë “lajm”, ndërsa t’i ngrijë të gjitha aktivitetet që do të shënonin ngritje të grafikoneve të jetës fetare islame në vend.

Cili “mysliman” si Shaqir Fetai do të pranonte që të tallet me medresantët, t’ua marrë paratë e shkollimit dhe, në fund, t’i hedhë në rrugë, si dhelpira këlyshët e vet!

Një kryetar, mysliman i devotshëm, nuk do të lejojë për asnjë çmim që të dëmtohet, të vidhet, të shkatërrohet vakëfi i BFI-së! Shaqir Fetai lejon që të shkatërrohet, madje edhe të përvetësohet vakëfi e të bartet si pronë e bashkëpunëtorëve të vet! Cili besimtar i devotshëm do të lejonte siç lejon Shaqir Fetai që bashkëpunëtorët e vet të përvetësojnë banesa në ndërtim nga vakëfi i BFI-së, të marrin përqindje parashë nga donacionet e huaja por edhe nga kontributet dhe taksat fetare!

Cili mysliman i devotshëm do të lutej, te jomyslimanët, siç lutet Shaqir Fetai, që t’ia ruajnë dhe t’ia garantojnë sigurinë, mosluhatshmërinë nga kolltuku i BFI-së të cilën e uzupoi me tradhëti e me komplot!

Cili mysliman i devotshëm mundohet ta gënjejë Allahun e Gjithëdijshëm, siç mundohet Shaqir Fetai, duke u përpjekur të reflektojë “mirësi” ndërkohë që hipokrizia e krejt botës vlon në shpirtin e tij?

Ja pse, shumë shpejt do të flitet për një kohë kur Bashkësinë Fetare Islame në RMV e drejtonte një jobesimtar! Nuk do të jetë presedan! Sepse, sot me të madhe po flitet se si dikur, nëpër xhamitë tona, paskan shërbyer me decenie hoxhallarë rusë! Atyre as emri nuk u dihet, vetëmse trajtohen si dukuri shumë të shëmtuar, si raste eklatante kur dikush është munduar ta gënjejë Allahun Fuqiptotë! Ajeti 15 i sures El Bekare, thotë: “Allahu do të tallet me ata dhe do t’i lërë një kohë të gjatë që të bredhin verbërisht në mendjemadhësinë e tyre.”

Cili hipokrit sot, shpreh mendjemadhësi prej abdalli më shumë se vetë Shaqir Fetai? Mjer ajo kohë që, fatkeqësisht, do të shënohet me emrin e Shaqir Fetait/**KohaNews/05.08.2022**

## **Ndërgjegjësimi si një vetëtimë**

**Një ditë, kur do të ndërgjegjësohet Shaqir Fetai mbase do ta provojë vetëvrasjen!  
Natyrisht, kjo kurrë nuk do të ndodhë, sepse nuk do të ndodhë as ndërgjegjësimi i tij**

***Nga Mimoza Doko***

Jo vetem karakteristikat hipokrite të Shaqir Fetait që dëshmojnë për faktin që një kohë BFI-në e drejtoi një jo mysliman por, mbi të gjitha për këtë fakt dëshmojnë: degradimi fetar, kadrovik dhe organizativ i BFI-së si dhe dezorientimi total i myslimanëve të vendit.

Këto fakte nuk mund t'i lexojë Shaqir Fetai, sepse akoma është në delir nga eliksiri i tradhëtisë, të cilën e provoi i catur nga lakmia për ta shijuar përkrahjen dhe mbrojtjen e pushtetit i cili asgjë nuk ka të bëjë me islamit! Po pse këtë babëzitet Shaqir Fetai? Sepse, po zbulohet se një jetë të tërë i kishte shërbyer këtij pushteti si dhe pushteteve të shërbimeve intepegjente të ndryshme antishqiptare! Shtyrja në karrierë, mbrojtja dhe përkrahja do t'i vinë si shpërblim për besnikërinë e tij në aktivitetet e UDB-së.

Pa dyshim, një ditë, do të elaborohen të gjitha këto fakte, do të përdoren si teza disertacioni ku do të zbardhen të gjitha djallëzitë e “një reisi” që ishte produkt i politikave antiislame e antishqiptare në RMV.

Shaqir Fetai, sipas analizave të sjelljeve të tij, akoma është nën efektin e dehjes nga joshja e pushtetit politik i cili në çdo hap është kundër Institucionit të BFI-së. Shaqir Fetai akoma nuk është ndërgjegjësuar për ta kuptuar tradhëtinë e madhe që ia bëri ish-reisit të vet i cili me sukses po e realizonte konceptin e vet mbi një BFI që do të ishte gardian në mbrojtjen e interesave fetare e kombëtare të Shqiptarëve të RMV-së.

Mbase një ditë do të ndodhe edhe ndërgjegjësimi i Shaqir Fetait. Do të jetë i pafuqishëm për t'u drejtuar nga situatat e reja post-ndërgjegjësimit, sepse, do të ngajë si qentë e rrezikshëm të lidhur nën zinxhirët e pronarit. Madje do të ndjehet i pafuqishëm edhe për të lehur e kuisur!

Atëherë, Shaqir Fetai do të kuptojë se, të gjitha sukseset galopante, të gjitha të arritura e paimagjinueshme (eventualisht nëse i arrinë!!!) do t'i duken cikërrima, zero suksese, sepse, do ta brejë tmerrësisht ndërgjegja: si pranova të zgjidhem “reis” nga shërbimet politike-intelegjente, paraprakisht duke ia ngulur thikën atij në duart e të cilit ishte rritur si një fëmijë lozonjar!

Tek atëherë, pas ndërgjegjësimit, do të kuptojë se akti i tij në tradhëti, sa do të ekzistojë ky Institucion, do të kujtohet si komplotist, puçist e tradhëtar më të ndyrë që ka dalur ndonjëherë nga gjiri i popullit! Ai që pranon të bëhet kriminel, nga të tillët do të përfundojë, dhe kjo do ta bëjë sado pak të lumtur. Sepse, do të bëhet shembull se si nuk duhet të përsëritet kurrë një akt i tillë çfarë e bëri Shaqir Fetai në 27 maj të vitit 2020!

Një ditë, kur do të ndërgjegjësohet Shaqir Fetai mbase do ta provojë vetëvrasjen! Natyrisht, kjo kurrë nuk do të ndodhë, sepse nuk do të ndodhë as ndërgjegjësimi i tij! Po nëse dodhë? Atëherë – në rr.s.! Myslimant e vendit gjithmonë do ta kujtojnë si hipokrit që nuk ishte prej nesh!/**1KlikLarg/Mileniumi3/06.08.2022**

## **Karakteristikat hipokrite të Shaqir Fetait**

**Një ditë, kur do të ndërgjegjësohet Shaqir Fetai mbase do ta provojë vetëvrasjen!  
Natyrisht, kjo kurrë nuk do të ndodhë, sepse nuk do të ndodhë as ndërgjegjësimi i tij**

***Nga Mimoza Doko***

Jo vetem karakteristikat hipokrite të Shaqir Fetait që dëshmojnë për faktin që një kohë BFI-në e drejtoi një jo mysliman por, mbi të gjitha për këtë fakt dëshmojnë: degradimi fetar, kadrovik dhe organizativ i BFI-së si dhe dezorientimi total i myslimanëve të vendit.

Këto fakte nuk mund t'i lexojë Shaqir Fetai, sepse akoma është në delir nga eliksiri i tradhëtisë, të cilën e provoi i catur nga lakmia për ta shijuar përkrahjen dhe mbrojtjen e pushtetit i cili asgjë nuk ka të bëjë me islamit! Po pse këtë babëzitet Shaqir Fetai? Sepse, po zbulohet se një jetë të tërë i kishte shërbyer këtij pushteti si dhe pushteteve të shërbimeve intepegjente të ndryshme antishqiptare! Shtyrja në karrierë, mbrojtja dhe përkrahja do t'i vinë si shpërblim për besnikërinë e tij në aktivitetet e UDB-së.

Pa dyshim, një ditë, do të elaborohen të gjitha këto fakte, do të përdoren si teza disertacioni ku do të zbardhen të gjitha djallëzitë e “një reisi” që ishte produkt i politikave antiislame e antishqiptare në RMV.

Shaqir Fetai, sipas analizave të sjelljeve të tij, akoma është nën efektin e dehjes nga joshja e pushtetit politik i cili në çdo hap është kundër Institucionit të BFI-së. Shaqir Fetai akoma nuk është ndërgjegjësuar për ta kuptuar tradhëtinë e madhe që ia bëri ish-reisit të vet i cili me sukses po e realizonte konceptin e vet mbi një BFI që do të ishte gardian në mbrojtjen e interesave fetare e kombëtare të Shqiptarëve të RMV-së.

Mbase një ditë do të ndodhe edhe ndërgjegjësimi i Shaqir Fetait. Do të jetë i pafuqishëm për t'u drejtuar nga situatat e reja post-ndërgjegjësimit, sepse, do të ngajë si qentë e rrezikshëm të lidhur nën zinxhirët e pronarit. Madje do të ndjehet i pafuqishëm edhe për të lehur e kuisur!

Atëherë, Shaqir Fetai do të kuptojë se, të gjitha sukseset galopante, të gjitha të arriturat e paimagjinueshme (eventualisht nëse i arrinë!!!) do t'i duken cikërrima, zero suksese, sepse, do ta brejë tmerrësisht ndërgjegja: si pranova të zgjidhem “reis” nga shërbimet politike-intelegjente, paraprakisht duke ia ngulur thikën atij në duart e të cilit ishte rritur si një fëmijë lozonjar!

Tek atëherë, pas ndërgjegjësimit, do të kuptojë se akti i tij në tradhëti, sa do të ekzistojë ky Institucion, do të kujtohet si komplotist, puçist e tradhëtar më të ndyrë që ka dalur ndonjëherë nga gjiri i popullit! Ai që pranon të bëhet kriminel, nga të tillët do të përfundojë, dhe kjo do ta bëjë sado pak të lumtur. Sepse, do të bëhet shembull se si nuk duhet të përsëritet kurrë një akt i tillë çfarë e bëri Shaqir Fetai në 27 maj të vitit 2020!

Një ditë, kur do të ndërgjegjësohet Shaqir Fetai mbase do ta provojë vetëvrasjen! Natyrisht, kjo kurrë nuk do të ndodhë, sepse nuk do të ndodhë as ndërgjegjësimi i tij! Po nëse dodhë? Atëherë – në rr.s.! Myslimant e vendit gjithmonë do ta kujtojnë si hipokrit që nuk ishte prej nesh!/**TetovaSot/07.08.2022**

## **Takim “zyrtar” për një organizim privat**

**Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI**

**Shaqir Fetai paska organizuar një “TAKIM KONSULTATIV ME KRYESINË E HAXHIT”, në vendë se të organizonte një “RAPORTIM TË KRYESISË SË HAXHIT PARA RIJASETIT”! Pse “takim konsultativ”? Për t’u konsultuar se si t’i ndajnë paratë që i kanë vjedhur, ose, si të gënjejnë për të dalur nga situata ku janë futur**

Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së, me kohë kishte informuar mbi planet e Shaqir Fetait dhe bandës së tij për të organizuar për herë të parë në historinë e BFI-së një haxh privat, me qëllim që t’ia dalin që, për kokë të haxhiut, të vjedhin minimum nga 1000 euro. Prandaj dhe kishin një çmim fantomik, të caktuar vetëm nga planifikimi i këtij farë “reisi” për të vjedhur sa të munden nga haxhi i sivjemë! “Lëvizja” ka pasur informacion se muaj më parë, është lëshuar një sekser në vendet e shejta, i cili, paraprakisht ka zënë hotele me një çmim solid ndërsa pastaj, me një vonese të pajustificueshme, kanë shkuar njerëzit e Shaqir Fetait që të gjejnë hotele për t’i vendosur haxhilerët. Nuk ia kanë dalur të gjejnë dhe, sakaq, u është “imponuar” sekseri dhe, njerëzit e Shaqir Fetait bëjnë kontratë me këtë sekser! Vjedhje “perfekte”! Dhe, tani, i mbledh Shaqir Fetai në një “takim konsultativ”! Përse do të konsultohen, nëse jo për ndarjen e parave që i kanë vjedhur!

Po pse “takimin konsultativ” ta organizojë Shaqir Fetai? Ku është këtu Rijaseti? Apo, meqë nuk u inkuadrua Rijaseti në organizimin e Haxhit të sivjemë porse ky organizim i egër e privat ishte ekskluzivisht i Shaqir Fetait, atëherë, logjikisht, nuk ka se çfarë “të konsultohet” Rijaseti, porse, thjesht, banditët t’i raportojnë boss-it!

Dhe, idiotizmi nuk ka brirë! Në këtë “takim konsultativ” me Shaqir Fetain, qenkan hedhur edhe disa mendime!!! Pra, nuk ka raporte, nuk ka pikë raportesh, nuk ka konkluzë, por, ka “mendime”! Një analizë shkel e shko mbi keto “mendime” do të nxirrte në përfundime se kemi të bëjmë me një “elitë hajnash” të babëzitur e aspak të sinqertë në raport me Allahun e Gjithëdijshëm dhe me Institucionin.

Ja disa mendime që i paskan hedhur të mjerët e Shaqir Fetait:

“Parapërgatitjet për haxhin e sivjemë paskan qenë të nivelit të lartë duke filluar nga Rijaseti e deri te Myftinitë”!

Rrena e parë, prej nga shtrohet baza për një vjedhje perfekte! Tërë opinionin e di se Haxhin e sivjemë nuk e organizoi Rijaseti, sepse nuk ka pasur asnjë mbledhje të Rijasetit, as për zgjedhje të kryesisë, as debat mbi ofertat e agjencive kandidat për përzgjedhje për organizim të haxhit, as debat e vendim institucional për çmimin e hoteleve, si dhe për Haxhin e sivjemë! Krejt bota e di se, po atë ditë kur u publikua informata se do të organizohet haxhi i sivjemë, po në atë informatë u tha se kuota e caktuar nga Ministria e Haxhit të Arabisë Saudite për Maqedoninë e Veriut tashmë është plotësuar! Do me thënë, gjithçka ishte në të egër, tinza dhe organizim mafioz! “Udhëtimi i haxhive është realizuar në mënyrë më precize”! Kush nga sharlatanët, kush nga idiotët, kush ga abdallët do ta thoshte këtë “mendim” kaq të budallakaftë! Udhëtimi i haxhilerëve qenka kryer në mënyrë precize? Si raketat kur lëshohen mbi cakun e synuar për asgjësim!

“Udhëheqësia, kordinatorët dhe udhëheqësit e grupeve bashkë me ekipin medicinal kanë qenë në krye të detyrës”, është një mendim i radhës! A e di Shaqir Fetai se çfarë do të thotë MENDIM! Në këtë “takim zyrtar” për një organizim privat duhej të raportohej se sa ishte numri i udhëheqësve, kordinatorëve, numri i udhëheqësve dhe i ekipit mjekësor! Kush i pagoi këta? Nga sa u paguan këta? Kush ua caktoi pagat? A është e vërtetë se pagat e tyre i mbuluan haxhilerët nga çmimi i Haxhit të sivjemë! Edhe qëndrimi i tyre në haxh do të duhej të kushtonte po nga 5700 euro! Plus, mesatarisht, janë paguar nga 700-800 dollarë honorar! Kush e solli këtë vendim? Cili organ kolektiv i BFI-së vendosi për këto shpenzime të cilave u vie erë korrupsioni e hajnie?

Një “mendim” tjetër i aventurierëve të Shaqir Fetait paska qenë edhe:

“Rrjedhat administrative në vendet e shenjta kanë ecur me përpikëri dhe precizitetin më të madh” – po kjo? Kapaku i idiotizmit që mund të rrjedhë vetëm nga truri i kalbur i Shaqir Fetait! Budallai përzihet në punët e brendshme organizative të institucioneve arabe!

“Mendim” edhe më injorant ishte ai që flet për disiplinën e haxhilerëve! Shaqir Fetai e nënvizon edhe këtë “mendim”:

“Disiplina e haxhinjve ka qenë plotësisht në përputhshmëri të plotë me programin e hartuar nga Kryesia e Haxhit”! Disiplinë e paraparë me program?!? Kështu dikur raportonin vetëm udbashët! Vetëm UDB ia dilte që të organizojë “disiplinë” të qytetarëve me program të komitetit qendror! Dhe, falë këtij “programi”, pason “mendimi” tjetër që thotë:

“Disponimi i haxhinjëve si gjatë qëndrimit në vendet e shenjta, poashtu edhe gjatë kthimit ka qenë i nivelit të lartë”! Po pse haxhilerët mos ishin në cilsitë të tifozllëkut apo ishin në klube nate dhe, falë “vigjilencës” së banditëve të Shaqir Fetait, ia paskan dalur që nëpër vende të shenjta të sillen në mënyrë sa më disiplinore? Pra, jo vetëdija e lartë e myslimanëve tanë të devotshëm por meritator paska qenë “programi i Shaqir Fetait” për atë “disiplinim të lartë” të haxhinjëve tanë! “Mendimi” i radhës, i honxhobonxhëve të Shaqir Fetait që i nxorën në këtë “Takim konsultativ”, paska qenë edhe ky:

“Në këtë mbledhje, Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai u shprehu falënderime të përzemërta haxhinjve, imamëve, muftinive në krye më Myftinjtë, sektorëve të Rijasetit, e në veçanti Kryesisë së Haxhit duke uruar shëndet të plotë dhe suksese të reja në jetën e tyre”! Çka mund t’i thuhet këtij “mendimi”? Kësaj “konkluze”? Këtij “vendimi”? Kjo dëshmon për një amatorizëm dhe për një nënvlerësim total të BFI-së; flet për një nëpërkëmbje të dinjitetit të këtij Institucioni, flet për një tallje të Shaqir Fetait, me të gjithë myslimanët e vendit! Këto “mendime” një ditë do të analizohen si fakte që do të flasin për një degradim total të BFI-së prej njerëzve që, me ndihmën e shërbimeve sekrete dhe të pushtetit maqedonas, ia dolën ta degradojnë BFI-në deri në një ojç amatore dhe aspak të rëndësishme!

Dhe në fund, për ta ngadalësuar reagimin e opinionit, apo për ta relativizuar reagimin profesional kundër kësaj hajnie transparente, Shaqir Fetai e hedh edhe këtë “mendim”:

“Mbetet t’i qasemi edhe njëherë në mënyrë më serioze haxhit në mbledhjen e rregullt të Rijasetit të BFI që do të mbahet në të ardhmen menjëherë pas përfundimit të pushimeve”!

Kjo flet se “Takimi konsultativ” në mes të banditëve ka qenë një parapërgatitje e raportit formal që duhet të dalë në Rijaset por që duhet të jetë në parametrat e caktuara në këtë “takim konsultativ”! Turp, he Zoti i marroftë! /1KlikLarg/Fakte/08.08.2022

## **Legalizimi shtetëror i ekstremizmit fetar**

**Dikush duhet të ngreh alarmin se diçka e tmerrshme po ndodhë në këtë shtet, diçka e tmerrshme që do ta njollosë rëndë imazhin e popullit shqiptar, diçka që po legjitimohet nga Shaqir Fetai, instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së; po ndodhë diçka që menjëherë dhe urgjentisht duhet të ndërpritet. Faji më i madh do t'u bie subjekteve politike shqiptare**

### ***Nga Ilir Topi***

Faktorë ndërkomëtarë mjaft me relevancë kanë sinjalizuar vazhdimisht se Maqedonia e Veriut është një vatër me kushte ideale për t'u zhvilluar ekstremizmi dhe radikalizmi fetar. Ish-srukura udhëheqëse e Bashksisë Fetare Islame vazhdimisht ka kërkuar ndihmë nga organet gjegjëse shtetërore që t'i bllokojnë aktivitetet dhe çerdhet e ekstremistëve që, përmes manipulimeve në emër të fesë e të Zotit, ia mësynin destabilizimin e BFI-së. Këta struktura e kanë ëndërr që një ditë ta kapin të vetmin Institucion fetar islam në vend dhe prej aty, t'i legalizojnë dhe t'i legjitimojnë të gjitha angazhimet ekstremiste në emër të vendimeve dhe dispozitave ligjore inatitucionale! Kësaj strategjie, aktualisht, gati ia kanë dalur! Aktualisht, kryesia e tanishme e BFI-së, fill pas instalimit të Shaqir Fetait nga ana e pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, në zhvillim e sipër e ka fazën e bashkëpunimit me këta struktura mjaft të dyshimta, të padenja për të folur as në emër të fesë e as në emër të kombit. Tërë kjo “lojë” po zhvillohet para syve të organeve të pushtetit i cili, në fakt, me këtë tolerancë dhe me përzierjen e saj në mënyre direkte në oranzim të jetës fetare, po del të jetë një prej stimuluesve kyesor të këtyre rrymave ekstremiste e radikaliste që po zhvillohen në emër të islamit.

Së fundmi herë, falë sinjalizimeve që erdhën nga shërbimet intelgjente perëndimore, policia e vendit arriti që të arrestojë një grup prej tre vetëve që paskan pasur plane e armatim për t'i sulmuar e për t'i ngritur në hava qendrat tregtare të Shkupit! Krijohet përshtypja se ky grup u kap vetëm pasi u sinjalizua prej të huajve! Natyrisht, pasi të kapen kriminelët, ekstremistët, ata merren në pyetje, ata flasin për të gjallë e për të vdekur, ata do të tregojnë gjithçka, ata do t'i tregojnë edhe “ajatollahët” e tyre, do t'i tregojnë nxitësit, motivuesit, përpunuesit e shpirtit të tyre naivë, të cilët janë të gatshëm që në emër të Zotit e të fesë të mbysin qindra qytetarë të pafajshëm! Po ku dinë ata se çfarë thotë feja e çfarë Zoti? Kush i manipuloi ata?

Të gjitha këto i di policia e vendit! Në kushte normale bashkë me ekzekutorin kapen edhe motivuesit, inspiruesit, manipuluesit, kapen fondet e tyre, shkëputet kanali i parave të pista dhe të armatimit! Apo, këta që nuk i njeh shërbimi intelgjent i huaj, këta i fusim në përdorim për të na ndihmuar tregëtinë me emigrantët që po vlojnë këtë periudhë.

“Ajatollahu” i këtij grupi, përkundrazi, shpërblehet prej organeve të shtetit! Kryetari i komunës jep urdhër që të nisen eskavatorët dhe të rrënohet objekti pa leje, kurse ministri i punëve të brendshme jep urdhër që të tërhiqen eskavatorët dhe objekti të ndërtohet sa më shpejt. Paralelisht “ajatullahu” bashkëpunëtorë edhe ia legjitimojnë aktivitetin, duke ia zyrtarizuar religjionin i cili përzihet në punët e fesë islame! Islami dhe BFI-ja thërrasin në unitet, prandaj, nuk është e qartë se ide e kujt është kjo përçarje, duke lejuar “xhami” të reja të një religjioni të ri! Për herë të parë,

fatkeqësisht, në kohën e Shaqir Fetait po na ndodhë që të kemi edhe “xhami” të ministrisë së punëve të brendshme! Gradualisht do t’i futen edhe themelimit të medresesë private, me qëllim të prodhimit të kuadrit profesional për xhami, të cilët pastaj do të të futen me lezet nëpër xhami! Nuk do të kenë nevojë të ndërtojnë por do t’i uzurpojnë xhamitë dhe, me këtë, edhe vakëfin! Ky është synimi, pa dyshim! Synim i pistë që do t’i kushtojë shumë shtrenjtë imazhit të shqiptarëve të vendit!

Edhe struktura aktuale udhëheqëse e BFI-së e njuh fort mirë këtë problematikë! Shpesh thotë se BFI-ja është e angazhuar me projekt në luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit fetar, ndërsa asnjë herë nuk shprehi revoltë kundër qëndrimit favorizues të disa segmenteve shtetërore që ua bëjnë këtyre lëvizje ekstremiste. Nuk është syçeltësi institucionale vetëm kapja në moment të fundit e grupeve ekstremiste por, syçeltësi është mbi të gjitha, bashkëpunimi i pandashëm ndërinstitutional, i organeve gjegjëse të shtetit me bashkësitë fetare.

Shaqir Fetai deri më sot nuk e tha asnjë fjalë kundër këtyre “ajatullahëve”, nuk u ankua te askush për ndihmën e shtetit që po ua afron këtyre rrymave si dhe, përkundrazi, po i legjitimon me prezencën e organeve të ndryshme të BFI-së në përrurimin e sektit dhe të ideologjisë së tyre që nuk ka kurrfarë përputhshmërie me interesin fetar e as kombëtar të myslimanëve të vendit! Një lojë tragjike e tmerrshme po zhvillohet në taborrin e shqiptarëve të përgjumur! Çdo tragjedi në fund shkakton përlojtje të publikut. Një përlojtje e trishtë do t’ju ndodhë shqiptarëve në fund të lojës. Në fund do ta kuptojnë se të gjithë paskan qenë në lojë, nën regji të Shaqirave, Stankove e Boshkovskëve që historikisht i kanë shërbyer përçarjes dhe degjenerimit të shqiptarëve!/**TetovaSot/09.08.2022**

## "Fenomeni" Sadulla Bajrami

(Rrersh një shkrimi me titull "Legalizimi shtetëror i ekstremizmit fetar", botuar në disa media e portale kombëtare)

*Nga Halid Sadiku*

Këto ditë lexova një shkrim shumë të fuqishëm të blogerit Ilir Topi, i cili po trajtonte një dukuri mjaft shqetësuese dhe shumë të vërtetë për popullit tonë. E vetmja gjë që nuk më pëlqeu ishte mosdhënia emër problemit! Problemi ka emër! Kush është problemi? Duhet ta themi hapur e t'i bijmë gjërave mu në kokë!

Për ne kumanovarët, e di krejt bota se, "hoxha" më problematiku, më i dyshimti dhe më i rrezikshëm është Sadulla Bajrami!

Sadulla Bajrami, në një të kaluar jo shumë të largët as që guxonte të bëhej i gjallë! Ish-reisul ulema, Sulejman Rexhepi, e pat shpallur satan, duke kërkuar nga organet e shtetit që të marrin masa ndaj tij, ta mbajnë nën vëzhgim dhe të marrin masa kundër veprimtarisë së tij jashtinstitucionale dhe shumë të rrezikshme!

Është e vërtetë që ai, me fonde shumë të dyshimta, ia doli që të ndërtojë xhami të veten dhe, sot për sot mund të llogaritet "satani" i vetëm në botë që arriti të bëjë xhami personale, private dhe ilegale!

Shqiptarët dikur ia dilnin shumë lehtë me Haxhi Qamilat! Përtej këtij soji, Sadulla Bajrami ia doli që të regjistrojë sektin e vet dhe, me xhaminë që e ka si dhe tjetrën që e përuroi në Lagjen e Çairit, ku prezantuan edhe zyrtarë të lartë të BFI-së së Shaqir Fetait, pa dyshim që, ka hedhur bazë të fuqishme për ta zhvilluar në emër të islamit një sekt të ri në mesin e shqiptarëve, siç ia dolën edhe adhuruesit e Haxhi Bektashit që ta zhvillojnë dhe ta përçajnë unitetin e shqiptarëve këtu e një shekull e gjysëm më parë! Një ditë të kemi "bajramizmin" sikur bektashizmin?!

Një gup kumanovarësh kemi kërkuar sqarim edhe nga kryetari aktual i komunës së Kumanovës se pse u lejua ndërtimi i një objekti të tillë të diskutueshëm, i cili na ka thënë se, vetë ai ka dhënë urdhër që të nisen eskavatorët për ta rrënuar por që ministri Spasovski ka urdhëruar që të stopohet rrënimi dhe, madje, edhe të legalizohet sa më parë si "objekt kult"! Meqë Bashkësia Islame nuk ka kërkuar legalizim, as ndërtim, nuk ka kërkuar as leje ndërtimi, nuk ia ka dalur as t'i bëhet pronar, atëherë, ne kumanovarët, me të drejtë e quajmë "Xhamia e Spasovskit"!

Është më se e vërtetë se Sadulla Bajrami posedon financa të forta! Sepse, është e pamundshme që një xhami të japë në çdo vakt llokume e lëngje për t'u freskuar! Është e pamundur që një xhami të shtrojë për xhematin e vet dreka e darka, të shtrojë iftar e të organizojë "gjezme"! Një njeri normal, as që do të pranonte të shkonte e ta dëgjonte një sharlatan siç është Sadulla Bajrami sikur edhe t'ua hapte "Dyert e Xhenetit"! Sepse, ai aktron, sepse, vetëm dëgjojani diksionin, artikullimin e fjalëve, përcilljani gjestet, mimikrinë, nuancat e zërit, sakaq do të vërtetoheni se kemi të bëjmë me një "gllumac" i cili as që e di këtë zanat porse mundohet të imitojë "havarixhë" të vet! Vetëm provencialistët, vetëm të mjerët e të ngratët do të pranonin që ta përcjellin "aktrimin" e fëlliqur të Sadulla Bajramit, i cili, po ia del falë financave të dyshimta!



Paramendoni një gazetar televiziv, një intelektual, një profesor, një fytyrë publike të ligjeronte siç flet e “ligjëron” Sadulla Bajrami! Të gjithë do ta trajtonin si “dylber”! Ndërsa Sadulla Bajramit i akordohet edhe emision televiziv, thuase nuk ka teologë akademikë të mirëfilltë në Maqedoninë e Veriut!

Ia del që të ketë një grumbull njerëzish vetëm falë asaj që “faltoren” e ka shndëruar në çajtoje! Pa dyshim, Sadulla Bajrami me ndihmën e shtetit por edhe të financave të dyshimta që i vinë nga jashtë, shumë shpejt do t’ia dalë të ketë një zinxhir “faltoresh” të sektit të vet! Po përgatitet që të fillojë edhe me një “medrese” private dhe, tek atëherë, do t’ia dalë Medresa “Isa Beu” të akreditohet, sepse, deri t’atëherë do të bëhet edhe “medresja” e Sadulla Bajramit dhe do të akreditohen së bashku! Do të prodhojnë kadro profesionale për të shërbyer nëpër xhami dhe do të na mbushen xhamitë me “bereket” Sadullai!

A mos janë ky soj vija ruse e “myslimanizmt” të cilit e promovoi instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, e që u fuqizua përmes ligjeratave publike duke e përkrahur Rusinë në konfliktin kundër Ukrainës? Shikuar nga ky prizmi u bënë gati një komunitet “hoxhallarësh” të Shaqir Fetait që janë rreshtuar në këtë vijë pro-ruse të turpit! Shaqir Fetai po e përmbush amaneti e marrur nga antislamistët, i ka ngelur vetëm edhe një amanet rus: ta ngris përmendoren e babait të Ahmedovit, bashkëluftëtarit të Putinit, në mes të Tetovës, ashtu siç ua premtoi delegatëve të Putinit që i pranoi në zyrë disa ditë para se të nise invazioni rus kundër Ukrainës! Këtë premtim ua dha Shaqir Fetai! Punë shejtani, pra!/**TetovaSot/11.08.2022**

## **Fiqfiriqi i mjerë**

**Në hisorinë e vet, nuk ka pasur kopil që ka mundur ta shkatërrojë BFI-në dhe t'i dezorganizojë myslimanët e vendit, prandaj, ky synim, ky mision i pamundshëm, nuk do t'i shkojë ndorësh as abdallit, Shaqir Fetait**

### ***Nga Valbon Osmani***

Në Veles ka vdekur gruaja e Shemsedinit, në Kumanovë ka vdekur gruaja e Mehmetit, në Shkup ka vdekur gruaja e Sylës, e Halitit, e Halimit, gruaja e Shefqetit, e Fazliut, në Tetovë ka vdekur gruaja e Musbajdinit, e Shemsiut, e Elezit, në Gostivar ka vdekur gruaja e Ganiut, e Mutalipit, në Strugë ka vdekur gruaja e Orhanit, e Mazllamit, në Dibër ka vdekur gruaja e Flamurit, e Rexhepit, në Prilep paska vdekur gruaja e Hasanit, e Enverit, në Ohër gruaja e Sabriut, në Kërçovë paska vdekur gruaja e Orhanit, gruaja e Fadilit, e Abdurrahimit, në Manastir ka vdekur gruaja e Idrizit, e Halitit, e Mehmedaliut... Brenda javës ndër myslimanët e Maqednisë së Veriut paskan vdekur dhjetra gra të myslimanëve të cilët për së gjalli kanë kontribuar jashtëzakonisht pa kursim për të mirën e islamit në RMV. Kanë vdekur edhe dhjetra nëna si dhe 12 fëmijë të vegjël, të pafajshëm, të çiltër! Te asnjëri prej këtyre nuk ka qenë Shaqir Fetai në ngushëllime. Pa dyshim, janë shumë! Por, a e llogarit Shaqir Fetai se sa shumë e rëndë është përcaktimi i tij që t'i vizitojë vetëm ata prej të cilëve varet fotelja e tij e grabitur përmes puçit klasik! Po pse kaq shumë frikë Shaqir Fetai sa, jo vetëm që u shkon në ngushëllime “bashëpunëtorëve” të vet por, këtë “aktivitet” abdalli e bën lajm!

Kur jemi te lajmet, duhet pranuar se tashmë Shaqir Fetai e ka bastarduar lajmin si publikim gazetaresk deri në deklaratë spiunimi! Vetëm Shaqir Fetai, ky shund-instalacion i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së ia del që të bëjë lajm nga vizitat që ia bëjnë turlifarë haxhi babe, turifarë qytetari i rëndomtë, turlifarë pjesëtari i familjes së vet, të cilët me telefon po i ftuaka që t'i shkojnë për kafe që ky pastaj të bëjë “lajm aktiviteti”, etj. Pra, Shaqir Fetai ka nevojë që ta shpërfaqë diku prezencën e vet si të kaposhit, t'i tregojë dikujt se është “reis”, ka nevojë që të dëgjojë se si e thërret dikush “reis”, thjesht, ka nevojë të vizitohet prej atyreve që e pranojnë si nusprodukt të segmenteve të caktuara të pushtetit maqedonas antiislam. Përmes këtyre “lajmeve” Shaqir Fetai në fakt po e kamuflon misionin e tij të vetëm – degradimin e BFI-së si dhe dezorganizimin xhematit dhe, me këtë, devijimin e jetës fetare islame në vend. Vetëm të verbëtit nuk mund të vërejnë se si në këtë aspekt Shaqir Fetait po i shkon kungulli mbi ujë!

Shaqir Fetai nuk di se si ta mbushë kohën që e ka me tepri! Shaqir Fetai paskësh menduar se reformë është vetëm institucionalizimi i tradhëtisë në BFI duke e “vlarë” ish-reisul ulemanë, të cilit, Shaqir Fetai ia kishte borxh tërë karrierën e tij prej “teologu” (të diskutueshëm)! Veç kësaj, Shaqir Fetait i duhej eliminimi i ish-reisul ulemasë, sepse, vetëm ai ia dinte të gjitha aktivitetet e nëndheshme si dhe vetëm ai e dinte se kush në të vërtetë është Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai nuk ka kohë të ulet me ata që nuk e pranojnë, që nuk e njohin, që e njohin vetëm si instalacion të huaj! Shaqir Fetai nuk ka kohë t'i kushtohet debatit publik, nuk ka kohë të njohtohet me të gjitha ofertat për myslimanët e vendit, nuk ka kapacitet të përballet me nevojat imediate për reforma gjithëpërfshirëse në BFI. Shaqir Fetai reformën e përcepton vetëm në

kontekst të vizitave të ndërsjella, prezenca e tij në ndonjë dua të synetisë, të hatmes, të hapjes së ndonjë xhamie, vizitë ndonjë mullai, ndonjë hoxhe, për të cilët, deri më sot nuk ka shprehur mundin më të vogël për t'ua përmirësuar pozitën dhe të trajtohen si qytetarë të rendit të parë! Natyrisht, Shaqir Fetai nuk ka kohë për asgjë, sepse, si asnjëherë më parë po e vëren se tashmë ia ka zënë rrota bishtin! Nuk ka fytyrë për asgjë, vepron vetëm aty ku është i sigurtë se nuk do ta ngacmojnë dhe se do ta fladisin duke iu drejtuar me “reis”! Edhe kjo i dhemb, sepse, thellë në vetëvete e ka të qartë se nuk është “reis” dhe se kurrë nuk mund të jetë përveçse një udbashçiç i mjerë..

Ai e justifikoi tradhëtinë e vet sepse “babai shpirtëror” i tij e paska shkelur nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së. Kaq! Ani pse ai vetë e shkel, po e shkelë dhe në vazhdim do ta shkelë tërë Kushtetutën e BFI-së! Në atë shkelje të nenit 58 ish-reisul ulemja e pati përkrahjen absolute të bashkëpunëtorëve të vet, përfshirë këtu edhe Shaqir Fetain. Shaqir Fetai “e reformoi BFI-në”, duke e eliminuar me tradhëti dhe me komplot reisin e vet, ndërsa vazhdoi punën me po ata bashkëpunëtorë të cilët ish-reisin e kishin ndihmuar për ta shkelur nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së!

Jo që vazhdoi por, po flitet me të madhe se, shumicën e këtyre bashkëpunëtorëve që ia vodhi ish-reisit, po i korrupton, po ju jep para nga fitri e zeqati, me qëllim që ta sigurojë përkrahjen e tyre! Kësaj i thonë “karrierë” e blerë, e korruptuar, e vjedhur, kontrabanduar! Po shpërndanë para pa kurrfarë vendimi. Pa vendim, sepse, të tjerët pastaj do të ankohen, pse disave u jep e disave jo! Po një ditë kur do të mbarojnë këto para, çka do t'ua ofrojë Shhaqir Fetai bashkëpunëtorëve të vet përveçse b... Në këtë stacion po e drejtojnë bashkëpunëtorët Shaqir Fetain, të cilit i hidhërohen nga dy-tre muaj, ky ua hedhë lekun vu, ata pajtohen, pastaj tjetri, pastaj tjetri, dhe kështu deri sa ta shterrin dhe t'ia fusin qepën! Këtë çast dhe këtë akt të turpshëm të cilin Shaqir Fetai e percepton si “madhështor” – vetëm ai nuk është duke e vërtur tek po afron! Në hisorinë e vet, nuk ka pasur kopil që ka mundur ta shkatërrojë BFI-në dhe t'i dezorganizojë myslimanët e vendit prandaj, ky synim nuk do t'i shkojë ndorësh as abdallit, Shaqir Fetait!**1KlikLarg/Opinione/17.08.2022**

## **Kryqi në Presillë të Krushevës me leje të Shaqir Fetait?!**

### ***Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI***

Presilla, katund shqiptarësh, e rrethuar me katunde etnikisht maqedonase, shtrihet në komunën e Krushevës. Katundi është qind për qind shqiptarë. Në krye të katundit, ka ekzistuar një kishë, e cila me decenie është ruajtur pikërisht nga këta shqiptarë. Nuk ka qenë funksionale por është ruajtur në gjendje të mirë. Maqedonasit lokalë ngrisin iniciativë për ta renovuar dhe për ta zgjëruar! Këto ditë, maqedonasit, krye më vete, kishin vendosur ta ngrisin një kryq 30 metërsh. Shqiptarët e këtij katundi, të konfesionit islam, kanë reaguuar, janë kërcënuar, kanë shprehur revoltën e tyre duke kërkuar nga maqedonasit që kryqin ta ngrisin në katundet e tyre dhe jo në Presillë! Përkohësisht është ndërprerë puna e ngritjes së kryqit!

Natyrisht, kjo është një strategji, një presion kundër katundit të vetëm shqiptar, me qëllim që të provokohen fetarisht dhe të zbrazet edhe ai katund, kështu që, krahu lindor i Krushevës të bëhet zonë etnikisht dhe fetarisht i pastër!

Tani i doli punë edhe BFI-së së Shaqir Fetait e cila, në gazetën e vet të murit doli me një “reagim” të nënshkruar nga “sektori për informim”! Kjo flet se, nëse Shaqir Fetai nuk është brenda projektit për ngritjen e këtij kryqi, të paktën ai pajtohet me nismëtarët, gjegjësisht, me Kishën Ortodokse Maqedonase!

Shaqir Fetai është dashur që urgjentisht ta mbledhë Rijasetin e BFI-së, të debatojnë mbi problemin dhe të sjellin konkluzë prapa të cilave do të qëndrojnë vetë Shaqir Fetai, t’i informojë të gjithë ishtancat më të larta të shtetit me qëndrimet e Rijasetit rreth problemit në fjalë, si dhe t’ua bëjë me dije të gjithë korit diplomatik të vendit se, me këtë aksion provokativ, në zonën ku akoma pengohet rindërtimi i Xhamisë së djegur më 2001-shin, ngritja e një kryqi në katundin shqiptaro-mysliman do të pengohet me mburojë të gjallë!

Shaqir Fetai këto konkluzë të Rijasetit është dashur t’i lexojë në vendin e ngjarjes, i rrethuar nga të gjithë anëtarët e Rijasetit, pikërisht në formën kur rrethohet përgjatë kumtimit të akteve të tradhëtisë e të kompleteve kundër Institucionit të vetëm fetar islam në vend!

Shaqir Fetai është dashur që ta urdhërojë kukullën e vet, “myftiun e Prilepit”, efendi Shefketin, që t’i mbledhë të gjithë imamët e zonës (nëse ka autoritet!!!) dhe të shkojnë në vendin e ngjarjes dhe nga aty të lëshojnë ndonjë kumtesë që do t’ua bëjë me dije të gjithëve në vend se situata është mjaft serioze dhe se provokimet e tilla nuk do të tolerohen dhe se do të luftohen qoftë edhe fizikisht!

Por ama, këtë gjest nuk guxojnë ta bëjnë as Shaqir Fetai dhe as marioneta e tij, Shefketi, sepse, që të dy janë të kapur nga institucionet shtetërore që e luftojnë hajninë dhe korrupsionin! Në fakt, Shaqir Fetai e ka mision që ta rëndojë gjendjen e myslihanëve të vendit, në bashkëpunim me elementët antiislam, ndërsa “myfti” Shefketi nuk guxon të bëjë “gëg” që kur miliona eurot e dedikuar për vakëfin e Prilepit, i konvertoi në blerje të pozitës “myfti”! Kjo “dosje” është edhe në duart e Shaqir Fetait, prandaj “myftiu” i ngratë nuk guxon të bëjë një hap më tej! Me një situatë të tillë kaq shumë serioze mund të tallet vetëm Shaqir Fetai, duke u fshehur pas një deklarate të thatë në emër të BFI-së e të nënshkruar nga “sektori për informim”!

Shaqir Fetai duhet të shkojë dhe të qëndrojë aty, në mesin e atyre myslimanëve të devotshëm e të sinqertë dhe, mos të lëvizë nga aty derisa nuk do të marrë garanca nga organet gjegjëse shtetërore se një provokim i tillë nuk do të mund të përsëritet dhe as të ndodhë kurrë në jetë, dhe jo të shëtisë si kaposh sofër më sofër, syneti më syneti e vaki më vaki!

Që kur pranoi me vullnet të instalohet nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së myslimanët e vendit përjetuan sprova nga më të poshtrat, të cilat ua kanë lënduar dinjitetin, po ndjejnë se po dezorganizohen dhe për më tepër, po ndjejnë thellë në shpirt se kanë ngelur vetë e me një BFI të kapur nga elementet antiislame! Janë dhjetra raste që e vërtetojnë këtë fakt, por, shtrohet pyetja – sa do të zgjasë durimi i myslimanëve dhe i hoxhallarëve të mirëfilltë!

**/1KlikLarg/Fakte/18.08.2022**

## **Përpjekja për reagim subjektiv pas një konstatimi objektiv**

Pas editorialit të LMR në BFI, me titull “KRYQI NË PRESILLË TË KRUSHEVËS ME LEJE TË SHAQIR FETAIT”, botuar në shumë portale kombëtare, rreth reagimit formal e të pashpirt të Shaqir Fetait, sa për ta kamufluar kontributin e vet në ngritjen e kryqit në Presillën myslimane të Krushevës, ka reaguuar “shërbimi për informim i BFI”, duke u munduar të na thotë që, falë angazhimit të Shaqir Fetait si dhe të ashtuquajturit “myfti” të Prilepit, Shefket Imerit, qenka stopuar ngritja e kryqit tridhjetëmetërs.

Në fakt, reagimi ishte po aq formal sa, me shumë bazohej në turpërimin që ua bëri editoriali, se sa në ndonjë angazhim konkret! Le ta nxjerrin ndonje procesverbal që flet për takimin e Rijasetit, të mexhllisit të xhemateve të Myftinisë së Prilepit, ndonjë takim të organeve të BFI-së me organet e pushtetit lokal; le të publikojnë ndonjë konkluzion nga ndonjë mbledhje me këtë rast! Nuk ka! Shaqir Fetai po rrenë dhe po reagon i turpëruar dhe i nervozuar se pse mediat po ia nënvizojnë kontributin e tij lidhur me ngritjen e këtij kryqi! A nuk është formë kontributi edhe pranimi vullnetar i tij për t’u instaluar nga qarqet antiislame në krye të BFI-së?

Që kur ushtroi tradhëtinë e madhe Shaqir Fetai e deri më sot, kanë ndodhur lojëra edhe më të fëlliqta mbi kurriz të BFI dhe myslimanëve të vendit, ndërsa Shaqir Fetait nuk i është dëgjuar zëri. “Reagon” vetëm kur t’i thonë! A thua kush i tha të “reagojë” mbi editorialin e LMR në BFI!? U provokua nga e vërteta a?

Provokimi i Shaqir Fetait nxjerr në shesh një problem tjetër! Do me thënë se, “falë reagimit të Shaqir Fetait dhe, të ashtuquajturit “mufti”, Shefket Imeri, qenka stopu një projekt maqedonas antiislam”! Kaq forcë paskan këta dy dudukë? Atëhere, le të provojnë kështu në union për ta inicuar ndërtimin e Xhamisë së djegur nga maqedonasit në Prilep? Me siguroi do t’ia dalin! Apo, Shaqir Fetait e Shefket Imerit nuk u intereson ndërtimi i kësaj Xhamie aq sa “u intereson” mosngritja e kryqit në Presillë! Shaqiri e Shefketi janë të kapur si mos më keq, marioneta që reagojnë vetëm ashtu siç lëvizë dora e pronarit të tyre!/**1KlikLarg/19.08.2022**

## **Medet për kalorësin që i varen këmbët**

**Që kur u instalua Shaqir Fetai në krye të BFI-së, ky farë abdalli si dhe organet-marioneta të tij, më tepër raportuan në shërbimet intelegjente të vendit e të huaja (kryesisht serbo-ruse) se sa që raportuan në Rijaset para organeve të BFI-së**

***Nga Valbon Osmani***

Këto ditë, në një shkrim u shtrua edhe një problem shumë interesant: A e keni parë ndonjëherë Shaqir Fetain të kryej ndonjë detyrë që kur u instalua nga qarqet antiislame në krye të BFI-së? Vërtet, a e di Shaqir Fetai se cilat janë detyrat e tij, qoftë shoqërore, qoftë kushtetutare apo programore? Nuk i di dhe as që dëshiron t'i dijë, sepse, ai ka pranuar të instalohet vetëm sa për ta shijuar kënaqësinë e të qenit "reis" (prej udhëbashi në "reis"?!)

Shaqir Fetai nuk erdhi për të kryer detyra institucionale sipas Kushtetutës së BFI-së, sepse, që në fillim e shkeli Kushtetutën dhe fuqishëm foli: nuk më intereson kjo Kushtetutë, sepse, vetëm përtej kushtetutshmërisë mund të shkatërrohet Institucioni i BFI-së! Kjo është detyra primare dhe e vetme e Shaqir Fetait. Ai nuk i ka obligim as teologëve, as myslimanëve, sepse asnjëra dhe as tjetra shtresë nuk e zgjodhën për "reis" porse ai u imponua, sepse u kishte dhënë fjalë pundhënësve të vet se do t'i bëjë pikë e pesë si shoqërinë shqiptare ashtu edhe shoqërinë myslimane të vendit.

Shaqir Fetai nuk njeh detyra programore, sepse ai u instalua, ai nuk erdhi me aklamacion falë programit të vet! Ai as që di se çfarë është programi, ai ka hedhur disa pika adoleshente në letër dhe mendon se kështu duhet të duket programi i një Institucioni tepër serioz dhe i rëndësishëm. Me program shpëtohet Institucioni, pa program shkatërrohet, dhe, fatkeqësisht, realizohet synimi i vetëm i Shaqir Fetait,

Çfarë pune ka bërë deri më sot Shaqir Fetai që kur u instalua nga qarqet antiislame në krye të BFI-së! Shaqir Fetai për këtë periudhë sa është duke e ushtruar rolin e marionetës antiislame përveçse që ka pritur e përcjellë njerëz të kotë, sa për të bërë ndonjë "lajm", përveçse që ka shkuar në ndonjë shtëpi për ngushëllim sa për interes personal, në ndonjë syneti, në ndonjë festë familjare për lindje të fëmijëve, punë tjetër me peshë e me rëndësi nuk ka kryer. Sepse, edhe nuk di por, edhe sikur të dijë, nuk guxon nga pundhënësit e vet!

Shaqir Fetai përveçse që e ka bishtin e kapur me derë, përveçse është i kapur nga elementë të dyshimtë për fenë islame, ai edhe vuan, e ka kompleks, tmerrohet e ngelë pa fije vullneti sa herë që t'i kujtohet mënyra se si e largoi ish-reisin e vet për t'ia zënë vendin dhe për t'i përligjur të gjitha ata projekte kombëtare e fetare që ishin ngritur me decenie e me shumë mund nga strukturat pararendëse në BFI! Ai këto ditë ka menduar seriozisht që t'i kërkojë hallallëk ish-reisit për tradhëtinë që ia bëri dhe për thikën që ia nguli pas shpine. Ai nuk është rehat! Shaqir Fetai gjatë kësaj periudhe dyvjeçare asgjë nuk ka bërë, ndërsa kjo periudhë do të mbahet në mend si kohë kur kanë ndodhur shumë gjëra të trishta kundër fesë sonë dhe kundër myslimanëve të vendit, kohë kur u regjistruan dhe u institucionalizuan sekte e religjione që veprojnë në emër të islamit, kohë kur u fragmentarizua uniteti i deridjeshëm i myslimanëve të

vendit, kohë kur u ndërtuan “xhami” personale, kohë kur e troshiti pa insaf vakëfin, kohë kur u shpenzuan për qejfe e lezete të gjitha letrat në vlerë që, në fakt, ishin vakëf! Kohë kur për herë të parë në historinë e BFI-së si dhe të Medresesë ISA BEU nxënësit e saj protestuan kundër parisë fetare!

Që kur u instalua Shaqir Fetai në krye të BFI-së, ky farë abdalli si dhe organet-marioneta të tij, më tepër raportuan në shërbimet telegjente të vendit e të huaja (kryesisht serbo-ruse) se sa që raportuan në Rijaset para organeve të BFI-së.

Si kurrë më parë ka rënë në mënyrë drastike interesimi për t’u shkolluar në Medresenë Isa Beu, sepse, pas kryerjes së kësaj shkolle profesionale, nxënësit nuk mundën të regjistrohen në asnjë fakultet, madje as në Fakultetin e Shkencave Islame! A ka ndodhur kjo përpara! Kurrë! Shteti nuk e njeh Medresenë! Shaqir Fetai manipulon edhe më tej me prindërit dhe me nxënësit, sepse, i duhen këta nxënës, pa këta nxënës i bie përdhe buxheti, nuk ka mjete nga participimi për shkollim, nuk ka fitra dhe zeqat, nuk ka kurbanë e kontribute të tjera! Shaqir Fetai problemin e vet e hedh në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut! Mendon se ky organ shtetëror është kompetent për t’ia zgjidhur problemet.

Nuk mund të zgjidhet ky problem përderisa problemi kryesor është vetë Shaqir Fetai!

Në kuvend nuk avancohen shkollat fetare, në Kuvend miratohen ligje, ndërrohet Kushtetuta, ndërrohet sistemi sekular i shtetit në atë gjysëm sekular apo në fetar!

Medresja akreditohet vetëm me vendim qeveritar! Brenda sistemit shtetëror aktual nuk ka shans tjetër, përveçse vendimit qeveritar! Ndërsa qeveria mund të sjellë vendime të këtilla vetëm pasi të “kërcënohet” seriozisht nga paria fetare!

Një “mëkat” të tillë nuk guxon ta bëjë Shaqir Fetai. Prandaj, Shaqir Fetai do të ishte më i lumtur që të mëkatojë me nxënësit e Medresesë se sa me pushtetin! Shaqir Fetai do të ishte më i lumtur të përgëdhelet nga pushteti maqedonas, se sa të respektohet nga gjeneratat e reja të hoxhallarëve. Zatën ai është mjeshër për t’u tallur me hoxhallarët. Ai edhe kur është i “mëshirshëm” dhe “serioz” me hoxhallarët, ai në fakt tallet me ta! Shaqir Fetai hoxhallarët i do sa për t’ia mbajtur ison në tërë atë hajni, në tërë atë shkatërrim, në tërë atë degradim dhe në tërë atë amatorizëm që po e ushtron mbi Institucionin e vetëm fetar islam në vend. Shaqir Fetait i duhen hoxhallarët sa për ndonjë “lajm” pasi ta pijnë çajin me të, sa për ta shoqëruar në dreka e darka, kryesisht nëpër familjet e varfëra e të painformuara. Në ato familje myslimane që e dinë se kush është Shaqir Fetai, nuk mund të futet brenda as me ushtrinë e rusit!

Shaqir Fetai ka shkaktuar aq dëme, ka devijuar aq shumë nga misioni i institucionit fetar, ka sjellë aq shumë telashe, ka rrënuar aq shumë suksese paraprake sa, cilado strukturë që do të vie pas tij, do t’i duhet që të kalojë decenie e decenie për ta rimëkëmbur BFI-në, për t’ia rikthyer atë peshë, atë status dhe atë rëndësi që e ka pasur përgjatë historisë, do të duhet aq shumë kohë për t’i sanuar të gjitha defektet që i ka shkaktuar për këtë kohë Shaqir Fetai me budallallëkun e vet! Shaqir Fetai, si Rankoviqi, mund të shkojë e të futet në çdo shtëpi shqiptare, t’ua hajë edhe bukën dhe t’ua përmbysë sofrën, asnjë prej shqiptarëve nuk do t’ia mbyllë derën, sepe, është në traditën e shqiptarit që ai që troket në derë, të futet edhe brenda! Por ama, a falë myslimani i ketyre trevave, a falë shqiptari? Kurrë jo! Nëse sot nuk mund t’i bëjnë asgjë, të paktën, brez pas brezi do ta mësojë e do ta njohë si Haxhi Qamilin, si spiunin, si tradhëtarin, si manipulantin e pështirosur që e keqpërdorte fenë së bashku me honxhobonxhot e vet që ia lakmojnë profesionin primar Shaqir Fetait – atë të kodoshllëkut!/**TetovaSot/28.08.2022**



## **Kalorësia e Sanço Panços! Po kush është Don Kishoti?**

**Kush po e trimëron Shaqir Fetain në degradimin e Institucionit të vetëm fetar islam në RMV dhe në deinstitutionalizimin e jetës fetare islame! Veprimtaria e Shaqir Fetait është aq e ulët, aq populliste, aq naive sa, nën këtë nivel poshtëruës bijnë vetëm marionetat e tij që i shërbejnë duke qenë të shantazhuar. Turp e mëkat**

***Nga Halid Sadiku***

A e mbani mend se kush ishte BFI-ja deri para dy viteve e kush është sot! Kush e drejtonte deri para dy viteve e kush po e drejton sot! A e mbani mend se si BFI-ja ishte Institucion me peshën e “shtetit në shtet”, ndërsa sot duket si një subjekt në grahmen e vet të fundit, që po jep shpirt nga injektimet e përditshme me antiislam e antishqiptari që po i injekton Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai pati detyrë për t’ia gulur thikën pas shpine ish-reisul ulemasë, ndërsa pati urdhër që mos t’i prekë dhe të bashkëpunojë ngusht me bashkëpunëtorët e ish-reisit! A ju kujtohen pamjet kur, pas çdo deklaratë të ish-reisit, bashkëpunëtorët e tij, përfshirë këtu edhe Shaqir Fetain servil, i qëndronin mbrapa si “ushtarë besnikë”, madje edhe duke i duartrokitur për ndonjë shprehje patriotike që e thonte pa u trembur ish-reisi e që nuk guxonin ta thoshin bashkëpunëtorët e tij. Bashkëpunëtrët e ish-reisit “u amnistuan”, sepse dulën besnik të “urdhërit” i cili i tuboi brenda natës dhe i urdhëroi që të gjithë tash e tutje t’i rrinë mbrapa Shaqir Fetait! Pse Shaqir Fetait? Sepse ky ishte i radhës më të lartë të “urdhërit” – “nxënës” me nofkën ORAO i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit! Vetëm Shaqir Fetai dhe bashkëpunëtorët e tij do të mund që Bashkësinë Islame ta orientojnë kah interesat ruse ndërsa, të bëjnë përpjekje që drejt këtij interesi antikombëtar ta involvojnë edhe partinë më me ndikim të shqiptarët në RMV!

Këta bashkëpunëtorë të ish-reisit dhe tani të Shaqir Fetait, këtij instalacioni të shërbimeve antiislame në krye të BFI-së, a do të mund të amnistohen edhe për herë të tretë?! T’i shërbejnë me kaq besnikëri Shaqir Fetait, të dokumentuar e të faktuar si njeri i lig, antifetar e antikombëtar, dhe, të shpresojnë në kohën kur do të amnistohen edhe një herë? Kurrë! Kanë vetëm një shans – të vetëamnistohen duke u penduar për angazhimin e tyre në shërbim të Shaqir Fetait e, përmes tij, në shërbim të UDB-së! Edhe udbashë edhe nëpunës të BFI-së? Ata janë shumë të vetëdijshëm se kjo punë nuk mund të ndodhë asnjëherë! Ata, ngjashëm si kalorësia e Sanço Panços janë përbetuar se do të jenë nën urdhërat e tij! Po kush është në këtë rast Don Kishoti që i jep urdhëra Sanço Panços (Shaqir Fetait)? Cili “Don Kishot” i tuboi brenda natës që t’ia kumtojnë shkarkimin ish-reisit, nëse jo i njëjti shërbim i përbashkët antikombëtar që i ka nën komandën e vet “të shenjtë”!

Cili është mëkati i tyre kaq i madh sa që të detyrohen e t’i përulen si robër Shaqir Fetait! Duhet të jenë më të zinjë se Shaqir Fetai, ndryshe, nëse janë pak fajtorë, nuk do të pranonin që edhe më tej të zhyten në lluc duke i tërhequr për hunde Shaqir Fetai si gjonë e gjallë!

Cilët janë kualitetet e Shaqir Fetait përveçse afinitetet e tij në thurrjen e intrigave, të tradhëtisë e të spiunimit! Këtij debili t’i qëndrohet gatitu dhe të qëndrojnë në shërbim të urdhërave të tij!

Të gjithë janë të mëkatshëm, të gjithë janë dallaverxhinjë, të gjithë kanë vjedhur, të gjithë kanë spiunuar, të gjithë kanë bërë pasuri duke e vjedhur vakëfin, madje ka prej atyreve që kanë marrur

banesa, lokale nga firmat që ua kanë lënë në dispozicion tokat vakufore për të ndërtuar “gradaçela”, ka nga ata që janë pronarë të super makinave e të dhjetra banesave e lokaleve, ka nga ata që kanë shtuar pasurinë me kontrabandim të refugjatëve! Të gjitha me ndeshmëri e me një rrogë të nëpunësit të BFI-së !!?

Këto krime i di Shaqir Fetai, tashmë i ka në duar dosjen e secilit bashkëpunëtor të vet, ndaj dhe, kushdo që tenton të lëvizë, ua tundë para hundëve dosjet duke i shantazhuar! Dhe pastaj heshtin dhe, me heshtje, ia zgjasin jetën Shaqir Fetait në aktivitete antikombëtare e antifetare duke qëndruar në krye të BFI-së! A nuk janë këto fakte që duhet ta frikësojnë prej Allahut çdo bashkëpunëtor të shantazhuar të Shaqir Fetait! A nuk është fakt i pamohueshëm ky që Shaqir Fetai ka mision për ta degraduar e për ta shkatërruar BFI-në! Kujt pastaj do t’i duhet një BFI e depersonalizuar, e defaktorizuar dhe e deinstitutionalizuar? Askujt! Të gjithë do të ikin prej saj të turpëruar e të mërzitur. Vetëm Shaqir Fetai do të jetë jashtëzakonisht i lumtur! Përgjegjësi para Allahut xh.sh. do të japin bashkëpunëtorët e tij edhe për “lumturinë” që ia kanë shtuar Shaqir Fetait!

Mbase para myslimanëve e xhematit do të thonë “po ne nuk e kemi ditur”, por ama para Allahut xh.sh. nuk mund ta thonë këtë! Para Tij vetëmsa mund të pendohen, të bëjnë teube dhe të kthehen në Rrugën e Tij! Ai e ka Mëshirën e Madhe!**1KlikLarg/29.08.2022**

## **Me rrena nuk shkohet në Xhenet, o Shaqir Fetai**

### ***Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI***

Është e pamundur që të mos rrejë Shaqir Fetai, sa herë që ta hapë gojën, apo sa herë që përpiqet të bëjë lajm sa për vetëlavdërim!

A ju kujtohet kur thoshte se vendimi për akreditim të Medresesë qenka në Parlament, ndërsa tani informon se miratimi i mendimit të qeverisë për shkollat e mesme fetare, tani do të kalojë në Parlament! Do me thënë, po ikë edhe një gjeneratë me pengesa ligjore për të vijuar shkollimin sipëror! Tash e dy vite rresht i thuhet Shaqir Fetait se ky problem mund të zgjidhet vetëm me vendim të Qeverisë e cila nuk i hy këtij "akcioni" pa një presion të mirëfilltë institucional, kurse Shaqir Fetai nuk e merrte mundin që ta hidhërojë qeverinë që e instaluan në krye të BFI-së, qoftë kjo edhe me "djegie" të gjeneratave të tëra të medresantëve!

Dy-tri deceniet e fundit, Drejtoria e përgjithshme e vakufëve të Turqisë por dhe TIKA, në territorin e Maqedonisë së Veriut kanë kryer intervenime, restaurime e rinovime në dhjetra objekte fetare me rëndësi të veçanta historike e si vlera të trashëgimisë kulturo-fetare! Dhe ky aktivitet është llogaritur ekskluzivisht si aktivitet i institucioneve turke në të mirë të BFI-së dhe, përgjithësisht, myslimanëve të vendit. Intervenimin e Drejtorisë së vakëfeve të Turqisë, Shaqir Fetai u mundua ta paraqesë si meritë e tij personale dhe si aktivitet të tij personal! Paska nënshkruar dy protokole?! Nënshkrimi i çfarëdo dokumenti nga ana e Shaqir Fetait është absolutisht formal, sa për ta "begenisur" edhe të "parin e fesë"! Protokolet zyrtare janë nënshkruar në mes të Institucionit turk dhe Drejtorisë për Trashëgimi Kulturorë pa lejen e të cilës nuk mund të ngulet asnjë gozhdë, në asnjë objekt me rëndësi historike e me vlera të trashëguara kulturo-fetare! Në këtë rast, Shaqir Fetai është bira e fundit e kavallit!

Po pse Shaqir Fetai ka shumë qejf që t'i vjedhë aktivitetet e huaja dhe t'i përvetësojë duke i personalizuar?

Shaqir Fetai u ka borxh myslimanëve të vendit t'ju tregojë se cili ishte aktiviteti kriminal i tij që i detyroi arabët të heqin dorë nga projekti disa milion dollarë që do të kalonte vakëf i BFI-së-Myftinisë së Gostivarit! Deshti t'i vjedhë, pa dyshim, ndaj investitori iku tepër i dëshpëruar. Edhe institucionet turke do t'i vidhte Shaqir Fetai për sa fytyrë që ka. Por ama, ja që projektet e institucioneve turke janë rezultat i bashkëpunimit të tyre institucional me institucionet e shtetit, sepse, tashmë Shaqir Fetai është i lexueshëm si "parja e kuqe", dikush nga bota arabe ia vuri myhyrin si hajn i babëzitur! /1KlikLarg/Opinione/01.09.2022

## **Shaqir Fetai sërish rrejti**

Duke dashur që të tërheq sado pak vëmendjen e opinionit, Shaqir Fetai i gJORë, me rastin e një shtatorit, fillimit të vitit shkollor, u drejtohet nxënësve, pra edhe medresantëve me një tekst të denjë për filloristët gjatë hartimeve shkollore dhe, veç tjerash, u thotë: "kam nderin dhe cat që tua shpreh urimet e mia..."

A mund të ketë nder i pandershmi! A mund të flasë për diturinë injoranti dhe mjeshtri i intrigave, snobi e hipokriti!

A mund të ketë nder një tradhëtar e një udbash siç është Shaqir Fetai?! A mund t'i drejtohet me nder dikujt Shaqir Fetai ndërkohë që në historinë e BFI-së do të ngelë si njeriu më i pandershëm dhe si karrieristi më i pashpirt?!

Paska pasur fatin?! Shaqir Fetai kurrë nuk do ta kishte "fatin" sikur mos ta kishte mundësinë që ia krijuan elementet antiislame e antishqiptare që e instaluan në krye të BFI-së.

Pra, mundësinë që ia krijuan këta elemente kundër BFI-së Shaqir Feta e "konverton" në fatmirësi. Ky po që është kokrra e mediokrit!**1KlikLarg/01.09.2022**

**Shaqir Fetai për t'u bërë myfti ia fërkonte h.Sulejman Rexhepit, për të shpëtuar nga nofka “orao” ia fërkonte BDI-së, për ndotje të BFI-së po ia fërkon qeverisë**

**Kalaja pushtohet së brendshmi, vetëm se duhet të përgatiten spiunët dhe të aktivizohen në momentin e duhur! Me decenie pushtetet maqedonase kërkonin ta kompromitojnë BFI-në dhe, kësaj ia arritën vetëm pasi e aktivizuan marionetën e tyre, Shaqir Fetain**

*Nga Venera Zendeli*

Nëse navigoni në faqen zyrtare të BFI-së, dhe i përcillni “ngjarjet” brenda dhjetë ditëve, do të vëreni se, elementet që përpiqeshin për ta deinstitutionalizuar dhe depersonalizuar e kompromituar BFI-në kësaj veçmë ia kanë arritur përmes Shaqir Fetait. Sot nuk kemi një Institucion me integritet e me dinjitet, por kemi një filiale të shërbimeve të ndryshme maqedonase dhe, kemi një Shaqir Fetah që si “ai sendi” po ngritet ditë për ditë nga lëmimet qeveritare maqedonase. Po e lëmojnë sepse më servil e më të dëgjueshëm nuk do të gjenin kurrë! Në faqen zyrtare të BFI-së do të gjeni “aktivitete madhështore” të Shaqir Fetait që konsistojnë në pritje-përcjellje të haxhi-babave të cilët nuk e dinë dhe nuk e njohin Shaqir Fetain porse kanë ëndërr jetike të ulen dhe të pinë çaj me “reisin” e tyre. Shaqir Fetai i keqpërdorë pikërisht këta “ëndërrimtarë” të sinqertë për të bërë “lajm” mbi atë se sa shumë xhemat “e përkrahin” fuksin! Nuk ka aktivitete konkrete që mund të dalin nga strategjitë e tij islame, nga kalendari i planifikimit zhvëllimor i tij, nga programi i tij “miratuar” në Rijaset apo para kuvendarëve të BFI-së! Në mungesë të kësaj, Shaqir Fetai do të urojë doktor shqiptar i cili ia paska dalë të emërtohet drejtor klinike në një spital perëndimor. Por ama e pranon që nuk e njeh këtë person! Ka edhe ngushëllime për vdekjen e një ambasadori dhe këtë e bën sa për “qëllime elektorale”! Ky ngushëllim mungon në faqen zyrtare të Ministrisë së punëve të jashtme. Lajmi më i ndytë është ai që bartet nga fb-u personal i Shaqir Fetait e që ka të bëjë me një aktivitet-mbledhje të Qeverise maqedonase. Shaqir Fetai dhe “bashkësia antiislame” e tij ndjek aktivitetet e Qeverisë?!

Qeveria paska miratuar mendimin mbi shkollat fetare!!! Çka do të thotë kjo? Si ndodhi kjo? A ka ndonjë proces miratimi i këtij “mendimi”? A duhet të dalë në diskutim publik para se të shkojë për miratim në Parlament, apo, për Shaqir Fetain gjithçka që vjen për “islamin” nga Qeveria maqedonase duhet thënë amin!

Dhe në fund Shaqir Fetai i “falënderon të gjithë”? Kë të gjithë? Kush janë ata? Kush iu bë therrë në sy pushteteve maqedonase me angazhimin permanent të tij për ta akredituar Medresenë! Cilat ishin përpjekjet sizifiane të ish-reisul ulemase H. Sulejman ef. Rexhepit? Pse Shaqir Fetai nuk e bëri lajmin duke publikuar një kronologji se si rrodhi puna deri te miratimi i këtij “mendimi” nga ana e Qeverisë? Efendi Rexhepi kurrë nuk ua ka fshehur, nuk ua ka mohuar angazhimet e ministrave të BDI-së për akreditimin e Medresesë, vazhdimisht i ka lavderuar me emër e mbiemër! Shaqir Fetai “falënderon të gjithë”, duke iu shmangur nënvizimit të kontributit të

faktorit politik shqiptar, konkretisht të ministrave të BDI-së. Natyrisht, nuk shpreh falënderime të përveçme, sepse pastaj, cili do të ishte angazhimi personal i Shaqir Fetait? Zero kontribut, pa dyshim!

Dhe, gjithçka që vjen nga qeveria maqedonase e cila e instaloi marionetën e vet në krye të BFI-së, nuk duhet të diskutohet! A e di stafi akademik i Medresesë, Këshilli i prindërve, drejtorja e shkollës, Rijaseti, a e di vetë Shaqir Fetai se cila është materia e “mendimit të miratuar” që do të shkojë në Parlament për t’u miratuar? Çka do të thotë ky “akreditim”? A do të thotë se tash e tutje, veç të tjerash, punësimet do të inicohen dhe do të lejohen nga Ministria për arsim! A do të mund ta pengojë dikush punësimin e personelit arsimor që do të jet pasqyrë e përfaqësimit adekuat, (të punësohen profesorë maqedonasë) madje për ndonjë lëndë fetare të paraparë me program të integruar të punësohet në Medrese edhe ndonjë pop! Kush do i paguaj këta! Apo i paguan Shaqir Fetai me paratë e fitrit dhe zeqatit? Ku i intereson kjo gjë Shaqir Fetait! Ai do të pranojë t’ua kthejë edhe b... vetëm e vetëm t’ia mbrojnë kolltukun ku e kanë ngulur këtë nalet!/**Kombetare/05.09.2022**

## **Bolero në "institucionin" e Shaqir Fetait**

### ***Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI***

Shaqir Fetai paska shkuar në Sisak për të marrur pjesë në përrurimin e Xhamisë dh të qendrës islame që do të mbajë emrin e presidentit turk, Rexhep Taip Erdogan!

Ç'është e vërteta, Shaqir Fetait nuk i ha fort b... për qendra islamike! Ai ka shkuar në këtë event (duke marrur me vete një aradhë "bashkëpunëtorësh") mundësisht për të kaluar përskaaj Presidentit Erdogan që një ditë të lavdërohet si idiot: "e kam njohur, kam ndejtur bashkë me Presidentit Erdogan"! Natyrisht, presidenti turk as që e ka llogaritë për insan, sepse ai tashmë e di se si, katër vite më parë, në prezencë të H. Suejman ef. Rexhepit dhe të dy "hanëm ingjeve", Shaqir Fetait i ka shkuar buza në gaz kur njëri prej të pranishmëve ia ka sharë nënën kollanumkollan Rexhep Taip Erdoganit!

Shaqir Fetai as që do t'ia dijë për qendrat apo për organet islame! I ka edhe në Maqedoninë e Veriut, të cilat mendon se "i drejton"! E di veten Shaqir Fetai që nuk është për institucione e organe të mirëfillta, nuk mundet t'ia dalë në krye me aktivitete të mirëfillta, nuk di dhe nuk i njeh! Edhe sikur t'i dinte nuk e lë ajo pikë ndërgegje që i ka ngelur, sepse, nuk mund të jetë drejtues i organeve fetare ndërsa ka ardhur në krye të tyre fare në mënyrë joislame. Prandaj i lë të katandisen, të bëhen për ibret!

Vetëm në kohën e një fuksi, të një komplotisti e të një tradhëtari organet dhe sektoret e BFI-së ia kanë arritur që të shndërrohen në bolero! Dhe të gjitha të mbahen me paratë e fitrit dhe të zeqatit. Nuk ka gjë më të trishtë se tradhëtia ndaj dhe, kur ka duruar Shaqir Fetai që ta gëlltisë tradhëtinë, duron edhe amoralitet, hajni e tradhëti nëpër këto organe!

Shaqir Fetai e di fare mirë se kush vjedh fitrin dhe zeqatin, kush e vjedh haxhin dhe kush vjedh kurbanë; Shaqir Fetai fare mirë e di se kush huazon fitër e zeqat për të blerë hashash e narkoza të ndryshëm, Shaqir Fetai e di fare mirë kush ka vjedhur nga vakëfi, kush nga vakëfi ka bërë "vakëf" për vete; Shaqir Fetai e di fare mirë se si institucionet e tij po shndërrohen në "shtëpi publike", e di fare mirë se si po zhvillohet amoralieteti nëpër organet e BFI-së; Shaqir Fetai e di fare mirë se cilët bashkëpunëtorë të vet i ka të shërbimeve intelektuale!

Këtij njeriu pastaj t'i interesojë qendra islamike në Sisak?! Nuk është e vërtetë! Ai ka nevojë që sado pak të largohet nga këto skandale që shumë shpejt do t'i shpërthejnë, ose, nëse i shpërthejnë të paktën ai të mos jetë në vendin e vet dhe, pasi të shpërthejnë, prej "gurbetit" të kyçet drejt e në katundin e vet, si i mjerë, si i pistë!

Kësaj radhe, vetëm do të sinjalizohet për dukuritë e turpshme dhe, shumë shpejt do të publikohen emrat e atyreve që keqpërdorin, mbi të gjitha, detyrat islame si dhe paranë e myslimanëve të ngratë të vendit për punë joislame (për të mos thënë për zina)!

Shaqir Fetai do të mbahet në mend edhe për suksesin e tij që ia doli që, institucionet e BFI-së t'i shndërrojë në filiale të shërbimeve sekrete dhe, për më keq e më turp, në shtëpi publike.

**Medet!/IKlikLarg/Lajme7/09.09.2022**

## Qelepîrxhi në Sisak

Shaqir Fetai që kur u instalua dhunshëm e turpshëm në krye të BFI-së (për këto dy vite) ka qenë më shumë në Kroaci, më shumë e ka vizituar kushëririn e vet, ambasadorin maqedonas Milaim Fetain dhe “Qevapçiçat” se sa që ka vizituar kryetarin e Meshihatit të Kroacisë apo ndonjë xhami! Shaqir Fetain, kur ta merr malli për kushën e vet dhe për një racion “10 qevapçiçi”, ia kanë nanën krejt buxhetin e BFI-së e bën rrush e kumlla. Është i poangopshëm Shaqir Fetai dhe shumë i përmalluar.

Le të na tregojë Shaqir Fetai, jo, mos t’i tregojë opinionit, mos të bëhet transparent se është jashtëzakonisht i varfër në shpirt për të qenë transparent, të paktën, a ka raportuar me shkrim para Rijasetit që të tregojë se çfarë ka bërë në Kroaci dhe cilat janë përfitimet që i ka BFI-ja si dhe myslimanët e vendit nga këto shëtitje si “fena n’tirqi” të Shaqir Fetait në Kroaci?

Shaqir Fetai kësaj radhe është mbajtur në distancë si fuks, nuk e ka përfillur askush, prej 28 fotografive të publikuara në fb-un e vet, nuk e ka asnjë me presidentin e Turqisë. Natyrisht që e kanë mbajtur sa më larg presidentit. Pse-në e di shumë mirë Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai mungon edhe në rreshtin e peronaliteteve që presin secili nga një copë prej shiritit inagurues. Thjesht, kësaj radhe ia kanë treguar vendin koteles!

Dhe, i mërziur nga kjo bllokadë kundër Shaqir Fetait, ky, në t’u kthyer ka vizituar familjarë nga myftiu i vet, për të cilët fort i kishte marrë malli. Aty i hëngrën edhe kah 15 qevapçiçi dhe, duke u marur ngryk me Milaim Fetain, ambasadorin maqedonas, si dhe me familjen Zendeli, Shaqir Fetai u kthye në Maqedonië e Veriut!

E çka fitoi! Ç’të mirë i solli BFI-së nga kjo vizitë kot e kot? Kush ia mbuloi shpenzimet Shaqir Fetait në udhëtim për t’i takuar familjarët e vet dhe për t’u çmallur me ta! Shaqir Fetai, pa dyshim, bashkë me “patriotët” e vet, është ekipi që në historinë e BFI-së, këtij Institucioni i ka kushtuar më së shtrenjti!

Sepse, Shaqir Fetai është qelepîrxhi, e do qelepîrin, për këtë flasin të gjithë anëtarët e Rijasetit, madje tregojnë edhe barcaleta lidhur me mënyrën dhe sasinë e ngrënies nga ky i babëzitur që merr udhë këtu e në Sisak për të hëngër kah nja 15 qevapçiçi bashkë me kushën e vet dhe për të diskutuar se si të dalin nga halli ku janë futur vetë këtu e vite më parë!/**Kombetare/10.09.2022**



**Shaqir Fetai ka shtrirë “dorën e mëshirës”! Veturat i paguan edhe një herë më shumë se çmimi i pazarit**

**Tashmë katërcipërisht është vërtetuar se makutëria dhe skuthëria e Shaqir Fetait i tejkalon edhe pisat më të pashpirtë me këto karakteristika! Shaqir Fetai po mundohet që veten ta shohë sa më gjatë në atë pozitë ku e instaluan qarqet e ndryshme maqedonase, duke e blerë atë pozitë me para të huaja, duke e vjedhur vakëfin e BFI-së dhe duke blerë “bashkëpunim”, servilizëm dhe bashkëpjesëmarrje në devalvim të islamit dhe të vlerave islame. Pa dyshim, tashmë e kanë kuptuar myslimanët e vendit dhe mbi të po derdhin proje mallkimesh**

*Nga Xhelil Qazimi*

Shaqir Fetai kur pranoi të instalohet nga qarqet antiislame në krye të BFI-së, në duar të veta pati tre atu në të cilat shpresonte se do t’ia dalë! Në fakt, nuk ishin atu personale të tij sa ishin këshilla të shërbimeve sekrete, sepse vetëm ata dinë marifetllëqe të tilla që po i përdor Shaqir Fetai!

Atuja e parë ishte që t’i kapë e t’i mbajë për fyti të gjithë bashkëpunëtorët e shërbimeve sekrete që në BFI ishin me bollëk!

Atuja e dytë ishte që mos ta respektojë Kushtetutën e BFI-së, mos të punojë sipas këtij akti më të lartë dhe, në kundërshtim me të, të nis e të demonstrojë superioritet duke i prerë dhe qepur “kostumet” vetë. Si rrjedhojë e kësaj e shtoi numrin e përkrahësve të vet që i duhen vetëm si vota: i emërtoi për myfti disa koordinatorë të padenjë mandje për të udhëhequr edhe ndonjë mekteb! Sepse, me këtë “këshillë” në fakt Shaqir Fetai ia mësynte amortizimit të votave, apo, meqë e dinte se ata që e përkrahën në instalim një ditë do të zhgënjehen prej tij dhe mund t’ia tërheqin besimin, më e sigurtë do të ishte të sigurojë “vota alternative”! Pra, këtë situatë Shaqir Fetai e “relativizoi” duke siguruar vota të tjera prej njerëzve që për karrierë të falsifikuar janë në gjendje ta shesin edhe më të shtrenjtën e tyre!

Atuja e tretë e Shaqir Fetait tek tani po vjen në shprehje! Fillimisht kishte pak droje por, tani, sikur është azdisur, apo, mbase po e ndjenë rrëshqitjen e karrierës në drejtim të mallkuar, ndaj dhe ka filluar të shpenzojë si pijanecët pasi të dehen.

Shaqir Fetai po ndjenë se po i has sharra në gozhdë! Shaqir Fetai e filloi me një myfti, i cili, pasi kishte hatërmбетje që nuk po ia jepte një shumë goxha të madhe (sikur të ishte e babait të vet), u dakordësuan me Shaqir Fetain që të shitet edhe për 30 mij euro si dhe të drejtojë një aksion fetar! Të tjerët i morën erë këtij pазari, ndaj dhe, nisin të ngrisin kokë!

Shaqir Fetai ka para, ka gjetur para të majme, sepse decentralizimi përmes letrave në vlerë veçmë kishte filluar! Ku ngelën këto letra vakëf? Çka po bëhet me këto letra vakëf? Njëerë prej myftinive iu kthyen 900 mij euro letra në vlerë. Plus i kishte “dhuratë” nga një shtet arab edhe 420 mij euro për vakëf! Asnjë cm kub nuk u shtua vakëfi i kësaj Myftinie me këto para, ndërsa u pajisën me makina super të shtrenjta, referentët u bënë me shtëpi të reja, me parqe e me oborre “mbretërore” (në raport me kushtet si i kishin më parë!) Kjo blerje e përkrahjes i duhej myftiut,

sepse po shkonte në rr.s., po ia tunte fotelen vetë Shaqir Fetai i revoltuar nga rrebelimi i përkohëshëm i tij!

Shaqir Fetai po ec gjurmëve të myftiut të vet, në fakt, tashmë janë shtuar ndaj dhe gjurmët kah duhet të shkelë Fetai janë shtuar! Miliona pronë e decentralizuar në letra me vlerë! Të gjitha i ka shpenzuar për rroga, asnjë cm kub vakëf nuk iu shtua BFI-së! Shaqir Fetai ka nisur t'i kritikojë organet e veta se, pse nuk kërkojnë makina të reja e lluksoze! Vetëm le t'ia kërkojnë, le t'ia tregojnë tipin dhe Shaqir Fetai fak-tak ua blenë! Blerjet e para më tepër flasin për nevojën e Shaqir Fetait për të shpëlarë para të pista! Shaqir Fetai makinës që kushton 17-18 mij euro ia "jep" 35 mij euro!

Asnjë komision për këto punëra! Asnjë komision për blerje të makinave, asnjë ofertë paraprake për tipin e njëjtë të makinës, asnjë vendim prej Rijaseti për blerje të makinës, asnjë kërkesë zyrtare prej organit për një makinë zyrtare, kurrfarë respektimi ndaj rregulloreve paraprake për furnizimet e BFI-së!

Komisioni për antikorrupsion dhe policia financiare si asnjëherë më parë kanë arsye për ta krehur një institucion fetar. Shaqir Fetait dhe myftinjëve të tij nuk do t'u falet asnjë metalik nga letrat me vlerë që janë kthyer në vend të vakëfit të nacionalizuar. Ky duhet të jetë premtimi i vetëm i pretendentëve të devotshëm që ia mësyjnë të zgjidhen në krye të BFI-së sipas procedurave të parapara në Kushtetutë dhe në rregullore për zgjedhje të organeve të BFI-së. Matrapazët, hajnat dhe shkatërruesit jo që duhet ta kthejnë çdo metalik të shpenzuar nga vakëfi por, duhet të sigurohen se që të gjithë do t'i nënshtrohen proceseve gjyqësore që, para se të përfundojnë burgjeve, duhet të dëshmojnë se ku dhe si iku vakëfi në formë të letrave me vlerë! Natyrisht, do të duhej të respektohen të gjithë ata që nuk shpenzuan asnjë metalik të këtij vakëfi, porse, a nuk do të ishte një lloj mëkati edhe pranimi i tyre që, si të pastër, të punojnë bashkë me matrapazët, kriminelët dhe hajnat e BFI-së? Bashkëpunimi i tyre vetëmsa ia ka zgjatur jetën hajnisë deri në themel të BFI-së. Këta bashkëpunëtorë "të pastër" do të lihen në mëshrën e Zotit! Mëshirëploti di si të gjykojë mbi këtë kategori nëpunësish "të dvtoshëm"! Edhe ata që shpresojnë se me pensionim do t'ia dalin që mos t'i nënshtrohen proceseve gjyqësore, do të zhgënjehen keq! Hajnat e vakëfit duhet të ndiqen deri në varr, pastaj, pas varrosjes së tyre, nuk duhen të lihen rehat të gjallët e tyre! Vakëfi nuk mund të trashëgohet si miraz prej babe, ai duhet t'i kthehet pronarit të vërtetë, të vetëm dhe të përhershëm - BFI-së! **Politesa/12.09.2022**

## **Inati i gomarit**

**Kur gomari inatoset me pronarin, i ngulë këmbët në lloç dhe për më të madhin kjamet nuk e bën një hap tutje! Edhe me drunjë, edhe me shufra hekuri të goditet, jo bre, nuk do të lëvizë, sepse, nuk i thonë kot – inat gomari**

## ***Nga Ibadete Asipi***

Kam dëgjuar prej shoqeve të mia që dikur kanë kryer Medresenë, që kanë pasur rastin ta kenë profesor këtë farë “reisin”, Shaqir Fetain, tek thonë se, është interesant abdall, se është i humbur, i trembur, se kur të zhytet në kujtime edhe gishtin me ia futë në “vesh”, nuk e ndjenë! Sa është i çuditshëm aq është edhe naiv, sa është profesor aq është edhe analfabet, sa është “i mirë” aq është edhe inatçor. Inat paska mbajur edhe me nxënësit e mirë, duke ua treguar atyre se çfarë është “intelektualiteti” alla-Shaqir Fetai. Ajo me të cilët atëbotë qeshnin më se shumti nxënësi paska qenë prirja e Shaqir Fetait për t’u kërrysur ndryshe! Krejt meshkujt e dynjasë kërrysen duke i dalur paksa kurrizi, apo duke u lakuar në mes për nja 10-20 shkallë. Mbase në botë është i vetmi Shaqir Fetait që kërryset ndryshe, qafa i ik nga mbrapa, në drejtim të bythëve, duke e nxjerrur barkun përpara si shtatëzënë! E keni parë se si rri “gatitu” Shaqir Fetai, vetëm vërejeni, tamam sikur ta ketë manir për ta imituar gruan shtatëzënë, apo, për inat të këtyre grave, pozicionin e tyre e merr edhe më mirë. Abdall, mo! Gjithnjë në qëndrim të fëmijës së përgjumur duke e bërë çiqin!

Shaqir Fetai e di fare mirë se nuk ka mysliman i shëndetshëm që e do apo që ka respekt për të. Të shëndetshëm janë të gjithë myslimanët e vendit, me përjashtim të një grushti të cilët joshen naivisht nga interesat e Shaqir Fetait, duke i përjetuar si interesa të tyre.

Rrëfejnë shumë myslimanë të vendit se si Shaqir Fetai i ka marrur inat se pse nuk kanë pranuar hala që të shkojnë tek ai në zyrë, ta pijnë ndonjë kafe dhe t’ia bëjnë për hajër e ta urojnë në krye të “reisllëkut” me qëllim që të bëjë ndonjë lajm për vete! Ka ngelur pa lajme! Kohëve të fundit po i vjedh aktivitetet, eventet dhe ngjarjet e huaja që t’i përshkruajë si aktivitete të tij, meqë edhe ai ka marrur pjesë formalisht nëpër ato raste!

Shaqir Fetai, aq sa e vuan urrejten e myslimanëve të vendit, aq u gëzohet edhe përfshirjes së tij nëpër evente të ndryshme, sepse, do të ketë rast për ta shprehur tërë atë inat të magarit që e ka kundër myslimanëve të vendit.

Vetëm një lolo si Shaqir Fetai mund të shkruajë në facebook-un e vet atë që e shkruan për vete Shaqir Fetai lolo. Kryetari i shtetit, në fb personal do të shkruante “sot mora pjesë...”, kryeministri do të shkruante “isha për vizitë në Amerikë...”, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s do të thoshte “sot dhashë urdhër që të...”, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të thoshte “kërkoj solidaritet më të shtuar në mes kombeve...” etj.

Vetëm Shaqir Fetai, absolutisht vetëm ky abdall në dynja, kur shkruan në fb-un e vet, thotë: “Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai, të martën mori pjesë në ceremoninë e organizuar...”, “Në këtë ceremoni e nderuan kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reisul Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetai i shoqëruar nga kabineti i tij...”, “Delegacioni i BFI e RMV në krye me Reisul ulemanë H.Hfz. Shaqir ef Fetain pat një pritje

vëllazërore...”, “Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai hodhi gurrthemelin e Xhamisë së Re...”, etj.

Logjika e Shaqir Fetait: sado që nuk më pranoni si “reis”, sado që më urreni, unë, për inat të juaj, vetes do t’i drejtohem me “kryetari i BFI-së, reisi”! Bëhet “gazetar-informator” i vetëvetes! Vetes i raporton se çka ka bërë “reisul ulema Shaqir Fetai”! E ka difekt që nga periudha kur ishte fuks aktiv. Një jetë të tërë është mësuar që të raportojë si “ORAO” me qëllim që t’ia shtojë akcionet fuksit Shaqir Fetait! Raportet policore nuk kanë kuptim në fb personal por ja që për Shaqir Fetain kanë kuptim të plotë, sepse, përmes kësaj forme të raportimit ai në fakt e shpreh inatin që e ka kundër të gjithë atyreve që nuk e duan dhe që nuk e pranojnë. Numri i atyreve karshi të cilëve Shaqir Fetai e shpreh inatin dhe urrejtjen është i barabartë me numrin statistikor të regjistrimit të fundit të myslimanëve në RMV!

Inati prej gomarit i Shaqir Fetait e fut llugave edhe më shumë! Ditë më parë, Ambasada e SHBA-së në Shkup, me rastin e aktit terrorist më 11 shtator të vitit 2001, kishte organizuar një takim me faktorët e ndryshëm të vendit si dhe me korin diplomatik për ta përkujtuar këtë moment nga më të rëndat në historinë e njerëzimit. Natyrisht, në të tilla evente protokolli më tepër parasheh mirësjellje, kurtoazi, se sa qëndrime e vendime zyrtare! Ambasadorja do t’i përshëndesë të gjithë, pas fjalimit të saj si pjesë zyrtare, gjithçka tjetër është mirësjellje. Do t’i vizitojë delegacionet dhe personalitetet nëpër tavolina, do të përshëndetet sa me njërin e sa me tjerin, do t’ju shpreh falënderim për pjesëmarrje në event që shpreh solidarizim ndërkombëtar me shqetësimin amerikan dhe jo vetëm!

Kurse Shaqir Fetai në fb-un e vet do të shkruaj “Pas fjalimit, Reisul Ulemaja H. Hfz. Shaqir ef. Fetai, bisedoi me Ekselencën e saj Ambasadores Kate M. Byrnes dhe e falënderoi për gjithë kontributin që ajo e ka dhënë në vendin tonë, duke qenë një nga promotorët kryesorë që e radhiti vendin tonë në familjen e madhe të NATO-s.”

Shaqir Fetai po rrenë, po e keqpërdorë këtë takim kurtoazie dhe se po harron që, vetëm abdallët nuk mund ta kuptojnë se, në një event të tillë, për të ardhur muhabeti deri te ky “falënderim politik e zyrtar” i Shaqir Fetait do të duhej të zhvillohej një bisedë të paktën prej nja 15 minuta! Dhe thua ti që zonja ambasadore të ketë lajthitur nga trutë dhe t’i ketë kushuar 15 minuta takim Shaqir Fetait që ky të pallamudë kot e kot, ndërsa në oborr ku po mbahej eventi ka me dhjetra e dhjetra personalitete më të rëndësishëm se Shaqir Fetai dhe të cilëve nuk ia ka dalur t’i kushtojë falënderime më shumë se dy-tre minuta! Maqedonia në NATO kurse Shaqir Fetai i legjitimon dhe i legalizon “armiqtë” e NATO-s në vend!

Nëpunësit e Shaqir Fetait nëpër xhami mbajtën ligjerata të tëra kundër rreshtimit të shqiptarëve që e dënuan dhe e sanksionuan sulmin barbar të Rusisë kundër Ukrainës. Natyrisht, këtyre ligjeratave do t’ju paraprijë edhe takimi i Shaqir Fetait në zyret e BFI-së me delegacionin e Putinit, të cilit delegacion i premtoi se aleatit historik të Putinit myslimanët e vendit do t’ia ngrisin një përmendore në Tetovë!/**TetovaSot/14.09.2022**

## **Treni lodër pa bateria**

**Thonë që, të merresh me demagogun është si të merresh me gjysëm budallain, prandaj na qenka mëkat t'i replikoshë atij. Dakord, mos u merr me budallain, ama gjysmës tjetër duhet t'ia tregohet vendi! Demagogu është po aq i keq dhe i ligë sa abdalli. Prandaj, është vepër prej atyreve të pëlqyera që demagogu “të goditet me tullë” dhe të dëbohet miliona kilometra larg komunitetit. Sepse, është i dëmshëm, është i ligë, është pandemik**

### ***Nga Sevdie Kasami***

Në takimin e fundit me rastin e një synetie, është dëgjuar tek janë lavdëruar haxhuzet plaka të mëhallës me Shaqir Fetain: “Si fëmijë ka pasur shumë qejf që të bëjë vula prej patatesh dhe pasi i bënte me bojë gjithë ditën vinte “vula” nëpër letra të bardhë, duke marrur pozat e atyre “eporëve” që tej sporteleve zyreve të vendit (“mesna zajednicës”) vulosnin dokumenta zyrtar. Kishte qef që mbrapa vetes të varte nëpër “shtylla” edhe copa arnash për të cilat ai thoshte se i ka flamuj të shteteve të ndryshe. Eee, qysh atëherë shihej se do të na dalë i zoti”!

Sot, Shaqir Fetai mundohet të përmbushet me atë nevojë që e ka pasur zhit kur ka qenë fëmijë. Shumë ka qejf që demagogjitë e veta të thata t'i postojë me ndonjë fotografi ku shihet se si hedh firmën në letër, me prapavijën përplot flamuj! Tipike kjo për fëmijët me ëndërra për ta luajtur rolin e presidentit! Psikologjia e shpjegon si reaksion që del nga thellësia e zbrazëtirave shpirtërore në kohën e fëmijërisë. Prandaj, kur dikush sillet si i përhanë thonë se është “i porealizuar”, “i paplotësuar”, mu sikur Shaqir Fetai!

Shaqir Fetait dikush ia paska ngacmuar dhe shtuar inatin e magarit dhe ky, menjëherë paska raguar me një shkresurinë-paçavurë me do simbole të cilave as që ua di domethënien, as që di se ku dhe kur mund të përdoren.

Shaqir Fetai veten po e ndjeka si tren të mbushur me vlera, i cili ndalet nëpër stacione sa për të marrur vlera dhe ik menjëherë, nuk ka kohë për të vonuarit!

Cila është vlera e Shaqir Fetait kur tashmë është zbërthyer e dokumentuar si “ORAO” bashkëpunëtor i Stanko Dagoviqit, i transferuar me nofkën “Sevdalinka” te Temelko Boshkovski, te udbashi më i tmerrshëm antishqiptar i Pollogut!

Cila na qenka ajo vlerë e Shaqir Fetait kur publikisht doli dhe tha: “po, unë jam ai tradhëtar që di fort mirë t'ia ngul mikut thikën pas shpine”!

Cila qenka ajo vlerë e Shaqir Fetait, i cili, prej një abdalli klasik pranoi të instalohet si “reis” duke ua përcjellë “të falat” e shërbimeve antiislame atyreve që do të duhej të grumbulloheshin tinëz dhe t'ia venë duvakun Shaqir Fetait!

Çfarë treni me vlera na qenka Shaqir Fetai dhe që po u ndalka nëpër stacione për t'i marrë vetëm ata që na qenkan në “rrugëtim të islamit”, ndërsa kopetë (“organet”) i kanë shndërruar në kupleraj! Në Shaqir Fetain “tren” mund të futet vetëm soji i tij pa gjakë e pa yndyrë!

Për ku po ngutet Shaqir Fetai pa treguar se çarë u bëri letrave me vlerë që ishin vakëf! Ku i shpenzoi, për çka i shpenzoi? Edhe tren edhe tugar! Edhe tren i shpejtë edhe po i del koha që ta blejë “shpejtësinë” e vet duke i korruptuar bashkëpunëtorët! Kush ia kërkoi me ngulm 400 mij

euro të donuar për BFI-në ndërsa ky arriti t'ia japë vetëm rreth 10 për qind prej tyre si dhe t'ia japë për ta menaxhuar tërë një aksion fetar? Me kë u konsultua, me kë e solli këtë vendim, në çka e bazoi këtë sjellje apo, thjesht, në nevojën e tij për ta mbushur trenin me qymyrgur! Po Shaqir Fetai e ka shumë të qartë se, vetë ai është po si ai treni lodër pa bateria, i cili nuk ka nevojë as për qymyrgur e as për energji elektrike!

Ku do të ikë ky farë treni i kalbur pa treguar se si u bë që makinën prj 17 mij euro me çmim regu, ta paguaj me faturë në vlerë prej më shumë se 30 mij euro për mikun e vet rijasetxhi!

Nuk ka tren në botë, madje edhe ai tren që i bie kah Zagrebi, që nuk e ka staconin e vet të fundit si dhe që nuk e ka “hangaren” ku futet për t’u kontrolluar a është teknkisht i gatshëm për rrugëtim të ri, a duhet të riparohen apo, është në derxhen e pavalershmërisë absolute e që duhet të hidhen për skrap! Shaqir Fetai, me gjasë, shumë shpejt do të përfundojë si lëndë skrap! Do ta mëshirojë Zoti e do ta bëjë ndryshk, sepse, një “hafëz” me të gjitha këto skandale e dreqnilëqe e të na shpërfytyrohet si “tren i shpejtë islamik”! Është një përpyetje e abdallit për t’u tallur me Zotin! Ka për të përfunduar skrap!/1KlikLarg/15.09.2022

## **Debati është eliminues i keqkuptimeve**

**Çdo mosmarrëveshje, çdo dilemë, çdo çështje në periudhën e Pejgamberit a.s. është zgjedhur publikisht, me debate konstruktive dhe me dëgjimin e të gjithë palëve! A nuk na e ka lënë i Dërguari i Zotit xh.sh. edhe këtë veprim si amanet! Pse e refuzojmë debatin? Pse nuk e kuptojmë si vlerë islame ndërkohë që është një prej postulateve kryesore që e zhvillon dhe e avancojnë jetën islame në çdo shoqëri**

### ***Nga Mulla Nazmi Jashari***

Mbi dyzet vite i kisha shërbyer islamit dhe myslimanëve të vendit tim. Natyrisht, me aq sa kam pasur kapacitete ndërkohë që, kurrë nuk pata më të voglin konflikt apo mosmarrëveshje me dikë prej xhematit tim. Në fund, u pensipova në katundin tim, në Ropalcë të Kumanovës.

Elhamdulillah, sot jam krenar dhe ballëlatë para të gjithë atyreve që u shërbeva, duke lartësuar bashkarisht fjalën e Allahut Fuqiplotë!

Koha e pensionimit tim është po ajo kur nisën problemet në Institucionin e vetëm islam në RMV, në Bashkësinë Fetare Islame! Kam pasur mjaft kohë që të analizoj një periudhë të caktuar të islamit në RMV dhe të bëj krahasime! Periudha 2006-2014 ka qenë një prej periudhave më të rënda për BFI-në por, në anën tjetër, edhe një prej periudhave më të lavdifshme të saj! Kjo, pa dyshim, falë një personi, ish-sekretarit të përgjithshëm të BFI-së, Afrim ef. Tahiri! Edhe sot e kësaj dite nuk e kam të qartë, kush u bë sebeb që të largohet nga puna Afrim efendi Tahiri, dhe kush mendoi se BFI-ja do të shtyhet edhe më mirë pa të!

Ne, hoxhallarët e vendit, e dimë se cila ishte atmosfera islame në kohën kur BFI e kishte Afrim ef. Tahirin! Ne e dimë fort mirë se cili ka qenë respekti dhe nderimi i Rijasetit karshi hoxhallarëve të vendit. Ne e dimë fort mirë se si mbrohej dinjiteti dhe integriteti i hoxhallarëve, se si lulëzonte dhe ngritej lartë e më lartë jeta fetare islame.

Ish-Reisu Ulema i BFI-së, Sulejman ef. Rexhepi, sot me dhimbje flet për faktin që ka pasur shumë kërkesa prej bashkëpunëtorëve të tij për ta larguar Afrim ef. Tahirin, dhe tashmë janë vërtetuar shumë herë se këto kërkesa paskan qenë të bashkëpunëtorëve të qarqeve antiislame të vendit e që nuk ia paskan dashur të mirën as BFI-së!

Afrim Tahiri për asnjë moment nuk rreshti së kritikuari drejtimin e dështuar të BFI-së dhe vazhdimisht ka kërkuar reforma në BFI! Ai ka dalur edhe me program, ka dalur edhe me projekt por ka dalur edhe me Platformë origjinale (të gjitha i ka publike) se si duhet të bëhet ajo reformë gjithëpërfshirëse në BFI!

Po del puna se në BFI më tepër paska pasur parazitë, “neutralë”, njerëz tërësisht pasivë se sa që paska pasur të intresuar dhe vizionarë për të ndryshuar diçka në BFI! A duhen ndryshimet? Natyrisht, tepër shumë! Por, në bazë të analizave po del se kjo strukturë e cila aktualisht po drejton BFI-në nuk ka interesimin për kah e mira dhe e mbara! Në mesin e tyre as nuk ka ekspertë, as nuk ka vizionarë dhe as që ka të interesuar, sepse, natyrisht që do t’u priset komoditeti.

BFI-në e kanë mbuluar skandale nga më të dhimbshmet, nga më të poshtrat dhe nga më antiislamet! Hoxhallarët tashmë po trajtohen si “pijavica” që po thithin gjakun e myslimanëve të vendit! Mbledhin fitra, zeqat, kurbanë, organizojnë haxh, për të pasur buxhet e për të blerë rehati paraziti nëpër poste të BFI-së!

Sot, Afrim Tahiri ka vendosur që mos të fle natë e ditë, me qëllim që t’i gjuajë dhe t’i zbardhë skandalet që po ndodhin “në emër të islamit” në BFI, kurse, Shaqir Fetai, edhe më tej, si në kohën e Sulejman ef. Rexhepit, frikësohet prej Afrim ef. Tahirit si prej “Azrailit”!

Për myslimanët e RMV-së fare nuk është me rëndësi posti i Shaqir Fetait, madje as vetë Shaqir Fetai, për këta myslimanë e rëndësishme është BFI-ja, është shumë i rëndësishëm fati i islamit në këtë nënqiell! Për hirë të kësaj, Shaqir Fetai, nëse nuk e ka atë inat të tij për të cilën u shkrua këto ditë, nëse është vetëm pak islamikisht i pastër, nëse e ka vetëm hall islamit e vendit, atëherë, duhet të ulet e ta sheshojë problemin me Afrim Tahirin dhe jo me ambasadorët e huaj në vendin tonë! Të mos ulen për të mirën e Afrim ef. Tahirit dhe as për të mirën e Shaqir Fetait, por ekskluzivisht për të mirën e BFI-së dhe të myslimanëve të vendit. Këtë zgjidhje të vetme ia pata kërkuar publikisht edhe ish-Reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit, i cili, edhe pse kishte qenë i gatshëm, pikërisht këta Shaqir Fetaha nuk e kishin lënë, duke i thënë se do të ishte tradhëti fatale për “bashkëpunëtorët” e tij!

Nëse Shaqir Fetai ka vendosur që ndonjë axhedë të huaj ta çojë deri në fund, Afrim Tahiri gjithashtu ka vendosur që mos t’i heshtë problemet, sepse janë sa të turpshme aq më shumë antiislame.

Shaqir Fetai nuk guxon të heshtë kur Afrim Tahiri ngre dyshime se letrat me vlerë, që i ka dhënë qeveria si formë e denacionalizimit të vakëfit, po harxhohen për rroga e për qejfe të bashkëpunëtorëve të Shaqir Fetait. Me heshtje ai nuk guxon të mendojë se mund t’i justifikojë këto veprime të turpshme.

Shaqir Fetai nuk guxon të heshtë nëse Afrim Tahiri ngre dyshime se disa nga nëpunësit e tij janë bërë “mbretër”, ia kanë arritur që prej fukarenjëve të bëhet “boss”-a, nuk guxon të heshtë as për ata nëpunës për të cilët po flitet se në katet vakëf të objektit që po ngritet te ish-Komunaleci në Shkup, kanë marrë pallate gratis! Në fakt, këtu nuk ka gratis asgjë, këtu, nëse është i vërtetë ky fakt, kemi të bëjmë vetëm me grabitje të vakëfit! Edhe hoxhallarë edhe grabitës të vakëfit? Këta pastaj t’i “mëshirojë” efendi Tahiri dhe mos t’i kritikojë?! Po të gjithë këta “melaqe të mullirit” pse nuk e kritikojnë Afrim Tahin, apo sepse nuk kanë absolutisht asnjë fakt!

Krejt në fund, Shaqir Fetai nuk guxon të heshtë nëse ka të vërteta në blerjen e makinës prej dhjetra mijëra euro për dekanin e FSHI-së në kundërshtim me ligjet e vendit!

Ja pse Shaqir Fetai urgjentisht duhet ta tejkalojë inatin e vet (dhe të atij “shoqit”) dhe të ulet me Afrim Tahirin, t’i ballafaqojnë të vërtetat dhe të shohin se ku po çalon puna. Monologjet e Shaqir Fetait, intervistat e tij të porositura e të paguara, janë bërë shumë të neveritshme dhe të gërditshme. Shaqir Fetai vetëm në debat publik përballë Afrim Tahirit, duk i shfletuar të gjitha faktet dhe argumentet, mund ta demantojë Afrim Tahirin dhe “ta pensionojë” para kohe!

Ndryshe, me monologje Shaqir Fetai vetëm sa do të mundohet t’i fshehë gjurmët e korrupsionit, të vjedhjes e të shkatërimin në BFI! Me këtë sjellje Shaqir Fetai kurrë nuk do të mund që t’i shleftësojë argumentet dhe faktet e Afrim ef. Tahirit!

Afrim Tahiri është zëri i fuqishëm i shumë hoxhallarëve të vendit, të cilët Shaqir Fetai nuk guxon t’i injorojë aq lehtë. Nëse edhe vetëm një hoxhë është jashtë skemave të Shaqir Fetait, ai nuk guxon të flasë as për “simbolin” e unitetit të myslimanëve dhe as nuk guxon të pretendojë se të gjithë “hoxhallarët” janë unikë. Sepse, me automatizëm do të dalë

rrrenc!/**IKlikLarg/Mileniumi3/19.09.2022**



## **Kush po i vjedh paratë e myslimanëve që i japin për rrymën e xhamive?!**

**Ministri i Ekonomisë pranë Qeverisë së RMV-së, Kreshnik Bekteshi, paska vendosur që t'i vizitojë edhe bashkësitë fetare dhe, prej tyre, si prej subjekteve që më së shumti po shpenzuakan rrymë në vend, të kërkojë ndihmë! Ndihma do të konsistojë në apelet e krerëve të BFI-së drejtuar besimtarëve të tyre që të reduktojnë për sa të jetë e mundur shpenzimin e energjisë elektrike. Të parin e vizitoi instalacionin e pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, Shaqir Fetain**

***Nga Jasir Jashari***

Po si iu përgjigj këtij halli qeveritar Shaqir Fetai? A ka më turp se sa për një “kryetar” të gënjejë e të mos dijë se çka po flet? Vërtet, pse ministria ekomomike paska konstatuar se BFI-ja (si dhe bashësitë e tjera fetare) qenka shpenzuesja e madhe e energjisë elektrike! Si po e shpenzuaka këtë energji ky Institucion? Si paska mundësi të jetë një prej borxhlinjëve më të mëdhenj në vend! Pse një fukarai, nëse nuk paguan rrymën, ia ndërpresin menjëherë, ndërsa Shaqir Fetait jo! Pse ta lënë të jetë një prej borxhlinjëve më të mëdhenj në vend!

A guxon një “kryetarë” të gënjejë kaq shumë, të bëjë një gafë të tillë e cila e nxjerr zbuluar si injorant total! Shaqir Fetai thotë: “Ne menjëherë do të apelojmë në të gjitha 700 e disa kryesi që kemi në RMV, në 13 myftinitë tona ku ato do të apelojnë tek të gjithë xhamitë e kështu me radhë që me të vërtetë të kenë kujdes...” Shaqir Fetai na i paska 700 e disa kryesi në 13 myftini"! Dhe, të gjitha këto “kryesi” do të kërkojnë prej xhamive “që me të vërtetë mos të shpenzojnë kaq shumë të kenë kujdes”!

Shaqir Fetai tallet edhe me ministrin! Shaqir Fetai tallet edhe me institucionet e shtetit, tallet sepse ka përkrahjen e subjekteve që nuk pyesin as për qeveri e as për institucione maqedonase! Shaqir Fetai nuk do të kërkojë prej imamlerëve, prej hoxhallarëve të xhamive që mos të shpenzojnë pa nevojë energji elektrike por do të kërkojë direkt prej xhamive!!! Po, është më se e vërtetë se në pjesën dërmuese të xhamive shpenzohet energjia elektrike natë e ditë. Madje si verës ashtu edhe dimrit, bile dimrit edhe më shumë, madje nuk do të ndërpritet ky konsumim sikur edhe brirët t'i dalin Shaqir Fetait, jo se ia bën dikush me inat, porse, sepse është nevojë jetike për çdo xhemat ngrohja apo freskimi në xhami, siç është nevojë për administratorët, digasteret, ministritë, rrymen e të cilëve e paguajnë qytetarët me taksat e tyre!

Janë të pakta ato xhami që nuk e kanë komoditetin që gjatë verës të freskohen prej dy-tre klimave! Janë të paktën ato xhami që nuk kanë rrjete elektrike nën tepih e nën sexhade për t'u ngrohur xhemati brenda xhamisë! Shaqir Fetai rrenë kur thotë se xhamitë tona nuk konsumojnë energji as një orë, ndërsa thotë se 5 minuta para namazit lëshohet nxemja, dhe ndalet dhjetë minuta pas namazit. Do me thënë 15 minuta brenda një kohe namazi: pesë kohë nga 15 minuta 1 orë e 15 minuta!

Po kujt ia tregojn këtë gënjeshtër Shaqir Fetai?! Ministrit Kreshnik Bekteshit? Cila xhami mund të ngrohet për 5 minuta dhe, kujt i duhet ajo ngrohje 10 minuta pasi të jetë përfunduar namazi kur kanë dalur xhemati nga xhamia? Po mektebet a duhet të harxhojnë? Po kohëve kur të ketë ligjeratë fetare a nuk duhet që xhamitë të jenë më të ngrohta (dimrit) apo më të freskëta (verës)? Kurse Shaqir Fetai, duke gënjyer publikisht, thotë: “Sa i përket kursimit të rrymës nëpër xhami, në 24 orë objektet fetare harxhojnë shumë pak sepse këtë e kanë obligim fetar”.

Tani po rrenë Shaqir Fetai apo Kreshnik Bekteshi? Njëri, po!

Për myslimanët e vendit nuk ka rëndësi se kush po gënjen në rastin konkret! Ai që ka hall, në rastin konkret Kreshnik Bekteshi, nuk mund të gënjejë. Gënjenë vetëm ai që e ka mizën nën kapuç (siç e ka Shaqir Fetai)!

Gati në çdo të premte, pasi të falet namazi i xhumasë, pothuajse në të gjitha xhamitë e vendit (me theks të veçantë në qytete), shtrohet hastra dhe mutevelinjë mbledhin para për të paguar ujin, rrymën dhe plehërat e xhamisë! Verë e dimër imami apelon pas çdo xhumaje që myslimanët të bëjnë gajret dhe të ndihmojnë për detyrimet e xhamisë që i ka ndaj institucioneve shtetërore! Pa dyshim që, nga shuma e përgjithshme e mbledhur në xhuma, i bie mesatarisht për çdo xhami të vendit nga 300-500 euro! Muaji i ka katër xhuma dhe, paramendoni se sa para mbliidhen prej një xhamie gjatë një muaji! Atëherë, ku po shkojnë këto para që nuk po ia dalim t'i shlyejmë borxhet dhe të ngelim përherë borxhliu më i madh i vendit ndaj institucioneve që na furnizojnë me ujë e me rrymë?

Ky duhet të jetë problemi më i madhë që duhet ta shqetësojë Shaqir Fetain dhe jo problemi i Kreshnik Bekteshit! Shaqir Fetai duhet të dorëhiqet menjëherë dhe jo të bëjë ekzibicione duke u munduar të gënjejë se paskemi nja “700 kryesi në 13 myftini” dhe se këto do të mbajën çdo javë ligjerata që mos të harxhojnë rrymë! Shaqir Fetai e di fort mirë se sa rrymë harxhojnë xhamitë tona, por, ajo që nuk po e “ditka” na qenka problemi se pse xhamitë tona edhe më tej qenkan konsumuese më të mëdha si dhe borxhlinjë më të mëdha në vend! “Nuk po e ditka” as atë se ku shkojnë paratë që mbliidhen për çdo xhuma? Nëse nuk i di këto fakte, atëherë, le të ecë se na turpëroi deri në palcë.

Shaqir Fetai ka gjithnjë e më pak fitra e zeqat, ka gjithnjë e më pak kurbanë, Shaqir Fetait po i vidhet para syve vakëfi! Në tërë këtë dëm, kontribuon me vullnet të madh edhe vetë Shaqir Fetai: Ai organizon manifestime të ndryshme “fetare” nëpër salla elitare dhe, shtrohet një pyetje: meqë qenkan fetare, pse nuk i organizon nëpër objekte fetare, pa kurrfarë shpenzimi?

Ai organizon simpoziume, promovime, “e komedirash” të kësaj natyre nëpër salla konferencash super të shtrenjta dhe jo nëpër objektet e institucioneve arsimore që i ka! Apo, ka marrëveshje për t'i promovuar mundësitë për konferenca që i ofrojnë hotelet, resortet e restorantet luksoze të vendit!

Ai me nëpunësit e vet organizon simpoziume treditore jo në ndonjë sallë të Fakultetit, të Medresesë, apo në ndonjë hapësirë vakufore të përshtatshme për simpoziume të tilla, por i merr ato më të shtrenjtat, me asnjë standart të hallallit, me “qendra spa” e me kushte ekskluzivisht rinore për ata shtresa të shturura dhe, vendos që aty t'i fusë imamlerët! Po kush i mbulon këto shpenzime? Po kush e vendosi që aktivitetet e tilla “rinore” të mbahen nëpër objekte të tilla pa e ditur çmimin për person? Në cilën mbledhje me mexhlise të xhemateve u soll një vendim i tillë, cili propozim flet për formimin e komisionit i cili ka për obligim që të shqyrtojë tre oferta për kushte paksa më “myslimane” ku do të mbahet një aktivitet i tillë! Nëse Shaqir Fetai na e paska dert mos të shpenzojnë për energji elektrike, pse nuk e ka dert këtë shpenzim për gjëra luksoze të cilat i paguajnë me paratë e myslimanëve që i ndajnë nga kafshata e gojës “për islamin” e Shaqir Fetait dhe të pataricës së tij, Qenan Ismailit? Apo nuk ia çokë njeri Shaqir Fetait!

E ky, i gjendur si qura në mjegull, “detyrohet” publikisht të gënjejë kështu: “Ne nëpër xhamitë tona duke e ditur se harxhohet ndonjëherë rrymë e madhe, ne shkojmë vetëm aty ku ka nevojë p.sh. një pjesë e xhamisë nxehet edhe atë e bëjmë në mënyrë automatike që ajo të ndizet 5 minuta para kryerjes së lutjes deri 10 minuta pas kryerjes së lutjeve nëpër xhami. Kur do ta organizojmë si duhet as 1 orë nuk do të harxhohet nëpër objektet fetare energji elektrike”!

A nuk është ky mendim i Shaqir Fetait që flet për të si për një person totalisht të gabuar, në vend të gabuar e në kohë të gabuar! Na bëri gaz i botës!

Dhe, qershia mbi tortë vjen kur Shaqir Fetai thotë: “Gjithashtu xhamitë harxhojnë pak energji elektrike për shkak se faturat e xhamive paguhen nga vetë besimtarët!” Ja çfarë lolo ka vizituar ministri i nderuar, Kreshnik Bekteshi!/**Fakte/20.09.2022**

## **Mediokri në konferencë**

**Shaqir Fetai po na udhëtuaka për në Kajro! Jo për të shprehur kërkesë që ta inspektoj në një “fakultet” nga i cili po na vinë kuadro gjysmakë e pseudo-teologë duke thënë se kanë studiuar në Kajro (por duke mos treguar se cili është ai fakultet që për 18 muaj të jep diplomën e studimeve katërvjeçare)! Nuk po shkon në Kajro Shaqir Fetai as për ta dërguar të barasvlefshme programin e Medresesë me programet përkatëse të Ez herit për ç’gjë tash e dy vite rresht medresantët tanë nuk po arrijnë të regjistrohen në këtë Universitet botëror. Shaqir Fetai po shkon në Kajro sepse, si i mjerë, ka nevojë për disa fotografi në fakir-albumin e tij “ndërkombëtare”**

## ***Nga Sadbere Zendeli***

Në një informacion paçavurë që tregon se Shaqir Fetai do të shkuaka në Kajro për të marrur pjesë në një konferencë fetaro-shkencore, veç tjerash thuhet: “Është rast i mirë për afirmimin e BFI në nivel ndërkombëtarë...”! Informacioni na ilustron me portretin e Shaqir Fetait kërrusur mbi tavolinë në rolin e nekrologut!

Jo njëherë është konstatuar se nuk ka më cinik, më narcis dhe më abdall se Shaqir Fetai, i cili mendon se, ra ky e BFI-ja do të njihet ndërkombëtarisht! A ka punuar ky në BFI apo, singerisht me trup ka qenë në këtë Institucion e me tru dhe shpirt ka qenë në UDB! A ka përcjellë aktivitete të BFI-së, apo jo? A ka ditur ndonjëherë se çka po ndodhë në BFI, apo tërë kohës ka bredhur si qurat në mjegull? Përmes Shaqir Fetait BFI-ja duhet të fitojë nga rasti dhe të afirmohet në botë! Por, a e di Shaqir Fetai se, BFI-ja, si Institucion me relevancë botërore, më në krye Reisul Ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepi, ka qenë e pranuar ndërkombëtarisht që në momentin kur në dyert e këtij Institucioni kanë hyrë lloj-lloj burrshtetas si dhe udhëheqës të institucioneve botërore me shumë relevancë!

A e di Shaqir Fetai se kur BFI-ja dridhte instanca ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e shqitarëve në Maqedoni e në Kosovë, Shaqir Fetai mund të ketë qenë duke u luhatur në prerin e Temellko Boshkovskit!

A e di Shaqir Fetai, për shembull se:

Më vitin 1993 BFI-ja bëhet anëtare e rregullt e Kuvendit të lartë për çështje islame me seli në Kajro;

Më vitin 1995 BFI-ja bëhet anëtare e rregullt e Kongresit botëror Islam me seli në Tripoli;

Më vitin 1997 BFI-ja bëhet anëtare e rregullt e Unionit Islamik për Evropën;

Më vitin 1997 BFI-ja merr pjesë në themelimin e Shurës Euro Aziatike me seli në Ankara, ku Reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi zgjidhet zëvendës i sekretarit gjeneral.

Më vitin 1998 BFI-ja merr pjesë në themelimin e Kuvendit të Këshillit për Evropën Lindore me seli në Stamboll, ku Reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi zgjidhet zëvendës i sekretarit gjeneral.;

Më vitin 1999 BFI-ja bëhet anëtare e rregullt e Forumit të shkencëtarëve Islam me seli në Rabat; Reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, me dinjitet të plotë e ka afirmuar, e ka prezantuar dhe e ka shndërruar BFI-në në faktor me relevancë të paimagjinueshme për trurin e atrofizuar të Shaqir Fetait, duke marrur pjesë si i ftuar i patejkalueshëm në:

Konferencën e Kuvendit të përgjithshëm për çështje islamike, Aleksandri, Egjipt, 1994;  
Konferencën ndërkombëtare për Ballkanin, Stamboll, 1994;  
Kongresin e muslimaneve të Evropës, Basel, 1995;  
Kongresin ndërkombëtar të intelektualëve myslimanë organizuar nga Universiteti “Al el Bejt”, Jordan, 1998;  
Konferencën Botërore Islame për Dialog, Mekë, 2008;  
Kongresin për çështje islame, Kajro, 2008;  
Takimin e Shurës Islame të Shteteve Euro-Aziateke, Stamboll, 2009;  
Kongresin botëror Islam, 2009;  
Konferencën botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivilizues, Ohër, 2010;  
Konferencën e Këshillit të Lartë për Çështje Islame, Kajro, 2010;  
Takimin e Liderëve Myslimanë të Ballkanit, Shkup, 2011;  
Konferencën Muslimane, në Sofja, 2011;  
Konferencën ndërkombëtare, “Konfrontimi i ekstremizmit dhe terrorizmit”, Kajro, 2014;  
Takimin e Shuras Euro-Aziateke, Bruksel-Belgjikë, 2014;  
Konferencën shkencorë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, “Religjioni dhe dhuna”, 2015;  
Samitin Rajonal për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, Tiranë, 2015;  
Takimin e Shurës Islame të Shteteve Euro-Aziateke Tetore, Stamboll, 2016;  
Konferencën ndërkombëtare mbi diversitetin, organizuar nga Ez’heri Sherifi me temë: Temë boshte ishte “Liria, atdhetaria, diversiteti dhe integritet”, Egjipt, 2017  
Konferencën ndërkombëtare në Nju Jork, nën organizimin e Rabita Alemu Islamije me moton “Vijëmësia e lidhjeve midis SHBA-ve dhe Botës Islame”, 2017;  
Konferencën ndërkombëtare, organizuar nga Liga Botërore Islame me temë “Uniteti i muslimanëve – rreziku i frakcionimeve të ndryshme dhe ndarësitë”, Mekke, 2018.  
Janë këto vetëm një numër eventesh ku ka prezantuar BFI-ja për periudhën kur Shaqir Fetai, me gjasë, nuk paska qenë në tokë të bukës, ndaj dhe sot mendon se me instalimin e tij BFI-së po i hapen dyert e botës!  
Shaqir Fetai është mosmirënjohës, është i vetëbënisur dhe i është rrasur mendj se historia e këtij Institucioni fillon që nga momenti i instalimit të tij nga qarqet antiislame në krye të BFI-së pas një tradhëtie dhe komploti perfekt që e realizoi mbi Institucionin gjashtë shekullor si dhe mbi “babain shpirtëror” të tij!  
Edhe diçka! Me sa e dimë në administratën e BFI-së punon i vetmi kuadër që vjen nga El Az’heri i Kajros dhe ky është z. Jusuf Zimeri! Sikur ky që mund ta njohë Kajron, Universitetin si dhe Gjuhën arabe, nuk mund ta njohë shoqërsin e tij të cilin Shaqir Fetai e prezanton si “linku me botën arabe”, Ismet Ademi! Shaqir Fetai mendon se vetëm ai mund ta dijë se pse pikërisht e merr me vete Ismet Ademin dhe se, të tjerët, nuk e dinë! E dinë, e dinë shumë faktorë se pse Shaqir Fetai i shëtisin b... bashk me Ismet Ademin nëpër “Arabi”! Thjesht, Shaqir Fetain nuk e njeh askush, (mund ta njohin vetëm si “ORAO”) kurse Ismet Ademin e njohin disa “shërbime arabe”, të cilët, pa dyshim që nuk mund ta honësin profesor Jusuf Zimerin!  
Me shëtitjet memece të Shaqir Fetait nëpër botë, BFI-ja edhe atë autoritet të pakontestueshëm që e kishte, po e humb gjithnjë e më shumë!  
H. Sulejman ef. Rexhepi asnjëherë nuk kthehej nga shtetet turko-arabe pa siguruar kuota regjistrimi për medresantët tan nëpër universitete të ndryshme, madje u siguronte edhe bursa, me theks të veçantë në Univrstitetin e Az’harit, në Kajro, ku tash e dy vite Shaqir Fetait nuk ia njohin diplomat e Medresesë, sepse nuk di injoranti se si t’i bëjë ekuivalent programet mësimore profesionale me programet përkatëse të pranueshme nga ky Universitet! Ndërkohë që lidhë

kastraveca me “studentë” që po kryekan “sudime katërvjeçare” në afat rekord (më pak se dy vjet) në një “universitet” që u rras duke shitur diploma! Të tillë kuadro i duhen Shaqir Fetait, sepse, vetëm në mesin e tyre ai mund të krrrekoset si ai gjeli në maje të plehut!/**Kombetare/22.09.2022**

## Shaqir Fetai gjerman

Kohë më parë, Shaqir Fetai paska pritur në zyrën e uzurpuar të Kryetarit të BFI-së, një teolog nga Shkupi që jeton dhe vepron në Hamburg të Gjermanisë. Gjithçka në regull nëse Shaqir Fetai nuk do të niste ta luajë “gjermanin”, apo atë dylberin që prezantohet “unë nuk jam nga këtu”! E pret njeriun e respektuar, ndërkohë që, akoma nuk është penduar nga ajo që ishte i përfshirë në trillime, që ka përfolur apo ka lejuar të flitet për mysafirin në kohën kur Shaqir Fetai ishte anëtarë i Mexhllisit Shura, apo edhe anëtarë i Rijasetit! Për personalitetin në fjalë janë thënë lloj-lloj shpifjesh të cilave Shaqir Fetai u ka buzëqeshur si debill dhe kurrë nuk ka kundërshtuar për ta mbrojtur dinjtetin e teologut nga Hamburgu! Dhe, sakaq, e pret në zyre duke i thurur elozhe! Ja edhe jë hipokrizi e Shaqir Fetait!

Megjithatë, Shaqir Fetai ka nevojë për ta manipuluar hoxhën e respektuar! Dëshiron që t’i shpërfytyrohet në “gjerman”! Shaqir Fetai vdes që të tregohet pak gjerman, në kuptimin kohor dhe jo gjenetik. Ai vdes të përfaqësojë qeverinë, popullin gjerman. Të jetë më i madhi i gjermanëve. Këtë kompleks ai shpreh përmes fjalisë: “Me këtë rast, Reisul Ulemaja në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV e falënderoi për punën e madhe që ka bërë në Gjermani dhe që vazhdon të bëjë dhe në shenjë respekti i ndau mirënjohje dhe Letërnjoftimin më të ri të BFI e RMV”!

Shaqir Fetai e falënderon hoxhën e nderuar për kontributin që po e jep në Gjermani!!! Po pse ta falënderojë Shaqir Fetai kur këtë mund ta bëjë Hansi, apo Myleri, apo, pse jo, Merkeli! Paramendoni kur një ditë ta gjejë një hoxhë që jeton dhe vepron në Amerikë dhe, të njëjtit pastaj t’i shpreh mirënjohje për kontributin e tij në Amerikë. Sa mend ka Shaqir Fetai i hy punës për ta gjetur edhe ndonjë hoxhë nga Rusia dhe ta falënderojë e t’i japë mirënjohje për kontributin e tij që po e jep në Rusi!

Allahu e di se ç’ç duket vetja? Ndonjë Guteresh apo Butros Butros Gali!

Po çka ishte një fjali tjetër?! Ia paska dhuruar Letërnjoftimin më të ri të BFI-së?! Letërnjoftimi, si dokument, më i riu, bëhet vetëm nëse ke ndërruar adresë, emër, apo mbiemër! Epo, cili na qenka ky “letërnjohim i ri i BFI-së”? Për dallim prej të vjetrit, mund të thuhet se tani, kemi një BFI me në krye “ORAO”-n e instaluar nga shërbimet recidiviste të UDB-së, dhe të shkatërruar deri në themel, pa kurrfarë identiteti dhe pa kurrfarë integriteti!

A i kujtohet Shaqir Fetait kur i nisi hapat e para në BFI? Kush ishte kryesia? Me kë drejtonte H. Sulejman ef. Rexhepi? Me Hafëz Idriz Selamin dhe Hafëz Rexhep Nuredinin që i kishin nja 100-200 hoxhallarë mbapa! Me Hafëz Zenun Berishën, Jakup Selimovskin, Isa Ismailin, Bahri Aliun, Ruzhdi Latën, Alifekri Esati që ishin tmerri i intrigantëve kudo që mundoheshin të ngrisin kokë! Dhe, prej më të rinjëve, Afrim Tahirit, të cilin BFI-ja historikisht do ta njohë si drejtuesin që nuk i shmangej për asnjë shkronjë Kushtetuës dhe tërë rregullativës së BFI-së! Para këtyre personaliteteve të nënvizuar më sipër, sa herë që paraqitej Shaqir Fetai, ua ngacmonte nervat dhe i bënte nervoz me sjelljet e tij servile dhe me të folmën e tij prej hipokriti. Gjithnjë dhe për çdo gjë u thoshte: “edhe unë jam me ju”! Sepse ishte pa personalitet, ishte pa integritet, ndaj dhe, si i tillë, gjithnjë i refuzuar, i përçmuar e i urreyer! Si duket, duke qenën nën presion të këtij kompleksi, Shaqir Fetai do të pranojë çdo veprim mbi të, do të pranojë çdo plan me të, do të pranojë çdo detyrë, qoftë edhe imorale, vetëm e vtëm që “t’u bëhet një ditë reis”! Ai mund të bëhet edhe “Kapetan Leshi” por njeri, jo! Aq më pak gjerman apo “françuz”!/1KlikLarg/23.09.2022

## **Dështimet nuk mund të mbulohen me rrena e vetëkënaqësi**

### **Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI**

Këto ditë, Muftinia e Gostivar paska mbajtur mbledhjen e tretë për këtë vit (!!!) në të cilën “myftiu” i Shaqir Fetait i paska njohtuar anëtarët e Myftinisë me “të gjitha rezultatet dhe aktivitetet e periudhës së Ramazanit, Haxhit dhe Kurban Bajramit: Sadekatul Fitrit dhe Zekatin, Haxhin si dhe Kurbanët dhe ndarjen e mishit të kurbanëve”. Dhe, paramendoni, tërë ky prezantim bëhet para instalacionit të qarqeve antiislame në krye të BFI-së, Shaqir Fetait, i cili, veç të tjerash paska vlerësuar tejmasë punën e Muftinisë së Gostivarit “për këto të arritura gjatë vitit 2022 në periudhën nëntë mujore” dhe se kjo Myftini “në vazhdimësi edhe më mirë po jep rezultate të mira në nivel të lartë”!!!

Gjithçka paska shkuar si në tëlynë, ë! Po pse këto suksese nuk prezantohen para Rijasetit por vetëm brenda myftinisë! Pse Shaqir Fetai nuk ua mundëson myftive përballjen në mes vete dhe të diskutohet se si një myftini mund të jetë e suksesshme e tjetra jo!

Për çfarë suksesi flet Shaqir Fetai ndërsa nuk e paraqet numrin e saktë të nxënësve të paraqitura në vitin e parë në paralelen e medresesë për vajza në Gostivar? Ku është suksesi këtu kur kemi vetëm tri nxënës? Dhe tani për vetëm tri nxënës do të mbahen në punë 10-15 profesorë e personel teknik, të cilët do të duhet të paguhen nga dikush! Si do ta arsyetojë këtë dështim para myslimanëve Shaqir Fetai dhe “myftiu” i tij?

A e di Shaqir Fetai se në mbledhjen e 25 marsit të Rijasetit të tij, mbledhje kjo e fundit deri më sot, veç tjerash ka sjellë edhe këtë konkluzë: (pika 8) “Dhënia e Sadekatul fitrit është obligative të jepen ekskluzivisht në fondin e Medreseve dhe në këtë vit me qëllim të transparencës do të publikohen në faqen e BFI e RMV”!

Pse nuk i publikon emrat e këtyre kontribuesve? Sepse është mashtrues ordiner! Sepse është manipulant i rehur! Sepse, natyrisht që do t’i dalë në shesh dështimi flagrant!

T’ia paguajnë kontributet Shaqir Fetait që ky pastaj, të pallohet në dreka e darka?

T’ia paguajnë kontributet ktij farë të pangopshmi që ky pastaj të blejë përkrashje e rehati duke i korruptuar “rebelët” e BFI-së?

T’ia paguajnë ktij farë të babzitura që ky pastaj të vjedhë duke blerë vetura me çmimin dy fishë më të madh se sa çmimi real i tregut?

Pa dyshim, një ditë edhe Myftinia e Gostivarit do të duhet të ofrojë fakte për të gjitha ato “suksese kaq të mahnitshme” dhe, do të japë llogari për çdo mashtrim e dështim! Përpjekjet për ta demantuar Shaqir Fetain do të jenë shumë të vonshme!

Suksesi i kësaj Myftinie do të startojë vetëm me zbulimin e arsyes së vërtetë mbi atë se pse Shaqir Fetai i dëboi investitorët arabë nga Gostivari ku kishin vendosur, mu në qendër të qytetit, të ngrisin objekt disa milionëshe që do të ngelte vakëf i kësaj Myftinie!

Me rrena dhe me vetëkënaqësi nuk mund të mbulohen dështimet! Shaqir Fetai është tepër “jeshil” për të ardhur deri te suksesi dhe për ta kuptuar suksesin, por ama është shumë i pjekur për dallavere, për vjedhje, për mashtrime e për tradhëti? /1KlikLarg/Opinione/24.09.2022



## **Cili është borxhi i EVN-së ndaj BFI-së?**

**Dështoi premtimi i Shaqir Fetait që ia dha ministrit të ekonomisë, Kreshnik Bekteshit se, duke filluar nga kjo xhuma, në të gjitha xhamitë (mbi 700 të tilla) në Maqedoninë e Veriut do të flitet për kursimin e rrymës elektrike gjë që, sipas Shaqir Fetait, na qenka edhe “porosi islame”! Nuk ka raporte prej asnjë xhamie në vend se në xhumanë e fundit, ndonjë imam ka folur për këtë çështje, sepse pa dyshim që i kanë nja një milion çështjesh të tjera prioritare**

### ***Nga Mr. Eset Shaqiri***

Në mënyrë shumë naive, instalacioni i dhunshëm në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, gjatë një takimi me përfaqësuesin e qeverisë së vendit, mori rolin e inkasantit të rrymës, duke u shndërruar vullnetarisht në propagues dhe mbrojtës të interesave të EVN-së! Për këtë shërbim edhe mund të paguhet! Një Zot e di! Jemi në të tjera kushte tregu!

Shaqir Fetai pranoi se BFI-ja me xhamitë dhe institucionet e veta qenka ndër borxhlinjtë më të mëdhenj të EVN-së. Pra, me një fjalë, xhamitë nuk guxojnë të shpenzojnë kaq shumë energji elektrike! Po çka nëse vazhdojnë të shpenzojnë njësoj? Do t’ua vëmë dryrin? Po edhe nëse harxhojnë kaq shumë, a mos po e prekin buxhetin e shtetit, apo, deri në qindarkën e fundit paguhet nga vetë xhemati! Xhemati ka vendosur që gjatë faljes së vakteve, apo gjatë dëgjimit të ligjeratave fetare, vazh-nasihateve apo edhe mektebeve, ato t’i kryej ose duke u ngrohur ose duke u freskuar dhe, për këtë “lluks” ata janë në gjendje për të paguar pa bërë asnjë fjalë! Dhe, pa dyshim që kanë paguar, madje, nëpër disa xhami (që janë shumë) brenda një apo dy xhumave janë mbledhur paratë për një vit pagesë të rrymës, aq sa mund të harxhojnë ato xhami! Është problem tjetër pastaj fakti se ku përfundojnë ato para! Shaqir Fetai duhet ta ketë të qartë si Zotin që është Një se, paratë për rrymë, ujë e plehëra, mbledhen, madje edhe tejkalohen! Ky duhet të jetë problem për Shaqir Fetain, dhe jo shpenzimi i rrymës së EVN-së, e cila është e obliguar që ta furnizojë çdo qytetar të vendit me rrymë, pavarësisht çmimit dhe kostove të tjera!

Ku po treten paratë e xhematit me dedikim! Kush po i ha e kush po i vjedh ato para që xhemati, për çdo xhuma, i jep për nevoja të xhamive e të institucioneve të tjera (për rrymë, ujë...) Ky është problem për një analizë të gjërë e të thuktë, i cili, për rrjedhojë, do të shkaktonte nevojën urgjente për një reformë të thellë në këtë aspekt!

Shaqir Fetai, para se të shndërrohet në inkasant të EVN-së dhe në propagues vullnetar të kësaj korporate, duhet të dijë edhe një fakt: a mos është kjo trysni e EVN-së sa për t’i ikur borxhit të saj që e ka ndaj BFI-së?!

Vite më parë, diku 2007-2008, EVN-ja tentoi që t’i bëjë trysni BFI-së dhe ta paraqesë edhe atëherë “si borxhli më të madh në vend” dhe si shpenzuese e rrymës industriale! Megjithatë, atëherë pati persona që me vetëmohim mbronin interesat e BFI-së! Sekretari Gjeneral, H. Afrim ef. Tahiri, i inspektoi të gjitha xhamitë në vend dhe, doli me konstatim se, borxhi i EVN-së ndaj BFI-së është disa herë më i madh se sa borxhi i BFI-së ndaj EVN-së që atëbotë vlerësohej diku rreth 100 mij euro!

Pasi ua prezantoi faktet Afrim Tahiri përfaqësuesve të EVN-së, pasi i bindi se janë borxhlinj të mëdhenj ndaj BFI-së, ata pranuan që xhamitë të mos paguajnë më sipas tarifës “rrymë industriale”! Veç kësaj, EVN-ja u bë edhe “babadimri” i BFI-së, duke dhuruar pako humanitare

para çdo viti të ri! Nga ana tjetër, do të nisë edhe një komplot çuditërisht “i fshehur” kundër H. Afrim ef. Tahirit, i cili këmbëngulte në mbrojtjen e interesave të BFI-së e jo të EVN-së! Në çka bazohej ky “konflikt energjetik”? A e di Shaqir Fetai se, në arkivin e Institucionit duhet të jetë raporti i Afrim ef. Tahirit pas inspektimit të të gjitha xhamive në vend! Raporti flet për mbi 50 xhami brenda oborrit të të cilëve ka trafostacione të rrymës elektrike! Edhe vendi i atyre trafove duhet të përfshihet në procesin e decentralizimit të pronës së vakëfit! Shteti dikur i mori pa pyetur dhe, nuk mund që me automatizëm të kalojnë në pronësi të një korporate private! Po kaq trafostacione janë edhe jashtë avllive të xhamive por që janë fare pranë ose përreth! Ekziston Lista e xhamive me emër e mbiemër të cilët rrezikohen nga prezenca fizike e këtyre trafostacioneve, për të cilat nuk paguhet kurrfarë qeraje! Shaqir Fetai bën mirë që takimet me faktorët relevant të vendit t’i shfrytëzojë për të ndikuar te EVN-ja për këtë përvetësim të vkëfit të BFI-së dhe, jo abdalli vullnetarisht të shndërrohet në inkasant si dhe në propagues naiv i EVN-së! Asgjë nuk i ka borxh BFI-ja EVN-së sa i ka kjo borxh BFI-së! Ia ka borxh tokën ku i ka ngritur trafostacionet si dhe sigurinë fizike të xhamive nga ndonjë avari prej këtyre trafove që hasen madje edhe nëpër oborre të xhamive që paraqesin vlerë kulturo-historike si dhe të trashëgimisë kulturo-fetare! Kur Shaqir Fetai do të bëhet një herë në jetën e vet mbrojtës i interesave të BFI-së!/**TetovaSot/25.09.2022**

## **Si festohet sukcesi i huaj**

**Edhe një herë i vetëashtuquajturi “kryetar i BFI-së, Shaqir Fetai, paska vendosur që të “lulohet” me sukseset e huaja, si zakonisht deri më sot! Paska vendosur që të shesë kopalla në një konferencë shkencore kushtuar Revesitës “Hëna e Re” për të cilën nuk e ka as më të voglën meritë!**

### ***Nga Shaban Aziri***

Këto ditë, me iniciativë skuthi të Shaqir Fetait do t’u mbakëka një konferencë shkencore me rastin e 35 vjetorit të funksionimit të Revistës “Hëna e Re”, ndërsa ata që e themeluan, që e mbajtën gjallë, që i dhanë fizioniminë e qartë, që e bënë me emër dhe të citueshme madje dhe nëpër studime shkencore, nuk marrin pjesë në konferencë, ndonëse të gjithë këta aktorë janë akoma gjallë! Ku di Shaqir Fetai se cilat ishin sfidat e tyre, ku e di Shaqir Fetai se nëpër çfarë kaluan ata që e mbajtën mbi kurrizin e vet “Hënën e Re”!

Më sa kam kuptuar, themeluesi i “Hënës së Re” (në shqip), reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, nuk është ftuar për të folur se si e ndau “Hënën e Re” nga revista periodike që dilte në tre gjuhë (shqip, maqedonisht, turqisht) duke e bërë revistë mujore në gjuhën shqipe! Shaqir Fetai nuk e di se kjo ndarje ishte projekt, se dikush e nxiti këtë projekt te efendi Rexhepi, se dikush hasi në përkrahje të parezervë te ef. Rexhepi për ta shtyrë projektin në fjalë deri në ditët e sotme!

Ndoshta mund të jenë ftuar figura dhe persona të ndryshëm të cilët kanë dhënë kontribut me bashkëpunimin e tyre në këtë Revistë, por ama, bartësit e këtij projekti, zhvilluesit dhe ata që i dhanë mish e shpirtë këtij projekti, nuk janë ftuar! Kësisoj, Shaqir Fetai mendon se, në mungesë të tyre, më lehtë e ka t’ua vjedhë mundin, djersën dhe kontributin e tyre, duke i varur si xhingla-mingla rreth qafës së vet dhe duke u krekosur se “ja, ja, çfarë po bëjmë ne”!

Unë, autori i këtij teksti, kam qenë më së paku nja dhjetë vite kryeredaktor i Revistës “Hana e Re” dhe, përkundër këtij fakti të pamohueshëm, ja që nuk jam i ftuar në atë konferencë në të cilën, më kompetent se unë për të folur për këtë revistë, nuk mund të jetë asnjë i pranishëm aty! Të gjithë mund të flasin për rolin e revistës nëpër sfera të ndryshme, të gjithë mund të flasin për kontributin e madh të revistës, të gjithë mund të flasin për revistën si për një dritare prej nga depërtonin rrezet e diellit duke hedhur dritë mbi mendimin shkencor e fetar që po kultivohej në gjitha trevat shqiptare! Mund të flitet për konceptin por ama jo edhe për politikën redaktuese dhe as për sfidat nëpër të cilat kaloi Revista!

Nuk është i ftuar Agim Mehmeti? Po a e di Shaqir Fetai se pikërisht Agim Mehmeti i ka rregulluar dhe i ka redaktuar shkrimet e tij duke i përshtatur për t’i botuar në “Hënën e Re”! Nuk është ftuar as Ajten Vllasaku, redaktore e shtojcës “Gruaja myslimane” që botohej në kuadër të Revistës! Nuk është i ftuar Avni Halimi! A ka kuptim një konferencë shkencore kushtuar “Hënës së Re”, ndërsa aty nuk është i ftuar të flasë Avni Halimi! Krijues i konceptit të mirëfilltë të “Hënës së Re”, si revistë shkencore, fetare, kulurore, kështu siç del edhe sot e kësaj dite!

Ne jemi ata që, me përkrahjen dhe me insistimin e Reisul Ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit, për opinioin tonë e pasqyruam luftën që u zhvillua në Bosnjë-Hercegovinë si dhe në Kosovë, me

çrast, për të qenë sa më pranë refugjatëve nga Kosova në kohë lufte, e shpeshtuam daljen dhe e bëmë dyjavore!

Ku guxon të flasë Shaqir Fetai në mungesë të Abaz ef. Islamit, i cili, si kryeredaktor i Revistës, denjësisht e vazhdoi këtë praktikë, duke dhënë një kontribut të pamohueshëm në tërheqjen e teologëve të vendit dhe jo vetëm për të publikuar shkrimet e tyre në “Hënën e Re”! A e di Shaqir Fetai se në Revistën “Hëna e Re” janë publikuar intervista e biseda zhvilluar me personalitete të ndryshme të vendit e ndërkombëtar! Cilët nga personalitetet me relevancë pranon të flasë për një media nëse paraprakisht nuk është i informuar për ndikimin e saj të fuqishme? Shaqir Fetai mund të flasë vetëm për një fakt: si ia ka dalur të jetë sabotues i suksesshëm dhe mashtgues për refuzimin e revistës nga ana e imamlerëve dhe xhemateve! Shkoni nën shkallët e Myftinisë së Gostivarit dhe shikoni stogjet e “Hënës së Re” të kohës kur kjo Myftini drejtohej nga Shaqir Fetai! Në kohën kur ky farë “alimi” nuk ishte myfti, vetëm në Gostivar shpërndaheshin dhe shiteshin 1200 revista, në Tetovë 1400, në Shkup 1600! Sot, në kohën kur Shaqir Fetai dëshiron të flasë për “suksesin e vet”, “Hëna e Re” nuk shpërndahet as 1000 ekzemplarë në tërë vendin dhe, për t’u shitur as që bëhet fjalë!

Kjo konferencë shkencore është dashur të organizohet nga redaksia “Hëna e Re”, që do ta drejtonin aktorët kyç të revistës që nga themelimi e deri më sot, dhe jo ta organizojë BFI-ja sa për të pasur alibi që të pozojë Shaqir Fetai e të kënqet duke i përvetësuar djersën, mundin dhe suksesin e të tjerëve që janë më meritoret por që mungojnë në këtë Konferencë! Ndryshe, kujt do t’ia dedikojë këto 35 vite funksionim të kësaj Reviste!

Sa është mediokritet aq më shumë është edhe turp për Shaqir Fetain, i cili, nëse nuk ia del të vjedhë e të “lulohet” me sukseset e huaja, sa për veten e tij, ai është i bindur se emri i tij nuk do të ngelë i shënuar as margjinave të historisë së BFI-së! Sado që ka emra që mund t’i urrejë Shaqir Fetai, me këtë veprim përveçse që mund ta ushqejë shpirtin e vet, nuk mund të bëjë asgjë në drejtim të fshirjes së atyre emrave! Ata emra, ata kontribues në projektin e suksesshëm “Hëna e Re”, janë legjenda të gjalla e të tillë do të ngelin derisa të ekzistojë BFI-ja! Sukseset e tyre janë evidente dhe të pamohueshme! Por, cilat janë sukseset e Shaqir Fetait? Të gjitha i dimë!

*(Autori ka qenë kryeredaktor i “Hënës së Re” dhe drejtor i Sektorit për informim dhe botim pranë BFI-së në Republikën Veriore të Maqedonisë)/TetovaSot/26.09.2022*

## **Suksesi ka emër**

**Në këtë nënqiell as nuk ka ndodhur e as që është dëgjuar ndonjëherë për dikë që ia do shpirti fort të mburret me sukseset e huaja. Me përjashtim të njërit që vret e pret, që shkelë mbi bukë e mbi Kuran, vetëm e vetëm që të vie deri te sukseset e huaja, t'i përvetësojë dhe të mburret me ato. Megjithatë, çdo sukses e ka kohën dhe emrin! Këtë nuk e di vetëm Shaqir Fetai**

### ***Nga Mr. Abaz Islami***

Që kur u instalua në krye të BFI-së, Shaqir Fetai është në kërkim të më të voglit sukses me qëllim që të mburret: ja, edhe unë, ndonëse si mish i egër në trup të huaj, megjithatë, prap mund të jem i dobishëm! Po cili mund të jetë dobija e mishit të egër, e masës tumorale?!

Më në fund, me gjasë, e gjeti një sukses epik të njerëzve, të cilët Shaqir Fetai nuk i do por ama djersën dhe gjakun e tyre dëshiron t'ua thithë! Tamam monstër!

Paska vendosur që ta festojë 35 vjetorin e Revistës “Hëna e Re”, nën moton “Hëna e Re”, 35 vjet jetë mes sfidave dhe sukseseve”! Ku e di Shaqir Fetai se cilat ishin ato sfida e cilët ishin ata suksese që i përjetoi kjo Revistë për 35 vjet rresht? Ku mund ta dijë Shaqir Fetai kur nuk kaloi qoftë edhe një ditë në këtë Revistë!

Pikërisht për faktin që Shaqir Fetai kurrë nuk ishte në këtë redaksi, madje as që është pritur ndonjëherë në zyren e kësaj redaksie, ai mashtron, gënjenë dhe organizon një “konferencë shkencore” mbi një gënjeshtër që e ka nga injoranca e vet! “Hëna e Re” 35 vjet? Nuk është e vërtetë! “Hëna e re” si revistë më vete nuk ka më shumë se 31 vjet, kurse, e përbashkët, si revistë në tre gjuhë, nën emërtimin “Hëna e Re, Mllada Meseçina dhe El Hilal”, po, kjo ka 35 vite! Po pse e bën këtë ndarje artificiale Shaqir Fetai? Pse kaq shumë nevojë që të “shqiptarizohet” pak? BFI-ja ka vetëm një redaksi dhe vetëm një revistë e cila del në tre gjuhë: shqip, turqisht dhe maqedonisht! Nëse myslimanët që flasin turqisht dhe gjuhën maqedonase do të ishin zhdukur dhe nuk do të kishte asnjë në këtë nënqiell, atëherë, mund të pranohet kjo ndarje naive që e bën Shaqir Fetai, por ama, përderisa ata janë këtu dhe japin kontributin e tyre si në “Mllada Meseçina”, ashtu edhe në “El Hilal”, shënimi i vetëm sukseseve të “Hënës së Re”, sa është tendencioze aq më tepër është edhe e poshtër, jo e denjë për një “reis” të myslimanëve të Maqedonisë së Veriut!

Shaqir Fetai dëshiron që të flitet për një projekt shumë të suksesshëm, dëshiron që të flitet për një projekt që ka lënë gjurmë të pashlyeshme përgjatë historikut të vet, të flitet për një projekt të një Institucioni në të cilën jo vetëm rastësisht gjendet aty, por edhe prezenca e tij është shumë imponuese përmes një instalimi të dhunshëm në krye të BFI-së. Dëshiron të flitet për një sukses të një “projekti”, sepse ndryshe, me çfarë do të mbahet në mend Shaqir Fetai! Edhe përkundër kësaj tendence karakteristike për hajnat e sukseseve të të tjerëve, megjithatë, Shaqir Fetai nuk do të përkujtohet absolutisht për kurrfarë suksesi, me përjashtim të suksesit të tij në thurje të një intrige që vetëm shpirtshitari mund ta bëjë, siç e bëri më 27 maj të vitit 2020!

Suksesi i “Hënës së Re” ka një emër, sfidat e kësaj Reviste kanë disa emrash personalitetesh të cilët i mbajnë mbi supet e veta të gjitha problemet e kohës me të cilat u përball “Hëna e Re” deri në përvjetorin e saj të 31-të!

Faktet dhe historia nuk mund të shtrembërohen, as të lulohen, sepse, në një rast të tillë do të dukeshin artificiale! Artificialiteti nuk paraqet problem vetëm për llojin e Shaqir Fetait!

Në Maqedoninë e Veriut ka ekzistuar një person historik që ka dhënë kontribut të madh në themelimin e Medresesë Isa Beu, që e ka themeluar Fakultetin e Shkencave Islame, që i ka hapur pesë paralele të shpërndara të Medresesë Isa Beu, që ka themeluar Bibliotekën Isa Beu, që i ka themeluar dhe formuar 13 Myftini të BFI-së dhe, tani nga tërë kjo histori suksesesh “përjashtohet” ky personalitet, me qëllim që me to të “stoliset” Shaqir Fetai!

Të mos harrojmë edhe këtë të vërtetë të “Hëna e Re”, po ka përjetuar sfida nga më të egrat sepse është penguar dhe ekzistonin tendenca për mos botimin e saj dhe ka qenë ëndër e dikuj që ajo të mos sheh dritë. Sa e turpshme që është kur sheh sabotuesit e dikurshëm të kësaj reviste se si mundohet të shënojnë përvjetorin e saj.

Nuk mund të flitet për sukseset dhe sfidat e “Hënës së Re” pa qenë në raporte korrekte me ata me të cilët përkojnë këta suksese historike!

*(Autori për shtatë vite ka qenë kryeredaktor i “Hënës së Re”)* /**TetovaSot/29.09.2022**

**Kush po na e bën haramin 'hallall'?!**

**Çka po ndodhë me Bashkësinë Fetare Islame? A e kuptojnë “teologët” aty, si dhe trembëdhjetë “alamet myftinjte” se harami nuk mund të bëhet hallall! BFI-ja nuk mund të jetë kishë ku mund të lahen mëkatet. Ke bërë çfarë ke bërë deri dje, sot je i shpëlarë e i pamëkatshëm. Kjo është logjika e tyre? Na e kanë bërë “hallall” mishin e derrit, na kanë rrasur me këtë mish dhe, sot, “i reaguam STOKOMAK-ut dhe, kjo kompani vendore, nga sot e tërheq këtë produkt nga dyqanet”! Përgjegjësi nuk ka, ata që e kanë hëngër “narezokun”, u bëftë mirë**

***Nga Mulla Nazmi Jashari***

Nëpër dyqanet e vendit, nëpër markete, madje edhe nëpër katunde ku të gjithë banorët janë myslimanë, deri më sot është shitur “narezok mishi”, pra jo “narezok viçi”, apo “narezok derri” por, “narezok mishi”! Sikur të ishte “narezok derri” vështirë se do të futej nëpër dyqane myslimanësh! Dyqanet tona vazhdimisht qenkan furnizuar me këtë produkt, sepse, natyrisht, është shpenzuar! Sipas shumë dyqanxhinjëve ky prodhim serb shitet për shumë vite nëpër dyqanet tona! Ky prodhim serb, shitet si lloj “pashtete viçi” me 40 për qind mish derri, si dhe, me një përqindje të madhe të kërcit dhe lëkurës së derrit! Nëpër dyqanet tona i gjenë në dy lloje, me “narezok viçi” dhe “narezok mishi”! Nuk ju duket këtu që ka hile të qëllimshme, për t’u poshtruar myslimanët?!

Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së e kapi këtë produkt haram për myslimanët ndonëse mbante vulën e “Standardit Hallall”, dhe e alarmoi opinionin e gjërë. Brenda pak kohe, për punë minutash, u alarmua një numër i madh i myslimanëve të vendit të cilët reaguuan ashpër! Reagime të ashpra pati edhe në adresë të Bashkësisë Fetare të Shaqir Fetait, si i vetmi Institucion në vend që e ka të drejtën e çertifikimit të produkteve me vulën e “Standardit Hallall! Reagoi Bshkësia Fetare Islame duke ia hedhur fajin Bashkësisë Fetare të Serbisë që ka vënë vulën “hallall” në atë produkt, reagoi kompania vendore “Stokomak”, duke kërkuar shumë “falje”, ndërsa me këtë u kënaq dhe u mjaftua edhe BFI-ja! Dhe me kaq të mbyllet ky skandal për ç’gjë do të duhej të “tëkërliteshin” koka të mëdha!

Si guxon të flejë kaq i qetë Shaqir Fetai! Si guxon të mos alarmojë të gjithë institucionet e shtetit! Si guxon që të vihet në shërbim të EVN-së sepse këtë ia kërkoi Ministri i Ekonomisë, kurse ky nuk i kërkon Ministrin të Ekonomisë që t’ia vë në dispozicion Agjencisë për Hallall Standard, përbërjen e çdo produkti që prodhohet e që futet në Maqedoni! Si nuk guxon t’i kërkojë kësaj Ministrie që prodhuesit vendorë, si dhe ata që shesin mallëra të huaja në vendin tonë me patjetër që duhet ta deklarojnë në Agjencinë e BFI-së tërë listën e përbërësve të prodhimeve. BFI-ja duhet t’i sigurojë qytetarët e vet se çfarë po hanë. A guxon BFI-ja që ta kërkojë fajin diku gjetkë, për shembull te BFI e Serbisë e cila qenka e autorizuar që ajo t’i vulosë prodhimet serbe me llogon e Hallall Standardit! Do me thënë që, për myslimanët e Maqedonisë kujdesin duhet ta ketë Bashkësia Islame e Serbisë, kurse Shaqir Fetai me kompaninë e vet ta trashë qafën me “narezokë”!

Po çka bën Bashkësia Fetare Islame e jona? Apo, mundësia e saj është vetëm që të reagojë kundër ndonjë dukurie pasi që të zbulohet prej myslimanëve të vendit! Po vetë Agjencia? A i kontrollon produktet? Çfarë pune ka nëse jo t’i kontrollojë produktet, sepse, para dy-tre viteve jemi rrasur duke ngrënë edhe “napolitanka hallall”, me 3 për qind yndyrë derri! A ka kjo Agjenci

e Shaqir Fetait ndonjë katalog, me fotografinë e produkteve të cilat nuk duhet t'i blejnë myslimanët e vendit, sepse përmbajnë elemente derri! A nuk do të ishte kjo një trysni që kompanitë të mendojnë për prodhimin e përshtatshëm për një konsumator që është relativisht i madh në vend, siç jemi ne myslimanët e vendit?

Si qenka zgjidhja kaq shumë e lehtë: Stokomaku na kërkoi falje, nga nesër do ta tërheqë këtë produkt me mish derri që mbanë llogon e "Standardit Hallall"! Atë që e keni hëngër ju bëftë mirë, tul e dhjamë! A nuk u duket ky një krim i qëllimshëm?

Vjen një "kompani ushtarësh" të huaj, të vret e të plagosë gjysmën e popullatës, nëse jo edhe më shumë dhe, në fund: na falni se plumbat paskan qëlluar plumba luftarake, të cilat gabimisht i paskemi marrur me vete, në vend të "municionit shkollor"! Ata që u vranë "Zoti në xhenet", ju që mbetet gjallë, na e bëni hallall!

Unë dhe familja ime e gjërë, nga sot, një Zot e di se sa gjatë do të jetojmë në dyshime: nëse e kemi hëngër edhe ne këtë "narezok" a jo! Tërë ditës kemi pasur një ndiesi të fajit, duke shkuar derë më derë nëpër familje e duke shtruar pyetje nëse kanë ngrënë apo jo nga ky "haram"! Sot, si familja jonë, janë ndjerë edhe mijëra familje myslimane në vend, ndërsa shërbimet e Shaqir Fetait na thonë "e zgjidhëm problemin, reaguam dhe, prej nesër nuk do të ketë nëpër dyqane "narezok derri" me vulën "Hallall"! Po produktet e tjera? Po prodhimet e tjera që futen në vendin tonë pa u kontrolluar e të fallcifikuar! Vetëm një Zot e di se sa lloj prodhimesh të tjera kemi nëpër dyqane tona që mbajnë vulën "Hallall"! Ne, pleqtë që bëjmë pazare ditore, na mjafton për ta parë vulën "Hallall", e t'i bindemi produktit, sepse nuk mund ta lexojmë përmbajtjen me shkronja mikroskopike! "Hallall narezok" me mish derri mund të jetë shtruar edhe nëpër restorantet e Medreseve tona! Gjithçka është e mundur me këtë haram kryesie që na u instalua në krye të BFI-së! Edhe derrin na e bënë "hallall"!

Në heshtje nuk duhet të rrijë as Komisioni i Fetfasë pranë BFI-së! Të na thonë se sa i shpëtojmë ne si qytetarë edhe ata si "drejtues" përgjegjesisë! A duhet të japë dikush përgjegjësi që "gabimisht" na paskan lejuar që me vetëdije ta bëjmë haramin "hallall"! Gjithçka mund t'i falet Shaqir Fetait por jo edhe kjo heshtje prej qyqeje e ndrydhur në grusht të "haramit"!/Bota/29.09.2022



## **A ka dëgjuar ky farë Shaqir Fetai për Luginën e Preshevës**

**Instalacioni perverz i pushtetit maqedonas, i montuar në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, na paska inicuar një “konferencë shkencore” përmes së cilës do të mundohet që sado pak t’i japë vetes pakëz lagështi (vllagë)! Nja njëzet “shkencëtarë” të pranuar vetëm prej tij dhe nja 5-6 shkencëtarë të mirëfilltë nga Shqipëria e Kosova, nuk e ndjenë se në mesin e tyre po mungonin edhe përfaqësues nga Lugina e Preshevës dhe Malit të Zi!**

### **Nga Ferid Saiti, Preshevë**

Të merret sukcesi epokal i tjetër kujt dhe, të “personalizohet” me qëllim që të gjejë alibi për t’u dëshmuar “tjetërfarësh” nga ajo që është, këtë orvatje mund ta bëjë vetëm Shaqir Fetai i gjorë. Bashkësia Fetare Islame e ka njohur dhe njeh për demagog e mediokër të pashoq, simbol i tradhëtisë dhe komplotit në BFI, nga këtu dhe nevoja që një konferencë e tërë i kushtohet një sukcesi të huaj, të orientohet kah “shpërlarja” e Shaqir Fetait!

Seisoni i parë i Konferencës “shkencore” kushtuar 35 vjetorit të Revistës “Hëna e Re”, i kushtohet tërësisht “figurës” së Shaqir Fetait, për të cilën na paskan folur “shkencëtarë” të kalibrit të Shaban Ramanit, i cili, hala nuk ishte mësuar të lexojë shqip atë që ia kishin shkruar! Dhe ky “shkencëtar” (me gjasë, arkatari i BFI-së), qenka paraqitur me punim shkencor (!!!) kushtuar top-pesëshit që më së shumti pasan shkruar në Hëna e Re! Arkatari na qenka bërë “shkencëtar” në saje të hartimit “shkencor” kushtuar numrit të hartimeve shkollore të shkruara e të botuara nga Shaqir Fetai! Jo pra, nuk i ka hyrë të vlerësojë “gjuhën”, “stilin” dhe as “teknikën” e të shkruarit të Shaqir Fetait, e cila, për shkak të kompilacionit, përkthimit pa fusnota dhe vjedhjes së pasuseve, nuk ia del ta ruajë asnjë kontinuitet dhe liniarizim të “hartimeve shkollore”! Në mungesë të këtyre afiniteteve, “shkencëtari” flet për numrin e “hartimeve” të Shaqir Fetait që na i paska publikuar në Hëna e Re dhe që po na e mbakëka vendin e parë për nga numri i publikimeve! Po Reisul Ulema i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi që i ka 287 shkrime në Hëna e Re! Nëse “hartimet” e Shaqir Fetait janë që të gjitha kompilime apo interpretime të njëtrajtshme mbi “problemet islame” (të thëna e të stërthëna nga të tjerët që vetëm na i sjell në shqip të sakatosun Shaqir Fetai), publikimet e efendi Rexhepit janë me peshë, janë me përgjegjësi, janë fakte që kanë detyruar të ndërrohen edhe kurse politiko-shoqërore në të mirë të myslimanëve të vendit! Prandaj dhe janë huazuar nga Hëna e Re nga shumë revista e gazeta ku janë ripublikuar, kurse ato të Shaqir Fetait nuk kanë provokuar kurrfarë interesimi prej të tjerëve! Sido qoftë, ky problem ngel çështje e një hulumtimi shkencor për t’i demaskuar të gjithë kuazi-shkencëtarët të cilët, një ditë të mirë, të ndërsyer nga Shaqir Fetai, deshtën që të bëjnë “shkencë”!

Problem shumë shqetësues është, me gjasë, mbajtja peng e Shaqir Fetait i cili edhe më tej nuk guxon me ia turbullu ujin pronarëve të tij! Pse Shaqir Fetai i thërret në “konferencën shkencore” humoristike vetëm përfaqësues nga Shqipëria e Kosova, kurse i injoron përfaqësuesit legjitimë të shqiptarëve myslimanë nga Lugina e Preshevës dhe nga Mali i Zi? Kush i ka thënë që mos të prekë në Serbi e në Mal të Zi? Pse i injoron këta shqiptarë, pse ua fshinë adresat mu si politika antishqiptare? A e di Shaqir Fetai se shqiptarët anekënd botës japin njëmilion Shaqir Fetaha e nuk e japin një thua të një shqiptari nga Lugina e Preshevës, apo të një shqiptari nga ata (të Malit

të Zi) që e ruajnë me devotshmëri varrin e Ymer Prizrenit (a e di Shaqir Fetai se ku gjendet ky varr?!)

A e di Shaqir Fetai se është një autor nga Presheva i cili në Revistën Hëna e Re ka shkruar shumëfish shkrime më shumë se ai! A e di Shaqir Fetai bashkë me “shkencëtarin” e tij se, në Hëna e Re janë të publikuara disa punime shkencore të Dr. Abdulla Hamitit nga Tërnoci që janë shumëfish më të vlefshme se të gjitha shkrimet kopalla të atij anonimusi që po e mbakëka vendin e parë me shkrime në Hëna e Re!

A e di Shaqir Fetai se në arkivin e BFI-së ekziston një dakortësim paraprak i liderëve fetar shqiptar (H. Sulejman ef. Rexhepi, H. Sabri ef. Koçi dhe H. Rexhep ef. Boja), i cili bënte fjalë për një iniciativë të ngritur më vitin 1994, në mes të këtyre personaliteteve për ngritjen e një redaksie të përbashkët Shkup-Tiranë-Prishtinë (me seli në Tiranë) për nxjerrjen e një gazete dy javore që do të ishte organ i përbashkët i tri bashkësive fetare islame në rajon! Kjo ide pat hasur në përkrahje të hatashme nga shqiptarët myslimanë të Luginës së Preshevës dhe, vullnetarisht insistonin që të marrin pjesë në bashkëfinancimin e këtij projekti! Ndërsa sot, Shaqir Fetai, i injoron, i anashkalon dhe e mohon rolin dhe peshën e tyre, duke mos i përfshirë në një “konferencë shkencore” të cilin, me kopili e organizon ekskluzivisht për promovimin e vetëvetes si dhe të dy-tre pataricave të tij që i hynë në punë sa herë që ka nevojë të lirohet nga kapsllëku shqirtëror që e ka mbërthyer avdallin! Edhe ky turp flet për paftyresinë e tij!/**JetaPress/02.10.2022**

## **Çka pret Shaqir Fetai nga vizitat te bashkatdhetarët tanë**

Instalimi i Shaqir Fetait në krye të BFI-së nga shërbimet e dyshimta atislame e antishqiptare, edhe më tej po dëshmon se ka qenë një përpjekje rehabilituese dhe shpërblyese për Shaqir Fetain për tërë atë kontribut madhor që e ka dhënë deri sa ka qenë lojalist i devotshëm i këtyre shërbimeve.

Në këtë pozicion ku e kanë instaluar, tani më Shaqir Fetai ka vetëm një hall: a do të pranohet, a do të mëshirohet, a do të falet për të gjitha ato poshtërsi që i ka kryer nën “hyqmin” e Stanko Dragoviqit dhe Temelko Boshkovskit (oficerë të UDB-së). Dëshiron të përcjellë një mesazh të vetëm: bëni vepra antikombëtare e antifetare, sepse, populli është “kope dhenësh”, në fund ju falë e ju pranon siç më pranoi, fali dhe deshti mua!

Natyrisht, ka zgjedhur një barometër se si ta masë këtë pajtesë të popullit: përmes vizitave! Nëse shkon (me ftesë prej tij) një qytetar i rëndomtë për të pirë çaj në “zyren me sy” të Shaqir Fetait, ai do të shkruajë se erdhi të më urojë për postin e ri dhe të më urojë shëndet e suksese! Që do me thënë se, atë po e amnistojnë, ndonëse e dinë të gjithë se çfarë kishte bërë deri sa ka shërbyer nën pseudonimin “ORAO” për UDB-në! Po ashtu, kur të niset për vizitë jashtë vendit, ai do të shkruajë se hasi në një “pritje madhështore”! Kjo është esenca e ftesës dhe e vizitës, pra, për Shaqir Fetain e rëndësishme është a do të hasë “në pritje madhështore” (sepse edhe mund të dëbohet si ai me bishtin nën shalë) dhe jo arsyeja për të cilën është ftuar!

Kështu, këto ditë Shaqir Fetai kishte vizituar në Vienë “xhematin” e vet të organaizuar e të manipuluar prej sojit të tij. Ftesën e kishte pasur me rastin e hapjes së Qendrës islame shqiptare në kryeqytetin e Austrisë, ndërsa, prej krejt kësaj vizite, impresionim i kishte lënë vetëm “pritja madhështore”! Shaqir Fetai në fb-un e vet shkruan: “Pritje madhështore, organizim i nivelit të lartë”.

Ky fakt flet për problemet e Shaqir Fetait që i ka në jetën e vet të stërmbytur me konspiracion! Shkon i tmerruar nga frika dhe, çuditërisht habitet “nga pritja madhështore”! Shaqir Fetai me këtë sintagmë nuk ia përton që t’i fusë në konspiracion të gjithë ata shqiptarë të shkretë që nga malli janë në gjendje t’i bëjnë nder e respekt edhe një qeni prej vendlindjes së tyre!

Shaqir Fetai nga “pritjet madhështore” të këtilla lirohet shpirtërisht, sepse, ose i vërtetohet teza e tij se “shqiptarët janë grigjër”, ose, në ndërdije e ka konstatimin se “vetëm fuksat mund t’ia organizojnë një pritje madhështore fuksit”! Pra, në të tilla situata shqiptarçe, ai ofendon, sepse, të gjithë ata që e respektojnë i duken si vetja e vetë – fuksa! Ai edhe vizitat ua bën nën shoqërim me fuksa e me hipoteka morale!

Se sa i vakët që është, se sa i prishur në tru që është, se sa i mjerë e i varfër shpirtërisht që është, flet edhe momenti kur, avdalli, mundohet të prezantohet si kancelar, si kryeministër, si funksionari më i lartë i shtetit ku shkon si mysafir i rëndomtë! Në Vienë, shqiptarët myslimanë të devotshëm, i paska falënderuar për “kontributin e dhënë në organizimin e jetës islame në Austri”! Shaqir Fetai mund të mahnitet, mund të mrekullohet, mund të kënaqet, mund të gëzohet me prirjen organizative të shqiptarëve në Perëndim, por jo edhe t’i falënderojë për këto organizime, sepse, këta shqiptarë nuk janë të deleguarit e Shaqir Fetait që kanë marrur rol të zbatojnë një urdhër të tij dhe tash, është momenti për falënderim! Ky me të vërtetë mendon se është “Kalif”, “kryetar” i të gjithë myslimanëve të botës, ndërkohë që kontestohet madje edhe si “hoxhë” në katundin e vet. Turlifarë avdalli!/**Lajme7/09.10.2022**

## **Përçudnim satanik i Shaqir Fetait**

Sa herë që Shaqir Fetait situata dhe punët i bëhen lëmsh, fijen e shpëtimit e kërkon në diasporë! Diaspora jonë, siç ka dëshmuar deri më tani, nga përmallimi i zjarrtë, shpesh ka ditur që ta presë e ta respektojë qoftë edhe një qen nga vendlindja. Këtë përmallim, por edhe organizimin e tyre të brendshëm, vetëm Shaqir Fetai di ta përkthejë në “pritje madhështore, vëllazërore, të lartë...” Nëse në një xhami mblidhen myslimanët e vendit, qoftë për kryerjen e një namazi, apo, pse jo, edhe për ndonjë organizim me karakter fetar, ndërsa aty prezanton edhe Shaqir Fetai, sakaq, Shaqir Fetai këtë devotshmëri të besimtarëve tanë do ta paraqesë si “adhurim” të diasporës që ia bëjnë këtij farë sharlatani!

Këto ditë Shaqir Fetai paska vizituar qendrën islame shqiptare në Vjenë dhe, aty “pritje madhështore” i paskan organizuar mbi 600 pjesëmarrës. Në fakt, këta pjesëmarrës në këtë qendër kishin ardhur për të falur namazin e Xhumasë, siç tubohen çdo herë në këtë namaz! Ndërsa Shaqir Fetai na thotë se këta na qenkan mbledhur për t’ia organizuar një “pritje madhështore” Shaqir Fetait! Kjo do të thotë se, nëse nuk do të ishte aty Shaqir Fetai, në këtë namaz të Xhumasë nuk do të vinte asnjë mysliman?! Myslimanët tanë, kudo qofshin ata, edhe në diasporë, në xhami shkojnë për ta kryer obligimin e tyre fetar, gjendet aty ky farë avdalli apo jo!

Edhe në “Hilal” të Hollabrunit myslimanët e atyshëm i paskan organizuar një “pritje vëllazërore” Shaqir Fetait! Myslimanët i përgjigjen thirrjes islame për ta adhuruar Allahun Fuqiptotë, kurse Shaqir Fetai e nënvlerëson këtë devotshmëri dhe e zbret në “adhurim” ndaj Shaqir Fetait!

“Pritje vëllazërore në IKE”! Pjesëmarrje masovike aty ku paska prezantuar Shaqir Fetai! A nuk është kjo përpjekje për ta devaluuar dhe për ta minimizuar devotshmërinë e vëllazërve tanë në Perëndim të cilët, po kështu masovikisht përfshihen në çdo namaz e organizim tjetër fetar! Këtë devotshmëri e përçmon Shaqir Fetai, duke e paraqitur atë si “pritje vëllazërore”! Po pse ka kaq shumë nevojë Shaqir Fetai për “pritje madhështore” e për “pritje vëllazërore”! Apo, ndoshta kështu e kanë mësuar “instaluesit” me qëllim që ta bëjë si fakt të kryer “dashurinë vëllazërore” që e paskan shqiptarët për një marionetë të pushtetit, qoft ai edhe fuks dhe xhelat i interesave kombëtare!

Hapja e Xhamisë në Linc u bë para një numri të madh të bashkatdhetarëve tanë të cilët paskan organizuar një “pritje madhështore” për Shaqir Fetain! Tani, këtu përzihen “reqatet” dhe nuk dihet: këta besimtarë a kishin ardhur për përrurimin e Xhamisë së Re apo për “pritje vëllazërore” për Shaqir Fetain! Pse asnjë informacion mbi këtë aktivitet të vëllazërve tanë, pse asnjë informacion mbi këtë Xhami të re, për përmasat e saj, për peripetitë dhe sfidat gjatë ndërtimit të saj, për kontributin e myslimanëve tanë në atë vend austriak! Apo, asgjë këtu nuk është me rëndësi sa “pritja madhështore” që qenka organizuar “për nder” të Shaqir Fetait, alias, ”ORAO”! Ja, ja. Si e begenizin shqiptarët një udbash!

A e dini se pse Shaqir Fetai përpiqet që këtë aktivitet të diasporës ta paraqesë nga nënhija e “pritjes madhështore” që ia organizojnë këtij farë dallkauku? Sepse ky avdall para myslimanëve del vetëm me shpresë se do ta mirëpresin dhe jo se e do “kuvendi”! Këtij nuk i intereson as xhamia, as qendra, as vakëfi as asgjë! Thjesht, i intereson të dijë nëse po shtohet numri i myslimanëve (qoftë edhe për një, që do ta mirëpresin përmes organizimit të “pritjeve madhështore e vëllazërore”!

Një është shumë e sigurtë: në bazë të reagimeve në inbox, të paktën edhe një 30-40 bashkatdhetarë myslimanë kanë refuzuar të marrin pjesë me pjesëtarë të familjeve të tyre në këtë

ngjarje shumë të rëndësishme për ata. Nuk shkohet aty ku do të prezantojë edhe Shaqir Fetai, sepse nuk kemi nevojë të djallëzohemi!

Është më se e qartë se Shaqir Fetai mendon se asnjë nga pjesëmarrësit në atë event nuk do të ishte aty sikur të mungonte Shaqir Fetai. Pra, prezenca e madhe e myslimanëve në një ngjarje festive bëhet sepse aty merr pjesë Shaqir Fetai dhe, nëse nuk merr pjesë ky, atëherë pjesëmarrja e xhamatit do të ishte e papërfillshme! Kjo është logjika satanike e Shaqir Fetait! Me idiotizma të këtilla mundohet t'i japë vetes peshë e rëndësi, pavarësisht që, që të gjithë, nuk ka mysliman në vend e në botë (nga RMV-ja e më gjërë) që nuk e di se kush është Shaqir Fetai, si ia doli që ta kryej puçin dhe ta uzurpojë pa kurrfarë merite vendin e kryetarit të BFI-së, dhe cilat herbime antishqiptare e antifetare e instaluan në këtë pozitë! Nuk ka mysliman i vendit, qoftë këtu qoftë në diasporë, të cilët nuk dinë për profesionin e tij prej fuksi! Dhe, ta përktheshë ibadetin e tyre në “pritje vëllazërore” ky është vetëm një cinizëm që rrjedh prej shpirtit të satanizuar të një krijese mutante si Shaqir Fetai!

p.s.

Shaqir Fetai ia paska dalur që edhe këtu të vizitojë Ambasadën e RMV-së në Vjenë dhe ta takojë ambasadorin maqedonas! Shaqir Fetai, që nga instalimi i dhunshëm i tij në krye të BFI-së, më shumë është takuar me ambasadorët maqedonasë se sa, bie fjala, me “myftiun” e Prilepit, të Resnjës, të Velesit, të Shtipit, të Kumanovës, të Dibrës dhe Kërçovës! Tamam si fuksat e dikurshëm që para se të ndërmerrenin ndonjë “aksion subversiv” në ilegale, shpesh i frekuentonin ambasadat jugosllave! Ka pasur mundësinë të takojë dhjetra personalitete shqiptare me peshë, nga sfera politike, kulturore e sportive, por, ja që zgjedh, si çdo herë, të takojë ambasadorin maqedonas! Mbase për të lënë apo për të marrur ndonjë mesazh të koduar! Arsyë, motiv dhe obligim tjetër nuk ka! Një teolog i dështuar t'i shëtisë b... nëpër ambasadat maqedonase?! Shaqir Fetai më shpesh i organizon takimet nëpër ambasada maqedonase se sa që organizon në Rijaset një takim të drejtuesve të organeve dhe institucioneve të BFI-së! **1KlikLarg/10.10.2022**

## **Postfestum: Burra me karafil në dorë apo farsa e një hipokriti**

**Aty ku ka qenë, ku është dhe ku do të jetë i Dërguari i Allahut Mëshirëplotë, Muhamedi a.s., aty nuk ka vend për hipokritët e llojit të Shaqir Fetait. Prezenca e tij në shënimin e Ditës së Lindjes të Muhamedit a.s. vetëm sa paraqet përpjekjet e tij qyqare për të mjegulluar të gjitha të bëmat e tij prej hipokriti**

*Nga Halid Sadiku*

Në Gostivar, nën angazhimin e Myftinisë së këtij qyteti, tashmë është bërë traditë që të organizohet një program stereotip kulturo-fetar kushtuar Ditës së Lindjes së Pejgamberit, Muhamed Mustafasë! Natyrisht, kjo do të duhej të ishte një ditë ku do të kujtohej Pejgamberi ynë duke i radhitur të gjitha sukseset jetike që i ka arritur BFI-ja nga përfundimi i eventit të kaluar e deri te ky i sivjetshmi! Me çka e bëmë krenar të Dërguarin e Allahut Mëshirëplotë? Me çka u mburrëm para Tij si pasardhës dhe pasues të Rugës së Ndrirshme që na e trasoi Ai me shokët e vet besnikë.

A mundet që të jetë i sinqertë një person si Shaqir Fetai, i cili përpiqet të shpreh “respektin” e vet për Pejgamberin tonë, ndërkohë që, që kur pranoi të instalohet dhushëm në krye të BFI-së nga shërbimet antiislame e antikombëtare e deri më sot, ka vepruar vetëm në kundërshtim të porosive të Muhamedit a.s. Një tradhëtar, një përçarës, një rrënues i vlerave morale, fetare e kombëtare të arritura me mund e me djersë përgjatë dekadave, një hipokrit, një degradues dhe një dezorganizues i xhematit, një gënjeshtar e një zhatës i vakëfit – a mund të jetë një person i këtillë, si Shaqir Fetai, i denjë për t’u drejtuar një auditori për ta lutur që të jetë pasues i denjë i veprave të Muhamedit a.s.

A mund ta ketë gëzuar Muhamedit a.s. Shaqir Fetai i rrethuar e i shoqëruar nga dilinxhinjë, hajna, rrencakë, të pashpirtë, imoralë e hipokritë! Po sikur të pyetej publikisht nga Pejgamberi a.s. se kush janë këta shoqërues të tij – pa dyshim, Shaqir Fetai do ta kishte gënjyer publikisht Muhamedin a.s. duke ia prezantuar si të po atij niveli që ishin as’habët e tij! E ka këtë trohë fytyre Shaqir Fetai për ta gënjyer edhe Pejgamberin a.s., siç përpiqet ta mashtrrojë edhe Allahun xh.sh. në ditë me diell!

Pas një përshendetje prej 5 minutave e shumë monotone, Shaqir Fetai mori guximin që të hyjë në temë, të flasë nja 18 minuta, para të pranishmëve të cilët e humbën durimin dhe nisën ta shajnë, sepse nuk ishin ardhur për të dëgjuar kopalla prej tij, por, për të dëgjuar zëra të bukur të atyreve që këndojnë pjesë nga Kurani e ilahi! Si ju tha Shaqir Fetai atyre që kënduan ilahi e ashere?! “Këndusa”, ju tha! Në shumë treva shqiptare “këndues” i thonë gjelit, ndërsa këngëtarë u thonë atyreve me zë të bukur e të ëmbël që këndojnë këngë, pra, edhe ilahi!

Në një moment Shaqir Fetai do ta humb kontrollin e do të dalë fare në stërrnishta! Tamam si ata të pafytyrët, do të shprehte “dëshirë” për ta pasur sot gjallë Muhamedin a.s.: ”ta sjellim në kohën në të cilën ne jetojmë, të ulemi e të bisedojmë me te, të na mësojë rreth praktikës së fjalës hyjnore, të na tregojë metodologjinë dhe strategjinë e veprimit për të qenë në shërbim të njerëzimit, për të qenë në afrim me njëri tjetrin, për të qenë në Shërbim të Zotit...” Kush e shpreh këtë “dëshirë”, Shaqir Fetai që një jetë të tërë ishte në shërbim të Temelko Boshkovskit e të Stanko Dragoviqit, duke hequr dorë nga emri që i është kënduar nga ndonjë “këndus” në vesh e duke u pagëzuar nga UDB-a me emrin “ORAO”! Kush e shpreh këtë “dëshirë”? Shaqir Fetai

që e luajti lojën më të ndytë e më të rrezikshme që është luajtur ndonjëherë mbi kurriz të BFI-së, Institucionit të vetëm fetar islam në RMV! Ky të flasë për moralin ndërkohë që luajti rolin më të pamoralshëm mbi prijësin fetar dhe mbi liderin që ai deri një ditë para se t'ia ngulte thikën pas shpine e vlerësonte si “figurë markante” e si mysliman të devotshëm i cili ka trasuar rrugën e ndritshme për islamit dhe myslimanët në këta troje!

“Sonte e kemi Muhamedin a.s. me ne”, do të thotë Shaqir Fetai, për të vazhduar: “dhe ai është i lumtur dhe i gëzuar me ne...” Pavarësisht të bëmave të tmerrshme të Shaqir Fetait, pavarësisht që dikujt ia ka këputur e përvëlur shpirtin, qoftë nga xhelozia, qoftë nga djallëzia, qoftë nga intrigat e tij, qoftë nga porosia e shërbimeve nëntokësore, Shaqir Fetai mendon se gjithkush që gjendet para tij, pra edhe Muhamedi a.s., duhet të jetë i gëzuar dhe i lumtur! Sjellje kjo tipike e xhelatëve, sepse, edhe xhelati, pas aktit të vet antihuman thotë: “jam i gëzuar që ia shkurtova vuajtjet kësaj viktime”! Shaqir Fetai vazhdon: “Ne jemi krenar që porosinë e Muhamedit a.s. e bartim dhe e prezantojmë...” Po a është porosi e Pejgamberit a.s. për të vjedhur vakëfin? A është porosi e Pejgambetit a.s. për ta vjedhur haxhin, kurbanët, fitrin e zeqatin? A është porosi e Pejgamberit a.s. që të lejohet futja e pykave madje edhe me dëshirën më të madhe të institucionalizohen ato “pyka” përçarëse të ummetit të Muhamedit a.s., duke legalizuar dhe përkrahur turlifarë “bashkësie islame” në vend? A është porosi e Pejgamberit a.s. që të blehet përkrahja e organeve duke i korruptuar e duke i shantazhuar? A është porosi e Pejgambrit a.s. që për t'ia bërë qejfin pushtetit maqedonas, i blihet njeriut të këtij pushteti makina prej të cilës Shaqir Fetai (apo sekserët e tij) do t'i fusin në xhep rreth 17 mij euro, para nga fitri e zeqati! A është porosi e Pejgamberit a.s. që të lihet vakëfi (ish-selia e Myftinisë së Shkupit) në hipotekë me qëllim që të sigurohen para për rrogat e majme për degraduesit më të mëdhenj të jetës institucionale fetare në vend! A është porosi e Pejgamberit a.s. që të dëbohen nga vendi arabët të cilët kishin nënshkruar marrëveshje për ndërtimin e një objekti jetik për vakëfin e Myftinisë së Gostivarit! Fare në fund – a është porosi e Pejgamberit a.s. që teologët “e respektuar” të futen në skemat e rrezikshme të atyreve që nuk ia duan të mirën as kombit dhe as fesë dhe, të realizojnë strategjinë e tyre për ta ushtruar një puç e një tradhëti një komplot e një mort mbi BFI-në siç e zhvilloi Shaqir Fetai me honxho bonxhot e tij?!

Shaqir Fetai në këtë shënim të Ditëlindjes së Pejgamberit a.s. para të pranishmëve u tallë me Personalitetin e Pejgamberit a.s. si dhe me Porositë e tij të shenjta, në mënyrë cinike i përçmoi të pranishmit dhe, tek bashkëveprimtarët e vet përcolli mesazhin: bëni veprime antiislame sepse do t'i mbuloni ato me “ligjerata islame” kur t'ju jepet rasti!

Emërues i përbashkët i kësaj tallje, këtij cinizmi dhe këtij përçmimi ishte vetëvlerësimi skandaloz i Shaqir Fetait, i cili në një moment do të thotë (minuta 16.08) tha: “Por, ja edhe unë si doktor Kurani”!!! Shaqir Fetai “doktor Kurani”?!? Nëse Shaqir Fetai na qenka “doktor Kurani”, atëherë, myslimanët e vendit i bie që të jenë “pejgamberë”!

Nuk mund të jetë “doktor Kurani” ai për sojin e të cilit vetë Kurani thotë: “Ka ndonjë njeri (hipokrit), fjalët e të cilit në jetën e kësaj bote ta bëjnë qejfin dhe që betohet në Allahun për atë që mban në zemër, por që, në të vërtetë, është kundërshtari (yt) më i betuar.” (El Bekare, 204). Nuk mund të jetë i umetit të Muhamedit a.s. ai hipokrit (soj i Shaqir Fetait) për të cilin vetë Muhamedi a.s. ka thënë: “Shenjat e hipokritit janë tri: kur flet, gënjen; kur premton, mashtron dhe kur i besohet diçka, tradhton! (Muslimi shton: Edhe nëse agjëron, falet dhe mendonse është musliman.)” (Shënon Buhariu dhe Muslimi) /**Top24/12.10.2022**

## **Recension: Nusprodukt i një komploti dhe tradhëtie**

Kohë më parë u paralajmërua se së shpejti do të dalin në dritë dy botime që do të ngelin arkiv i gjallë mbi të bëmat e Shaqir Fetait “si performansë” që nga instalimi i tij politik në krye të BFI-së nga pushteti maqedonas.

Korporata për Produksion, Informim dhe Botim “1kliklarg”, Tiranë, në bashkëpunim me Lëvizjen Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së, këto ditë botuan librin elektronik “Kështu foli Shaqir Fetai”, të autorit Faik Shahinbejlliu. Për shkak të volumit të madh të librit të radhës (mbi 720 faqe), me titull “Nusprodukti i një tradhëtie dhe komploti”, si dhe për shkak të shtrenjtiveve enorme të materialit të nevojshëm për botim, pra, në mungesë të financave për ta financuar librin, edhe ky tiull doli në dritë si botim elektronik. Kësisoj, lexuesit, tash e tutje do ta kenë mundësinë për ta lexuar online librin e radhës, “Nusprodukti i një tradhëtie dhe komploti”!

Në librin e parë që u botua vitin e kaluar, me titull “Tradhëtia dhe komploti i Shaqir Fetait në kohë pandemie” u përmbledhën mbi dyqind shkrime të botuara në rreth 20 portale shqiptare, e që kishin të bëjnë kryesisht me tradhëtinë e Shaqir Fetait mbi institucionin e vetëm fetar islam në RMV, mbi gatishmërinë aq lehtësisht të mundshme të Shaqir Fetait për të tradhëtuar Zot e miq për interes të karrierës së vet të verbuar. U fol për gatishmërinë aq lehtësisht të demonstrueshme nga ana e Shaqir Fetait për të shkelur mbi çdo akt normativ të BFI-së, mbi traditën shekullore të këtij Institucioni si dhe mbi përpjekjet e mbinatyrshme të një sërë gjeneratash për t’i dhënë peshe dhe rol meritore këtij Institucioni në shoqëri. Duke e njohur dhe duke e ditur karakterin dhe natyrën e dobët të Shaqir Fetait, u sinjalizuan të gjitha ato pasoja dhe tatëpjetëza në të cilën do të rrokulliset BFI-ja për shkak të misionit joislam e jokombëtar të Shaqir Fetait. Dhe, gatishmëria lehtësisht e demonstrueshme e Shaqir Fetait në këtë tradhëti dhe komplot do të sjellë sot një nusprodukt që do të llogaritet si katastrofa më fatale e BFI-së dhe shoqërisë myslimane në RMV që ka mundur t’i ndodhë.

“Nusprodukti i një komploti dhe tradhëtie” është, në fakt, përmbledhje e rreth 200 shkrimeve të publikuara brenda një viti nëpër portale të vendit dhe të rajonit e që zbardhin të gjitha pasojat që nga momenti kur Shaqir Fetai pranon të bëhet marionetë e pushtetit maqedonas që e kishte ëndërr shekullore për t’i futur duart në Institucionin e BFI-së.

Keqpërdorimi i fitrit dhe zeqatit, vjedhja e haxhit dhe kurbanëve, vjedhja, përvetësimi dhe shitja e vakëfit, shkeljet e përditshme të Kushtetutës së BFI-së dhe akteve normative të saj, manipulimi dhe shantazhimi i organeve të BFI-së, instalimi nëpër organe i individëve me vlera të dyshimta morale e njerëzore, devaluimi i organeve, institucioneve, sektarizimi i shoqërisë, dezorganizimi i xhematit, tallja me ndërkombehtarët, shndërrimi i BFI-së në eshalon i tretë e i parëndësishëm i pushtetit maqedonas, partizimi dhe politizimi i skajshëm e në mënyrë naive i BFI-së, angazhimi i gjithësecilit nëpunës të BFI-së për ta dëshmuar lojalitetin partiak si mënyrë e mbijetesës në BFI – pra, të gjitha këto dukuri si dhe një sërë dukurish të tjera që do të jenë objekt i editorialeve dhe analizave në të ardhshmen, janë lajtmotiv i kësaj përbledhje të shkrimeve si dhe të sërë shkrimeve të tjera që nuk u përfshinë në këtë libër elektronik.

Pa dyshim që, ky libër si dhe dy librat e më parshëm (“Tradhëtia dhe komploti i Shaqir Fetait në kohë pandemie” dhe “Kështu foli Shaqir Fetai”) të shpërdarë edhe në shumë biblioteka online në botë, do të shërbejnë si materie e gjallë që do të flasë për kohën dhe për një person i cili, duke pasuar rrugëtimin e Haxhi Qamilit, u angazhua që ta katandisë BFI-në në një “ojq” të rëndomtë e pa kurrfarë peshe në shoqëri.

Bazuar mbi aftësinë për të gënjer, për t’u shtirur, bazuar në hipokrizinë dhe analfabetizmin e vet, Shaqir Fetai u përpoq që të “krijojë” një BFI sipas modeleve të imponuara nga subjekte të



dyshimtë por që i garantonin karrierë prej “reisi”! Personazh ky shumë i denjë për “Gomari i Baba Tomorit”!

Pa dyshim, Shaqir Fetai, karakteri i tij, lukunia e tij prej satani, nuk do të kalojë pa u bërë personazh shumë i rëndësishëm në ndonjë nga veprat e ardhshme artistike. Dhe, pa dyshim, të dhëna mbi karakterin e tij do të shërbejnë pikërisht këto njësi shkrimesh nga mbi 500 editoriale, analiza, komente e studime mbi “personalitetin” e Shaqir Fetait. Dramaturgjia kombëtare do të pasurohej me një komedi të mrekullueshme me personazhin në epiqendër që do të pasqyronte gjithë personalitetin qesharak e intrigues të Shaqir Fetait!/**IKlikLarg/15.10.2022**

## **Shaqir Fetai i vonshëm**

### ***Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI***

Kohë më parë, Levizja Myslimane për Reforma në BFI, bëri publike përgjumjen dhe sjelljen nonshalante të Shaqir Fetait duke tërhequr vërejtjen se, ky farë duduku nuk është as i interesuar por as i lejuar nga shërbimet që e kanë kapur për fyti, për ta nostrifikuar Medresenë në Universitetet prestigjioze ndërkombëtare me karakter islam.

Për pasojë, tash e disa vite nxënësit e Medresesë "Isa Beu" nuk pranoheshin as në Universitetin e El Ah'zarit të Kajros.

Në fakt, kemi pasur "nxënës" që kanë shkuar për të "studiuar" në Kajro, por, kryesisht në "Universitet" privat i themeluar për të shitur diploma për të gjithë të dështuarit në jetë si dhe pseudoteologët!

Se Shaqir Fetai nuk e ka pasur prioritet shkollimin e kuadrit tonë nëpër Universitete prestigjioze islame, këtë e dëshmon edhe vetë ai, duke nënvizuar se qëndrimin në Kajro kësaj radhe e paska shfrytëzuar me qëllim që dokumentat e nevojshme të cilat sivjet qenkan nisur me vonese, t'ia dorëzojë në duar vetë Sekretarit të Ez'herit!

Edhe për këtë vit akademik, nuk kemi medresantë tanë me studime në këtë Universitet, sepse për sivjet dokumentat dorëzohen me vonesë! Këto të dorëzuara në dorë mund të jenë të mangëta vitin e ardhshëm akademik, sepse kriteret po shtohen për çdo vit! Ndërkohë që, për vitin e ardhshëm akademik, nëse akreditohet nga shteti i RMV-së, Medresja "Isa Beu" mund të jetë me program të adaptuar sipas Rregullores së Ministrisë së Arsimit për shkollat e mesme shtetërore në RMV, adaptim ky që mund të jetë joadaptabil për programet përkatëse të Universitetit të Ez'herit!

A ia shpjegoi këtë problem Shaqir Fetai Sekretarit të Ez'herit, apo, kjo nuk është gjithaqë e rëndësishme, pasi për Shaqir Fetain të rëndësishme janë sa më shumë foto me ndërkombëtarët në albumin e vet privat.

E çka kuptoi Shaqir Fetai nga ky takim kur, si përkthyes e pati njeriun tashmë të dëshmuar që përgjatë përkthimeve stimultante është vetëmse një manipulator dhe mashtrues ordiner!**IKlikLarg/Fakte/17.10.2022**

## **Shaqir Fetai fabrikues i rrenave**

### **Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI**

Ai që tradhëton, ai që komploton, ai që u shërben turlifarë shërbimeve, pa dyshim që duhet të jetë “pehlivan” i rrenës! Rrenën duhet ta ketë kult! Duhet të dijë të gënjejë dhe, gjithësesi, duhet ta ketë fytyrën qindra hektar, thjesht, të jetë i lumtur se është i pafytyrë.

Shaqir Fetai nga Kajro na e jep kumtin por, të sforcuar me një rrenë të madhe! Thotë: “PRANOHEN STUDENTËT TONË NË UNIVERSITETIN EL AZ’HAR TË KAIROS” (jo “tonë” por “tanë”, sepse fjala “studentët” është e gjinisë mashkullore! Përemrin “tonë” Shaqir Fetai mund ta përdorë në titullin e informacionit “E dekoruan studentin tonë!”)

Do me thënë, Shaqir Fetai është nisur në Kajro me një grup studentësh dhe, sapo ky ia ka dorëzuar Programin e Medresesë sekretarit të Ez’herit, me automatizëm u pranuan studentët të prirë nga Shaqir Fetai! Ky farë rrenci do të ishte mirë nëse informon me titull “Në këtë vit akademik do të pranohen edhe studentët tanë që kanë kryer Medresenë”!

Janë të “falshme” këta gabime gjuhësore kur kihet parasysh sjellja skandaloze e Shaqir Fetait, i cili mbijeton duke rrejtur herë brenda e herë jashtë! Shaqir Fetai nuk e ka dert rrenën, sepse tashmë është kalitur! Ai jo një herë është kapur duke gënjyer dhe, kur i është tërhequr vërejtja ai vetëm qeshë, si i marrë! Do me thënë, rrenën e ka ushqim shpirtëror!

Shaqir Fetai nuk e ka pasur dert këtë problem, i cili, problem iu bë që kur u kritikua nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI! Sepse, sikur ta kishte dert, ai do të shkonte në Ez’her muaj më parë, me të gjitha dokumentat që i kërkojnë autoritetet e këtij Universiteti me famë botërore! Nuk do ta priste momentin e ndonjë udhëtimi eventual “zyrtar”! Një i ri për të ikur në një shtet tjetër, në një kontinent tjetër, shumë të largët, të shtrenjtë plus me kushte të rënda, do të duhet të përgatitet shpirtërisht e familjarisht. Vite më parë, studentët tanë që iknin në këtë Universitet shkonin me një bursë të garantuar që ua siguronte ish-reisul ulema!

Shaqir Fetai, tamam si skuth, pret një udhëtim për në Egjipt, shkon atje dhe i dorëzon dokumentet e dhura dhe, me kaq merr fund puna – “PRANOHEN STUDENTËT TONË NË UNIVERSITETIN EL AZ’HAR TË KAIROS”!

Shaqir Fetai brenda vendit tashmë është zbërthyer si rrenc profesionist, nuk ka xhemat në vend që nuk është përballur me një numër rrenash nga ky farë duduku që imponohet dhe mundohet të shitet si “reis”! Prandaj, brenda vendit, kontaktet i ka reduktuar në minimum, ndërsa si terren të rrenës mundohet ta përdorë çdo udhëtim!

Madje edhe vetëkënaqet duke informuar se po rrenë. Nga Kajro Shaqir Fetai na e dërgon edhe këtë rrenë: “Është e rëndësishme që të përmenden edhe takimet e ndryshme që u realizuan ku u ndruan mendime, përvoja mbi shpjegimin dhe organizimit të jetës fetaro islame në BFI e RMV”! Fjali e shthurrur, e pakuptimtë por deri diku “e qartë” përpjekja e Shaqir Fetait për të na thënë se si i ka shfrytëzuar disa takime për t’i kripur me rrena autoritetet e ndryshëm. Shaqir Fetai i paska njohtuar për organizimin e jetës fetare si dhe për organizimin e BFI-së si Institucion!

I ka kripur me rrena, sepse, duke ia njohur natyrën prej rrenci të sëmurë, është e pabesueshme se Shaqir Fetai i ka njohtuar autoritetet e ndryshme nga bota islame me deinstitutionalizimin total të jetës fetare islame në Maqedoninë e Veriut që nga instalimi i tij në krye të BFI nga struktura antifetare e antiislame!

Shaqir Fetai nuk u ka treguar se si e dezorganizon xhematin, se si e sektarizon dhe se si i institucionalizon sektet që më së paku u intereson islami!

A ua ka treguar datën e mbledhjes së fundit të Kuvendit ilegjitim të BFI-së, organ ky që të paktën një herë në vit duhet të mbledhet? A ua ka treguar datën e mbledhjes së fundit të Rijasetit, ose, a u ka treguar se Kuvend e Rijaset për Shaqir Fetain është “shërbimi misterioz” sipas urdhërave dhe diktateve të të cilit vepron në emër të islamit!

A u ka thënë autoriteteve islame se ai është instaluar në krye të BFI-së krejt në mënyrë ilegale, jokushtetuese dhe i kontrabanduar!

Që atëherë e deri më sot, pse nuk u tregon autoriteteve të ndryshme jasht vendit se, nuk e njeh Kushtetutën e BFI-së dhe se atë e shkel natë e ditë, me dy këmbë!

Pse nuk i shfrytëzoi këto takime për t’ju treguar drejt, pa i rrejtur se, çdo ditë e shkel –

paragrafin dy të Preambullës së Kushtetutës së BFI-së;

paragrafin pesë dhe gjashtë të Preambullës së Kushtetutës së BFI-së;

nenin 1; pikat 1,2,5,6, 7, 8, 11, 13 të nenit 7; nenin 8; nenin 11; pikën 2 të nenit 12; pikën 17 të nenit 25; nenin 30; nenin 35; nenin 36; nenin 37; nenin 39; nenin 40; nenin 42; nenin 44; nenin 49; nenin 50; nenin 55; nenin 58; nenin 59; nenin 62!

Natyrisht, Shaqir Fetai nuk duhet t’i rrejë miqtë e BFI-së por t’u tregojë drejt se si vepron jashtë të gjitha rregulloreve të BFI-së! Shaqir Fetai ka gjetur të rrejë shlirshëm jashtë vendit, duke qenë i bindur se nuk do të mund të demantohet aty për aty! I shkreti nuk e di dhe nuk mund ta besojë se funksionojnën kanalet e miqësisë së fuqishme të BFI-së me miqtë e vet ndërkombëtarë, të cilët janë të inforuar dhe informohen në hollësi me tërë këtë tmerr që po ndodhë në BFI nën përpjekjet e Shaqir Fetait për ta depersonalizuar në tërësi të vetmin Institucion fetar islam në vend! Prandaj dhe i kanë dhënë rolin e vëzhguesit pasiv, publik i rëndomtë, pa të drejtën e fjalës në asnjë panel! Sepse po rrenë shumë! Të gjithë e dinë, madje, kudo që qëndon i papërmbushuri me shëtitje nëpër botë, informohen dhe ata dinë gjithçka hala pa e hapur gojën e rrenës Shaqir Fetai. Të mos mendojë i gjori se është në bahçe të babës ku mund të bëjë gjithçka.../1KlikLarg/Lajme7/19.10.2022

## **Rroftë Talat Xhaferi, posht Talat Xhaferi**

**Në analet e Parlamentit të Maqedonisë, z. Talat Xhaferi do të ngelë, pa dyshim, si një prej kryeparlamentarëve me një instinkt të hatashëm i cili edhe e ka bërë një burrshtetas të padiskutueshëm**

*Nga Ilir Topi*

Rroftë Talat Xhaferi!

Një vit më parë, atij iu afrua si goxha “nën këmishë” instalacioni politik i shërbimeve të huaja që e vunë në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, me detyrë speciale për ta njetosur dhe komprometuar tërësisht si biografinë ashtu edhe karrierën e tij. Pak para se të hidhet Rusia në okupim të Ukrainës, ndonëse aroma e luftës po ndjehej gjithandej, Shaqir Fetai do ta presë në kabinetin e tij delegacionin e Putinit, delegacion ky me mision për të bindur liderë e pushtetarë të viseve ballkanike që babait të të vetmit aleat të Putinit (Ramazanov) t’i ngritet gjithandej përmendore, me theks të veçantë, në Tetovë! Po pse kaq i pashpirt Shaqir Fetai kundër Tetovës dhe tetovarëve!

Shaqir Fetai po këtë delegacion do ta dërgojë edhe në Palament të RMV-së, te Kryetari Talat Xhaferi, i cili, në shenjë të respektit dhe të besimit që kishte ndaj “bashkëpatriotit” të vet, Shaqir Fetait, do t’i pranojë këta misionarë putinianë pa i njohur dhe pa i ditur se kush janë! (Radio Evropa e Lirë pati një qasje kritike mbi këtë “aventurë” shumë të rrezikshme!)

Ky gjest do të ishte e vetmja gafë e Kryetarit Talat Xhaferi, për ç’gjë edhe ngelën me hatërmbetje shumë homologë të tij e politikanë ndërkombëtarë. Me instiktin e politikanit të stërpjekur që e karakterizon z. Talat Xhaferin, sapo krisi lufta në Ukrainë, do të jetë ndër ata politikanët e parë anekënd botës, që do të niset për ta vizituar Presidentin ukrasin, Zelinskin, dhe, në emër të të gjithë qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për t’ia shprehur përkrahjen e rezervë. Talat Xhaferi i qëndroi në fjalë e në besë Volodimir Zelinskit, i cili, këto ditë e dekoroi z. Xhaferi me medalje presidenciale për merita të rëndësishme në forcimin e bashkëpunimit ndërshtetëror, mbështetjen e sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial të Ukrainës si dhe kontributin e rëndësishëm në promovimin e shtetit ukrainas në botë. Këtë aktivitet e ka zhvilluar z. Xhaferi vetëm e vetëm për t’u shpëlarë nga gafa si dhe për ta dëshmuar orientimin e vet politik properëndimor, ashtu siç e ka në fakt edhe Partia e tij (BDI) prej nga vjen!

Megjithatë, poshtë Talat Xhaferi!

Ndonëse qenka angazhuar shumë për promovimin e shtetit ukrainas në botë, natyrisht, pasi ka siguruar bindjen ukrainase se është një njeri tek të cilët mund të mbështeten fuqishëm, z. Xhaferi paska pasur mundësi që ta rehabilitojë te autoritetet ukrainase edhe Shaqir Fetain. Dhe nuk e ka bërë këtë, duke e lënë Shaqir Fetain pa një “dekoracion” ukrainas! Poshtë Talat Xhaferi!

Me tërë atë instinkt prej politikani të urtë, si nuk e paska kuptuar nevojën e Shaqir Fetait për ta rehabilituar! Apo, instikti i tij ka kuptuar që Shaqir Fetai është një rus i papendueshëm në shpirt për të cilin nuk ia vlenë të angazhohesh aq shumë! Njeriu investon në vete duke u angazhuar jashtëzakonisht shumë për ta dëshmuar sinqeritetin, besnikërinë dhe ndershmërinë!

E Shaqir Fetai, sikur vetëm një garm të punonte për myslimanët e vendit sa ka punuar si “ORAO” për Stanko Dragoviqin e UDB-së, sot do të njihej më si njeri, e jo si qenie e pa sineqertë, jo besnik e i pandershëm!

Sikur vetëm pak të rrinte urtë Talat Xhaferi, me garancë sot do ta kishte një “dekoracion” nga Putini që do t’ia siguronte Shaqir Fetai. Por edhe ky Talat po luan bisht në sy të Shaqir Fetait, prandaj – Rroftë Talat Xhaferi, poshtë Talat Xhaferi!/**BotaPress/23.10.2022**

**Institucionalizimi i gënjeshtërs për justifikim të zhatjes**

**Kur është në pyetje vjedhja dhe zhvatja e pronës së përgjithshme, atëherë kjo mundësohet vetëm përmes institucionalizimit të genjeshtrës. Në raste të tilla, kur dora e hajnisë funksionon në mënyrë perfekte, atëherë genjeshtrën e praktikon madje edhe “kleriku i devotshëm”**

***Nga Halid Sadiku***

Këto ditë, instalacioni politik në krye të Bashkësisë Fetare Islame në RMV, Shaqir Fetai, paska pritur në zyrën e vet një mysafir nga Kuvajti, një personalitet të respektueshëm nga bota akademike arabe, ekspert i çështjeve të vakfit, Shejh Hisham Ferhud El Mubarek! Informacioni nuk tregon se mysafir i kujt ishte ky personalitet, arsyen e qëndrimit të tij në RMV dhe me ftesë të cilit subjekt Shejh Mubareku gjendet në Shkup! Sido qoftë, lëvizja e njerëzve është e lirë dhe ata mund të gjenden kudo ku kushtet janë të përshtatshme për mysafirllëk!

Shaqir Fetai e paska informuar mysafirin e lartë me “letërnjohtmin” e BFI-së! “Fillimisht mysafirin Shejh Hisham Ferhud El Mubarekun e njohtova me organizimin dhe funksionimin e BFI e RMV si dhe synimet e saja në organizimin e jetës fetare”, informon Shaqir Fetai! Se cilat mund të jenë synimet e një organizate pa platformë dhe pa program por dhe pa planin akcional, këtë mund ta dijë vetëm Shaqir Fetai, i cili, botërisht dihet se ka për mision shkatërrimin e Institucionit të BFI-së si dhe dezorganizimin dhe sekrtarizimin e myslimanëve të vendit!

A i tregoi Shaqir Fetai mysafirit të lartë kuvajtas se BFI-ja organizon jetë fetare jashtë çdo rregulloreje të miratuar nga organet më të larta të BFI-së dhe jashtë kushtetutshmërisë së saj! A i tregoi Shaqir Fetai mysafirit kuvajtas se BFI-në e ka shndërruar në ojq private-personale, e cila kurrë nuk mban mbledhje të nivelit të lartë, dhe se praktikën për të raportuar para organeve më të larta të BFI-së (Rijasetit dhe Kuvendit) e ka devaluuar deri në mohim të këtyre organeve.

Po pse e paska pritur këtë ekspert të vakëfit? Për ta pyetur nëse ka gabuar që i ka refuzuar investitorët arabë të cilët veçmë kishin filluar projektin 5-6 milion dollarrë në qendër të Gostivarit ku parashihej që godina të behej pjesë jetike e vakëfit të kësaj Myftinie të BFI-së! A i tregoi mysafirit se investitorët arabë ikën të trishtuar nga Gostivari pasi që “myftiu” i Gostivarit, Shaqir Fetai, kishte vendosur t’iu kërkojë haraç për investimin e tyre!

A mos e pyeti mysafirin e lartë, Shejh Hisham Ferhud El Mubarekun, nëse ka bërë haram për vjedhjen e pronës vakufore, një parcelë për vete dhe një për funksionarin e madh të vendit, nga klerarkia më e lartë shtetërore! Këtë vjedhje Shaqir Fetai e bëri deri sa ishte myfti i Gostivarit, duke e mashtruar edhe ish-reis ul ulemanë! Po tani, si “reis”, Një Zot e di se çfarë vjedhjesh ka bërë, duke qenë i sigurtë se nuk do t’i raportojë askujt! Por ama, organet gjegjëse shtetërore e dinë datën e saktë kur e përvetësuan pronën e vakëfit, e dinë saktë, me emër e mbiemër se kush i vodhi këto dy prona (natyrisht, Shaqir Fetai me një “mikun” e vet, funksionar i lartë shtetëror! Nuk është për t’u habitur nëse ua nxjerr emrat VMRO dhe nëse i ka përfshirë në mesin e këtyre 127 funksionarëve të qeverisë aktuale që paskan prona të padeklaruar!)

Jo po, është nënvizuar qindra herë se Shaqir Fetai është një trukaxhi tepër naiv. I bën disa punë që në kushte normale, pa përkrahjen e shërbimeve nëntokësore, vështirë se do t’i rrekej atyre punëve të pista. E sjell kuvajtasin këtu vetëm sa për të hyrë në pazar me të që, ai, në Kuvajt, të ndikojë dhe sërish ta hapin çështjen e financimit të një numër të caktuar të teologëve, si dikur, para disa vitesh. Shaqir Fetai insiston që “lista e rrogave” të fillojë me të dhe me na dy-tre bashkëpunëtorë të tij, për të cilët ai garanton se mund të jenë lojalistë të atyreve që financojnë rroga!

Tashmë Shaqir Fetai e ka siguruar një rrogë nga Emiratet e Bashkuara Arabe, gjë të cilën e dëshmon madje vetë personi që u bë sekser i sigurimit të kësaj rroge, ekskluzivisht për Shaqir Fetain!

Ky farë “reisi” e ka për zemër që të sigurojë gjithçka për vete; t’i shfrytëzojë financat e BFI-së që nëpër botë të sigurojë rroga ”të misterhme” për vete! Madje, di edhe të luaj politikë me bashkëpunëtorët e vet: më përkrahni mua se do t’ju soguroj të gjithëve edhe nga një rrogë! Po pse të huajt të të japin rrogë? Cila është marreveshja dhe cili duhet të jetë ai shërbim për ta merituar atë rrogë! Imamllëku? Devotshmëria? Pse, këto cilsi stërviten dhe ruhen për rrogë të dytë e të tretë! Nuk janë për Allah?

Provën e cinizmit dhe të talljes me bashkëpunëtorët të vet Shaqir Fetai e dha muaj më parë kur, i mori në një udhëtim “zyrtar” në Arabinë Saudite të gjithë anëtarët e Rijasetit të tij dhe që, që të gjithë i la të flinin në një dhomë, si delet e stanit! Natyrisht, për vete kishte “suitë”, mënyrë kjo për t’ua bërë me dije anëtarëve “të Rijasetit” se kush është këtu “baba”!

A e pyeti Shaqir Fetai mysafirin e lartë kuvajtas, Shejh Hisham Ferhud El Mubarekun, a është hallall zhvatja dhe vjedhja e vakëfit; a është hallall shfrytëzimi dhe keqpërdorimi i letrave në vlerë që u dhanë nga qeveria maqedonase gjatë procesit të denacionalizimit; a e pyeti mysafirin kuvajtas se a është hallall dhe a llogaritet si shitje e pronave të vakëfit keqpërdorimi i letrave me vlerë të ndarë nga qeveria maqedonase për BFI-në; a i tregoi mysafirit të lartë se si për tu mbajtur mirë me qeverinë dhe me shërbimet antiislame dhe antikombëtare ka pranuar çmime qesharak në shenjë denacionalizimi të pronës së vakëfit. Në fakt, a i tregoi Shaqir Fetai se çfarë ka bërë me ato letra në vlerë, meqë deri më sot nuk ka blerë dhe nuk ka shtuar asnjë cenimetër vakëf nga ato bono të qeverisë në vlerë prej miliona eurove: i shpenzoi për rroga, i shpenzoi duke blerë rehati karrieriste apo i shpenzoi duke sponsorizuar grupe, sekte e lëvizje që nuk përkojnë askund me islamin dhe me shkollën juridike të cilës i përkasin myslimanët e vendit.

Një ditë, Shaqir Fetai do të japë llogari, do të përgjigjet para drejtësisë se a i shpenzoi me dedikim të gjitha ato bono në vlerë; një ditë do të përgjigjet për zhvatjen dhe për vjedhjen e pronës së vakëfit, e cila do t’i merret mbrapsht atij me gjithë “mikun e ngushtë” nga niveli i funksionarëve shtetërorë i cili, meqë është patriot i madh dhe atdhetar maqedonas, nuk prek pronë të shtetit por ia ka qejfi të përvetësojë nga prona e vakëfit. Këtë vjedhje Shaqir Fetai mundohet ta mbulojë me kthim të disa livadheve plot me shkurra e therra, për ç’gjë shkumon duke e theksuar këtë “sukses” ndërsa si pulë e lagur rri para faktit se ka vjedhë dhe ka përvetësuar vakëf, duke e njollosur edhe mikun e vet politikan, siç rri si pulë e lagur edhe para faktit se tash e dinë edhe organet gjegjëse shtetërore se, edhe ai edhe miku i tij, kanë hedhur mbi vete vakëf duke e vjedhur vakëfin e Gostivarit, siç e dinë edhe për rrogën e tij të dytë e të tretë të siguruar nga një përfaqësues shtetëror në EBA! I dinë edhe komisionet, të cilat do t’ia aktualizojnë sapo të mundohet Shaqir Fetai të paraqitet shqiptar e mysliman! Ai është i mallkuar që përjetë mbi kurriz të vetin, si “afis”, të mbajë njolla të papërballueshme të harmit!/**TetovaSot/27.10.2022**

**Shaqir Fetai bën qufër qëllimisht apo nga injoranca**



## ***Nga Valbon Osmani***

I është thënë Shaqir Fetait miliona herë që as mos të pallamudë si “filozof i atrofizuar në tru” por as të mos shkruaj sepse, gjithnjë është i prirur t’ia fusë kot, madje edhe të bëj qufër e shirk! Ja, për shembll, duke dashur që për ditën e sotshme, ditë e xhuma, të shkruaj dy-tre fjali, ai, më së paku në dy fjali e tregon injorancën e vet, apo edhe prirjet e tij për t’u tallur me vlerat islame. Në një postim prej shtatë fjali në facebook-un e vet, ai në më së paku dy fjali e shpalos shpirtin e vet katran. Shaqir Fetai thotë: “Kjo ditë freskon shpirtin, mendjen dhe besimin tek Zoti i Madhërishëm...”

Cilido që ka dy gram logjikë, cilido që di të flasë e të shkruajë shqip, cilido që ka dy habere me sintaksën e gjuhës shqipe, sakaq do të shohë tek kjo fjali e Shaqir Fetait se, kjo ditë ka impakt, ndikim, direkt te Zoti i Madhërishëm. Do me thënë, sa herë që vjen dita e xhuma, feskohet shpirti tek Zoti; freskohet mendja tek Zoti; freskohet besimi tek Zoti i Madhërishëm! Pavarësisht se çka mendon Shaqir Fetai, ai me këtë fjali ka dëshmuar injorancën e vet. Ata që e njohin e dinë fare mirë se çfarë ka dashur të thotë por, kjo nuk e shpëlanë nga veprimet e tij të qëllimshme për të bërë qufër duke e përdorur injorancën si justifikim. Do të thotë ai, patjetër të gaboj sepse një jetë të tërë e kam kaluar duke folur serbokroatisht.

Tutje, Shaqir Fetai, duke u shtirur si injorant i klasit të parë, do ta përdorë edhe këtë fjali katastrofale: ”Ngrit vetëdijen mbi Zotin, vetveten, familjen dhe njerëzve...”

Mbi Zotin nuk ngritet asgjë dhe, mbi Të mund të ngrisë diçka vetëm Shaqir Fetai sepse, deri më sot, katërcpërisht ka dëshmuar se i ka hije shumë që të bëjë qufër e shirk! Si mor kjo ditë ta ngritkëka vetëdijen mbi Zotin! Kjo ditë të afron tek Zoti dhe nuk të ngritë mi të! Madje kjo ditë nuk ta ngritë vetëdijen as mbi veten dhe mbi familjen. Kjo ditë të vetëdijëson si asnjë ditë tjetër që ta duash veten, që të bëhesh më i dashur me familjen, ta duash veten e të të dojë familja!

Shaqir Fetai në çdo moment mendon, logjikon në serbokroatisht, në vete përkthen nga serbokroatishtja dhe tek pastaj ia futë kot në gjuhën shqipe. Ai e ka të ndaluar (mbase edhe ndëshkim nga i Madhi Zot) që të mendojë serbokroatisht e të shkruajë shqip. Shërbimet më të “fuqishme” i ka bërë në serbisht, prandaj me shqipen nuk i bëjnë punët

fare!**1KlikLarg/Opinione/28.10.2022**

**A ju kujtohen fletoret e kujtimeve? “Unë ndër mollë, ti ndër ftua, mos harro se të dua”, “Vij nga shkolla në shtëpi, mendjen e kam te ti”, “ha-ha-ha, hi-hi-hi, ta uroj vitin e ri”, “isha i sëmurë, isha duke ndejt, erdhe ti, më shnoshe krejt”... Tani kemi avancuar! Kemi edhe “përkujtime elektronike”! Po si duket një e tillë? Veç hyni në fb-un e Shaqir Fetait, madje edhe më katastrofale, shikojani faqen zyrtare BFI-së që e ka shndërruar tërësisht në fletore kujtimesh të adoleshentit me buzë të shkrumbuar e me sy të përvuajtur!  
Subhanallah!**

***Nga Blerim Hoxha***

Asnjë nga faqet zyrtare nuk mund të jetë më e pështirë se kjo aktualja e BFI-së? Faqet zyrtare janë për informacione të shpejtë që flasin për aktivitetin e firmës, të organizatës, të komunitetit, për aktivitete që i bëjnë nder organizatës, që i sjellin përfitime orgaizatës, që është një hajër i përgjithshëm!

Shaqir Fetai e përdor për t’i shëruar kompleksët e veta! Shaqir Fetai ka zgjedhur avdallçe mënyrën e “heshtjes” së problemeve gjithnjë e më të mëdha, ka zgjedhur që të shpërftyrohet në struc, i cili, nga frika di të reagojë duke e futur kokën në rërë, ndërsa b... e ngrit kah dielli! Masat dhe mjetet populliste janë, pa dyshim, skema nga më të pa pëlqyerat nga një lider që është me tru normal, që ka një gram ndërdije! Po çka i duhen Shaqir Fetait këto masa populliste? Shaqir Fetai është shumë i ndërgjegjshëm për injorancën e vet, është shumë i ndërgjegjshëm për aftësinë e tij për të thurrur intriga, është shumë i ndërgjegjshëm për afinitetet e tij për përçarje, për vjedhje, për shkatërrim dhe degradim të vlerave të shëndosha. Është, tamam siç e kanë definuar disa miq e shokë që e njohin shumë mirë: “hafëz” i intrigave, “hafëz i rrenave”, “hafëz” i shkeljes dhe mosnjohjes së çdo norme institucionale, njerëzore, morale, fetare...

Shaqir Fetai e di fort mirë se si erdhi në krye të BFI-së, dhe, pa dyshim që këtë gjë e ka peng shpirtëror. Ai e di dhe e vuan tepër shumë tradhëtinë që ia bëri “babait shpirtëror”, H. Sulejman ef. Rexhepit, të cilit i shërbeu deri me një verbëri totale; ai e di fort mirë dhe e vuan së tepërmi faktin që e instaluan disa struktura të dyshimta dhe që nuk e meriton atë vend të cilin e uzurpoi. Shaqir Fetai është shumë i ndërgjegjshëm se shumë shpejt do të vie dita kur do të turpërohet kur të dalë edhe para familjes së vet të ngushtë; do të shpalosen të gjitha vjedhjet e tij, të gjitha dëmet e tij që ia ka bërë BFI-së, të gjitha lojërat që ia ka luajtur pas shpine Institucionit; Shaqir Fetai është i tmerruar nga fakti që ka zënë një pozitë për të cilën kurrë nuk ka qenë i denjë, ndërsa e ka lakmuar deri në mohim të islamit, vetëm e vetëm që të jetë në pozitë të vjedhjes si dhe të kamufllimit të biografisë së tij të zezë!

Këtu “fshihet” arsyeja se pse Shaqir Fetai ka aq shumë dëshirë të jetë “popullist”! Pse insiston në një “faqe zyrtare” përplot me ”kujtime” që nuk i hynë asgjë në punë BFI-së. Ai nuk e ka mendjen te e mira e BFI-së, ai e ka mendjen se si të bëhet sa më “i pranuar” në masë! Prandaj, faqa zyrtare e BFI-së, është kopje e zbehtë e fb-ut të tij personal, është fletore turpëruese e kujtimev të një nxënësi të perjetshëm! “Sot, reisi priti nxënësin e vet”, “Sot reisi priti hafiz dudukun”, “Sot reisi ngushëlloi filanin”, “Sot reisi vizitoi profesorin e vet”, “Sot reisi priti ish-rektorin”, “... priti ambasadorin”, “... priti një delegacion rus”, “inspektoi punët e ndërtimit të xhamisë në Tunguzi”, “priti imamin e xhamisë në Pallçishtë, atë nga Çegrani, atë nga Vijena, atë nga Roma...” “Reisi vizitoi lokalim “Qevapçiçi” dhe ia doli të hajë dhjetë qebapa”... etj. etj.! Të tillë tituj ke me bollëk, as me lopatë nuk mund t’i mbledhësh në atë “portal zyrtar” të BFI-së të cilën e ka shndërruar në paçavurë neveritëse. “Arkivi” nuk mund të shndërrohet në fletore

kujtimesh të kota! Secili mysliman e di, si Zotin Një se, me ato "ekzibicione" cirkuzante të Shaqir Fetait, Institucioni i BFI-së nuk fiton asgjë prej gjëje! Shaqir Fetai e bjerr kohën kot në BFI, Shaqir Fetai paguhet majmë, e shpenzon trash BFI-në vetëm për atë kohë që e humb duke u angazhuar për "kujtime" në fletorën e vet të turpshme! A ka më gjynah se të humbësh kohë, ta dëmtoshë buxhetin e BFI-së për të siguruar "pika populliste" siç e bën i gjori!

Shaqir Fetai do të sigurojë alibi që një ditë, kur do të nxirret para gjyqit për shumë vepra penale të tij, të thotë "po mua më kanë dashur! Ja, ja, çdo ditë kam qenë i vizituar"! Apo, ndoshta të justifikohet turpshëm para familjes së vet "kur unë vidhja e shkatërroja gjithçka në BFI, më donin, më vizitonin çdo ditë, nuk kishin vërejtje në veprimet e mia"!

Po pra, një ditë Shaqir Fetai do t'i involvojë dhe do t'i përshijë në krime të veta të gjithë ata që i shërbejnë si marioneta, të gjithë ata që e vizitojnë, "që e respektojnë", "që e nderojnë" sa për t'ia pirë një çaj! Edhe në aspekt të çajit e të kafes Shaqir Fetai i kushton jashtëzakonisht shtrenjtë BFI-së! Pse a mos e ka futur ndonjë herë dorën në xhep të vet për ta bërë "një sevap" me këta që e vizitojnë duke i çuar në ndonjë "qevapçillnicë"! Jo pra, se atje vizita merr kuptimin e takimit privat. Ky është njeri "zyrtar"! Është grykës i pangopshëm, siç po tregohet edhe përgjatë përdorimit të masave manipulative me "vizitorë" të shumtë që ia zberthejnë në mënyrë të përkryer dashurinë e ndytë për popullizëm!/**TetovaSot/04.11.2022**

**Hajnat dhe qentë e uritur**

A e dinë marionetat e Shaqir Fetait se çka do të thotë ndihmë humanitare, çka do të thotë ojç, çka do të thotë shtet, dhe çka do të thotë ndihmë nga një shtet për një institucion të shtetit tjetër! Konkretisht, “myhybët” cirkuzantë të Shaqir Fetait, ndajnë “ndihma” në Medresenë Isa Beu! Thonë se këta ndihma erdhën nga “disa faktorë” nga Kuvajti, ndërsa në “banderolën” e vënë skaj një furgoni të rraskapitur e të mbushur me ca kutia, shkruan se “ndihma” është e SHTETIT TË KUVAJTIT!!!

A ka gjë më të turpshme? A ka përpjekje më idiotike për ta devaluuar Shtetin e Kuvajtit? Pse a në këtë formë po shpërndakëka ndihma Shteti i Kuvajtit në një shtet tjetër? Si bëhet ndihma e një shteti dedikuar shtetit tjetër! Kjo bëhet ose me vendim të qeverisë, ose me ratifikim të ndonjë marrëveshje nga ana e dy parlamenteve gjegjëse në të cilën marrëveshje parashihihen edhe ndihmat konkrete! Shaqir Fetai me këmbëngulje vazhdon përpjekjet për ta rrejtur opinionin dhe për t’ia bërë vetes qejfin: të paraqitet si “talent” për bashkëpunim bilateral ndërshtetëror, të paraqitet si shtetar që mund të arrijë edhe bashkëpunim në mes të “shtetit” të vet dhe Shtetit të Kuvajtit! Janë përpjekje të kota, sepse të gjithë e dinë se fuqia e tij është në penjtë e lidhur për gishta të pronarit që e lëviz marionetën, të gjithë e dinë se është instalacion politiko-partiak dhe se, të gjithë e dinë që është intrigant i hatashëm që lojën mundohet ta luaj përmes myhybëve të vet me të cilët kënaqet që janë që të gjithë nën nivelin e tij. Kurse niveli i tij është “i burrshtetasit” apo “i mbretit”, me fuqinë e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale, me obligimin shtetëror për t’i vizituar ambasadorët e shtetit dhe, me të drejtën e “zotit” për ta vjedhur vakëfin dhe për t’ia dhuruar atë “politikanëve” që ia mbajnë iso-n në shkatërrimin total të BFI-së! Shteti i Kuvajtit kurrë nuk nisë një furgon me disa kompjutorë e me tabela elektronike për Medresenë Isa Beu! Shteti i Kuvajtit mund të kryej një ndihmë të tillë përmes transaksioneve bankare dhe me dedikim konkret, ose, institucionet gjegjëse të shtetit të Kuvajtit mund ta përkrahin ndonjë projekt të ndonjë organizate vendore, e cila ka konkuruar për qëllime dhe ndihma konkrete! Cili është ai projekt? Cilat janë implikimet financiare të atij projekti? Kujt ia lëshoi paratë Shteti i Kuvajtit dhe, cila është ajo shifër? Sa nga ato para u përdorën për ta realizuar projektin dhe sa u futën nëpër xhepa! Ku u blenë ato paisje për t’ia falur Medresës! A kanë fatura ato pajisje!

Dhe, për të qenë ironia edhe më e madhe, në po të njëjtën banderolë shkruan se “e realizon Bashkësia Fetare Islame”! Çka realizon BFI-ja e Shaqir Fetait? Vjedhjen e ndihmës humanitare? Apo, e realizon fshehjen e “donatorit misterioz”, të “disa faktorëve nga Kuvajti”! Një Institucion serioz kurrë nuk do ta bënte këtë gafë, siç nuk do të shkruante në baderolë as “Projekti: Furnizim me smart-tabela për Medresenë Isa Beu”, kurse në “informacion” nënvizojnë se u dorëzuan disa kompjutorë, pesë smart tabela si dhe “veshja me tepik kualitativ të mesxhidit”! Përpjekje galopante për të vjedhur nga kjo ndihmë “kuvajtase”, përpjekje galopante për të shkaktuar huti dhe “edhe ujku i ngopur edhe qingjat në vend”! Turp, kurse për Shaqir Fetain lezet! Edhe diçka, për stafin injorantë të kryeinjorantit Shaqir Fetai: projekti është projekt dhe ndihma është ndihmë! Nëse ky “projekt” qenka donacion humanitar kuvajtas, nemelazëm të paraqitet si projekt? Apo, edhe kësaj hajnie Shaqir Fetai i thotë projekt! Vetëm mos ta turpërojnë Shtetin e Kuvajtit, i cili, më përpara do ta mohonte islamin se sa të merrej me ndihmëma prej pesë smart tabela për një institucion! Ofendim intrigantësh që i shprehet Kuvajtit nga disa të papërgjegjshëm që i shërbejnë intrigantit të pashoq, Shaqir Fetait.

Kur është fjala te projektet si aktivitet kompleks, është mirë që Shaqir Fetai të ngrisë institucionalisht alarmin dhe të bëjë diçka për t’i shpëtuar nxënësit e Medresës Isa Beu, oborri i së cilës po vlonë nga qentë endacak, të zgjebosur e të uritur. Në Medrese mund të hynë edhe delegacione të ndryshme të vendit e ndërkombëtar! Ata qenë të “medresesë” nuk e kanë hallin te

delegacioni por te ushqimi! Të mos përsëritet ngjarja skandaloze siç ndodhi këto ditë kur disa qenë desh e shqyen një “shkencëtar” të Shaqir Fetait, i cili, tërë këtë ngjarje po e rrëfen si barcoletë e duke u zgërdhirë si i çmendur nëpër ndeja me bosh-muhabet. “Funksionari” i tij po lëngon nga kafshimet e rënda që ia shkaktuan qentë në oborrin e Medresesë, dy ditë para se ta furnizojnë Medresenë me “disa kompjutorë”! Medresja ka nevojë për një projekt i cili do të siguronte kompjutorë të nevojshëm për të gjitha “medresetë” e vendit dhe jo vetëm “disa”, siç ka nevojë për ta siguruar me rrethojë adekuate që do ta mbronte ambientin e jashtëm prej qenve e prej hajnave!

Me disa kompjutorë e me pesë smart-tabela nuk mund të kompensohet tmerrri që u shkaktua me kafshimin e “funksionarit” të Shaqir Fetait nga “banorët e çartur” të oborit të Medresesë që rrezikojnë gjithësecilit që jeton aty brenda!**1KlikLarg/Fakte/06.11.2022**

**Pse frikë nga ndryshimet**

**Komunistët e periudhës post-komuniste, spiunët përmes të cilëve mbahej ajo ideologji e mbrapshtë dhe, mediokrët që ia “zgjasnin jetën” atij sistemi antihuman, janë tri kategori që në mënyrë plastike dëshmojnë se sa të rëndë e kanë të ndryshohen kur ka ndryshime! Pranojnë ndryshimin e sistemit por jo dhe të ndryshojnë vetë, qoftë në karakter qoftë në pozita drejtuese. Sepse, i bie që pastaj ta gjejnë veten në fundbishtin e kalit. Prandaj sot i ke gjithandej, në pozita drejtuese e shërbyese, të thyeshem e të lakueshëm, si marioneta**

***Nga Mr. Eset Shaqiri***

Derisa Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI insiston në ndryshim rrënjësor, si në organizim ashtu edhe në drejtim të këtij Institucioni shekullor islam në RMV, “struktura mentale” e përfaqësuar nga instalacioni politiko-partiak, Shaqir Fetai, as që pranojnë të ketë ndryshime. Pse, çka thotë temperament i kësaj “strukture”? Kush mundohet t’i rezistojë ndryshimeve nëse jo ata që i frikësohen ndryshimeve Po pse Shaqir Fetai dhe myhybtë e tij aq shumë i frikësohen ndryshimeve? Mbase tashmë deri në palc janë frikësuar nga Shaqir Fetai me atë rrëfimin e plakave të ngrata nëse nuk fle vjen “babaroga” e të ha, ose “nëse nuk më bindeni mua e nuk më qëndroni nën këllqe, vjen Afrimi e ju “ha”!

Kush ka frikë nga ndryshimet? Vetëm ata që e njohin veten, që e dinë se nuk dinë të punojnë ndryshe, që nuk mund t’i përshtaten ndryshimeve ngase ndjehen shumë komod në “standardet” që i ka instaluar Shaqir Fetai: pasivitet, servilizëm dhe nënshtrim – përtej kësaj do të ndjehen si të burgosurit që kanë rënë në rini në burg e që lëshohen pas 30-40 viteve: sapo ata të dalin jashtë portave të larta të burgut, sërish kthehen brenda, sepse në mungesë të kontaktit me jetën e jashtme, humben, nuk dinë të funksionojnë në këtë ndryshim kaq radikal!

Shaqir Fetai me marionetat e veta nuk mund ta përceptojnë ndryshimin si diçka në të cilën ka edhe humbje por ka edhe fitim, madje fitimi gjithnjë është mijëra herë më i vlefshëm se dëmi nga humbja! Pa dyshim që një fitim i tillë do të sillte vlera edhe në punë, edhe në jetë, edhe në shoqëri! A mund të lejojmë që të gjitha këto vlera, tërë ky përfitim madhor të humbë për shkak të frikës së Shaqir Fetait nga ndryshimet eventuale?!

Servilët e Shaqir Fetait nuk duan ndryshime, sepse janë më se të bindur se mirë janë kështu, sepse nga ndryshimet askush nuk përfiton asgjë, nuk mësojnë asgjë të re, madje as që kanë nevojë të mësojnë të renë, sepse u mjafton kjo “dituri” e “njohuri” që e kanë! Këta nuk duan t’ia dinë se, ata mundet edhe të mos përfitojnë asgjë, sepse nuk e kanë konceptin mbi të renë, por ama ndryshimet gjithmonë i kanë sjellë përfitime të mëdha opinionit të gjërë! Nga reformat mund të mos përfitojë asgjë Shaqir Fetai dhe as “shaqirovcit” e tij të BFI-së, por ama, popullata myslimane gjithësesi që do të përfitonte ndjeshëm!

Shaqir Fetai ta përkujton atë figurën e mbretit në fushë të shahut! Përreth i ka mbretëreshën, oficerët, kuajt, topat, përpara i ka ushtarët. Ata presin të lëvizin por vetë nuk mund të lëvizin. Fuqia dhe roli i tyre do të vie në pah varësisht intelegjencës dhe shkathtësisë së lëvizësit! Shaqir Fetai nuk mund të funksionojë pa marrur urdhëra sabah për sabah! Nuk mund të lëvizë pa lëvizësin! Mbreti i shahut, si Shaqir Fetai, duhet të mbijetojë deri në fund dhe, për këtë mbijetesë do të jetë në gjendje ta flijojë mbretëreshën, oficerët, kuajt, topat madje edhe ushtarët. Sepse, nëse vdes mbreti i pari, është mat, fundloja!

Shaqir Fetai nuk është nga ata “mbretër” që do të sakrifikohej vetë për hirë të së mirës së përgjithshme, nuk do të jepte asgjë nga vetja për të pëfituar myslimanët e vendit! Sepse ai konsideron se nuk ka asgjë çfarë të japë, prandaj duhet të marrë sa më shumë nga myslimanët e vendit që të ketë pastaj se çfarë t’u japë! Ai këtë raport nuk mund ta konceptojë si sistem, si vlerë

e përgjithshme, si mirëqenie dhe prosperim, por e koncepton vetëm si mundësi për përfitime personale. Të vetmin ndryshim që e ka pranuar dhe që tashmë e ka etabluar mirë ndër myhybët e vet është shkeljet kushtetutare deri në mohim të Kushtetutës së BFI-së dhe në institucionalizim të anarkisë! Më mirë të bëhet ashtu siç thotë Shaqir Fetaj, sepse mund të vie Afrimi e pastaj... Pastaj mund të marrin fund talljet me organet e BFI-së, siç ishte tallja e fundit e Shaqir Fetajit me Kuvendin e BFI-së, mund të marrin fund rrogat arabe për Shaqir Fetajin, mund të marrin fund vjedhjet e vakëfit apo përfitimi i përkrahjes politike në këmbim të vakëfit për politikanë, apo, dorëzimi i të gjitha banesave të përfituara hajnisht në objektet që po ngriten te “Komunaleci”... Meqë ra fjala për “Komunalecin”, gjithësesi që, bashkë me ndyrshimet që do të ndodhin në BFI do të shtyhet edhe procesi gjyqësor për të hetuar krimin që po i bëhet BFI-së me “harrimin e ndërtimit” të Hotelit të BFI-së gurthemeli i së cilës zyrtarsht u hodh katër vite më parë e që duhej të përfundonte brenda dy viteve. Dëm kolosal ky për vakëfin e BFI-së! Ata që duhet të përfundojnë në burg duhet edhe të frikësohen nga ndyrshimet! Por ama, burgut nuk mund t’i shpëtojnë, siç nuk mund t’i rezistojnë pas konfiskimit të vakëfit të vjedhur!/**TetovaSot/08.11.2022**

**Askujt nuk i hyn në punë një BFI, pa identitet e me integritet të parcializuar**

***H. Afrim ef. Tahiri, ish-sekretar gjeneral i Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut, aktualisht drejtues i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI, është mbase i vetmi faktor në Ballkan e më gjërë që ushtron opozitarizëm karshi një bashkësie fetare. Siç nënvizon efendi Tahiri në këtë intervistë për JetaPress.com, opozitarizmi i tij konsiston në kthimin e BFI-së në kushtetushmëri, në stopim të angazhimeve të “strukturave” të diskutueshme që janë përgjegjës për rrënim të BFI-së, për rrënim të vlerave islame, për dezorganizim të xhematit dhe për frakcionim të myslimanëve të vendit. E gjithë kjo gamë e dukurive antisllame brenda dhe rreth BFI-së bëhet, siç thotë H. Afrim ef. Tahiri, vetëm e vetëm që të defokusohet vëmendja nga vjedhja e madhe që bëhet në buxhetin si dhe në vakëfin e BFI-së si dhe nga misioni për defaktorizim të Institucionit fetar islam në RMV***

***Nga Rejhane Rexhepi***

***Efendi Tahiri, nga viti 2006 e deri më vitin 2015 ju keni qenë sekretar gjeneral i Bashkësisë Fetare Islame në RMV! Pastaj u larguat dhe tashmë drejtoni një Lëvizje Myslimanëve për Reforma në këtë Institucion! Pse u larguat?***

Ndërkëmbëzat që i vinin këtij Institucioni nga qarqe të caktuara të pushteteve politike, përpjekjet për ta partizuar si dhe për ta kriminalizuar BFI-në, më vitin 2006 e kishin sjellë Institucionin në fjalë buzë falimentimit dhe mbylljes. U desht një luftë e pakompromis për t'i refuzuar të gjitha përpjekjet dhe ofertat jo të sigjerta si dhe punë me myslimanët e vendit për ta rikthyer besimin tek Institucioni i BFI-së! Sërish ia kthyem atë forcë e fuqi që e kishte BFI-ja viteve pas pavarësisë së Maqedonisë së Veriut. Në emër të myslimanëve, në emër të islamit, në emër të bashkëjetesës fetare nuk mund të vendoste shteti, madje as për paqe e kohezion, pa u pyetur dhe pa marrur miratimin e BFI-së! Ky Institucion e kishte bërë të qartë faktin se shteti nuk e gëzon besimin e BFI-së, pasi që shteti, nuk kishte përmbushur asnjë kërkesë racionale të BFI-së! Në Konferencën ndërkombëtare kushtuar bashkëjetesës fetare, e cila organizohej nga ministria për kulturë e nën patronatin e kryeministrit, përfshirjen e BFI-së e kushtëzuam me ndërtimin e Xhamisë së djegur në Prilep gjatë konfliktit të 2001-shit, kërkuam që ne të jemi ftues të personaliteteve nga bota islame dhe, gjuha shqipe të ishte zyrtare në këtë Konferencë! Këto kërkesa nuk plotësoheshin ndërsa pa pjesëmarrjen e BFI-së nuk kishte kuptim mbajtja e Konferencës ndërkombëtare, kështu që, fuqia e shtetit nuk po ia dilte ta “lakojë” BFI-në, ndaj dhe kjo konferencë më 2013 dështoi! Natyrisht, shteti nuk do të rrinte duarkryq, nisi t'i përpunojë disa individë nëpunës të BFI-së. Unë me kohë i kisha dedektuar si hajna, si të dyshimtë, si bashkëpunëtorë të shërbimeve të dyshimta (madje edhe policore!) ndaj dhe, para ish-reisul ulemasë kisha vetëm një kërkesë: ta pastrojë BFI-në nga individë që po bëheshin gjithnjë e më të rrezikshëm, që nuk po i shërbenin islamit dhe as popullatës myslimane por, djallit! Qëndrimi im në BFI u kushtëzua me largimin e elementit të dyshimtë, për të cilin dyshime të bazuara kishte edhe vetë ish-reisi. Me gjasë, të korruptuarit, hajnat e spiunët patën ndikimin më të madh dhe, më 2014 u dorëhoqa. Pas premtimeve se punët do të fillojnë të përmirësohen, u riktheva deri në largimin tim më 2015. Jasht tashmë dal nga dal, po formohej një Lëvizje që kërkonte me ngulm reforma në këtë Institucion. Kërkesë e kësaj Lëvizje ishte që t'i prij deri në realizimin e asaj reforme për ç'gjë hartuam Platformë dhe program veprimi!



***Kur e kishit më të lehtë të drejtonit: si sekretar gjeneral i BFI-së apo si kryetar i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI?***

Si sekretar i përgjithshëm kisha detyrë dhe obligim për ta institucionalizuar jetën fetare islame si dhe për ta bindur opinionin e gjërë mysliman se Institucioni është i tyre, se bashkëpjesëmarrës në ngritjen dhe në rimëkëmbjen e Institucionit do të jenë vetë ata dhe, për çdo gjë, fjala vendimtare do të jetë e vetë atyre, si kontribues absolut në buxhetin e BFI-së! Këtij qëllimi mund t'ia arrijnë fare lehtë vetëm njerëzit e pastër, të sinqertë dhe pa kurrfarë hipoteke! Elhamdulillah, ia dolëm me sukses!

Sot, drejtoj një Lëvizje Myslimane për Reforma në BFI, pra, nuk jam kryetar, por, me insistim të miqve dhe dashamirëve të BFI-së, drejtoj një Lëvizje. Nuk jam kryetar sepse nuk jemi të regjistruar si organizatë, nuk kemi bord, nuk kemi status, nuk kemi dashur të jemi “organizatë” që do ta konkurrojmë BFI-në! Thjesht, përfaqësojmë dëshirën e zjarhtë të shumicës myslimane për mbarësi në BFI; jemi opinion që artikulon të gjitha shkeljet kushtetutare që bëhen në BFI, që shpalos të gjitha dukuritë imorale që ndodhin aty, që insiston në departizimin dhe depolitizimin e BFI-së, që këmbëngul në kthim në identitetin e vet, në personalitetin e vet me plotë integritet! Kërkojmë debat publik, t'i ballafaqohjmë faktet dhe, të binden të gjithë ata që sot janë instaluar në krye të BFI-së nga qarqet e dyshimta antislame e antishqiptare se, pa reforma të thella dhe të përgjithshme në BFI, ky institucion vetëmsa po shndërrohet në filiale të qarqeve të caktuara politiko-qeveritare.

***Jeni mbase e vetmja “strukturë” në Ballkan dhe më gjërë që e bëni opozitarizimin faqe institucioni fetar!***

Në Shqipëri dhe Kosovë pushtetet nuk insistojnë të fusin duart në institucionet fetare, të cilat gëzojnë liri të plotë organizimi dhe veprimi. Këtyre pushteteve nuk u duhen bashkësi fetare në cilësi të filialeve, me peshë e rol të kontrolluar! Këtyre institucioneve u kërkohet funksionim normal dhe përgjegjësi për zhvillim të çdo dukurie që do ta cënonte rendin kushtetues dhe që do ta njolloste interesin kombëtar të shqiptarëve!

Maqedonisë së Veriut nuk i intereson një Bashkësi Fetare Islame që për anëtarësi do të kishte gati gjysmën e popullatës! Asnjë organizatë politike, fetare, kulturore etj. nuk është më e madhe se BFI-ja në shtetin e Maqedonisë së Veriut. Ndaj dhe, pushteti aktual ka futur thellë duart në këtë Institucion, ka instaluar njerëzit e vet, në krye kanë vënë një marionetë, e cila do të pajtohet në heshtje me angazhimin e strukturave të caktuara antislame për ta rrënuar BFI-në, për ta dezorganizuar popullatën myslimane si dhe për ta përçarë përmes regjistrimit dhe legalizimit të “bashkësive islame” të dyshimta që mëtojnë sektarizimin e shoqërisë sonë. Kjo është ajo politikë të cilës po ia bëjnë “hyzmetin” strukturat aktuale të BFI-së e cila, jo se duhet të stopohet për shkak të paaftësive apo dyshimeve në përgatitjet e tyre profesionale, por, mbi të gjitha, duhet të stopohet dhe të goditet duke e detyruar pushtetin që t'i tkurrë duart dhe t'i nxjerrë fare nga BFI-ja!

***Janë paksa akuza të rënda! Me çka do ta argumentonit këtë që e thoni mbi pushtetin maqedonas me duar të shtrira në BFI?***

Mënyra si u zhvillua komploti, mënyra si u shkarkua ish-reisul ulema, Sulejman ef.Rexhepi, mënyra si u zhvilluan ngjarjet e mëtejme, stopimi i proceseve gjyqësore kundër aktorëve të të

njëjtës lojë që e zhvilluan me plotë fallcifikime ndërsa i njëjti fallcifikim të regjistrohet si legal nëpër organet e gjyqësorit! Më e rënda ishte shkelja kushtetutare! Mohimi i Kushtetutës së BFI-së ishte “e vetmja trampolinë” prej nga i ashtuquajtimi “reisi” aktual do t’ia dilte të hidhet në prehërin e pushtetit i cili do ta përkundte në djepin që ia ka instaluar në zyre dhe ku ia ka caktuar detyrën e madhe: vetëm gjumë!

“Reisi” aktual përcillet dhe, “vëllai i madh” e di fare mirë se cilat janë shkeljet kushtetutare që i bën ai, e di fare mirë se çfarë po ndodhë me vakëfin, e di fare mirë se kush në BFI ka përvetësuar vakëf, kush po i keqpërdor bonot me vlerë që i janë dhënë BFI-së gjatë procesit të denacionalizimit; “vëllai i madh” e di fare mirë se si ato bona në vlerë merren pa mbajtur llogari në devalvimin e vlerës së mirëfilltë të vakëfit. “Vëllai i madh” e di fare mirë se cila është përbërja e kësaj strukture që u prinë “reisi”, sa prej tyre kanë “kryer” fakultete e janë pajisur me diploma fallco, sa prej tyre kanë blerë provime, kanë blerë tema magjistrature e doktorature, sa prej tyre brenda natës janë bërë magjistra, sa prej tyre kanë kryer nëpër “institucione arsimore” të dyshimta; “vëllai i madh” e di fare mirë se si dhe kush e vjedh haxhin, kush i vjedh kurbanët, (sidomos kurbanët që paguhen nga diaspora), e di fare mirë se si bëhen kontratat gjatë kryerjes së haxhit, sa vidhen haxhilerët, sa pasurohen individ të caktuar! “Vëllai i madh” i vështron të gjithë ata teologë dhe administratorë të BFI-së të cilët i shfrytëzojnë zyret dhe xhamitë për të zhvilluar aktivitete të tyre “joqeveritare”, përfituese dhe të dyshimta! I di edhe “reisi” aktual por, nuk bëzanë dhe e pret momentin për t’i shantazhuar! “Vëllai i madh” e di fare mirë se si “reisi” aktual e blenë rehatinë e vet, qëndrimin në krye ku është instaluar, duke u dhënë nga 30-40 mij euro “organeve të rrebeluar përkohësisht”, duke i qerasur me ndonjë shëtitje nëpër botë, duke i mbyllur sytë para “organeve” që marrin nga disa rroga përveç rrogës së BFI-së, duke u paraqitur si hut karshi vjedhjeve të mëdha, duke e njollosur postin “myfti” me turlifarë bilmezi që do t’i duhen eventualisht si “votë”! “Vëllai i madh” e di fort mirë se si vidhet duke blerë makina te reja, si bëhen pazaret me pronat e BFI-së, e di fare mirë se kush përvetëson banesa nëpër objekte të ngritur në truall të vakëfit të BFI-së etj. “Vëllai i madh” ndjehet i fyer prej “reisit” aktual, i cili, prezencën e BFI-së nëpër evente të ndryshme ndërkombëtare e bën përmes hajnave, kriminelëve, përmes njerëzve amoralë e të dëmshëm për shoqërinë e përgjithshme të vendit! Me këtë dukuri të shëmtuar janë të njohtuar edhe institucionet relevante të vendit, por, e teleisin këtë dukuri duke e paraqitur si më të mirën e mundshme të BFI-së! Sepse, një ditë, shteti duhet ta justifikojë arsyen e futjes së duarve deri në bërëlla në Institucionin e BFI-së! Duke e luftuar krimin brenda BFI-së do të tregohet se sa e kujdesshme që është! Kurse, absolutisht, shtetit nuk i duhet ky “lluks”, BFI-së nuk i duhen brenda vete elementët e pistë të shtetit, shteti nuk ka nevojë të ngrisë “strategji” për ta pastruar BFI-në nga elementet paçavurë! BFI-së urgjentisht i duhet një pastrim nga kryet, sepse, “peshku kalbet nga koka”!

***Pavarësisht kësaj që thoni ju, shikuar nga një kënd objektiv, cilat veprime mund të konsiderohen institucionale, kushtetuese, të mira e të dobishme?***

A mund të jetë subjektive kritika që thotë se zyrja e reisit është shndërruar në “çajtores” ku ftohen lloj-lloj personash me qëllim që të bëhet ndonjë fotografi private dhe ky “aktivitet” të publikohet si përkrahje publike që i bëhet “instalacionit” të pushtetit maqedonas në krye të BFI-së! A mund të jetë subjektive kritika që “reisi” u shkon në raport organeve të BFI-së tek të cilët ka dyshim se mund ta “tradhëtojnë”, ndërsa organeve me të cilët është tallur duke “emëruar” myftinj persona pa kurrfarë bagazhi teologjik e intelektual, nuk u shkon fare! Lëvizja këtë dukuri e ka kritikuar vazhdimisht dhe, kur “reisi” mbështetet për muri, atëherë nis të “zbatojë” Kushtetutën e BFI-së –

thërret mbledhjen e “Rijasetit” të vet në të cilën mbledhje do të duhej të raportonte gjithësecili! Por, vetëm pasi t’i “vizitojë” dhe t’ua masë pulsën myftinjëve të cilët ai i llogaritë si “bashkëpunëtorë të ish-reisit”, tek atëherë thërret mbledhjen e organit kolektiv, i cili, me Kushtetutë duhet të mblidhet të paktën një herë në muaj dhe jo në 7-8 muaj një herë! A mund të jetë kritikë subjektive fakti që “reisi” aktual nuk e di se kush janë anëtarët e Kuvendit të BFI-së, a mos u ka kaluar mandati apo, kur duhet të thirret mbledhja e këtij Organi! Thënë shkurt, “reisit” i mjafton përkrahja dhe “këshillat” e shërbimeve të caktuara shtetërore! A është “kritikë subjektive” fakti që vetëm një “reis” i kapur nga korrupsioni, nga hajnia, nga imoraliteti, mund ta gëlltisë kritikën objektive dhe mos të reflektojë mbi faktin e pamohueshëm se është bërë kancer i Institucionit!

### ***Reisi, Rijaseti, Kuvendi, Myftinitë! Organet kryesore që nuk i mungojnë BFI-së!***

Ju lutem! Për çfarë organesh e keni fjalën! Për celula të marionetave? “Reisi” aktual është “instalacion politik” dhe këtë fakt e dinë që të gjithë, madje e di edhe vetë i instaluari! Ç’bëri pasi u instalua nga qarqe të ndryshme politike? Gjënë e parë që e bëri e kontrabandoi titullin “MYFTI”! Kordinatorët e myftinive i bëri ”myftinj” krye më vete, sepse, ata nuk kishin të drejtë vote, dërsa këtij i duhej përkrahja dhe përmes tyre, sigurimi i pozicionit të vet të cilin e uzurpoi pa më të voglën meritë, pas një tradhëtie dhe komploti që e stigmatizoi përjetë BFI-në si “poligon” të shërbimeve sekrete! Rijasetin por dhe Kuvendin i degradoi, i degjneroi deri në “organe” të papërfillshme dhe që gjithmonë do të jenë të gatshme të jenë në shërbim të “emëruesit dorëshlirë”! Korrupsion ky i llojit të vet! Imagjinoni, “reisi” që thotë se u konstituua Kuvendi i BFI-së, ndërsa shkelë të gjithë rregulloret dhe tërë Kushtetutën që parasheh shumë qartë se si zgjidhet ky organ! Neni 45 i Kushtetutës së BFI-së thotë: “Kuvendi i Bashkësisë Fetare Islame është organ më i lartë juridiko-financiar”, dhe, pikërisht për këtë rol profesional, Neni 48 precizon: “Anëtarët e Kuvendit të BFI-së me 2/3 duhet të jen me arsimim sipëror nga profilet juridiko-administrativo-ekonomik.”!

Që kur u realizua puçi klasik përmes përkrahjes së shërbimeve të dyshimta e deri më sot, Kuvendin e kanë udhëhequr injorantë, njerëz me diploma të falsifikuara, jokompetentë, njerëz që nuk dinë ta definojnë noconin “nen” e jo të punojnë sipas neneve të Kushtetutës së BFI-së! Së fundmi, na qenka zgjedhur edhe kryesia e re e Kuvendit! Në kryesinë e parë të këtij Kuvendi kemi pasur profesionistë të shkëlqyeshëm, si nga rrafshi juridik ashtu edhe nga ai ekonomik-financiar! Struktura përbërëse është ngritur mbi profesionistë nga lëmenjtë e paraparë me Kushtetutë. Sot Kuvendit i prijnë imamë xhamishë, i prijnë njerëz që kurrë në jetë nuk e kanë lexuar Kushtetutën dhe as që i dinë kompetencat, detyrat dhe obligimet e tyre kushtetuese. Njerëz pa personalitet, pa respekt për veten e vet, ndryshe, nuk do të pranonin kurrë që të shpërfaqeshin kaq hapur si karrieristë që janë në gjendje të shërbejnë qorrazi! Pse? Sepse kështu do “reisi” i tyre, marioneta prej pondlash që nuk dinë as çka është llogaria përfundimtare, as buxheti, as të hyrat, as shpenzimet, që nuk dinë jo të kërkojnë raport financiar, por as ta lexojnë një raport të tillë. I duhet strukturë e tillë që nuk kanë njohuri mbi vakëfin, që nuk dinë se çka është bërë me vakëfin e BFI-së, që nuk dinë të kërkojnë as llogari dhe as përgjegjësi! Me Rijasetin aktual, “reisi” i instaluar politiko-partiakisht “e siguron” rehatinë dhe gojën plotë me të vetmën lutje: “zgjate Zot”! Kurse me Kuvendin aktual e siguron një “sallamadi” dhe një veprim i cili do të ndikojë në degradim total të jetës fetare islame në vendin tonë! Tërë ky veprim amator, dezorganizues, devaluës është me qëllim që të realizohet sa më mirë misioni i “reisit” të

instaluar: degradimi deri në mospërfillje i Institucionit të BFI-së në këmbim të “vetëqeverisjes komuniste” që nuk i siguron më shumë se një grusht interesash meskine!

### ***Çka do të ndryshonit nëse një ditë do të drejtoni Institucionin e BFI-së?***

Nuk është synim i imi drejtimi i BFI-së! Unë e kam thënë edhe më herët, madje shumë herë e kam përsëritur: mua më intereson vetëm kthimi në identitet, drejtimi sipas Kushtetutës dhe dispozitave pozitive të BFI-së si dhe të kryhen reforma esenciale dhe të thella në këtë Institucion! Të ulemi, të bëjmë një strategji, t’i futemi reformave dhe, për mua, fare nuk është e rëndësishme se kush do ta drejtojë Institucionin, le të jetë ky edhe ndonjë udbash nëse kjo nuk do t’i nënçmonte myslimanët e vendit! Për reforma në BFI jam i gatshëm që publikisht të prononcohem se kurrë nuk do të futem, në asnjë organ të BFI-së! Por, ja që ka brenda individë të dobët, të dyshimtë, të pistë që thonë “nëse nuk jeni me mua, do ju vie Afrim Tahiri dhe do t’ju largojë të gjithëve nga puna”! Pse t’i largojë? Çka kanë bërë ata që duhet të largohen, nëse janë me faj, pse nuk i largon “reisi”, pse i mban, apo i duhen për shantazhim në ditën kur do t’i duhet “reisit”! Afrim Tahiri kurrë nuk ka thënë se dua të bëhem reis, as sekretar dhe as të drejtoj çfarëdo organi në BFI! Unë, si teolog, dua të kem një Institucion i cili denjësisht do t’i prezantojë myslimanët e vendit, një Institucion pa ata individë që e çojnë në haram fitrin, zeqatin, të hyrat nga kurbanët, nga haxhi! Një institucion me peshë dhe rol të padiskutueshëm nga asnjë në shtetin tim! Struktura aktuale e BFI-së nuk është e interesuar për reforma, madje as që i kupton nevojat e domosdoshme që i ka Institucioni, madje as që di t’u qaset këtyre reformave. Nuk i do reformat, sepse, me reforma të sinqerta mbyllen të gjitha portat gjigante për hajni, për korrupsion, për shkatërrim të vakëfit, për politika të gabuara kadrovike, për sendërtime të interesave meskine!

### ***Si të arrihen këta reforma?***

Së pari duhet të pajtohemi që të gjithë se reformat në BFI janë jetike dhe në të mirë ekskluzivisht të myslimanëve të vendit! Tevona, do t’i ballafaqojmë platformat dhe programet, të BFI-së dhe të Lëvizjes, natyrisht, nëse i kanë! Këtu nuk merr fund puna: platformat dhe programet do t’i nxjerrim në diskutim publik, do të shkojmë xhami më xhami, organ më organ, që të merret mendimi dhe pëlqimi i çdo myslimani në xhemat. Vendimet duhet të merren nga poshtë lartë, iku më ajo kohë kur “i pari” u imponon vendime e qëndrime bazës! Dikush mund të mendojë se me këtë pajtesë do ta “faktorizonte” Lëvizjen! Përgjigja është shumë e thjeshtë: pas një dakordësie për reforma gjithëpërfshirëse, pas një programi të përbashkët, pas hartimit të një strategjie afatgjate të BFI-së, pas kryerjes së procesit të reformave, në atë sekond do të shuhet Lëvizja dhe më kurrë nuk do t’i përmendet emri! Po nëse dikush mendon se kjo do të ishte “një derë” prej nga unë dua të futem në BFI, ja ku po e përsëris: paraprakisht do të nënshkruaj deklaratë se Afrim Tahiri nuk do të jetë në asnjë organ të BFI-së, thjesht, do të ngeli një anëtarë besnik i BFI-së!

### ***Cila është pozita ndërkombëtare e BFI-së, meqë në të kaluarën ka qenë zë i fuqishëm i myslimanëve, i institucioneve fetare islame të Ballkanit?***

Ka rënë përdhe! Ne vazhdimisht kontaktohem prej organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare të botës islame, por edhe perëndimore, për rrjedhat dhe kahet e përditshme të BFI-së! Të gjithë janë të informuar se kush është “reisi”, si erdhi “reisi”, kush e solli “reisin”, cili

është misioni i tij etj. Natyrisht, pavarësisht se kush e drejton, insistimi i Lëvizjes është që BFI-ja të mos mungojë në asnjë proces, në asnjë konferencë, në asnjë takim nëpër qendra të ndryshme islame. BFI-ja duhet të jetë prezent qoftë edhe duke u përfaqësuar nga “reisi” aktual i cili jo që nuk e njeh gjuhën arabe por nuk ka informacione për rrjedhat e përgjithshme bashkëkohore në botën islame! Është shumë i hendikepuar me mosnjohjen e as të gjuhës arabe dhe as të anglishtes, apo frengjishtes dhe as të turqishtes! Pa njohjen e këtyre gjuhëve mund të keshë vetëmse njohje tepër sipërfaqësore për proceset islame në botë.

Në të kaluarën nuk ka pasur rast që të formohet ndonjë organizatë ndërkombëtare islame, nuk ka pasur konferencë që nuk është bashkëdrejtuar edhe nga ish-reisi i BFI-së, ef Rexhepi! Sot, BFI-ja prezanton vetëm si figurë statike, sepse organizatorit i intereson një pjesëmarrje sa më masovike dhe nuk i intereson nëse një bilmez nga Maqedonia e Veriut do të prezantojë në konferencë apo jo! Aq më keq, nga qendra të caktuara arabe na vijnë informacione se “reisi” aktual këto takime i shfrytëzon kryesisht për të përfituar ndonjë “stipendi”, apo rrogë mujore prej tyre! Në të tilla rrethana dhe kushte humb edhe Institucioni i BFI-së! Fatkeqësisht!/**JetaPress/10.11.2022**

## **Dy shembuj të pakrahasueshëm**

**Nëse analizojmë punën e Ulema Mexhlsit të Shkupit, bazuar në raportin e punës përpara 100 viteve, gjegjësisht gjatë vitit, 1 korrik 1938-31 dhjetor 1939, me punën katërmëdhjetë muajshe të bashkësisë fetare të Shaqir Fetait, gjegjësisht të vitit, nëntor 2020-dhjetor 2021, do të vërehet një dallim epik për sa i përket punës profesionale por dhe kombëtare të Institucionit një shekulli më parë me punën qorrazi të atyreve që për mision kanë devalvimin dhe shkatërrimin total të Institucionit gjashtë shekullor të BFI-së**

*Nga Afrim Tahiri*

Nisur nga konteksti historik, shoqëroro-politik si dhe, marrë parasysh frikën e botës nga lëvizjet nazi-fashiste që si furi po shtriheshin mbi Evropën duke krijuar aleanca të rrezikshme për mbarë njerëzimin, pra, nisur nga këto fakte dhe, në anën tjetër, bazuar mbi raportin e punës së Ulema Mexhlsit të Shkupit që përfshinte Serbinë nga Beogradi e te poshtë, tërë Luginën, Malin e Zi, Sanxhakun, Kosovën e krejt Maqedoninë e Veriut, mund të konkludojmë se ky Institucion, një shekull më parë, ka qenë një prej shtyllve më të organizuara kombëtare që i ka ndejtur karshi Mbretërisë Serbe.

Rapoti në fjalë, përmbledh raporte, hulumtime e fakte të grupeve të ndryshme punuese që me urdhër të kryetarit të sapozgjedhur në atë kohë, Sherif ef. Osmani, kishin inspektuar punën e Ulema Mexhlsit si dhe të të gjithë organeve të saj. Në emër të këtij angazhimi, në fakt, synohej që të vihet deri te disa të dhëna, pa respektimin e të cilave tërë historia kombëtare do të ishte e mangët. Të dhënat e shumta statistikore, të grumbulluar në terren, me javë të tëra, nën kushte primitive, por me një vullnet të pashoq, janë grumbulluar të dhëna mbi numrin e myslimanëve në tërë territorin e Ulema Mexhlsit, mbi numrin e objekteve fetare, mbi numrin e teologëve dhe shkallës së tyre profesionale, mbi numrin e varrezave, teqeve, tyrbeve, mbi numrin e mualimëve, mbi numrin e ndjekësve të mësimbesimit islam, mbi numrin e xhemateve medreseve, nxënësve, mbi numrin e shoqatave humaniare, kulturo-artistike etj. etj.

Histori më vete është organizimi dhe puna ditore e Ulema Maxhlsit, punë kjo e kryer mbi baza të një profesionalizmi të lartë, që flet për programe e strategji të veçanta, që flet për seriozitetin dhe misionin që kryesia e atëhershme (Hfz. Sherif ef. Osmani, Ataullah ef. Kurtishi, Bedri ef. Hamidi dhe Idriz ef. Hajrullau) i kishte caktuar vetes!

## **Aktivitet profesional i burrave të kombit e të fesë**

Janë disa shënime që duhet të ngelin model pune për gjithësecilin që dëshiron të lë gjurmë në punën e vet dhe që do të arrijë maja të sukseseve. Asnjë veprim nuk është kryer pa u mbështetur në vendimet e organit më të lartë, vendime me data e me numër protokolar, të shoqëruar me arsye mbi sjelljen e atyre vendimeve. Vendimet nuk janë urdhër, as rekomandime dhe as arsyetime të një subjekti, qoftë ky dhe kryetari, por janë rezultat pas shterrimit të argumentave dhe nevojave të ngritura në mbledhje ditore të organit kolektiv të Ulema Maxhlsit.

Raporti thotë se përgjatë këtyre muajve (1 korrik 1938-31 dhjetor 1939) u mbajtën gjithsej 69 mbledhje, edhe atë: 23 mbledhje në pjesën e dytë të vitit 1938, në të cilat u shqyrtuan 389 lëndë, kurse më 1939 u mbajtën 44 mbledhje, në të cilat u shqyrtuan 1973 lëndë. Në pjesën e dytë të vitit 1938 te Ulema Mexhlsi kanë arritur 2191 lëndë, kurse në vitin 1939 kanë arritur 8941

lëndë. Janë shqyrtuar që të gjitha këto lëndë. Veç kësaj, u shqyrtuan edhe një numër i madh i lëndëve të trashëguara nga ish-udhëheqësia e naibit.

Sipas këtyre fakteve, mund të përfundojmë se organi kolektiv i Ulema Mexhlsit në muaj ka mbajtur nga 8-9 mbledhje, ku si pika të veçanta në rend dite kanë qenë edhe shqyrtimi i lëndëve, si të komunitetit të teologëve ashtu edhe të qytetarëve të territorit të Ulema Mexhlsit të Shkupit. Në vazhdim le t'i shohim disa nga aktivitetet që i kanë kryer kryesia si dhe organet e ndryshme të atëhershme:

U sollën 10 vendime (që mbajnë datën dhe umrin e regjistrimit në fletoren zyrtare) për avancime, ndërrim të vendeve të punës, largim apo punësim të reja;

U sollën 22 vendime përmes të cilëve u miratuan mungesat, pushimi vjetor dhe pushimet mejksore personelit të Ulema Mexhlsit;

Asnjë lëvizje, si brenda ashtu edhe jashtë, nuk mund të kryejej krye më vete, pa miratimin e vendimeve qoftë për vizita të ndërsjella të organeve brenda territorit të Ulema Mexhlsit, qoftë për vizita zyrtare. Natyrisht, vendimet sillen bazuar në arsye të veçanta, qofshin ato si nevoja apo si iniciativa orgaizative.

Kësisoj, gjatë kësaj periudhe prej pesëmbëdhjetë muajve, Ulema Mexhlsi solli 11 vendime për udhëtime zyrtare.

Është për t'u admiruar qëndrimi fetar e profesional që drejtuesit e Ulema Mexhlsit kanë pasur me arkën qedrore të Institucionit. Asnjë metalik nuk ka mundur të dalë pa një vendim të organit. Kështu, gjithnjë përgjatë kësaj periudhe kohore janë miratuar gjithësej 7 vendime për paradhënie (avans) për anëtaarët e Komisionit kuvendor të Vakëfit Mearifit të Shkupit.

Komision për këqyrjen e situatës momentale të xhamive në territorin e këtij Mexhlsi të Shkupit si dhe për t'i evidentuar nevojat e xhemateve për meremetimin apo ndërtimin e xhamive të reja ose të minareve të tyre, miratoi 14 vendime si: Vendim numër 2757, të datës 15 shtator 1938, të ndërtohet minarja e xhamisë në Vrapçishtë (Gostivar); Vendim numër 3491, të datës 15 shtator 1938, të ndërtohet minarja e xhamisë në Hodonoc (Gjilan); Vendim numër 2927, të datës 19 shtator 1938, të ndërtohet xhamia në Rostushë (Gostivar); Vendim numër 3816, të datës 29 tetor 1938, të ndërtohet xhamia në Sopot (Kumanovë) etj.

Gjatë periudhës së përgatitjes së këtij Raporti, për shkak të angazhimit me honorar të disa imamëve të xhemateve, janë lëshuar 16 vendime. Në ndërkohë janë miratuar edhe 3 vendime për pensionim të personelit. Po ashtu, në këtë periudhë janë miratuar edhe 169 vendime përmes të cilëve i janë dhënë leje imamëve të xhemateve për të munguar, për pushime vjetore dhe mjekësore, etj. Kurse, Komisioni kuvendor i Vakëfit Mearifit, ka miratuar 75 vendime për paradhënie të imamëve të xhemateve.

Natyrisht, pa lejen dhe vendimet e Ulema Mexhlsit asgjë nuk ka mundur të “funksionojë” brenda xhamive. Gjithçka ishte nën kontroll dhe saktësisht dihej se kush është mualim, kush është i angazhuar dhe sa ishte numri i nxënësve. Kështu, gjatë kësaj periudhe, Ulema Mexhlsi, pas analizave dhe shterrjes së argumentave, ka miratuar 67 vendime për hapjen e mektebeve të reja, ndërsa janë lëshuar edhe 208 vendime për angazhimin e mualimëve.

Një vëmendje e veçantë e Ulema Mexhlsit të Shkupit ishte përqëndruar edhe në ofrimin e këshllave si dhe të mendimeve bazuar në pikëpamjet dhe mësimet islame për cilindo qytetar që shprehte kërkesë. Përgjatë kësaj periudhe Ulema Mexhlsi lëshoi 46 vendime-fetva apo shpjegime sipas Sheriatit.

Në anën tjetër, le të marrim si “raport” të punës për periudhën prej katërmëdhjetë muajve, “biltenin” e bashkësisë fetare të Shaqir Fetait, që pasqyron “punën” e tij për periudhën nëntor 2020-dhjetor 2021! Çdo përpjekje serioze për të bërë një krahasim të “raportit” të Shaqir Fetait

dhe atij të Hafëz Bedri ef. Hamidit, do të ishte, mbi të gjitha, një nënçmim dhe mohim cinik ndaj punës patriotike, kombëtare e fetare të Ulema Mexhlsit. “Raporti” i Shaqir Fetait shpreh paudhësinë e tij, diletantizmin e tij, narcisoizmin e tij, afinitetet e tij psikopatike për të shkatërruar Institucionin më të rëndësishëm të vendit si dhe për ta deorganizuar tërë xhematin e vendit.

### **Bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait është turpi i vendit e i kombit**

Mbi 13.400 lëndë janë shqyrtuar dhe janë lëshuar po aq vendime përgjatë 113 mbledhjeve që i ka mbajtur Ulema Mexhlsi nga korriku i vitit 1938 e deri më fund të vitit 1939. Për pesëmbëdhjetë muaj 113 mbledhje! Gati nga dhjet mbledhje në muaj të organit kolektiv, siç ishte Ulema Mexhlsi!

Po çka na paska bërë “reisi”, Shaqir Fetai, ky instalacion i shpifur në krye të BFI-së nga struktura që nuk kanë të bëjnë asgjë me Bashkësisë Fetare Islame në RMV! Një shfletim shkarazi i “raportit” të Shaqir Fetait na sjell në këto të dhëna, sa qesharake aq edhe të trishtueshme! Për katërmëdhjetë muaj “aktivitete” të publikuara edhe në fb-un e BFI-së, edhe në fb-un e Shaqir Fetait por edhe në paçavurën “zyrtare” të BFI-së, Shaqir Fetai mund të “mburret” me këto fakte:

Në 95 faqe ka publikuar si aktivitete te veta 95 “lajme” që në fakt janë:

47 urime nga subjekte të ndryshme

28 ngushëllime nga Shaqir Fetai dhe për Shaqir Fetain

6 konkurse të qendrave të ndryshme

14 urime prej Shaqir Fetait

Çfarë aktivitete ka këtu me të cilat do të mburret BFI-ja por dhe breznitë që do të vinë pas 100 viteve! A mund të jetë e arritur “fletorja përkujtimore” personale e Shaqir Fetait! Janë edhe nja 5 autorizime (pra, jo vendime) përmes të cilëve Shaqir Fetai mundohet të imponohet si “mbret” i vendit, si prijës politik i vendit, i cili, me peshën e autoritetit politik që “e ka”, ka të drejtën që të veprojë me autorizim, pa pasur nevojë për kurrfarë vendimi! Kurse, pararendësit e tij për një vit e gjysëm paskan miratuar mbi 13 mij vendime!

Në “raportin” paçavurë të Shaqir Fetait, raport ky që vulos turpin e Institucionit, Shaqir Fetai na sjell mbi 750 fotografi prej të cilave 91% e fotove janë pozim i shpifur dhe i ulët i manekenit, Shaqir Fetait, dhe, vetëm 9 për qind janë foto të çastit. Natyrisht, narcisoizmi i tij vërehet sidomos në fb-un e BFI-së dhe në “paçavurën zyrtare” ku të publikuara po të njëjtat informata të përmbledhura në këtë “raport” shoqërohen me mbi 3000 foto, prej të cilave 95% e fotove janë pozime të shpirtërisht të papërbushurit (Shaqir Fetait) ndërsa vetem 5 për qind janë foto të çastit!

Shaqir Fetai i publikon si aktivitete madhore të tij mbi 150 pritje të personave privat e të familjarëve të vet, të cilët vetëm sa e kanë dëmtuar BFI-në duke u qerasur me çajëra e kafe, me lëngje e me dreka dhe darka të paguar nga arka e BFI-së. “Zyrtarisht” është vizituar nga 46 persona, prej të cilëve, shumica i përkasin atyre shërbimeve që e instalojnë dhunshëm në krye të BFI-së! Janë të evidentuar 13 vizita nga ambasadorë e personalitete të rëndësishëm nga jashtë. Të gjitha këto vizita, absolutisht që të gjitha, në fakt shprehin aktivitet të tjetërkujt (Të vizitorëve) dhe jo të BFI-së e aq më pak të Shaqir Fetait! Po, janë dhe nja 7-8 vizita, aktivitete të Shaqir Fetait, që i ka kryer nëpër institucione të larta shtetërore! Ky aktivitet në fakt ka qenë në shërbim të aktiviteteve të funksionarëve të shtetit. Shaqir Fetai këto vizita nuk i ka kryer në interes të BFI-së, këto vizita nuk i ka shfrytëzuar për të dorëzuar vendime të BFI-së, kërkesa të



pakthyeshme, nuk ka dorëzuar qëndrime zyrtare të BFI-së, por, thjesht, i ka shfrytëzuar për t'u ndjerë "i madh"!

Në këtë "raport" i ka të evdinetuar vetëm 12 vizita zyrtare që i ka bërë jasht vendit, edhe atë, jo që i ka materialzuar në interes të së mirës së përgjithshme të BFI-së por, thjesht, e ka dëmtuar buxhetin e BFI-së, duke përfituar edhe ndonjë "rrogë" të huaj, apo ndonjë lekë në formë mëditje! Fatkeqësisht, Shaqir Fetai, për këta katërmbëdhjetë muaj të përfshirë në këtë "bilten" ka shënuar se ka realizuar vetëm 3 mbledhje me organet e BFI-së (Rijasetin dhe Kuvendin), prej të cilave nuk ka të nënvizuar asnjë konkluzion, asnjë vendim, asnjë qëndrim! Si lëvizje për të fituar qelepër ndonjë drekë a darkë, Shaqir Fetai ka shënuar se ka prezantuar edhe në 15-20 organizime për hedhje të ndonjë gurthemeli të xhamisë së re, të hapjes së ndonjë xhamie të re, si dhe në ndonjë dua hatme apo hifzi, të cilat, edhe këto, nuk shprehin kurrfarë aktiviteti personal të Shaqir Fetait.

P.S.

Pra, njëqind vite më parë, kombi pati burra që të përkujdeset, veç të tjerash, edhe për Institucionin fetar islam, përmes së cilës e ndihmonte interesin dhe çështjen kombëtare dhe, ja, sot, duke i kryqëzuar këto fakte, na del puna që kemi diletantë që punojnë me diletantizëm për kryedilitantin! Ja pse REFORMAT në këtë Institucion janë të domosdoshme, janë urgjente dhe jetike!/**BotaPress/13.11.2022**

**Institucioni pa testament të trashëguar**

**Pa i evidentuar të metat dhe dështimet, pa i evidentuar politikat e gabuara dhe planet ogurzeza, pa i evidentuar synimet dhe strategjitë “e armikut”, vështirë se arrihen sukseset! Pa lënien “testament” të të arriturave nga i pari te pasardhësi i vet, assesi nuk duhet të shpresohet në përkrahje të gjërë. Pa nivelizimin e vlerave dhe të të arriturave ndër myftinitë e BFI-së mund të flasim vetëm për organe primare dhe për “organe” që janë “organe” sepse duhet vota e tyre e instrumentalizuar. Përballë këtyre anomalive mund të flitet vetëm për sharlantantizëm, diletantizëm, shkatërrim, dezorganizim...**

***Nga Afrim Tahiri***

Në një analizë timen, publikuar kohë më parë, duke folur për Institucionin e BFI-së këtu e tetëdhjetë vite më parë dhe sot, bazuar në raporte e në fakte, nënvizova punën kolosale dhe të paarritshme që është bërë në atë kohë dhe, pa dyshim, tërhoqa vërejtjen mbi punët nonshalante që sot kryhen në këtë Institucion.

### **Sukseset fiktive në imagjinatën e vakët**

Cilët janë aktivitetet dhe sukseset e arritura brenda po të njëjtës periudhë kohore të përkufizuara në raportet përkatëse! Cilët janë sukseset e srukturës aktuale të dhunshme të BFI-së? Nuk ka? Ose, ka por, që të gjitha janë pjellë e imagjinatës së dështakëve që kanë qejf të vetëmashtrohen se sa shumë të suksesshëm që janë!

“Reisi” aktual ka prezantuar në disa mbledhje të organeve dhe të institucioneve arsimore, më tepër si manikin se sa si autoritet dhe, gjithnjë ka dalur me konstatim se myftinjtë janë për “mësyshë”, janë shumë të sukseshëm dhe se po e drejtojnë organin ashtu siç duhet! E si duhet të drejtohet një organ, këtë nuk e di as vetë “raportuesi” (“reisi”), prandaj ai nuk ka program, prandaj ai nuk ka as synime dhe as qëllime. Prandaj ai nuk ka plan të veprimit, apo planin zhvëllimor, prandaj atij, gjithçka që ia siguron rehatinë në kolltukun e uzurpuar me puç, i duket e mirë, e mrekullueshme, e qëlluar. Dhe, të tilla vlerësime në fakt përbëjnë vetëkënaqësinë e pashembullt të një “reisi” të instaluar me një mijë intriga e dallavere!

Komisionet nuk ngriten për t’i evidentuar sukseset (qofshin ato edhe fiktive), siç i mëton këto “reisi” i shpifur! Komisionet nuk ngriten për t’ia kënaqur “epshet” hipokritit i cili as që di se çka është puna, si veprim! Tetëdhjetë vite më parë ishin formuar sërë komisionesh për t’i nënvizuar sukseset eventuale por, mbi të gjitha, për t’i evidentuar të gjitha të metat, të gjitha dështimet të gjitha gabimet, të gjitha mangësitë, të gjitha devijimet... Kjo, me të vetmin qëllim që të ndërmerren iniciativa, të mendohen projekte e rrugëdalje që të evitohen dhe të eliminohen të gjitha anomalitë dhe dobësitë organizative por edhe të atyreve që gabimisht ushtrohen ndër xhematet tona.

Kjo metodologji e punës dhe të kuptuarit e esencës së ndërmarrjes për kontrollim, evidentim e korigjim të të metave dhe të gabimeve, dhe bërja e tyre transparente, është e vemtja rrugë drejt sukseseve dhe drejt bërjes së historisë. Evidentimi i “sukseseve” dhe këmbëgjulja se gjithçka po shkon si në vaj, është vetëm një strategji e mirëplanifikuar për dështimin dhe shkatërrimin e një projekti, të një institucioni, të një sistemi, të një shteti.

**Posti i trashëguar si amanet**

Veç tjerash, në analizën time të publikuar kohë më parë kisha nënvizuar edhe numrin e mbledhjeve të mbajtura të organeve të atëhershme dhe sot, në hark kohor gati të njëjtë, numrin e vendimeve të miratuara atëherë dhe sot, por dhe konceptimin e aktiviteteve, të cilat, dikur kishin karakter kombëtar ndërsa sot kanë karakter personal, të personit të cilit i mvishen të gjitha “aktivitetet” vetëm e vetëm, që dikush të dalë si “më i vizituar”, si “më i dashuri”, si “më i suksesshmi” por ama vetëm në imagjinatën e tij shumë të kufizuar! Tek të tjerët, qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm, “reisi” i instaluar dhunshëm nga qarqet politike që nuk janë dëshmuar si hajri i fesë islame, gjithnjë do të ngelë si masë e dhunshme politike, i cili nuk ka arritur që të trashëgojë një histori dhe një trashëgimi të begatë nga strukturat udhëheqëse të mëhershme. Sepse, i bëri komplot dhe puç njeriut i cili ia kishte dalë që të bëjë histori për sa i përket BFI-së! Çka po dua të them! Në kohën kur u dorëhoq Sulejman ef. Rexhepi dhe në vend të tij erdhi Arif ef. Emini, e kemi fjalën për vitin 2000, prej meje është kërkuar nga ish-Reisi Sulejman ef. Rexhepi që të bëj “letër qarkore” drejtuar institucioneve ndërkombëtare, faktorëve nga bota turko-arabe, me të cilën ai i njoftoi se tash e tutje, atë e pason efendi Arifi, kurse vet do të drejtojë një nga sektorët e BFI-së. Nuk ka dyshim se “letër qarkorja” në fjalë ishte shumë e qëlluar, në dobi të institucionit, të Reisit dhe më gjërë.

Dhe, nga ana tjetër, çfarë ndodhi me Shaqir Fetain, si u instalua në krye të BFI-së? Në fakt ai startoi nga zeroja, sepse nuk mund që ta tradhëtoshë pararendësin ndërsa t’ia respektoshë të gjitha të arriturat e tij si lider fetar! Në fakt, të gjithë institucionet vendore dhe të jashtme, të gjithë subjektet e botës turko-arabe, u informuan se liderit fetar të vendit iu bë një puç klasik, një komplot politik dhe, në vend të tij, u instalua politikisht, një njeri i cili pranoi që të jetë bartës i puçit dhe rrënimt të BFI-së! Nuk mund të jeshë lider kontinuitiv nëse nga pararendësi nuk ke “testamentin” për ta trashëguar tërë atë që është punuar. Largimi i pararendësit me arsyetim se, po largohet meqë përgjatë veprimit të vet ka shkelur Kushtetutën, i bie që të mohohet gjithçka e arritur prej tij dhe çdo lidhje bilaterale e krijuar prej tij.

Kjo është njëra prej arsyeve kryesore se pse “reisi” ftohet apo vizitohet vetëm sa për t’u kryqëzuar me sërë pyetjesh nga faktorët relevantë, të cilët janë të interesuar të dinë se cila është strategjia e veprimit të tij! Deri më tani nuk ia ka dalur ta bindë asnjërin me strategjinë e tij. Prandaj dhe, ata që e vizitojnë BFI-në, sot, qofshin nga vendi apo edhe nga jashtë, vijnë vetëm për informim, për ta testuar pulsën e komplotistëve, prandaj, gjithnjë bëhet “prezantimi i letërnjohtimit të BFI-së”, dhe asnjëherë nuk ia dalin që të nënshkruajnë ndonjë marrëveshje për investime kapitale, për shtim të pronës së vakëfit, për bursa studentore, për pranim të studetëve tanë nëpër qendra të ndryshme botërore etj.

### **Edhe diçka...**

Pa dyshim që, të huajt po shoqërohen për të vizituar organe të caktuara të BFI-së, ashtu siç po ndodhë që “myftinj urbanë” të dërgohen diku për ta prezantuar BFI-në! Deri më sot, nëpër evente të bashkësive tona në diasporë, nëpër tribuna e takime shkencore, nëpër evente brenda apo edhe jashtë, nuk dërgohen “myftinj të ruralë” por, vetëm ata që “reisi” i llogarit si shtylla përkrahjeje që gjithnjë duhet të ushqehen me beton! Myftiu i Velesit, myftiu i Resnjës, ai i Ohrrit, i Prilepit, i Kërçovës, i Shtipit dhe Dibrës, pothuajse nuk përfshihen në asnjë event. Pse? Për faktin që tashmë ua ka blerë përkrahjen dhe nuk ka nevojë t’i “qerasë”, apo për faktin që i ka katastrofë! Myftiu i Resnjës, Dibrës, Prilepit, Velesit, Manastirit, Shtipit nuk figurojnë në asnjë “axhendë” të të vetëshpallurit “reis”! Apo, të gjithë këta i llogaritë “myftinj” vetëm kur t’i duhet votat e tyre për t’ia verifikuar si “gjest të qëlluar” tradhëtimin, komplotin, puçin! Po sa po

tregohet i sinqertë i vetëshpalluri “reis” me këta “personalitete” se, me përkrahjen e tyre të rezervë po kontribuojnë në jetësimin e planit të “reisit”, në fakt po kontribuojnë në shkatërrimin total të BFI-së?/**KohaNews/18.11.2022**

**Çorganizimi total i BFI-së**

**Bashkësia Fetare Islame është në prag të rrënimin total mu si një kullë prej letre! Kjo fatkeqësi po i ndjellat BFI-së si rrjedhojë e karrierizmit të verbër të, instalacionit partiak në krye të BFI-së nga strukturat antiislame, Shaqir Fetait, i cili, për të gëzuar respekt e përkrahje arifciale, është në gjendje që të vihet në shërbim të turlifre matrapazi**

***Nga Mr. Abaz Islami***

Ata që e përcjellin punën e paudhë të Shaqir Fetait, sakaq do të konstatojnë se i gjori, për të krijuar një iluzion prej “magjistari”, është në gjendje që prej asgjëje të prodhojë “pesë lajme”, që të gjitha të parëndësishëm, të kotë por që ia shtojnë vetëkënaqësinë Shaqir Fetait. Vjen filani si mysafir i BFI-së dhe, Shaqir Fetai, kujdes, jo gazetarët por Shaqir Fetai, do të prodhojë “dhjetra lajme”, duke i titulluar se filani vizitoi BFI-në, i njëjti filan po qëndron në Medrese, i njëjti filan u mahnit me FSHI-në, qëndroi edhe në myftininë e Tetovës, të Gostivarit, Kumanovës, se i njëjti filan i shikoi zogjtë e Shkupit, e shkeli barin e njomë, se i njëjti filan e futi dorën në xhep dhe e nxori për t’i lëmuar flokët etj. etj. Nuk e ka dert edhe nëse gënjenë Shaqir Fetai, për të është me rëndësi të krijohet, por ama në letër, një përshtypje e mirë për bashkësinë “fetare” të Shaqir Fetait. A e keni parë se si gënjen i pafytyri, duke e paraqitur edhe mysafirin e nderuar në parametra të një duduku injorant! Sipas, Shaqir Fetait, gjatë vizitës së Medresesë “Isa Beu”, mysafiri paska thënë: “Në këtë institucion erdha për të parë se si funksionon një shkollë e mesme, a në realitet gjeta staf dhe nxënës të përgaditur si të një universiteti”! Ose Shaqir Fetai po rrenë, ose mysafiri i lartë paska qenë hipokrit, sepse, kjo përshtypje nuk mund të krijohet për një orë vizitë, sepse ne të tjerët e dimë fort mirë se cili është kapaciteti aktual i kësaj Medrese! Kur ka ndodhur që xhemati i vendit të dezorganizohet duke lejuar, ligjëruar dhe institucionalizuar fraksionimin e xhematit dhe aderimin e tij në lloj-lloj rrymash e ideologjishë “fetare”! Ligjet e vendit nuk lejojnë që një i punësuar të jetë i punësuar edhe në institucione të tjera dhe të marrë nga dy-tri rroga, siç ndodhë kjo në bashkësinë “fetare” të Shaqir Fetait. Ligjet e vendit nuk lejojnë që një i pensionuar të vazhdojë edhe më tej me punë dhe të paguhet, përveç pensionit, edhe me rrogë të rregullt, siç ndodhë kjo te bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait. Një i punësuar në BFI obligohet që të kontribuojë për këtë Institucion, ta ruajë interesin e këtij Institucioni dhe mos t’i dëmtojë burimet e tij financiare, siç po ndodhë aktualisht në bashkësinë “fetare” të Shaqir Fetait. Sot kemi plotë hoxhallarë që punojnë si imamë nëpër xhami, por që janë edhe drejtues të oj-q-ve, të shtëpive botuese ku botojnë pa iu nënshtruar redaktimit profesional nga ana e ekspertëve të BFI-së, drejtojnë agjenci turistike, organizojnë haxh, umre, e lënë detyrën krye më vete dhe caktojnë vetë zëvendësues të tyre në xhami, deri sa do të qëndrojnë në haxh apo umre të organizuar privatisht. Kësisoj, krijohen raste kur asnjë organ i BFI-së nuk di se cili person është caktuar “imam” i përkohshëm i xhamisë, kush është ai, nga vjen ai, çfarë përgatitje ka etj.

Nuk mundet që një hoxhë i Bashkësisë Fetare Islame ta përdorë xhaminë dhe t’i animojë myslimanët që në haxh apo umre të shkojnë përmes agjencive private për të cilat punojnë dhe agjitojnë ata; nuk mundet që të mbledhin kurbanë apo fitra e zeqat për “ojq”-në që e udhëheqin vetë.

Dhe, meqë të gjitha këto anomali i hesht Shaqir Fetai, kjo nuk do të thotë se “BFI-ja po ec rrugës së mirë”. Këto anomali i hesht Shaqir Fetai, sepse karrierizmi i tij është katran i zi, sepse, për një “rehati në karrierë” është në gjendje të lejojë, të motivojë madje edhe t’i përkah veprimet nga më fatalet për Institucionin dhe për xhematin e vendit. Pastaj, kjo përpjekje e tij e djallëzuar, e çon të

gënjejë, e çon të bëjë veprime antiislame, e çon t'i mbyllë sytë para problemeve devijante, e çon të përkrah dukuri që nuk i kanë hije as një abnormali!

Këndellja e popullit do të ndodhë, shumë shpejt do të shihet se çfarë katastrofe paska qenë Shaqir Fetai, por, po shtohet droja se do të jetë paksa vonë! Do të duhet vite e vite për t'i sanuar defektet që i ka shkatuar Shaqir Fetai dhe pastaj të nisët me strategjinë që ia rikthen dinjitetin dhe identitetin Bashkësisë Fetar Islame. Zoti na ndihmoftë në tejkalimin e kësaj sfide që aktualisht është e vetnja e myslimanëve të vendit – dëbimi sa më parë i Shaqir Fetait, i kësaj katastrofe të myslimanëve të vendit!/**TetovaSot/19.11.2022**

**Biografia nuk mbulohet me xhingla-mingla**

**Kush janë ata të cilët i thërret Shaqir Fetai që ta vizitojnë? Kush janë ata prej të cilëve Shaqir Fetai kërkon që t'i organizojnë “pritje imponante”? Të gjithë janë “personalitete me kontribute të mëdha fetaro-kombëtare”? Pse ky vlerësim kaq shumë i rremë i Shaqir Fetait për persona e individë që janë me zero kontribut fetaro-kombëtar, pse ata personalitete me kontribute të hatashme fetaro-kombëtare, Shaqir Fetai frikësohet deri në vdekje t'i shikojë në sy**

***Nga Valbon Osmani***

Dikur, deri para puçit dhe komplotit klasik të Shaqir Fetait në BFI, këtë Institucion e vizitonin pa rreshtur subjekte ndërkombëtare, por edhe burrështetas e personalitete të instancave të larta shtetërore! Kur merrnin detyrën e re, kur në horizont do të shfaqej sado një krizë e vogël, kur përfundonin mandatin diplomatik e shkonin gjatë, por jo pa organizuar edhe takimin lamtumirës. Takime të tilla nuk ka më! Sepse, nuk ka as takime kur nisin me punë në vendin tonë. Të gjithë kanë instrukcione që mos t'i afrohen dhe ta injorojnë njeriun e shërbimeve të huaja, marionetën e turlifarë shërbimeve.

Tërë këtë mungesë Shaqir Fetai e mbulon duke i ftuar hoxhallarë, ish-nxënës, studentë, “diplomatë” të partisë, profesorë të kotë, intelektualë të nivelit të “intelegjencies” së vet, afaristë të kikirikave e të farave të lulediellit... Dhe, fap “informata”: “Sot pata nderin që të vizitohem nga hoxh... ky personalitet i moth (sipas shqiptimit të Shaqir Fetait) vendit, i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm fetaro-kombëtar”! Ose, “sot prita imamin e iks qytetit të shtetit perëndimor i cili është i njohur për kontributin e tij fetaro-kombëtar...”

Do me thënë, vetëm ata që janë me pedigree “fetaro-kombëtar” mund ta vizitojnë një “reis” që nuk është as tradhëtar e as spiun, si puna e Shaqir Fetait! Vetëm ata “personalitete” që kanë dhënë kontribut të madh “fetaro-kombëtar” mund ta presin një “kombëtar të moth” (si puna e Shaqir Fetait) që kurrë nuk ka qenë as spiun e as tradhëtar! Siç!

Duke qenë i shtrënguar në mengele të kësaj të vërtete, Shaqir Fetai i ka vënë vetes detyrë që, nëse e do nevoja edhe një qind vjet, do të angazhohet vetëm për ta kamufluar (jo për ta minimizuar, shlyrë apo zhdukur) etiketën e imoralit të pashoq në këtë nënqiell! Nën këtë inercion abnormal, Shaqir Fetai ka hequr dorë edhe nga e vërteta, edhe nga islami, edhe nga aktivitetet për zhvillimin e islamit në vend, edhe nga e mira e përgjithshme e myslimanëve të vendit. Prioritet mbi prioritetet e tij është që të presë “personalitete me kontribut të moth fetaro-kombëtar” dhe të pritët prej “personaliteteve të njohur në mbarë Evropën për kontribute fetaro-kombëtare”!

Shaqir Fetai, duke u munduar që t'i hedh hi syve të myslimanëve të vendit, përpiket që të imponohet si “personalitet shumë i moth fetaro-kombëtar”, ndërkoh që t'i kërkoshë: ose thuaje vetëm më të voglin kontribut fetaro-kombëtar që e ke ose dënohesh me 100 vite burg, kokëulur do t'i ndëshkohet dënimit, sepse, nuk do të mund ta gjejë asnjë kontribut, ndërsa në UDB kontributi i tij është “madhor”!

Shaqir Fetai tashmë e ka uzurpuar një vend shumë të rëndësishëm për islamit dhe për mbarë popullatën, e ka uzurpuar vetëm sa për t'i shëruar kompleksët e veta dhe sa për ta ulur atë afsh që e kishte të bëhej “reis për dy vite, deri sa të pensionohet”! Pra, synim e kishte pensionimin dhe jo jetësimin e programit sipas të cilit garantohej zhvillimi dhe avancimi i jetës fetare islame në vend. Uzurpimi i këtij vendi, pa kurrfarë plani e programi, a nuk është mëkat që ushtrohet nga kryemëkatari! Në momentin kur kryemëkatari vizitohet nga “personalitete të mëdha

fetaro-kombëtar”, apo kur kryemëkatari pritet nga “personalitete të mëdha fetaro-kombëtar”, ky moment do të shënojë nismën e kijametit! Kjo nuk mund të ndodhë asnjëherë, ndërsa mund të ndodhë të vizitohet nga persona e individë që i kryejnë detyrat dhe obligimet fetare si të gjithë hoxhallarët, gjithandëj botës, pra edhe si ata hoxhallarë që nuk pranojnë as ta vizitojnë Shaqir Fetain e as ta njohin për insan!

P.s.

Në një -çajtoje, aty në Jahja Pashë, e zënë ngusht hoxhën që e kishte vizituar Shaqir Fetain i cili e kishte vlerësuar “personalitet me kontribut të moth fetaro-kombëtar”! Kishin insistuar me këmbëngulje që t’ua thotë kontributet e veta fetaro-kombëtare! Hoxha ishte habitur, ai as që e kuptonte fjalën kontribut dhe as që e kuptonte fjalën “fetaro-kombëtar”! “Unë nuk di se ku ia ka futë ai dhe çka i është dashur kjo rrenë, unë nuk kam bërë asgjë, sepse, tash e tridhjetë vite jam nëpër dyert e psikiatrive të ndryshëm”, ishte përgjigjur hoxha all i skuqur në fytyrë ngase ishte turpëruar!

E kishin zënë para vetes disa intelektualë e patriotë të rreptë hoxhën në një qytet të Perëndimit dhe, e kishin pyetur: ku e ke dhënë ti atë kontribut fetaro-kombëtar që po ta njihkëka ty “ORAO”! Hoxha kishte thënë: “unë kurrë nuk kam pranuar t’ju përzihem në punë juve! Unë jam i thirrur vetëm për detyrat e mia si imam në raport me xhematin e këtushëm, dhe nuk mbajë përgjegjësi kah pallamudë Shaqir Fetai”!

Të gjitha vlerësimet, nënçmimet, urrejtjet, frikërat, veprimet antikombëtare e antifetare, janë vetëm xhingla-mingla në shiritin e varur krahëqafe me të cilën Shaqir Fetai mundohet ta “zbukurojë” veten! Shëmtia ngelë përherë shëmti. Me thjeshtësinë e vet mund të ndodhë që të kalojë në vepër arti, në kryevepër. Edhe i prishtë edhe kryevepër prej portreti?! Po, ndodhë vetëm në pikturë!/**TetovaSot/22.11.2022**

**Rosaku patriot**



**“Të gjithëdhishmit” Shaqir Fetai njëmilion herë i është thënë që mos t’i japë kosës gjërë, sepse, aq sa i duket vetja “intelektual” aq më shumë na shpërfaqet në analfabet**

***Nga Halid Sadiku***

Shaqir Fetai na e paska uruar 22 Nëntorin, ditën e Alfabetit Shqip. E çka thotë Shaqir Fetai në urimin e vet? Ia futë kot, kësaj ngjarje madhështore ia bashkangjet edhe një ngjarje që nuk ka ndodhur në këtë vit dhe në këtë datë por, ka ndodhur, fiks 64 vite më vonë. Shaqir Fetai thotë: “22 Nentori është ngjarje e madhe e shqiptarëve që simbolizon unifikimin e gjuhës dhe themelimin e alfabetit shqip.”

Pa dyshim, dita e themelimit të Alfabetit është 22 nëntor, viti 1908 “Kongresi i Manastirit, 14-22 nëntor 1908)! Kurse unifikimi i gjuhës shqipe ndodhë në Kongresin e Drejtshkrimit, më vitin 1972!

Pas këtij urimi, Shaqir Fetai nuk harron që ta publikojë edhe foto-sesionin e vet, t’i publikojë një dhjetra fotografi nga pjesëmarrja e tij në një akademi solemne kushtuar Ditës së Alfabetit Shqip, organizuar me gjasë nga partia shqiptare në pushtet! Shaqir Fetai i jep aq shumë hapësirë këtij eventu thuse e ka organizuar vetë ai apo “organizata” e tij! Shaqir Fetai me këtë dëshmon se jeton në organizime të huaja, nuk ka kënaqësi më të madhe se sa ta ftojnë në evente të huaja ku ky do të krekoset si gjeldet, dhe të shesë “stile patriotike”!

Po pse Shaqir Fetai nuk organizon diçka për nderë të kësaj Dite, kur dihet se kontributi i teologëve shqiptarë ishte i jashtëzakonshëm! A e di Shaqir Fetai se kush nga hoxhallarët e asaj kohe morën pjesë në këtë Kongres?

A ka dëgjur ndonjëherë Shaqir Fetai se, në Kongresin e Alfabetit morën pjesë këta hoxhallarë: Hoxhe Hasan Tahsini, Hoxhe Daut Boriçi, Hafiz Ali Ulqinaku, Hoxhe Said Najdeni, Hafiz Ali Korça, Hoxhë Rexhep Tetova dhe Hoxhë Abdulhaqim Hiqmet Dogni! Pse Shaqir Fetai në prag të Ditës së Alfabetit Shqip nuk organizon ndonjë event, ndonjë simpozium shkencor kushtuar këtyre hoxhallarëve shqiptarë që dhanë kontribut të pamohueshëm në themelimin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe? Pse merr pjesë në një event ku nuk u përmendet as emri e lëre më kontributi i këtyre hoxhallarëve patriotë? Apo, Shaqir Fetait nuk i hy në kokë fakti që një hoxhë mund të jetë edhe patriot shqiptar, meqë vetë, që në bankat shkollore të mesme ka hequr dorë nga patriotizmi për ta dëmtuar rëndë atë në vitet e studimeve!

Natyrisht, Shaqir Fetai nuk e ndriçon këtë periudhë kaq të rëndësishme të shqiptarëve, sepse, do të tmerrohej edhe vetë nga të dhënat e asaj kohe kur do të bënte krahasimin: në çfarë niveli të lartë patriotik kanë qenë hoxhallarët e kohës dhe, në çfarë niveli të tradhëtisë është sot, bie fjala, “hoxhë” Shaqir Fetai! Periudha e themelimit të Alfabetit Shqip e kompleson së tepërmi Shaqir Fetain, prandaj nuk i qaset ngjarjeve që do të jepnin kontribut mbi zbardhjen e së kaluarës ku hoxhallarët ishin në krye të detyrave patriotike, ku nuk mund të ndodhte asnjë ngjarje e rëndësishme kombëtare pa u kërkuar edhe kontributi i hoxhallarëve.

Po sot? Në çfarë derexhe i ka sjellë hoxhallarët Shaqir Fetai? Nga të gjithë ata kërkon që të respektohet dhe të përkrahet një mahluk i rrezikshëm siç është vetë ai, duke u thënë: më përkrahni mua, sepse mua më do partia e pushteti! Unë jam karabiberi i partisë, në çdo event të tyre prezenca ime është e domosdoshme, prandaj, më duani mua nëse doni t’ju dojë pushteti! Ky e ka me pushtetin që e instaloi dhe jo me eventet dhe kontributet kombëtare të hoxhallarëve.

Shaqir Fetai ua përcjell mesazhin: i vetmi angazhim patriotik i juaji, si hoxhallarë, është të më doni mua, pavarësisht të kaluarës sime të pistë!/**Kombetare/24.11.2022**

**Mospërfilja e datave kombëtare**

**Nuk është urimi i thatë, nuk është as pjesëmarrja formale nëpër evente partiake, aktivitet që mund të përkthehet në përpjekje për të shënuar data të rëndësishme kombëtare! Me këto trupe idiotike Shaqir Fetai është bërë tepër bajat. Më 17.11.2012, në mbyllje të simpoziumit kushtuar kontributit të ulemasë në ngritjen e çështjes kombëtare, kumtohet që BFI-ja OBLIGOHET që pas dhjetë viteve, në përvjetorin jubilar të Pavarësisë të Shqipërisë, të mbajë simpoziumin e radhës për të hedhur dritë mbi fakte e personalitete të tjerë nga komuniteti i teologëve shqiptarë që dhanë kontributin e tyre vetëmoues për gjuhën, fenë, kombin, vatanin, shtetin**

***Nga Mr. Abaz Islami***

“Botimet islame në gjuhën shqipe deri më 2020”, bibliografi me profil katalogu të rëndomtë, botim ky i bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait, ka muaj që është botuar. Shaqir Fetai përkujdeset që pikërisht tani ta organizojë një promovim! Kurrë në jetë i mjeri nuk ka organizuar kurrfarë promovimi të librave të botuar që janë përfshirë në këtë katalog, ndërsa vendos ta promovojë librin me tituj të librave tashmë të botuar! Sa për informim të injorantit, katalogjet nuk promovohen, ndërsa nëse mendon se po promovon një “libër shkencor”, apo, një “bibliografi”, e ka gabim, sepse botimi në fjalë në asnjë moment nuk ka pikëtakim me këtë shkencë! Bibliografia është shkencë më vete, katalogu është një “bllok” teknik për një qëllim të caktuar!

Po pse tani i hy këtij “aktiviteti shkencor” Shaqir Fetai! Shumica do të mendojnë se, i ka hyrë përrurimit tani, sepse u bë shumë kohë që Shaqir Fetai nuk ka folur “për shkencë”, nuk është dëshmuar si “shkencëtar” dhe, ja momenti: të promovojmë një katoog të botimeve islame në gjuhën shqipe! Uh çfarë aktiviteti pretencioz; punë kjo për komisione të të tri bashkësive fetare islame (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut) komision i posaçëm nga diaspora dhe, gjithësesi, komision i veçantë për botimet nga botues e shoqata private anekënd trojeve dhe viseve etnike! Do të thoshin që, ja, Shaqir Fetait i duhet një aktivitet ku do t’i mbledhë disa kuazi-shkencëtarë, disa intelektualë të mendermethëshëm dhe, hajde tani ta mbushim një album me foto: Shaqir Fetai i përqaftuar me cinizëm nga ata që vuajnë për të përçar mesazhe përmes gjesteve dhe sjelljeve të tyre, e me intelektualë që, të dalur krah Shaqir Fetait, dëshmojnë se sa lirë e shesin mendimin shkencor, sa lehtë ia bëjnë qejfin mahlukatit, sa me lehtësi dalin në foto me një shpirtshitur, edhe atë për një honorar prej jo më shumë se dy mij denarë.

Në fakt, Shaqir Fetai e di fort mirë se brenda muajit nëntor është dashur të promovohet një tjetër titull që do të ishte pëmbledhje e kumtesave shkencore kushtuar kontributit të teologëve mysliman shqiptar të angazhuar për vatanin.

Me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë të Shtetit Shqiptar, Bashkësia Fetare Islame organizoi Simpozium Shkencor, më temë “Kontributi i Ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare”! Në përmbyllje të Simpoziumit, i cili hodhi dritë mbi shumë fakte historike, mbi shumë personalitete fetar të kombit që kishin kontribuar për ndërtimin e identitetit kombëtar, kryetari i Këshillit Organizativ, H. Afrim ef. Tahiri, veç të tjerash do të theksonte: “Në emër të KO të këtij Simpoziumi, në emër të BFI-së dhe kryetarit të saj, H. Sulejman ef. Rexhepit, ju ftojme për bashkëpunim të mëtutjeshëm për të nxjerrë nga pluhuri i harresës edhe shumë personalitete të tjerë që kanë dhënë kontribut për gjuhën, fenë, kombin, vatanin, shtetin... Kam nderin që, prej sot (17.11.2012, vër. ime) t’ju njoftojmë se, me rastin e 110 vjetorit të Pavarësisë, pra, në vitin 2022, BFI obligohet që në të njëjtën temë të mbajë edhe një simpozium ku, ju dhe studiues të tjerë, do të keni rastin përmes dokumentave dhe fakteve historike t’i zgjeroni punimet e juaja shkencore dhe të ndriçojmë edhe figura të jerë fetare e kombëtare.”

Shaqir Fetai, ky farë instalacioni në krye të BFI-së, jo që e tejkalon afatin e orgnizimit dhe mbajes së një simpoziumi aq shumë të rëndësishëm, për të cilën paraprakisht, dhjetë vite më parë, ishte zotuar BFI-ja se do ta mbajë, duke i njohtuar historianët, shkencëtarët shqiptarë gjithandej trojeve shqiptare, pra, jo që e heshtë këtë datë e këtë organizim, por, mundohet që atë ta mbulojë me një kuazi-aktivitet të denjë për shoqatat joqeveritare!

Se pse Shaqir Fetai “e ka harruar”, këtë datë e këtë ngjarje me rëndësi të madhe kombëtare, për këtë është mirë të flasë vetë ai! Se kush e ka urdhëruar që ta anashkalojë këtë ngjarje jetike për myslimanët shqiptarë, edhe për këtë duhet të flasë vetë Shaqir Fetai. Bashkësia Fetare Islame nuk është pronë e Shaqir Fetait që e ka trashëguar prej haxhi babës së vet dhe, ja tash, meqë patalogjikisht e urrenë Sulejman ef. Rexhepin dhe Afrim Tahirin, do ta zerojë një aktivitet të tillë, qoftë kjo edhe me harrimin e të gjithë atyreve që kanë dhënë kontribut të veçantë kombëtar dhe fetar. Meqë është aktivitet i premtuar qysh para dhjetë viteve nga Afrim Tahiri, me të cilën obligohet BFI-ja që ta organizojë, Shaqir Fetai qëllimisht “e harron”! Myslimanët e vendit, nuk kanë, nuk kanë ama bash kurrfarë nevoje që të njohtohen me kuazi-aktivitetet e Shaqir Fetait, por, kanë nevojë dhe interes të posaçëm që të njohtohen me të kaluarën e hoxhallarëve që me të drejtë e kanë gëzuar epitetin e persoalitetit fetar e kombëtar, por që ideologjia komuniste dhe tipat si Shaqir Fetai, qëllimisht i kishin lënë në harresë.

Nuk është i pari dhe i vetmi aktivitet kombëtar që e stopon apo që e anashkallon Shaqir Fetai! Nëse dikur BFI-ja e obligonte veten për ta ndriçuar të kaluarën e lavdishme të ulemasë shqiptare, Shaqir Fetai, me gjasë, e ka obligim që t’i mohojë të gjithë ata teologë që dhanë kontribut për çështjen kombëtare, sepse vetë ka qenë aktivist i devotshëm i anti-çështjes shqiptare! Le ta provojë të kundërtën, nëse nuk frikësohet se mund t’i vërshojnë të tjera fakte për të kaluarën e tij!/**Top24/26.11.2022**

**Sa kushton “patriotizmi” i shpifur i Shaqir Fetait**

**Shaqir Fetai, instalacioni i shërbimeve të huaja në krye të BFI-së, brenda javës lëviz si i ndërkrayer, si i shastisur e i dalur mendsh, sepse, po afrohej 28 Nëntori e ky nuk e kishte të qartë se çfarë të bënte! Për “vepra patriotike” nuk duhet të shpenzohet Shaqir Fetai, ai duhet të përfitojë nga ato! Vërtet, sa i kushton BFI-së “patriotizmi” i shpifur i Shaqir Fetait**

***Nga Alban Muça***

**1.**

Këto ditë, meqë u zbulua lakuriq shpirtvogëlsia e Shaqir Fetait, ai, duke refuzuar kategorikisht mbajtjen e premtimit të dhënë dhjetë vite më parë para intelektualëve e personaliteteve kombëtarë që, me rastin e 110 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë të mbahej edhe një konferencë gjithëkombëtare organizuar nga BFI, zgjedh të ikë në Bullgari, në një konferencë Ballkanike ku na e paskan vënë theksin në siguri dhe paqe në rajon! Po çka mund të flasin e të kuvendojnë krerët e bashkësive fetare islame të rajonit përveçse të tërheqin vërejtjen nga lëvizjet e mundshme të elementit të pranishëm ndër shoqërinë myslimane dhe, në emër të islamit e në interes të ideologjive antiislame të bëjnë ndonjë sherr! Vetëm për këtë duhet të debatohet, ë? Dhe, nuk duhet fare të ngritet iniciativa dhe theksi të vihet ekskluzivisht mbi politikën shoveniste të Serbisë e cila po u kanoset me luftë miliona myslimanëve të rajonit ballkanik! Pra, problem qenkan myslimanët dhe jo serbët që me tërë qenien e tyre janë vënë në shërbim të shtetit terrorist, Rusisë! Meqë bëhet fjalë për Rusinë, Shaqir Fetai duhet të rrijë sus, sepse, një Zot e di se çfarë mund t’i zbulojnë më tej nga dosja e tij!

**2.**

Natyrisht, shumë shpejt Shaqir Fetai do ta kuptojë këtë gafë dhe, që mos të përballet me opinionin e gjërë që po kërkon të dijë se pse Shaqir Fetai nuk e organizoi Konferencën gjithëkombëtare dedikuar ulemasë shqiptare, do të ikë në Zvicër! Nuk do të mbajë ndonjë ligjeratë, për shembull, në Xhaminë e Larmë të Tetovës, ku është falur e lutur edhe Said Najdeni, Hoxhë Voka, delegat në Kuvendin mbarë kombëtar tubuar me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërië. Ai do të shkojë në Eftetikon të Zvicrës, për ta festuar pesëvjetorin jubilar të një qendre islamike të Debreshit në këtë qytet zvicëran! I ikë manifestimeve të rëndësishme kombëtare për t’u fshehur diku nëpër tubime aspak të rëndësishme!

Shaqir Fetai nuk ishte në mesin e patriotëve të tij debreshasë se i plasi xhani për ta, apo se aty pa diçka të rëndësishme “islamike”, por, thjesht, iku se udhëtimet në Evropë sjellin edhe mëditje të mëdha! A e mbani mend se sa herë ka qenë Shaqir Fetai në Zvicër e sa në Kosovë? Po në Shqipëri? Epo, nuk shkon këtu se, mëditja nuk është më e madhe se 30 euro, ndërsa në Perëndim (përfshirë edhe Bullgarinë) mbushen xhepat, natyrisht, nga arka e BFI-së ku vajton e rënkon parja nga fitri, zeqati, kurbanët e haxhi!

Shaqir Fetai që kur e uzurpoi zyren e reisit pas një puçi klasik dhe një komploti me plotë tradhëti, më tepër ka qëndruar në Zvicër se sa në Myftininë e Kumanovës, Zvicrën e ka pasur më të afërt se, për shembull, Myftininë e Shtipit, të Resnjës, të Prilepit, të Velesit, të Dibrës! E pse të vizitohen këto vende kur nga kjo nuk hy në xhep të Shaqir Fetait kurrfarë mëditje, por do t’i llogariteshin aktivitetet e punës ditore. Shaqir Fetai është mësuar të vjedhë aktivitetet e jo të organizojë!

Në këtë qendër të debreshasëve, Shaqir Fetai u kërkoi që t’ia siguronin një ikonografi kombëtare, sepse, në vendlindje e mbytën me kritika. Foltoren ia mbështjellën me “flamurin” e

Ballistit të njohur, kurse prapa shpinës ia vunë një flamur kombëtar. Dhe me kaq Shaqir Fetai i doli hakut gjithë atyre burrave të kombit që u angazhuan për Pavarësinë e Shqipërisë. Ku i ha palla Shaqir Fetait për burrat e kombit!

### 3.

Shaqir Fetai mundohet ta vjedhë edhe një akt shumë fisnik dhe të lartë të Komunës së Tetovës, konkretisht të kryetarit Bilall Kasami, i cili ia doli që, shkrimtarin e madh të letrave shqipe, Ismail Kadarenë, ta shpallë Qytetar Nderi të Tetovës! Së këndejmi a nuk i vie turp Shaqir Fetait që të dalë me informacion me titull “BFI pjesëmarrëse në dekorimin e Ismail Kadaresë”? E para, gënjeshtër e ulët, sepse Kadare nuk u dekorua por u SHPALL Qytetar Nderi! E dyta, të thuash se BFI mori pjesë në dekorimin e Kadaresë, i bie që në përgatitjen e medalionit, në serdhjen e saj në flori, në blerjen e shiritit etj. mori pjesë edhe BFI-ja! Në fakt, “BFI”-ja mori pjesë në ceremoninë e organizuar me rastin e shpalljes së Kadaresë Qytetar Nderi i Tetovës, meritë kjo ekskluzive e administratës së Komunës së Tetovës.

Në atë ceremoni mori pjesë Myftiu Qani Nesimi, përfaqësues i organit fetar islam i Bashkësisë Fetare Islame të Tetovës! Ai nuk është ftuar aty si “hija” e Shaqir Fetait por është ftuar si Myfti i Tetovës. Vërtet, a u mor vesh se kush e pengoi Shaqir Fetain që të marrë pjesë në këtë event kushtuar “mbretit” të letërsisë shqiptare! Pra, sa është e turpshme aq është edhe përpjekje diktatoriale e “perandorçicit” Shaqir Fetai që të këmbëngulë se në atë event Dr. Qani Nesimi e ka përfaqësuar Shaqir Fetain, sepse, aty ai është ftuar si Myfti i Tetovës.

Dhe, kulmi i prishurisë shpirtërore i Shaqir Fetait! Vjen fluturimthi nga Zvicra e drejt në sallën ku Ambasadori Shqiptar kishte organizuar pritje me rastin e Ditës së Flamurit dhe të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar! Shaqir Fetai na sjell “fakte” nga ai event, sipas të cilave na del se vetë Shaqir Fetai ka qenë qendra e vëmendjes, në fakt, vetë ai ka qenë organizator i një gjëje shumë të madhe. Plotë 36 fotografi që flasin për “pritjet dhe përshëndetjet” të Shaqir Fetait me shumë personalitete të pranishëm aty. Në bazë të këtij seti fotografik nënkuptohet se aktiviteti i ambasadorit Reka ka qenë “aktivitet” personal i Shaqir Fetait. Shaqir Fetai e bën edhe këtë marrinë, siç e kishte bërë edhe tjetrën në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, ku ka mbajtur ekspozitë Kancelari Gjerman, Frank- Walter Shtajnmajer!

Është mirësjellje, është kulturë, është protokolare që një buerrshettas në një parlament të huaj të zhvillojë disa përshëndetje, sidomos më ata që janë në reshtin e parë përpara të cilëve paralakohet deri në ulësen e caktuar. Kjo kulturë u vërejt edhe nga Kancelari Shtajnmajer i cili, u përshëndet sa për kurtuazi gati me të gjithë ata që kishin zënë vend në rreshtin e parë. Nuk është ky moment për fotografim, madje është përtej çdo respekti e kulture. Ndërkaq Shaqir Fetai, duke iu mbështetur si petull e bërë në ujë, duke u krekosur si gjeldet në krah të mysafirit gjerman, fak e fak ia vjedh një fotografi, duke e lënë në pozita shumë të palamueshme Kancelarin gjerman në komisionin parlamentar të të cilit, katër vite më parë është diskutuar edhe për largimin nga puna të gazetarit të BFI-së, madje me popozimin e vetë Shaqir Fetat. Nuk është e rëndësishme kjo, e rëndësishme sipas Shaqir Fetait është se gjermani “pranoi” të fotografohet me të! “Ja ja, edhe ky më do, jam aleat i tij”, mund t’i ketë bërë qejfin vetes Shaqir Fetai i ngratë!/**TetovaSot/30.11.22**

**Asnjë tradhëtar nuk ia ka dalur të bëjë karrierë**

**Shaqir Fetai, instalacioni i shërbimeve antiislame në krye të BFI-së, jo vetëm që është i pashoq në prishuninë e tij, jo vetëm që është shpirtzi e intrigant por, na del të jetë edhe tallës i paparë. Tallet me kë të mundet, ku t'i jepet mundësia ai tallet, ai përqesh, përgojon, sakaq personatetet me integritet mundohet t'i vë në lojë. Me të tilla zezona kënaqet Shaqir Fetai. Kjo është edukata, kjo është kultura, ky është njerzillëku i tij**

***Nga Naim Ramadani***

Në FB-un e vet, Shaqir Fetai poston një informatë përplot me budallakira, madje që në titull: “VIZITË E Z. NASER ALIMIT NGA TURQIA ME PREJARDHJE NGA JAKRENOVA E PRILEPIT”! A është lexuar ndonjëherë titull më idiotik në një informatë? Kush është ky farë z. Naser Alimi? A mos është ndonjë kryetar organizate botërore, ndonjë president a kryeministër që me doemos duhet t'i theksohet emri që në titull! Qenka nga Jakrenova? Po pse a e di Shaqir Fetai se ku është Jakrenova? Ka qenë ndonjëherë? E ka vizituar?

Z. Alimi na qenka biznesmen dhe filantrop i dallueshëm në Turqi, paska kontribuar në ndërdimin e disa xhamive. Paska donuar edhe ndërtimin e xhamisë në Jakrenovë! Zoti e shpërbleftë me të gjitha të mirat e Tij!

Por ama të bëhet lajm se ka ardhur dhe e ka vizituar një të panjohur, te i cili pastaj është rrëfyer se çfarë biznesmeni është, me çka merret dhe çka është në gjendje të bëjë, kjo i vie (sipas informatës së publikuar nga Shaqir Fetai) që ka ardhur te dikush prej të cilit kërkon “koncesion”, kërkon terren e fushëveprim për biznesin e vet, sepse, ja që po kontriboka edhe për ndërtimin e xhamive! Tani Shaqir Fetai na bën lajm mbi biznesin e tij në faqen zyrtare të BFI-së!

Jo vetëm kaq, por, Shaqir Fetai shfrytëzon rastin dhe mysafirit i këkon të inicojë diçka që do t'i shkonte në të mirë të Shaqir Fetahut: të inicojë një tubim me shqiptarët e Turqisë, të shkonte ky atje dhe, të gjithë ata të çmалleshin me vendlindjen. Pra, shih Shaqir Fetahun e çmallur me vendlindjen! Të mblidhen diku në Stamboll, të njihen në mes vete, ta njohin edhe Shaqir Fetain sepse vetëm kështu ata do të çmалleshin me vendlindjet e tyre prej ka janë dëbuar për në Turqi. E kush i dëboi? Natyrisht, UDB-ja, Stanko Dragoviçat e Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai gjithnjë e më shumë po e ndjenë veten si një lider me famë botërore, po mendon se, meqë e kanë pranuar myslimanët e Maqedonisë së Veriut, të Bullgarisë si dhe të Vinteturit, do ta pranojnë edhe ata të Stambollit. Madje, Stambolli është vend i bekuar prej nga shpërthejnë liderët me famë botërore, si Rexhep Taip Eerdogani! Shaqir Fetait i është rrasur mendja se edhe ky mund të shpërthejë në Stamboll, madje t'ia tejkalojë Erdoganit, vetëm i duhet dikush, si puna z. Alimit, që t'ia organizojë tubimin e t'i mbledhë të gjithë ata shqiptarë të migruar gjithandje Turqisë, të cilët, pastaj, e kanë shumë të lehtë të mblidhen sapo të dëgjojnë se në tubim do të prezantojë Shaqir Fetai – të gjithë do të turren pas tij që të çmallen me atdheun! Funjda, Erdoganit nuk ia ka dalur që deri më sot në shesh të Stambollit të tubojë më shumë se dy milion militantë të tij, kurse Shaqir Fetai mendon se mund t'i tubojë 5-6 milion shqiptarë sa janë nëpër Turqi. Gjakovari thotë: “Hajt bac t'u rritë mendja”!

A ka më cinizëm se kjo? A ka më intrigë dhe më idiotësi se kjo e Shaqir Fetait! Po pse Shaqir Fetai nuk e organizon një tubim të shqiptarëve nga Turqia mu në mes të Shkupit, dhe këta pastaj, pasi të mrekullohen me paraqitjen e Shaqir “shpëtimtarit”, të shkojnë secili në vendlindje dhe të çmallen me vendin e me njerëzit e tyre. Kjo po që ka logjikë, por ama, të kërkojë Shaqir Fetai të tubohen shqiptarët në Stamboll dhe ta presin “shpëtimtarin” dhe “çmallësin”, Shaqir Fetahun, përmes të cilit do ta shuajnë mallin për atdhe, kjo vërtet që është përtej racionales, është përtej

logjikës, përtej normales, të cilën mund ta ëndërrojë vetëm faqeziu, vetëm i kompleksuari kokë e këmbë, Shaqir Fetai.

Dhe, meqë Presidenti turk është lider botëror dhe nga kjo pozitë e ka gjithë komoditetin e vet për të shprehur brengën shtetërore për turqit që janë shpërngulur dhe veprojnë në Perëndim, edhe Shaqir Fetai shpreson ta përsërisë këtë sukses kur thotë: “BFI do të tregonte kujdesin ndaj bashkatdhetarëve të cilët për shkaqe të ndryshme janë shpërngulur në Turqi”! Jo për shkaqe të ndryshme o Shaqir Fetai por, shkurt e shqip, për shkaqe politike dhe të skenareve të UDB-së (aty ku ke hëngër bukë edhe ti) këta shqiptarë janë shpërngulur në masë të konsiderueshme nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut, nga Mali i Zi dhe nga Lugina e Preshevës që nga Nishi e Prokuplja për në viset e ndryshme të Turqisë. Mos e amnisto UDB-në, as veten mos e ngrit në “lider”, sepse tradhëtarët kurrë në jetë nuk kanë bërë karrierë!

Le ta gjejë Shaqir Fetai vetëm një tradhëtarë që ka bërë karrierë e pastaj do ta quajmë “reis”!  
**/Kombetare/02.12.2022**

**Të gjitha kafshët e liga të "shpirtërores" së Shaqir Fetait**



**Pseudohumaniti, i cili (e di vetë ai!) me një fjalë nonshalante që e ka nxjerrë nga goja si buallica bajgën, ka ditur të djegë e të përvëlojë familje të tëra, fëmijë e nipër (mbase në mesin e tyre edhe persona me nevoja të veçanta) i “RESPEKTOI PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA TE SHOQATA “MËSHIRA” dhe të “SOS VITA”**

*Nga Halid Sadiku*

Me rastin e 3 Dhjetorit, Ditës së personave me nevoja të veçanta, tash e sa kohë është bërë traditë që të vizitohen entet por edhe organizatat joqeveritare që merren me këtë vlerë shoqërore tejet të çmuar, të dashur e të vlerësuar ndër ne. Natyrisht, ndonëse një herë në vit, të paktën këta persona e ndiejnë përkujdesin e shoqërisë dhe mund ta shohin humanitetin në vepër të institucioneve dhe të subjekteve të ndryshme në vend. Ata që janë më serioz, të nivelit shtetëror e shoqëror, bëjnë vizita nëpër ente, nëpër hapësira të veçanta ku trajtohen këta persona por edhe nëpër shtëpi të ndryshme, ndër familje që rrisin dhe përkujdesen për persona me nevoja të veçanta. Gjithësesi, gjatë këtyre vizitave dërgohen edhe ndihma të ndryshme – enteve u dërgohen mjete mësimi, mjete elektronike, televizorë, ndonjë paisje elektrike për guzhinë, lodra të ndryshme, shoqatave që përkujdesen për persona të tillë u shpërndahen lodra, mjete që mundësojnë lëvizjen e personave që kanë nevojë për të tilla paisje, por edhe familjarëve u dhurohen, kryesisht, karroca. Po me këtë rast, çka dhuroi Shaqir Fetai, meqë i “paska respektuar” të dy shoqatat!

Po a mund të kujtohet një person i djallëzuar deri në maje të kohës, a mund të kujtohet një person që shpirtëroren e ka përplotë me kafshë të liga, pra, një Shaqir Fetai i tillë, a mund të kujtohet që në të tilla raste nuk shkohet “si ai në dasëm”, duart në xhepa, por ndan diçka nga buxheti i institucionit të vet që të dhurojë ndonjë dhuratë sado qoftë ajo modeste! Jooo, sepse buxhetin e ka për të blerë rehati kolltuku të uzurpuar, e ka për ta blerë dhe korruptuar përkrahjen prej marionetave të kabur të tij, e ka për t’u “palluar” nëpër “qevapçillnici” si dhe për shëtitje e mëditje. I ka punët në terezi, prandaj, as që i shkon në mend që ta gëzojë këtë komunitet ndër më të veçantit në shoqërinë tonë.

Jo po, kështu ndodhë kur të jeshë “një prej ushtrisë së djallit” ku mund të aderojë duke i bërë tjetrit keq, duke ia djegur shpirtin dhe familjen, duke shpifur e duke urryer, duke u friksuar në përballje me vlerat dhe njerzillëkun, duke e vjedhur vakëfin dhe duke e dëmtuar jetën institucionale, duke e dezorganizuar xhematën dhe duke e orientuar kah poshtrimi dhe degradimi, kah fracionimi dhe kah rrënimi i çdo vlere islame në këtë nënqiell, të ngritur me shumë mund e sakrificë ndër breznit.

Shaqir Fetai mund të thotë (ashtu siç e ka përfunduar “informacionin”): çka dëshironi nga unë? A nuk mjafton që me prezencën tonë tek këta persona dhe tek familjarët e tyre “mbollëm emociione”? Shaqir Fetai thotë: “Vërtetë u vërejtë gëzim i madhë tek personat me nevoja të veçanta, familjet e tyre dhe mbollën emocionet tek të gjithë të pranishmit.”

Kurani i Madhërishtëm flet mjaft qartë për këtë soj njeriu siç na del këtu Shaqir Fetai! Po si more paska “mbjellë emociione”? Gjëja shkakton emcione, nuk mbjell, sepse i ka mbjellur Krijuesi i Gjithësisë! Mendja e tij e djallëzuar mendon se është “krijues”! Krijuesi Mëshirëplotë, që kur e krijoi qenien e parë njerëzore, e deri më sot, të gjithë krijesat e veta në këtë botë i nxjerr, veç tjerash, edhe me emociione! Pra, qeniet njerëzore lindin me emociione dhe nuk ka nevojë që Shaqir Fetai “t’ua mbjellë emocionet”? Madje, për të mbjellë duhet të keshë “farë”? Po ç’farë mund të ketë Shaqir Fetai përveçse ato të djallit të mallkuar! Dhe ky të mbjellë diçka, “të mbjellë emociione”? Njeri pa kurfarë emociione, njeriu që nuk e emocionon askend, njeriu i stërngrakuar

në shpirt me kafshët e liga – është i mallkuar, e ka haram të prezantojë nëpër manifestime të tilla, e ka haram të dalë nga oborri i shtëpisë së vet, sepse për interes të vetin mund t’i xhingosë të gjithë.

Çka bën i xhingosuri, i mbërthyeri nga kafshët e liga? Shaqir Fetai mundohet që me zbutjen e situatës në të cilën është gjendur pasi e kanë hetuar se është përfaqësues i pseudohumanizmit, i kujtohet që t’ju shprndajë “dekorraçione” atyre institucioneve e shoqatave që kanë donuar ndonjë dhuratë për këta persona me nevoja të veçanta. Pra, Shaqir Fetai i “motivon” të tjerët për humanitet, derisa me këtë gjest fuqimisht dëshmon se ai dhe humaniteti janë dy nocione që nuk përputhen në asnjë pikë!

Të jeshë tallës, përçmues idiot, i prishur në shpirt, nuk mund të jeshë, njëkohësisht, edhe humanist. Pseudohumanit si puna e Shaqir Fetait, po! /1KlikLarg/04.12.2022

**Nga ekspertët amerikanë të "krihet" edhe Shaqir Fetai**

**Në Maqedoninë e Veriut kanë zbarkuar edhe ekspertët amerikan që hulumtojnë dhe ndëshkojnë korrupsionin sidomos në institucionet e gjyqësorit, te funksionarët, pseudo-biznesmenët etj. Po Shaqir Fetai dhe institucioni i tij “fetar”, në cilin segment të shoqërisë bëjnë pjesë?**

***Nga Jasin Arbnori***

Për këto vite demokracie në shtetin tonë, amerikanët mjaftë kanë ndarë buxhet e ndihma nga taksapaguesit e vet për shoqërinë maqedonase e cila është dashur të aftësohet dhe të trimërohet për ta hetuar dhe ndëshkuar korrupsionin në çdo pore të shoqërisë së këtij shteti! Megjithatë, nuk është hedhur një hap tutje, që do të thotë se, institucionet gjegjëse kanë vazhduar të ngelin të korruptuar. Amerikanët kanë shprehur habinë se si, bie fjala, një lëndë e të drejtës civile, siç është largimi tendencioz nga puna (!) të zgjasë katër vite, ndërkohë që duhej të shterronte për maksimum gjashtë muaj! Kështu, gjyqësori është palë me institucione joserioze dhe pala e larguar nga puna ngelë plotë katër vite pa kurrfarë të ardhure, pa sigurim shëndetësor e pa perspektivë!

Më në fund, amerikanët kanë arritur në Maqedoninë e Veriut, janë po ata që ndëshkimin mund ta shtyejnë deri në futjen në listën e zezë amerikane të personave, pavarësisht detyrës apo funksionit që ushtrojnë!

A mundet që, nga kjo krehje të amnistohet Bashkësia Fetare Islame, në krye të së cilës u instalua politikisht një person i cili është me një të kaluar jo të pastër, ndërkohë që instalimi i tij në krye të BFI-së është edhe më skandaloz se sa personi për të cilin kanë dyshimet e veta se si u përzgjedh për të parin e Prokurorisë së Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, dhe pretendimeve të shumta në opinion për lidhjet e tij me partinë shqiptare që është pjesë e Qeverisë. Akuza të tilla, madje me dëshmi konkrete, pati edhe me rastin e sjelljes së Shaqir Fetait në krye të BFI-së pas një puçi dhe komploti klasik që ky person së bashku me strukturat e larta të kësaj partie ia bënë ish-resul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepi! Efendi Rexhepi, madje publikisht është prononcuar duke e zbrëthyer tërë lojën që është luajtur e në të cilën kanë qenë të përfshirë lloj-lloj strukturash partiake të qeverisë aktuale.

Sipas kësaj, funksionarët aktualë, por edhe ish-funksionarët, që do të hulumtohen nga ekipi amerikan i sanskioneve, duhet që ta hetojnë shtrirjen e tyre oktopodiane deri në Bashkësisë Fetare Islame, që nga instalimi në krye të saj i Shaqir Fetait.

Këto ditë, pas qëndrimit të Shaqir Fetait në Zvicër, me të madhe po flitet madje kjo bisedë është shtrirë edhe në Gjermani se, kur është pyetur nga një imam i këtushëm që vepron në Zvicër, nëse po i kurdisin edhe atij ndonjë komplot, Shaqir Fetai është përgjigjur se nuk ka para në BFI, sepse kjo punë nuk bëhet pa para. Po flitet se Shaqir Fetai ka thënë se ai që duhet të vijë në vend të tij duhet ta dijë se “ky shërbim” kushton 500 mij euro, aq sa ka paguar edhe ky te funksionarë të caktuar të pushtetit! (ose i ka vjedhur vetë dhe tani do t’ia mveshë funksionarëve të Partisë që e kanë sjellë në krye të BFI-së!!!) Në fakt, ka thënë ai, 500 mij euro BFI ka paguar për largimin e Sulejman Rexhepit, ndërsa për emërimin e tij është paguar po aq! Këtu gati ikën të gjitha paratë e siguruara nga bonot me vlerë dhe arsyeja se pse në kohën time u lëshuan në xhirollogarinë e BFI-së, ka thënë Shaqir Fetai, dhe kjo po bisedohet me të madhe në diasporën shqiptare në Zvicër dhe në Gjermani!

Funksionarët partiakë, ata që e sollën në krye të BFI-së Shaqir Fetain, duhet të hetohen edhe për pronën e tyre që e kanë si “dhuratë” nga BFI-ja! Madje, të gjithë ata funksionarë të Shaqir Fetait që kanë pranuar që nga vakëfi i tyre të ndajnë për funksionarët e partisë, edhe vetë janë pajisur

me banesa në pallatet që po ngriten në tokën-vakëf të BFI-së, pasi ta plotësojnë edhe një kusht: të heqin dorë nga ndërtimi i Hotelit gurthemeli i të cilit u hodh qysh më vitin 2018!

Kjo lidhshmëri korruptive e strukturave të BFI-së me strukturat partiake, ka siguruar edhe një heshtje të institucioneve shtetërore rreth shfaqjes së sekteve dhe fraksioneve ideologjiko-fetare të ndryshme që ia kanë dalur që nëpër gjykatat tona të regjistrohen edhe si “bashkësi fetare” edhe pse këtë rreptësisht e ndalon ligji! Natyrisht, mosreagimi i strukturave të BFI-së që janë të thirrur të luftojnë dukuri të tilla, janë shpërblyer me para të majme dhe të dyshimta për prejardhjen e tyre.

Së këndejmi, konsideroj se Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, e kanë tashmë të gatshme dosjen e BFI-së, që flet për krim, korrupsion dhe zhvatje, që nga ardhja e Shaqir Fetait dhe, të njëjtën do t’ia dorëzojnë grupit të ekspertëve amerikanë por dhe tërë korit diplomatik në vend, natyrisht, nëse nuk e kanë bërë deri më sot! Vjedhjet dhe keqpërdorimet e pozitës dhe detyrës zyrtare për ta dëmtuar financiarisht Institucionin si dhe xhepin e qytetarit mysliman, është me ligj i dënueshëm por që, gjyqësori ynë, ndonëse pati iniciativa qytetare, nuk shqyrtoi asnjë proces gjyqësor kundër BFI-së së kapur nga persona të dyshimtë, të rrezikshëm dhe shumë destruktivë për shoqërinë mbarë./1KlikLarg/08.12.2022

## **Hezitim dhe iritim**

**Është i pakuptimtë mosreagimi i Shaqir Fetait me rastin e një “aktiviteti” që ka zhvilluar në këtë fundjavë! Ka pritur një delegacion të Organizatës Humanitare “Merhamet” (e afërt me partinë që ia ka fort ënda të kruhet Shaqir Fetai) ndërsa, nuk është e qartë se si e ka heshtur këtë takim, kur dihet që ka reaguar me postime të “informacioneve” edhe për “aktivtete” të tilla nga më banalet**

## **Nga Faruk Ismaili**

Nga BFI-ja e uzurpuar prej politikave destruktive të cilët në krye të Institucionit e instaluan kryedestruktivin, Shaqir Fetain, na thonë se, nuk është hera e parë kur Shaqir Fetai heziton që të bëjë publike ndonjë “aktivitet” të tij që konsiston në pritje-përcjellje të turlifarë mahlukati! Edhe më herët ka pasur raste që ka takuar persona të ideologjizuar e të sektarizuar por që ka hezitur që ta bëjë publike “lajmin”!

I njëjti burim thotë që, Shaqir Fetai, përveç hezitimit, shpesh di edhe të iritohet prej “ngjarjeve”, sidomos prej atyre ngjarjeve dhe “takimeve” që nuk rezultojnë me ndonjë përfitim personal nga ana e Shaqir Fetait. Takimet e tilla, që nuk prodhojnë përfitime meskine, e iritojnë Shaqir Fetain, ndaj ky, si ai me këmbë në baltë, ngulmon që mos të bëhen publike “aktivitetet e pafrytshme”! Një prej “aktiviteteve” është edhe ai i fundit: Shaqir Fetai u vizitua prej një delegacioni të organizatës humanitare “Merhamet”, por që, me gjasë, nuk i ka bërë kurrfarë përshtypje, ndaj dhe i ka injoruar tërësisht! Por, kjo organizatë nuk e ka injoruar aktivitetin e vet: në FB-un e kësaj organizate ekziston lajmi mbi këtë vizitë!

Shaqir Fetai nuk dëshiron të hapë temë “humanitare”, sepse, sakaq do të vërshohet nga kritikant për moshumanitet të plotë!

Shaqir Fetai mendon se aktivitetet humanitare duhet të ndërmerren një herë në vit, gjatë Muajit të Ramazanit, edhe atë, kryekëput të jetë në rolin e distributorit të ndihmave që vijnë nga jashtë,

sepse, vetë, as që e ka haberin se si bëhet humaniteti, sepse vetëm nga jashtë nuk ia njohin shpirtin antihuman, kurse të jashtëm i besojnë Institucionit shekullor! Pranon delegacion nga një shoqatë humanitare, e cila, ndonëse relativisht e re, ka kryer “shekuj më shumë” humanitet se bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai mendon se myslimanët e vendit, një herë në vit duhet të hanë mish! Ndonëse mishi i kurbanëve dhurohet në shumicë për të varfërit e vendit, ndonëse Shaqir Fetai është lavdëruar se është dhuruar shumë mish kurhani, aq shumë sa nuk është adekuat me sasinë të cilën “e dhuroi” për të varfërit anekënd vendit, por e magazinoi për dita kur atij i duhet të paraqesë “shpirtin human” të tij, dhe krejt kjo flet se humanitetin ai e ka më tepër “politik” se sa shpirtëror!

Shaqir Fetai i frikësohet aksioneve të grumbullimit të ndihmave humanitare për të varfërit e vendit, sidomos në këto kohëra krizash. Shaqir Fetai “bën humanitet” vetëm nëse dikush ia falë të pakëtuat ndihmat humanitare. Vetë, e ka bezdi që t’i futet aksioneve dhe të ftoj për ndihmë, sepse, paraprakisht e ka të qartë se do të dështojë, sepse, këtij farë grykësi as që i donon dikush ndihma, sese, të gjithë e dinë se çka u ka bërë ndihmave humanitare më herët! I shpërndante 100 pako me nga 7-8 kg, ndërsa i raportonte 8-9-10 ton ndihma!

Natyrisht, “Merhametit” i intereson rrjeti distributiv i BFI-së (organet, institucionet, xhamitë) si dhe distribuimi përmes tyre i ndihmave që mund t’i sigurojë, meqë besueshmërinë e ka shumëfish më të fuqishëm se sa bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait.

Shaqir Fetait i intereson që të vihet si distribues në shërbim të organizatave humanitare, “aktivitet human” ky i cili do t’ia “zbardhte” fytyrën. Nuk i intereson për të ditur për “politikën humanitare” që i zhvillojnë organizatat e ndryshme, nuk i intereson as fakti se çfarë fshihet pas këtyre “ndihmave”! Për Shaqir Fetain me rëndësi është që të flitet se “ja, ja, Shaqir Fetai po shpërndanë pako humanitare”!

Askush asgjë nuk ofron për kot nëse nuk e ka interesin e vet! /**TetovaSot/10.12.2022**

**Cili është sinqeriteti i udbashëve**

**Udbashët, sidomos ata që katapultohen në pozita të lakmueshme, të ndihmuar edhe nga oficerët e shërbimeve sekrete që kanë qenë në bashkëpunim me ish-UDB-në, gjithmonë gojën e kanë përplo me “fe e vatan”! Krejt kjo për të shkaktuar eufori me qëllim që të kenë materiale për të raportuar nëpër shërbimet e ngjashme si dikur UDB-ja**

***Nga Fejzi Salihu***

A ka kuptim që në mesin e Ulemasë, në mesin e hoxhallarëve të kërkohen personalitete patriotike. Ka, gjithësesi, sepse të gjithë hoxhallarët nuk mund të futen në një thes! Po ama, a ka kuptim që në mesin e hoxhallarëve të mos luftohen “hoxhallarët” që kanë shërbyer apo që vazhdojnë t’i shërbejnë UDB-së dhe ideologjive të ndryshme antishqiptare! Natyrisht, do të dalë ndonjë si puna e Shaqir Fetait, të cilin institucionet e shërbimeve telegjente e katapultojnë në krye të institucionit fetar ndërsa ky pastaj, me mish e me shpirt, do të përpiket që të flasë për kontributin e ulemasë si dhe për angazhimet e “hoxhallarëve” që po flijohen për “vatan dhe iman”! Me këtë përpjekje, lloji i Shaqir Fetait, do të angazhohet që të gjithë t’i fusë në një thes, se të gjithë “hoxhallarët” janë për “iman e vatan”, madje edhe ai vetë! Sic!

Çka i thuhet atij hoxhe që i shërben hajnisë nëse jo hajn? Po çka i thuhet atij hoxhe që i shërben krimin nëse jo bashkëfajtor në krim? Po çka i thuhet atij hoxhe që përpiket ta mbulojë rrenën nëse jo rrencak! Po ai hoxhë që i shërben udbashit, çka i thuhet nëse jo alet i udbashit, kolaboracionist apo “bilbil” që këndon në veshë të UDB-së!

Vërtet, si do të quhen një ditë të gjithë ata që i shërbejnë Shaqir Fetait nëse jo informatorë të Shaqir Fetait, alias, “ORAO”-s, spiunit të oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit dhe Temelko Boshkovskit, satrapit të shqiptarëve të pollogut!

Sot, të gjithë janë nevojtarë të një rroge, sepse secili ka familje dhe duhet të jetojë. Por ama, të sigurojnë rrogë doke i shërbyer Shaqir Fetait, kjo është rrogë e mëkatshme dhe nuk i bën për nga shëndeti mirë as fëmijës, as familjes!

Të gjithë e dinë se si erdhi Shaqir Fetai, zgjedhje e cilave shërbime ishte instalimi i tij në krye të BFI-së, si e tradhëtoi shokun më të ngushtë apo “babain shirtëror” të tij dhe si e eliminoi “plakun” duke mos iu dridhur qerpiku! Tipike kjo sjellje e një udbashi!

Po pse e instaluan pikërisht Shaqir Fetain? Natyrisht, sepse sistemi i bodimit e kishte favorizuar Shaqir Fetain, UDB-a mjaftueshëm kishte hyrë në kredi tek i njëjti dhe, kështu shpërblehet shërbimi!

Tani, të gjithë hoxhallarët e vendit, a do të kenë shans të mburren ndonjëherë se, ja, i kanë shërbyer Shaqir Fetait! T’i shërbeshë këtij mahluku do të thotë se i ke shërbyer tërthorazi UDB-së. Dhe, kontribut patriotik i ulemasë do të llogaritet vetëm ai angazhim për ta spostuar aty ku e ka vendin Shaqir Fetai. Vetëm ky angazhim do të llogaritet “për iman dhe vatan”, gjithçka tjetër që shkon në të mirën meskine të Shaqir Fetait do të llogaritet kontribut për udbashin dhe shërbimin e tij ruso-sllav!

Kjo periudhë do të ngelë jashtëzakonisht e varfër me teologë nacionalstë e patriotë, me teologë të devotshëm që i kanë shërbyer të mirës! Sepse, “të gjithë” (me shumë përjashtime, ndonëse të heshtur!) po i binden Shaqir Fetait, gjegjësisht, strukturave të ish-UDB-së! Prandaj, sa herë që Shaqir Fetai manipulon me “ka dhënë kontribut për iman e vatan” në fakt e ka fjalën për manipulim, sepse, thellësisht ai e di që nuk është as për “vatan e as për iman” por për UDB, sepse i ka ngelur shprehi që nga vitet studentore (ai e di se cilët patriotë i ka marrur më qafë!) Nuk ka hoxhallarë të gjallë e të sinqertë i cili do të pajtohej se shërbimet që i ofrohen udbashit janë shërbime për “fe e atdhe”! Ato shërbime shkojnë drejtë kanalizimeve të UDB-së, prandaj,

duhet të kihet shumë kujdes kur të kërkohen patriotët në mesin e Ulemasë. Nuk ka patriotë aty ku nuk luftohen kolboracionistët dhe tradhëtarët!/**Kombetare/15.12.2022**

**Gënjeshtër si mjet për viktimizim**

**Kur një karakter ndërtohet mbi gënjeshtër e hipokrizi, kur një karrierë ndërtohet mbi gënjeshtër ndërsa “të vërtetën” e ka përdorur vetëm përgjatë dhënies së informacioneve në UDB, kur një gjysëm familje i përket llozhës së UDB-së, patjetër që do të lindin pasardhës gjenetikisht rrencakë, gjenetikisht udbashë, gjenetikisht të prishur**

*Nga Halid Sadiku*

I prishuri gënjeshtër nuk e përdor për së mbari, për t’i shpëtuar të keqes! Ai gënjeshtër e përdor për ta përçarur mesazhin deri te personat, deri te institucionet shtetërore, deri te funksionarët se, vetëm UDB-a, vetëm udbashi nuk duhet gënjer kurse institucionet dhe pozitat shtetërore, po!

Kështu njeriu i prishur i futet për ta gënjer edhe gjyqin, edhe gjykatësin, me shpresë se gënjeshtër e tij do ta superojë institucionin e shtetit dhe kështu, i prishuri, do të ngadhënjë edhe duke gënjer edhe duke e marrur më qafe të pafajshmin!

Po çka ndodhë nëse e humb gjyqin, nëse nuk ia del ta joshë gjyqtarin me rrena! Natyrisht që do të vulolet institucionalisht si rrencak ndonëse do të mundohet të dalë si viktimë e faktit që është recidiv i udbashëve dhe si të tillë e diskriminon gjyqësori. Për t’i bërë eventualisht të vërteta gënjeshtërat ai, si puna e Shaqir Fetait, është në gjendje të paguaj shpenzime gjyqi, nga fitri e zeqati, është në gjendje të paguaj avokatë jomyslimanë vetëm e vetëm që “armiku” të ndëshkohet, sepse, armiku i shtetit meriton ndëshkime edhe mbi baza të akuzave të sajua, “recetë” kjo tipike komuniste. Po çka ndodhë kur gënjeshtër e të prishurit nuk shitet; kur gjyqësori e nxjerr si rrenc, si shpifës, si matrapaz! Natyrisht, do të nisin metodat e UDB-së për hakmarrje kundër “armikut” të udbashit.

Ky rrencaku, tipi i Shaqir Fetait, instalacionit të gërditshëm të shërbimeve antiislame që e sollën në krye të BFI-së, i duhen njerëz përreth edhe më të prishur se ai. Sepse, të gjithë i paraqet si vegla të cilët ia ka imponuar UDB-a. Dmth “i miri”, Shaqir Fetai, të cilit këmbët po ia ngatërron UDB-a. Përreth tij vegjetojnë, kriminelë, hajna, vjedhës të haxhit në xhepat e të cilit hyjnë më shumë para se sa në arkën e BFI-së. Ai i përdor këta xhokerë edhe për t’i tallur organet jokomuniste sot si dhe për t’i nënvlerësuar organet dhe institucionet ndërkombëtare, për ta nënçmuar botën turko-arabe, sepse ky është stili i UDB-së.

Pra, gënjeshtër, financimi i institucioneve shtetërore me shpresë se do t’ia bëjnë të ligjshëm rrenën, përçmimi i themeleve të së vërtetës dhe demokracisë, nënvlerësimi i porosive kuranore – këto janë karakteristikat e sojit të Shaqir Fetait i cili tashmë është bërë i lexueshem si letëra lakmushi! /1KlikLarg/19.12.2022

**Plasje për pak autoritet**



**Kodoshin të gjithë e “respektojnë” nga frika se është në mundësinë e tij për të marrur dikë më qafë! Sapo të përfundojë karriera e tij prej spiuni, të gjithë fillojnë e tallen me të! Kështu ishte edhe në kohën e komunizmit**

***Nga Sabit Vejseli***

Në kohën e komunizmit spiunët ishin “më të serpektuarit” dhe vendin e kishin në oxhak! Nuk kishte oda ku mungonte spiuni! Të gjithë e dinin statusin e tij e megjithatë e “nderonin”! Spiuni e dinte se mikëpritja ndaj tij ishte tejet fallce, në çdo të dytën fjalë e merrte porosinë: ç’do këtu, nuk e ke vendin këtu, nuk po të do asnjëri”, por, ja që kishte nga ata që pranonin ta hanë edhe m... vetem ta kryenin me nder detyrën ndaj kryeudbashëve!

Kodoshët shkrimtarë dërgoheshin nëpër evente kulturore në diasporë. Të gjithë e dinin se kush është ky spiun-shkrimtar por, ja që nuk guxonte askush që ta dëbojë apo t’ia fusë noj flakaresh, sepse ai duhej të vinte ndonjëherë në vendlindje, te familja!

Pra, prezenca e spiunëve nëpër evente gjithnjë ka qenë e keqja e domosdoshme. Nga ana tjetër, derisa ka qenë prezent spiuni në ndonjë aheng familjar apo në ndonjë event, të gjithë janë ruajtur, nuk ka plasur festa, gjithcka ka shkuar formalisht, kurse, me ikjen e spiunit, ka shpërthyer dëfrimi. Por a ka guxuar të futet spiuni në mesin e burrave të kombit?! Kurrë, jo! Sepse ia kanë qëndisur gjoksin sakaq.

Vetëm Shaqir Fetai, spiuni i studentëve të 1982-83-84, shkon dhe si për gjynah zë një copë vend në vatrën e arsimit të lartë që u ngrit mbi gjakun e derdhur të studentëve të spiunuar prej sojtit të Shaqir Fetait.

Shkon manjaku dhe merr pjesë në përvjetorin e Universitetit të Tetovës me të vetmin qëllim që ta njojosë pak me prezencën e spiunit. Një njeri normal për më të madhin kjamet nuk do të pranonte që të futet në mesin e intelektualëve të kombit ndërkohë që e di fare mirë se të gjithë e dinë se ka qenë, është dhe se do te vdesë spiun. I shkreti mendon se prezenca e tij i ka mahnitur, i ka mrekulluar dhe i ka kënaqur të gjithë profesorët. As që ia kanë mrrrotë avdallit.

I njëjti manjak, ka kërkuar që në këtë vazhdë t’i organizohet një ligjeratë në mesin e studentëve të Fakultetit të Shkencave Islame në Kondovë! Shaqir Fetai dhe ligjerata?! A e di Shaqir Fetai se sot, edhe studenti më i dobët është akademik për Shaqir avdallin! Po ku ia llogarisin në rabush ligjëratën Shaqir Fetait që para studentëve del të jetë bilmezi unikat në botë! Bota e revolucionit, bota e ndryshimeve dhe e reformave vjen pikërisht nga studentët, sepse ata janë të dijshtëm, të kthjellët, të urtë dhe, kur të detyrohen që të dëgjojnë kopalla prej tipit të Shaqir Fetait, sakaq do të dalë ndonjë Norë e Kelmendit që do t’ia plasë në sy: kush je ti, kush të solli, si erdhe, siç ia kumlluan Shaqir Fetait në fund të ligjeratës së shpifur!

Ishte edhe me rastin e doktorimit të një magjistri, i cili, e bindi që t’i prezantonte si publik, sapo i tha se në fund do të shtrohet edhe një drekë. Po ku e refuzon qilipuri Shaqir Fetain. Dhe, paramendoni se ç’doktora po na dalin! Edhe doktor edhe në tryezë me spiunin me tapi! Prandaj nuk po u ecë atyre që fërkohen me Shaqir Fetain, sepse sakaq djallëzohen. Të djallëzuarit i ndjek mallkimi, u shterret hajri që në momentin kur këmbejnë “selame” me Shaqir Fetain e ngratë./1KlikLarg/20.12.2022

**Sorra hu më hu ngulet diku**

**Islami na qenka realitet sot? Islami, si fenomen në zhvillim, realitet ka qene 1400 vjet para “epokës” së Shaqir Fetait. Sot për islamin mund të flitet si për vetë egzistencën. Islami është jetë, nuk është fenomen me trend në rritje që të pranohet realitet. Islami, mbi të gjitha, është besimi në Allahun Fuqiplotë**

***Nga Besnik Imami***

Shaqir Fetai, në momentin kur e ka ndjerë veten të përjashtuar nga fokusi i interesit të opinionit, menjëherë ka kërkuar t’ia organizojnë një “ligjeratë” për studentët e FSHI-së. Studentëve ua paska nënvizuar faktin që BFI-ja si organizatë e vetmja kompetente në organizimin e jetës fetare islame në vend! Kë e gënjen Shaqir rrenci? Studentët, ë? Pse a nuk e dinë studentët që Shaqir Fetai ua shiti frakcioneve primatin e të qenurit i vetmi institucion i organizimit të jetës fetare në vend? Të gjithë e dinë që Shaqir matrapazi i legjitimoi disa “bashkësi fetare”, disa frakcione e sekte të cilët, në mënyrën e tyre dhe sipas sistemeve që në asnjë pikë nuk përputhen me ate të BFI-së, organizojnë jetë paralele “islame”! Shaqir Fetai është fillimi i dezorganizimit të xhematit tonë dhe përcarësi më i madh i tij. Shaqir Fetai është devaluuesi absolut i BFI-së si dhe rrënuesi me i madh i interesave të saj.

Mbanë pseudo-ligjeratën dhe, në profilin e vet, në vend se të flasë për vete, në veten e parë, ai flet për “reisul ulemanë” i cili, pa kurrfarë hezitimi paska pranuar ftesën e studentëve. Heeejz turulum! Shaqir Fetai ua fëlliqë intelegjencien studentëve të FSHI-së kur thotë se e pranoi ftesën e tyre për ligjërim! Studentët kurrë nuk do ta ftonin nxënësin e eprorit të UDB-së, Sanko Dragoviq, që t’iu ligjërojë! A mos po përpiqet Shaqir Fetai të përçojë mesazh se studentët vdesin për udbashin “Orao” të Stanko Dragoviqit!

“Ishte një panel shkencor me një pritje të nivelit të lartë”, thotë avdalli! A ka logjikë kjo fjali! Nuk thotë ishte një pritje e këndshme studentore por, duke e llogaritur veten “druzhe Tito” paka përjetuar “pritje të nivelit të lartë”. I kompleksuar deri në veshë, i mohuari mezi pret pak “dashuri” dhe, edhe nëse nuk ia ofron askush, ai e shpikë edhe subjektin edhe dashurinë. Sepse e ka të vështirë pozitën e të mohuarit dhe të atij që urrehet vazhdimisht, por që i druhen pak për shkak të fuqisë prej udbashi që e ka! Kështu mendojnë ndërsa, në realitet e ka fuqinë me t’u kap për aleti e me u çjerrë si Tarzani “a-aaaa-aa”!

Pastaj, thotë: “Me të drejt themi se studentët tanë janë të vetëdëshëm për detyrat dhe rolin e tyre”! Për cilat detyra dhe cilin rol, o Shaqir Fetai! A mos po i llogaritë Shaqir Fetai si informatorë të tij? Kur Shaqir Fetai i llogarit se janë të vetëdëshëm: atëherë kur ia organizojnë “një pritje të nivelit të lartë” apo kur e mbërthyen për murë me pyetjet: “kush të sollti ty këtu, si u bëre, kush të bëri reis”!

Sërish një titull lajmi, si të një pseudo-gazetari të dështuar: ” REISUL ULEMA MORRI PJESË NË MBROJTJE TË DIPLOMËS NË FSHI”! Morri apo mori, o plesht i qenit të zgjebosur?! Zonjën (zonj) J... e paraqet si zotëri (z.) J... Tallet injoranti! Tallet me një grua shumë të nderuar duke dëftuar avdalli se i duket si z. (zotëri)! “Ishte një mbrojtje e shkëlqyer e kandidatës në një procedurë e nivelit të lartë e Komisionit të FSHI.” A ka ndonjë njeri në fytyrë të tokës për të kuptuar se çfarë ka dashur të thotë Shaqir Fetai me këtë fjali prej injoranti!

Pas një duzinë frazash idiotike, Shaqir Fetai e përmbyllë me një “perle” që mund te dalë vetëm nga goja e një shpirtziu! Postimin e vet idiotik Shaqir Fetai e përmbyllë: “Edhe kësaj radhe u dëshmuua puna shkencore e FSHI në Shkup”! Nuk flitet për punën e palodhshme dhe madhështore që ka kryer doktoresha në realizim të temës së disertacionit, por flitet për njëfarë

pune shkencore që në këte rast paska bërë FSHI! Pse Shaqir Fetai, ky publik i rëndomtë i disertacioneve nuk po tregon se ia ka ënda të prezantojë në evente të tilla sepse, në fund, gjithmonë shtrohen dreka e darka që ai vdes për to, sepse për Shaqir Fetain drekat dhe darkat janë momente ku ai lirisht mund të shesë kopalla pa hetuar se sa herë që rrapllon gjithnjë shkakton të qeshura, tamam si palaço! Ta kishte publikuar të paktën një foto nga dreka e të sapodoktoruarës! Apo e di se është një lloj mëkati dhe nuk e publikon këtë informacion. E ç'mëkat ka ngelur pa bërë Shaqir Fetai, ky farë rrencaku lehtësisht i verifikueshëm!/**1KlikLarg/22.12.2022**

**Biblioteka “Isa Beu”, në kohën e vet, startoi dhe ishte Biblioteka më e madhe në Ballkan! Sot është Institucion që reflekton injorancën, institucionin e mospërfilljes së librit, institucionin e turpfit, të krimit ndaj fjalës së shkruar! Në kohën e Shaqir Fetait ka marrur edhe epitetin e “entit ndëshkimor”**

***Nga Ilir Topi***

Njëri nga shkrimtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, hispanoamerikani Jorge Luis Borges, një çerek jete kaluar tërësisht i verbër, thoshte: “Unë gjithmonë kam imagjinuar që parajsa është një lloj biblioteke”! Ndërsa Marie de Sevigne thoshte: “Kur hy në bibliotekë, nuk mund të kuptojë se përse dal nga aty”!

Bibliotekat dhe fondi i librit flet për një civilizim, flet për një kulturë, flet për identitetin kulturor që e ka populli me biblioteka grandioze! Jo rastësisht Gazi Isa Beu e themeloi Bibliotekën, për të dëshmuar për një shoqëri dhe sistem inteligjent, për një popullatë që tashmë e ka të rrënjësuar bindjen se vetëm përmes librit çelen portat e perspektivës.

Ku është sot Biblioteka “Isa Beu”, në ç’pozitë gjendet! Askush nuk e di ku është, ndërsa është në pozita edhe më të rënda se sa në kohën e Pikolominit kur u dogj tërë Shkupi! Sot, këtë Bibliotekë, Shaqir Fetai e ka shndërruar në një “ent ndëshkimor”! Të gjithë ata që nuk pajtohen me politikën e budallakavta të Shaqir Fetait, të gjithë ata që e dinë fare mirë se si atë në krye të BFI-së e instauan do shërbime të dyshimta antiislame, ky i ndëshkon duke i futur në këtë “ent ndëshkimor”! Aty nuk punon asnjë bibliotekar profesionist, aty, të “ndëshkuarit” nuk kanë të kryer kurrfarë kursi biblioteke. Aty ka njerëz që kurrë në jetë nuk kanë lexuar ndonjë libër, si puna e Ismet Bitiçit! Aty, së fundmi është “punësuar” edhe Avni Halimi, pa asnjë sekond punë të kryer nëpër biblioteka. Aty punon dhe ish-shëf i kabinetit të H. Sulejman ef. Rexhepit, i cili, në mungesë të përgatitjes profesionale prej bibliotekisti ka pranuar qorrazi që të drejtojë një “institucion” nën kushte mizerable!

Shaqir Fetai, injoranti më i njohur në hapësirën tonë si dhe personi që në mënyrë katastrofale mundohet të themelojë “institute”, në fakt, “Bibliotekën Isa Beu” e ka futë dhe akoma e mbanë në një biruc të padenjë për t’i mbajtur edhe minjtë eksperimentalë. Ajo vetëm bibliotekë që nuk është! Thjesht, është një magazetë librash ku nga lagështia mund të brehet druri e hekuri e lëre më libri! A nuk është ky një krim ndaj librit! A nuk është kriminalitet, injorim dhe shkatërrim i qëllimshëm i qindra librave të vjetër nga 300-400 vjet, me alfabet arabo-osman! Libra të pastudiuar, libra të ekspozuar lagështisë, temperaturave ekstreme të dimrit dhe verës, dritës jo të mjaftueshme! Thjesht, Shaqir Fetait nuk i intereson libri, aq më pak libri që fikon dhe dëshmon lashtësinë, autoktoninë tonë si dhe nivelin intelektual të dikurshëm të myslimanëve të kësaj ane! Biblioteka më e vjetër në Ballkan, me një fond prej rreth 5000 libra dhe e degdisur në një birucë që nuk mund të gjendet asnjëherë!

Çka mund të thuhet për Shaqir Fetain dhe “Llopovat e Bagdadit”, për çfarë “civilizimi” e inteligjence të tyre mund të flitet ndërkohë që njëmijë herë më shumë harxhojnë për çaj e për kafe se sa për librin! A ka në buxhetin e BFI-së zë ku parashihet blerja e librave dhe pasurimi i fondit të bibliotekës?! Për avdallin librat kanë vlerë aq sa ka vlerë pasqyra për të verbërin! Pra, shndërrimi i Bibliotekës në birucë ndëshkimi, me kushte ku degradohet dhe degjenerohet libri, me të punësuar krejtësisht të paafët për punën e bibliotekistit (gjë që dëshmon për injorimin që ia bëjnë Bibliotekës) dhe me fond qesharak njëmijë herë më të vogël se biblioteka personale e

Shaban Rahmanit të Shaqir Fetait, flet se ky, si çdo herë, është truri i fëlliqtë i BFI-së! Dhe, pa dyshim, rreth fëlliqësirës nuk rrinë bletët por mizat e m...

Profesorët, studentët, intelektualët, myslimanët e vendit, sa më parë duhet të ngrisin zërin kundër këtij qëndrimi dhe qëllimi të Shaqir Fetait dhe turlifarë sallatave të tij për ta degjeneruar librin, sidomos librat e lashtë që janë kapital i paçmueshëm i Bibliotekës "Isa Beu"!

Vetëm një inspektim shkarazi, vetëm, një hedhje e njërit sy mbi këtë "bibliotekë" aktuale, do të mjaftonte që mbi Shaqir Fetain dhe sallatoret e tij të kryhej një "rexhëm" me kiloton patatesh të kalbur! Armiqtë e BIBLIOTEKËS, injoruesit e LIBRIT nuk meritojnë asgjë tjetër përveçse të ngodhin në duhmin e patateve të kalbur!/**BotaSot/24.12.2022**

**Kur mediokri "Shaqir Fetahi" flet për intelektualizëm**

**Brenda një fraze prej tri-katër rreshta “intelektuale” të shprehura nga një mediokër, konkretisht nga i instaluari prej shërbimeve të huaja në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, lexuesi që ka njohuri sipërfaqësore gjuhësore, do t’i dedektojë tetë gabime gramatikore dhe gjashtë gabime sintaksore**

***Nga Mr. Abaz Islami***

Nga sharllatani i komunitetit pseudo-intelektual ku bë pjesë edhe Shaqir Fetai, na del një definicion mbi intelektualitetin, provë kjo që, në kushtet e dominimit të ligjit gjuhësor, do të mjaftonte për ta futur në birusë për ta vuajtur dënimin burg të përjetshëm. Të të flasë Shaqir Fetai për intelektualitet e intelektualizëm është e njëjtë sikur gomarin ta veshësh me rrobe dirigjenti e ta vëshë për dirigjim para qindra instrumentistëve të filharmonisë.

Sipas Shaqir Fetait “Intelektuali duhet të reflektoi urtësi dhe maturi, sepse kjo është rruga e vetme drejt shpirtit dhe zemrës, vetëdijes, bindjes së njerëzve”! Ky qenka misioni i intelektualit: të shtrojë një rrugë e cila do ta mundësojë depërtimin në shpirt dhe zemër të njeriut! Por, ja që, sipas Shaqir Fetait, zemra na qenka e ngurtë “dhe e mbyllur ndaj agresives, ndaj averzionit, ndaj alogjikes”!!!

Intelektuali është personi që mijëra herë e zbardhë natën mbi libra e duke lexuar, personi që ka njohuri të ndryshme mbi shumë fusha, që ka dhe ofron zgjidhje për probleme të ndryshme, që është i rrjedhshëm, i qartë dhe logjik si dhe që është i gatshëm të kontribuojë sukseshëm mbi çdo problem, të lëshojë rrugë e të sakrifikohet për një të mirë të përgjithshme; intelektualizëm është vetëflijimi për të mirën e çështjeve kombëtare, madje edhe altruizmin e vet e vë në dobi të çështjeve kombëtare!

Këto ditë Rijaseti i Bosnjë-Hercegovinës paska mbajtur një konferencë në Shkup për zbardhjen e figurave boshnjake kudo ku kanë jetuar dhe vepruar në rajon. Për kontributin dhe mikëpritjen është lavdëruar dhe falënderuar Shaqir Fetai! I thuhet këtij “intelektual” që e mohon të veten dhe e lartëson të huajën kur nuk është nevoja!

Po kështu, disa ditë më herët, ishin festat shqiptare të Nëntorit! E çka bëri “intelektuali” Shaqir Fetai dhe rijaseti i tij për 14-22 Nëntorin, çka bëri për 28 Nëntorin përveç që e refuzoi mbajtjen e një premtimi të dhënë dhjetë vite më parë në emër të BFI-së nga Afrim Tahiri, sekretari historik i BFI-së që, në vigjile të këtij 28 Nëntori, të mbahej një konferencë gjithëkombëtare me qëllim të ndriçimit të angazhimit dhe kontributeve patriotike të personaliteteve nga radha e ulemasë shqiptare nëpër kohëra e periudha të ndryshme.

Për Shaqir Fetain më e rëndësishme dhe më e nevojshme është që t’i ndihmohet Rijasetit të Bosnjës që të ndriçohen figurat nacionale boshnjake se sa të dalë një figurë e re teologjike që i ka shërbyer kauzës kombëtare shqiptare!

Ky është kuazi-intelektuali Shaqir Fetai, i cili, me “altruizmin” dhe me “intelektualitetin” e vet më me qejf i shërben të huajit se sa të vetit! Punë mediokri!/**TetovaSot/29.12.2022**

**Po flitet**

**Sa herë që ka ndodhur një gjë e bukur, gjithmonë është folur, sa herë që ka ndodhur ndonjë tradhëti me përmasa epike, gjithmonë është folur dhe do të flitet deri në amshim, sa herë që do të ndodhë ndonjë fëlliqësirë, do të flitet, sepse, në natyrën e njeriut është që mos ta hesht veprën e mirë, por as të shëmtuarën, të keqen, tradhëtinë...**

### ***Nga Blerim Hoxha***

Po flitet se akoma, tek-tuk, paska prej atyreve që nuk hamenden nëse duhet ta pranojnë apo ta mohojnë Shaqir Fetain si “reis”!

Po flitet se, brenda BFI-së paska plotë të penduar për gjestin që kanë bërë që nga momenti kur i janë nënshtruar “urdhërave misterioze” e deri në momentin kur kanë ngritur gishta në favor të Shaqir Fetait.

Po flitet se këta që kanë pranuar “urdhëra misteriozë” për ta votuar Shaqir Fetain, nuk po mundën që të shfaqësohen se janë nën presionin e fuqishëm të shantazheve nga ata që i detyruan të votojnë (që të gjithë jomyslimanë, sepse vetëm ata nuk e duan unitetin dhe fuqinë e BFI-së, si Institucion!

Po flitet se një duzinë nëpunësish, intelektualësh, profesorë janë të pajtimit që të mbledhin forcë dhe publikisht të tregojnë se kanë qenë të manipuluar, se kanë qenë të detyruar, se kanë qenë të shtrënguar që ta pranojnë Shaqir Fetain për “reis”, ndërsa ka ardhur koha që ta tregojnë të vërtetën se si iu imponua Shaqir Fetai!

Po flitet që ardhja e Shaqir Fetait paska qenë kompromis i një lideri politik maqedonas me një lider politik shqiptar, i cili, me këmbëngulje paska kërkuar që sa më parë të largohet ish-sekretari i qeverisë, Muhamet Zeqiri, ndërsa lideri politik maqedonas paskësh kërkuar si kompensim largimin e “armikut shekullor” të Zeqirit, ish-reisul ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepin!

Po flitet se lideri politik shqiptar qenka pajtuar me këtë zgjedhje, madje edhe duke ia zbrëthyer skenarin lehtësisht të realizueshëm.

Po flitet se lideri politik maqedonas paskësh pasur edhe propozimin konkret për liderin fetar islam në RMV! Ai në tavolinë e paskësh nxjerre kandidatin fort të dashur të Oliver Spasovskit, Ministrin të Punëve të Brendshme! Këtë ofertë, lideri politik shqiptar paska kërkuar që ta diskutojë me kryesinë e partisë dhe, pas tre ditëve, meqë janë frikësuar se kandidati i Oliverit po na bëhet lider fetar, atëherë, spontanisht paska dalur propozimi për Shaqir Fetain.

Sipas kësaj që po flitet del se, Shaqir Fetai nuk ka qenë i propozuar si vlerë, por, si opion për ta shpëtuar BFI-në që mos të bie tërësisht në duart e palës maqedonase!

Sipas kësaj që po flitet me të madhe, largimi i Sulejman Rexhepit paska ndodhur me qëllim që, pastaj, kush sa të mundet t’i fusë duart në BFI dhe ta coptojnë aq sa kanë mundësi. Mundësia natyrisht që ishte më e madhe e palës shqiptare por, ja që me këtë vërtetohet se, edhe pala maqedonase paska një copër bukur të konsiderueshme të BFI-së! Pra, Shaqir Fetai paska qenë “zgjidhje” politike! Dhe, as njëri krah e as krahu tjetër nuk bëhen burra e të shpjegojnë qartë se, me këtë ndarje të “hiseve”, BFI-ja ngadalë por sigurt po merr fund! Prandaj, nisën regjistrimet e bashkësive “fetare” të tjera, regjistrimi i xhamive private etj.

Sipas kësaj që po flitet, kjo është arsyeja se pse BFI-ja tash e sa kohë duket sikur të jetë “interes” në margjinat e ndërkombëtarëve, të cilët, kanë informacion të mjaftueshëm se kush është Shaqir Fetai që u hodh në zjarr si kundërkandidat i “simpatikut” të Oliver Spasovskit dhe kush është kandidati i Spasovskit, karrierist i ndyrë, i cili, për pushtet desh e shndërroi BFI-në digaster të papërfillshëm për qeverinë maqedonase, ndonëse në kohën e Sulejman Rexhepit ngjante në “shtet në shtet”!

Po flitet gjithnjë e më shumë se kthimi i Afrim Tahirit në BFI do të ndodhë me patjetër dhe se, ky personalitet shikohet si i vetmi opsion i cili do t'ia dalë ta largojë dorën e shtetit nga BFI-ja si dhe këtë institucion fetar islam ta kthejë në peshën dhe rolin e vet që e pati që nga themelimi i saj para më shumë se gjashtë shekujve e deri në instalimin politik të Shaqir Fetait në krye të këtij institucioni.

Po flitet se edhe nëpunsit brenda BFI-së po thonë se në kohën e Afrim Tahirit BFI ka lulëzuar ndërsa korrupsioni dhe vjedhja ishin çrrënjësor tërësisht! Ata po e ndjejnë gjithnjë e më fuqishëm nevojën për kthimin e Afrim Tahirit porse janë paksa “të pezmatuar” nga gënjeshrat e trillimet se sapo të vijë Afrim Tahiri të gjithë do të fluturojnë nga puna! Po pse të fluturojnë? Pse me kaq lehtësi Shaqir Fetai i njollosë dhe i poshtron të gjithë! Çka di ai për këta nëpunës të cilët, sapo të vie Afrim Tahiri të gjithë do të fluturokan jashtë! Afrim Tahiri është shumë i kujdesshëm me ligjet, ai thërret ekskluzivisht të punohet sipas akteve juridike të BFI-së si dhe dispozitave kushtetuese. Ligji për punë i mbronë të gjithë të punësuarit. Nuk mundet me automatizëm të dëbojë dikë Afrim Tahiri, siç e provoi dhe Shaqir Fetai por që gjyqësori ia tharbi hundët: e nxorri si rrenc që me dokumente falco mundohet t'i manipulojë institucionet shtetërore të drejtësisë! Ky fakt tashmë është evidentuar në “ditarin” e praktikave gjyqësore si dhe në të gjitha defteret e organizmave ndërkombtare në vend!

Po flitet se tani më partisë politike shqiptare i janë varur dy hejbe shumë të rënda në qafë: në njërin rusofili Shaqir Fetai, në anën tjetër, budallallëku që ranë në ujdi me liderin politik maqedonas që ta eliminojnë opsionin maqedonas për “reis” dhe ta pranojnë për hisenik të BFI-së.

Ndër partinë politike shqiptare tashmë ashiqare po flitet se Shaqir Fetai paska qenë kurthi i politikës maqedonase: asnjëherë nuk paskan munduar ta bëjnë kandidatin e Oliver Spasovskit “reis”, porse loja paska qenë që ta bëjnë Shaqir Fetain duke e imponuar kandidatin e tyre “imagjinar”! Tani, Shaqir Fetai me lezet ka pranuar që ta vallëzojë “Vallen e Rëndë” të tyre, ndryshe, mund të fluturojnë gjithandej fleta nga një dosje që po ia tundin para hundë!

**/BotaSot/03.01.2023**

## **Vjen edhe “çestitka” skandaloze për Vitin e Ri**

### **Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI**

Janë shumë arsye që e bëjnë skandaloze “urimin” e Shaqir Fetait për Vitin e Ri!

Ndonëse “homologët” e tij kanë hyrë në Vit të Ri pa pompozitet, Shaqir Fetai, i mbërthyer në kryqin e megalomanisë së vet, duke u vetëndjerë si kryeministër i një vendi të ngritur në imagjinatën e tij fëmijërore si dhe duke u vetëllogaritur ekspert i vjedhjes së mundit të huaj por dhe i rrenës, nuk ia përton shpërfaqjes së vet rutinë, si mediokër!

Duke i kopjuar fjalimet e burrshtetasëve, Shaqir Fetai thotë se me sukses ia paskemi dalur ta mundim korona virusin si dhe krizën ekonomike dhe se, tani, në vitin që do vie (cili vit? Ai që do vie, ai që pritët nga sot e tutje, te vie, është 2024-shi!) paskemi me qenë më të sukseshëm në organizimin e jetës fetare! Avdalli, këtë sukses e ndërlidhë me haxhin! Regjistrimin e haxhilerëve Shaqir Fetai e llogarit si sukses të vetin. Thuase ky po ia del financiarisht që t'i çojë në haxh nja 2000 haxhilerë! Është vetëm një e vërtetë për sa i përket organizimit të haxhit: kemi qenë më të shtrenjtë në rajon me qëllim që të krijohen mundesitë për të vjedhur pa hesap!



Shaqir Fetai, vitin që e lamë pas e llogarit si shumë të suksesshëm!!! Po, ka qenë i suksesshëm vetëm në shitjen, në tjetërsimin dhe në vjedhjen e vakëfit! Myslimanët e dinë që para Fakultetit është një rryp toke të cilin pronari e ka ofruar për shitjen e saj për 40 mij euro. Shaqir Fetai i mbledhë myhybtë e vet dhe thotë se toka është në shitje dhe se do ta blejmë për 150 mij euro. Të gjithë e dinë se pronari ka kërkuar 40 mij, ndërsa Shaqir Fetai do ta blejë për 150 mij euro! Diçka ngjashëm siç e fryu çmimin e makinës zyrtare, e cila nga

15 mij euro sa e kishte çmimin e pazarit, u pagua rreth 35 mij euro. Afro 20 mij euro përfunduan në xhepin e të pangopshmit! Dhe, kur i pëshpëriti në vesh njëri prej myhybëve “haxhi rreis, pronari na e jep për 40 mij euro, është dëgjuar Shaqir Fetai tek i thotë: shuj, do ketë edhe për ty”! I suksesshëm ishte Shaqir Fetai në shpenzimin e miliona eurove të vakëfit të denacionalizuar në formë të letrave me vlerë!

“Ky vit do jetë vit i projekteve, dinamizmit, racionalizmit, zhvillimit në sfera të ndryshme, ndërtimit, dhe shumë punë tjera”, thotë Shaqir Fetai! Nëse ky vit paska me qenë i projekteve, të kujt ishin vitet që kaluan? Të hajnisë, të intrigave, të munafikllëqeve? A mund të ketë projekte e dinamizëm pa plan veprimi, pa kuadrin logjik të veprimit sipas projektit, pa preventivën financiare të nevojshme për çdo projekt! Ku mund të ketë dinamikë pa një reformë gjithëpërfshirëse dhe të thellë, duke filluar nga Shaqir Fetai, i cili duhet të mbahet mend si i fundit hajn e matrapaz i BFI-së.

Shaqir Fetai e përfundon “çestitkën” e vet: “Kështu na do i Madhi Zot”! Shpifje në llogari të Zotit! Kur i paska ndashur i Madhi Zot, hajnat, tradhëtarët, spiunët, “oficerët e shejtanit”, rrencakët, snobët, mediokrët, ata që shtiren se janë për gjynah dhe, këtë shtirje e përdorin sepse janë të bindur se mund t’ia hedhin edhe të Madhit Zot, ta mashtrojnë! Një përfundim të tillë mund ta imagjinojë vetëm një i zgjedhur e i emëruar i policisë, si puna e Shaqir Fetait dhe, këtë sukses të aparatit shtetëror dhe aparatçikëve ta “paketojë” si Vullnet i Zotit!

**/1KlikLarg/Kombetare/03.01.2023**

**Malli shaqirian për andalusinë**

**Është shumë i vetëdijshëm Shaqir Fetai se në çfarë derexhe e ka kthyer organizimin e jetës fetare islame, prandaj dhe thotë “Koha kërkon që pjestarët e Islamit të jenë të gatshëm dhe dinjitoz të prezantojnë vlerat e Islamit në kohë dhe vend”, si dikur në Andaluzi! Po “parinë” fetare a e thërret koha dhe vendi? Apo këta janë totalisht të përjashtuar, vetëm sa të vjedhin edhe pak nga vakëfi, meqë nuk i përkasin komunitetit “pjesëtarë të islamit”**

***Nga Vehbi Maliqi***

Nuk ka më cinik se sa Shaqir Fetai, nuk ka më “filozof naiv”, i cili, përmes naivizmave të tij mundohet të na shpërfaqet në “filozof tradicionalist”! Shaqir Fetai e llogaritë veten të reinkarnuar dhe se mund të jetë ndonjë nga pasardhësit e parë të Pejgamberit: ata kanë ndërruar jetë dhe, duke ikur për në botën tjetër, kanë lëshuar shpirtin në bredhje dhe, hajt e hajt, hajt e hajt dhe, hop e ka hyrë në trupin e Shaqir Fetait! Është po ai që e ka kaluar, si shpirt, edhe periudhën e artë të Andalusisë, ndaj dhe fton në shëndritje si në këtë periudhë të flaktë të devotshmërisë! Por, Shaqir Fetai iu drejtohet “pjesëtarëve të islamit”, duke e përjashtuar veten, sepse, e njeh vetëveten, e di se çfarë “ushtari i djallit” është, çfarë antiislamisti dhe çfarë mëkatari që është. Prandaj, me të gjitha këto sifate ai vetëm mund t’i thërrasë të tjerët, duke e përjashtuar vetëveten apriori, sepse, nuk mundet edhe i devotshëm edhe hipokrit, edhe pjesëtar i besimit islam edhe shkatërrues i vakëfit. Ai e ka të qartë se në këtë botë mision ka vjedhjen, hajninë, shantazhin, korrupsionin ndaj dhe, e ka të qartë se nuk mund të jetë “pjesëtarë i islamit”! Cilat vlera të jashtëzakonshme të islamit do të mundte Shaqir Fetai t’ia prezantonte botës, ndërsa në ndërkohë atij shumë më përshtypje i bëjnë veprimet e djallëzuara me të cilat ushqehet natë e ditë! Sidomos abuzuesi me vakëfet siç është Shaqir Fetai, a do të kishte të drejt morale të thirrte në fenë islame.

Shaqir Fetai, qëllimisht i lë të vjedhin myftitë e tij, qëllimisht i lejon që të pasurohen me prona të patundshme, aq shumë pasurohet me vakëfet e vjedhura e të shitura sa, sot i ke ndër personat me mirëqenie sociale që nuk e meritojnë fare, jo vetëm për shantazhë sa edhe për ta mbuluar vetëveten duke thënë të tjerët janë ata që vjedhin ndërsa unë i ha akuzat meqë ua mbuloj turpin!. Nuk ka myftini e organe të Rijasetit që nuk kanë pasuri enorme të pajustificushme, ndërsa me rrogat që i marin nuk mund të blejnë asnjë bicikletë! Vjedhin të gjithë myftinitë, dhe për të gjitha myftinjtë flet se si vjedhin, vetëm për Myftininë e Gostivarit deri më tani nuk ka shkaktuar ndonjë aferë. Të gjithë myftinjtë e Maqedonisë duhet të pendohen, ta vetëkthejnë atë që e kanë vjedhur, kurse vetëm ai i Gostivarit duhet të lavdërohet, sepse po qe se flet ai për vjedhjet e paraardhësit të tij, Shaqir Fetait nuk i ngelë vend ku të futet! Ai mund të flasë edhe për sekretarin e BFI-së, vendasin e vet dhe pastaj të dalë punë se vetëm Gostivari ka vjedhur, ka shitur e ka tëhuajësuar, madje edhe ka dëbuar vakëfe më shumë se të gjitha muftonjtë e tjerë!

Kërkon lokacion për një medrese për femra në Shkup, ndërsa e ka humbur vendit më atraktiv në tërë vendin, shtëpinë ku banoi Hafëz Bedri Hamidi. Ku është kjo pronë, ky vakëf? Shaqir Fetai thotë se nuk i di meqë ai nuk i ka ato dokumente! Hotel Isra, hotel i BFI-së në lokacionin e ish-Komunalecit është dashur të përfundojë kah fundi i vitit 2020, tani janë stopuar të gjitha punët dhe, sipas një informacioni as që do të nisen para vitit 2030! Deri atëherë ky hotel që ka të hedhur vetëm gurin themeltar duhet të presë ndërsa Myftinia e Shkupit vetëm të shkojë në humje! Ku ngeli prona e vakëfit pas hotel Arkës, në Çarshi të Vjetër!

Pse u humb Teqja Arabati! Ku ngelën donacionet e Arabisë Saudite që u dhanë për ndërtimin e Myftinisë së Kumanovës, ndonëse ky objekt u ndërtua tërësisht me donacionet turke! Pse me

këto para nuk u ble ndonjë vakëf i mirë e i madh por, blihet diçka të cilën Shaqir Fetai, si rrencak i pashembullt, thotë se u ble një tokë në qendër të Kumanovës!

Kur jemi te qendra, vërtet pse i dëboi Shaqir Fetai arabët që ishin gati, me dokumente e me gjithëçka për ta ndërtuar një qendër të madhe në mes të Gostivarit, në shumë prej miliona dollarë, i cili do të bëhej një prej vakëfeve më të mëdha në Maqedoni!

Për këto 20 vite organ i BFI-së, në daç si myfti, në daç si “reis”, Shaqir Fetai ka shkaktuar dëme edhe tërthorazi edhe drejtë për drejtë, mbi 30 milion euro vakëf, të cilën ose e ka zhdukur, ose e ka vjedhur, ose e ka shitur. Përderisa gjithnjë thotë se nuk di se çfarë ka ndodhur se, nuk i ka ato dokumente, atëherë i bie të jetë dëmtuesi historikisht më i madhi i vakëfit! Si guxon të thotë se nuk e di as marrëveshjen dhe nuk di asgjë, madje nuk posedon asnjë dokument për pallatet dhe për hotelin e BFI-së në truallin që dikur ishte oborri i ”Komunalecit”, i cili u denacionalizua që më vitin 2013, ndërsa deri më sot nuk ka gjeneruar kurrfarë të ardhure dhe kurrfarë prone për BFI-në! Ka shumë njerëz që e dinë saktësisht se kush sa hyrje pallatesh do të përfitojë, kush do të jetë aksionar në këtë kompleks vetëm e vetëm le ta mbyllë gojn! Për këtë të vërtetë Shaqir Fetai mund ta pyes edhe hajnin e vet me licencë, Mustafa Dautin, ose, pse jo, mundet t’ia marrë tërë dokumentacionin ish-reisit, nëse dyshon se e ka ai! Nëse nuk guxon t’ia marrë, do me thënë nuk dëshiron që të hapen aferat se mund të digjet edhe vetë, siç u dogj edhe me pëpjekjen për ta blerë truallit para FSHI-së të cilin pronari e shet për 40 mij euro e Shaqir Fetai dëshiron ta blejë për 150 mij euro, sepse, kështu blihet, siç e bleu makinën zyrtare kah mesi i vitit që iku – makinën me çmim tregu prej rreth 15 mij euro, e bleu për rreth 35 mij euro!

Ja pse Shaqir Fetai nuk guxon të thërrasë në emër të vetin në organizim të jetës fetare islame si në kohën e Andalusisë. Sepse, ajo kohë ishte kohë e vakëfit, e shkencës, e artit, e kulturës, e kulturës vakufore. Ndërsa koha e Shaqir Fetait është kohë e tatëpjetës së islamit në RMV. Sepse, çka mund të pritet prej një hipokriti dhe mediokri përveçse matrapazllëqe. Edhe matrapaz edhe thirrës në islam? Ai nuk i hy këtij lluksi, sepse, e di shumë mirë se, sapo të hapë gojën prej hajduku e rrenci, të gjithë do të ikin prej islamit. Sepse, të apelojë Shaqir Fetai për jetë organizative islame është ngjashëm si gjarpëri të të kërkojë të ta puthë këmbën me garanca se nuk do të kafshojë! I besohet gjarpërit?!

“Andaj, kjo është domosdoshmëri e kohës dhe hapsirës për të konkuruar me vlera për të notuar në ambijentin bashkëkohorë dhe për t’ia prezentuar skenës së zhvillimeve botërore vlerat madhore, universale dhe humane të Islamit”, thotë Shaqir avdalli! Thërret në një punë që është kryer tash e 14 shekuj më parë! I paska ngelur Shaqir Fetait që botës t’i prezantojë vlera islame. Dhe kush ate – Shaqir Fetai, njeriu më antivlerë ne mesin e umetit mysliman!

**/BotaSot/09.01.2023**

**Adabra-kadabrat e një kuazi-hoxhe**

**E keni parë një set fotografishë të Shaqir Fetait! Na fton që përmes fotografive të njohtohemi me renovimin e selisë së BFI-së. Përmes një “iluzioni optik”, përmes një rrene prej injoranti dhe hipokriti, na ofron disa fasada sa për ta bindur opinionin se ai po punon diçka. Të gjithë nëpunësit e BFI janë shokuar kur i kanë parë fotot përmes të cilave Shaqir Fetai motivohet për një rrenë të re sa për t’u tallur me opinionin**

***Nga Munir Rexhepi***

Nga demokratizimi i vendit e deri më sot, disa herë janë bërë “renovime” të Institucionit fetar islam: renovimi i kabinetit jo me mobilje, jo me tavan të lëshuar, ndërrimi i tapetit, ndërrimi i dritareve, i dyerve, intervenime në tualet etj. por që asnjëherë nuk është dalur në opinion për ta quajtur këtë freskim të interierit “renovim”. Këtë e bën vetëm Shaqir Fetia i ngratë i cili, natë e ditë, opinionit ia shetë mizën për buall!

Para nëpunësve lavdërohet se kjo nuk është asgjë, sepse shumë shpejtë do të nisë ta ndërtojë selinë e BFI-së në Kalanë e Shkupit!

Çka po dëshiron të bëjë në të vërtetë Shaqir Fetai?

Para 15-16 viteve partia shtet (VMRO-DPMNE) e Gruevskit, duke shpresuar se përmes ringjalljes dhe partizimit të Kishës Ortodokse të RMV-së, do të ngritet shteti në kishë si dhe do të përfshihen në parti të gjithë besimtarët e religjionit ortodoks, nisi të paraqitet si nënë për KOM-in dhe si njerë për BFI-në. Me këtë rast, sakaq, KOM-it ia ndau një çerek Kalaje për të ndërtua selinë e kishes ortodokse me objektet ndihmëse, ndërsa i anashkaloi bashkësitë fetare.

Ishte një prijës fetar atëbotë (H. Sulejman ef. Rexhepi) që çdo diskriminim shtetëror e parqiste në të gjitha instancat ndërkombëtare, që reagonte ashpër për çfarëdo padrejtësie dhe që nuk pranonte kurrfarë marrëveshje politike në dëm të fesë islame. Pastaj fillonte trysnia mbi pushtetin, pastaj pushteti përpiquej të ofronte rrugëzgjidhje dhe ishte aty Efendi Rexhepi dhe sekretari gjeneral i BFI-së, H. Afrim ef. Tahiri, të cilët nuk kërkonin asgjë më shumë dhe asgjë më pak nga ajo që i ishte ndarë KOM-it, edhe atë pikërisht në atë lokacion!

Çka ndodhi më tej? Fillimisht Shteti përpiquej për të gjetur po atë hapësirë, madje në pozitë të dinjitetshme, herë duke e nxjerrur një problem e herë një problem tjetër teknik. Në momentin kur gati po zgjidhej problemi, ra pushteti i VMRO-së.

Një pushtet tjetër (LSDM), për t’i zgjidhur sa më lehtë disa probleme të trashëguara nga pushteti i kaluar (decentralizimi i pronës, letrat me vlerë, pronat-lokalet-dyqanet e BFI-së) i hyri aventurës që ta bëj përmbysjen e pushtetit edhe në BFI). I ndihmoi Shaqir Fetait, përmes lakejve të vetë paraprakisht të instaluar në BFI që t’i largojnë besnikët dhe të gjithë ata që e përbënin krahun e djathtë të Sulejman ef. Rexhepit dhe në fund edhe vetë atë. Ky pushtet e instaloi Shaqir Fetain i cili, paraprakisht kishte premtuar se do të shpreh gjithnjë falënderime për këtë pushtet çfarëdo dhe sado që do të japin nga ajo që i përket BFI-së.

Në këtë vazhdë do të jetë edhe selia e BFI-së njësoj si Kishës Ortodokse Maqedonase.

Regjistrimi i “bashkesive fetare islame” njësoj si bashkësive kishtare ortodokse, pa e kuptuar Shaqir Fetai se islami është fe ndërsa ortodoksia religjion.

Shaqir Fetai ka marur rolin e acidit që dobëson fuqinë e kërkesave reale të BFI-së! Shaqir Fetai ka marur rolin e shurdhuesit të kërkesave reale të BFI-së! Shaqir Fetai është përfaqësues i motos “Jep çfarë të japësh” se nga BFI-ja do të lavdërohesh deri ne kupë të qiellit!

Së kendejmi, Shaqir Fetai po e përgatit opinionin për ta shprehur kënaqësinë për atë që do ta japë për selinë e BFI-së, ndonëse do të jetë miniaturë e asaj që i është falur Kishës. Madje Shaqir

Fetai po agjton më shumë se për çdo parti shqiptare për LSDM-në sepse, sipas Shaqir Fetait, denacionalizimi si dhe “dhuratat” prej shtetit qenkan në dorën dhe fuqinë e LSDM-së. Shqiptarët çfarëdo të mire që po ta bëkan kërkuakan shpërblim të majmë, kjo sipas Shaqir Fetait!  
Pra, Shaqir Fetai është sjellë dhe akoma mbahet sa të realizohen disa kërkesa të BFI-së, por sipas kutit të pushtetit. Të merren letrat me vlerë, sipas çmimit të LSDM-së, të merren objektet duke paguar përqindje të madhe për sekserët lsdmistë! Të merret lokacioni në Kala për Selinë e BFI-së, lokacion ky që nuk i hy në punë as lavazheve. Ky është Shaqir Fetai, i cili, edhe frikësohet, edhe po shantazhohet sepse është i kapur por edhe pse e ka mision shpirtëror të marrur nga shërbimet e huaja serbo-ruse! Këtë tashme e ka dëshmuar katërcipërisht.  
**/1KlikLarg/10.01.2023**

**“Reisi” që për një aktivitet partiak injoron Ministrin e Haxhit**

**Për herë të parë në historinë post-komuniste ndodhë që një kryetar i BFI-së të refuzojë takimin me Ministrin e Haxhit sepse do ta ketë një aktivitet partiak lokal në katundin e vet! Kjo është çmenduri totale e Shaqir Fetait**

***Nga Fejzi Salihu***

Delegacioni nga BFI-ja që paskësh shkuar në Arabinë Saudite po e përfaqësuaka Shaqir Fetain! A mos është i sëmurë, në derexhe të vdekjes, ky farë Shaqir Fetai? A mos është i arrestuar për vjedhje e për degjenerim të vakëfit, apo i arrestuar politikisht? A është i mbajtur peng diku, a mos ia kanë marrur dokumentin e udhëtimit, apo, çfarë u bë që Shaqir Fetai të përfaqësohet në takimin me Ministrin e Haxhit nga Ismet Ademi? Pse pikërisht nga Ismet Ademi, kur dihet fare mirë se ai është linku i njerëzisë të dyshimitë me njerëz ta paverifikueshëm të botës arabe! Pse pikërisht Ismet Ademin, njeriun e burgosur rreth një viti nga shteti arab deri sa ka studiuar atje! Kush është Shaqir Fetai që të përfaqësohet në takime me zyrtarë më të lartë të Shtetit arab! Të mos takohet Shaqir Fetai me Ministrin e Mbretërisë Arabe por të përfaqësohet nga dikush që nuk është i denjë të takohet me askënd tjetër përveçse me prokurorë të shtetit?! Si guxon Shaqir Fetai t'i dërgojë të falura dhe ta falënderojë për organizimin e haxhit dhe për lehtësira të tjera që i ofrohen haxhinjëve tanë! Skandaloze! Shaqir Fetai as që i mendon fjalët kur i nxjerr nga b... A është normal ky njeri! E falënderon Ministrin që po ia organizuaka Haxhin! Shaqir Fetai thotë: “Delegacioni i BFI, i përcolli Ministrin të Haxhit dhe Umres falënderimet e Kryetarit të BFI, Reisul Ulemasë H. Hfz. Shaqir ef. Fetai për organizimin e Haxhit dhe për lehtësimet e tjera të cilat ua ofrojnë haxhinjëve tanë!” Pra, paska diçka speciale që po ua ofruakan haxhinjëve tanë dhe jo të gjithë haxhilerëve të botës! Pse po rrenë sa është i rrumbullakët Shaqir Fetai? Duhet t'i vijë turp, avdallit!

“Humoristi” injorant, megjithatë, duhet të tregojë të vërtetën! Si e eliminoi vizitën dhe takimin me Ministrin e Haxhit të Arabisë Saudite nga axhenda e vet! Kush u bë sebeb! Çka përfaqëson Shaqir Fetai! Çka organizon Shaqir Fetai: jetën politiko-partiake apo jetën fetar! Ky, e harron jetën fetare kur është në pyetje aktiviteti i liderit politiko-partiak që do ta ketë në fshatin e tij! Fiks dy javë abstenon nga jeta fetare në efekt të organizimit partiak!

Këto ditë u publikua se një lider partiak, i cili e instaloi Shaqir Fetain në krye të BFI-së, do të oranzojë një takim me elektoratin e katundit të Shaqir Fetait, në Çegran! Në këtë vend do të prezantojë edhe lideri i partisë, për të cilin Shaqir Fetai e lëshon takimin me Ministrin e Haxhit, nga frika se mund të keqkuptohet nga lideri partiak dhe ta spostojë nga vendi ku e ka instaluar! Zatën, jo njëherë i është ankua liderit partiak se disa bashkëpunëtorë të tij të brendshm janë duke punuar për ta larguar me një puç klasik, mu siç e largoi Shaqir Fetai h. Sulejman ef. Rexhepin! Shaqir Fetai është paranojak, e di se çfarë m... ka hëngër dhe, tashmë, është i bindur dhe tmerrësisht i frikësuar se pikërisht atë lojë të ndyrë do t'ia luajnë edhe Shaqir Fetait. Ndaj dhe, ai patjetër duhet të jetë në Çegran ditën e vizitës së liderit partiak, sepse, pastaj, ky lider do të mund të hidhërohet me këtë avdall dhe ta përplasë hundë e buzë dhe në vend të tij të sjell një njeri më normal!

Kjo është arsyeja se pse e injoroi Ministriinë e Haxhit dhe, për ta “zbutur” paksa situatën, i çon lavdërata kësaj Ministrie për organizimin e Haxhit, sjellje kjo tipike prej karrieristi të pamend! Shaqir Fetai tashmë i ka çuar selam liderit politik se “i gjallë apo i vdekur”, ai vetë do të dalë në krye të katundit Çegran për ta pritur liderin! Në këtë mënyrë ai dëshiron t'i tregojë se për të, si “lider fetar”, ai është më i rëndësishëm se sa Ministria të cilës “i përkulen” të gjithë orgnizatorët e haxhit deri sa të mbarojë ky obligim fetar!

Përveç kësaj, Shaqir Fetai ka filluar të ndjehet shumë i hendikepuar me mosnjohjen e gjuhës arabe! Ç'të kërkojë në takim me zyrtarët arabë kur po e ndjenë veten injorant para tyre. Njeriu që nuk e di gjuhën arabe, është i kotë në takime me arabët, të cilët shprehin mëshirë për të si për një të hendikepuar, me nevoja të veçanta!

BFI-ja ka përplotë intelektualë, profesorë, njohës të përkryer të gjuhës arabe, personalitete të denjë për të qenë përfaqësues të Institucionit Fetar në takime me personalitete të larta arabe, dhe jo të dërgohen atje “personalitete” që nuk dinë ta shkruajnë as emrin e vet.

**/Kombetare/TetovaSot/13.01.2023**

**Persekutimi sipas kaçikut**

**Diktatorët, ata që e rrëmbejnë pushtetin pa e merituar dhe me turlifarë intrige si dhe, injorantët në krye të pushtetit – këta gjakun e kanë plotë limfa ndëshkuese dhe persekutuese, sepse, ndryshe si të ruhet kolltuku i grabitur**

***Nga Reshat Gashi***

Si ta dalloni këtë “intelektual” të tipizuar si “intelektuali gjakësor”, apo metaforikisht, “vampiri që të dhuron puthjen e vdekjes”, i cili shquhet për afinitetet e tij: të të flas te qafa; në emër të besnikërisë pret humbjen e vëmendjes dhe përqëndrimin derisa ta thithë gjakun në qafë! Diktatorçiq plus dhe karikaturë e gjallë prej gjaksori! Karrierën e vet, ky lloj diktatori, e mbindërton përmes persekutimit, ndëshkimit dhe internimit. Kështu ka mbajtur pushtetin e vet Rankoviçi, Millosheviçi, Enver Hoxha etj! Të gjithë ata tokmakë që intelektualët e kombit i kanë ndërre rrezik, i kanë persekutuar, i kanë ndëshkuar “në emër të popullit” dhe i kanë internuar në Goli Otok, në Perëndim duke i hasmëruar me perendimorët, në Spaç e në Kuçovë, shkrimtarin e kanë çuar te dhenët, pilotin me ngarku-shkarku plehëra, bujkun në bibliotekën universitare, profesorin konduktor etj.

Kur të bëhet ky përshkrim i “intelektualit gjakësor” mendja të shkon edhe te Shaqir Fetai, instalacioni i shërbimeve ruso-sllave në krye të BFI-së, abuzuesi me i madh i të gjitha kohërave, “myslimani” i cili për interesa të veta kafshërore në çdo moment është në gjendje të dëshmojë rrejshëm, të betohet rrejshëm, të shkelë mbi Kuran e mbi fëmijë të vet. Ai, që në momentin kur ka nisur ta persekutojë librin duke e lënë në kushte burgu, duke e lënë në duar të injorantëve që nuk e dinë protokolin dhe kodeksin e sjellies ndaj librit në kushte biblioteke, që kur bibliotekën nis dhe e trajton si “ndëshkimore”, ai, pra, Shaqir Fetai që nga ky moment ka dëshmuar se nuk është as hajri i fesë dhe as hajri i kombit! Me librin shqip, me shkrimtarin kombëtar (po e përsëris: me shkrimtarin kombëtar, të verifikuar e të pranuar në krijimtarinë gjithëkombëtare) Shaqir Fetai sillet keq vetëmse është i brumosur me mësimet e oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviçit, dhe të OZN-ës, Tihomir Vuksanoviçit (ndoshta i kujtohet Shaqir Fetait, nëse jo ëzhtë mirë t’i publikohet ndonjë gjë nga dosja e OZN-s)!!! Një vlerë kombëtare Shaqir Fetai nuk e honeps dot, prandaj në ndihmë i thërret mësimet e UDB-së dhe Oznës, nëse ka nevojë për t’ia lënduar dinjitetin intelektualit të kombit!

Shaqir Fetai jo se ka bythë për ta realizuar nëpërkëmbjen e dinjitetit të tjetrit, por ama e ka ndihmën e institucioneve “shtetërore”, të cilët kurrë nuk ta kryejnë një punë pa një kundërshtim. Natyrisht, këta institucione nuk kanë nevojë për kundër-shperblime, sepse edhe aty Shaqir Fetai është cinik, por kanë nevojë për spiunim ku Shaqir Fetai është ekspert. Dynjaja e di se çfarë spiuni, çfarë intriganti që është, çfarë kuazi-dijetari që është dhe, ky hiç nuk e ka dert të futet në oda, në mexhli, sepse nuk i bën pesë para, sepse ata që nuk janë tajfa e Stanko Dragoviçit hiç nuk i bëjnë përshtypje Shaqir Fetait! /**Kombetare/16.01.2023**

**Kush ka të drejtë: Shaqir Fetai apo ministri serb Selakoviç**



## ***Nga Afrim Tahiri***

Në raport me ushtrinë (OZN-a) dhe policinë serbe (UDB-a) Shaqir Fetai gjithmonë është munduar të jetë i kujdesshëm. Madje për këta dy institucione nacionale serbe, edhe vetë serbët nuk e kanë atë mirësjellje të Shaqir Fetait.

Sot, të gjithë Institucionet e Kosovës dhe jo vetë por dhe subjekte të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare e perkuntojnë Masakrën e Reçakut. Të gjithë e përkujtojnë si masakër, si krim kundër njerëzimit të kryer nga ushtria dhe policia serbe. Pra, fajtor direkt për këtë tmerr është shteti serb, populli serb, institucionet nacionale të këtij populli!

E paska përkujtuar edhe Shaqir Fetai! Nga perkujtesa që e ka publikuar në faqen e vet personale, shihet që Shaqir Fetai përpiket t'i korrigjonte serbët dhe mos t'i përfshijë në krim institucionet nacionale serbe, por faji të bie mbi plehëra të dorës së dytë dhe, me këtë rast, faji të ngelë jetim! Sipas Shaqir Fetait, "Para 24 vitesh ndodhi masakra e paparë në Reçak të Kosovës nga paramilitarët sërb". Pra, sipas Shaqir Fetait, kjo vepër nuk qenka e Institucioneve të Sërbisë, por e "paramilitarëve serbë", që do me thënë se "mal pa ujçer nuk ka"! Mesazhi i Shaqir Fetait: mos ua lini fajet institucioneve shtetërore serbe por hordhive që asnjëherë nuk janë institucionalizuar!!!

Ndërsa, ministri i punës në qeverinë serbe, Nikolla Selaković sot, si përgjigje mediave ia drejtoi këtë përgjigje: Reçaku "ishte dhe mbetet veprim ligjor dhe legjitim i ushtrisë dhe policisë serbe!" E pra – kush ka të drejtë Shaqir Fetai apo ministri serb, Selaković!/Kombetare/16.01.2023

## **Premtimet manipulative**

A dëgjuat premtimet e Shaqir Fetait për 2023-ën?!

Shaqir Fetai gjithnjë ka premtuar, por njihet si njeri që nuk realizon thuaja asgjë nga ajo që premtton. Ai vet, por dhe bashkëpunëtorët e tij si dhe opinionimi më i gjërë, e dinë se:

– nuk ka pasur njeri në botë që e ka mburrur aq shumë Shaqir Fetain sa e ka bërë këtë Reisi i tij, Sulejman ef. Rexhepi;

– askush si ai nuk e ka imponuar Shaqir Fetain në mexhllis si “vlerë”;

– askush respekt e nder më të madh se sa ai nuk i ka bërë Shaqir Fetait, me vetë faktin që e ka avancuar në karrierë;

– askush si ef. Rexhepi nuk ia ka mbuluar Shaqir Fetait injorancën, hipokrizinë dhe shpirtprishurinë;

– askush Shaqir Fetain nuk e ka mikluar dhe nuk e ka përgëdhelur më shumë se Reisi i tij Sulejman ef. Rexhepi;

– askush, madje as babai i vetë, askush bre, nuk ka bërë aq shumë për Shaqir Fetain se sa Reisi i tij;

– askush Shaqir Fetait nuk do t’ia përgatitë respektin dhe qëndrimin ndër xhemat më shumë se sa ia ofroi ai...

Për këtë sjellje njerëzore të ish-Reisit ndaj tij, ai gjithnjë ka pasur “të siguruar” premtime për përkrahje, respekt e besnikëri deri në frymën e fundit si dhe lojalitet të paluhatshtëm nga Shaqir Fetai!

Dhe, çka fitoi në fund Sulejman ef. Rexhepi! Kush doli Shaqir Fetai për Sulejman ef. Rexhepin? Doli tradhëtari i padiskutueshëm, gaca e mbuluar, doli të jet djalli, doli i pabesi dhe i pafytyri më i madh që e paska pasur rreth tre decenie krah të djathtë!/**Fakte/23.01.2023**

## Mjer për BFI-në e lum për Shaqir Fetain

**Opinion i gjërë tashmë i di të gjitha emrat e “teologëve” të Shaqir Fetait, të cilët vjedhin, shajnë, tradhëtojnë, që janë të pamoralshëm, që shkelin çdo normë islame, që nuk respektojnë asnjë nen të normativës së BFI-së, që janë sahanlëpirës, puthadorë e servilë, që heshtin para “reisit” të tyre edhe kur ai shkretton, edhe kur uzurpohet dhe vidhet vakëfi...**

*Nga Halid Sadiku*

Bashkësia Fetare Islame (BFI) është shndërruar në një institucion ku nuk dihet se cili nëpunës apo cili zyrtar i saj po zhvillon aktivitete në frymën institucionale. Nëpër shumë xhami të vendit tonë, imamë, vaizë, hatibë, po shfrytëzojnë xhamitë për interese të veta. Shaqir Fetait rri heshtur, muftinjve nuk u dëgjohet zëri, kurse të dekretuarit e tyre keqpërdorin mihrobe, qursi, hytbe... në dobi të shoqatave, mexhliseve, klubeve, agjencive turistike, fraksioneve, sekteve...! Dmth. të këtillët shfrytëzojnë xhamitë, zyrat dhe mjetet e xhamive për përfitime personale, apo të palës së tretë!

Flitet se “Reisit” Shaqir Fetai i mjafton që të këtillët mos t’i përzihen në interesin e tij, mos t’ia lëkundin kolltukun, sepse ai dhe myftinjte e tij janë shumë të vetëdijshëm se shkeljet e tyre janë shumëherë më të rënda se sa e nëpunësve të BFI-së. Nuk ka dyshim se kjo gjendje na flet se keqpërdorimi i të mirave të institucionit është zgjeruar në të gjitha nivelet. Fatkeqësisht, ky lloj metastazimi garanton trashjen e zullumit – zullumqarëve, dobësimin dhe shkatërrimin e BFI-së! Në rrethana të këtilla, kur vetëm në administratën aktuale të BFI-së së Shaqir Fetait aktualisht janë dhjetra persona që janë të gatshëm më shumë t’ju shërbejnë intereseve të huaja se sa xhemateve, persona që nuk kanë fytyrë të dalin para xhematit, hajna, antihumanistë, antiislamistë, horexhinjë, bixhozxhinjë, keqpërdorues të fitrit, të zeqatit dhe haxhit, dalleverxhinjë e hipokritë, vetëm një i marrë mund të mendojë se BFI është në rrugë të mbarë dhe që gjatë 2023-tës pritshmëritë janë se të gjithë pisat do të përmirësohen dhe se ujë do të ndrrojnë edhe qimet edhe zanatin!

Opinion i gjërë tashmë i di të gjitha emrat e “teologëve” të Shaqir Fetait, të cilët vjedhin, shajnë, tradhëtojnë, që janë të pamoralshëm, që shkelin çdo normë islame, që nuk respektojnë asnjë nen të normativës së BFI-së, që janë sahanlëpirës, puthadorë e servilë, që heshtin para “reisit” të tyre edhe kur ai shkretton, edhe kur uzurpohet dhe vidhet vakëfi.

Opinion i gjërë i di të gjithë këta persona, sepse janë lakuriqësuar me dhjetra herë, me emër e mbiemër, po të njëjtat akoma janë në krye, janë krahu i djathtë e i majtë i Shaqir Fetait, janë “drejtues” të organeve e të institucioneve të BFI-së. Të tillët i duhen Shaqir Fetait, sepse të tillët ia sugjeron punëdhënësi i tij dhe të tillët i mbanë më lehtë në grusht!

Prandaj, është konstatim i përgjithshëm që po qarkullon ndër myslimanët e vendit: Shaqir Fetait nuk i intereson BFI-ja, nuk mbron të drejtat e myslimanëve, xhemateve që këqpërdoren nga imamët dhe myftinjte e tij, atij i intereson interesi i tij dhe instaluesit të tij! Mjer për BFI-në e lum për Shaqir Fetain dhe myhibtë e tij! **/Kombetare/24.01.2023**

**Maska e tradhëtisë**

**Tradhëtarët, kriminelët, spiunët, të djallëzuarit, gjithnjë ndjehen të hendikepuar nga veprimet e tyre antinjerëzore, ndaj, për të qenë pranë njerëzve dhe të mos refuzohen aq lehtë, ky lloj antinjeriu gjithnjë organizon, porosinë, paguan takime, vetëm e vetëm të ndjehet paksa i pranuar prej opinionit dhe i defokusuar nga krimet e shumëfishta të antinjeriut**

***Nga Besnik Thaçi***

Të takohet Shaqir Fetai, qoftë edhe për një çaj rusi, është solidarizim me veprimet e tij prej kriminelit, spiunit e tradhëtari! Vetëm një person si Shaqir Fetai, i ngjeshur me strukturë prej kriminelit, mund t'ia dalë të organizojë një përmbysje kriminele të një Institucioni, t'i manipulojë e t'i kriminalizojë të gjithë kolegët vetëm e vetëm që të bashkëndahet krimi.

Për pranim në komunitet e në opinion pas një përvoje të gjatë prej spiuni udbash, vetëm një mahluku si Shaqir Fetai mund t'i shkojë mendja të organizojë e të porosinë takime me policë, me prokurorë, me politikanë, dmth me "pushtet" nga i cili takim manipulon duke përçarur mesazh të satanizuar se "ja, pushteti më do, ai është me mua, prandaj, kujdes...!"

Për ta relativizuar tradhëtinë e rëndë, pisi i llojit të Shaqir Fetait është në gjendje të "sponsorizojë" takime me turlifarë kuazi-intelektuali, madje, injoranti i gëzohet edhe talljes së "shkrimtarëve" prej të cilëve e blenë një "dekoracion", sepse, në kushte normale, nuk ka shkrimtar në botë që do të panonte të pinte kafe me Shaqir Fetain, pasi të njohtoheshin me krimin, tradhëtinë dhe spiunimin e tij të dokumentuar.

Shaqir Fetai, tanimë, kur iu tret maska e tradhësisë, mundohet të shpreh brengë për Librin e Allahut xh.sh., Kuranin e Shenjtë! Shaqir Fetai të flasë për Kuranin? Kjo është maja e hipokrizisë së tij! I ka hije Shaqir Fetait të flasë për Kuranin kur një jetë të tërë ka shkelur parimet, mësimet, urdhërat kuranore!

Cili Libër i Shenjtë, aq më pak Kurani, urdhëron spiunimin siç e ka në gjak Shaqir Fetai!

Cili Libër i Shenjtë, aq më pak Kurani, urdhëron të parin e komunitetit mysliman që t'ua zhvasë kafshatën nga goja, t'ua rrëmbejë fitrin, zeqatin, kurbanin, vetëm e vetëm që t'i shpenzoj duke paguar gjykatë e avokatë jomyslimanë për t'i përndjekur myslimanët që nuk duan që të drejtohen nga një spiun, nga një kriminel, nga një tradhëtar!

Cili Libër i Shenjtë, aq më pak Kurani, pajtohet me të parin e komunitetit mysliman që ta vjedhë, ta hajë e ta shpenzojë vakëfin, të cilën të parët tanë e lanë si pasuri të përgjithshme për zhvillimin e jetës fetare islame e jo për të trashur qafë e b... Shaqir Fetai!

Cili Libër i Shenjtë, aq më pak Kurani, i lejon të parit të komunitetit myslimanë që të shoqërohet me kriminelë, e hajna, me banditë, me injorantë e hipokritë?

Cili Libër i Shenjtë, aq më pak Kurani, i lejon Shaqir Fetait që të bëjë "karrierë" duke tradhëtuar miq, duke spiunuar kolegë, duke tradhëtuar një kauzë jetike për popullin shqiptar e, përgjithësisht, mysliman!

Shaqir Fetai tashmë është bërë "literaturë bazë" për të studiuar një komplot e një tradhëti që ia bëri ish-reis ulemasë! Shaqir Fetai do të ngelë i vetmi lider që një ditë do të studiohet si materie e zezë! Shaqir Fetai sikur edhe me tërë njerëzimin e botës të pijë çaj rusi, të presë e të përcjellë njerëz butakë, ai sërish në histori do të ngelë si personazhi më kontravers që ka frymuar e vegjetuar mbi këtë tokë! Ai do të mësohet si "reis" që erdhi në post me akte kriminale.

Nuk ka vizitë, nuk ka pritje e përcjellje, nuk ka personalitet që Shaqir Fetait do t'ia lehtësojnë peshën e papërbalueshme të kriminelit.

Hoxhës nuk i shkon epiteli kriminel, spiun e tradhëtar, ndërsa djallit po! Shaqir Fetai nuk e ka hallin e jetës fetare islame, nuk e ka hallin e myslimanëve, nuk e ka ngritjen e institucionit fetar, nuk e ka dhe kurrë nuk do ta ketë hallin e medresantëve, Shaqir Fetai e ka të papërballueshme peshën e tradhëtisë, kriminit, hipokizisë. Për këtë djallëzi ai është shumë i vetëdëshëm, dëshiron të dalë nga kjo situatë. Dhe, daljen nga kjo situatë ai e sheh vetëm te ndërprerja e fushatës kundër tij (siç ankohet edhe te ndërkombëtarët), dhe jo në kërkim të një falje të thellë për grabitjen në formë kriminele të një “karrige” për të cilën kurrë nuk ka qenë dhe nuk mundet të jetë i denjë! Edhe spiun e tradhëtarë edhe “reis”?! Pushteti është si kungulli, asnjëherë nuk rri gjithnjë mbi ujë! Dikund do të thyeret e bëhet copa-copa. Këtë thyerje po e ndjenë dhe po e pret edhe Shaqir Fetai! Ai po e gënjenë veten, ndërsa tashmë është rrasur në lluc deri në maje të hundës.

**/BotaSot/30.01.2023**

**Pse protestojnë mederesantët**

**Medresantët plaçkiten, prindërit e tyre me taksat fetare sigurojnë mirëvajtje të procesit arsimor, sigurojnë rroga për stafin arsimor e teknik, myslimanët e vendit e mirëmbajnë Medresenë Isa Beu, ndërsa në fund, askush nuk çanë kokë për shkollim të mëtejshëm të tyre! Pse tërë ky kontribut? Që t'iu minohet shkollimi superior?!**

***Nga Valbona Musai***

Më sa na kujtohet, disa javë më parë, instalacioni i pushtetit politik maqedonas në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, sikur deklaroi se tashmë Medresja është akredituar dhe se medresantët do të regjistrohen në cilindo fakultet të universiteteve shtetërore. Kjo po vërtetohet edhe një herë se Shaqir Fetai, ky fare Nasradin Hoxha bashkëkohor, e ka në gjak rrenën. Ose, edhe më keq: Shaqir Fetai është i kapur aq rëndë nga shërbimet e ndryshme intelektuale sa, premtimet e tij i ngjajnë vetëm “simfonisë” së shërbimeve që të detyrojnë të vallzoshë sipas ritmit të tyre!

Pra, medresantët kanë konstatuar se Shaqir Fetai i ka gënjyer rëndë dhe sërish i ka lënë në rrugë. A e keni parë ndonjëherë Shaqir Fetain që nervozohet, që e ngrit zërin, që i bie grusht tavolinës, që kërcënon, që vë ultimatumë, që acarohet me pushtetin? Paraardhësi i tij e bënte këtë, ai nuk i kishte këto halle të Shaqir Fetait, sepse nuk ishte kurrë në situata siç është Shaqir Fetai!

Po pse pushteti politik e mbështet me shpatulla për muri Shaqir Fetain, duke i premtuar diçka jetike ndërsa nuk i rri në fjalë premtimit të vet? Sepse, luan me Shaqir Fetain, sepse tallet me të, sepse realizimi i premtimit të pushtetit politik kërkon flijim; heqje dorë nga diçka që nuk i shkon në interes pushtetit dhe shërbimeve të tij! Pushteti i ka ofruar diçka shumë të rëndësishme Shaqir Fetait, por ama, realizimi i saj pritet të ndodhë atëherë kur Shaqir Fetai do të heqë dorë nga ndonjë “matematikë që nuk hy në hesapet e pushtetit. Siç e bëri me kriminalizimin e vakëfit të denacionalizuar! Atë ditë që Shaqir Fetai do të kumtojë se tashmë medresantët do të mund të regjistrohen nëpër fakultete të ndryshme, po atë ditë, është e qartë si Zoti Një, Shaqir Fetai ka kryer koncesione në të mirë të pushtetit e në dëm të madh të myslimanëve të vendit.

Prandaj Shaqir Fetai është i vetmi “lider” në botë që ka kapur një pushtet pa kurrfarë plani, pa kurrfarë strategjie, pa kurrfarë plani aksional. Sepse, Shaqir Fetait i është bërë me dije që ai duhet të zbatojë plane që i vijnë nga “lartë” dhe jo të zbatojë diçka të veten që nuk përputhet në asnjë pikë me planin e atyreve që zhvillojnë politika ortodokse (që nga Rusia e deri në Greqi).

Myslmanët e vendit tashmë për një gjë janë të sigurtë: jo vetëm protestat, por sikur Shaqir Fetait t'ia tëkërlisin dhe shallin, sikur t'ia thyejnë kokën me gurë protestash, sikur edhe ta turpërojnë zi e më zi, ai do ta ketë më të përballueshme dhe më të lehtë se sa mos t'i realizojë planet e atyre shërbimeve që e instalojnë në krye të BFI-së.

Jo një herë është thënë se, Shaqir Fetai është turpi i myslimanëve të vendit; kapaciteti i tij mental është po ai i një shërbëtori i cili i ka topitur dhëmbët duke përsëritur “da gospodine” (po zotëri), “poveli gospodine” (urdhëro zotëri), “kako qe reçete vie gospodine” (si do të thoni ju zotëri)...

Ai nuk ka as shpirt, as zemër, as gjakë që një ditë t'i ndalet pushtetit karshi dhe t'i thotë: “ose të zgjidhet probemi jetik i medresantëve ose ky shtet nuk mund të funksionojë normalisht!” Shaqir Fetai nuk e ka të stërvitur këtë frazë, sepse, ai nuk është për ta zhvilluar dhe avancuar jetën fetare islame por për ta degraduar dhe dëmtuar në palcë këtë jetë fetare institucionale. Në këtë fakt tashmë janë katërcipërisht të bindur të gjithë myslimanët e vendit dhe më gjërë.

**/Nistori/01.02.2023**

**Servili në siklet**

**Servili është qenia më e pështirë që ka krijar i Madhi Zot. Një kombinim i derrit dhe dhelprës tek kafshët! Por, kur servili bie në hall, kur ka ndonjë siklet, kur nuk i shkon kungulli mbi ujë, ai di të shndërrohet edhe në një qenie-konglomerat i të gjithë zvarranikëve që i ka falur Krijuesi i Gjithësisë, e që i ka koncentruar në shpirtin e shkatërruesit dhe degjeneruesit të BFI në RMV**

***Nga Abdulqerim Kodra***

Kush është servili? Çka bën ai? Çka e karakterizon atë? Servili është puthadori, b...lëpirësi; servili është ajo lloj ushujze që kapet për më të fortin dhe mundohet t'ia thithë gjakun me lezet dhe nuk shqepet derisa të ngopet. Servili 24 në 24 është në shërbim të më të fortit, dhe, si lloj butaku që është, i pakarakter dhe i pashpirt, kënaqet duke u shitur si pasardhës gjenetik i më të fortit. Pra, servili shitet si i përgëdheluri i më të fortit, i pushtetit. Po si e arrinë servili këtë përafrim me më “të fortin”? Natyrisht, duke spiunuar, duke i ofruar përfitime që ia mbushin syrin më të fortit, duke sjellë informacione të dorës së parë dhe duke përcjellë Fake News te milet! Po si të kuptohet më mirë servili?

Nëse analizohet profili dhe veprimtaria e Shaqir Fetait, këtij farë instalacioni të pushtetit politik në krye të BFI-së, sakaq do të krijohet një përceptim real mbi këtë qenie të pacipë!

Kush është më i rrezikshëm se servili? Vetëm servili kur është në halle, kur ka ndonjë siklet! Atëherë bëhet edhe më i fëlliqtë. Servili i lumtur nganjëherë edhe mund të jetë më i qetë, më pak spiun, më pak tradhëtarë, më pak i prishtë. Por ama, servili në siklet, trazohet shpirtërisht, egërsohet, çartet, vazhdon vullnetarisht dhe besnikërisht spiunimin, kërkon të bëhet mercenar i pushtetit politik vetëm për pak përkrahje që t'ua ngulë thikën pas shpine të gjithë atyreve që do t'ia rrezikojnë planet ogurzeza, i eliminon të gjithë ata që pushteti nuk i honepsë dot dhe, kësisoj, kriminalizohet vullnetarisht vetëm e vetëm që të përfitojë pak nga “gishti përgëdhelës” i pushtetit. Bashkësia Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në histikun e vet, nuk ka njohur njeri më të rrezikshëm, më spiun, më tradhëtar, më servil se Shaqir Fetai, i cili, për të bërë pak karrierë prej “hoxhe” është në gjendje që brenda vetes ta zgjoj edhe atë qenie-konglomerat të një zvarraniku me të gjitha instiktet kafshërore të bishave më të rrezikshme në planet!

Shaqir Fetai, ky farë servili në siklet, tashmë është i lexueshëm për të gjithë; edhe zogjtë e malit e dinë se përmes cilit krim erdhi dhe u instalua në krye të BFI-së, nuk ka shqiptar në botë që nuk e di se çfarë hipokriti, çfarë pisi e çfarë sevili që është! Ai pa servilizëm nuk mund të funksionojë, në fakt, ai e ka fort të qartë se vetëm servilizimin e ka profesion. Ndaj dhe rrenë, ndaj dhe vjedh, ndaj dhe nuk e ka dert në emër të islamit t'i bëjë njëmijë mëkate e pislleqe, ndaj dhe nuk i intereson koha dhe autoriteti i tjetrit kur i fton në kabinet sa për të bërë “lajm”! Nuk mbanë llogari se ua humb kohën e shtrenjtë, se ua njollosë autoritetin, sepse takimi me një spiun e me një tradhëtarë është baraz me humbjen e autoritetit! Takon azetarë, prokurorë, mjekë, takon persona “kontribues fetaro-kombëtar”, pa u brengosur fare se do të shikohen si persona të kompromentuar nga nje udbash aktiv siç mund të jetë Shaqiir Fetai por që personat që pranojnë ta takojnë nuk ia dinë aktivitetin prej spiuni.

Le t'i sjellim këtu vetëm nja tri fjali të djallëzuara të Shaqir Fetait që mund të lexohen në “informacionet” e budallakafta që i publikon i gjori në FB-un e vet!

Shaqir Fetai paska marrë pjesë në një “Konferencë për ballafaqim”! Për herë të parë në botë, madje në historinë e njerëzimit qenka organizuar një “konferencë” e tillë! “Konferencë për

ballafaqim”?! A mos po do me thënë Shaqir Fetai “Konferencë më temë “Përballja me antisemitizmin”?! Nejse, në këtë Konferencë paska qenë i ftuar Shaqir Fetai! Në fakt ka qenë i ftuar Institucioni i BFI-së, organizaorit i është dashur përfaqësimi i këtij institucioni, organizatorit i duhet sa më shumë “publik institucional”?! Shaqir Fetai ka qenë aty vetëm numër publiku! Dhe, ky farë avdalli thotë: “Pjesëmarrja në këtë konferencë edhe njiherë tregoi se BFI është subjekt pjesëmarrës në shumë konferenca”?! Pjesëmarrja si publik sa është e mirë aq më shumë është edhe ofenduese! A mund të ndodhte dikur ndonjë Konferencë ku nuk do të dëgjohej zëri, qëndrimet, pikëpamjet e BFI-së mbi një dukuri apo fenomen! A mund të fillonte Konferencë e natyrës së tillë pa pasur fjlaim ish-reisul ulema, pa iu drejtua të pranishmëve! Ka ndodhur që ka dështuar Konferencë ndërkombëtare vetëm pse kështu ka vendosur me të drejtë ish-reisul ulema (siç ishte Konferenca Botërore Religjioze, që organizohej nga Ministria e Kulturës e që në çdo tre vite mbahej në Ohër)! Pjesëmarrja pasive është ndarje nga koha e jote e shtrenjtë (që mund edhe të refuzohet) për ta nderuar organizatorin si dhe për t’ia nxjerrë të suksesshme aktivitetin! Hiç më tepër!

Servilizëm qesharak e i pështirë i Shaqir Fetait vërehet edhe në pritje të nja dy arabëve, aktivistë humanitarë, të cilët na qenkan nga “ORGANIZATA SAUDITE E MBRETIT SELMAN PËR BAMIRËSI”!!! Sipas Shaqir Fetait, Mbreti Selman, drejtues i një prej shteteve më me relevancë në botë, na e paska edhe një “organizatë humanitare”?! Ofendim më të poshtër nuk do të mund t’i bënte asnjë cinik siç ia bën Shaqir Fetai. Edhe, paramendoni, këta dy aktivistë humanitarë na qenkan mysafirë pesë ditë të BFI-së! As nuk ndajnë ndihma, as nuk shqyrtojnë projekte humanitare, as nuk organizojnë ndonjë konferencë donatorësh për ndihmë për myslimanët e vendit, por, rrumbullak pesë ditë mysafir të Shaqir Fetait! Nën petkun e humanitetit kohëve të fundit po fshihen turlifarë mahluki, “misionari”?! Shaqir Fetai e bënë kabull edhe më të keqen për fenë, për kombin, për shtetin, vetëm e vetëm që të sigurojë ndonjë rrogë për myhybët e vet, në këtë krizë financiare që e ka kapur BFI-në, meqë e vodhën dhe e ropën fare. Nga BFI po vijnë muhabetete se Shaqir Fetai me bashkëhajnat e vetë e ka sjellë BFI-në buzë falimentimit! Kur je në siklet, servil në siklet, atëherë shiten edhe interesat e familjes dhe jo vetëm të kombit e të shoqërisë!

Për shpirtin e viktimave nga tërmeti në Turqi dhe Siri, Shaqir Fetai Paska organizuar dua hatme. Por, me nxënësit e Medresesë dhe me studentët e FSHI! Po pse nuk i ka përfshirë edhe profesorët e Medresesë apo të FSHI-së? Po pse nuk i ka paraparë në këtë aktivitet të përsëritshëm të angazhohen edhe teologët apo hafëzlerët më eminentë të vendit, por vetëm nxënësit dhe studentët? Apo, aty e ka ndikimin i mjeri Shaqir! Ku guxon t’i urdhërojë e të përfshihen në ndonjë aktivitet teologët e vendit. Për inat të Shaqir Fetait do të dështonte edhe kjo dua hatme. Shaqir Fetai nuk ka autoritet tek teologët e vendit më sa mund të ketë një i pandershem e i pamoralshëm!/**IKlikLarg/09.02.2023**

**A falet hipokriti**



**Në një pusullë bakalli, në të cilën argati i pushtetit antikombëtar e antifetar, Shaqir Fetai, pasi kishte shprehur “keqardhjen” për tragjedinë apokaliptike që ndodhi në Turqi (po jo edhe për Sirinë), në fund kishte shkruar: “Zoti Madhë. Ti je Ai që falë dhe na falë neve.” Tani, shtrohet një pyetje përgjigjen e të cilës e di gjithkush që i ka thënë vetes mysliman dhe që me sinjeritet të plotë beson në Krijuesin e Gjithësisë: a e falë Zoti hipokritin?**

**Nga Muzafer Shasivari**

Në ajetin 138 të sures En Nisa, Allahu i Gjithëdhënësi thotë: **“Paralajmëroji hipokritët (o Muhamed) për dënimin e mjerueshëm që i pret!”**

Allahu xh. sh. falë, pa dyshim, por ama, për këtë kategori njerëzish thotë: paralajmëroi për dënimin që i pret, e jo për faljen! Pra, as nuk i ka falur dhe as nuk i falë! Nëse Shaqir Fetai është mysliman i sinqertë duhet ta pranojë këtë të vërtetë të pamohueshme! Shaqir Fetai nuk falet!

I Madhi Zot na e ka bërë shumë të qartë se: **“Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehenemit dhe ti kurrsesi nuk do t’u gjesh atyre ndihmës.”** (En Nisa, 145)

Shaqir Fetai është shumë koshient për mallkimin e Zotit që i ka rënë mbi kokë që nga momenti kur vendosi të bëjë veprën më të urreyer, kur tradhëtoi, kur bashkëveproi në hartimin e planit për ta rrënuar e shkatërruar një histori të tërë suksesi që e kishin arritur myslimanët e devotshëm tek të cilët ai u afrua si mercenar me mision të caktuar! Ndaj, tani, duke u tmerruar nga ky gjest e veprim, ai shpreson se do ta falë Allahu xh.sh. Se qenka falës dhe do ta falë, dhe pse Shaqir Fetai e di fort mirë se Allahu i Madhërishtëm llojin e Shaqir Fetait e ka paralajmëruar për dënimin që e pret dhe jo për falje!

Pa dyshim, të gjithë ata myslimanë të Turqisë dhe Sirisë që vdiqën në këtë tragjedi të tmerrshme, ata vdiqën si shehidë dhe, që të gjithë nuk kanë nevojë për kurrfarë lutje të Shaqir Fetait!

Po pse nuk u lut ky farë hipokriti edhe për të vdekurit e tërmetit në Siri! E mblodhi “Rijasetin” e vet dhe vendosi që të apelojë te popullata myslimane e vendit që të donojnë ndihma për të goditurit në Turqi! Por, jo dhe në Siri! Paska lëshuar edhe një letër qarkore deri te myhurbtë e vet që të apelojnë të mblidhen sa më shumë ndihma që t’i dorëzohen Dijanetit të Turqisë e këta popullatës turke të prekur nga kjo katastrofë! Por, jo dhe popullatës siriane!

Shaqir Fetai është në gjendje që të veprojë edhe më të pabërën nëse shpreson se do të falet nga Zoti për gabimet e pafalshme që i ka bërë!

Si mund të shpresojë në falje nga Zoti njeriu i cili ka marrur më qafë shokë e studentë myslimanë duke i spiunuar te UDB-a nën pseudonimin “ORAO”?

Si mund të shpresojë në falje të Zotit njeriu, si Shaqir Fetai, i cili ka vepruar gjënë më të urreyer te Allahu xh. sh., ka tradhëtuar, ka komplotuar dhe ia ka ngulur thikë pas shpine njeriut që e ka rritur fetarisht e profesionalisht, që e kishte lider fetar! Nuk ia tërhoqi vërejtjen në emër të Zotit por, si një kriminel profesionalist, ia nguli thikën pas shpine?

Si mund të presë falje prej Zotit njeriu, si Shaqir Fetai, i cili, duke e vjedhur, duke e hëgër, duke e falur, duke e shitur dhe duke e tëhuajësuar vakëfin, e ka degraduar institucionin fetar dhe e ka degjeneruar zhvillimin e jetës fetare islame në vend.

Si mund ta presë mëshirën e Zotit njeriu, si Shaqir Fetai, i cili, i rrenë medresantët duke ua humbur karrierën në jetën e mëtejme akademike.

Si mund të presë shpëtim njeriu, si Shaqir Fetai, i cili, ndonëse i njeh bashkëpunëtorët e vet, ndonëse e di që janë të pamoralshëm, spiunë, hajna, kriminelë, zhvatës, ai gati se është në

gjendje të lidhë kurorë me ta dhe të përfundojë në të njëjtin shtrat! A nuk është kjo përpjekje këmbëngultëse e Shaqir Fetait që ta mashtrorë Zotin Fuqiptotë!

Shaqir Fetai gjuhën dhe zemrën e ka në konfuzitet absolut. Allahu Fuqiptotë thotë: **“Ka prej njerëzve që thonë, “Ne i besojmë Allahut dhe jetës tjetër (Ahiretit)”, por ata nuk janë besimtarë.”**(El Bekare, 8). Pra, Shaqir Fetai, si mashtrues i dëshmuar katërcipërisht, atë që e thotë me gojë nuk e beson me zemër!

Shaqir Fetai mashtron! Sepse, nuk mund të jeshë spiun profesional nëse nuk mashtron, nëse nuk je egzibicionist! Sa herë të hap gojën ai mashtron, madje aq lehtësisht i jepet të mashtrorë sa edhe ta mohojë Atë që di gjithçka! Ajeti 9 i sures El Bekare thotë: **“(Përpiqen ta) mashtrojnë Allahun dhe ata që besuan, por nuk mashtrojnë tjetërkë pos vetes, dhe nuk e kuptojnë!”** Apo, ajeti 142 i Sures En Nisa **“Munafikët përpiqen të mashtrojnë Allahun (duke u paraqitur rrejshëm si besimtarë), por Allahu mbizotëron dinakëritë e tyre.”**

Shaqir Fetai dyshon në aftësitë e veta, e mohon përcaktimin e Zotit që nuk ia ka mundësuar kurrë të bëhet “reis” i përkrahur dhe i përzgjedhur, në emër të Tij, nga shokët e vet por, ndaj dhe, për ta nënvlerësuar këtë përcaktim të Zotit, në ndihmë e thërret pushtetin politik që për Krijuesin e Gjithësisë është ZERO!

Pikërisht ajetet 138-139 të sures En Nisa, flasin për tipin e Shaqir Fetait, dhe thonë: **“Ti (Muhammed) lajmëroj munafikët se me të vërtetë ata kanë një dënim të dhembshëm. Janë ata që, përkundër besimtarëve, i miqësojnë jobesimtarët. Vallë, a mos kërkojnë fuqi te ta? S’ka dyshim, e tërë fuqia i takon Allahut.”**

Dhe, edhe një herë, fare në fund, Shaqir Fetai po e gënjenë vetëm vetën e vet! Duke e ditur se me çfarë karakteristikash të djallëzuara është i “lular” ai edhe më tej shpreson se do ta falë Zoti! Kurrë! Ai sa më parë duhet të ikë, që mos të bëhet shkaktar që të sprovohet edhe më tej popullata myslimane e vendit, ndonëse Allahu Fuqiptotë fort mirë na e ka bërë të qartë: **“Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete...”** (Er Ra’d, 11) Pa dyshim, siç shpjegon më tej ky ajet, popullata jonë është e ndëshkuar prej Zotit me Shaqir Fetain. Nga ky mëkat duhet të lirohen sa më parë dhe, shfajësimi vjen vetëm pasi të ndërjegjësohen dhe ta shporrin sa më parë Shaqir Fetain nga Institucioni që e ka uzurpuar vetëm si hapësirë dhe pozitë për t’u tallur me vlerat e islamit në këtë nënqiell. /1KlikLarg/10.02.2023

**Editorial: Si tallet Shaqir Fetai me medresantët**

## **Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI**

**Katër muaj më parë, konkretisht, më 5 tetor të vitit 2022, paçavura e Shaqir Fetait botoi lajmin me titull: “NXËNËSIT E DIPLOMUAR NË SHMI “MEDRESEJA ISA BEU” – MUND TË PRANOHEN NË UNIVERSITETET E VENDIT (Video)” – bfi.mk - dhe, e bënë fakt të kryer se Medresja Isa Beu u akreditua, ndryshe, nuk do të mund të regjistroheshin medresantët nëpër fakultete të vendit**

Sot, ky lajm nuk ekziston më, është fshirë. Në faqen zyrtare të BFI-së (bfi.mk) ka ngelur vetëm si gjurmë për të dëshmuar për gënjeshtat dhe truqet e ulta të Shaqir Fetait! Do me thënë, i kanë rrejtur medresantët, e kanë rrejtur tërë popullatën e vendit, kanë rrejtur sepse e kanë profesion! Kohë më parë, sërish medresantët protestuan, shprehën revoltën e vet kundër këtyre rrenave. U ngritën dhe protestuan! BFI-ja e Shaqir Fetait asnjë fjalë, ndërsa Ministri i arsimit, z. Shaqiri, më 27 janar të vitit 2023 do të deklarojë: “PRESIM ELABORATIN NGA BFI PËR AKREDITIMIN E MEDRESESË, DERI TASH NUK ËSHTË DORËZUAR NGA BFI”!

Ka më shumë se dy-tre vite që na gënjejnë se gjithçka është dorëzuar, se tani projekti është në duart e deputetëve, se “u kry”, se qeveria aktuale e miratoi, se medresantët mund të regjistrohen... Tani na del puna se akoma nuk është gati elaborati dhe programi për akreditim të Medresesë.

Sa herë që ka situata të jashtëzakonshme, Shaqir Fetai shfrytëzon nga rasti dhe shpejt e shpejt mbanë mbledhje të jashtëzakonshme me “rijasetin” e vet! Dhe, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 7 shkurt 2023, paskan debatuar vetëm për dy pika të rendit të ditës:

Akreditimi i SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup;

Pasojat e tërmetit të trishtueshëm që goditi Jugun e Turqisë dhe atë të Sirisë.

Në pikën e parë paskan diskutuar gjërë e gjatë mbi elaboratin dhe programin mësimor për akreditimin e SHMI "Medreseja Isa Beu", pas të cilës unanimisht edhe e paskan miratuar. Pra, elaborati paska qenë gati por ja që Shaqir Fetait i është dashur një situatë e jashtëzakonshme që t'i thërrasë myhybtë e vet për ta miratuar elaboratin. Se pse është frikësuar që t'ua kryej më herët këtë siklet nxënësve të Medresesë këtë mund ta dijë vetëm i gjori Shaqir Fetai.

Pika e dytë e rendit të ditës ka nxjerrë në pah edhe një herë shpirtin katran të Shaqir Fetait. Edhe një herë katërcipërisht vërtetohet se Shaqir Fetai për islam e njeh vetëm interesin. Aty ku nuk ka interes as që do t'ia dijë për atë islam e për ata myslimanë. Prandaj, dua hatme, qarkore për ndihmë, mbledhje ndihmash ia dedikon vetëm vktimave të Turqisë dhe jo edhe të atyreve të Sirisë. Nga Siria nuk ka para për Shaqir Fetain, nga Turqia edhe mund të dalë diçk. Ky është Shaqir Fetai faqeziu!/**IKlikLarg/Fakte/11.02.2023**

**"Feja" e të djallëzuarit**

**Cili abdall në RMV beson se dikush i paska besuar punë Shaqir Fetait të cilin ky po e kryeka me nder e me sinqeritet! Shqiptarët dhe myslimanët asgjë nuk i kanë besuar Shaqir Fetait! Punën këtij farë narcisi ia besuan vetëm struktura të caktuara të pushtetit maqedonas, të cilën, nuk do të mund ta fitonte sikur paraprakisht mos ta kryente “tradhëtinë e madhe”! Ai duhej të dëshmonte se është alet i mirë i strukturave antishqiptare e me rrënjë që zgjatojnë nga UDB-ja**

***Nga Halid Sadiku***

A i ka hije Shaqir Fetait që të manipulojë me ajete e hadithe! Hadithet që interpretohen nga goja e Shaqir Fetait e humbin besueshmërinë dhe saktësinë! Nga njeriu i dyshimtë, i pasinqertë dhe hipokrit, edhe citimi i ajeteve kuranore duhet t’i merret me rezervë! Sepse, ky soj, ka ndërtuar edhe “xhami për t’u shkakuar dëm besimtarëve” (Et Teube, 107)!

E vërteta e pamohueshme gjithmonë, përjetë, ngelë si dëshmi! Është dëshirë e Allahut Fuqiplotë që ta mbajë të gjallë përjetë kujtimin, evidencën, mbi tradhëtinë, mbi spiunimin, mbi hipokrizinë, mbi gjithçka që ka ndaluar Ai! Si mund të harrohet data 27 maj e vitit 2020, ditë kjo kur Shaqir Fetai i priu tradhëtisë më të tmerrshme që ka përjetuar historikisht BFI-ja! Ta përdorë liderin fetar për të bërë karrierë, ta përdorë për ta mburrur kudo e kurdo, ta përdorë për ta njollosur e për ta zhytur sa më keq llugave, kurrë pa ia tërhqur vërejtjen, kurrë pa e këshilluar, kurrë pa e udhëzuar në të mirë, kurrë pa e kritikuar qoftë edhe islamikisht dhe, fare në fund, “ta shpëtojë islamin” duke ia ngulur thikën prapa shpine, duke e njollosur e katranosur po atë, për të cilin, një javë më parë kishte folur si për një figurë markante të fesë e të kombit, me të cilin një javë më parë kishin falur bashkarisht bajram...

Vërtet, cila fe e Shaqir Fetait e proklamonte këtë sjellje prej kriminelit?! Cila fe e Shaqir Fetait thotë që, atë që e plagosi duke e plandur rëndë mbi dhe, tashmë nuk duhet të takohet dhe as të përshëndetet, qoftë edhe me një selam siç i jepet një plaku të shtyer në moshë! Pse e predikon këtë “fe” Shaqir Fetai! Vetëm kriminelët ia kanë frikën viktimës, vetëm tradhëtarët e spiunët ruhen nga viktimat e tyre, vetëm vrasësi i cili ka ngritur dorë mbi udhëheqësin e vet, ka frikë që të përballlet me të, nuk i lë as bashkëpunëtorët e vet që ta përshendesin ish-udhëheqësin e tyre, sepse edhe ata i ka përdorur dhe i ka përllyer në një punë të pistë!

Cila “fe” e Shaqir Fetait thotë që personin të cilin e ke plaguar, ndonëse e ke shënjestruar për ta vrarë fare, nuk duhet të ftohet në ndonjë event fetar si lider i dikurshëm, cila “fe” e Shaqir Fetait thotë që ndaj tij duhet “ngritur” tërë respektin dhe nderin!

Cila “fe” e Shaqir Fetait lejon që të shpifet, që të eliminohet konkurrenca me lloj-lloj intrigash, që të dëbohen njerëz nga puna duke i spiunuar se si pijnë kafe me personin që nuk ia njeh “fenë” Shaqir Fetait!

Cila është ajo “fe” që ia lejon Shaqir Fetait ta shkatërrojë vakëfin, ta shesë, ta shpenzojë për veprime antiislame të Shaqir Fetait! Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait e cila ia lejon vjedhjen e haxhit, duke bërë marrëveshje për hotelet me “matrapazët” të cilët i kanë marrur qysh më herët dhe ia ofrojnë “nën rogoz” Shaqir Fetait?

Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait që ia lejon që të grabiten myslimanët e vendit në emër të kurbanëve, të cilët, jo që nuk i therrë, por edhe ato që i ka therrur ua keqpërdor mishin duke zhvilluar “humanitet personal”!

Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait që e urdhëron në deinstitutionalizim të jetës fetare dhe në deorganizim të xhematit, duke lejuar “lulëzimin” e lloj-lloj sekteve dhe duke i institucionalizuar këto dukuri të tmerrshme për myslimanët e vendit!

Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait e cila ia bën hallall vjedhjen nxënësve të Medresesë, i detyron të paguajnë shkollim të cilin nuk ia njeh as Fakulteti “i vet”!

Cila është ajo “fe” e Shaqir Fetait e cila ia ndriçon skenën tek nusëron e bën temena para oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviçit, para oficerit më të tmerrshëm për shqiptarët e Maqedonisë Perëndimore, Temellko Boshkovskit, e deri te komandanti i “branitellave”, Stojançe Angellov, me të cilin, së bashku i gjykuan brohoritjet e protestuesve shqiptarë “Shqipëria etnike” dhe “UÇK-UÇK”, kurse, asnjë fjalë nuk i doli nga goja kundër protestuesve maqedonasë që orkestruashin nga strukturat ruse në brohoritjet “smrt za shiptari”, “gasna komora za shiptari”... Nuk ka mysliman dhe shqiptar në RMV që e do “fenë” e Shaqir Fetait, sepse, të gjithë e dinë se ku e ka burimin “feja” e tij! Të gjithë faktet flasin se, Shaqir Fetai me nder e me sinqeritet i ka kryer vetëm ato punë që ia ka besuar Stanko Dragoviçi dhe loza e tij!/**Kombetare/15.02.2023**

**Shaqir Fetai "vërshon" bibliotekat botërore**

**Sado që Shaqir Fetai përpiqet të zhvillojë sulme hibride mbi faqen 1kliklarg.com (si dhe mbi të gjitha ato portale që po e demaskojnë ditë e më shumë!), sepse ai paguan para të majme që të zhduken këto faqe elektronike dhe të fshihen të gjitha shkrimet demaskuese për të, tash ai duhet ta dijë se është bërë “lëndë studjuese” për mbarë njerëzinë e botës, sepse, tashmë profili i tij i “përmbledhur” mjeshtërisht në tri libra, gjendet anekënd bibliotekave të botës. Libri i katërt është në përgatitje e sipër!**

### ***Nga Kushtrim Nela***

Korporata për Produksion, Informim dhe Botim, “1kliklarg”, në javën e parë të fillimvitit është informuar nga Biblioteka Kombëtare e Tiranës që, botimi ynë me titull “TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË PANDEMIE”, pasi u është ofruar bibliotekavë të ndryshme botërore për këmbim titujsh, si formë e bashkëpunimit ndërinstitucional, është kërkuar nga një numër i madh i bibliotekave botërore, si dhe nga të njëtat është kërkuar që t’ua dërgojmë edhe dy titujt e tjerë që i botuam vitin e kaluar: “NUSPRODUKTI I NJË KOMPLOTI DHE TRADHËTIE” dhe, “KËSHTU FOLI SHAQIR FETAIT”!

Meqë titujt e lartpërmendur kanë ISBN numrin si dhe janë katalogizuar në këtë Bibliotekë, ne si Korporatë edhe për Botim kemi qenë të obliguar që të dorëzojmë tirazhin e caktuar në Bibliotekën Kombëtare prej nga janë distribuar institucionalisht në të gjitha ato biblioteka ndërkombëtare që i kanë kërkuar në shenjë bashkëpunimi ndërbibliotekar duke këmbyer tituj me interes për secilën bibliotekë.

Kësisoj, këta tre tituj tashmë gjenden në këto biblioteka ndërkombëtare: Biblioteka Shkencore Universitare Shtetërore e Tiranës, Cambridge, University Library, Cambridge, British Library, Boston, The British Library, London, The Library of Bradford, Nacional Library of Scotland, Edinburgh, Nacional Library of Australia, Osterreichische Akademie der Wissenschaften, Osterreichische Nationalbibliothek, Wien, Association Internationale des Juristes Demokrates, Bruxelles, Bibliotheque Rojale Albertler, Bruxelles, The Royal Library, Copenhagen, Cairo University Central Library, Giza, Helsinki University Library, Helsinki, Akateeminen Kirjakauppa, Helsinki, Bibliotheque Nationale, Paris, Bayerische Staatsbibliothek, Mynchen, Deutsche Forschungsgemeinschaft, Bonn, Universitätsbibliothek der Humboldt-Universität zu Berlin, Universitäts- und Statsbibliothek, Keln, Deutsche Nationalbibliothek, Leipzig, Staatsbibliothek zu Berlin, Biblioteca Apostolica Vaticana, Universitaria Alessandrina, Romë, International Exchange Bureau, Rojal Library, The Hague, Akademia Roana, Bucuresti, Biblioteca Centrala Universitara din Bucuresti, Karolinska Institute Library and Information Center, Stockholm, Bibliotheque Nationale Serice des Echanges et Dons, Tunisie, The Library of Congress, Washington, The New York Public Library, New York, British Library, Boston, The British Library, London etj.

Ndryshe, libri i parë, TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË PANDEMIE, ngërthen në vete mbi 220 njësi shkrimi, të natyrave të ndryshme: opinione, intervista, reagime, analiza, komente, deklarata etj, të publikuara në mbi 36 portale gjithëkombëtare, edhe atë duke filluar nga data 27 maji e vitit 2020 deri më 26 maj të vitit 2021, e që i dedikohen që të gjitha Shaqir Fetait, i cili, pas një puçi dhe komploti spektakular, arriti që, falë ndihmës nga pushteti aktual maqedonas, të instalohet në krye të BFI-së me qëllim që t’i pengojë proceset e parapara për një reformë të thellë e gjithëpërfshirëse të Institucionit në fjalë. Libri është si një arkiv më vete, që flet për një tentativë e cila gjithësesi që do të dështojë por që synon lëndimin dhe “trullrosjen” e jetës fetare islame institucionale në vend.

Një pjesë bukur e madhe e librit i kushtohet veprimeve antiinstitucionale, antikushtetuese dhe pro-politikave qeveritare të Shaqir Fetait, i cili, lojën e fillon duke akuzuar se pararendësi i tij paskësh shkelur nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së, ndërkohë që, vetë ai, brenda një periudhe fare të shkurtër, do të shkelë 58 nene të Kushtetutës së BFI-së.

Botimi do të shërbejë si literaturë bazë për të gjithë ata studiues që një ditë do të vendosin të shkruajnë për një periudhë të caktuar nga e kaluara e BFI-së, periudhë kjo që do të përceptohet, pa fije dyshimi, si më e zymta dhe më tragjika në historinë e Institucionit të BFI në RMV. Qëndrimet e “institucionit” (sidomos kur ai është i politizuar) gjithnjë kanë qenë, janë dhe do të jenë shumë irelevante në krahasim me qëndrimet e opinionit, të cilat zakonisht merren si bazë dhe si fakte relevante.

Libri, qoftë si botim fizik, qoftë ky si botim elektronik, TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË PANDEMIE, do të jetë, pa dyshim, ndër librat burimorë dhe më i cituar në hulumtimet e ardhshme për të kaluarën e zymtë të BFI-së! Sepse, botimi faktom me ditë e me data ndodhitë nga më të ndryshmet rreth dhe brenda BFI-së, që kur pushteti maqedonas do ta instalojë marionetën e vet, Shaqir Fetain, në krye të BFI-së.

Edhe libri i dytë “NUSPRODUKTI I NJË KOMPLOTI DHE TRADHËTIE”, është, në fakt, përmbledhje e rreth 200 shkrimeve të publikuara brenda një viti nëpër portale të vendit dhe të rajonit e që zbardhin të gjitha pasojat që nga momenti kur Shaqir Fetai pranon të bëhet marionetë e pushtetit maqedonas që e kishte ëndërr shekullore për t’i futur duart në Institucionin e BFI-së. Keqpërdorimi i fitrit dhe zeqatit, vjedhja e haxhit dhe kurbanëve, vjedhja, përvetësimi dhe shitja e vakëfit, shkeljet e përditshme të Kushtetutës së BFI-së dhe akteve normative të saj, manipulimi dhe shantazhimi i organeve të BFI-së, instalimi nëpër organe i individëve me vlera të dyshimta morale e njerëzore, devaluimi i organeve, institucioneve, sektarizimi i shoqërisë, dezorganizimi i xhematit, tallja me ndërkombëtarët, shndërrimi i BFI-së në eshalon i tretë e i parëndësishëm i pushtetit maqedonas, partizimi dhe politizimi i skajshëm e në mënyrë naive i BFI-së, angazhimi i gjithësecilit nëpunës të BFI-së për ta dëshmuar lojalitetin partiak si mënyrë e mbijetesës në BFI – pra, të gjitha këto dukuri si dhe një sërë dukurish të tjera që do të jenë objekt i editorialeve dhe analizave në të ardhshmen, janë lajtmotiv i kësaj përmbledhje të shkrimeve si dhe të sërë shkrimeve të tjera që nuk u përfshinë në këtë libër elektronik.

Pa dyshim që, ky libër, si materie e gjallë, që do të flasë për kohën dhe për një person i cili, duke pasuar rrugëtimin e Haxhi Qamilit, u angazhua që ta katandisë BFI-në në një “ojq” të rëndomtë e pa kurrfarë peshe në shoqëri.

Bazuar mbi aftësinë për të gënjyer, për t’u shtirur, bazuar në hipokrizinë dhe analfabetizmin e vet, Shaqir Fetai u përpoq që të “krijojë” një BFI sipas modeleve të imponuara nga subjekte të dyshimtë por që i garantonin karrierë prej “reisi”!

Në vllugun e përpjekjeve për ta dëshmuar veten si “engjëll”, Shaqir Fetai, instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, kishte vendosur që të zhvillojë “aktivitete” ku do ta nxirrte në pah kapacitetin e vet “intelektualo-organizativ”! Do të takonte njerëz për të pirë çaj e për të zhvilluar ndonjë dorë muhabeti nga ato “filozofemat” që Shaqir Fetai i ka origjinale të vetat! Çka dëshmojnë ato “filozofema”? Asgjë, përveçse injorancën e Shaqir Fetait! Portali

“Kombetare.com”, u përkujdes për “perlat” e tij duke hapur një rubrikë me titull “KËSHTU FOLI SHAQIR FETAIT”, në të cilën do të analizohen “perlat e mendimit” të “reisit” të instaluar pas puçit dhe komplotit që e bëri në BFI! Natyrisht, titulli i rubrikës do të jetë një intertekstualitet i nxjerrur nga “Kështu foli Zaratrusta” i Niçes!

Po çka në të vërtetë foli Shaqir Fetai? Vetëm rrena, sepse përmes rrenave ai i shëron komplekset, duke i shëruar komplekset ai e mëton “devotshmërinë”! Po si të arrihet përmes rrenave deri te “devotshmëria”?

Libri, KËSHTU FOLI SHAQIR FETAI le të shërbejë ky libër si “doracak” për të gjithë ata që dëshirojnë ta tejkalojnë qoftë për një milimetër sojin e Shaqir Fetait, sepse këtu do të vërejnë se nuk ka më tmerr se ajo nëse përsëritet Shaqir Fetai!

Sado që Shaqir Fetai përpiket të zhvillojë sulme hibride mbi faqen 1kliklarg.com (si dhe mbi të gjitha ato portale që po e demaskojnë ditë e më shumë!), sepse ai paguan para të majme që të zhduken këto faqe elektronike dhe të fshihen të gjitha shkrimet demaskuese për të, tash ai duhet ta dijë se është bërë “lëndë studiuese” për mbarë njerëzinë e botës, sepse, tashmë profili i tij i “përmbledhur” mjeshtërisht në tri libra, gjendet anekënd bibliotekave të botës. Libri i katërt është në përgatitje e sipër!/**1KlikLarg/17.02.2023**



## Shaqir Fetai e depersonalizo i tërësisht BFI-në

**“Është jashtë çdo parimi islam e kombëtar përkrahja që i jepet prej disa të mjeranëve që nuk po dinë se çfarë po bëjnë. Po mendojnë se po japin kontribut për islamin në vend, e në fakt, po kontribuojnë që të trashet zullumi dhe xhepat e atyre të pafytyrëve që i tërheq zvarrë Shaqir Fetai. BFI-në e ka shëndërruar, nga ku ishte si qender islame, në qendër të rrenave të bajatshme”**

### *Nga inbox-i:*

*Gjatë vikendit, në inbox-in e Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI ka ardhur një letër e shkruar nga nëpunës i Shaqir Fetait, i cili lutet që mos t’ia publikojmë autorësinë, sepse, Shaqir Fetai ata që nuk pajtohen me të, sakaq i shpallë për armiq dhe i largon nga puna! Sipas letërshkruesit BFI-ja po vlon nga korrupsioni, nga vjedhja, nga tradhëtia, nga shitja e interesave fetare e kombëtare, nga zhvatja, nga nepotizmi...*

*Për më tepër, ja letra:*

“Të dashur muslimanë! Ajo që më shtyri t’ju shkruaj ishte një bisedë të cilën e dëgjova derisa po prisja jashtë, në kabinetin e shefit të reisit, ndërsa brenda hynë ca nëpunës të tjerë dhe po flisnin me Shaqir Fetain. Ishte momenti kur sapo e përcollën ambasadorën e Amerikës në Shkup! Njëri i tha:

“Reis, kjo që diplomatët po i pret me Mustafën (Dautin) dhe Ismetin (Ademi), besa edhe me Irsalin, kjo nuk të bën nder hiç. Ti sikur po tallesh me ndërkombëtarët. Del te shkallët në foto me zonjën ambasadore ndërsa në foto edhe Mustafa Dauti, Ismet Ademi, Irsal Jakupi! Po ju shumë mirë e dini se si po keqpërdoren fotografitë, po analizohen e pastaj po i merr fund karriera diplomatit”!

“Ata po vinë për mua, po vinë te unë, ata e dinë që unë jam kristal i pastër. Edinë edhe faktin që unë i kam gjetur ata këtu, nuk i kam prodhuar unë kaq të rrezikshëm! Ku t’i çoj, ata më përkahin, e përkrahin politikën time, apo mendoni se jam naiv që t’i eliminoj e të ma jepni hyxhymin pastaj! Le të jenë të poshtër, të rrezikshëm, hajna, pisa, janë për vete. Mua më nderojnë e më përkrahin. Do t’i nderoj edhe unë” – u përgjegj Shaqir Fetai!

Mustafa Dauti ka qenë i përjashtuar nga BFI për vjedhje të ndihmave humanitare. Ish-reisul ulema është njohësi më mirë i Mustafa Dautit! Ai e thotë me emër se bashkëpunëtor i cilit oficer i shrbimeve inteligjente është Mustafa Dauti, se si e kanë rekrutuar shërbimet në BFI, se sa ka vjedhur nga ndihmat, si në artikuj ashtu edhe në para, se cila është pasuria e tij e paligjshme, e cila ishte lidhja e tij me grupet e dikurshme kriminele dhe me narkodilerët në Strugë. Dihet se cili është niveli i moralit të tij dhe kapaciteti mental për të punuar në BFI dhe, nuk ka diplomat që nuk i ka informacionet se, sapo të përfundojnë takimet në mes të Reisit dhe diplomatëve, menjëherë raportohen shërbimet inteligjente të vendit. Ambasadorja e Amerikës të pritët me Mustafa Dautin?!

Si guxon Shaqir Fetai të ftojë Ismet Ademin që të fotografohen së bashku me zonjën ambasadore amerikane kur edhe zogjtë e malit e dinë se kush është Ismeti, sa është sektarian dhe ekstremist dhe, Shaqir Fetai (këtë na e ka treguar vetë) e di se ai ka qëndruar një vit në burg në Arabinë Saudite ku edhe është rekrutuar si alet i shumëfishtë. Ai mund ta shkurtojë e rrumcavë mjekrën

që e kishte deri në kërthinzë, por ama “ideologjinë” e ka të gjatë që të arrinë në palcë e të degjeneron!

Arkitekti i vjedhjeve të aksioneve fetare në BFI pa dyshim që është Irsal Jakupi, të cilin të gjithë myslimanët e vendit e thërrasin “Bagdatski llopov” (Vjedhësi nga Bagdadi)! Ai me pempele është zënë se si në BFI ka ardhur për ta vjedhur haxhin, dhe e vjedh hatashëm. Ai ka ardhur për ta vjedhur fitrin e zeqain dhe, i vjedh pa fije frike nga Zoti i Gjithëdishëm! Ai formon komisione për tubimin e pasaportave, për vënien e vizave arabe si dhe për shitjen e vizave që i merr gratis. Po me këta tipa, si dhe me disa të tjerë që Shaqir Fetai i ka korruptuar deri në fyt, takohet edhe me diplomatë të tjerë, e liderë partishë, me Ali Ahmetin...

Shaqir Fetai gënjenë pa pikë turpi kur thotë se zonja ambasadore i paska dhënë përkrahje në përpjekjet e BFI për t’i zbutur anomalitë e ndryshme! A nuk është anomali edhe regjistrimi i disa “bashkësive islame”, i disa sekteve e frakcioneve, madje regjistrimi i tyre në regjistër zyrtar, të cilët po veprojnë dhe po thiren në emër të islamit, e drejtë kjo dikur ekskluzive e BFI-së? Shaqir Fetai nuk angazhohet në shlyerjen e tyre, në ndjekjen e manipulantëve që me plotë gojën islam po u shëbejnë qendrave ideologjike të huaja që nuk kanë kurrfarë pikëtakimi me interesat kombëtare, me synimet e kombit tonë për t’u futur në gjirin e popujve të BE-së por, po i mjaftuaka që t’i zbusë raportet me ato anomali! Dhe këtu e paska gjetur përkrahjen nga ambasadorja amerikane? Rrenë, natë e ditë rrenë! Apo, dëshiron të thotë se BFI dhe ai po u angazhuakan shumë për ta luftuar ekstremizmin dhe radikalizmin islam! Le ta numërojë vetëm një angazhim në këtë drejtim! Janë me qindra ekstremistë e radikalistë të punësuar në BFI, që tashmë xhamitë i kanë shndërruar në gjithçka: në vend propagande, në agjenci turistike, në zyre pune... Këto janë anomalitë më të tmerrshme që po ndodhin e që po i mbulon me plaf qenësh Shaqir Fetai.

Paska biseduar edhe për agresionin rus në Ukrainë! A i tregoi ambasadores se pse, një muaj para agresionit, Shaqir Fetai i pranoi në zyrë miqtë e Putinit. A i tregoi se sa hoxhallarrë të tij publikist e përkrahën Putinin dhe e propaguan si luftë të drejtë të tij kundër Ukrainës. A i tregoi se kur reagoi Shaqir Fetai kundër kësaj përkrahje që Putinit i shkonin nga organet e BFI-së! Shaqir Fetai thotë se me ambasadën amerikane paskan prioritete të përbashkëta! Ku i di Shaqir Fetai se cilat janë prioritetet e ambasadës dhe, cilat janë prioritetet e BFI-së! Le ta numërojë vetëm një prioritet!

Po, prioritetet e Shaqir Fetait janë ku të gjejë edhe një mundësi për ta zhvatur ndonjë investitor siç ia bëri arabëve që i erdhën në Gostivar për t’ia ndërtuar një qendër tregtare me vlerë disa miliona dollarë dhe t’ia lënë vakëf Myftinisë, por që i rjopi dhe i detyroi të ikin!

Po, Shaqir Fetai ka një prioritet: si të marrë edhe do letra me vlerë në shenjë denacionalizimi të pronave që kanë ngelur hala pa u kthyer nga shteti, që të ketë mundësi edhe një vjedhje të mirë ta bëjë.

Prioritet e ka si të ndërtohen sa më parë ndërtesat te ish-Komunaleci, sepse bashkëpunëtorët e tij ngelën duke i pritur banesat që i kanë marrur për vete e që në fakt duhet të jenë vakëf i Myftinisë së Shkupit.

BFI-në Shaqir Fetai e ka shndërruar në një shesh pazari të fëlliqtë. Është jasht çdo parimi islam e kombëtar përkrahja që i jepet prej disa të mjerëve që nuk po dinë se çfarë po bëjnë. Po mendojnë se po japin kontribut për islamit në vend, e në fakt, po kontribuojnë që të trashet zullumin dhe xhepat e atyre të pafytyrëve që i tërheq zvarrë Shaqir Fetai. BFI-në e ka shëndërruar nga ku ishte si qender islame, në qendër të rrenave të bajatshme”, përfundon letra e këtij nëpunësi të BFI-së!"

P.S.

Letra të këtillë, madje me emra e mbiemra, vazhdimisht vijnë në inbox-in e LMR në BFI, por që nuk i kemi marrur aspak serioze. Na duken tamam letra mynafikësh! Nuk janë të nevojshme letrat e këtilla, me lutje që të ruhet anonimiteti, sepse Shaqir Fetai po i larguaka nga puna! Ngrituni pra të gjithë dhe largojeni ju Shaqir Fetain nga puna. Ai është një, ndërsa nëpunësit janë me qindra! Në fakt, bëhet fjalë për faktor që i dirigjon dhe që mund të hidhërohet nëse nxiten përçarjen brenda “trungut” të Shaqir Fetait. Frika është nga ai “faktori” dhe jo nga Shaqir Fetai fuqia e të cilit është sa përpëlitjet e bishtit të këputur të xhapikut!

**/LMR në BFI /1KlikLarg/18.02.2023**

**Medreseja si karrem**

**Nxënësit e Medresesë “ISA BEU” që protestuan kundër politikave të Shaqir Fetait i cili assesoi t’ia dalë që ta akreditojë këtë vatër arsimore dhe të mos kenë problem medresantët për t’u regjistruar nëpër fakultetet e universiteteve të vendit, kohëve të fundit po kërcënohen dyfish: me thyerje të notës së sjelljes për shkak të protestimit si dhe me largim nga shkolla nëse i tregojnë dikujt për këtë masë disiplinore**

***Nga Nurxhan Sejfullahi***

Çka i duhet Shaqir Fetait Medresja e Shkupit? Është e paqartë se pse “insiston” aq shumë për akreditimin e Medresesë derisa çdo vit numri i të interesuarve për t’u shkolluar në Medrese po bie në mënyrë drastike.

Që kur u instalua nga pushteti politik në krye të BFI-së Shaqir Fetai është bërë një pengesë e patejkalueshme për të gjithë ata që dëshirojnë të pajisen me diturinë bazë për fenë islame dhe pastaj, pas pjekurisë, të vazhdojnë atje ku kanë dëshirë. Kjo dëshirë nuk po u plotësohet pasi që ekziston një vendim qeveritar që i pengon medresantët të vijojnë studimet, madje këtë pengesë e kanë edhe për të vazhduar në Fakultetin e Shkencave Islame!

A e keni parë ndonjëherë Shaqir Fetain tek brengoset për këtë padrejtësi dhe për këtë shkelje institucionale të të drejtave të medresantëve? A e ka ngritur diku zërin Shaqir Fetai? A ka pritur ndonjë nga asociacionet për të drejtat e njeriut siç i pret disa brithyer që i shkojnë për t’u fotografuar me “manikinin” tek pijnë çaj rusi? A ka kontaktuar me avokatin e popullit, me dikë nga Komiteti i Helsinkut, a ka kontaktuar me shoqatën e nxënësve të shkollave të mesme; a mos i ka organizuar hoxhallarët që një të premtë të flasin e ta ngrisin zërin të gjithë hoxhallarët në qyrsi! A mos ka thirrur për ndonjë protestë para kuvendit e para qeverisë! Jooo, nuk guxon se mund ta hajë ndonjë shkop b...

Shaqir Fetai nuk guxon t’ia prishë pushtetit politik, madje nuk dëshiron që këtij pushteti t’i bie as kokrra e pluhurit. Edhe sikur të mbyllet fare medresja, madje edhe FSHI, Shaqir Fetai vetëm duhet t’i duartrokasë pushtetit politik, sepse, ky mendon dhe funksionon për këtë pushtet e jo për Medresenë!

Ky qëndim idiotik i Shaqir Fetait, ka nisur t’i depersonalizojë edhe arsimtarët e Medresesë, edhe personelin teknik të kësaj vatre arsimore! Meqë numri i nxënësve po bie vit për vit, si pasojë e emigrimit, meqë numri i nxënësve po bie vit për vit si pasojë e pamundësisë për të vijuar studimet e mëtejme, Shaqir Fetai ka kërkuar nga profesorët që të vihen në aksion dhe të sigurojnë nxënës, ndryshe, do të ngelin pa punë, sepse do të duhet të mbyllen paralele! Tani, profesorët po u bëjnë presion hoxhallarëve që të kërkojnë nga prindërit që të dërgojnë fëmijë në medrese, pavarësisht që u nxihet jeta atyre, sepse, të përfundoshë karrierën vetëm me një Medrese është gjë e trishtë. Shaqir Fetai nuk e ka Medresenë për të përgatitur kuadër profesional për nevojat e BFI-së, sepse tashmë këto nevoja janë përmbushur katërcipërisht, por e ka për t’i mbajtur në punë profesorët e medresesë, sepse, nëse ngelin pa punë automatikisht kalojnë në armiqësi me Shaqir Fetain. Kjo e tmerron këtë avdall dhe jo mospasja mundësi e medresantëve për të vijuar studimet akademike.

Aktualisht, në BFI ka me dhjetra pensionistë që vazhdojnë të punojnë, madje ka pensionistë që marrin pension por që akoma janë të angazhuar në BFI dhe që marin rrogë! Sepse, këta pensionistë puthadorësh janë marioneta të Shaqir Fetait i cili e di fare mirë se nëse i dalin marionetat nga dora, përfundon loja!

Në anën tjetër, janë dhjetra e qindra medresantë që nuk i shërbejnë BFI-së, që janë të kyçur nëpër administratë e nëpër punëra të shtetit, janë me dhjetra e qindra të tjerë, madje me fakultete teologjike e me master, që presin të gjejnë ndonjë punë, që nuk ftohen të japin kontribut në BFI vetëm për faktin që nuk e pranojnë Shaqir Fetain dhe që nuk e bëjnë hesap as për roje magazine! Çuditërisht, asnjë nga institucionet fetare të vendit nuk insiston dhe nuk pranon që shkollat e tyre të akreditohen nga shteti. Nuk duan që programet shkollore t'ua diktojnë politika, nuk duan që shteti t'i fusë duart nëpër shollat e tyre të mesme fetare. Ndërsa këtë kënaqësi mezi pret ta përjetojë Shaqir Fetai! Faqeziu mezi pret që Medresenë ta fusë nën sjetull të pushtetit politik i cili, jo që nuk ka lidhje me islamin por që nuk e duron fare islamin. Kjo arpipori do të ndikonte në rrënimin e institucionit të fitrit dhe të zeqatit si dhe të kontributeve të tjera, sepse, deri më sot i ka kërkuar këta kontribute për mirëmbajtjen e Medresesë! Mezi pret financa nga shteti, sepse, burimin kryesor, vakëfin, si premisë për zhvillimin e jetës fetaro-arsimore në vend, e ka shkatërruar tërësisht. Për të gjithë këto probleme tash e sa vite na flet e na sinjalizon Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, porse myslimanët e vendit sikur nuk dëshirojnë të vetëdijësohen. Këta myslimanë akoma nuk kanë parë gjë, akoma nuk janë të vetëdijshëm se çfarë do t'i gjejë me Shaqir Fetain. Ky është i gatshëm të pranojë dhe të kontribuojë deri në polarizim të skajshëm brenda familjar. Ky nuk do të kënaqet përderisa nuk do të shikojë se si djali ngre patllakun kundrejt babës apo, anasjelltas. Sepse, një të riu apo një të reje t'ia mbyllish të gjitha mundësitë e shkollimit akademik, kjo vërtet që trazon mallkime mbi gjithkë që bëhet shkaktar të mbarohet një shkollë e mesme pa kurrfarë perspektive. Dështimi dhe rrënimi i BFI-së e ka emrin Shaqir Fetai! /1KlikLarg/04.03.2023

## **A mund të konvertohen dështimet në suksese**

**Kur shkeljet ligjore, ato statutare e kushtetuese, kombinohen me amatorizmin që sforcohet me gjakimin për rrënim institucional, atëherë na paraqiten situata tragji-komike! Më e trishtë se çdo gjë tjetër, në të tilla situata, është heshtja, heshtja që nënkuptohet si miratim i strategjisë rrënuese**

***Nga Fejzi Salihu***

Rijaseti i Shaqir Fetait paska mbajtur një mbledhje të rregullt, edhe atë, në “përbërje të plotë”, “përbërje” kjo që rezulton nga shkeljet më brutale të Shaqir Fetait mbi Kushtetutën e BFI-së! Madje, për ta dëshmuar këtë “përbërje të plotë”, i është bërë zakon që në fund të mbledhjes, të bëjnë një foto të përbashkët para shkallëve të BFI-së. Në fakt, pse e përsërit këtë gjest Shaqir Fetai? Është gjest sa për ta dëshmuar “unitetin” apo, të tjera mesazhe përcjell Shaqir Fetai, mesazhe këto që shpreson se do të futen edhe në analet e BFI-së!

Mesazhi i parë është për opozitarët dhe ka këtë përmbajtje: “ju që po përpiqeni me aksione diversante të më futeni në terren, ja, shikoni, kam përkrahjen e organit tim që e kam formuar vetë, për qejfin tim, sipas qejfit tim dhe në shërbim të qejfit tim”! Dhe, mesazhi i dytë, më objektivi: “Unë jam i duhuri, sepse vetëm një si unë mund t’ia dalë me injorantët që përbëjnë Rijasetin tim, prej të cilëve, minimum 5 vetë (përfshirë edhe mua, Shaqir Fetain) janë spiunë, me emër e mbiemër që hasen nëpër dosjet e intelektualëve tanë”!

Veç tjerash, Shaqir Fetai dhe dukurit e tij në këtë mbledhje paskan konstatuar se viti 2022 paska qenë viti më i suksesshëm në historinë e BFI-së!!!

Shaqir Fetai, përmes vetëlavdërimit, përmes masturbimit mental prej psikopati, përmes rrenës që tashmë e ka ngritur në nivel institucional, përmes taktizimeve të mësuara nëpër kurset e UDB-së, përpriqet që ta kamuflojë atë që nuk duron kurrfarë petku të fëlliqtë – të vërtetën!

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, edhe më tej, me sukses po ia del ta shkelë Kushtetutën e BFI-së, të punojë e të veprojë jashtë normave, rregullave e dispozitave islame dhe të BFI-së?

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, për herë të parë kemi protesta të nxënësve të Medresesë, sepse me vendim të qeverisë e cila e instaloj Shaqir Fetain në krye të BFI-së, nuk po ia dalin të regjistrohen në asnjë fakultet të universiteteve të vendit, madje as në FSHI?

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, ja që ia doli veturën zyrtare prej 10-15 mij euro ta paguajë me 30 mij euro?

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, ish-objekti i Myftinisë së Shkupit po degradon deri në shtëpizë qenësh endacakë?

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, vakëfi ku më parë ishte ish-Komunaleci për momentin është falur dhe nuk gjeneron kurrfarë të ardhurash për Myftininë e Shkupit (me përjashtim që ka “gjeneruar” dhjetra banesa që janë vjedhur prej honxhobonxhove të Shaqir Fetait)?

A është i suksesshëm viti 2022 që në planin e realizimit të aksioneve fetare dështoi plotësisht: më pak fitra, më pak zeqat, më pak kontibute dhe me një çmim prej hadjuku e kriminelit për Haxhin e vitit 2022?

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, ia doli të tubojë më tepër kurbona? Le të supozojmë se kjo është e vërtetë! Çfarë suksesi ka këtu kur dihet se bëhet fjalë ekskluzivisht për devotshmërinë e myslimanëve tanë!

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, megjithatë ia doli që në Haxh të këtij viti të bëjë një tregëti të hatashme prej nga përfituan ai dhe idoli i tij në hajni, Irsal Jakupi, qindra mijëra euro?

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, pikërisht në këtë vit e shpikën metodën e vjedhjes më të lehtë duke mos e caktuar çmimin e haxhit deri pak para nisjes?

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, ja që ia doli me sukses ta fragmentarizojë dhe ta sektarizojë shoqërinë myslimane, duke lejuar dhe stimuluar formimin e turli farë “bashkësive fetare islame”, madje edhe duke institucionalizuar fraksione e xhami private?

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, për herë të parë gjatë këtij viti dolën muhabetete se dikush në BFI-në e Shaqir Fetait po merret me kriminalitet, duke transportuar ilegalisht refugjatë sirianë, afganë etj. nga Turqia për në Kosovë e Shqipëri dhe se, aktualisht janë në kërkim të shoferëve të kamionëve transportues?

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, mori disa premtime se nga viti 2023 do t'i lëshohen edhe disa letra me vlerë, meqë ato të vitit 2018, 2019, 2020, 2021, gjatë vitit 2022 i bëri rrush e kumbulla! Nuk bleu asnjë pronë, me asnjë metë katëror nuk e shtoi vakëfin nga ato para që i mori si denacionalizim të pronës!

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, duke i dëbuar arabët meqë u përpoq që t'i vjedhë, tash e dhjetë vite parkingu në qendër të Gotivarit ngeli parking dhe jo qendër tregëtare të cilën arabët dëshronin ta ndërtonin dhe t'ia falnin Myftinisë së Gotivarit si vakëf!

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, ja që ia doli ta blejë një “myfti” për 30 mij euro, kurse një tjetër “anëtar” Rijaseti me 70 mij euro!

A është i suksesshëm viti 2022 për Shaqir Fetain se, këtë vit nuk ia doli ta ngulë asnjë baski në xhaminë e Tophanës?

Nëse Shaqir Fetai është i bindur se ka pasur një vit shumë të suksesshëm, pse atëherë këtë e konstaton me honxhobonxhot e tij. Ky konstatim duhet të vijë nga një audit i jashtëm, dhe jo nga ata që i ka korruptuar, i ka blerë e i ka zhatur deri në fyt nëpër punë të pista.

Viti 2022 mund të thuhet se ishte i suksesshëm vetëm në zbardhjen e të gjitha veprimeve mediokër, diletanteske dhe shumë të rrezikshme të Shaqir Fetait, përmes qindra shkrimeve, analizave, opinioneve që u përblodhën në dy vëllime tashmë të botuar e të distribuar nëpër bibliotekat më të rëndësishme të botës.

Shikuar këto suksese të Shaqir Fetait, na del që i ka ngelur vetëm edhe një për ta përmbushur tërësinë e “sukseseve”: të mbledhë guximin dhe sa më parë publikisht të heqë dorë nga islami, sepse na fëlliqi fare!/**JetaPress/09.03.2023**

## **Nën prangat e panikut**

**A e di Shaqir Fetai se çka do të thotë aktivitet? A mund të jetë aktivitet një shëtitje e kotë? A mund të jetë aktivitet pjesëmarrja si publik në një event? Aktiviteti është ngjarje me rezultat konkret i cili shkon në dobi të institucionit, komunitetit, shtetit, shoqërisë... Shaqir Fetai shfrytëzon Institucionin për të zhvilluar ndonjë vizitë të kotë apo edhe për t'u vizituar kot e kot**

### ***Nga Sabit Ibrahimi***

Facebook-u personal është një formë e medias për komunikim me opinionin e gjërë me të cilin flet në vetën e parë. Le të themi se është një lloj notesi ku mbahen shënime memoaret, veprimet ditore, ngjarjet dhe ndodhitë gjatë ditës dhe natës! Në këtë “media” personale pra, komunikohet në vetën e parë dhe, aty, edhe kryetari i shtetit do të shkruante “sot takova...”, “sot pranova...”, “sot isha...”, “sot u nisa...” etj. etj. Kështu komunikon edhe Sekretari i NATO-s, edhe Sekretari i OKB-së, edhe Kryetari i SHBA-ve, edhe Mbreti i Anglisë edhe... Vetëm Shaqir Fetai, ky avdall i papërmirësueshëm, opinionit i drejtohet me titullin që e ka vjedhur dhe, në FB-un e vet informon “sot reisul ulema...”, “reisul ulema u nis për në...”, “reisul ulema takoi”, “sot reisul ulema priti...” e duballallëqesh të këtilla prej injoranti!

### **“Reisul ulema filloi aktivitetin e tij me vizitën Institutit “El Furkan” në Londër”**

Këtë titull e ka publikuar Shaqir Fetai në Facebook-un e vet! I kompleksuar nga fakti që askush nuk e pranon për reis, ose, të gjithë ata që e thërrasin “reis”, e thërrasin me përçmim dhe sa për t'u tallur e për të lozur “tashak”, ndaj dhe bie në trans sa herë që veten do ta thërrasë me “reis”. Ka nevojë i shkreti, ka dëshirë të papërmbyjtshme! E cili na paska qenë ai aktiviteti i “reisit” që e paska filluar në këtë Institucion në Londër! Cilat ishin pritshmëritë dhe çka përfitoi qoftë vetë Shaqir Fetai, qoftë vetë Institucioni në krye të të cilit e instaluan disa qarqe qeveritare antiislame dhe ç'dobi pati shoqëria myslimane e vendit! Zero, asgjë, me përjashtim të “vidi p... put”! Aktivitetet e shëndetshme gjithnjë sjellin dobi të përgjithshme. Vizitat që i ka ky gjatë një udhëtimi për Shaqir Fetain ose kanë kulmuar me “vizitë ambasadorit të shtetit”, ose me haje prej “10 qevapçiçi” për të cilat vdes i gjori!

Nëse Shaqir Fetai mendon se paska zhvilluar aktivitet meqë me drejtorin e Institucionit paska këmbyer njohuri dhe përvoja – edhe kjo është rrenë e kulluar, sepse, drejtori nuk ia pranon përvojat e Shaqir Fetait të cilat konsistojnë në: vjedhje, në rrena, në bashkëpunim me shërbime të huaja, me degradim e tëhuajësim të vakëfit në Shkup, në Tetovë, në Gostivar, në Kumanovë e gjithandej në Maqedoninë e Veriut. Kjo është përvoja e Shaqir Fetait dhe, i pajisur me këto karakteristika, në fakt, gjithkund ku prezanton Shaqir Fetai, e fëlliq atyhin krejt! Dhe, Shaqir Fetait nuk i bëhet vonë fëlliqja, me rëndësi është që ai të ftohet diku e të përzihet me dikë, sepse u krimb duke pritur e përcjellë njerëz për çaj në kabinetin që e ka uzurpuar për ta degraduar deri në stog plehu!

### **Shaqir Fetai si cung i shkretë**



Pse përzihet Shaqir Fetai në botën arabe kur i shkreti nuk e kupton gjuhën arabe, nuk e flet, sepse nuk e di, sepse tërë potencialin e vet e ka shkrirë për ta mësuar serbishten, gjuhë kjo e dalur nga familja e gjuhëve ruse. I hendikepuar me këtë fakt, avdalli përzihet me arabë dhe rri si cung i shkreti, duke u përgjumur e duke e prekur krahëve shoqëruesi i vet “përkthyes” dhe duke e zgjuar “çu mos flej”! Pranaadaj arsytimi i pjesëmarrjes së tij nëpër evente të tilla tradicionale është më se i kotë, është vetëm sa për “vidi p... put” dhe për një shëtitje në vendet që as që ka mundur t’i ëndërrrojë. Plotësimi i ëndërrave personale të Shaqir Fetait nuk është aktivitet. Nëse ai ftesat zyrtare i keqpërdorë dhe i përkthen si “aktivitet i reisul ulemasë” – ky është karakter plastik i Shaqir Fetait!

Ai nuk lexon as kumtesë, ai nuk përfshihet as në debat, ai nuk kontribuon as në sjellje të ndonjë konkluzioni; ai përshendetjet e zakonshme me “selame” i interpreton si “takime me personalitete të larta”, sepse, në fakt ai nuk mund të realizojë takime, sepse i mungon komunikimi, i mungon mjeti i komunikimit, i mungojnë projektet e gatshme, i mungojnë iniciativat, i mungon stafi profesional, “myftinjë” kryesorë nuk ia dinë gjuhën arabe. Shaqir Fetai në fakt përfaqëson vetëm “bashkësinë e mjerimit kadrovik”!

Lëre gjuhën arabe, Shaqir Fetai ka problem edhe me gjuhën shqipe. Duke u munduar që të shes “intelektualitet” i shkreti shpërfaqet në mediokër origjinal dhe unikat! Shaqir Fetai na thotë, veç tjerash se, në këtë Konferencë na qenka debatuar edhe mbi “Pozicioni i Islamit...; Pozicioni i muslimanëve...”

Shaqir Fetai ky “kontribues i moth fetaro-kombëtar” duke u ndjerë si i tillë, zgjedh fjalë nga fjalori militar, nga fjalori ushtarak dhe flet për pozicione dhe jo për pozita. Është sepap të ndihmohet i padituri: fjala pozicion do të thotë “brez toke i ndërtuar posaçërisht, ku vendosen trupat për të sulmuar ose për t’u mbrojtur; vend i përgatitur e i mbrojtur që zë luftëtari në luftim; mënyra se si vendoset një njësi ushtarake ose një ushtar në luftim; kryes, vendi ku përqendrohen trupat ose ku zhvillohen veprimet luftarake”, kurse fjala pozitë, sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe do të thotë “Gjendje, në të cilën ndodhet dikush a diçka; tërësia e kushteve dhe e rrethanave që ndikojnë për zhvillimin e mëtejshëm të diçkaje”!

### **Lumet na që po vjen Ramazani, do të “pallohena” me iftare të begata**

Shaqir Fetai, sa herë që dëshiron të tregohet se sa “i madh” që është, fton profesorë nga Medresja Alaudin e Prishtinës, apo profesorë nga FSHI e Sarajevës! I duhen vetëm për një fjali për ta publikuar! “Dikur e kisha profesor”, thotë Shaqir Fetai! Mesazhi i tij është: “Ja, këta ishin profesorë, ngelën profesorë dhe u pensionuan si profesorë, ndërsa unë, nxënësi e studenti i tyre po përfundoj si reis”! Ky është mesazhi përçmues që e përcjell avdalli!

Kësisoj, këto ditë paska pasur mysafirë nga “Alaudini” i Prishtinës, me të cilët, Shaqir Fetai paska biseduar për dy pika:

1. Të realizohen vizita të ndërsjella gjatë muajit të Ramazanit nga delegacione të dy bashkësive të udhëhequra nga dy Kryetarë të dy bashkësive në Prishtinë dhe Shkup;
2. Gjatë vizitave të organizohen panele dhe tribuna fetaro shkencore në suaza të aktiviteteve të të dy bashkësive islame dhe më në fund përgatitja e iftarit të përbashkët solemn”!

Në fakt, Shaqir Fetai po e ndjenë se do të dështojë edhe në këtë Ramazan! Po e ndjenë se nuk do t’ia dalë t’i dirigjojë e t’i komandojë bashkëpunëtorët e vet që të lëvizin nëpër vend me paratë e veta, sepse, nuk ka para, i hëngër, i zhbërrti duke marrur mëditje e bileta avionësh duke e shëtitur b... e vet dhe të pulenëve të tij nëpër botë; duke blerë përkrahjen prej honxhobonxhove të vet, duke blerë rehatinë duke i korruptuar marionetat e veta.

Shaqir Fetai nuk ka më as forcë, as kredibilitet, as të drejtë morale të kërkojë prej hoxhallarëve që të jenë më të angazhuar gjatë Muajit të Bekuar të Ramazanit! Shaqir Fetai po ndjenë se do të sabotohet, po ndjenë se nuk po përfillet, po ndjenë se fjala e tij nuk ka peshë më sa pordha e magarit ngarkuar me drunj të vjedhur; ai po ndjenë se shumë shpejt do ta thërrasin në përgjegjësi për vjedhjen dhe tjetërsimin e vakëfit, për shpërndarjen e parcelave-vakëf për ata faktorë që i japin përkrahje politike; ai po ndjenë se vështirë do të falet dhe se do të paditet për letrat me vlerë që i shpenzoi për vjedhjen dhe mbajtjen e pozitës së të parit të Institucionit! Ndaj dhe, i ka vajtur mendja që këtë “zbrazëtirë” ta mbulojë me hoxhallarë e delegacione nga Kosova, të cilët mund të kushtojnë edhe më lirë: një mëditje 30 euro dhe një “iftar solemn”!

Shaqir Fetai nuk brengoset për shtresat e varfëra, nuk ua qanë hallin të varfërve që do të hynë në Ramazan me asnjë kilogram miell, nuk brengoset për të ngratët, për jetimët, për familjet që nuk kanë as kryp për të ngjyer në sofër. Ai fton imamlerë e delegacioni prej Kosove për të shijuar së bashku “iftare solemne”! Për Shaqir Fetain iftari nuk duhet të jetë modest por solemn, nuk duhet të jetë me ata që e kanë grykën e ngushtë për të ngrënë, por me ata që janë të babzitur si vetë ai.

Turp t’i vie, pisit!/**1KlikLarg/16.03.2023**

## **A jepet mielli "hejdije"**

**Në Bojanë, në praninë e një numri të madh të xhematit, në mesin e tyre edhe mysafirë nga Shqipëria dhe Kosova, qenka bërë hapja solemne e xhamisë së re, të cilën, para disa viteve e inicioi dhe e hodhi gurin themeltar vetë ish-reisul uema i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi. Ai nuk ishte prezent në këtë hapje solemne, Shaqir Fetai, hajni që ia vodhi postin duke ia ngulur thikën pas shpine, nuk e kishte ftuar, dërsa populli thotë: “aty ku mungon maçoku minjtë bëjnë dasëm”**

## **Nga Valon Bajrami**

Shaqir Fetai po “udhëhiqet” nga disa komplekse në të cilat është futur deri në grykë. Është shumë i kompleksuar, po i “krijohet opinioni” e po i rrëshqet dheu nën këmbë, po e ndjenë. Po e di që është dhe që do të ngelë në histori si i vetmi “reis” i padëshirueshëm, i papërfillshëm, e i përçmuar, sepse, u bë i tillë si pasojë e një tradhëtie dhe të një komploti që e zhvilloi mbi personin i cili e kishte ndërtuar atë si “personalitet” – e tërhoqi gjatë tërë jetës si “shleper” pa rrota.

Prandaj, i kompleksuar deri në huti absolute, ai nuk po di se çfarë po bën, ose po i ndërmerr disa veprime të cilat, megjithatë, nuk dëshmojnë për asgjë tjetër përveçse për komplekset e tij të pashërueshme.

## **Hajn me tapi**

Ditë më parë, në një xhami të Shkupit ishte bërë përrurimi i një hafizeje të re. Zoti asaj i dhashtë shëndet, mbarësi dhe gjithmonë pastë bekimin e Tij. Hafëzja rrjedh prej një familje me traditë hifzi. Këtë traditë të saj Shaqir Fetai “e vodhi”, siç e vodhi edhe kontributin vetëmohues të muafizit! Këtë gëzim duhej ta përjetonin dhe ta festonin familjarët e vajzës, farefisi, miqtë, shoqet dhe muhafizi dhe, jo Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai e vodhi aktivitetin e shenjtë të vajzës dhe, e prezantoi atë si aktivitet personal të tij, madje, duke e “dokumentuar” përmes shumë fotografive. “Lajmin” e kishte shoqëruar me nja 20 fotografi, në të cilat, vetëm në 4 foto dukej hafizja e re, ndërsa në 16 të tjera pozonte Shaqir Fetai duke u krekosur si gjeldeti, thuase ky aktivitet ishte personalisht i tij! Ky është një krim, është një vjedhje prej të cilës do të turpëroheshin edhe hajnat më të sofistikuar. Është ky veprim në vazhden e veprimeve prej hajni të pacipë të Shaqir Fetait!

## **Shaqir Fetai nuk i njeh organet e BFI-së**

Shaqir Fetai, në “fletën e murit” të vet informon: “REISUL ULEMA I BFI E RMV SOLEMNISHT HAPI NISMËN E NDARJES SË DHURATAVE TË PARA TË RAMAZANIT NGA ARABIA SAUDITE”! A ka gjë më të budallakaftë se të thuash “solemnisht hapi nismën”! A ka më tmerr se sa ndihmat humanitare të nisin të ndahen “solemnisht”! A mund të konsiderohen ndihmat humanitare si “dhuratë”? Këtë mund ta bëjë vetëm koka kungull e Shaqir Fetait! Po si mund të bëhet hejdije, dhuratë, mielli?

A e di Shaqir Fetai se sa rënd e ka fyer Mbretin e Arabisë Saudite dhe Shtetin e Tij! Maqedonia e rreth një milion myslimanëve, prej të cilëve, tre për qind, apo rreth 30 mij vetë jetojnë në mjerim e në varfëri të skajshme, përjeton hapje solemne të “dhuratave” për vetëm 1 për qind të numrit të përgjithshëm të të varfërve! Mbreti saudit angazhohet për këtë gjest antihuman që vjen si pasojë e rrenave të Shaqir Fetait, apo, Shaqir Fetai dëshiron që t’ua përcjell një mesazh atyreve që nuk e duan, që nuk e bëjnë hesap më sa një qen endacak: më duani të gjithë nëse dëshironi privilegje nga mbretëria arabe siç u nderuan me “dhurata” këta 2400 të varfër!!!

Ose, fare në fund, nëse ishte aktivitet human i institucioneve shtetërore të Arabisë Saudite, pse këtë aktivitet ta “ushtrojë” paralelisht Shaqir Fetai dhe jo Organizata Humanitare “HILAL” dhe kryetari i saj? Apo, nuk mundet të rrijë një ditë pa vjedhur aktivitete Shaqir Fetai! Këtu nuk kemi të bëjmë me mosbesim ndaj “kryetarit” sa kemi të bëjmë me vjedhje të aktiviteteve si dhe me kryetarë të pa dinjitetshëm (si “reisi” ashtu edhe “kryetari” ilegjitim i “Hilalit”)

Nuk ka sevape, nuk ka lutje e përlësi të Shaqir Fetait që mund t’ia shpëlajnë mëkatet, trishtimet e haramet që i ka bërë nën “emblemën” e UDB-së e nën pseudonimin policor “ORAO”, e as që mund të bëjnë që të harrohet tradhëtia dhe komploti që ia bëri “babait shpirtëror” të tij, H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili e rriti në karrierë si ta kishte evlad. Madje as për evladët e vet nuk bëri aq sa bëri për Shaqir Fetain që kur shërbimet sekrete komuniste (gjithnjë sipas sh-reisit) ia impunuan ta pranonte në punë në BFI qysh tre dekada më parë!**IKlikLarg/20.03.2023**

## I vetëpëlqyeri i neveritshëm

**Biografët e ndryshëm që janë marrur me jetën dhe veprimtarinë e spiunëve, nënvizojnë se spiunët, edhe pasi të lirohen nga angazhimi i tyre policesk, edhe pasi të pensionohen, ata edhe më tej ngelin me të njëjtin ves: spiunojnë! Nëse tashmë nuk do të mund të spiunojnë për askend, sepse fundi i tyre gjithnjë është dekonspirues, ata në çdo kuvend odash e logjesh, do të vetëspiunohen. Vetëlavdërohen duke mos kuptuar se po spiunohen. Spiunimin e kanë në gjak**

*Nga Mahir Rexhepi*

### 1.

Dikush vdes për të takuar politikanë dhe për t'u fotografuar me ata. Kjo jo se ua di peshën, jo se ua di vlerën politikanëve porse, thjesht, sepse pamjet e tilla u duhen për lavd. Këtu pastaj politikanët bijnë pre e nevojës së turlifarë idioti për lavd e që, një ditë, kur të kuptojnë se janë fotografu me spiunë e me tradhëtarë, me kriminelë e me vrasës, do të turpërohen!

Një prej lavdëruesve të këtyllë është edhe Shaqir Fetai! I shkreti, vdes për t'u fotografuar me turlifrë mahlukati. Çka e shtyn të ngratin që të vizitohet ambasada e të fotografohet me aq shumë ambasadorë nëse jo nevoja për t'u lavdëruar?! Shaqir Fetai është njëri nga vizituesit e takuesit më të mëdhenj në vend me ambasadorë! Çka e lidhë këtë avdall puna me ambasadorët e Maqedonisë së Veriut që veprojnë nëpër botë! A mos e ka mision të ngarkuar nga Ministri i jashtëm, Bujar Osmani, sepse Shaqir Fetai ka vizituar e takuar ambasadorë më shumë se Osmani!

Ç'është kjo dashuri kaq e madhe për të vizituar ambasada maqedonase? Natytrisht, dikur nëpër ambasadat jugosllave funksiononin edhe zyret e UDB-së, në të cilat, shpesh spiunët e akredituar futeshin për të dhënë "informacione taze" për shqiptarët patriotë në ilegalitet. Nëse sot nëpër ambasadat maqedonase nuk ka zyre spiunazhi, kjo nuk do të thotë se zvogëlohet nostalgjia për këtë profesion ata që infiltroheshin, si "ORAO" etj.

Është edhe një motiv tjetër (që lidhet po me spiunazhi) që Shaqir Fetait ia shton "afshin" për t'i vizituar ambasadorët. Malli për kushëririn, për spiunin tjetër familjar, i cili është ambasador dhe, të cilin e ka takuar 5-6 herë ndërsa hala nuk e ka vizituar, për shembull, myftiun e Prilepit, atë të Shtipit, atë të Resnjës, të Velesit etj. Me vizitat që ia bën ambasadave të ndryshme, Shaqir Fetai dëshiron që ta amortizojë dhe ta relativizojë vizitën që ia bën shumë shpesh kushëririn të vet ambasador! Po pse dy udhëbërës kanë nevojë që të takohen zyrtarisht kaq shpesh? Këtë mund ta dijë vetëm Shaqir Fetai!

### 2.

Shaqir Fetai tashmë është dëshmuar katërcipërisht (madje për të ka edhe shumë barcoleta) si njëri që habit me këmbënguljen e vet në thirrjen e personave të ndryshëm që ta vizitojnë dhe ta pijnë një kafe apo çaj me të! Jo që ka ndonjë hajër Bashkësia Fetare Isame, jo që ka ndonjë të mirë për myslimanët e vendit, porse, thjesht, ky është ves shumë i keq i Shaqir Fetait! Ai e ka në shpirt që të shërbejë si informator, të informojë! Asnjë personalitet në vend, asnjë subjekt institucional, juridik e fizik, nuk informon kështu si Shaqir Fetai për vizita e takime ditore me persona të papërfillshëm, të kotë, të padobishëm. Asnjë subjekt në vend nuk lajmëron për takime

me miq e me shokë, të tashëm e të dikurshëm. Ky nuk është misioni i asnjë subjekti me relevancë. Por ama, kur e ke mision, kur e ke në gjak spiunimin, atëherë, të duhen tema! Prandaj, i fton, i bënë temë lajmi dhe informon!

Shaqir Fetai nuk ka kohë dhe nuk ka guxim që të dalë nga zyrja e të vizitojë myftini në prag të Muajit të Bekuar të Ramazanit dhe ta organizonte një program më profesional, t'u jepte angazhime konkrete, t'u kërkonte përgjegjësi dhe t'u ndante detyra vartësve të vet vegla! Nuk ka koh, sepse kohën po e harxhon në pritje të turlifarë duduki që duhet me i ardhur në zyre dhe me ia uru postin "reis" që e vodhi në mënyrën qyqare.

### 3.

Por, Shaqir Fetai ka një përgjigje: nuk mundem t'i detyroj myftinj të e mi që nuk dinë të punojnë dhe nuk interesohen për të mirën e përgjithshme porse angazhohen vetëm për xhepin e vet! Pikërisht këtë fjalë e ka thënë në një lokal deri sa pinte kafe me "miq" të parëndësishëm pas faljes së teravisë së parë!

Do me thënë, meqë "vartësit" e vet i ka analfabetë, ka shpikur një "aktivitet" krejt të kotë sa t'u dëshmojë atyre se çfarë "reisi" kanë me mendtë kalavesh rrushi! Këtë "aktivitet" Shaqir Fetai po e ushtron duke nxjerrë çdo ditë nga notesi i vet amator, thënie që ia kushton agjërimit! Me këtë dëshiron që ta dëshmojë edhe "devotshmërinë" e vet, ndonëse nën hijen e flatrave të "ORAO-s! I gjori, duke qenë përjetësisht nën influencën e këshillave UDB-eske, ai do të shkruajë edhe "margaritarë" të llojit siç e gjenë te "shënimi 3", e që thotë: "... Agjërimi si institucion... për të ndryshuar botën nga formimi i familjes, shoqërisë, jetës..." Pra, kjo botë qenka krejt e mbrapshtë, duhet të ndryshohet, këto familje e shoqëri, nja dy miliardë myslimanë qenkan të kotë, prandaj bota duhet të ndryshojë duke filluar nga familjet! Këshilla tipike të UDB-së! Më tej thotë: "Ramazani është fenomen i pashtershëm i ideve të formimit të individit..." Atëherë, kjo na lë të nënkuptojmë se Shaqir Fetai kurrë në jetën e vet nuk paska pasur lidhje me Ramazanin, sepse, si ndryshe të ketë ngelur individ kaq i paformuar, pa personalitet dhe kaq shpirtzi!

Se Shaqir Fetai është hipokrit i pakrahasueshëm (sepse nuk gjendet edhe një si ai), dëshmon edhe një "postulat" që e sjell në "shënimin 2", duke thënë: "Andaj, kuptonie një të vërtetë. Ramazani është i dashuri ynë me begati të shumta për të ngritur dinjitetin tonë shpirtëror dhe moral." Çfarë dinjiteti shpirtëror e moral mund të vërejë njeriu te Shaqir Fetai? Njeriu që tradhëton, që spiunon, njeriu që kryen komplot, njeriu që i ngulë thikën pas shpine "babait të vet shpirtëror", njeriu që abuzon me paratë prej fitri e zeqati në blerje të rehatisë së vet në kolltukun i cili mund të jetë edhe me kunj! Këtij t'i ketë bërë hajr Ramazani? Ky specie dhe begatitë e Ramazanit janë miliona kilometra larg njëri tjetrit!

Në "shënimin 1" Shaqir Fetai na e dëshmon një të vërtetë të madhe e cila vetëm për të nuk mund të vlejë! Ja pse! Ai thotë: "E gjithë kjo ndodh se agjërimi lidh fuqishëm njeriun me Zotin."! Nuk dëshirojmë të themi se Shaqir Fetai nuk agjëron! Agjëron por, e ka për formë, hipokrit bre! Hipokriti jo një muaj, por le të agjërojë po deshti edhe tërë jetës se, e ka të pamundshme lidhjen me Zotin! Nuk e pranon Zoti këtë lidhje, Ai e refuzon hipokritin! Një agjërime i hipokritit, i cili nuk pranon të pendohet në emër të Zotit, t'i kërkohet falje për të gjitha ato mbrapshtësi që i ka bërë, që ka marrur njerëz më qafë, që ka shpërdoruar pozitë dhe detyra kushtetuese, duke shitur e vjedhur vakëf, duke pakësuar vakëfin, duke i premtuar buste e përmendore në Tetovë njerëzve të Putinit, duke u rrethuar me edepsëza e dinsëza – pra, një agjërime i një individ të tillë është më se i kotë. Zoti e di më mirë por, dihet sa çka na mëson Kurani i Madhërishtëm për hipokritët, të cilët dinë edhe ta kenë gojën plotë Zot, të flasin mirë për islamin, të thërrasin në Rrugën e Drejtë por

që nuk duhet t'u besojmë, sepse ata edhe islamin e përdorin për interesa të veta e jo për t'iu përrulur vetëm Krijuesit tonë!

#### 4.

A është islamikisht në rregull veprimi të cilin e ndërmori avdalli! Me krejt suitën e vet niset për në Bashkësinë Islame të Turqisë, për t'i dorëzuar paratë e grumbulluara nga myslimanët e vendit për turqët dhe sirianët që pësuan nga tërmeti apokaliptik që u ndodhi kohë më parë! Po supozojmë se, Shaqir Fetai e di se funksionon transaksioni bankar dhe se paratë nuk i ka çuar me “aktofke” por përmes transferave bankare! A ishte farz që me suitën e vet të vizatohej në Turqi dhe të bëjnë aq shumë shpenzime sa, më tepër t'u kushtojë rruga dhe mëditjet se sa paratë që i kanë donuar! Apo deshti t'u thotë turqëve: ”ja, ja, krejt neve kemi kontribuar për popullin turk”! Po pse nuk shkoi edhe në Siri, në vendin që u godit nga tërmeti katastrofal! Nëse i ka dërguar përmes transaksioneve bankare, a nuk ishte kjo e mjaftueshme, pa marrur udhë për në Turqi? Jo, sepse kjo nuk paraqet kurrfarë lajmi për Shaqir Fetain! Për të e rëndësishme është që pastaj të ketë rast që në FB-un e vet të shkruaj “Reisul ulema u prit në Turqi...” Ky duhet të jetë lajm dhe jo humaniteti i myslimanëve të vendit tonë për popullin vëlla turk. Kur jemi te humaniteti, pash të Madhin Zot, pash këto ditë të agjërimit, a mund të na thotë Shaqir Fetai se sa para dha nga xhepi i vet në këtë aksion!

#### 5.

Në Ditën botërore që i kushtohet personave me sindrom down, u përfshi edhe BFI sa për të bërë aktivitet me paketat e donuara nga arabët për të varfërit e vendit tonë. Pako me artikuj ushqimor u shpërndanë familjarëve të 120 fëmijëve me këtë sindrom për të cilët angazhohet një asociacion përkatës! Tani, me këtë sindrom mund të jenë të prekur edhe fëmijë të familjeve mjaft të pasura dhe, a nuk është ofendim për ta që t'u jepet nga një pako nga ndihmat për të varfërit! Me këtë rast u tha edhe kjo gënjeshtër, natyrisht, e porositur nga Shaqir Fetai: “Një ndër prioritetet e Bashkësisë Fetare Islame me në krye Reisul Ulemanë H. Hfz. Shaqir ef. Fetahu është ngritja e ndërgjegjes së shoqërisë mbi nevojat dhe potencialin që kanë personat me sindromën Down.” A mund të na e numrojë dikush nga BFI vetëm një aktivitet për këtë komunitet të prekur me sindromin në fjalë e që do të dëshmojë se Shaqir Fetai i ka në krye të prioritetëve! Jo që nuk e ka pasur kurrë prioritet por, madje as që ka ndërmarrur ndonjë aktivitet, për shembull, në mbledhje të ndihmave financiare, për t'i donuar lodra e mjete tenike aq të nevojshme për një asociacion që mbanë nën përkujdesje fëmijë të kësaj kategorie. Me rrena nuk shkohet në Xhenet, o Shaqir Fetah! Të paktën, mos kërko që edhe stafi yt të të përngjajë ty, sepse nuk je mall për t'u përdorur si shembull i mirë!/**TetovaSot/28.03.2023**

## Hajdutët profesionistë

**Hajduti, pas vjedhjes, në të gjitha rastet detyrohet të betohet rrejshëm, pra të rrejë! Ai që vjedh dhe ai që rrenë në fakt, është edhe i pabesë edhe jobesimtarë. Prandaj Allahu xh. sh. në Kuranin Madheshtor, në ajetin 38 të sures El Maide, thotë: “Vjedhësit dhe vjedhëses ua pritni duart, si ndëshkim për atë që kanë bërë dhe si dënim nga ana e Allahut. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë”**

### *Nga Mahir Rexhepi*

Sipas asaj që po lexojmë çdo ditë, sipas asaj që po dëgjojmë çdo ditë dhe, sipas asaj që na vijnë muhabete nga brenda BFI-së, ky Institucion kurrë në historinë e vet nuk ka qenë kaq shumë si bastion i hajdutëve, i rrencave e i tradhëtarëve, i spiunëve e i bashkëpunëtorëve të shërbimeve të huaja. Shumë keq për një Institucion fetar si dhe për teologët e vendit! Një qelbet, të gjithë kundërmojnë në qelb!

#### 1.

Kanë nisur ta gjuajnë lekun e fukarasë! Për këtë Muaj të Ramazanit, agjërueshëm (!) të gjithë kanë dalur që t'i bidnin myslimanët, të pasurit dhe të varfërit (të varfërit janë qindra herë më shumë se të pasurit) që, amani, fitrin dhe zeqatin t'ua japin këtyre të BFI-së sepse me ato para do të mbahet Medresja e Isa Beut! Fitrin e japin që të gjithë agjëruesit, e ndajnë nga buka e gojës dhe e japin, sepse, kështu ka urdhëruar Allahu q: “Lëmosha (Sadekatul fitri) e zeqati është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për lirimimin e skllëvërve, për të rënduarit nga borxhet, për (luftëtarët në) rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve. Këto janë detyrat e vëna prej Allahut. Vërtet, Allahu është i Gjithëditshëm dhe i Urtë.” (60, Et Teube). Ndërsa, është bërë traditë, që nga sistemi komunist, që fitri të tubohet sidomos për mbajtjen e vatrave arsimore fetare, medreseve.

Tani jemi në të tjera periudha! Medresja, si shkollë e mesme, duhet të jetë e akridetuar dhe të finanohet nga shteti, meqë vetë shteti e ka bërë shkollimin e mesëm të obligueshëm! Ose, një ditë, kur do të akreditohet Medresja si rrjedhojë e presioneve të mëdha nga mediat e vendit e jo nga BFI-ja që është shëndërruar në filiale qeveritar, atëherë, në emër të kujt do ta mledhin fitrin këta hajdutë të BFI-së me në krye, kryehajdutin Shaqir Fetai dhe “Bagdatski llopovin”, Irsal Jakupin?!

Më herët mbledhja e fitrit ishte shumë transparente. Mblidhte këshilli i çdo xhamie, mblidhnin imamët dhe, kjo formë ishte si një garë në mes të këshillit, imamëve, xhamive se, kush e ka xhematin më të organizuar, kush ka zhvilluar aktivitete më të mëdha gjatë Ramazanit.

Botoheshin tollone dhe, një fitër një fletë! Pastaj nisën të botojnë tollone fallse edhe disa myftini, do me thënë, i jepnin tollonet false ndërsa BFI-së ia kthehnin ato origjinalet duk u arsyetuar se xhemati i varfër nuk po paguan fitra, ose, po ia paguan jetimëve, të varfërve etj. Vidhej me të madhe dhe për këtë fenomen është shkruar disa herë.



Sot, vjedhja është më e sofistikuar! Meqë nuk u besojnë as imamëve, as xhemateve, as këshillave të xhamive, në fakt, meqë Shaqir Fetai nuk dëshiron të dijë askush se sa fitra janë tubuar, ka fillar qe dy-tre ramazane që fitrin ta mbledhë edhe online! Po thonë që shumë po paguajnë në këtë formë, ndërsa askush nuk di se sa janë tubuar. Ky është edhe qëllimi i dyshe Fetai-Jakupi, të kenë mundësi të vjedhin sa të munden! Ata që tubojnë online, gjithësesi që e kanë edhe paragrafin e dëshmisë së tubimit të të hollave që është transparente deri sa të zgjasë aksioni dhe, në atë paragraf vërehet për çdo sekond se si ndryshon shumta e tubuar. Këtë transparencë, si të gjitha të tjerat, Shaqir Fetai nuk e do, nuk dëshiron që me të tjerët të ndajë informacionin mbi atë se sa para janë tubuar, sepse pastaj nuk mund të vjedhë, nuk mund ta ushtrojë profesionin prej hajduti për të cilin edhe e rrëmbeu me mijëra intriga BFI-në.

## 2.

Nuk ka asnjë bashkësi fetare në rajon e më gjërë (në proporcion me standardin jetësor) që e ka haxhin më të shtrenjtë se sa Shaqir Fetai! Edhe sivjet, ngjashëm si vitin e kaluar, Shaqir Fetai ka vendosur që të organizojë haxh privat me çmime të kripura! Tash e dy-tre muaj më parë ka nisur të genjejë duke iu drejtuar myslimanëve të vendit që të nguten e të regjistrohen, sepse numri i haxhilerëve po mbushet! Pasi që ka arritur numrin e nevojshëm, sipas kuotës së caktuar nga Arabia Saudite tash e 33 vjet më parë, pra, pasi që të jetë publike se filani do të shkojë sivjet në haxh, pasi të vie koha e përshëndetjeve, hallallëqeve, pas shtrimit të drekave e të darkave për këtë nijet, vjen koha të përballen me çmimin! Shaqir Fetai, duke e ditur mentalitetin e njerëzve tanë, duke e ditur inatin e shqiptarit, duke e ditur turpin e madh të heqjes dorë prej shkuarjes në haxh pasi të ta kenë bërë për hajër mijëra njerëz, vendos që ta publikojë çmimin e hajnisë për Haxhin 2023!

Askush nuk mori vesh se kush ishte kryesia e haxhit të sivjemë, kush ishte grupi pararendës i cili ka për detyrë për të siguruar hotele, për të marrur çmime të tatimeve, të udhëtimeve të brendshme, të ushqimit dhe të pagesave të paparashikueshme dhe, pasi që këto çmime t'i prezantonte në Rijaset, anëtarët e rijasetit do të vinin deri te një ujdi për çmimin real, përfshirë këtu edhe përfitimet e BFI-së për kokë të haxhiut! Natyrisht, përfitimi duhet të jetë në përpjestim real me standardin e myslimanëve tanë dhe jo të shpreh nevojën e Shaqir Fetait dhe të Irsal Jakupit për të vjedhur sa më shumë nga Haxhi dhe nga haxhilerët! Le të dalin publikisht dhe në mënyrë transparente t'i arsyetojnë të gjitha shpenzimet që bëhen nga udhëtimi e deri sa të kthehen në shtëpi haxhilerët dhe, le të dihet se sa do të ngelin për BFI-në! Por, jo, sepse pastaj nuk do të kenë mundësinë e vjedhjes.

## 3.

Një vjedhje tjetër është edhe vjedhja e kurbanëve! Vitin e kaluar u tha se ka pasur rekord kurbanësh, ndërsa askush nuk di se çfarë u bë me atë mish, apo ndoshta janë therur vetëm aq kurbanë sa do të plotësohen nevojat e restorantit të Medresesë, sa të shpërndahen nja 2-3 mij pako apo qese najloni me mishë dh, aq! Pjesa tjetër e parave në xhep të Shaqir Fetait dhe honxhobonxhove të tij! Me këto para Shaqir Fetai ka blerë rehatinë e shijimit të kolltukut për vitin 2022, ka "shpërblyer" bashkëpunëtorë për lojalitet!

Shaqir Fetai hala nuk e ka caktuar çmimin e kurbanëve, hala nuk ka formuar komision që të merren me çmime, me mënyrën e therrjes, me frigoriferët ku do të ruhen, me formimin e komisioneve për shpërndarje të suksesshme të mishit për të varfër e të ngratë.

Shaqir Fetai konsideron se për sivjet hala herët është të caktohet çmimi, sepse, ai, si skile që është, pret që ta ndjejë nijetin e xhemateve për therrje të kurbanit për vitin 2023 dhe, tek atëherë

të caktojë çmim! I duhen para, sepse, deri në përfundim të vitit 2023 do të kalojë nëpër shumë sfida të papërbalueshme prej hajdutëve. Dihet se cili është fundi i hajdutëve! Ndaj, për të pasur një fund sa më të lehtë duhet para edhe për korrupsion. Shaqir Fetait i duhet që për sivjet të futet fuqishëm në botën e korrupsionit.

#### 4.

Shaqir Fetai vjedh edhe përgjatë “vizitave” që ua bën xhemateve të diasporës! Qejf i madh i tij që të vizitojë qendra islamike shqiptare në shtete perëndimore. Qejf i madh i tij që të shohë njerez të devotshëm që shkojnë për t’u lutur para Zotit e që Shaqir Fetai mendon se kanë ardhur në xhami për shkakun e tij. Ky qejf i kushton BFI-së, ky qejf i budallakaftë i kushton buxhetit të Institucionit. Vetëm për udhëtime me avionë e për mëditje që paguhen në BFI do të mund të mbahej me artikuj të nevojshëm guzhina e Medresesë. Vizitat e Shaqir Fetait dhe hajdutëve të tij që i bëjnë nëpër qendra të diasporës sonë, asgjë nuk i sjell as BFI-së dhe as myslimanëve të vendit. Shaqir Fetai e ndjenë se në Maqedoninë e Veriut ditë e më shumë po humb terren dhe xhemat, herë pas herë ka nevojë për të ndjerë përkrahje (duartrokitje) nga një xhemat tjetër, por që, edhe kjo nevojë e këtij avdalli po i kushton shumë BFI-së. Le t’i tregojë projektet, le t’i tregojë relacionet, letërkëmbimet, që i ka mbajtur me cilindo nga udhëheqësit e xhemateve, marrëveshjet paraprake që kanë detyruar Shaqir Fetain të jetë në mesin e atij xhemati. Nuk ka! Një ditë të bukur i kujtohet Shaqir Fetait dhe marionetave të tij që ta shijojë “mikpritjen fascinantë” nga diaspora dhe, në kthim, të marrë ndonjë mëditje, të fusë në xhep ndonjë “bakshish” nga mërgimtarët tanë të sinqertë e të devotshëm.

#### 5.

Vakëfi është një fushë tjetër ku Shaqir Fetai për këtë kohë ka vjedhur si në “bahçe të babës”! Shaqir Fetai akoma nuk na tha se sa para i vodhi apo i zhduku nga projekti dhe financimi arab i qendrës tregtare që e la pa u ngritur dhe që e dobësoi vakëfin e Gostivarit për miliona dollarë! Shaqir Fetai hala nuk na tregoi se çka u bë me hotelin e BFI-së në vendin e ish-komunalecit, nuk tregoi hala se sa banesa janë vjedhur prej honxho-bonxhove të tij në këtë kompleks pallatesh. Shaqir Fetai hala nuk e tha asnjë fjalë për dhjetra dokumente që po publikohen e që po dëshmojnë për vjedhje të vakëfit të Shkupit! Shaqir Fetai hala nuk e tha një fjalë për humbjen e Teqes së Arabatit. Shaqir Fetai hala nuk po dëshiron të pranojë se atij pushteti politik ia ndihmoi instalimin në krye të BFI-së pasi u arrit kompromisi me “dhurimin” e “Ini Pajkos” pushtetit që ia ndihmoi komplotin. Shaqir Fetai hala nuk e tha një fjalë se ku i shpenzoi deri më sot miliona euro nga prona e denacionalizuar në formë të letrave pa vlerë. Kurrë nuk i publikoi shifrat, duke menduar se do t’i vjedhë dhe do të shlyej gjurmë, pa kuptuar se dokumentet arkivohen dhe ato, herdokurdo do të dalin në opinion, siç i doli edhe dokumenti i UDB-së se ai, si “hoxhë” me nofkën sllave “ORAO” i ka shërbyer shumë më besnikërisht UDB-së se sa myslimanëve të vendit!**1KlikLarg/02.04.2023**

## **Sikur të ishte gjallë Bajram Begu?!**

**Çizma e baltosur e Shaqir Fetait “shkeli” presidencën e Shqipërisë! Asnjëra palë nuk tregoi se cili ishte motivi i kësaj vizite! Me ftesë e me kërkesë të kujt u realizua takimi në mes të Presidentit të Shqipërisë, z. Bajram Begaj dhe intrigantit e komplotistit Shaqir Fetai, alias “ORAO” (nofkë kjo policore derisa shërbeu si spiun i UDB-së, i dirigjuar nga oficeri i tij, Stanko Dagoviq**

*Nga Mahir Rexhepi*

Injoranca e Shaqir Fetait, komplekset e lakuriqësimit që e kanë mbërthyer deri në maje të hundës, krijimi tashmë i opinionit për atë si për një hajn, rrenc, dallaverxhi, manipulant, matrapaz, tradhëtar e degradues i vlerave fetare e kombëtare, veçmë po vjen gjithnjë e duke u trashur. Thonë: kur zullumi trashet, këputet! Po a e di Shaqir Fetai se çka bëhet kur trashet injoranca?! Kur trashet injoranca formohet imazhi i Shaqir Fetait duke marrur formën e trurit të tij si konopi i pistë kur bëhet strumbullar.

### **1.**

Një ditë i thamë që mos të merret me “pusulla” nga notesi i tij i Ramazanit, sepse, definicionet që po na i ofron po e lakuriqësojnë si kokrrën e injorantit! Ky, pa mbështetjen e Stanko Dragoviqit në intriga është si ai huti i xjerrur në diell, ndërsa në rrafshin intelektual-fetar pa mbështetjen e Sulejman Rexhepit shpërfytyrohet në një xhahil të pashoq!

E la vlerësimin mbi agjërimit dhe Ramazanin sepse ishte i zënë me takimin që ia bëri zëvendësambasadorit maqedonas në Berlin! E ka kënaqur, ia ka shtuar jetën, ia ka rregulluar ditën maqedonasit me këtë vizitë! A është në tokë të bukës ky far avdalli apo sinqerisht mendon se është funksionar i lartë shtetëror? Nuk i mjafton takimet me hoxhallarët e diasporës, madje i duken hiç asgjë në raport me takimin me zëvendësambasadorin maqedonas, Vasko Gërkov! Ky takim i paraqet kënaqësi dhe jo ai me hoxhallarët. Apo, mos deshti që t’i çojë dikujt selam se, ja, unë nuk takohem vetëm me hoxhallarët por edhe me ambasadorët e shtetit. Tamam shprehi kjo e spiunëve të UDB-së.

### **2.**

Në “pusullën” e tij të tetë shkëputur nga notesi i Ramazanit, Shaqir Fetai e shkruan një fjali të denjë për konkurs “kush ia zbërthen kuptimin e ka të garantuar udhëtimin për në Haxh”! Fjalja e shthurur e Shaqir Fetait është kjo: “Agjërimit është shkolla më praktike dhe efikase e humanizimit të personelit të njeriut sepse abstenim nga haja dhe pija sjell organizmin në gjendjen e etjes dhe urisë, gjendje kjo që sjellë “dhimbje” të barabartë të të pasurit dhe të varfurit”! Natyrisht, kjo fjali e Shaqir Fetait është kompilacion, është shkëputje prej një teksti tjetër që ky nuk ia ka dalur ta përkthejë mirë! Sepse, për ta përkthyer fjalinë nga serbishtja në shqip, duhet ta dishë mirë, logjikshëm dhe rrjedhshëm vetë gjuhën shqipe. Shaqir Fetai mendon se e di dhe, në praktikë, sa herë na paraqitet, na del se kur shkruan shqip mendon serbisht, ose, ka problem me përkthimin dhe vjedhjen e teksteve. Më tej Shaqir Fetai thotë: (Agjërimit) “ngjall ndjenjat ndaj atyre që nuk kanë dhe kjo mbjell në shpirtin e njeriut ndjenjë e bujarisë, humanizmit dhe solidaritetit”! Do me thënë, këtë efekt e shkakton vetëm agjërimit dhe ne, kur

nuk agjërojmë, jemi pa ndjenja dhe nuk jemi as humanë, as bujarë e as solidarë! Me këtë Shaqir Fetai konstaton se, vetëm një muaj duhet të dëshmojmë se jemi nën urdhërat e Zotit, pas kësaj “udri babo”! Ja pse Shaqir Fetai sillet si i ndërkryer, me ndjenja të vdekura, të cilat i ngjallen vetëm kur agjëron!

### 3.

Edhe “postulatin” numër 9 e ka tekst në serbokroatisht dhe është munduar ta përkthejë por që në variantin shqip e ka sjellë në formën më të shëmtuar! A ka logjikë kjo fjali e tij: “Njeriu shpeshherë harron pozicionin e tij te lartë duke qenë i shurdhër për të dëgjuar zërin e arsyes, logjikës, të kuptuarit, hyjnoren dhe bëhet fuqi e karakterit tjetër destruktiv – satanik.” Pozitën, o injorant, jo pozicionin! Duke qenë i shurdhër, apo duke u bërë, sepse kur njeriu është i shurdhër nuk mund të dëgjojë asgjë, ndaj dhe gabimet e tij mund të mos shënohen fare! Por ama, kur njeriu bëhet i shurdhër, si puna e Shaqir Fetait, kjo është sjellje tipike satanike!

### 4.

Shaqir Fetai parapëlqen “pozicionin” e altoparlantit partiak! Avdalli është lëshuar në fushatë partiake, pa ia kërkuar askush! Mos po i bie hija Shaqir Fetait që ky, me vrap o burra, të deklarojë: “URIME NISMA E MADHE E KOMBIT – KORIDORI – 8”! Koridori 8 nismë e kombit? I cilit komb, o Shaqir Fetai! Pse po ia futë kot! Zonja ambasadore e Ambasadës së SHBA-së në Shkup, zonja Angela Price Aggeler, për Koridorin 8 tha se është “projekt shumë i rëndësishëm për rajonin por edhe për SHBA-të.”! Zonja ambasadore më tej do të thotë: “Ky është më tepër se sa një investim i thjeshtë në rrugët e Maqedonisë së Veriut, ky është investim në ardhmërinë e Maqedonisë së Veriut dhe të gjithë vendeve të lidhura me Korridorin 8 dhe më gjerë. Kam besim se ndërtimi do të zhvillohet shpejtë dhe me sukses, duke afuar njerëzit e këtij rajoni më afër njëri-tjetrit”! Pra, nëse Shaqir Fetai mendon se me këtë rrugë do të afrohen shqiptarët në mes vete, mos të harroj, se kjo rrugë i afron në mes vete edhe serbët me maqedonasit! Tani, për cilën komb e ka fjalën që e paska nisur këtë projekt, sepse, aty, në përrurim të punëve, përveç shqiptarëve dukeshin në shumicë edhe maqedonasit! Kë e uroi Shaqir Fetai? Projekt kombëtar sa i përket rrugëve është rruga që do të lidhë me tunel Tetovën me Prizrenin! Pse nuk e uron nismën sa më parë të kësaj rruge Shaqir Fetai? Sepse, pikërisht kjo rrugë do të ishte projekt kombëtar, që do t’i afronte shqiptarët e tri shteteve! Ose rrugën e kombit Kërçovë-Dibër-Tiranë! Nuk guxon t’i përmendë Shaqir Fetai këto projekte kombëtare, sepse, sakaq dikush mund t’ia thyej këmbët e kolltukut dhe ai të përfundojë në kokërr të shpinës, me këmbë të ngritura lartë!

### 5.

Shaqir Fetai na paska qenë te presidenti shqiptar, z. Bajram Begaj! Po sikur të ishte gjallë Bajram Begu, a do ta pranonte në takim Shaqir Fetain!? Ai do t’ia këpuste kokën si vëmçit, ndërsa Bajram Begaj pa tjetër që do ta takojë, për t’ia ngrehur veshët, sepse, e di presidenti shqiptar se Shaqir Fetai e ka mbushë kupën aq shumë sa tani ka nisur të konceptohet si dëm i madh i kombit! Prandaj, në lajmin e presidencës, në titull të tij, pa e përmendur fare Shaqir Fetain, thuhet: “Presidenti Begaj pret një përfaqësi të Bashkësisë Fetare Islame nga Republika e Maqedonisë së Veriut”! Pra, “reisin” e zbrit me këmbë në tokë, duke i thënë “përfaqësi”, përfaqësues! Për dallim prej lajmit të modifikuar të Shaqir Fetait që për bazë ka lajmin e presidencës shqiptare, Presidenti Begaj ka folur për periudhën e lavdishme të BFI-së në kohën e ish-reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit, duke ia nënvizuar edhe kontributet që ky Institucion

i ka dhënë në rrafshin kombëtar më vitin 1999. “Presidenti Begaj, vlerësoi rolin dhe kontributin historik patriotik, fetar e edukativ, që Bashkësia Fetare Islame kishte luajtur për ruajtjen e identitetit të shqiptarëve, por edhe në mbështetje të vëllezërve nga Kosova të dëbuar gjatë vitit 1999 nga regjimi i Millosheviçit, duke hapur dyert e xhamive dhe ndërprerë veprimtaritë fetare.”, thuhet në komunikatën e publikuar në faqen zyrtare të presidencës shqiptare! Shaqir Fetai, akoma nuk ka një storie të tij kombëtare që do të mbahej në mend si kjo e ish-reisit të padiskutueshëm, efendi Rexhepit! Shaqir Fetai është dëmi më i madh dhe historik që i është bërë kombit shqiptar. Ky është mesazhi i Presidentit të Shqipërisë!

## 6.

Me t’u kthyer nga Shqipëria, Shaqir Fetai ndalet në një livadh ku kullosin bagëtitë dhe e falënderon myslimanin që atë livadh ia ka dhënë vakëf Myftinisë së Strugës! Ja pra, në kohën e Shaqir Fetait na u shtua vakëfi me një livadh! Por, a na thotë Shaqir Fetai se sa livadhe, sa fusha, sa objekte kapitale, sa prona ia hëngri vakëfit të BFI-së që kur e uzurpoi postin e “reisit”! Ky jo që është dëmi i madh i kombit, por është edhe katastrofa e BFI-së, është shëmtia më e turpshme që i ka ndodhur këtij Institucioni dhe myslimanëve, në përgjithësi. Kjo do të vërtetohet shumë shpejt!/**Kombetare/04.04.2023**

## **A blihet simpatia me fitra e zeqat**

**Është e drejte e gjithësecilit që të shtrojë iftar dhe të ftojë për iftar kë të dojë ai, madje, mundësisht, të ftuarit e tij ta kenë të drejtën e një gote raki si aoperativ para se të nisin iftarin! Dhe, kjo ftesë për iftar të përbashkët nënkupton edhe pagesën prej xhepit të vetë ftusit apo edhe prej atyreve që mund t'i mashtrojë si sponsoristë**

***Nga Mahir Rexhepi***

Kur të përmbysen vlerat është diçka që sinjalizon fundin e njerzillëkut, një hap drejt kijametit! Dëbimi nacist i shqiptarëve të Kosovës gjatë spastrimit etnik të Slllobodan Millosheviqit, një numër të konsiderueshëm të shqiptarëve i përballi me një vlerë të pashpalosur deri atëherë të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Qindra e mijëra kosovarë u strehuan nëpër shtëpitë e vëllezërve të tyre në RMV. Një prej këtyre kosovarëve ishte edhe Naim Tërnavë, kryemyftiu i Bashkësisë Fetare Islame të Kosovës! Ky farë burri strehën e gjeti te shtëpia e homologut të vet, ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepi! Atë çka e bëri efendi Rexhepi për Tërnavën dhe për Institucionin e tij, Naim Tërnavë nuk do të mund t'ia kthejë për shtatëqind mijë Bajrama! Dhe nuk i kërkohet, absolutisht jo, porse njerzillëkun ia kërkon gjithësecili, madje edhe vetë Zoti! A e ka sot Tërnavë këtë vlerë?! Me veprimet që po i ndërmerren po dëshmon se ai është teneqe që lakohet kah të fryjë era! Sot ai i përulet, i bën nder të jashtëzakonshme, i serviliset Shaqir Fetait, armikut publik të Sulejman ef. Rexhepit, komplotistit dhe puçistit, tradhëtarit i cili ia nguli thikën pas shpine mikut “më të ngushtë” të Naim Tërnavës, H. Sulejman ef. Rexhepi! E thotë këtë islami?

### **1.**

Kur njeriu shkëput kontaktin me realitetin, atëherë kërkon “realitete alernative”, kërkon diçka që është jashtë kohës, jashtë hapësirës, jashtë porosive të Krijuesit Absolut. Kjo dëshmon për shpirtprishurinë e atij që ka kërkesa të tilla absurde, kjo dëshmon për humbjen e sensit të devotshmërisë, për humbjen e nevojës për të qenë njeri, për humbjen e natyrshmërisë së njeriut, për shëndërrimin e tij në djall!

Gjithnjë e më e evidente po bëhet humbja e simpatisë të cilën Shaqir Fetai është në gjendje edhe ta blejë me para, edhe ta kontrabandojë, edhe ta joshë si boss-i putanet e rrugicave të errëta. Shaqir Fetai është në gjah të “simpatie alternative”, të cilat nuk janë asgjë tjetër përveçse mashtrime optike që një ditë do t'i kthehen bumerang mbi kokën e pamend të avdallit!

Zoti edhe me Kuran ka bërë shumë të qartë se si guxon të shpenzohet fitri dhe zeqati! Në asnjë ajet kuranor, në asnjë praktikë islame nuk thuhet se fitri mund të harxhohet duke paguar iftar për popa, për politikanë, për biznesmenë, për pasanikë, për diplomatë. Këtë e lejon vetëm “islami” i Shaqir Fetait, i cili, me paratë e fitrit dhe zeqatit është në gjendje ta kryej edhe më të pabëshmen, më të dënueshmen dhe më të palejueshmen islamikisht!

Shaqir Fetai ka humbur simpatinë e myslimanëve të vendit. Shaqir Fetait i duhet simpatia e popave, e politikanëve, e dallaverxhinjëve, e diplomatëve etj. Dhe këtë simpati nuk e blenë ai me paratë e veta apo të familjes së vet por, me paratë e xhematit fukara që ka ndarë nga kafshata e vet për ta kryer një obligim islam në raport me institucionet fetare. Kryeinstitucioni fetar ato para

i shpenzon për teke dhe për interes të instalacionit që disa qarqe antiislame e sollën në krye të një Institucioni i cili tashmë rreptësisht është dashur ta dënojë veprimin e Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai thotë se ka shtruar “iftar tradicional”! Pse a paska edhe jo tradicional, a? Shaqir Fetai ka shtruar një iftar gllamuroz i cili nuk i ka hije një myslimani! Iftari u shtrohet të varfërve, fukarenjëve, të ngratëve, jetimëve, njerëzve në nevojë. Iftari nuk u shtrohet atyre përkrahja e të cilëve të duhet shumë. Sepse, nëse të përkrah një prift, apo një politikan, një funksionar shteti, e që kurrë nuk kanë shprehur më të voglin respekt ndaj vlerave të fesë islame, atëherë ti ke hequr dorë nga vlerat dhe nga interesat islame. Ke lajthitur në tru! Këtë nuk e durojnë myslimanët e devotshëm. Prandaj, që kur e instaluan këtë “melaqe të mullirit” në krye të BFI-së, fitri dhe zeqati i dorëzuar në BFI ka pësuar një rënie në masë prej 49.1 për qind në të mirë të shoqatave që funksionojnë në emër të “isalmi”! Mbase ky edhe është synimi i Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai, me këtë rast, paska mbajtur edhe një fjalim idiotik, përplot me budallallëqe që mund t’i nxjerrë vetëm goja e tij.

Shaqir Fetai thotë se “Iftari dëshmon konceptin hyjnor të Zotit se njeriu është vepra më e bukur dhe më e dashur e Zotit dhe çdo tendencë e nënçmimit të kësaj veprë të përkryer të Zotit, është kundër vullnetit dhe ligjit të Zotit.” Pra, mos më shani mua për këtë iftar se do të jeni kundër Zotit! Nuk guxon ta nënçmoni Shaqir Fetain “si krijesë e Zotit” sepse do të jeni kundër Tij! Shaqir Fetai duhet të duartrokitet dhe të adhurohet për vjedhjen e fitrit, për nëpërkëmbjen e fitrit, për vjedhjen e vakëfit, për shkatërrimin e institucionit islam, për devalvimin e fesë islame, për talljen me medresantët, për gjithçka që ai vepron natë e ditë kundër fesë islame!

Shaqir Fetai thotë se “Iftari është ambient i Ramazanit kur pas agjërimit vjen dashuria ndaj njëri tjetrit, afërsia me tjetrin, mbjellja e paqes, solidaritetit, mirëqenies, kujdesit dhe ideja për një jetë të lumtur për të gjithë”! E para iftarit të Ramazanit, gjatë kohës së agjërimit nuk ka as dashuri, as paqe, as kujdes, as mirëqenie, as lumturi... A është në vete se çfarë flet Shaqir Fetai, ky turp i gjithë myslimanisë! Ky është në gjendje të pallamudë gjithçka para atyreve që ndonëse e dinë që i gjori është duduk fare, do ta duatrokasin si “alim”!

Dhe ky farë “alimi” vazhdon më tutje, duke thënë se “prezenca e juaj sonde në këtë iftar modest kësaj nate dhe këtij ambienti të iftarit i dhatë kuptimin, synimin dhe gatishmërinë për të evituar të keqen, destruktiven, armiqësinë në mes njerëzve, për të eliminuar varfërinë, skamjen”! A ka më cinizëm se kaq! A ka idiotizëm më shumë se kaq! A ka injorancë më të madhe se kaq! Jo! Shaqir Fetait iu paska dashur ky iftar që të marrin fund keqkuptimet, destruktivja, armiqësia në mes njerëzve, të marrë fund fukarallëku?! Pas këtij iftari të Shaqir Fetait qenka eliminuar skamja, varfëria!!! Zaten, Shaqir Fetai kurrë nuk sheh të varfër, fukarenj, të skamun, porse, për të, të gjithë janë qenie potencialisht për t’u spiunuar, ndaj të cilëve nuk duhet të kihet as mëshirë dhe as respekt. Ky është Shaqir Fetai, medet për myslimanët e vendit!

## 2.

Shaqir Fetai, pikërisht në ditën kur një Komunë e tërë, një Myftini e tërë vendos që t’u shpreh respekt teologëve historik të këtij territori, hoxhallarëve nga Tetova që dhanë gjithçka për fe e për komb, gjeti që të mungojë e t’i përgjigjet thirrësit i cili do t’i shtrojë një “iftar solemn”! Shaqir Fetai vdes për iftare të tilla, aq më tepër kur ato shtrohen nga miqtë e dikurshëm të ish-reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit!

Çka i hy në xhep myslimanëve të vendit, Institucionit fetar, iftari i Naim Tërnavës që e shtron për Shaqir Fetain? Dy shpenzime (të të dy bashkësive fetare) për t’i shprehur respekt Shaqir Fetait, bashkëpunëtorit të oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit! Vetëm një mosmirënjohës, një i të të

njëjtave ujëra të turbullta, si Naim Tërnavë, mund t'i shpreh respekt armikut më të fëlliqtë të mikut të tij të dikurshëm, H. Sulejman ef. Rexhepit!

Shumë shpejtë, madje është çështje muajsh kur do të dalin studimet e sakta, bazuar në fakte e në argumenta, që do të flasin për të keqen e tmerrshme që i ndodhi myslimanëve të vendit, Bashkësisë Fetare Islame si dhe vetë islamit që me shekuj është kultivuar në këtë nënqiell, e që u shkaktuan që nga momenti i instalimit politik të Shaqir Fetait në krye të BFI-së nga disa qarqe që e kanë ëndërruar me shekuj pozitën kaq të mjerë e kaq katasrofale të BFI-së në këtë vend! Këtë e arritën vetëm pasi e mbollën farën e keqe, Shaqir Fetain, në bahçen e myslimanëve të këtij vendi!/**TetovaSot/08.04.2023**



## Hajni i meritave të huaja

**Ai që e vjedh të mirën e përgjithshme, ai që e zhatë vakëfin, ai që vjedh fitrin e zeqatin, ai që vjedh dhe e shpërdoron pozitën, ai nuk e ka dert për të vjedhur edhe meritat e huaja. Madje, vjedh duke u krrekosur si gjeldet, pa fije turpi**

*Nga Nexharie Fejzullahu*

Kur hoxhallarët e vendit, me ligjeratat e tyre sensibilizuese për vështirësitë nëpër të cilat po kalonin shqiptarët e Kosovës, të vrarë, të masakruar e të dëbuar prej vatrave të tyre; kur Bashkësia Fetare Islame e RMV-së ishte bërë si një lloj qendre për shqiptarët e Kosovës; kur Bashkësia Islame përmes Organizatës së vet Humanitare “El Hilal”, të drejtuar nga Dr. prof. Abdurauf Pruthi si dhe nga sekretari gjeneral, z. Bexhehudin Shehapi, të cilët ia kishin dalur që të krijojnë një rrjet të hatashëm humanitar që vepronin nën amblemën e kësaj Organizate; në kohën kur ish-reisul ulema i BFI-së, H. Sulejman ef Rexhepi, ishte dëshmuar si një strateg i hatashëm i logjistikës së luftëtërave shqiptarë të cilëve po u dilte në ndihmë në mënyra të ndryshme por edhe duke u premtuar se asnjë shqiptar nga Kosova nuk do të ngelë i pastrehuar nëpër shtëpitë e myslimanëve të vendit (përfshirë edhe shtëpinë e vet ku e kishte strehuar Kryemyftiun Naim Tërnavë me familëjn e tij) – pra, në këtë kohë, mjerisht, Shaqir Fetai po përpiquej që të tërhiqej nga kthetrat e ofierit të UDB-së (Stanko Dragoviqit) dhe ta kamuflonte veprimtarinë e tij disa vitëshe prej ud bashi!

Natyrisht, sot, edhe një herë ishte momenti që të shprehet mirënjohja ndaj këtij Institucioni i cili, në momentin e duhur, në kohën e duhur, pati njerëz, besimtarë të devotshëm, që ditën t’i dalin në krah kombit që po kalonte ditët e veta më të vështira! Paradoksi na del sot, pikërisht në momentin e shprehjes së kësaj mirënjohje, të cilën e vjedh si hajni i pafytyrë, Shaqir Fetai! Kontributi i Shaqir Fetait ka qenë zero! ZERO! Edhe nëse ka bërë eventualisht ndonjë punë të hajrit, atë e ka bërë me urdhër të prerë të H. Sulejman ef. Rexhepit! Vetëm ai mund ta dijë se cili ishte kontributi i tij në drejtim të UDB-së! Në kohën kur ndodhi Tragjedia e Madhe e Kombit, Shaqir Fetai ishte “jeshil”, ruhej, frikësohej, nuk ishte në linjën e frontit humanitar, sepse, e dinte veten, e dinte se në ç’m... ishte i zhytur dhe kishte kujdes që mos të kapej nga ata që ta hiqnin flamën si pulave kur u bie derxha!

Sot, Shaqir Fetai, duke menduar se ngjarja ka ndodhu para pesë shekujve dhe se nuk ka ngelur asnjë dëshmitarë që mund ta dëshmojë të kundërtën e asaj që mundohet ta “prezantojë” avdalli, shkon në një manifestim, ku nuk e ka vendin pa e pasur aty edhe ish-Reisin, H. Sulejman ef. Rexhepin, pa e pasur aty një suitë hoxhallarë që në atë periudhë u shquan si personalitete kombëtarisht të paluhatshëm, pa i pasur aty nja tri-katër kryefamiljarë të cilët kanë strehuar me dhjetra e dhjetra vëllezë e motra nga Kosova!

Një bravo të madhe organizatorit të këtij eventi përkujtues! Duke e ditur ata se kush është Shaqir Fetai, duke ia ditur “kontributin” e diskutueshëm të tij, duke ia njohur karakterin dhe kleptomaniën e tij për të vjedhur e përvetësuar meritat e huaja, kanë bërë shumë mirë që mirnjohjen ia ndajnë Institucionit, atij Institucioni që ka bërë histori në këtë aspekt humanitar, atij Institucioni që në krye me H. Sulejman ef. Rexhepin ia doli që ta japë provimin kombëtar dhe përjetësisht të kujtohet si vatër e humanitetit kur ndodhi Tragjedia e Madhe!

Edhe njëqind mijë Shaqir Fetaha të kalojnë nëpër BFI megjithatë nuk do t'ia arrijnë kurrë ta kenë atë fat siç e pati ish-reisul Ulema ef. Rexhepi për ta larë një borxh që mund ta ketë pasur ndaj kombit të vet! Shaqir Fetai kohëve të fundit, pak para “pensionimit” të tij (meqë ka nisur ta nuhasë “fluturimin” tepe-taklla), ka nisur edhe të sponsorizojë aktivitete që do t'i japin pak “lagështi” (vllagë) patriotike! Keqpërdorim i fitrit dhe zeqatit për ta shpëlarë fytyrën e vet të pistë! Sepse, të jeshë krah i djathtë i liderit Ali Ahmeti (siç deklaroi Fetai me plotë gojë!!!), të jeshë mysafir (ndonëse i paftuar, me sponsorizim) i presidentit shqiptar, të tokësh dorën me një prej legjendave të gjalla të UÇK-së, z. Ramush Haredinaj, të marrësh në dorë mirënjohjen që i jepet BFI-së për kontributin në kohën e Tragjedisë Kombëtare, vërtet që të duhet të shkundes nga vesi i së kaluarës për t'i shërbyer UDB-së! Edhe udbash, edhe patriot nuk shkojnë!

Sulejman ef. Rexhepi e porositi me ngulm dhe e sponsorizoi botimin e biografisë së ish-reisul ulemasë së BFI-së, H. Bedri ef. Hamidi! Insistoi që mbi faktet, mbi dokumentat dhe mbi rrëfimet autentike të bashkëpunëtorëve të efendi Bedriut, të botohet një biografi që do të fliste se BFI-ja ka pasur një traditë të padiskutueshme patriotike, trupi teologjik i këtij Institucioni si dhe të gjithë hoxhallarët duhej të ishin në këtë vijë, ndryshe nuk do të kishte mundësi që islami të zhvillohet kaq fuqishëm, madje më fuqishëm se në çdo vend etnik tjetër! Deri sa nuk erdhi momenti i Tradhëtisë së Madhe, derisa Shaqir Fetai nuk u vu në krye të komplotit dhe të tradhëtisë për ta përmbysur tërë atë traditë patriotike të BFI-së dhe për ta instaluar një “të parë” me zgjidhje dhe imponim politik e antiislam, me një të kaluar prej spiuni, i cili, nuk çanë kokë për këtë të kaluar të tij, sepse e ka ushtruar në mënyrë të dinjitetshme dhe me shumë pasion.

P.s./ Çdo njeri normal, çdo njeri i pangarkuar, çdo njeri që e ka dert zhvillimin e ndjenjës kombëtare, nuk do ta bënte këtë gest të Shaqir Fetait! Barra e zhvillimit të strategjisë së BFI-së si Institucion i drejtuar nga H. Sulejman ef. Rexhepi, si dhe barra e zhvillimit të aktivitetit vëllazëror e humanitar kishte rënë mbi shpinën e ish-sekretarit të OH “EL Hilal”, do të ishte shumë korrekte dhe islamikisht në rregull që këtë mirënjohje dhe dekoratë ta tërhiqte z. Bexheudin Shehapi dhe të njëjtën ta dorëzonte në BFI, dhe jo Shaqir Fetai i cili atëbotë ka qenë tërësisht në linjë të gabuar dhe antikombëtare!/**TetovaSot/11.04.2023**

## **Manipulimi me fitra vepër penale**

**Pse gënjehet që po mblidhet fitri për medresantët! Ku janë medresantët sot? Fatkeqësisht, sot më shumë kemi medresantë të punësuar në shërbime sekrete e në administratë shtetërore sesa në administratën e BFI-së! Në BFI-në e sotme kemi dhjetra pensionistë, pleq, të cilët edhe marrin pension por edhe punojnë edhe më tej në BFI duke marrur rrogë, ndërsa medresantët, kuadri me përgatitje solide, madje edhe nëpër universitetet prestigjioze arabe, shëtiten poshtë-lartë nëpër rrugët e Perëndimit duke kërkuar ndonjë angazhim ditor**

***Nga Mr. Eset Shaqiri***

Fitri është një formë sadakaje, një detyrim i robit dhe i të lirit, i të voglit dhe i plakut, i mashkullit dhe femrës. Ky veprim human, gatise kolektiv, kryhet sidomos kah fundi i muajit Ramazan. Tubohet dhe u shpërndahet të varfërve, me qëllim që edhe ata të kenë mundësinë për ta shtruar dhe për ta pasur të begatshme sofrën e Bajramit! Jepet në fund të agjërimit me qëllim që të bëhet pastrimi i agjëruesit nga ndonjë e metë (përgojim, fjalë e keqe etj.) që mund ta ketë përcjellë agjëruesin gjatë këtij muaji përplot me ibadete. Pa dyshim, pjesa tjetër u shpërndahet kategorive të përcaktuar edhe me Kuran: “Allahu e caktoi obligim, që lëmosha (zeqati, fitri etj.) t’ju takojë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që duhen përfituar zemrat (të dobtëve në besim), e duhet dhënë edhe për lirimin nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve) në rrugën e Allahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. Allahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet.” (Et Teube, 60)

Natyrisht, më vonë, kur u hapën institucionet arsimore fetare (medresetë), popullata jonë myslimane sikur e bëri traditë që fitrin ta dorëzojë në këto vatra shkollore me qëllim të përgatitjes së kuadrit profesional fetar. Por, në momentin kur medresantët filluan ta vetëfinancojnë shkollimin e tyre, në momentin kur kjo shkollë do të financohet edhe prej shtetit, atëherë, pse duhet të grumbullohet fitri në emër të Medresesë! A nuk është ky një manipulim dhe, a nuk është manipulimi vepër penale! Fatkeqësisht, kjo vepër penale Bashkësinë Fetare Islame e ka shndërruar pjesërisht edhe në “institucion mashtrimi dhe gënjeshtre”, në ditë me diell manipulon dhe, deri më sot, nuk ka institucion që t’i dalë përpara dhe ta ndëshkojë manipulatorin. Po kur manipulimi bëhet në emër të fesë islame kjo i konvenon institucioneve shtetërore!

A lejohet që fitri dhe zeqati, i mbledhur në emër të të varfërve, i dhuruar nga ata që dëshirojnë që para Zotit të Madh të dalin sa më të pastër, të shpenzohet duke paguar iftare për popa e për politikanë, për pasanikë e për ata që kurrë në jetën e tyre nuk kanë agjëruar, për ata që janë deri në gushë të zhytur në mëkate, në zina, në alkool, në intriga e në projekte antiislame?

A lejohet që ky buxhet i dedikuar për të varfër të shpenzohet për mëditje derisa funksionarët e BFI-së shëtiten poshte e lartë dhe derisa i shtrojnë vetes “iftare solemne”, ndërkohë që nuk pati ndonjë projekt me të cilin do t’i dilej në ndihmë të gjithë të varfërve myslimanë të vendit përgjatë tërë muajit të Ramazanit!

Pse gënjehet që po mblidhet fitri në emër të Medresesë! Pse po na gënjenë Shaqir Fetai për çdo muaj duke na thënë se “tash u bë akreditimi i Medresesë”. Ai nuk iku vjet në haxh duke thënë se Arafat për të sivjet është akreditimi i Medresesë. Ngeli i gjori edhe pa Arafat (pa Haxh) por edhe pa akreditim! Po vie edhe koha e ndarjes së diplomave për medresantët! Çfarë do t’ju thotë atyre, çfarë do t’ju thotë prindërve të tyre! Do t’i gënjejë edhe sivjet se akreditimi u bë dhe se ata mund të regjistrohen ku të dëshirojnë?

Ku janë medresantët sot? Fatkeqësisht, sot më shumë kemi medresantë të punësuar në shërbime sekrete e në administratë shtetërore sesa në administratën e BFI-së! Në administratën e BFI-së së sotshme kemi dhjetra pensionistë, pleq, të cilët edhe marrin pension por edhe punojnë edhe më tej në BFI duke marrur rrogë, kemi të punësuar që në dy-tri vende marrin rrogë, ndërsa medresantët kuadri me përgatitje solide, madje edhe nëpër universitetet prestigjioze arabe, shëtiten poshtë-lartë nëpër rrugët e Perëndimit duke kërkuar ndonjë angazhim ditor!

A i njuh xhemati ynë medresantët, a i di se kush janë ata, sa po përgatiten për të ardhmen e islamit, kush po i përgatit ata, si po i përgatit! Më herët, kjo dihej, sepse ishte praktikë që, gjatë Muajit të Agjërit, nëpër xhamitë e vendit të angazhoheshin edhe medresantët, madje edhe të shpërndaheshin nëpër xhamitë e vëllezërve tanë në diasporë! Mbanin ligjerata, kryenin obligime fetare, xhemati mburrej me ata, xhemati praktikisht i shihte dhe krenohesh me fitrin, me zeqatin, me kontributin e vet! Kishte nga ata që derdhnin lotë gëzimi tek i verente medresantët HOXHALLARËT E ARDHSHËM, kishte nga ata që hidhëroheshin nëse nuk u vinte rendi për t’ua shtruar një iftar medresantëve të angazhuar në terren, kishte nga ata që bindeshin për ta udhëzuar femijën e vet për ta vijuar këtë shkollim.

Sot nuk i ke askund medresantët! Nuk i ke të përfshirë as në ligjerata, as në “akademi shkencore”! Intrigantët dhe munafikët që organizojnë “akademi shkencore” për pleqtë e rraskapitur, ku mungojnë studentët dhe medresantët! Natyrisht që do të mungojnë, sepse kush më mirë se medresantët dhe studentët do ta dijnë se “akademikët shkencor” nuk janë asgjë tjetër përveçse kuazimësues dhe manipulantë! Po pse parapëlqehen pensionistët dhe jo medresantët, kadri i ri? Sepse, pensionistët blihen me rroga, sepse pensionistët i duhen “drejtuesve” aktualë të BFI-së, sepse të rinjtë janë revolucionaristë, janë reformatorë ndërsa status quo-ja në institucion mbahet më lehtë me pensionistë, mbahet më lehtë me injorantë e intrigantë, të cilët, mund të hanë buk vetëm në grazhdin e superinjorantit dhe superintrigantit siç po na del aktualisht Shaqir Fetai!

Duke i injoruar kuadrot e veta që i prodhojnë e që janë shumëfish më të ngritur intelektualisht se “prodhuesit” e tyre, këta të BFI-së së sotshme kanë ardhur në derexhe që të kërkojnë “ligjerues” nga Kosova, nga Shqipëria e nga bota arabe, thuase xhemati ynë e “shkoqë” arabishten! Epo, si ndryshe të shpenzohen fitrat dhe zeqati i myslimanëve tanë nëse jo nëpër “iftare gllamuroze”, të shtruar për të mëkatshmit dhe për ata që Medresenë tonë as që denjojnë ta akreditojnë formalisht, pa pasur kurrfarë obligimi financiar ndaj kësaj vatre arsimore! Apo, krejt kjo bëhet për politikë, për t’i nxjerrë sa më të mirë pikërisht ata që nuk e duan as medresenë dhe as fenë! Të përdoret fitri dhe zeqati për qëllime politike fare meskine, ky është manipulim klasik dhe, një ditë, manipuluesit duhet të japin përgjegjasi, jo vetëm para Allahut xh.sh. por edhe para drejtësisë në këtë vend! Atyre duhet t’u bëhet me dije se, nuk kanë se çfarë të nisen për të dalur para Allahut të Githëdijshëm. Sepse, shkurt e qartë – ata, manipuluesit e fitrit, që të gjithë janë mëkatarë! Për këtë fakt myslimanët e vendit gjithnjë e më shumë po ndërgjegjësohen, prandaj, çdo vit, po pakësohet numri i atyreve që paguajnë fitrin të BFI-ja, e cila, që tani bën me dije se “iftaret” për popat dhe stërpanikët do t’i ketë “iftare tradicionale”!/**TetovaSot/15.04.2023**

## Vjedhje fetaro-"artistike"

**A e mbani mend motivin e shprehur nga Shaqir Fetai për aktin e tradhëtisë dhe të komplotit që e zhvilloi! Na pat deklaruar se ka platformë, program dhe synime për reforma të thella në BFI për, aktivitete që rrënjësisht do ta dallojnë BFI-në nga ajo e H. Sulejman ef. Rexhepit, i cili u degradua dhe u njolloso pikërisht nga ai për të cilin kishte harxhuar një jetë duke i thurrur lavde dhe elozhe, ndonëse e dinte që përveç lojaltetit të verbuar tjetër vlerë nuk kishte në shoqërinë tonë**

***Nga Mr. Abaz Islami***

Deri më sot, që nga instalimi i tij nga qarqet antiislame në krye të BFI-së, Shaqir Fetai nuk u shqua me ndonjë aftësi organizative, me iniciativa e ide reformuese, përveçse u shqua siç ka qenë gjithnjë: mediokër, snob e demagog i llojit të vet!

Shaqir Fetai e nisi dhe e përcoll Muajin e Ramazanit pa kurrfarë aktiviteti institucional që do të ishte më i avancuar se ato tradicionalet! Shaqir Fetai, ose nga turpërimi i thellë ose nga intelekti i tij impotent, ose nga paaftëia totale, nuk ia doli që të ngrisë një jetë kulturo-fetare që do të mbajnë vulën e tij! Ai inicon aktivitete të kota, por që duhet të jenë gllamuroze, masovike, sepse ka nevojë që ta ndjejë euforinë e “masës”, duartrokitjen e saj, të ndjejë amnestinë dhe rehabilitimin e masës për tërë atë tradhëti që e kreu dhe që e zhvilloi, si në jetën studentore ashtu edhe më vonë, deri te ngulja thikë pas shpine njeriut i cili i besonte më shumë së fëmijëve të vet! A është reformë organizimi i “programeve” fetaro artistike (!) ku ia del që ta shfrytëzojë atmosferën festive dhe të paraqitet para opinionit! Ndryshe, ai e ka tmerr të paraqitet në opinion, të paraqitet në debat dhe të mbrojë veprimet e tij destruktive dhe të pista. E ka tmerr që të japë qoftë edhe vetëm një argument, të cilin pastaj i duhet ta mbrojë islamikisht. Ai mbase edhe mund ta provojë një argument para ndonjërit që nuk ka njohuri të thella mbi islamin, por ama para një teologu Shaqir Fetai do të ikte si djalli prej temjanit!

A është reformë “Bakllava e Bajramit”, të cilin e shpiku ish-reisul ulema të cilin e llogariste “baba shpirtëror”? Shaqir Fetai nuk e di cili ishte motivi i kësaj “shpikje”, ose, e di por ja që mendon se opinioni ha bar dhe nuk e di të vërtetën e saj! Është e rëndë për Shaqir Fetain që ta vazhdonte traditën e hapjes së dyerve të BFI-së për këtë ditë festive dhe Institucionin ta frekuentonin qindra myslimanë, personalitete të ndryshme të vendit. E ka frikë këtë traditë, sepse është i bindur se do të turpërohet e do të zezohet – nuk do t’i shkojë askush, madje as vetë myftitë në zyren e tij të uzurpuar nga puçi klasik dhe nga komploti përplotë intriga!

Eventet e tilla sa janë formale aq janë edhe përplotë me demagogji! Pjesëmarrja e secilit aty nuk është asgjë tjetër përveçse pozë dhe reklamë, sepse, nuk përbën asnjë risi, asnjë kureshtje!

Bakllava, deri në mbajtjen e këtij “eventi”, gjatë ditës, është konsumuar nga të gjithë. Askujt si ka ngelur deri te “bakllava e BFI-së”? Thjesht, e ndjejnë si aktivitet formal-demagogjik dhe në të njëjtën mënyrë edhe sillen, që të gjithë, pa përjashtim! I vetmi interes ngel i Shaqir Fetait, sepse ja edhe një mënyrë për t’u paraqitur para “opinionit” si “reis” që dashurohet prej të gjithëve!

Burri i vërtetë nuk ka nevojë për “dashuriçka” të tilla! Shaqir Fetai, po!//**TetovaSot/24.04.2023**

## Ndëshkimi i Zotit po vjen

**Një mallkim i tmerrshëm ka ngulfatur Bashkësinë Fetare Islame në RMV, e cila tashmë po i përjeton grahmat e veta të fundit në këtë përbërje dhe e konceptuar kaq keq për një institucion reprezentativ fetar! E kapur me intriga, me tradhëti, e kapur me mashtrime e shpifje, e kapur me dorën e elementeve antiislame, e kapur padrejtësisht dhe pa leje të Zotit – pa dyshim që herdokur ndëshkimi i Tij do të vie! Ja tek po vjen**

*Nga Mahir Rexhepi*

### 1.

Asnjë komplot e puç, asnjë intrigë e tradhëti nuk është përshkruar aq shumë, madje deri në detajet më të imëta, sesa kjo e Shaqir Fetait, këtij farë instalaconi të shpifur e të poshtër nga qarqet antiislame që e instaluan në krye të BFI-së! Bashkëpunëtorët e tij të sotshëm u manipuluan, sepse kjo ishte në strategjinë e Shaqir Fetait dhe, pa dyshim, ishte e vetmja kërkesë drejtuar atyreve që do ta instalojnë: mi bindni bashkëpunëtorët që të më binden! Kurse vetë u tha: marioneta të mia, më përkrahni derisa të pensionohem, nuk më kanë ngelur shumë, edhe dy vite! Pra, e kërkoi bekimin e tyre për dy vite, deri në pensionim!

Bazuar në CV-në e Shaqir Fetait që na del në dokumentin e vetëm publik të tij, publikuar nga UDB-ja, mbase si shantazhë kur i kanë hetuar përpjekjet e tij për të ikur nga “zyret e bezdisshme” të UDB-së, ku ai një jetë të tërë kishte spiunuar pjesëtarë të familjës, miq e shokë si nga koha e studimeve ashtu edhe gjatë “ndërtimit” të karrierës së tij prej “hoxhe”, pra, bazuar në këtë dokument, Shaqir Fetai tashmë i ka përmbushur të gjitha kushtet për të ecur, për t’u pensionuar, ashtu siç ua kishte dhënë fjalën bashkëpunëtorëve të tij të sotëm! Apo ndoshta, Shaqir Fetai ka marrur amanet një mision krejt të huaj të cilin as që ka pasur kapacitet deri më sot që ta lëvizë qoftë edhe një hap ndaj dhe, është dashur që t’i gënjejë bashkëpunëtorët e vet aktualë, të cilët, po del puna se e paskan gënjyer opinionin kur i thoshin: na e kërkoi për dy vite deri në pensionim, dhe ne e votuam! Shaqir Fetai e dinte se të gjithë bashkëpunëtorët e tij do t’i kompromitojë dhe do t’i mbajë nën dyzginat e veta që në momentin kur ata pranuan që të jenë kukulla që do ta stolisin “piarin” e Shaqir Fetait. Ky ishte mashtrimi më i madh që iu servir opinionit të gjërë: Shaqir Fetai “reisi ynë”! T’i shërbeshë Shaqir Fetai dhe me vetëdije të plotë të pranoshë që të bëhesh kukull e tij, kjo do të thotë se nuk je i gatshëm t’i shërbeshë një institucioni fetar porse je pacient potencial për çmendinë (Iludnicë)!

Shaqir Fetai mbase edhe nuk do të pensionohet, sepse, jo vetëm që nuk ia ka dalur ta lëvizë projektionin antiislamik të strukturave që e instaluan në krye të BFI-së, por edhe për faktin që, BFI-ja, si kurrë më parë, në asnjë periudhë të saj, është përplotë me pensionistë që vazhdojnë të punojnë nëpër organet e BFI-së dhe, të marrin pagesa të dy fishta: edhe pension edhe rroga! Pasojat e kësaj “strategjie” teksa do të shihen.

### 2.

“Strategjia” e Shaqir Fetait për të qëndruar sa më gjatë në krye të BFI-së bazohet në gënjeshtër, në tradhëti, në spiunim, në trishim, në intriga, në shantazhe, në blerje të përkrahësve, me 30 mij euro, me 70 mij euro, me heshtje të vjedhjeve të rënda, me keqpërdorime, me shpërdorime të pozitave për të krijuar kushte për vjedhje e për zhvatje të vakëfit. A janë të vetëdëshëm

nëpunësit e BFI-së se çka i bëri Shaqir Fetai vakëfit të BFI-së? A janë të vetëdëshëm se, duke u bërë kukulla stolisëse dhe karadyzen të Shaqir Fetait, në fakt e ndihmuan që të harxhojë miliona euro dhe për po aq euro ta dëmtojë vakëfin e BFI-së? Këto janë fakte dhe, gjurmët e këtij krimi nuk do të mund askush t'i fshijë e t'i zhdukë! Një ditë do të kërkohen të gjitha letrat me vlerë që u dhanë si formë e denacionalizimit të Vakëfit!

Keqpërdorues i tmerrshëm dhe më i pashembull ky farë Shaqir Fetai! A i keni parë se si i radhitë telegramurimet që ia paskan dërguar personalitete të ndryshme me rastin e Fitr Bajramit! Urimi është një akt personal që i shprehet një personi dhe, këtu përfundon rëndësia e këtij akti! Çfarë peshe do të kishte urimi për Bajram i z. Pendarovskit, apo i z. Zajevit që do t'ia shprehnin, bie fjala, një myslimani të rëndomtë! Mbase edhe do të ndjehej i fyer! Ndërsa Shaqir Fetai përjeton lezet të madh!

Është keqpërdorim flagrant publikimi i dokumenteve-memorandumeve të institucioneve të ndryshme! Vetëm Shaqir Fetai i fotografon, i skenon dhe i publikon në formën origjinale! Sepse, në ndërdije e ka të qartë se tashmë ka humbur besimin ndaj dhe i duhet "origjinali" dhe, e dyta, është mësuar të jetë në shërbim të shejtanëve, sepse, publikimi i një dokumenti origjinal është gjest i mirësardhur për fallsifikatorët. Urimet dhe institucionet e personalitetet që kanë uruar mund të përmbliidhen në një informatë dhe aty të nënvizohet se prej nga kanë ardhur ata urime dhe kujt i dedikohen! Natyrisht, të gjitha i dedikohen myslimanëve të Maqedonisë së Veriut, Shaqir Fetai përdoret vetëm si "kuti postare" apo si adresë e jo si mik apo "personalitet botëror"!

### 3.

Në pamundësi për të zhvilluar aktivitete reformuese, Shaqir Fetai pret si huti në degën e thatë që të dëgjojë ndonjë tingull fteseje! Dhe pastaj, lëvizjet "e veta" i publikon me pompozitet, tamam si një fëmijë kur arrinë ta shtyjë një lodër nga e cila ka frikë! "REISUL ULEMA MER PJESE NË MBROJTJEN PUNIMIT TË Z. IMER HALILIT PËR SPECIALIZIM TË METODIKËS SË MËSIM BESIMIT NË FSHI – SHKUP", ka shkruar Shaqir Fetai i ngazëllyer nga ky "aktivitet"! Po si guxon që të duket në panel, në tavolinën e komisionit para të clit mbronë tezën e vet një kandidat në diplomim, në master apo në doktoranturë! Është shkelje fagrate e pozitës, sepse është konflikt interesi, sepse me pranimin e vet në panel do të ndikojë drejt për drejt mbi anëtarët e komisionit! Shaqir Fetai mund të marrë jesë vetëm si publik.

"REISUL ULEMA MER PJESE NË EKSPozITËN E SHMI "MEDRESEJA ISA BEU"- PARALELJA E VAJZAVE- NË BASHKPUNIM ME MYFTININË E TETOVËS", është një informatë që nga ku shihet qartë se si Shaqir Fetai, mundin dhe sukseset artistike të medresanteve mundohet t'ia atribuojë vetes! Po si ka fytyrë të gjendet në mesin e atyreve të cilat i ka gënjyer me dhjetra herë. A iu tha vitin e kaluar se nuk do të shkonte në Haxh sepse për të Haxh qenka akreditimi i Medresesë që do t'ua bëjë brenda ditës! Ikën 365 ditë, një vit i plotë, u organizuan edhe protesta në rrugë kundër Shaqir Fetait i cili, me pamundsinë e tij, me paautoritetin e tij, me paaftësinë e tij, po ua dëmton rëndë perspektivën akademike medresanteve, bijave, motrave tona! Dhe ky ngeli edhe pa haxh edhe pa akreditim! Dhe ky del para tyre duke i gënjyer edhe më tej! Është mëkat për këto medesante që nuk ia dolën të organizohen dhe ta gjuajnë me vezë e ta dëbojnë rrencin nga eventit i cili shpreh talentin, mundin dhe përpjekjet ekskluzive të tyre. BFI-ja e Shaqir Fetait nuk ka merita në asgjë! A mos pati ndonjë projekt për t'i ndihmuar ato vajza krijuese me penela, me kanavace, me pëlhura, me letër-hameri, me ngjyra etj!

"REISUL ULEMA I BFI E RMV MORI PJESE NË EKSPozENË E PRESIDENTES SË KOSOVËS DR VJOSA OSMANI- SADRIU NË KUVENDIN E RMV", shkruan Shaqir Fetai

mbi një informatë të publikuar nga agjencia maqedonase informative (MIA)! Jo po “paska marrur pjesë edhe në pritjen e Presidentes Osmani”! I ftuari mysafir paska pritur mysafir! I pret i zoti i shtëpise dhe jo turllifarë ahmaku! Po mirë, kur jemi te Presidentja, pse Shaqir Fetai nuk mori pjesë, aty ku ishte edhe Presidentja Osmani, në inagurimin e rrugës të cilën Komuna e Çairit e ka emëruar “Ibrahim Rugova”! Po pse Shaqir Fetai nuk mori pjesë në këtë event historik të organizuar nga Komuna e Çairit e tepër të rëndësishëm për shqiptarët e Shkupit dhe të tërë vendit? Sepse ishte i organizuar nga personalitetet e “Grupit të Zjarrit”! Do me thënë, ishte gabim edhe pjesëmarrja e Presidentes Osmani? Në këtë rast, do të nderohej “grupi i zjarrit” apo emri i Presidentit historik të Kosovës, Ibrahim Rugova! Shaqir Fetait i pengon çdo gjë që është kombëtare, ndërsa nuk i pengon kur me prezencën e vet prej udbashi njollosë cv-në e secilit personalitet kombëtar e fetar! Nejse, ku di dhia çka është taxhia!

#### 4.

Shaqir Fetai paska marrur pjesë edhe në darkën e shtruar nga Presidenti i vendit, z. Pendarovski! Po ku ka qelepir, mundësisht “qevapçiçi”, aty patjetër të jetë edhe Shaqir Fetai! E ka qejf ta qerasin, mundësisht nga shtatë herë në ditë. Por ama, vetë, kurrë në jetë nuk ia ka bërë një nderë askujt! Ja, zotëriu që i paska shtruar darkë Shaqir Fetait, mori pjesë edhe në një familje myslimane të përzgjedhur rastësisht për të hëngër, si president i shtetit, një iftar së bashku! Po Shaqir Fetai, a e bëri një gjest të tillë! A e përzgjodhi një familje të varfër të shijojë atë darkë modeste bashkë me ata! Aty ku nuk ka “qevapçiçi” as mos e thirrni Shaqir Fetain, sepse këtij nuk ia ka qejfi patatet, as kastravecën, as preshin! Mjaft është ngopur me të tilla “ushqime” një jetë të tërë! Tani e ka kohën e pensionimit, dëshiron nder e respekt më të madh, edhe pse askujt nuk ia shprehu kurrë, sepse është interesxhi tmerrshëm!/**IKlikLarg/TetovaSot/27.04.2023**



## **Kriminalizimi i Haxhit**

**I ndërkryeri, ky farë instalacioni i huaj në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, paska nënvizuar se BFI-ja qenka kujdesur që “të formojë një ambient” shumë të mirë për një agjërimit sa më të lehtë dhe për shumë aktivitete përgjatë Muajit të Ramazanit meritat qenkan të tij dhe të BFI-se së tij! Ky mendon se edhe agjërimit është iniciativë e tij. Është më se i bindur se edhe namazi, edhe teravitë, edhe lutjet në Itiqaf, gjatë Natës së Kadrit, kanë filluar që kur doli ky farë “tumoroidi” në skenën fetare. Sa i mjerë**

### ***Nga Mahir Rexhepi***

I vetmi aktivitet konkret dhe personal i Shaqir Fetait gjatë Muajit të Ramazanit ka qenë shtrimi i iftarit gllamuroz, për 500 veta, prej të cilëve 90 për qind që nuk agjërojnë, që nuk kanë pikë kontakti me islamin, që nuk e duan islamin, që e urrejnë mysimanin dhe që kanë pasuri edhe derrat me i ushqy. Këta i ka qerasur Shaqir Fetai, edhe atë me paratë e fitrit dhe të zekatit, ndërsa nuk e shtroi qoftë vetëm një iftar, me një supë të ngrohtë e me një sallatë të lehtë për një fukara, për një jetim, për një të ngratë!

### **Islami në RMV fillon me instalimin e Shaqir Fetait (kështu mendon ky!)**

Myslimanët e vendit e kanë traditë jetën fetare pas iftarit, përplot me ibadete e lutje të shtuara, në krahasim me muajt e tjerë të vitit. Devotshmëria e këtyre myslimanëve është, pa dyshim, më e sinqertë në Ballkan dhe më gjërë! Dhe, përfshirja e Shaqir Fetait në këto lutje është akt i mëkatshëm, është pajtim vullnetar për ta njollosur besimin, ndërgjegjen dhe sinqeritetin e shtuar para Zotit të Madherishëm! Shaqir Fetai, ky farë ciniku dhe i tredhuri në tru, mendon se islami në këtë nënqiell ia ka dalur të vie në shprehje me instalimin e tij në krye të BFI-së. Më herët, sipas bindjes së fuqishme të Shaqir Fetait, sidomos në kohën e H. Sulejman ef. Rexhepit, myslimanët e vendit kanë qenë “pa din e pa iman”! E dini pse mendon kështu Shaqir Fetai? Sepse, nuk ka qenie të gjallë më të prishtë se ai. Ku mund të jetë shpirtmirë njeriu që e ha vakëfin, që e shkatërron një jetë të tërë islame, që vjedh, që rrenë, që e blenë postin e vet herë me politikë e herë me fitër e zeqat, që i korrupton bashkëpunëtorët e vet për të siguruar një rehati të brishtë në kolltukun e uzurpuar, që tradhëton e që spiunon, që keqpërdorë pozita e detyra, “miq e shokë”, vetëm e vetëm që të shtojë pasuri personale. A ia keni parë barkun që i ka marrur formë nga gusha e deri në gjunjë?!

### **Nga obligimet që duhet t'i kryejë myslimani duhet të përfitojë Shaqir Fetai**

Cila bashkësi fetare në rajon dhe më gjërë e ka çmimin më të lartë të Haxhit të sivjemë se sa BFI-ja e Shaqir Fetait! Në fakt, të gjithë e kanë bërë transparent çmimin, me përjashtim të Shaqir Fetait. Hala, asnjë mysliman i vendit dhe më gjërë zyrtarisht nuk e di se cili është çmimi i haxhit të sivjemë që e ka caktuar “BFI-ja”! Në fakt, ky çmim do të jetë ashtu siç do t'i levërdisë Shaqir Fetait, nuk është çmim që diktohet nga politikat shtetërore e fiskale të Shtetit të Arabisë Saudite,

por, thjesht, është një çmim që caktohet varësisht sa do të fitojë Shaqir Fetai për kokë të haxhiut! Pra, BFI-ja dhe Shaqir Fetai organizojnë haxh, jo për t'i ndihmuar myslimanët e vendit për ta kryer një obligim fetar një farz, siç organizohet namazi kolektiv, siç organizohet dhënia e fitrit, zeqatit, anëtarësisë, por, thjesht, organizohet me çmimin aq sa i do b... Shaqir Fetait! Ky farë biçim myslimani shumë shpejtë do të nisë të kërkojë edhe tatim për deklarimin e shehadetit! Regjistrohuni e mos pyetni për çmim, regjistrohuni se u mbush numri! Asnjë i regjistruar nuk e di se cili është me radhë në atë listë! Po flitet se kjo është një strategji e hajnave! Numri prej 2000 haxhilerëve, aq sa është kuota, do të mbushet shumë shpejt, bashkë me mërgimtarët që kanë shtetësi dhe pasaportë të Maqedonisë së Veriut, kurse, shumë kandidatëve të pasur dhe me ekonomi familjare stabile, (i njohin hajnat e BFI-së, shumë mirë), do t'ju thonë se janë të rrezikuar që të shkojnë në haxh, sepse numri është mbushur para se ata të regjistrohen. Mjafton kjo fjali që “të pasurit” të shtojnë inat dhe të ofrojnë shuma të majme vetëm e vetëm që të spostohen nga radha “më të varfërit”! Këtë lojë po përgatit Shaqir Fetai përmes Irsal Jakupit dhe hajnave të tjerë, të cilët as nuk e tregojnë cili është çmimi dhe as që e bëjnë transparente listën e haxhilerëve të paraqitur e të regjistruar sipas radhës!

Nuk ka asnjë dyshim – Shaqir Fetai haxhin e përdor për përfitime të majme. Shet viza, i kushtëzon të pasurit me pagesa të majme për të zënë radhët e kandidatit të mundshëm për haxh, i mban nën ethe të devotshmit që mezi ia kanë dalur të bëjnë një grusht parashë për ta kryer Haxhin dhe për t'i vizituar viset e shenjta!

### **Sa fiton Shaqir Fetai për kokë të haxhiut**

Opozita tashmë e ka bërë me dije se cili është çmimi që Shaqir Fetai ua ka sugjerur myftinjëve të vetë në një takim formal! Dhe, askush nuk e ka të qartë dhe nuk di se si Shaqir Fetai ka ardhur deri te ai çmim! Pa dyshim, haxhi është i kushtueshëm, ka shpenzime e veta, por, a janë këto shpenzime aq sa ka caktuar Shaqir Fetai! Asnjë mysliman i vendit (përveç drejtusve të opozitës) nuk di se sa janë biletat e fluturimit, sa janë hotelet në Meke e sa në Medinë, sa kushton transporti i brendshëm, sa kushton ushqimi, sa kushtojnë taksat dhe shpenzimet e tjera të rastësishme! Nëse do të tregoheshin, sakaq myslimanët e vendit do të mësonin se Shaqir Fetai ka vendosur që për kokë të haxhive të fitojë nga 1500-2000 euro! Pra, taksa e Shaqir Fetait: 1500-2000 euro të paguajnë të gjithë ata që dëshirojnë të shkojnë në haxh me paratë e tyre! Ky është “fitimi legal” ndërsa fitimi ilegal është edhe më i madh (shitja e vizave, blerja e vendit në listë, mostherria e kurbanëve të cilët haxhinjëve u merren lekët në kuadër të çmimit total etj.)! A nuk është ky krimializim i Haxhit që po e bën Shaqir Fetai me honxho-bonxhot e vet!

Veç kësaj, Shaqir Fetai ka vendosur që haxhilerët tanë t'i masin kapuçët me haxhilerët e vendeve të pasura! Cakton hotele e kushte ideale të cilat janë të papërballueshme për standardin e haxhilerëve tanë. Me këtë lojë të pistë, në fakt, Shaqir Fetai ua bën me dije të gjithë njetlinjëve që, nëse dëshirojnë të shkojnë në haxh, duhet të nisen sipas kushteve të Shaqir Fetait, ndryshe, ngelin në shtëpi! Kurrë nuk i ka vizituar xhematet tona dhe asnjëherë nuk ka biseduar me ata, nëse janë të mendimit të kenë një haxh solid, apo të shtrenjtë, të jenë dy hapa larg Xhamisë së Pejgamberit apo Qabes e të paguajnë sa paguan “amerikani” apo të jenë një kilometër më larg e të paguajnë sa mund ta mbajë standardi dhe buxheti ynë familjar! Shaqir Fetai nuk e ka qëllim lehtësimin e kryerjes së obligimeve fetare, porse, e ka synim vështirësimin sa më të madh të tyre me qëllim që, mundësisht, të heqin dorë edhe prej fesë për shkak të tatimeve të larta! Shaqir Fetait i intereson që çmimet të jenë sa më të larta, sepse mundësitë për vjedhje do të jenë më ideale. Ky është synimi i këtij shpirtziu!/**Top24/03.05.2023**

## **Editorial: Plackitje Institucionale e haxhilerëve**

### ***Nga Levizja Myslimane per Reforma ne BFI***

BFI-ja e Shaqir Fetait, e gjendur nën presionin e opinionit të gjërë, më në fund, pranoi të dalë dhe publikisht ta pranojë çmimin e haxhit të sivjemë, të cilin, opozita e saj e ka bërë publike tash e një muaj më parë!

Shaqir Fetai thotë se, bazuar në vendimet e një mbledhje “sekrete” masonerike të “rijasetit” të tij, çmimi për haxhin e sivjemë do të jetë 6550 euro! Çmimi më i shtrenjtë në rajon, çmim ky që matet me çmimet e vendeve me standard ekonomik e jetësor super të lartë!

Po pse vendimet e një organi fetar të jenë aq sekrete dhe të publikohen vetëm kur organi mbështetet për muri, kur lakuriqësohet tërësisht në synimet e tij për ta vjedhur popullatën e shkretë! Çmimi i haxhit është një punë që bëhet publik hala pa nisë regjistrimi i haxhilerëve. Publikohet çmimi dhe tek pastaj, varësisht nga xhepi, paraqiten haxhilerët për t’u regjistruar! Çka ka bërë Shaqir Fetai! E hap regjistrimin, i manipulon myslimanët e diasporës (që kanë pasaportë maqedonase) dhe, vetëm regjistron, e shton numrin përtej kuotës së caktuar nga zyrtarët arabë dhe, pasi konkurrenca të arrijë në nivel të konsiderueshëm, e publikon çmimin, duke ua përcjellë mesazhin kandidatëve: nëse ju duket shtenjtë, mos udhëtoni, sepse ka plotë që po presin të paguajnë! Ato vende që lirohen nuk bëhen publike, porse me ato vende shantazhohen grupi prej njëmijë vetëve që janë “tepricë”, duke u thënë se, kush paguan më shumë, ka gjasë që t’i sigurohet një vend duke i eliminuar haxhilerët hallexhinjë të cilët as vetë nuk e dinë se në cilin numër rendor janë me radhë!

Hajni e përkryer kjo e Shaqir Fetait! Zatën, kjo hajni “profesionale” e tij është dëshmuar edhe më parë, dhe gjithnjë e bën atëherë kur e ndjenë momentin e largimit! Ka instiktin e mamuthit, i cili, sapo ta ndjejë vdekjen e vet, shkon dhe e hap varrin! Ngjashëm veproi edhe kur u përgatit për ta lënë myftullëkun sapo i thanë që të bëhet gati për tradhëtinë e madhe që do ta sjellë në pozita të “reisit”! I dëboi arabët të cilët ishin gati për një investim kapital i cili do të ngelte vakëf i Gostivarit duke i gjeneruar kësaj Myftinie miliona euro! Kërkesa për përqindje, për përfitim personal nga një investim i huaj, i detyroi arabët që tek Shaqir Fetai ta shohin hajdutin i cili, për interesa personale nuk do me ia ditë për parimet islame!

Tani, kur po e nuhatë largimin e tij nga “reisllëku”, insiston që bashkë me mentorin e vet të hajnisë, Irsal Jakupin, ta zbatojnë strategjinë e vjedhjes së haxhit, me të cilën strategji Irsal Jakupi kishte ardhur në postin e sekretarit të BFI-së (kjo strategji e tij u publikua me rastin e publikimit të “bombave”, përgjimeve, që i bënte publike ish-ryeministri, Z. Zajev)!

Shaqir Fetai, i revoltuar nga interesimi i opinionit për ta bërë publik çmimin e haxhit të sivjemë, ai tregon dhe e bën “transparente” (!!!) se ku do të shpenzohen paratë e haxhilerëve, duke trilluar dhe duke e bërë transparent synimin e vjedhjes së madhe! Me transparencë nuk nënkuptohet “dëshmia” se ku shpenzohen paratë, por sa dhe si do të shpenzohen paratë! Për shembull, sa do të jetë çmimi i vaksinës, edhe pse vaksina vjen falas nga Turqia. Nuk e tregon çmimin për ilaçet, edhe pse ato mund të sigurohen gratis nga shteti! Nuk tregon se sa do të paguhen doktorët dhe udhëheqësia e haxhilerëve (hoxhallarët) edhe pse, shumica prej tyre, do të jenë delila. Organizatori duhet të sigurojë “drejtues” nga nëpunësit e vet, të cilët edhe paguhen me rrogë për kryerjen e obligimeve fetare kundrejt popullatës myslimane!

Pra, justifikimet e Shaqir Fetait se ku do të harxhohen mbi 13 milion euro të haxhilerëve, janë përpjekje për ta kamufluar vjedhjen e madhe të Irsal Jakupit, i cili, pa dyshim që, fitimin nga ky “bisnes” do ta ndajë me Shaqir Fetain! Për këtë paftyrësi pa dyshim që mallkimi i Zotit dhe pesha e djersës së myslimanëve të ngratë do të bie mbi këta hajna profesonistë të cilët hajninë e konceptojnë si çështje reformash në BFI! /1KlikLarg/Kombetare/05.05.2023

## **Personi X**

**Personi, si Shaqir Fetai, i cili një karrierë të tërë prej intriganti e ka ngritur mbi vjedhjen, mbi tradhëtinë dhe komplotin, mbi gënjeshtrenë dhe trillimin, mbi akuzat kurrë të paprovura përpara opinionit dhe drejtësisë, natyrisht që në fund të “karrierës” do të duhet të ndërmarrë ca masa me qëllim që, pas “karrierës” të dalë i “paaksesueshëm” as nga drejtësia e as nga mbrojtësit e rendit dhe të sigurisë! Mbetet të shihet se sa do t’ia dalë kësaj Shaqir Fetai**

### ***Nga Mahir Rexhepi***

#### **1.**

Shaqir Fetai i vodhi arabët që po tentonin të ngrisinin vakëf miliona euro në Gostivar dhe, ata u detyruan që të ikin! Shaqir Fetai u trimërua në këtë vjedhje pasi që “babai shpirtëror” i tij, ish-reisul ulema, ia kishte hapur magazinën e lavdëratave që të vjedhë merita të huaja! Shaqir Fetai u trimërua të vjedhë nga kontributet e myslimanëve të vendit, madje, përveç kësaj, me heshtjen e tij prej qyqari e stimuloi vjedhjen masovike nga kolgët e vet në profesionin e hajnisë. Shaqir Fetai e vodhi një post të cilin, në mënyrë legale e legjitime, kurrë nuk do ta arrinte, sepse, që të gjithë faktorët vendimtarë e dininë se kush është Shaqir Fetai, kush kishte qenë ai si student dhe si kishte bashkëpunuar me shërbimin e UDB-së!

Shaqir Fetai, meqë kishte qasje në dosjet policore të secilit drejtues të organeve të BFI-së, të cilët vendosin për fatin e “reisit”, ai mjeshtrosh ia doli që ta përdorë këtë epërsi dhe t’i kanalizojë të gjithë në projektin e komplotit përmes të cilit do të tradhëtohej njerun që i kishte bërë “insanë” dhe që ua kishte zgjatur pamertueshëm dorën për t’i nxjerrur në “bregun e karrierës”! Kësisoj, Shaqir Fetai ia doli që ta kryej vjedhjen më të madhe në historinë e BFI-së – vodhi pozitën të cilën për më të madhin kijamet nuk e meritonte! Me ndihmën e organeve të drejtësisë, me ndihmën e organeve të rendit e të sigurisë si dhe me ndihmën e strukturave të ngjashme antiislame, ia doli që të insalohet në krye të BFI-së! Më tej, qëndrimin në këtë pozitë e vodhi prej anëtarëve të “rijasetit” të tij, duke i shantazhuar e duke i blerë me paratë e vjedhura nga arka e BFI-së! Ia vidhte vizitat qytetarëve që kishin dëshirë të pijnë nga një çaj me “reisin” ndërsa ky i paraqiste si përkrahës dhe urues të “detyrës së re” prej hajduti!

Tashmë organet antiislame e kanë parë gabimin fatal që e kanë bërë me këtë instalacion të shpifur, e kanë parë që Shaqir Fetai është njeriu më i rrezikshëm që për fe ka intrigën, kanë nisur që ta lënë në baltë dhe haptazi të kërkojnë falje për gabimn që e kanë bërë. Këtë ndiesi e ka edhe Shaqir Fetai, prandaj, po ngutet që të kërkojë “çare” prej organit të drejtësisë dhe të rendit e të sigurisë! I viziton njërin pas tjetrit!

#### **2.**

Ministria e drejtësisë ia paska organizuar një pritje me nivel të lartë të organizimit!!! Kështu thotë, pa fije turpi, Shaqir Fetai! Kështu ai përpiqet që ta degradojë edhe ministrin por edhe ministrinë, të cilët, paskan organizuar një pritje të nivelit të lartë! Për kë? Për ORAO-n e Stanko Dragoviqit të UDB-së?!

Shaqir Fetai, në mënyrë cinike thotë: “Mbetet që në të ardhmen të bashkëpunohet në nivele të ndryshme në mes BFI e RMV dhe Ministrisë së drejtësisë”! Në çfarë nivele të ndryshëm mund të bashkëpunojnë Ministria e Drejtësisë dhe BFI-ja? Është vetëm një nivel bashkëpunimi: drejtësia të shkojë në vend! Ministria e Drejtësisë ka për obligim që të nxisë organe kompetente që të hulumtojnë vjedhjen, keqpërdorimin e pozitës dhe detyrës zyrtare si dhe shpërdorimet e të gjitha letrave në vlerë që shteti ia ka dhënë BFI-së si pjesë e decentralizimit të pronave të nacionalizuara! Dikush duhet të përgjigjet për këtë vjedhje të ndodhur në kohën e instalacionit të quajtur “Shaqir Fetah”! Nuk mundet që hajnat të përfitojnë nga shteti ndërsa kurrë mos t’i përgjigjen organeve gjegjëse të shtetit!

### 3.

Nëse Drejtësia angazhohet për drejtësi, Ministria e Punëve të Brendshme përkujdeset që kjo drejtësi të shkojë në vend ndërsa të lidhen në pranga të gjithë keqpërdoruesit e të mirave të drejtësisë.

Duke u frikësuar se ky fat do ta ndjek edhe Shaqir Fetain, ky farë “strategu” merr pjesë në Ditën e MPB-së! Secili organ në strategjinë e vet synon që t’i përfshijë në një “poligon” të gjithë shtresat, pavarësisht nëse ndaj ndonjë shtresë shoqërore është bërë padrejtësi tendencioze, është ushtruar dhunë, apo edhe likuidime! Me këtë tubim në fakt vetëmasa justifikohen masat e dhunshme që janë përdorur qëllimisht, sa për të ushtruar superioritetin institucional ndaj “ardhacakëve”!

Edhe Ministria e Drejtësisë, por edhe ajo e Punëve të Brendshme është shumë koshiente për padrejtësinë dhe montimet politike të shumë rasteve të ndodhur mbi shqiptarët e RMV-së. Asnjëherë nuk u kërkua falje publike nga kjo Ministri për dhunën e ushtruar mbi shqiptarët! Asnjëherë nuk u kërkua falje publike mbi kualifikimet politike të kësaj ministrie (ju kujtohet Gordana Jankullovskaja) për plakën shqiptare 64 vjeçare te e cila u gjet një Kuran dhe, mjaftoi ky fakt që plaka të akuzohet si “fundamentaliste dhe terroriste myslimane”! Shumë dhunë e kualifikime politike të kësaj Ministrie pa e dhënë gjykimin organet e drejtësisë! Nuk kanë ndodhur këto raste para 100 viteve! Kanë ndodhur sëafërmi dhe, asnjëherë nuk u kërkua, për hirë të bashkëjetesës, një falje publike ndaj shqiptarëve dhe, përgjithësisht, ndaj myslimanëve! Dhe Shaqir Fetai shkon dhe ua nderon Ditën Ministrisë e cila u ka shumë hak shqiptarëve, myslimanëve të vendit!

Natyrisht, nuk do të duhej të bojkotohej, por, nderimi do të duhej të bëhej me delegacion të nivelit më të ulët dhe jo me prezencë t’i bekonte vetë Shaqir Fetai!

Apo, mesazhi i pjesëmarrjes së tij në këtë Ditë ishte: “Kur t’i lidhni duart, m’i lini pak të shlireshëm prangat”!

Shaqir Fetai është shumë i vetëdijshëm se përgjegjësia për tradhëti, për komplot, për rrena e shpifje dhe për vjedhje do ta zë shumë shpejt! Nuk do t’i shpëtojë mallkimit për tërë atë degradim e devalvim që ia bëri BFI-së si dhe vetë fesë islame. Islami nuk mund të zhvillohet mbi parimin e vjedhjes, të tradhëtisë e të komplotit. Këtë e di dhe vetë Shaqir Fetai! Ndaj dhe trishtohet nga ajo që do ta presë!/**1KlikLarg/09.05.2023**

## Çka po ndodhë në BFI

**Bisedat rreth BFI-së së Shaqir Fetait dëgjohen gjithandej! Nëse hyp në taxi, ose, nëse futesh në një çajtope, nëse ulesh në një restorant, nëse ulesh në karrigen nën hijen e “parkut të pleqve”, nëse shkon në një dasëm, në një mevlud, në një ndeje miqësore, janë të pashmangshme bisedat rreth BFI-së! Çfarë nuk dëgjon njeriu! Dhe të gjitha nisin me “ma tha njëri nga brenda”! Aty harami ka arritur pikën e vlimit, veçsa nuk ka shpërthyer**

### *Nga Mahir Rexhepi*

Sa janë të besueshme bisedat e tilla që dalin nga brenda BFI-së? A mos po bëhen në formë të shantazhit, a mos po gënjehet vetëm sa për ta njetosur gjithnjë e më shumë BFI-në (mision ky i planifikuar i Shaqir Fetait), apo, po shprehet një lloj reflektimi i njerëzve që ia dhanë përkrahjen njeriut që pranoi që, mbi baza të haramit, të veprojë dhe ta drejtojë një Institucion shekullor fetar!

Pse a mos është intriga hallall? A mos është tradhëtia hallall? A mos është hallall marrja e pushtetit me rrena e dallavere duke e nxirë personalitetin e tjetrit? A mos është hallall marrja e pushtetit duke e kërkuar përkrahjen e strukturave antiislame, antikombëtare si dhe të atyreve që janë marionetë e këtyre strukturave? A nuk është haram arrdhja në krye të një institucioni fetar pas një karriere goxha të gjatë prej spiuni në shërbime më antiislame siç është UDB-ja (Shaqir Fetai, sipas dokumenteve të publikuar, aty veproi me nofkën ORAO”)?

Pas këtyre veprimeve haram, natyrisht që baza e drejtimit do të jetë haram dhe gjithçka do të rrjedhë mbi baza të haramit! Kjo teksta do të zbrërthohet dhe teksta do të çuditen brezni të tërë se si ka mundur të ndodhë një tradhëti kaq e madhe, një drejtim kaq i poshtër antifetar dhe një intrigë kaq e djallëzuar dhe e denjë vetëm për njerëzit e shturur dhe shpirtzinjë.

Po çka po ndodhë në BFI-në e Shaqir Fetait? Asgjë më pak e as më shumë se sa vazhdimi i intrigave, sepse, krejt kjo lojë e ndytë nisi me intriga. Dhe, nuk ka gjasë të ndalojë apo të përfundojë ndryshe përveçse me intriga! Pyka del me pykë!

Shaqir Fetai për të ardhur në krye të BFI-së u desht që ta tradhëtojë dhe t’ia ngulë thikën pas shpine njeriut i cili ia kishte hapur të gjitha dyert e perspektivës! Shaqir Fetai, si skuth që është, nuk deshti që të dalë i përlyer i vetëm nga kjo lojë, porse, në të i futi të gjithë bashkëpunëtorët e ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit, njerëzit më të afërt dhe më të besueshëm të tij! Edhe këta e tradhëtuan efendi Rexhepin, madje u bënë palë me intrigantin më të tmerrshëm. Vjen momenti i vetëdijësimit, apo i shpagimit të fajësisë. Janë po këta bashkëpunëtorë që e tradhëtuan H. Sulejman ef. Rexhepin, që iu bashkangjitën lojës dhe intrigës së Shaqir Fetait dhe që, tani, meqë po e ndjejë peshën shumë të rëndë të tradhëtisë, kanë filluar që të mbajnë kontakte edhe me ish-reisin e tyre. Ish-reisi i tyre gjithnjë, çdo ditë të lume informohet se çfarë po ndodhë brenda, çfarë po vepron Shaqir Fetai, si po i shpërdoron paratë e BFI-së duke blerë “bashkëpunëtorë”! Sa i hidhërohet njëri e sa tjetri. E kanë hetuar se ky për ruajtjen e pozitave të veta është në gjendje ta thajë arkën e BFI-së, sepse, nuk po i jep paratë e veta, po i keqpërdorë fitrin e zeqatin, kontributin e myslimanëve, për të cilët, Shaqir Fetait nuk i ka hëngër kurrë dhe as që i ha b...

Të njëjtit bashkëpunëtorë, pastaj, sjellin informata te Shaqir Fetai nga H. Sulejman ef. Rexhepi! Dhe, bartja e informacioneve në mes dy kampeve më së shumti i intereson Shaqir Fetait, sepse ky është gjallë i interesuar që t'i kuptojë planet e subjekteve politike, subjekteve fetare, të palës opozitare, të njerëzve që nuk e duan Shaqir Fetain.

Vetëmse rrëfimet e bashkëpunëtorëve të ish-reisi janë më të tmerrshme, më të çuditshme, më “të sinqertë”! Sepse, ata përveçse raportojnë se çfarë haramesh po ndërmerr Shaqir Fetai, ata po rrëfejnë edhe për personat se kush i organizoi, kush i tuboi, kush i shantazhoi që t'i bashkangjiten komplotit të Shaqir Fetait, po flasin për planin dhe strategjitë si u zhvilluan dhe arsyen se pse u zhvillua tërë ajo lojë e ndytë. Këta bashkëpunëtorë po e ndjejnë shumë të rëndë peshën e fajit në shkatërrimin e BFI-së dhe në devalvimin e jetës fetare islame në vend. I rrëfejnë ish-reisit edhe përkrahjen që sot ia ofrojnë Shaqir Fetait strukturat e ndryshme, nga jashtë e nga brenda, që nuk kanë të bëjnë asgjë me BFI-në dhe që janë shumë të rrezikshme si për kombin ashtu edhe për fenë. Pranimi në zyre i të dërguarve të Putinit, krijimi i oponionit pozitiv për lojalistët çeçenë të Putinit, ishte momenti vendimtarë që i bëri të reflektojnë sado pak bashkëpunëtorët e efendi Rexhepit me të cilët aktualisht po menaxhon Shaqir Fetai!

Kurse Shaqir Fetait ia rrëfejnë strategjinë e ish-reisit për t'ia rrëmbyer bashkëpunëtorët dhe, të lidhur në mes vete, japin emra se kush mund të shkojë te ish-reisi dhe për sa para mund të mbahet në taborin e komplotistëve. Kësisoj, e rjepën Shaqir Fetain, i cili, për postin e vet jo se po ia ndinë fortë për shpenzimin e parave të vakëfit, të fitrit e të zeqatit.

Ja, kjo po ndodhë sot në BFI – vazhdimi dhe tjerrija e intrigave nga më të ndytat. Janë po të njëjtat figura që po e luajnë e që nuk u intereson as Shaqir Fetai dhe as Sulejman Rexhepi, porse paraja: kush ofron më shumë do të jenë në krahun e tij! Po një ditë kur do të mbarojnë paratë? Dhe, kjo ditë, po vjen shumë shpejt, këtë nuk po e vërenë vetëm Shaqir Fetai dhe bashkëpunëtorët e tij që po e tradhëtojnë te “babai shpirtëror” i tij i dikurshëm!/**Kombetare/11.05.2023**



## **Vedimi qeveritar që ia zbulon blofin Shaqir Fetait**

**Vizat dalëse janë recidivë e ish-sistemit komunist! Udhëtarët e shteteve demokratike kanë nevojë (jo domosdo) për viza hyrëse në shtetin që e vizitojnë e që mund të mos ketë marrëdhënie diplomatike ndërshtetërore. Më në fund, Qeveria e Maqedonisë së Veriut u ndërmend se po bën një padrejtësi absolute kundër haxhilerëve me regjimin e vizave dalëse, ndaj dhe të njëjtat i hoqi. Por, a e zbriti këtë shërbim Shaqir Fetai nga çmimi i Haxhit të sivjemë? A do t'ua kthejë haxhilerëve paratë e vizave, por edhe të vaksinave, sepse ato vijnë gratis nga Republika e Turqisë**

***Nga Mahir Rexhepi***

### **1.**

Dy komunikata që e nënvlerësojnë njëra tjetrën: komunikata e Shaqir Fetait dhe komunikata e zëvendëskryeministrit të parë të Qeverisë, z. Aran Grubi!

Shaqir Fetai pohon se më në fund Qeveria e Maqedonisë së Veriut reflektoi dhe e plotësoi kërkesën e tij shtruar kësaj Qeverie, lidhur me heqjen e vizave dalëse për haxhilerët që ishte vënë që në fillim të viteve '90. Më herët ishte edhe për ata që dëshironin ta vizitonin Shqipërinë! Pra, vizat dalëse ishin si një lloj pengese për të udhëtuar në ato shtete me të cilat shteti i udhëtarit nuk kishte marrëdhënie diplomatike! Shaqir Fetai për 30 vite nuk u kujtua që të kërkojë që kjo vizë të hiqet. Shaqir Fetai as që e ka ditur se pse është viza dhe a mund të hiqet! Shaqir Fetait, meqë i prish mjaft punë heqja e vizës në këtë kohë, e përçmon qëndrimin e qeverisë duke e interpretuar atë si dorëzim para “trysnisë” së tij që ia paska shtruar në formë kërkesë!

Shaqir Fetai deklaroi: “Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut sot me propozim të Ministrisë së Brendshme hoqi vizat dalëse për haxhilerët. Me këtë u realizua kërkesa e Rijasetit të BFI drejtuar MPB, respektivisht Qeverisë së RMV”!

Ndërsa, zv/kryeministri i parë, z. Artan Grubi askund nuk përmend as kërkesë të Shaqir Fetait dhe as që e llogaritë këtë matrapaz dhe, thotë: “Po ndaj me ju lajmin se në seancën e sotme të Qeverisë, me propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, miratuam vendimin për heqjen e vizave dalëse për kryerjen më të lehtë të obligimit fetar të besimtarëve myslimanë të vendit tonë – Haxhit. Qeveria me kujdes do të ndjekë udhëtimit e haxhinjve dhe do të jetë e hapur për çfarëdo lloj ndihme që atyre do t’ju nevojitet nga institucionet shtetërore”, shkruan në Facebook, zëvendëskryeministri Artan Grubi.

Shaqir Fetai, tashmë i dëshmuar si kallëpi i skuthit, këtë gatishmëri qeveritare, respektivisht të drejtuesve shqiptarë të institucioneve shtetërore, e përkthen në këtë formë: “Njihërit Qeveria e RMV deklaroi se do jetë plotësisht në shërbim të organizimit të Haxhit”! Kjo i bie që Qeveria e Maqedonisë do të jetë koorganizatore e Haxhit bashkë me BFI-në e Shaqir Fetait. A është në vete ky farë matufi a ka dalë krejtësisht prej kollsekut! Qeveria nuk mund të jetë në shërbim të organizatorëve matrapazë, por, detyrimisht duhet të jetë në shërbim të qytetarëve të vet, pra të haxhilerëve. Nëse është kështu, atëherë, qeveria urgjentisht duhet të kërkojë prej organizatorëve hajdutë të BFI-së që sa më shpejt ta zbresin çmimin e haxhit si dhe t’ua kthejnë haxhilerëve paratë e vizave dalëse. Sepse, në komunikatën e BFI-së, në arsyetimin se pse çmimi i sivjemë është kaq i lartë, veç të tjerash, në pikën e parafundit të arsyetimit, thonë se, në këtë çmim hyn

edhe viza dalëse! Qeveria duhet të intervenojë dhe dhënien e vaksinës duhet ta konsiderojë si shërbim ndaj qytetarëve, sepse, nuk shpenzon asgjë për këto vakcina të cilat vit për vit vijnë gratis nga Turqia. Prandaj, edhe për këtë “çmim” të vaksinave duhet të kërkojë që t’u kthehen paratë haxhilerëve me çrast dukshëm do të zbriste çmimi!

## 2.

Vitin e kaluar, Shaqir Fetai nuk shkoi në haxh! Ishte nën trysinë e medresantëve të cilët, më në fund u ndërgjegjësuan dhe u ngritën kundër lojës së ndytë të Shaqir Fetait, i cili, në emër të lojalitetit të fliqtë të tij karshi vendimeve shantazhuese qeveritare (për degradim të vakëfit të nacionalizuar!), nuk po ia del që t’ua zgjidhë problemin e regjistrimit të medresantëve nëpër fakultetet shtetërore. Me këtë qëndrim të pistë Shaqir Fetai po ua ndërpret karrierën akademike qindra motrave dhe bijave tona, qindra vëllezërve dhe djemve tanë! I frikësuar se do t’i dalë situata nga duart rrencaku u fut në mesin e nxënësve dhe, për t’u mirëpritur, atyre iu drejtua: “Akreditimi i Medresesë është gati! Sivjet nuk do të shkoj në haxh! Arafati im sivjet do të jetë akreditimi i Medresesë që do ta bëjmë këto ditë”! I rrejti në ditë me diell. Edhe sot e kësaj dite nuk ka akreditim!

Sivjet nuk do të shkojë në haxh jo sepse do ta akreditojë Medresenë, por sepse në Berlin e ka humbur pasaportën diplomatke (apo e ka kontrabanduar me ndonjë “vëlla mysliman” nga shërbimet sekrete ruse)!

Shaqir Fetai paska pritur maturantët e Medresesë sonë dhe u paska premtuar që edhe sivjet do të jetë në mesin e tyre për mbrëmjen e maturës! Me sa fytyrë do t’u dalë përpara. Nuk e ka dert Shaqir Fetai nëse u del edhe pa fytyrë (imoral), me atë pamje prej kozaku! Sërish do t’i gënjejë! Nuk ka akreditim, porse ka “pehlivanllëk” të Shaqir Fetait për t’ia “ngulur” Qeverisë! A do t’ju tregojë Shaqir Fetai medresantëve se tashmë ka hequ dorë nga koncepti i Medresë klasike! Nëse akreditohet Medresja nuk do të jetë ajo Medrese siç e themeloi BFI-ja, por, do të jetë një Medrese e tradhëtuar prej Shaqir Fetait, një vatër arsimore me 40 për qind lëndë profesionale dhe me 60 për qind lëndë të përgjithshme. Kjo do të thotë se, nuk do të kemi hoxhallarë të mirëfilltë nëse nuk do të kryejnë plus ndonjë kurs një apo dy vite pë hoxhë klasik!

A do t’ua thotë medresantëve Shaqir Fetai se ka hequr dorë nga Medresja klasike, edhe atë, si në rastin e përqindjes së lëndëve edhe në rastin e dytë, vendimin e ka sjellë krye më vete, pa respektuar kurrfarë organi të BFI-së! Medreseja, sipas djallëzisë së Shaqir Fetait, do të jetë vatër arsimore publiko-privat me të drejta të barabarta. Me këtë do të priset edhe sistemi i fitrit, i zeqatit, i kontributeve vullnetare etj. Sepse, duke qenë publiko-privat, përqindja e drejtimit përtej drejtimit të BFI-së, mund të jetë e tmerrshme për secilën shkollë fetare, përtej të drejtës për t’u financuar nga fitrat dhe zeqati, nga kontributet dhe djersa e myslimanëve tanë. Zoti na ruajt prej djallëzive të Shaqir Fetait!

## 3.

Shaqir Fetai vazhdon me informimin se ka pritur filan personalitetin, filan udbashin, filan drejtorin, filan ministrin, filan patriotin... Po, ai i pret dhe është i gatshëm t’i presë të gjithë, madje edhe të informojë mbi këtë aktivitet prej debilli.

Shaqir Fetai nuk mban llogari se mund t’ia njllisë biografinë personave që i pret! Ai dëshiron që të ketë sa më shumë njerëz me njollë në biografi siç e ka ky farë dinsëzi. Shaqir Fetai askund nuk bën hajër! Gjithkund ku shkel këmba e tij e pistë, aty bie mallkimi, nuk ecin mirë punët, zvarriten gjërat, zhvillimet shkojnë rëndë e më rëndë. Nuk është kurrfarë kënaqësie takimi me Shaqir Fetain, përkundrazi, është një inat më shumë tek popullata e përgjithshme. Kjo u pa me

çmimin e haxhit, i cili, sapo u publikua, u komentua nga mijëra qytetarë; të gjitha komentet ishin përplotë urrejtje kundër Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai nuk i duhet asnjë subjekti politik, nuk i duhet asnjë organi fetar, nuk i duhet asnjë subjekti juridik e fizik, sepse është intrigant, sepse i shfrytëzon për interesa mesquine. Çdo bashkëpunim me Shaqir Fetain është haram, i destinuar të dështojë bashkëpunuesi, sepse, bashkëpunimin Shaqir Fetai e vë në shërbim të interesit të vet të pistë.

#### 4.

Është aq i poshtër Shaqir Fetai sa i lejon vetes që të tallet edhe me dëshmorët e kombit! E fton të birin e një dëshmori në zyren e vet dhe i kumton se paska autorizuar një person që do ta kryej haxhin për babain e tij dëshmor! Po kush është Shaqir Fetai që të autorizojë delil! Po a është në tokë të bukës ky manjak a jo! Apo, i duhet pak “lagështi” edhe prej dëshmërove. ORAO cakton se kush do të shkojë delil për dëshmorin e kombit?! Manipulator i ulët, i shthurur, i dobët! Vendimi dhe pajtesa për delil i përket familjes dhe kurrësesi Shaqir Fetait, aq më pak një udbashi!

#### 5.

Një sugjerim për myftinitë e vendit, për hoxhallarët e muhafizët që, natë e ditë mundohen, sakrifikojnë nga vetja e nga familja vetëm e vetëm që të nxjerrin hafëzlerë të rinjë. Nuk është e ndershme që tërë atë mund e sakrificë t’ia dorëzojnë në fund myftiut e ky Shaqir Fetait. Për hirë të hafëzlerëve të rinj, mos e bëni këtë gabim! Nuk është e ndershme nga hafizat e rinj që ata të njollosen me prezencën e Shaqir Fetait në çastin e “çertifikimit” zyrtar të personit si “Rojtar i Kuranit”! Një ditë, kur do të rriten këta hafëzlerë, kur do të kuptojnë se janë “promovuar” nga një spiun i UDB-së, do të ndjehen shumë keq! Mos u tallni me çilërsinë e tyre, me fisnikërinë dhe bujarinë e tyre. Ata në momentin e kalimit të provimit para komisionit të hifzit, janë në delir, janë fëmijët më të lumtur në botë dhe, në të tilla emocione, ata e gëlltisnin edhe prezencën e udbashëve, por që, më vonë, do të ndjehen shumë keq.

Një udbash, një hajdut, një rrenc, një manipulator, një tradhëtar, një intrigant si puna e Shaqir Fetait, të dorëzojë çertifikatën e hifzit dhe me këtë akt të mos respektohet vetë muafizi, kjo me të vërtetë që përbën problem të madh, na bën të pyesim veten se sa të pastër dhe të ndershëm jemi në besim! Allahu na udhëzoftë!/**TetovaSot/18.05.2023**